RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË
NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE (DPT)

Për periudhën 01.01.2020- 31.12.2020

Tetor 2021

P Ë R M B A J T J A

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....3
II. HYRJA.....10
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.....12
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET 14
IV.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin, vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm.....14
IV.2. Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë:.....28
- Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut,
- Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,
- Drejtorisë së Hetimit Tatimor,
- Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara
- Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH

IV.3. Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore.....153
IV.4. Auditim i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare.....180
IV.5. Mbi marrëdhëniet e punës dhe pagat në institucion.....227
IV.6. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallrave dhe shërbime.....235
IV.7. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....250
IV.8. Auditimi i çështjeve të tjera të cilat mund të rezultojnë gjatë auditimit.....281
V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....300
VI. ANEKSE 303

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 513/1, datë 14.05.2021, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.05.2021, deri më datën 13.08.2021, në Institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u krye në teren auditimi i ñPërputhshmërisëò.

Auditimi mbuloi periudhën: prej 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm, përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, si Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë së Kontrollit Tatimor; Drejtorisë së Hetimit Tatimor; Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH; Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, hartimin e pasqyrave financiare, marrëdhëniet e punës dhe pagat, planifikimi dhe zhvillimin i procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësojnë tre cilësi: të jenë të përshtatshme (ka lidhje me çështjen që auditohen), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 12 aktkonstatime dhe 1 aktverifikim.

Pas kryerjes së takimit përmbyllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në projetraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Në datën 01.10.2021 në ambientet e KLSH është realizuar takimi përmbyllës midis përfaqësuesve të DPT dhe KLSH, për të cilin është mbajtur protokolli përkatës.

I.b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Përmbledhje e gjetjes	**Referenca RPA**	**Rëndësia**	**Rekomandimi**
1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të rimbursimit të TVSH-së, u konstatua se në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë **88 kërkesa** për rimbursimin e TVSH-së të pranuara por **të pamiratuara** në vlerën totale për **1,992,004 mijë lekë** të cilat megjithëse kanë kaluar afatin ligjor të 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 75/1, pika 1, dhe VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatueseò të ligjit nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pikat 3 dhe 4 të nenit 10.Si rezultat **vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së,** në vlerësimin e audituesve të KLSH-së, është **11,789,313 mijë lekë** (9,797,309 mijë e paraqitur nga DPT plus 1,992,004 mijë lekë kërkesa të pranuara dhe në tejkalim të afatit të miratimit). Gjithashtu kryerja automatike e pagesës nga ana e DPT-së brenda	*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**1.1.Rekomandim**: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të ndërmarrë një iniciativë ligjore me qëllim ndryshimin e VKMNr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, dhe konkretisht pika 3, neni 10, duke hequr frazën *...Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.*

afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim në zbatim të pikës 3 të nenit 10[1], të VKM nr. 953, datë 29.12.2014, për personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% - 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet**pa miratimin e raportit të kontrollit të drejtorive rajonale** paraqet një risk të shtuar për DPT-në për kryerjen e pagesave për rimbursime në vlera të pa konfirmuara nga një raport kontrolli. Kjo e vlefshme për të gjithë ato raste kur vlera e kërkesës së pranuar për rimbursim mund të ishte më e lartë se vlera e miratuar nga raporti i kontrollit.			
2. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në kuadër të auditimit të strukturës, kompetencave, mënyrës së emërimit dhe ndryshimeve të strukturës, hartimit të rregulloreve dhe detyrave funksionale së konstatohet se: legjislacioni i veprimtarisë së DHT nuk ka bashkëveprim të unifikuar midis tyre; Ligji i procedurave tatimore nuk ka përputhje në strukturën të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT; Udhëzimi i procedurave tatimore ka të përcaktuar organizimin Drejtoritë Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor të cilat tashmë janë shkrirë në bazë të riorganizimit të ri dhe ky udhëzim nuk ka ndryshuar; Drejtori i Hetimit vetëm emërohet nga Ministri i Financave dhe raporton tek ai por ai nuk ka pavarësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sepse në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò, ai varet nga zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm, gjithashtu ai vetëm propozon punonjës për tu punësuar në strukturat e hetimit por nuk ka statusin e vendimmarrjes për ta si dhe nuk është vendimmarrës për gjithë veprimtarinë e kësaj drejtorie, sepse sipas ligjit të procedurave tatimore; Rregullorja e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017 nuk është ndryshuar në funksion të ndryshimit të strukturës së Drejtorisë së Hetimit në DPT dhe shkrirjes së Drejtorive të Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor.	*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**2.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të ndërmarrin iniciativën ligjore me qëllim përditësimin e Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñ*Për përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimor*ò, në koherencë me ndryshimet strukturore të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, rritjen e pavarësisë së saj dhe harmonizimin e këtij akti nënligjor me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore.
3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të rimbursimit të TVSH-së, u konstatua se, për vitin 2020 shpenzimet për rimbursimin e TVSH-në bazuar në Ligjin e Buxhetit të vitit 2020 dhe Aktit Normativ nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar, janë **programuar në vlerën për 21,000,000 mijë** lekë dhe janë **realizuar në vlerën16,511,532 mijë lekë** ose në masën 79% kundrejt planit të shpenzimeve. Konstatohet se, Drejtoritë Rajonale të Dibrës, Elbasanit dhe Korçës kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara në vlerën 664,877 mijë lekë ose kanë tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, si në vijim : -Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 453,942 mijë lekë ose në masën 267% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**3.1.Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se, mund të procedohet me kryerjen e pagesave, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve për Drejtoritë Rajonale të cilat prezantojnë situata të tilla.

[1] *Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit,*

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 121,247 mijë lekë ose në masën 34% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së. -Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 89,687 mijë lekë ose në masën 35% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së. Veprime të tilla nga këto Drejtori Rajonale bien në kundërshtim me nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror qe zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.			
4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin ushtrimor 2020, të **ardhurat tatimore bruto dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve** janë realizuar në masën **235,499 milion lekë ose** në masën 95,5%, nga246,480 milion lekë të planifikuara me Aktit Normativ nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar në vlerën 10,981 milion lekë më pak se planifikimi të ardhurave. Megjithëse, peshën kryesore në realizimin e të ardhurave e zënë DR Tatimpaguesit e Mëdhenj me një vlerë për 88,708 milion lekë ose 38 % të të ardhurave bruto dhe të ardhurave nga kontributet, konstatohet se kjo drejtori paraqet një performancë jo të mirë duke rezultuar me një mosrealizim të planit të të ardhurave në masën për 8,3% ose në vlerën për 8,031 milion lekë. Gjithashtu me një performancë jo të mirë paraqitet edhe DRT Dibër e cila ka realizuar planin e të ardhurave bruto në vlerën për 2,797 milion lekë duke reflektuar një mosrealizim të planit në masën 16,64% ose në vlerën për 558 milion lekë më pak se plani. Nga auditimi i procedurave të mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u konstatua se, nuk kanë performancë të mirë në mbledhjen e të ardhurave Drejtoritë Rajonale Tatimore, Vlorë, Tiranë, Durrës ku konstatohet se, vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar për këtë zë në mbyllje të periudhës 2020, përfaqëson 25-27% të realizimit faktik të ardhurave, e ndjekur nga DRT Shkodër, dhe Lezhë. Ndërkohë që Drejtoritë Rajonale Tatimore, me përformancën më të mirë paraqitet Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ku vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar përfaqëson 1.1% të realizimit faktik të të ardhurave. **Mosarkëtimi i të ardhurave nga kontributet** nga ana e DPT-së, për **16,521 milion lekë** nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin nr.16, datë 21.02.2020 i Komitetit të Përmbushjes, i cili ka miratuar planin e të ardhurave tatimore për vitin 2020 për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**4.1.Rekomandim**: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave nga këto Drejtori Rajonale me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës.
5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të drejtorive funksionale në DPT konstatohet se: - Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, për periudhën 01.01.2020-24.07.2020 ka funksionuar me **7** (shtatë) punonjës në strukturë organike, nga 8 gjithsej të miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 3.5.2019 të Kryeministrit (*përfshirë drejtor dhe përgjegjës sektori*) ndarë në 2 sektorë: -Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve (*2 punonjës*), Sektori i	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**5.1.Rekomandim:**Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të

Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara (*1 përgjegjës dhe 4 punonjës*). Për këtë periudhë konstatohet një vend i pa plotësuar me punonjësnë pozicionin drejtor drejtorie, deri me hyrjen në fuqi të strukturës së re bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.2.2020. Me ndryshimet strukturore për periudhën 24 Korrik 2020-Dhjetor 2020, konstatohen katër vende të lira: Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese: me 2(dy) vende të lira/vakante, në pozicionin: P/Sektori 1(një) dhe inspektor 1 (një). Sektori Monitorimit & Analizës: me 2 (dy) vende të lira/vakante, në pozicionin P/Sektori 1(një) dhe inspektor 1(një). - Implementimi i strukturës së re të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut ka filluar në korrik të vitit 2020, ose rreth 5 muaj e gjysmë me vonesë si dhe ka mungesa në personel për këtë drejtori. - Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk është plotësuar me numër punonjësish e kryesisht Sektori i Kontrollit Tatimor ka mangësi në 50 %. Riorganizimi ka konsistuar në ndarjen e kësaj drejtorie në sektorë, pra në shtimin e sektorëve duke mbajtur të njëjtin numër punonjësish.Nga auditimi në Drejtorinë e Hetimit Tatimor konstatohet,mosplotësim i organikës me punonjës në pozicionin e përgjegjës sektori dhe inspektor hetimi kështu:nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës së bashku me 1 punonjës të këtij sektori, nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit së bashku me 4 punonjës të këtij sektori, kur gjithsej janë 9 punonjës ose 45% më pak punonjës së organika, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave. Gjithashtu për periudhën në vijim maj 2020 deri më 31.12.2020 konstatohet se: nuk është kryer ristrukturimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në afatet e përcaktuara po rreth 2 muaj me vonesë, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës, nuk është plotësuar Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të parave me numrin e punonjësve ku konstatohet se nga 3 punonjës ai ka vetëm 1 punonjës; Nga Drejtori i Hetimit nuk janë plotësuar kërkesat e udhëzimit për procedurat tatimore në të cilën shprehet se në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për tô punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke sjellë që shumë vende pune të jenë të paplotësuara.			miratuara.
6.Gjetje nga auditimi: Llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, e cila pasqyron shpenzimet që do të kryhen në periudhat pasardhëse, nuk pasqyron vlerën e plotë. Kjo llogari përbëhet nga vlera 1,500,621 mijë lekë e pasqyruar në llogarinë 486 të pasqyrave financiare të Aparatit të DPT dhe vlera 66,250 nga DRT. Konstatohet se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës stokun e rimbursimit të TVSH-së prej 9.7 miliard lekë nuk e ka pasqyruar në llogarinë 486 -Shpenzime të periudhave të ardhshme, por në llogarinë 467. Mos përfshirja e stokun e rimbursimit të TVSH-së prej 9.7 miliard lekë në raportimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat të udhëzimit plotësues të MFE nr. 2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të viti 2020ò dhe shtojcën 4 ñDetyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-sëò. Mos kontabilizimi i plotë i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 -Shpenzime të	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***I Lartë***	**6.1.Rekomandim**: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për raportimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore të detyrimeve për stokun e rimbursimit të TVSH-së në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH të informojë zyrtarisht Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës për vlerën e detyrimit. Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të ndërpresin praktikën e marrjes së

periudhave të ardhshme, është në kundërshtim me pikës 42 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, ku përcaktohet se detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve duhet të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare në llogarinë 486 sipas llogarive specifike të kontabilitetit. Në vlerën e detyrimeve të prapambetura të raportuara në MFE bënë pjesë edhe vlera e detyrimit për investime prej 569,127 mijë lekë, e cila ju përket dy projekteve të cilët bazuar në kontratat që administron DPT duhet të ishin likuiduar tërësisht. Këto projekte janë: a- **"**Përmirësimi i modulit të Manaxhimit të Kontrollit të Faturimitò (Fiskalizimi), zhvilluar si procedurë në vitin 2018 nga AKSHI, lidhur kontrata nr. 6756 date 27/11/2018 vlere totale 1,727,792 mijë lekë), me kod projekti M100500, me afat përfundimi të likuidimit brenda vitit 2020. Detyrimi i pa likuiduar më 31.12.2020 është në vlerën 512,787 mijë lekë (detyrim jashtë afatit të kontratës). Që nga viti 2018 e në vijim nuk është respektuar likuidimi vjetor i parashikuar në kontratë, por është likuiduar më pak, gjë e cila ka sjellë edhe krijimin e detyrimit të prapambetur më 31.12.2020 në vlerën 512,787 mijë lekë. b-ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, me kod produkti 18AV811, kontrata 3275 date 10/07/2020 vlere 80,040 mijë lekë, e cila është zhvilluar nga AKSHI në vitin 2020, me afat likuidimi brenda vitit 2020.Fillimi dhe miratimi i zhvillimit të kësaj procedure prokurimi nga DPT është bërë pa pasur fonde në dispozicion për këtë projekt, i cili nuk ka qenë i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe në planin fillestar vjetor. Ndryshimi i planit fillestar vjetor dhe futja e këtij projekti në listën e investimeve, është bërë me kërkesë të DPT, jo si rezultat i çeljes së fondeve të reja buxhetore, por si rezultat i transferimit të fondeve prej 23,700 mije lekë, nga projekti ekzistues ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò. Ky transferim ka qenë i gabuar, i paargumentuar, pasi këto fonde nuk kanë qenë fonde ñtepërò për këtë projekt, por fonde të planifikuara dhe të nevojshme për tu shpenzuar për të. Si rezultat për projektin ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, më 31.12.2020 DPT ka krijuar një detyrim të ri të prapambetur në vlerën 56,340 mijë lekë, ose 58% të vlerës së investimit, si dhe ka lënë pa mbuluar me fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2020, investimin ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò, për vlerën 23,700 mije lekë. Pra e gjithë vlera e investimit prej 80,040 mijë lekë, është angazhim i ri buxhetor pa pasur fonde në dispozicion, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, pika 153-162. Mosshlyerja e detyrimeve për angazhimet e mara buxhetore, është në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis palëve, si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.			angazhimeve buxhetor pa pasur më parë fonde në dispozicion. Në hartimin e buxhetit për vitin 2022, më parë të planifikohen fonde (dhe të zbatohen të pa ndryshuara gjatë vitit), fonde investimet e filluara dhe të pa likuiduara sipas parashikimit në kontratë.
7.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò, e cila pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera brenda dhe jashtë sistemit C@TS, detyrimet e kontabilizuara por të mbajtura jashtë sistemit C@TS janë në vlerën 2,809,818 mijë lekë. Detyrimet jashtë sistemit	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**7.1.Rekomandim**: Drejtoria e Kontrollit Tatimor të marrë masa për hedhjen në sistemin C@TS të vlerën 317,577 mijë lekë, detyrime të subjekteve të pa përfshira në këtë sistem dhe

C@TS janë në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo te gjitha deklaratat tatimore ishin te informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin ne ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore. Pjesën me te madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohej dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,107,793 mijë lekë, i përket vetëm 2 tatimpaguesve, ñAò sha me Nipt J në vlerën 2,106,993 mijë leke, subjekt i cili është në administrim te DRT Tirane dhe subjekti ñIò, me Nipt J, në vlerën 799,228 lekë, subjekt i cili është në administrim të DR Tatimpaguesit e Mëdhenj. Detyrimi për akcizën zë 75 % të totalit te detyrimeve jashtë sistemit C@TS, ndërsa 14 % te detyrimeve jashtë sistemit janë raportim nga Sektori i Shpenzimeve në DRT dhe DPT (aparati) te cilat nuk lidhen me të ardhurat tatimore, për rrjedhojë është normale të jenë jashtë sistemit C@TS. Vetëm 11% e detyrimeve jashtë sistemit C@TS, në vlerën 317,577 mijë lekëjanë për të ardhura tatimore për te cilat Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektoret e kontrollit nga zyra, do të duhet ti hedhin në sistemin C@TS, pasi për këto detyrime ka module përkatëse në sistem, si në vijim: Tatim mbi te ardhurat shuma 58,993,901 leke; Tatim fitimi shuma 2,772 mijë lekë; Taksa mbi biznesin e vogël shuma 63,750 lekë; Te tjera tatime (ne burim) shuma 17,556 mijë lekë; Tatim mbi vlerën e shtuar shuma 10,609 mijë lekë; Taksa e rrugës shuma 165 mijë lekë; Gjoba dhe kamate vonesa shuma 10,113 mijë lekë; Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shuma 217,302 mijë leke. Mosêhedhja në sistemin sistemin C@TS të vlerës 317,577 mijë lekë është në kundërshtim me kapitullin 6, ku përcaktohen detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të ñRregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimoreò.			për të cilat ka modul.
8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, u konstatua se për 26 vendime gjyqësore për largimin e punonjësve nga puna, për disa prej tyre ka diferenca të konsiderueshme në kohë midis datës së zbardhjes së vendimit të formës së prerë nga Gjykata dhe datës së depozitimit të këtij vendimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Në disa prej tyre diferenca është me disa vjet, ndërkohë që institucioni angazhon juristë përkatës për ndjekjen e çdo procesi gjyqësor (Vendimi i Gjykatës nr. 10, date 27.12.2013, depozituar në DPT në vitin 2020, shtatë vjet me vonesë, Vendimi nr. 12, datë 22.01.2014, depozituar në DPT në vitin 2020, gjashtë vjet me vonesë, Vendim nr. 28 datë 19.01.2015, depozituar në DPT në vitin 2020, pesë vjet me vonesë, Vendim nr. 3850, datë 20.09.2017, depozituar në DPT në vitin 2020, tre vjet me vonesë). Gjithashtu gjatë vitit 2020 nuk u konstatuan zbatimi i asnjë vendimi gjyqësor në mënyrë vullnetare dhe shpenzimet përmbarimore për këtë vit kanë vlerën 21,959 mijë lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 5, 6 dhe 7 të nenit 101 ñ Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit të çështjeve ligjoreò; Pikën nr. 5 Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò; Neni 15 i ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 ñKodi i procedurës civile i Republikës se Shqipërisëò.	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	***E lartë***	**<u>8.1.Rekomandim</u>**: Drejtoria Teknike dhe Ligjore të marrë masa që me përfundimin e proceseve gjyqësore dhe daljen e vendimit të Gjykatës, të njihet menjëherë institucioni më këtë vendim për të programuar zbatimin e tij në kohë.Të mundësohet në çdo rast kryerja e pagesës së vendimit gjyqësor në mënyrë vullnetare, duke lidhur aktmarrëveshje me kreditorin, me qëllim shmangien e shpenzimeve përmbarimore.

9.Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2020 nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në mënyrë të pa drejtë, në vlerën **377,601 mijë lekë**, **për 198 punonjës, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.** Kjo vlerë është 2.7 herë më e lartë se vlera e shpenzuar për këtë qëllim gjatë vitit 2019 (140,101 mijë lekë). Detyrimi i ngelur për DPT më 31.12.2020 për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna është në vlerën 184,759 mijë lekë për 168 punonjës. Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar proceset gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve nga puna ka qenë i pa rregullt dhe nga institucioni i DPT nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për këtë proces. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga DPT në proceset e largimit të punonjësve nga puna, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi nga DPT, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhetin e shtetit që sjell humbja e çdo vendimi gjyqësor. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*	*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*	***E lartë***	**<u>9.1.Rekomandim</u>:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna, duke ulur në këtë mënyre efektet financiare në buxhet për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pas kryerjes së analizës së vendimeve gjyqësore, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësive administrative, në përputhje me pikën nr. 60, të Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.

I.c. Opinioni i auditimit

Nga auditimi ka rezultuar një opinion i kundërt i auditimit të përputhshmërisë, trajtuar më gjerësisht në bazën për dhënien e opinionit i kualifikuar.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr.513/1, datë 14.05.2021, shkresës nr.513/2 prot., datë 29.06.2021, me lëndë ñNjoftimit për ndryshim në programin e auditimitò, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.05.2021, deri më datën 13.08.2021, në Institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u krye auditimi i ñPërputhshmërisëò. Auditimi mbuloi periudhën: prej 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020.
Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:
1. B. M., përgjegjës grupi
2. M. H., anëtar grupi
3. A. K., anëtar grupi
4. E. B., anëtar grupi
5. A. Z., anëtar grupi

Objekti i auditimit: Auditimi është i llojit ñAuditim përputhshmërieò dhe ka si objekt auditimin e veprimtarisë së DPT për vitin 2020, sipas pikave të programit dhe marrjen garancive nëse ky aktivitet është zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, për DPT. Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe kuadrit mbështetës në fuqi për mbledhjen e të ardhurave tatimore si dhe realizimin e aktivitetit tjetër të institucionit, në përmbushje të misionit që ka struktura e DPT.

Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional dhe i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimin dhe evidentimin e shkeljeve të parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar për miradministrimin e pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2020 deri më 31.12.2021, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive të veçanta në DPT të cilat monitorojnë ecurinë e aktivitetit të drejtorive përkatëse në rajone, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore, shpërndarja e tyre në Drejtoritë Rajonale, hartimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor për vitin 2020, transaksionet ekonomike, planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike, monitorimi i masave të marra për mbledhjen e detyrimet tatimore, efektiviteti i strukturave të veçanta si, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria për Rimbursimin e TVSH-së, etj., si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit si delegimi i kompetencave, zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për punonjësit, plotësimi i vendeve vakante, apo përmirësime ligjore të nevojshme, etj.
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar.
-Drejtori i Përgjithshëm si (*Nëpunësi autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale .

-Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e audituesve : Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Audites Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Kriteret e vlerësimit: Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të procedurave tatimore.

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,
- Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareveò;
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.88/2019, datë 15.12.2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publikò, i ndryshuar;
- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò;
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar;

- Ligj nr.33/2017 ñPër pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimoreò.
- Akte të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Standardet e auditimit Auditimi u bazua në: -Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren ñPër Procedurat e Auditimitò miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107, datë 08.09.2017, i ndryshuar referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:
-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin eaudituar

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është pjesë e Administratës Tatimore Qendrore dhe ndodhet në varësi të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Administrata Tatimore Qendore është i vetmi autoritet që pranon deklaratat tatimore për tatimet dhe taksat kombëtare, përfshirë deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore she shëndetësore, veç atyre që parashikohen në ligje të veçanta, vlerëson detyrimet tatimore, kontrollon saktësinë e deklarimit dhe, mbi këtë baze, përcakton detyrimet tatimore shtese të një tatimpaguesi, si dhe rimbursimin apo kthimin e tatimeve të paguara tepër, nëse ka te tilla.
DPT drejtohet nga Drejtori i Përgjithshmi cili ka në varësi të tij tre Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën, me qëllim realizimin e objektivave të programuara nga Qeveria, duke mbikëqyrur menaxhimin e funksioneve të veçanta në Drejtoritë Rajonale Tatimore.
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë etj. Ky ligj, përcakton parimet bazë mbi të cilat mbështetet sistemi tatimor shqiptar, administrimi i tij. Sanksionohen të drejtat e tatimpaguesve, që në fakt janë një balancë e plotë përkundrejt detyrimeve të tyre kontributeve, në të hyrat e buxhetit të shtetit. Gjithashtu përgjegjësitë dhe funksionet e DPT pasqyrohen qartë në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 24 datë 02.09.2008, përkatësisht pika 14.2 ñAdministrimi Tatimorò. DPT deri në gusht 2020 ka funksionuar me rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave. Me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020 të Ministrit të MFE, është miratuar ñRregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendroreò, në të cilën trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, etj.
Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe renditet si një nga institucionet ligjzbatuese më të rëndësishme në vend.
Funksionet kryesore të punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë si më poshtë:
1. Administron detyrimet tatimore në Republikën e Shqipërisë në nivel qendror për llojet e tatimeve dhe taksave të përcaktuara në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të përcaktuara me ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 ñPër Mbledhjen e

Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.
2. Përgatit dhe miraton planin strategjik të objektivave dhe synimeve kryesore të administratës tatimore qendrore për një periudhë afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë si edhe monitoron zbatimin rigoroz të tij nga të gjitha drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nga të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore. 3. Evidenton nevojat për ndryshime dhe paraqet propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave, lidhur me ndryshimet në ligjet tatimore, në aktet nën-ligjore të nxjerra në zbatim të tyre, në procedurat tatimore dhe gjithë elementët e tjerë që kanë të bëjnë me administrimin e tatimeve.
4. Përgatit dhe miraton procedura standarde pune operative. Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sigurohet se këto procedura promovojnë transparencën e duhur në marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesit, krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë tatimpaguesit dhe reduktojnë subjektivitetin e punonjësve tatimorë.
5. Ofron asistencë për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor, akteve nën-ligjore në zbatim të tij dhe manualeve operacionale në Drejtoritë Rajonale Tatimore.
6. Përcakton, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, masa uniforme për matjen e përformancës së punonjësve të administratës tatimore dhe krijon raporte standarte për të kontrolluar vlerësimin e performancës në nivel kombëtar, si dhe për çdo Drejtori Rajonale Tatimore. Ndjek zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës për Administratën Tatimore Qendrore.
7. Siguron shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore në çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
8. Bashkëpunon me të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, për të përgatitur plane vjetore pune, bazuar në numrin e personelit që është përcaktuar për çdo drejtori dhe në objektivat funksionale të performancës për çdo Drejtori Rajonale Tatimore. 9. Harton dhe zbaton një program vjetor të vizitave të punës në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, për të ofruar asistencë dhe për të kryer vlerësime, lidhur me efikasitetin dhe cilësinë e punës së kryer.
10. Përgatit raporte të vlerësimit të punës për secilën Drejtori Rajonale Tatimore.
11. Miraton planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.
12. Përcakton planin e buxhetit të çdo Drejtorie Rajonale Tatimore dhe kontrollon zbatimin e tij.
13. Përgatit marrëveshje të përbashkëta për të koordinuar punën me shoqatat e biznesit dhe me autoritete të tjera shtetërore, të tilla si: Doganat, Thesari, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, njësitë e qeverisjes vendore, etj., lidhur me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, në interes të administrimit tatimor.
14. Koordinon marrëdhëniet ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me administratat tatimore të shteteve të tjera.
15. Zbaton një politikë rekrutimi të punonjësve tatimorë në zbatim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar, Ligjin nr. 152, datë 30.05.2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, Ligjin Nr. 7691, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, në përputhje me strukturat e miratuara.
16. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Kodit të Etikës për punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me rregullat e etikës së administratës publike.
17. Përgatit, miraton dhe kontrollon zbatimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore për parandalimin e konfliktit të interesit të nëpunësit të Administratës Tatimore qendrore.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV. 1 Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm.

1*/a. Auditim mbi nivelin e implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT, këtu e më poshtë).

Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Nga auditimi u konstatua se, DPT e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, të cilat rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore.

Deri në shkurt 2020, njësia ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".* Me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* është miratuar struktura dhe organika e re. Ndryshimet strukturore me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, konsistojnë me shtimin e 59 pozicioneve të numrit të punonjësve të DPT-së, drejtori e sektorë, si dhe ndryshime në emërtime strukturash.

Gjatë auditimit rezultoi se, DPT ka funksionuar me rregulloren e miratuar me urdhrin nr.19, datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave deri në gusht 2020. Me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE, është miratuar ñRregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendroreò. Në rregulloren e brendshme trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, rregullat e përgjithshme, rregullat e administrimit, funksionet dhe detyrat e tyre. Kjo rregullore vendos rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore**.**

- Me urdhrin nr. 1, datë 21.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar rregullorja e brendshme *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve"*. Qëllimi i kësaj rregulloreje është deklarimi dhe mbajtja e përgjegjësive për deklarimin dhe kontrollon e pasurive, si dhe garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme e transparente, në interes të publikut nga zyrtarët publikë të DPT, si dhe ushtrimi i funksioneve nga punonjësit e DPT, jo në kushtet e konfliktit të interesave.

- Me urdhrin e Ministrit të MFE-së nr.7552 prot, datë 30.04.2020, janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore për MFE, pjesë e së cilës është edhe grupi i menaxhimit të programit 01140 ñMenaxhimi i të Ardhurave Tatimoreò që i përket DPT.
- Me urdhrin e Titullarit të Institucionit nr. 4, datë 29.01.2019, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i kryesuar nga Titullari dhe në cilësinë e anëtarëve janë

caktuar zv.drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive, nëpunësi zbatues si dhe drejtori i DAB në rolin e vëzhguesit.

- Me shkresën nr. 13751/1 prot. datë 16.07.2019, ñZbatim Vendimi nr. 495, datë 15.07.2019 të Këshillit të Ministraveò, është bërë emërimi i znj. D. I., Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve. Me ndryshimet strukturore të DPT, sipas urdhrit nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, ka ndryshuar edhe struktura e shumë drejtorive të DPT, Drejtorët e të cilëve janë anëtarë të GMS. Të detajuar si më poshtë:

- ✓ Drejtoria e Qendrës së Pagesave, është suprimuar dhe ka kaluar sektor në varësi të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës;
- ✓ Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndëristitucional, është bashkuar me Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve;
- ✓ Drejtoria e Qendrës së Thirrjeve, është suprimuar dhe ka kaluar sektor në varësi të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve;
- ✓ Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Komunikimit është suprimuar me urdhrin nr. datë 27.02.2019, të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".* Punonjës të cilët kanë kaluar në strukturë, tek AKSHI.

Konstatim: Titullari i Institucionit nuk ka krijuar GMS të ri, pas emërimit të tij me Vendim nr. 495, datë 15.07.2019, të Këshillit të Ministrave, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe me ndryshimet strukturore me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"* të strukturës së re organike, përbërjen e anëtarëve të GMS. Veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 8 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e titullaritò të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar; si dhe kreu II, pika 2.2.6 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, që citon: *Pika 2.2.6. Grupi i Menaxhimit Strategjik. Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.*

- Gjatë auditimit u konstatua se, me shkresën nr. 16997 prot, datë 31.08.2020, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës të DPT, ka hartuar Programin Buxhetor Afatmesëm, duke përcjellë pranë MFE, pasqyrat e kërkesave buxhetore për vitet 2021-2023. Me shkresën nr. 25231 prot, datë 29.12.2020, ka përcjellë ñDetajimin e buxhetit vjetor të miratuar për vitin 2021ò, brenda afatit të kërkuar, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPT, me shkresën nr. 88/1 prot., datë 26.02.2021, ka dërguar në MFE, pyetësorin e plotësuar të vetëvlerësimit, nëpërmjet të cilit ka synuar ndërgjegjësimin e mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor dhe planin e veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit, mbështetur në nenin 18, të ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar*.

- Gjithashtu u konstatua se, në bazë të nenit 9 ñPërgjegjshmëria Menaxheriale e Nëpunësit Autorizuesò, pika 4/a, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, si dhe Manualin për MFK, Kap. IV ñZbatimi i MFKò, pika 4.2.10 ñRoli i nëpunësit autorizues të njësisëò, është hartuar Plani Strategjik 2017-2021, i cili përmban objektivat strategjike dhe arritjet e tyre, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Strategjia për Menaxhimin e Risqeve, është detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11/2 dhe 21, të ligjit, 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar*, i

cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si të titullarit të institucionit, i cili ka këto kompetenca për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.
Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se, me shkresën nr. 18840 prot, datë 28.09.2020, ñKonkludim procedurashò, të Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, drejtuar Titullarit të Institucionit, si dhe Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve z. K. Sh., ka shprehur të nevojshme përditësimin e Regjistrit të Riskut, duke u bazuar në ndryshimet e strukturës së administratës tatimore.
Nga auditimi rezultoi se,pas 5 muaj, me shkresën nr. 3642 prot, datë 26.2.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është miratuar dhe përcjellë në MFE,Regjistri i Riskut, i hartuar sipas përcaktimeve të kapitullit III, pika 3.2 ñMenaxhimi i risqeveò të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Ky regjistër identifikon dhe kontrollon risqet dhe bën adresimin e personave përgjegjës për çdo risk.
Në kreun III ñKomponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollitò, neni 19 citohet: *Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri□tjetrin:*
1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.
Nga auditimi mbi komponentët e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit rezultoi se:
1. Mjedisi i kontrollit.
Bazuar në nenin 9 ñPërgjegjshmëria Menaxheriale e Nëpunësit Autorizuesò, pika 4/a, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* i ndryshuar, si dhe Manualin për MFK, Kap. IV ñZbatimi i MFKò, pika 4.2.10 ñRoli i nëpunësit autorizues të njësisëò, është hartuar Plani Strategjik 2017-2021, i cili përmban objektivat strategjike dhe arritjet e tyre, prioritetitet e institucionit dhe planet e veprimit.
a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.
DPT ka funksionuar me rregulloren e miratuar me urdhrin nr.19, datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave deri në gusht 2020. Me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE, është miratuar ñRregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendroreò. Në rregulloren e brendshme trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPT-së, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, rregullat e përgjithshme, rregullat e administrimit, funksionet dhe detyrat e tyre. Kjo rregullore vendos rregulla për saktësimin e detyrave funksionale të çdo strukture të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore**.** Institucioni disponon rregulloren ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në DPTò, miratuar me urdhrin nr. 14, datë 21.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe Rregulloren ñPër marrëdhënien e punës të personelit jo nëpunës civilë, në ATQò, miratuar me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2020, Drejtorit të Përgjithshëm.
Kodi i Etikës i Administratës Tatimore është miratuar me vendimin nr. 22, datë 17.12.2020, në mbledhjen e Komitetit të Reformave, pas prezantimit nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 16, datë 02.03.2018, ñPër ngritjen e komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit për grupet e përhershme të punës", i ndryshuar. Më datë **17.12.2020, është shfuqizuar edhe Kodi Etik, i mëparshëm.** Me ndryshimet strukturore të miratuara me urdhrin nr. 33, datë **12.02.2020**, të

Kryeministrit, gjatë vitit 2020 në DPT, pati largime të punonjësve nga puna. Rishikimi dhe miratimi i Kodit të Etikës **me vonesë,në fund të vitit 2020**, bëri që një nga rregullat dhe parimet e përcaktuara në të, që janë të detyrueshme për tâu zbatuar nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore, pavarësisht nivelit të pozicionit të punës, hierarkisë dhe funksionit që ato ushtrojnë, **nuk është zbatuar. Konstatim:** Një pjesë e punonjësve të DPT, të larguar nga detyra, nuk kanë kryer dorëzimin e pajisjeve dhe mjeteve të punës në ngarkim të inventarit personal. Veprim ky në kundërshtim me pikën 13, të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, si dhe të Kreut II, Standardet Bazë të Sjelljes, të Kodit Etik, që citon: *Pika2.1.19. Kur nëpunësi largohet nga detyra (kur jep dorëheqjen, largimit/lirimit nga shërbimi civil apo largohet nga puna), nëpunësi civil brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimit/largimit, është i detyruar të bëjë dorëzimin e detyrës e të gjithë dokumenteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës në inventar. Mosrespektimi i këtij parashikimi përbën shkelje disiplinore sipas legjislacionit për shërbimin civil si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Administratës Tatimore Qendrore.*

b) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.

Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin në DPT, rregullohen në bazë të ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; i ndryshuar, Kodin e Punës në RSH, si dhe dispozitat e tjera ligjore si: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; ligji nr. 7971, datë 26.07.1995, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, lejojnë Titullarin e Institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave, të ndërmarrë hapat e duhura.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Deri në shkurt 2020, njësia ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".* Me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* është miratuar struktura dhe organika e re. Ndryshimi i fundit në strukturë, është bërë me urdhrin 152, datë 19.11.2020, të Kryeministrit, me shtimin e pozicionit të Koordinatorit për Rrjetin Antikorrupsion, i cili është finalizuar në datë 26.02.2021. Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar numrin e punonjësve gjithsej, pozicionin e vendit të punës si dhe kategorinë për çdo pozicion. Struktura përcakton përgjegjësitë dhe kalimin e informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Drejtori i Përgjithshëm deri te specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. Drejtori i Përgjithshëm është dhe Nëpunësi Autorizues i njësisë. Sipas strukturës së njësisë, Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është Nëpunësi Zbatues dhe përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor me synim arritjen e qëllimeve dhe politikave të programit. Drejtori i Përgjithshëm ka në varësi të tij tre Zv/Drejtorët e Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën, me qëllim realizimin e objektivave të programuara dhe mbikëqyrur menaxhimin e funksioneve të veçanta në Drejtoritë Rajonale Tatimore. Me vendimin nr. 22, datë 17.12.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm, janë ngritur Komitetet e Menaxhimit të Punës së DPT, për të përmirësuar drejtimin e brendshëm dhe organizimin administrativ.

Delegimet e detyrave në DPT, bëhen me urdhër të Titullarit të Institucionit dhe/ose me propozim të Drejtuesit të Drejtorisë përkatëse. Lidhur me delegimin e kompetencave, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe

detyrat e tyre, siç kërkohet nga ligji nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar, neni 15 ñRregulla të përgjithshme për delegimin e detyraveò, si dhe Kapitulli III ñDelegimi i detyraveò, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

ç) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të Institucionit janë përcaktuar rregullat dhe detyrat e organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve, ndërmjet njësive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore. Institucioni i ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etikën, komunikimin e paraqitjen, shkeljet disiplinore, orarin dhe qëndrimin gjatë orarit të punës, etj.

d) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, njësia në bashkëpunim dhe nën drejtimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), ka trajnuar punonjësit e saj. Me vendimin nr. 1, datë 20.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar programi vjetor i trajnimeve. Programi pas miratimit, së bashku me kalendarin e trajnimeve nga Bordi i Akademisë Fiskale pranë MFE, zbatohet në bashkëpunim me QTATD dhe ASPA. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përcakton programe trajnimi siç kërkohet edhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III,pika 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm, në paragrafet ñPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreò dhe ñProfesionalizmi i stafitò. Drejtoria e Burimeve Njerëzore e DPT, ka përcaktuar trajnimet që ndiqen të detyrueshme në ASPA, nga punonjësit. Për vitin 2020 janë trajnuar 60 punonjës. Institucioni ka organizuar trajnime për procesin e Fiskalizimit, të gjithë stafit të tatimeve, me përjashtim të shërbimeve mbështetëse. Gjithashtu, janë kryer trajnime për rregulloren e sigurisë së informacionit. Më datë 27.11.2020, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, në funksion të zhvillimit dhe rritjes së aftësive profesionale të stafit të administratës tatimore, si dhe zbatimin e politikave për rekrutimin e studentëve ekselentë në administratën tatimore, rritjen e kapaciteteve njerëzore si pjesë e procesit të zhvillimit, të forcimit të aftësive dhe resurseve të intitucioneve respektive.

2. Menaxhimi i riskut.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore, Institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në mbështetje të pikës 2, neni 11 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisëò, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò i ndryshuar , si dhe pika 2.5.2, Kapitulli III ñMenaxhimi i Riskut në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, me shkresën nr. 3642 prot, datë 26.2.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar dhe përcjellë në MFE, Regjistri i riskut. Risqet kryesore të evidentuara në të, janë:

- Risku i stafit të ri;
- Mungesa e kryqëzimit të informacionit me palë të treta;
- Mungesa e një instrumenti analize të të dhënave jashtë modelit të riskut, i cili do të plotësonte dhe do të ndihmonte për analizën e riskut;
- Gabim në database, si pasojë e mënyrës së mbajtjes nga ana e tatimpaguesve të të dhënave të faturave, në librat e shitjes dhe të blerjes, që Administrata Tatimore e ka të vështirë ti gjurmojë se ku qëndron problematika;
- Implementimi i modulit të riskut në procesin e fiskalizimit dhe harmonizimi i tij me Modulin aktual të Riskut.

Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në DPT

ekzistojnë risqet që kërcënojnë objektivat, struktura e DPT ka mbartur **vende vakante** përgjatë periudhës objekt auditimi, ndaj në këto kushte **riskohet moszbatimi i objektivave.**

3. Aktivitetet e kontrollit.

Proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston ndarja e detyrave. Nëpunësi zbatues në bazë të ligjit për buxhetin, merr përsipër angazhimet për realizimin e programeve buxhetore. Në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet, ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare, kalon në dy procese. Specialisti e harton, përgjegjësi e kontrollon dhe më pas miratohet nga NZ, i cili ia përcjell NA. Transaksionet financiare në këtë institucion kryen në bazë të rregullave të vendosura nga MFE. Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit Excel dhe programit financiar Alpha.

Për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit në DPT, u konstatua se, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, ñPër arkivatò, me urdhrin nr. 18, datë 17.02.2020, të Titullarit të Institucionit, është urdhëruar krijimi i Komisionit të Ekspertizës me përbërjen e 9 anëtarëve, të cilët bëjnë miratimin e listës tip, të dokumentave të përpunuar sipas normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

4. Informacioni dhe komunikimi.

Titullari i Institucionit informohet vazhdimisht nga zv.drejtorët dhe drejtorët e drejtorive, mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të mbledhjeve periodike, informacioneve, evidencave të ndryshme. NZ, nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, informon me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, si dhe me anë të raporteve të monitorimit çdo 3-muaj. Komunikimi i brendshëm kryhet me shkrim dhe email, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare. Pas riorganizimit të administratës tatimore struktura ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, në Sektorin e Trajtimit të Ankesave, e cila administron dhe shpërndan për trajtim ankesat lidhur me shkelje të legjislacionit tatimor dhe ankesave të ndryshme për veprime korruptive. Mekanizmat e dedikuar për ankesat për korrupsion, janë numri jeshil : 08001414, adresë email-i: denoncime@tatime.gov.al, stop informaliteti etj. Të gjitha ankesat për korrupsion dërgohen për verifikime pranë Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion). Për kontrollin e sistemit të IT-së, serverat janë të vendosur, një pjesë në godinën e DPT dhe një pjesë në godinën e AKSHI-it. Ato monitorohen dhe i kryhet back up në mënyrë periodike.

5. Monitorimi.

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, përmes monitorimit në vijueshmëri e vetëvlerësimit. Në kryerjen e monitorimit, Titullari i Institucionit (NA), NZ dhe drejtuesit e tjerë, duhet tô kushtojnë vëmendje gjendjes së MFK-së dhe objektivave të arritura. Në DPT, Titullari informohet vazhdimishtnga drejtuesit e lartë, të mesëm, dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve apo informacioneve. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike janë dërguar në MFE, por **nuk rezultuan të publikuara në faqen e web-it** të institucionit ose të MFE-së.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

Znj.D. I. me detyrë, Drejtor i Përgjithshëm në cilësinëe Titullarit të Institucionit, në lidhje me moskrijimin e GMS, pas ndryshimeve strukturore të institucionit.

1.Titulli i gjetjes: Moskrijimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), nga Titullari, pas ndryshimeve strukturore të institucionit.

Situata: Me urdhrin e Titullarit të Institucionit nr. 4, datë 29.01.2019, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i kryesuar nga Titullari dhe në cilësinë e anëtarëve janë caktuar zv.drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive, nëpunësi zbatues si dhe drejtori i

DAB në rolin e vëzhguesit. Me shkresën nr. 13751/1 prot. datë 16.07.2019, ñZbatim Vendimi nr. 495, datë 15.07.2019 të Këshillit të Ministraveò, është bërë emërimi i znj. D. I., Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve. Me ndryshimet strukturore të DPT, sipas urdhrit nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, ka ndryshuar edhe struktura e shumë drejtorive të DPT, Drejtorët e të cilëve janë anëtarë të GMS. Të detajuar si më poshtë:
-Drejtoria e Qendrës së Pagesave, është suprimuar dhe ka kaluar sector, në varësi të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës;
-Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndëristitucional, është bashkuar me Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve;
-Drejtoria e Qendrës së Thirrjeve, është suprimuar dhe ka kaluar sector, në varësi të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve;
-Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Komunikimit, është suprimuar me urdhrin nr. datë 27.02.2019, të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".* Punonjës të cilët kanë kaluar në strukturë, tek AKSHI.
Konstatohet se,Titullari i Institucionit nuk ka krijuar GMS të ri, pas emërimit të tij në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe me ndryshimet strukturore me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"* të strukturës së re organike, përbërjen e anëtarëve të GMS, duke sjellë që, çështjet që janë trajtuar në takimet periodike të GMS, në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin të kenë qenë joefektive.
Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar;
Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;
Urdhri nr. 33, datë 12.02.2020 i Kryeministrit;
Rregullorja për Funksionimin e ATQ, miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE, nr. 193, datë 12.08.2020.
Ndikimi/Efekti: Një GMS joefektiv nuk ka linja të hapura komunikimi me të gjitha nivelet e njësisë dhe me audituesit e brendshëm dhe të jashtëm. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda Institucionit.
Shkaku: Mungesë veprimesh nga Titullari i Institucionit.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve duhet të urdhërojë menjëherë ngritjen e GMS, me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë, në mënyrë që, GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla në përmbushje të rolit këshillues,përsa i takon integritetit të informacionit financiar të Institucionit, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike.

1/b. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimi i veprimtarisë së saj.

Në zbatim të pikës mbi vlerësimin e auditit të brendshëm, Grupi i Auditimit u fokusua në çështjet e poshtëpërmendura:
a) Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (DAB, këtu e më poshtë). Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme;
b) Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportimi në këtë drejtori;
c) Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB;

d) Auditim me zgjedhje mbi praktika të auditimeve të kryera nga DAB, zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e auditimit të brendshëm, standardet dhe manualet, të dala në zbatim të tyre.

Misioni i auditit të brendshëm sipas nenit 5, të ligjit nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, është të japë siguri të arsyeshme Titullarit të Institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Roli i auditit të brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 6, të ligjit nr.114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, është tô japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, duke përgatitur plane strategjike dhe vjetore auditimi bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar si dhe duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve duke u fokusuar në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
- përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
- ruajtjen e aseteve;
- kryerjen e veprimtarisë së njësisë me ekonomi, efektivitet dhe eficencë;
- duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;
- duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna, etj.

DAB në aspektin organizativ dhe funksional përgjigjet përpara titullarit të institucionit. Mbështetur në strukturën organizative të DPT, DAB është krijuar dhe funksion në përputhje me pikën 1, të nenit 10, të ligjit nr.114/2015, ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò dhe përcaktimet e standardit 1100 ñPavarësia dhe objektivitetiò, në Manualin e Auditimit të Brendshëm. DAB në DPT, e realizon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në:

- *14 Drejtori në DPT;*
- *14 Drejtori Rajonale Tatimore;*
- *6 Drejtori sipas Rajoneve.*

Për vitin 2020, veprimtaria e DAB është kryer në zbatim të ligjit nr.114, datë 22.10.2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, ñPlanifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëmò, Kapitulli IV, ñKryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit.

I. Organizimi i kapaciteteve audituese në DPT.

Në bazë të organigramës, që grupit të auditimit iô u vu në dispozicion nga DBNJ, struktura e DAB në muajin janar 2020, ka patur 1 pozicion vakant, Inspektor i parë. Siç paraqitet dhe në tabelën më poshtë, struktura ishte e përbërë nga Drejtori me 9 punonjës, (1+8) inspektorë të parë.

Tabela: Organigrama Janar 2020

Pozicioni	Kategoria e Pagës	Emër	Mbiemër
Drejtor	III-a	Sh.	P.
Inspektor i Parë	III-b	M.	A.
Inspektor i Parë	III-b	B.	Ll.
Inspektor i Parë	III-b	I.	Gj.
Inspektor i Parë	III-b	K.	K.
Inspektor i Parë	III-b	B.	L.
Inspektor i Parë	III-b	N.	T.
Inspektor i Parë	III-b	Xh.	L.
Inspektor i Parë	III-b	**Vakant**	

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT.

Me shkresën nr. 931 prot, datë 17.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, dërgohet në MFE, ñPër mendim Draft-Struktura Organizative, Draft- Organigrama dhe Relacioni shoqëruesò. Në relacion është trajtuar qëllimi për ndryshimin e strukturës së miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 126 datë 02.08.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 86 datë 03.05.2019, ku citohet: *Qëllimi është përmirësimi i aspektit funksional dhe procedurial të saj, përshtatur me kontekstin aktual dhe ligjor të sistemit tatimor.*
Në kuadër të implementimit të Projektit të Fiskalizimit, si dhe rekomandimeve të FMN (...),për mirëfunksionim dhe eficencë të Administratës Tatimore, janë konstatuar të nevojshme ndryshime strukturore të cilat do të duhet të jenë në funksion të përmirësimit funksional dhe organizativ.
Ky propozim ka sjellë ndryshime edhe në strukturën e DAB-së,në DPT. Në strukturën e miratuar, me urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, si dhe pas miratimit të rregullores së re, me urdhër nr. 193, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE, DAB është në varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ajo është riorganizuar si Drejtori, me 9 punonjës (1+8 auditues) në organikë, e përbërë nga dy sektorë:

- Drejtor drejtorie me kategorinë III-a, 1 (një);

✓ Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit & Raportimit, (Përgjegjës me kategorinë III-a/1, 1 (një) + inspektorë me kategorinë III-b, 2 (dy);
✓ Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave, (Përgjegjës me kategorinë III-a/1, 1 (një) + Inspektorë me kategorinë III-b, 4 (katër).



Në qëllimin e përgjithshëm të pozicionit të punës së Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit & Raportimit, citohet: *Përgjegjësi i sektorit përgjigjet përpara Drejtorit të drejtorisë, për dhënien e këshillave lidhur me auditimet e këshillimit, si dhe për sigurimin e mbarëvajtjen e veprimtarisë së sektorit/drejtorisë me qëllim përmbushjen e misionit të saj në dhënien e këshillave,sigurimin e cilësisë, hartimin dhe raportimin e veprimtarisë.*
Në qëllimin e përgjithshëm të pozicionit të punës së Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit Financiar dhe të Ardhurave, citohet: *Përgjegjësi i sektorit përgjigjet përpara Drejtorit të drejtorisë, për dhënien e sigurisë në mbarëvajtjen e veprimtarisë së sektorit/drejtorisë me qëllim përmbushjen e misionit dhe funksionit që ka sektori në dhënien e sigurisë mbi pajtueshmërinë financiare.*
Pra, nga përshkrimet e punës të parashtruara në relacionin shoqërues, qëllimi i punës së përgjegjësve të këtyre dy sektorëve, është shumë i rëndësishëm.
U konstatua se, pas ristrukturimit të DAB-së në drejtori me dy sektorë, pozicionet vakante të përgjegjësve të sektorëve, janë shpallur në DAP në shtator 2020. Fitues është shpallur znj. E. S., në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit Financiar dhe të Ardhurave, detyrë në të cilën është emëruar më 09.12.2020. Ndërsa në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të

Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit & Raportimit nuk ka patur fitues, por ka mbetur vakant.

Struktura e DAB, në fund të vitit 2020, paraqitet e detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela: Organigrama Dhjetor 2020

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	**Kategoria e Pagës**	**9**	**Emër**	**Mbiemër**
Drejtor Drejtorie	III-a	1	Sh.	P.
Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave		**5**		
Përgjegjës Sektori **(emëruar më 09.12.2020)**	III-a/1	1	E.	S.
Inspektor	III-b	1	I.	Gj.
Inspektor	III-b	1	K.	K.
Inspektor	III-b	1	N.	T.
Inspektor	III-b	1	B.	L.
Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurisë të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit		**3**		
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	**vakant**	
Inspektor	III-b	1	B.	Ll.
Inspektor	III-b	1	Xh.	L.

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT.

Konstatim: Gjatë vitit 2020, DAB ka funksionuar me rreth 80% të strukturës së miratuar, si rezultat i ndryshimeve strukturore dhe lëvizjet e shpeshta të inspektorëve.
Auditimi i brendshëm në njësitë publike, është njëra nga tre shtyllat e kontrollit të brendshëm financiar publik (sipas standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm Kuadri COSO dhe sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit). Ai konsiderohet si një filtër i domosdoshëm për të dhënë titullarit të njësisë publike, nivelin e sigurisë mbi saktësinë e aktivitetit ekonomiko-financiar të njësisë shpenzuese të varësisë.

II. Çertifikimi i DAB.

Nga auditimi i dosjeve të personelit të DAB, u konstatua se, në dosjen e Sh. P., në cilësinë e Drejtorit të DAB, si dhe në dosjet e audituesve/inspektorëve E. S., K. K., B. L., Xh.L dhe M A., certifikata ñAuditues i Brendshëm në Sektorin Publikò, ndodheshin kopje të panjësuara me origjinalin. Veprime këto, në kundërshtim me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 ñPër organizimin e dosjes së regjistrit të personelitò, i cili citon: *Aneksi I. Dokumeneat duhet të jenë origjinal ose fotokopje të vërtetuara me noteri dhe janë pjesë përbërëse e dosjes.*
Statusi i kualifikimit, arsimimit dhe vjetërsisë në strukturat e auditimit të punonjësve rezultoi:
Të certifikuar si auditë të brendshëm 8 punonjës:
Ekonomistë 7 punonjës
Jurist 1 punonjës
Sipas vjetërsisë në auditim paraqiten si më poshtë:
Me vjetërsi në auditim deri në 5 vjet 4 punonjës
Me vjetërsi në auditim mbi 5 vjet 4 punonjës
Trajnimet e stafit të DAB, për shkak të pandemisë Covid -19, janë kryer online në periudhën nëntor-dhjetor 2020, nga DHAB, në MFE. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 7 auditues.

III. Planifikimi vjetor 2020.

Me shkresën nr. 18047/1, datë 18.10.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është miratuar, hartimi i planit vjetor 2020 dhe plani strategjik 2020-2022. Gjithashtu, janë dërguar brenda muajit Tetor, sipas përcaktimit në Manualin e Auditimit, pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) në MFE.
Me vendim nr. 7, datë 10.10.2019, Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka dhënë ***mendimin dhe rekomandimin pozitiv*** për planin vjetor 2020 dhe planin strategjik 2020-2022.

Nga auditimi u konstatua se, ***numri i planifikuar i angazhimeve, në planin vjetor për vitin 2020, është i njëjtë me numrin e planifikuar të angazhimeve për vitin 2020 në planin strategjik 8 auditime (7 të kombinuara + 1 performance).***

Me shkresën nr. 834/1, datë 15.02.2021, është dërguar në MFE, Raporti i Veprimtarisë së DAB-së për vitin 2020, shoqëruar me pyetësorin e vetëvlerësimit, në të cilin nga 40 pyetje në total, 6 kanë vlerësim *"përputhshmëri e pjesshme"* dhe 34 të tjerat *"përputhshmëri e plotë".*

Me vendimin nr. 6, datë 25.01.2021, Komisioni i Auditimit ka dhënë ***mendimin dhe rekomandim pozitiv***për raportin vjetor të veprimtarisë së DAB pranë DPT për vitin 2020, ku bashkëlidhur ka përcjellë procesverbalin e mbajtur në mbledhjet e organizuara në datat 22.01.2021 dhe 25.01.2021.

Me ndryshimet strukturore të DPT, me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit, ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* është parë i nevojshëm përmirësimi i Kartës së Auditit të Brendshëm. Me urdhrin nr. 72, datë 24.09.2020, ñPër miratimin e Kartës së Auditit të Brendshëm, së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeveò, është kryer miratimi nga Titullari i Institucionit, si dhe me shkresën nr. 20411 prot, datë 20.10.2020, është dërguar në DHAB, në MFE.

IV. Analiza e planit të DAB-së për vitin 2020.

Auditimet për vitin 2020, janë planifikuar në Planin Vjetor të Auditimeve, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me nr. 18204 prot, datë 01.10.2019. Mënyra e zgjedhjes për auditim është bazuar kryesisht në bazë të vlerësimit të riskut. Për këto auditime vlerësimi i riskut në planin vjetor ishte parashikuar si vijon:

- 6 subjekte për tâu audituar janë vlerësuar me risk të lartë;
- 2 subjekte për tâu audituar janë vlerësuar me risk të mesëm.

Për vitin 2020 janë vlerësuar me risk fushat si vijon:

IDENTIFIKIMI I RISQEVE	RISKU
Sistemi i kontrollit tatimor	I lartë
Sistemi i mbledhjes së detyrimeve të prapambetura	I lartë
Sistemi i shërbimit ndaj tatimpaguesve	I mesëm

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DPT

Bazuar në metodologjitë që përdoren për vlerësimin e riskut, janë programuar dhe audituar subjekte që paraqiten me një nivel të lartë e të mesëm risku. Janë kryer angazhime auditimi të kombinuara, si më poshtë:

Për vitin 2020 ishin planifikuar 8 auditime (7 të kombinuara + 1 performance):

- DRT Dibër auditim i kombinuar;
- DRT Gjirokastër auditim i kombinuar;
- DRT Lezhë auditim i kombinuar;
- DRT Tiranë auditim i kombinuar;
- DRT Kukës auditim i kombinuar;
- DRT Elbasan auditim i kombinuar;
- DRT Fier auditim i kombinuar;
- DPT, Drejtoria e Burimeve Njerëzore auditim përputhshmërie.

Nga 8 auditime të planifikuara për vitin 2020,kanë përfunduar procesin, vetëm 2 auditime,dhe janë në proces 3 të tjerë, si më poshtë:

Përfunduar auditime nga plani vjetor i miratuar për vitin 2020:

- DRT Dibër auditim i kombinuar;

- DRT Lezhë auditim i kombinuar;

Auditime në proces:

- DRT Gjirokastër auditim i kombinuar (dërguar projektraporti);
- DRT Fier auditim i kombinuar (përfunduar puna në terren);
- DRT Kukës auditim i kombinuar (në proces).

Përfunduar auditim në proces nga viti 2019:

- DRT Tiranë auditim financiar.

Mbetën pa u audituar sipas planit vjetor 2020:

- DRT Tiranë auditim i kombinuar;
- DRT Elbasan auditim i kombinuar;
- DPT, Drejtoria e Burimeve Njerëzore auditim përputhshmërie.

Auditimet e parealizuara zënë 37.5% të planifikimit vjetor të vitit.

Konstatim: Në mosrealizimin e planit të auditimeve për vitin 2020, kanë ndikuar ndryshimet strukturore të DAB, sipas urdhrit nr. 33 datë 12.02.2020, të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore"*, mosplotësimi me burime njerëzore i strukturës së miratuar, transferimet e shpeshta të inspektorëve për shkak të ristrukturimit të DPT, si dhe pandemia Covid- 19 që shoqëroi vitin 2020.

V. Gjetjet kryesore në auditimet e kryera nga DAB.

Përsa i përket gjetjeve të rezultuara, ato vijnë kryesisht nga zbatimi i gabuar apo i pjesshëm i legjislacionit tatimor. Kryesisht gjetjet më të shumta kanë rezultuar në sistemin e kontrollit tatimor, sistemin e shërbimit ndaj tatimpaguesve, funksionimin e kontrollit të brendshëm, etj.

Gjetjet në vlerë financiare:

- DRT Dibër dhe DRT Lezhë ï gjetje në vlerë **82,397,000 lekë,** janë konstatuar raste kur tatimpaguesit nuk kanë paguar plotësisht apo paguar me vonesë këstet e tatimit mbi fitimin;
- DRT Tiranë dhe Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Rajoni Qendror & DRT Tiranë ï gjetje në vlerë **1,534,080, lekë**, për pagesa të kryera për trajtim financiar, shërbime e dieta.
- Shpenzim pa efektivitet nga buxheti i shtetit, në shumën prej **19,470,000 lekë**, për marrje ambienti me qira nga DRT Lezhë, ambient i rezultuar jo funksional për punonjësit.

Gjetje të tjera:

- Parregullsi në plotësimin e dokumentacionit në rastet ñshërbime e dietaò;
- Mosrespektim të afatit ligjor në dorëzimin e pasqyrave financiare, pasqyrat financiare rezultonin jo të nënshkruara të gjitha nga nëpunësi i njohur me ligj;
- Raste të mosmbajtjes së gjobave për mosrespektimin e afateve të pagesës së kësteve të tatimfitimit;
- Shpërndarje jo racionale e burimeve njerëzore brenda DRT Dibër;
- DRT Dibër nuk ka identifikuar risqet dhe nuk ka hartuar regjistrin e riskut.

VI. Rekomandime të dhëna për vitin 2020

Në bazë të gjetjeve të bëra janë dhënë rekomandime për përmirësimin e procesit të menaxhimit në drejtoritë e audituara:

- Marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale;
- Mbikëqyrjen e administrimit të riskut dhe kontrolleve;
- Promovimin e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda njësisë publike;
- Sigurimin e administrimit efektiv të punës organizative dhe përgjegjësisë;
- Komunikimin e informacionit mbi riskun dhe kontrollin, në sistemet e duhura të njësisë publike.

Të ndara në: përmirësimin e sistemeve 6; të karakterit organizativ 8; rekomandime të tjera 24.

VII. Zbatimi i rekomandimeve të lëna.

Shkalla e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2020, paraqitet si më poshtë:

Periudha	Të rekomanduara	Të pranuara	Të zbatuara plotësisht	Të zbatuara pjesërisht	Në proces	Realizimi %
2020	38	38	6	1	31	15.8%

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DPT, përpunuar nga audituesi.

Konstatohet një shkallë e **ulët** zbatueshmërie e rekomandimeve të lëna, **vetëm 15.8%.**
Nga analiza e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në 3 auditimet e kryera konstatohet si vijon:
-Në 2 angazhime auditimi me fokus përputhshmërinë, si dhe 1 me fokus financiar të vitit 2019, gjetjet dhe rekomandimet janë fokusuar në tërësinë e tyre në përputhshmërinë tatimore.Rezultoi se, janë dhënë më shumë se një rekomandim për gjetje të njëjta, të konstatuara në angazhimin auditues të DRT Dibër.

VIII. Inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve.

DAB pas përfundimit të çdo auditimi, ka kryer procesin e inventarizimit të dosjeve, për çdo subjekt të audituar. Inventarizimi është bazuar në kërkesat e përcaktuara në Manualin e Auditimit. Në zbatim të kërkesave të parashikuara në *"Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën Shqipërisë"*, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), DAB i ka dorëzuar pranë sekretarisë së DPT.

- Në dosjen e auditimit të DRT Dibër vumë re:

- Në dokumentin me nr. 1511 prot., datë 22.01.2020, ñNjoftim për fillimin e angazhimit të auditimitò, angazhimi në subjekt parashikohet të fillojë në datë **05.02.2020.**
Konstatim: Në dosje nuk ka një shkresë justifikuese, mbi arsyen e mosfillimit të auditimit, sipas këtij njoftimi. Dhe dokumenti nr. 17341 prot., datë **08.09.2020**, ñNjoftim për fillimin e angazhimit të auditimitò, **mungon.**
Konstatim: Raporti Përfundimtar i auditimit në DRT Tiranë nga audituesit e DAB, është dorëzuar jashtë afateve të caktuara, si pasojë e pritjes së observimeve nga subjekti, të përcaktuar në *Hapin 11. Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar të Manualit të Auditimit të Brendshëm.*
Në zbatim të nenit 12, pika a, të ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò si dhe Kapitulli VII i Manualit të Auditimit të Brendshëm, me urdhrin nr. 24 datë 09.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar ñPrograme për sigurimin e brendshëm të cilësisë së njësisë së Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeveò. Një kopje e programit është përcjellë në DHAB në MFE.
A) Në planin strategjik të përgatitur nga DAB, janë përfshirë:
1. Qëllimi dhe objektivat;
2. Identifikimi i fushave të llogarisë/sistemet prioritare;
3. Kufizimet e auditimit;
4. Prioritetet për 3 vite;
5. Kostoja e auditimit të brendshëm;
6. Llogaritja e burimeve të nevojshme për auditimin;
7. Planifikimi për trajnime;
8. Sigurimi i Cilësisë.

B) Në planin vjetor të auditimeve përgatitur nga DAB, janë përfshirë:
1. Zhvillimet aktuale;

2. Prioritetet e auditimit për vitin 2020;
3. Objektivat vjetore;
4. Programi i angazhimeve;
5. Risqet e mundshme që mund të ndikojnë në realizimin e programit vjetor;
6. Kostot e auditimit;
7. Burimet e auditimit;
9. Sigurimi i Cilësisë.

Në planin strategjik, dhe vjetor janë bashkëngjitur listat e pasqyrave:

- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet, për vitin 2020;
- Plani strategjik i subjekteve të synuara për tâu audituar në vitet 2020-2022;
- Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2020;
- Planifikimin vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2020;
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2020.

2.Titulli i gjetjes: Organizimi DAB dhe vlerësimi i veprimtarisë së saj.

Situata:Nga auditimi rezulton se, aktiviteti i auditimit të brendshëm për vitin 2020, nuk ka arritur të përmbushë objektivat e tij. Nga 8 auditime të planifikuara në planin vjetor kanë përfunduar procesin, vetëm 2 auditime, dhe janë në proces 3 të tjerë, përfunduar 1 auditim financiar në proces nga viti 2019, në DRT Tiranë.

Struktura e DAB para ristrukturimit të DPT, ishte e përbërë nga Drejtori me 9 punonjës, (1+8) inspektorë të parë. Me shkresën nr. 931 prot, datë 17.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, dërgohet në MFE, ñPër mendim Draft-Struktura Organizative, Draft- Organigrama dhe Relacioni shoqërues. Në strukturën e miratuar, me urdhrin e Kryeministrit nr. 33 datë 12.02.2020, si dhe pas miratimit të rregullores së re, me urdhër nr. 193 datë 12.08.2020 të Ministrit të MFE, DAB është në varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ajo është riorganizuar si Drejtori, me 9 punonjës (1+8 audites) në organikë, e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit & Raportimit (1+2) dhe Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave (1+4).

Gjatë vitit 2020, DAB ka funksionuar me rreth 80% të strukturës së miratuar, si rezultat i ndryshimeve strukturore dhe lëvizjet e shpeshta të audituesve. Gjithashtu, u konstatuan transferime të audituesve/inspektorëve, për shkak të ristrukturimit të DPT.

Nga auditimi u konstatua se, në dosjen e DRT Dibër dhe DRT Tiranë ka mungesë të dokumenteve të auditimit, si dhe Raporti Përfundimtar i auditimit në DRT Tiranë nga DAB, është dorëzuar jashtë afateve të caktuara, si pasojë e pritjes së observimeve nga subjekti. Veprime këto, në kundërshtim me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm, i miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë; i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr.114, datë 22.10.2015*"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";*
Ligji nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil",* i ndryshuar;
VKM nr. 355, datë 07.07.2000 *"Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit";*
Urdhri nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016*;
Manuali i Auditimit të Brendshëm i miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Transferimet e inpsektorëve për shkak të ristrukturimit të DPT, kanë sjellë mospërmbushje të objektivave të DAB.

Shkaku: Mungesë veprimesh të strukturave përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:2 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP-in, të marrin masa, në plotësimin e strukturës së DAB.

Rekomandimi: 2.1 Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa në vijimësi, që për çdo angazhim auditimi, në përgatitjen e dosjes, përveç dokumentacionit që gjykohet i rëndësishëm nga grupi i punës, dosja duhet të përmbajë edhe dokumentet sipas formatit standard 1, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të zbatojnë afatet e dorëzimit të raporteve, në angazhimet e *tyre audituese.*

Për Projekt Raportin nr. 513/23 datë 01.09.2021, është paraqitur observacioni nr. 8715/36 prot, datë 27.09.2021, nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore,si dhe observacioni nr. 8715/38 datë 30.09.2021, nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në DPT, të cilët po e trajtojmë të përmbledhur në vijim:

***Pretendim i subjektit të audituar**: ....Duke rikërkuar që të saktësohet përgjegjësia e personave realisht përgjegjës, sipas detyrave funksionale,....si dhe në detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, kam kryer të gjitha detyrat që më ngarkon ligji dhe e rregullorja, në interes të institucionit….*

***Qëndrim i grupit të auditimit:**Nga shqyrtimi i dokumenteve bashkëlidhur observacionit, (kryesisht shkresat dhe email-et), në lidhje me problematikën e trajtuar, duke marrë në konsideratë dhe periudhat përkatëse në pozicion, ndryshimin e fundit në VKM nr. 833* datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit ", grupi i auditimit i qëndron problematikës së konstatuar, por merr në konsideratë observimin e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, si dhe u reflektua në Raportin Përfundimtar.*

***Pretendim i subjektit të audituar**: Në dosjen e auditimit financiar të DRT Tiranë është konstatuar mungesa e shkresës nr. 10475/1 datë 29.05.2019 "Autorizim për fillimin e angazhimit të auditimit", sqarojmë se auditimi është ushtruar me zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 62 datë 03.10.2019….*

***Qëndrim i grupit të auditimit:**Sqarojmë edhe njëherë se grupi i auditimit shkresën nr. 10475/1 datë 29.05.2019 "Autorizim për fillimin e angazhimit për auditim", e konstatoi të shkruar, në formatin standard nr. 1 të dosjes së auditimit të DRT Tiranë, por nga faktet që paraqisni, se auditimi në DRT Tiranë është kryer me urdhër të titullarit, observimi juaj merret në konsideratë dhe u reflektua dhe në Raportin Përfundimtar.*

IV. 2.Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së:

Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut.

Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.
- Analiza të Drejtorisë së menaxhimit te riskut;
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT

*****

Baza Ligjore

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,
- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve

shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Rregullore dhe Manuale për funksionimin e drejtorisë;
- Manuali i Menaxhimit të Riskut;
- Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore
- Akte të tjera ligjore e nënligjore.

*****

Nga tëdhënat dhe dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se:

Në bazë të organizimit, funksionimin dhe drejtimit të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut përgjatë vitit 2020ajo ka funksionuar në bazë të Urdhrit nr. 33 datë 12.02.2020 ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendroreò e ka patur në strukturë dy sektorë:

- Sektori i hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve (1 përgjegjës +6 punonjës)
- Sektori i Analizës së Riskut (1 përgjegjës +10 punonjës)

Implementimi i strukturës në zbatim të urdhrittë mësipërm ka filluar në korrik të vitit 2020, ose rreth 5 muaj e gjysmë me vonesë, gjithashtu duhet theksuar se kjo drejtori nuk është plotësuar edhe me numrin e nevojshëm po sipas kësaj strukture, ndërsa përpara këtij urdhri kjo drejtoria ka funksionuar po me dy sektorë po me numër më të reduktuar punonjësish e konkretisht:

- Sektori i Analizë së Riskut me 1përgjegjës +5punonjës kur duhet të jenë 1+ 6
- Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve me 1 përgjegjës +5 punonjës kur duhet të jenë 1 + 6

Për sa më sipër implementimi i strukturës së Drejtorisë së Riskut ka filluar në korrik të vitit 2020, ose rreth 5 muaj e gjysmë me vonesë ku për këto vonesat në implementimin e strukturës së kësaj drejtorie dhe mungesa në personel mbajnë përgjegjësi strukturat drejtuese dhe Drejtoresha e këtij institucioni.

Sistemi i Menaxhimit të Riskut ka për qëllim të ndikojë në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave të parashikuara duke siguruar :

- ✓ Menaxhimin efiçent dhe transparent të ardhurave tatimore;
- ✓ Evidentimin dhe zvogëlimin e risqeve të mos përmbushjes së objektivave të administratës tatimore;
- ✓ Inkurajimin dhe rritjen e shkallës së zbatimit dhe respektimit vullnetar të përmbushjes së detyrimeve tatimore, si dhe sigurimin e nxitjes së besimit publik ndaj integritetit dhe efikasitetit të Administratës Tatimore;

Gjithashtu Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka si objektivi parësor nëpërmjet modulit të riskut identifikimin mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

1. MODULI I RISKUT TATIMOR

1.1*Struktura e modulit të riskut tatimor*

Moduli i Riskut ndihmon administratën tatimore të identifikojë tatimpaguesit me sjellje mos përmbushjenë shmangien e detyrimeve tatimore. Moduli mbështetet në 50 rregulla të programuara nëpërmjet një moduli të veçantë të riskut, që është pjesë e sistemit informatikë të DPT, ku çdo rregull shqyrton automatikisht një aspekt të veçantë të dokumentacionit tatimor të tatimpaguesit për tre vitet e fundit bazuar në vetdeklarimin e tij.

Analiza e risqeve bazohet në informacionin elektronik të aktivitetit të tatimpaguesve për lloj tatimi: TVSH, Tatim Fitim, Tatim Fitimi i Thjeshtuar, Tatimin e të Ardhurave në Burim, Tatimin mbi të Ardhurat Personale si dhe Kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore.

Rregullat mbi të cilat analizohen risqetkanë shpërndarje sipas llojit të tatimit si më poshtë:

Lloji i Tatimit	Nr. i kritereve të aplikuara
TVSH	24
TF	20
Paga/ Kontribute	3
Te tjera	3

Risqet kryesore që mbulon Moduli i Riskut kanë të bëjnë me:

1. Regjistrimin,
2. Deklarimin
3. Pagesën
4. Raportimin

1.2*Moduli*

Modulit ndihmon në hartimin e analiza vetë risqeve nëpërmjet të cilat DMR:

- ✓ Identifikon dhe cakton përparësinë mes rreziqeve kryesore të përmbushjes, në bazë të një procesi të strukturuar të vlerësimit të riskut;
- ✓ Identifikon rreziqet serioze të përmbushjes, në të cilat duhet të përqendrohet vëmendja e menaxhimit të lartë drejtues;
- ✓ Sigurohet se ka një strategji për përballimin e çdo rreziku të përmbushjes;
- ✓ Sigurohet që këto strategji të kenë kapacitete administrative dhe teknike që të zbatohen;
- ✓ Mat nivelin e përmbushjes tatimore nga biznesi, popullata tatimpaguese në një ose disa sektorë ekonomikë;
- ✓ Evidenton grupet e taksapaguesve që kanë sjellje të ngjashme dhe fokusohet tek grupi që ka shkelje më të mëdha;
- ✓ Mbi këtë modul bazohet edhe rimbursimi i TVSH-së dhe përcaktimi i risqeve të tij, ku në evidentimin e tatimpaguesve me risk gjatë procesit të rimbursimit të TVSh-së aplikohet seti i rregullave që kanë të bëjnë me ketë lloj tatimi)

2. MËNYRA E VLERËSIMIT

2.1 ***Krahasimi***

Moduli i Riskut bazohet në rregulla të cilët:

a. krahasojnë secilin tatimpagues me performancën e tij gjatë periudhave,
b. krahasojnë performancën e tij me mesataren e sektorit ku operon,
c. krahasojnë performancën e tij me mesataren kombëtare.

Diferencat e mëdha nga këta tregues, çojnë në një vlerësim më të lartë të riskut dhe mbi numrin e kritereve të thyera të riskut përcaktojmë dhe formën e trajtimit të tij (kontroll vizitë fiskale ,kontroll nga zyra) .

2.2*Vlerësimi i riskut*

Pasi të jenë vënë në zbatim rregullat, për secilin tatimpagues bëhen dy vlerësime:

- ➢ Numri gjithsej i rregullave të thyera mbi të cilat bëhet renditja e tatimpaguesve nga ai me risk më të lartë deri tek ai me risk më të vogël;
- ➢ Evidentimi në vlerë i humbjes maksimale potenciale që rrjedh nga thyerja e rregullave.

2.3 ***Renditja e tatimpaguesve***

Tatimpaguesit renditen duke filluar nga vlerësimi më i lartë tek ai më i ulët. Subjektet që kanënumrin më të lartë të kritereve të thyera të riskut vlerësohen më riskun më të lartë dhe listohen të parët në *Dokumentin e listës së subjekteve.*

Një element shumë i rëndësishëm është edhe periodiciteti i ekzekutimit të modulit të riskut ku DMR ekzekuton modulin e riskut 2 herë në vit çdo 6 muaj dhe bazuar në rezultatet e tij dhe renditjen e tatimpaguesve planifikon kontrollet tatimore mujore për pjesën e 70% ndërsa për rimbursimet periodiciteti i ekzekutimit të modulit të riskut është 4 herë në vit e më konkretisht:

- ✓ është kryer 2 (dy) herë për vitin 2020 ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut, nga Komiteti i Përmbushjes, për planet e kontrollit (për pjesën e 70%) si më poshtë:
- Plan Kontrolli janar - qershor 2020 datë 21.01.2020;
- Plan Kontrolli korrik - dhjetor 2020 datë 20.07.2020.
- ✓ është kryer 4 (katër) herë për vitin 2020 ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut, kriteret për rimbursimin e TVSH-së, si më poshtë:
- shkurt - prill 2020 datë 10.02.2020;
- maj - korrik 2020 datë 08.05.2020;
- gusht - shtator 2020 datë 10.08.2020;
- nëntor - janar 2021 datë 10.11.2020.

Gjithashtu në aneksin nr. 1, bashkangjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve janë paraqitur numri i rregullave kodet dhe përshkrimi i kritereve të riskut, ku konstatohet se në vitin 2020 nuk janë bërë ndryshime në rregullat e riskut.

*Përmirësime të Modulit të Riskut:*Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ato ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Konstatohet se Moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2016, vit në të cilin është instaluar dhe është arritur përdorimi i plotë i tij, por i janë përmirësuar rregullat brenda vetë modulit.

Sa mësipërm moduli i riskut i cili përbëhet nga rregulla/kritere detajuar sipas tabelës së mësipërme ku merren në konsideratë deklarimet e TVSH, tatimit të fitimit, tatimit të thjeshtuar të fitimit, tatimit mbi të ardhurat, rimbursimet e TVSH, ndërthurje e Tatim fitimit me TVSH dhe balancën e detyrimeve tatimore të papaguara apo sjelljen e tatimpaguesit. Këto rregulla konsistojnë në krahasimin e sjelljes së tatimpaguesit në periudha të ndryshme dhe me mesataren e sektorit në nivel rajonal dhe kombëtar. Në lidhje me secilin kriter zbatohet një sistem pikëzimi dhe ky sistem, në bazë të algoritmave përpunues sjell renditjen e tatimpaguesve nga niveli më i lartë i riskut në nivelin më të ulët. Pasi është bërë kjo renditje, llogaritet humbje maksimale potenciale që mund të sjellë secili tatimpagues nga thyerja e kritereve për të cilat është bërë renditja e mëparshme. Në këtë mënyrë realizohet nëpërmjet një procesi të informatizuar si modul i sistemit të informacionit përzgjedhja për kontroll nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut. Nga ana tjetër për kontrollet që nuk i janë nënshtruar këtij sistemi, vlerësimi është bërë duke pasur parasysh aprovimin e përzgjedhjes së bërë nga DRT përkatëse.

Gjithashtu përzgjedhja e subjekteve përgjatë kësaj periudhe për tu kontrolluar është bërë duke marrë në konsideratë si variabël kryesor edhe orët në dispozicion për kontroll nga ana e secilës Drejtori Rajonale Tatimore. Ky është faktori i parë kufizues në përzgjedhjen e subjekteve për kontroll, ndërkohë që nga ana e Drejtorisë së Kontrollit ky variabël përkthehej në numër subjektesh për tu kontrolluar bazuar në eksperiencat e mëparshme për kohën mesatare të shpenzuar për një kontroll. Në këtë kuadër, 30% e kontrolleve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë të përzgjedhura nga vetë Drejtoritë Rajonale bazuar në klasifikimin e kontrolleve sipas tipit (1) dhe kontrolle të tipit (2). Kontrollet e tipit (2) janë në funksion të çështjeve specifike të raportuara nga institucione të tjera në DRT, në rastet e çregjistrimeve të bizneseve apo rimbursimeve të TVSH. Kontrollet e tipit (1) janë objekt vendimmarrje e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, që përbëjnë 70% të kontrolleve ndërkohë që kontrollet e tipit (2) janë të vendosura nga strukturat e Drejtorive Rajonale Tatimore në nivelin e 30% të totalit të kontrolleve të planifikuara. *Në të gjitha rastet, kontrollet e propozuara për tu kryer nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut janë rekomanduar për kontrolle të plota për shkak të riskut të lartë të evidentuar në vlerësimin e kritereve të paracaktuara për këtë*

*përzgjedhje.*Në vijim, realizimi dhe përmbushja e këtij cikli sipas argumentimit të bërë realizohet nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pas marrjes së konfirmimit për realizueshmërinë e kontrolleve duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve si variabël ka realizuar përzgjedhjen automatike të atyre subjekteve të cilat janë renditur më lart në bazë të Modulit të Menaxhimit të Riskut **(CRM) Compliance Risk Managment**, pjesë përbërëse e sistemit të informatizuar të deklarimit të tatimeve nga ana e tatimpaguesve.

*Në këtë kuadër rezultatet e gjeneruar nga analiza e riskut*i cili analizon sektorët e konsideruar si më me risk, përsa i takon sjelljes në lidhje me pajtueshmërinë vullnetare në kuadrin fiskal. Kjo mbështetet në të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik i riskut, Risk run (Ekzekutimi i Riskut) datë 21.01.2021 Plane kontrolli Janar-Qershor 2020.

Në analizat e kryera është bërë e mundur evidentimi numrin të kritereve që thyhen nga sektorët si dhe numrit të ñshmangies potencialeò e shprehur në pikë. Me anë të këtij informacioni i cili gjenerohet automatikisht, është bërë i mundur analizimi dhe trajtimi i sektorëve më me risk ose prioritar.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur 12 aktivitet me risk nga 556 aktivitetet gjithsej:

Kodi i aktivitetit	Përshkrimi i Aktivitetit	Nr. i rregullave të thyera	Pikët e riskut	% Nr. i rregullave te thyera	% pikët e riskut
I5630	Aktivitete të shërbimit të pijeve	43,620	12,663,382,498	9.8%	2.4%
G4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan	25,463	12,677,600,139	5.7%	2.4%
G4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara	17,631	8,525,801,702	4.0%	1.6%
I5610	Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm	11,916	4,972,075,714	2.7%	0.9%
G4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar	11,566	16,367,267,272	2.6%	3.1%
G4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara	10,680	3,721,973,516	2.4%	0.7%
S9602	Flokët dhe trajtime të tjera të bukurisë	9,026	821,554,134	2.0%	0.2%
G4773	Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara	8,446	3,317,593,086	1.9%	0.6%
F4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale	8,321	19,929,565,519	1.9%	3.8%
M6910	Aktivitete juridike	7,710	1,256,402,121	1.7%	0.2%
C1071	Prodhimi i bukës; prodhimi pastave të freskëta dhe kekeve	7,518	3,584,938,227	1.7%	0.7%
G4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara	7,295	3,403,591,268	1.6%	0.6%

- Tatimi i rrezikuar (ose potencialisht të humbur) nga çdo sektor ekonomik, bazuar në rezultatet e tatimit të humbur të gjeneruar nga analiza e riskut për çdo subjekt, pjesë e sektorit ekonomik ku ushtron aktivitetin.
- Risku i çdo sektori bazuar në numrin e rregullave të thyera nga çdo subjekt, pjesë e këtij sektori.

Nga analiza e kryer në bazë të numrit të kritereve të thyera rezulton se numrin me të lartë të rregullave të thyera e ka sektori i Bar- restoranteve ndjekur nga ai i Tregtisë me pakicë. Në të gjitha rastet, tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll sipas Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut në DPT janë referuar për kontroll të plotë sipas Modulit të Menaxhimit të Riskut dhe planeve sektoriale. Gjatë vitit 2020 pati një ndërprerje të aktivitetit të kontrolleve për arsye të pandemisë Covid-19 dhe gjatë 6 mujorit të dytë u implementua Plani Operacional Korrik-Dhjetor 2020 me fokus sektorë që nuk kishin mbyllje gjatë pandemisë.

Për sa më sipër në bazë të ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut sipas DRT-ve po paraqesim në mënyrë të detajuar shkresat me të cilat janë dërguar në DRT kontrollet e planifikuara sipas 70% dhe 30% gjithashtu dhe tabelat e plan faktit si dhe të zbulimeve si më poshtë:

Në bazë të zgjedhjes së tatimpaguesve për kontroll realizohet nëpërmjet hartimit të listave përfundimtare për kontroll bazuar në rezultatet e gjeneruara nga Moduli i Riskut Tatimore ato dërgohen të nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm jo më vonë se data 25 e çdo muaji për kontrollet që do të ushtrohen në muajt pasardhës. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka realizuar hartimin e listave për tatimpaguesit e zgjedhur për kontroll si më poshtë:

Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 1 / 70%)

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	23300	30.12.2019	Plan kontrolli
Shkurt	2516	03.02.2020	Plan kontrolli
Mars	-	03.2020	Plan kontrolli
Prill	Nuk është dërguar	25.3.2016	Plan kontrolli
Maj	7692	08.05.2020	Plan kontrolli
Qershor	11008	18.06.2020	Plan kontrolli
Korrik	11690	25.06.2020	Plan kontrolli
Gusht	15495	05.08.2020	Plan kontrolli
Shtator	16685	25.08.2020	Plan kontrolli
Tetor	19292	05.10.2020	Plan kontrolli
Nëntor	19882	23.10.2020	Plan kontrolli
Dhjetor	22766	25.11.2020	Plan kontrolli

Planet e kontrollit të dërguara në DRT për (Rasti 1 / 30%)

Muaji	Nr. Prot	Data	Përshkrimi
Janar	23184	27.12.2019	Plan kontrolli
Shkurt	e-mail		Plan kontrolli (tabelë)
Mars	4766	02.03.2020	Plan kontrolli
Prill	Nuk është dërguar		
Maj	Nuk është dërguar		
Qershor	Nuk është dërguar		
Korrik	e-mail		Plan kontrolli (tabelë)
Gusht	15023	29.7.2020	Plan kontrolli
Shtator	e-mail		Plan kontrolli (tabelë)
Tetor	18559	23.09.2020	Plan kontrolli
Nëntor	20885	27.10.2020	Plan kontrolli
Dhjetor	e-mail		Plan kontrolli (tabelë)

Tabelë e kontrolleve të planifikuara sipas DRT-ve viti 2020

Raste kontrolli/DRT	BR	DI	DTM	DR	EL	FR	GJR	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Totali
Raste 1 nga 70%	40	29	188	174	70	138	25	101	16	24	20	52	248	56	**1,181**
Raste 2 nga 30%	8	11	55	34	32	36	9	29	9	2	1	9	64	16	**315**
Raste 3 nga prokuroria			2	3	1		2			1		1	1		**11**
TOTALI	**48**	**40**	**245**	**211**	**103**	**174**	**36**	**130**	**25**	**27**	**21**	**62**	**313**	**72**	**1,507**

Tabelë me kontrolle të planifikuara për 2020 rasti 1,2 dhe 3 për vitin 2020 e detajuar.

Propozime kontrolli/DRT	Raste kontrolli	BR	DI	DTM	DR	EL	FR	GJR	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Totali
Rimbursim	Raste 1 nga 70%	31	15	119	152	28	82	12	39	2	10	19	28	128	30	**695**
Hetimi	Raste 1 nga 70%	1	4	2				2			7		2	43	1	**62**
Moduli	Raste 1 nga 70%	4	6	28	4	25	26	6	49	8	5		16	56	15	**248**
OJF	Raste 1 nga 70%					3	1			1				13		**18**
P/operaci 2020	Raste 1 nga 70%	4	4	39	18	14	29	5	13	5	2	1	6	8	10	**158**
Rikontroll	Raste 2 nga 30%				1	1								3	1	**6**
DRT	Raste 2 nga 30%	8	11	55	33	31	36	9	29	9	2	1	9	61	15	**309**
Prokuroria	Raste 3 nga prokuroria			2	3	1		2			1		1	1		**11**
TOTALI		**48**	**40**	**245**	**211**	**103**	**174**	**36**	**130**	**25**	**27**	**21**	**62**	**313**	**72**	**1507**

Tabelë e kontrolleve plan fakt dhe mosrealizime

Fakti /Sipas DRT-ve	BR	DI	DTM	DR	EL	FR	GJR	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Totali
Hequr nga plani													3		3
Mbyllur kontrolli	42	31	164	192	91	127	16	112		13		52	127	42	1008
Kontroll I pa mbyllur	6	9	81	19	12	47	20	18	25	14	21	10	183	30	495
TOTALI	**48**	**40**	**245**	**211**	**103**	**174**	**36**	**130**	**25**	**27**	**21**	**62**	**313**	**72**	**1507**

Tabelë e zbulimeve sipas DRT-ve (përtë gjitha llojet e tatimeve dhe gjoba e interesa)

Zbulueshmeria e propozimeve /Sipas DRT-ve	Raste kontrolli	BR	DI	DTM	DR	EL	FR	GJR	KO	KU	LE	SR	SHK	TR	VL	Totali
Rimbursim	**Raste 1 nga 70%**	**24,115**	**11,033**	**130,318**	**18,395**	**3,727**	**19,102**	**248,787**	**8,997**	**-**	**6,671**	**-**	**14,779**	**23,386**	**24,067**	**533,377**
Hetimi	**Raste 1 nga 70%**	**152**	**-**	**-**				**-**			**-**		**-**	**-**	**-**	**152**
Moduli	**Raste 1 nga 70%**	**1,719**	**1,824**	**34,703**	**1,671**	**4,814**	**8,694**	**1,414**	**8,748**	**-**	**5,730**		**79,138**	**10,257**	**4,113**	**162,825**
OJF	**Raste 1 nga 70%**					**238**	**-**			**-**				**-**		**238**
P/ operaci2020	**Raste 1 nga 70%**	**1,784**	**674**	**48,208**	**15,131**	**17,102**	**5,327**	**-**	**6,345**	**-**	**-**	**-**	**7,300**	**-**	**856**	**102,727**
Prokuroria	Raste 3 nga prokuroria			-	84	8,172		9,643			-		3,963	77,648		99,510
Rikontroll	Raste 2 nga 30%				149	-								18,734	561	19,444
DRT	Raste 2 nga 30%	9,435	6,426	95,903	96,294	33,865	15,758	-	5,176	-	12,889	-	2,719	18,377	8,377	305,220
TOTALI		**37,205**	**19,957**	**309,133**	**131,724**	**67,918**	**48,881**	**259,844**	**29,266**	**-**	**25,290**	**-**	**107,899**	**148,402**	**37,974**	**1,223,493**

Gjithashtu në këtë kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave, pas testimeve të vazhdueshme për evidentimin e problematikave të tyre, DMR sipas të dhënave të saj ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumentit në Word, në bashkëpunim me specialistëve Drejtorisë Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modulit.

Gjatë periudhës Janar ï Dhjetor 2020janë hapur11Jira (çështje për një problematikë të caktuar) në sistem për të trajtuar mangësi që janë evidentuar dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme.

Jira-t hapen në sistem (nga personi përgjegjës ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes në funksion të pandërprerë të sistemit e-Tax) për çdo çështje të kërkuar nga DMR lidhur me Modulin e Riskut.

(Jira hapen: kur DMR kërkon të bëjë testime të rregullave, mbushje të paketave të modulit ose për çdo pyetje që bëhet për palën mirëmbajtëse).

Janë testuar rregullat e Modulit të Riskut si më poshtë:

- TCSAL - Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga krahasuar me mesataren e sektorit ku operon tatimpaguesi;
- TCSALA- Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga si dhe ñnëndeklarimin për profesion të caktuarò nga mesatarja e sektorit ku operon tatimpaguesi;
- TCSALB ï Mos deklarim i pagës reale të punonjësve krahasuar me mesataren e profesionit;
- VATREF1S ï Mosdeklarim i saktë i shitjeve. Kryqëzim i numrave serial të faturave;
- VATREF1B ï Mosdeklarim i saktë i blerjeve. Kryqëzim i numrave serial të faturave;
- VATREF 2 - Rritje e kredisë së TVSH-së duke rritur në mënyrë fiktive blerjet;
- VATREF 3 - Rritje e kredisë se TVSH-se duke nën deklaruar shitjet
- VATREF 4 - Importues në Doganë por pasive në Tatime
- VAT EXP ï Mosdeklarimi i saktë i Eksporteve
- VAT IMP ï Mosdeklarimi i saktë i Importeve
- ËHDP - Ulje e vazhdueshme ne deklaratën e TB

Janë kryer dhe aprovuar Kërkesa për Ndryshim si më poshtë:

Å "Kërkesa për Ndryshim" nr.39 për rregullin e riskut TCSALA SLA2-329,

Å "Kërkesa për Ndryshim" nr.40 për rregullin e riskut TCSALB SLA2-345,
Å "Kërkesa për Ndryshim" nr.43 për rregullin e riskut VATREF1S SLA2-326,
Å "Kërkesa për Ndryshim" nr.44 për rregullin e riskut VATREF1B SLA2-327,
Å "Kërkesa për Ndryshim" nr.53 për rregullin e riskut VAT EXP SLA2-387.

Kërkesat për ndryshim krijohen kur për një kriter të caktuar të modulit është hapur më parë një Jira, pas testimeve të kryera nga DMR lind nevoja për të bëre ndryshim të Kriterit të Modulit dhe vetëm nëkëto raste pala mirëmbajtëse përgatit kërkesën për ndryshim e cila aprovohet nga DMR dhe anëtarët e tjerë që janë ndjekës të kontratës, prandaj numri i Jirave të hapura është më i madh se numri i kërkesave për ndryshim.

Për sa më sipër konstatohet se moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2016, vit në të cilin është instaluar dhe është arritur përdorimi i plotë i tij, por i janë përmirësuar rregullat brenda vetë modulit. Moduli i riskut është shumë i rëndësishëm të përmirësohet sepse nëpërmjet tij në mënyrë të shpejtë dhe të saktë përpunohen të dhënat e hedhura nga tatimpaguesit në sistem e arrihet:

- identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen,
- të verifikohet veprimtaria tregtare e tatimpaguesve të cilëve do dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi;
- ndihmon administratën tatimore të zbulojë evazionin dhe mashtrimin tatimor,
- shqyrton automatikisht një aspekt të veçantë të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi për periudhën për tre vitet e fundit.
- Gjithashtu për kontrollet e realizuara dhe të evidentuara sipas tabelave sa më sipër konstatohet se për këto kontrolle nga ana e DRT nuk janë mbledhur dhe realizuar vlerësime të raporteve të tyre pasi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është në proces pune për një standardizim dhe unifikim të raporteve të kontrollit, gjithashtu dhe për faktin se nga ana e DMR-së në mënyrën si hartohen raportet e kontrollit nga DRT është e pamundur unifikimi i vlerësimeve për saktësinë e shkeljeve ligjore apo të risqeve sipas shkelje të evidentuara në çdo rast, megjithëse DRT nga ana e tyre duhet të përgatisin raporte përgjithësuese për çka konstatohet dhe të japin në mënyrë periodike kush janë problematikat më të shpeshta të hasura dhe mendime për përmirësimin e kritereve të risqeve, të cilën ato pothuajse nuk e realizojnë.

DMR ka iniciuar edhe një proces për evidentimin dhe identifikimin e fenomeneve dhe proceseve me risk duke dërguar shkresën 11699/1, datë 05.07.2019 si dhe shkresën me nr. 23072, datë 01.12.2020 ñMbi formularin e evidentimit të riskuò me formularin përkatës bashkangjitur, ku ndërmjet të tjerave citohet ñ.... DMR po punon për të kuptuar se si faktorë të ndryshëm influencojnë në hartimin e planeve vjetore gjithëpërfshirëse dhe sektoriale si fenomenet, ngjarjet, sjelljet, eksperiencat, perceptimet, qëndrimet etj., të secilit tatimpagues në mënyrë që të kërkojmë mundësi për ti shfrytëzuar si një avantazh për administratën tatimore. Kjo nëpërmjet përmirësimit të Modulit të Riskut aktual, ashtu edhe në mundësinë e përshtatjes së sjelljeve tona në terma afatgjatë gjatë hartimit të strategjive të trajtimit të riskut dhe grup risqeve të evidentuara. DMR bazuar në këto faktorë propozon dhe përshtat Regjistrin e Riskut ku evidentohen ndryshime metodologjike dhe cilësore në kriteret e Moduli aktual të riskut, harton dhe implementimin e kritere të reja dhe ndërton plane dhe strategji sektoriale me qëllim përmbushjen tatimore nga tatimpaguesit.....ò . Për këto kërkesa të përmirësimit të Riskut nga ana e DMR i janë përgjigjur vetëm tre drejtori të cilat janë në strukturën e administratës së DPT e konkretisht:

- Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit Sektori i Kontabilitetit të Ardhurave me shkresën nr. 11699/2, datë 05.07.2019,

- Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Sektori i Monitorimit dhe Analizës me shkresën nr. 23072/1, datë 04.12.2020,
- Drejtoria e Hetimit Tatimor sektori i administrimit të Informacionit dhe Analizës me shkresën nr. 23072/2 datë 15.12.2020,
- DRT nuk ka kthyer asnjëra përgjigje apo të kenë plotësuar formularin.

*****

Nga auditimi konstatohet se objektivat e Drejtorisë për vitin2020janë:

- ➢ përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të risqeve në mosrespektimin e legjislacionit tatimor i cili ka këto shtylla të rëndësishme:
  - Zhvillimin dhe zbatimin e projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut; (projekti për informalitetin në tregun e punës, në sektorin e ndërtimi, turizmit)
  - Zgjerimin e kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut, duke përdorur burime të informacionit nga palë të treta, rritjen e kapaciteteve të stafit dhe sigurimi që çdo informacion tjetër që ndikon hartimin e analizave cilësore të vlerësimit të riskut;
  - Hartimi i analizave që fokusohet në risqe specifike, kështu janë realizuar:
- Analiza e riskut të sektorit të ndërtimit
- Analiza e riskut të hartuesve të pasqyrave financiare
- Analiza e riskut në tregun e punës
- Analiza e riskut të TP me blerje të larta në raport me shitje
- Analiza e riskut të TP me blerje në vlera të mëdha në periudhën e fund muajit në mënyrë të shmangies së pagesës së TVSh-së,
- Analiza e riskut të mosdeklarimit të shpenzimeve me qëllim dhe uljen e deklarimit të qarkullimit.

Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes së objektivave.(nga monitorimi i konstatohet si më poshtë).

INDIKATORËT E PËRMBUSHJES JANAR-DHJETOR 2020

I. Regjistrimi në organet tatimore

Përmbushës konsiderohen tatimpaguesit që kanë përmbushur detyrimin për tâu regjistruar në organet tatimore, *nëse janë kryer 100 verifikime në terren, ka rezultuar se 98.6 tatimpagues kanë përmbushur detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore, ndërsa 1.4 nuk e kanë përmbushur këtë detyrim.*

II. REGJISTRIMI

II.A REGJISTRIMI PËR TVSH-NË



Përmbushës konsiderohen tatimpaguesit që kanë patur detyrimin për tâu regjistruar për TVSH-në dhe janë regjistruar vullnetarisht për këtë përgjegjësi tatimore, *nëse 100 tatimpagues kanë patur detyrimin për t'u regjistruar për TVSH-në, 68.46 prej tyre e kanë përmbushur vullnetarisht detyrimin për t'u regjistruar për këtë përgjegjësi tatimore, ndërsa 31.5 pre tyre nuk e kanë përmbushur këtë detyrim*.

II.B REGJISTRIMI PËR TATIMIN MBI FITIMIN



Përmbushës konsiderohen tatimpaguesit që kanë patur detyrimin për tâu regjistruar për TF-në dhe janë regjistruar vullnetarisht për këtë përgjegjësi tatimore, *nëse 100 tatimpagues kanë patur detyrimin për t'u regjistruar për TF-në, 31.68 prej tyre e kanë përmbushur vullnetarisht detyrimin për t'u regjistruar për këtë përgjegjësi tatimore, ndërsa 68.32 pre tyre nuk e kanë përmbushur këtë detyrim.*

II.C REGJISTRIMI PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI



Përmbushësh konsiderohen tatimpaguesit që kanë patur detyrimin për tâu regjistruar për TAP dhe janë regjistruar vullnetarisht për këtë përgjegjësi tatimore, *nëse 100 tatimpagues kanë patur detyrimin për t'u regjistruar për TAP, 97.81 prej tyre e kanë përmbushur vullnetarisht detyrimin për t'u regjistruar për këtë përgjegjësi tatimore, ndërsa 2.19 pre tyre nuk e kanë përmbushur këtë detyrim.*

III. DEKLARIMI

III.A DEKLARIMI I TVSH-SË



Përmbushësh konsiderohen tatimpaguesit që kanë dorëzuar në kohë deklaratat e TVSH-së, *nëse kanë qenë 100 deklarata TVSH-je për t'u dorëzuar, 97 prej tyre janë dorëzuar në kohë, ndërsa 3 prej tyre nuk janë dorëzuar.*

III.B DEKLARIMI I LISTËPAGESËS



Përmbushësh konsiderohen tatimpaguesit që kanë dorëzuar në kohë listëpagesat, *nëse kanë qenë 100 listëpagesa për t'u dorëzuar, 96.5 prej tyre janë dorëzuar në kohë, ndërsa 3.5 prej tyre nuk janë dorëzuar.*

IV. PAGESA:

IV.A PAGESA E TVSH-SË



Përmbushësh konsiderohen tatimpaguesit që kanë paguar në kohë detyrimet për TVSH-në, *nëse kanë qenë 100 lekë detyrime TVSH-je për t'u paguar, 95.87 lekë janë paguar në kohë, ndërsa 4.13 lekë nuk janë paguar.*

IV.B PAGESA E DETYRIMEVE QË RRJEDHIN NGA LISTËPAGESA



Përmbushësh konsiderohen tatimpaguesit që kanë paguar në kohë detyrimet që rrjedhin nga listëpagesa, *nëse kanë qenë 100 lekë detyrime që rrjedhin nga listëpagesa për t'u paguar, 90.4 lekë janë paguar në kohë, ndërsa 9.6 lekë nuk janë paguar.*

V. DEKLARIMI I SAKTË

V.A DEKLARIMI I SAKTË PËR TVSH-NË



Përmbushësh konsiderohen tatimpaguesit që pas përfundimit të kontrollit kanë rezultuar pa detyrime tatimore shtesë (gjetje) për TVSH-në, *nëse një tatimpagues ka patur 100 lekë detyrime TVSH-je për të deklaruar, ai ka deklaruar 88.69 lekë, ndërsa 11.31 lekë nuk i ka deklaruar.*

V.B DEKLARIMI I SAKTË PËR TATIMIN MBI FITIMIN



Përmbushës konsiderohen tatimpaguesit që pas përfundimit të kontrollit kanë rezultuar pa detyrime tatimore shtesë (gjetje) për TF-në, *nëse një tatimpagues ka patur 100 lekë detyrime TF-je për të deklaruar, ai ka deklaruar 95.88 lekë, ndërsa 4.12 lekë nuk i ka deklaruar.*

Për sa më sipër monitorimi është i rëndësishëm sepse duke i studiuar treguesit në mënyrë periodike dhe duke i analizuar në mënyrë të detajuar, do kemi mundësinë të njohim shkallën në të cilën tatimpaguesit përmbushin detyrimet e tyre tatimore, për periudha të caktuara dhe për lloje tatimi. Gjithashtu do të mund të ndërtojmë pasqyra në nivel DRT-je, Sektori dhe

Tregu, ku të evidentojmë nivelin e përmbushjes tatimore, si dhe të shikojmë mundësinë për të identifikuar risqe të reja.

- Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash ku tregues kryesorë të performancës janë:
  - Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve;
  - Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit ï reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk;
  - Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit ï reduktimi i hendekut të përmbushjes.
  - Vlera dhe numri i deklaratave të korrigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta;
  - Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT.

Objektivat e DMR janënëpërputhje me vlerësimin e TADAT Gusht 2016, Kapitulli III Vlerësimi i performancëssë të ardhurave tatimore, POA 2 - POA 6, të rekomanduara nga FMN për të cilat edhe raportohet gjatë misioneve të monitorimit të saj.
Në DMR nga aktivitet e programuara dhe realizuar gjatë vitit 2020 në funksion të realizimit të objektivave konstatohet:

1. Planet sektoriale të realizuara gjatë vitit 2020

1.1 Planet Sektoriale

Gjatë vitit 2019 - 2020 nga DMR u hartua implementua dhe analizua plani Sektorial i Bar-Restorante, dhe nëpërmjet tij nën asistencën e FMN experti i tij trajnoi stafin dhe hodhi bazat e hartimit të Planit **Sektorial të Ndërtimitsi një sektor i evidentuar me risk potencial dhe me ndikim në të ardhurat tatimore ku shumë subjekte tatimpagues dhe aktivitete që ndërthuren me njeri-tjetrin**. Analiza e riskut në sektorin e ndërtimit, nuk u arrit të realizohej gjatë periudhës janar mars nëpërmjet procesit të hartimit të strategjisë për trajtimin e riskut në ketë sektor për arsye të pandemisë Covid - 19, por ky sektor u përfshi në Planin Operacional Korrik ï Dhjetor 2020, miratuar me Vendimin e Komitetit Operacional nr. 1244, datë 03.07. 2020.

DMR ka punuar edhe në hartimin e ñPlanin Strategjik 2020-2021ò miratuar në Komitetin e Reformave me Vendimin nr.16292, datë 19.08.2020 dhe ñPlanin Operacional Korrik ï Dhjetor 2020, miratuar me vendimin e Komitetit Operacional nr.12444 date 03.07.2020, të cilat janë mbështetur në parimet dhe objektiva me bazë inteligjencën (Riskun), sepse për arsye të pandemisë Covid - 19 në periudhën Mars-Qershor 2020 pati një ndërprerje te kontrolleve. Rezultatet e këtij plani operacional janë miratuar në mbledhjen e Komitetit Operacional sipas Vendimit nr. 19, datë 21.12.2020 të tij dhe me nr. prot 24700, datë 21.12.2020 të Drejtoreshës së Përgjithshme.

Nga analiza e këtyre planeve konstatohet se:

- në bazë të planit sektorial operacional të bar ï restoranteve u arritën disa rezultate të cilat nga monitorimi i treguesve(*treguesit krahasohen me të njëjtën periudhë të një viti më parë)*kemi:

✓ 2% është rritur numri i kuponëve mesatarë,
✓ 6% është rritur qarkullimi me kasë,
✓ 9% është rritur paga mesatare e punonjësve,
✓ 8.4%janë rritur shitjet e tatueshme me 20%,
✓ 8%janë rritur shitjet e tatueshme me 6%,
✓ 100tatimpagues janë planifikuar për kontroll të plotë në vend,
✓ 48kontrolle kanë përfunduar deri në 31.12.2019,
✓ 26.3mln lekë janë gjetjet nga kontrolli.

- Plani operacional Korrik-Dhjetor 2020 përfshinte planin e turizmit, të zhvilluar gjatë muajve të verës dhe fokusin e administratës tatimore në sektorë si tregtia dhe ndërtimi si sektorë më pak të prekur nga gjendja e pandemisë dhe si sektorë me ndikim në realizimin e të ardhurave. Nëkëtë plan kriteret e riskut të aplikuara në përzgjedhjen e tatimpaguesve për trajtim ishin:
  - Tatimpagues të cilët gjatë periudhës janar-maj 2020 rezultojnë me rritje të qarkullimit por me rënie të TVSh-së detyrueshme për tu paguar;
  - Tatimpaguesit që janë kontribuesit kryesore të ardhurave duke përjashtuar bankat, ente publike të cilët bazuar në Modulin e Riskut kanë thyer kritere risku por që nuk janë kontrolluar pas Qershorit 2019. Ndaj tyre vlerësohet që bazuar në numrin e kritereve të thyera të jetë edhe reagimi administratës tatimore;
  - Tatimpagues të cilët ushtrojnë aktivitet në Sektorin e Tregtisë të cilët bazuar në të dhënat e deklarimeve dhe pagesave të TVSH rezulton me një gjendje kreditore të mbartur më të madhe se 1.000.000 lekë.
- Realizimit i planit operacional korrik-dhjetor 2020. Në zbatim të pikave të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të Planit Operacional korrik-dhjetor 2020, është bërë monitorimi, në mënyrë sistematike, i kontrolleve nga zyra dhe vizitave fiskale të planifikuara nga DPT-ja. Ky proces është ndjekur në baza ditore, duke filluar nga muaji korrik 2020 deri më datë 31.12.2020, nëpërmjet hapave të mëposhtëm:
- krijimit dhe implementimit të një formati standard të raportimit,
- grumbullimit të informacionit në nivel analitik,
- verifikimit të cilësisë,
- rakordimit me DRT-të në raste mospërputhje,
- prezantimit dhe analizës së performancës në nivel DRT-je.

Në përfundim të këtij procesi, rezultatet që paraqiten janë si vijon:

➢ *kontrollet nga zyra*

Kontrollet nga zyra të planifikuara nga DPT-ja në kuadër të Planit Operacional korrik-dhjetor 2020, konstatohen këto rezultate në nivel të përgjithshëm:

DRT	Kontrollet/ Planifikuar	Përfunduar				Nr. i kontrolleve në proces
		Nr. KP	Vlera e gjetjeve 000 lekë	% e realizimit	Nr. i Kontrolleve pa gjetje	
TOTAL	2,053	2,053	452,687	100%	1,459	-

Sa vërehet, numri i përgjithshëm i kontrolleve nga zyra është arritur në nivelin 100%, si dhe të gjitha DRT-të i kanë mbyllur kontrollet nga zyra të planifikuara në kuadër të këtij plani.

➢ *vizitat fiskale*

DRT	VF Planifikuar	Përfunduar				Nr. i kontrolleve në proces
		Nr. VFP	Vlera e gjetjeve 000 lekë	% e realizimit	Nr. i Kontrolleve pa gjetje	
TOTAL	430	430	48,204	100%	204	-

Sa vërehet numri i përgjithshëm i vizitave fiskale është arritur në nivelin 100%, të gjitha DRT-të i kanë mbyllur vizitat fiskale të planifikuara në kuadër të këtij plani .

1.2 Plani sektorial nëinformalitetin në tregun e punës

Gjatë vitit 2020 është punuar me implementimin e Planit OperacionalpërInformalitetin në tregun e punës. DMR nën asistencën e specialistëve tëBB evidentoi profesione të reja me

riskun e nën deklarimit tëpagëspër tëcilën u zgjodh trajtimi nëpërmjet letrave të personalizuara të hartuara.
U analizua Informaliteti nëtregun e punëspër të 4 komponentë dhe 2 nënkomponentë të tyre si:

1. Mosregjistrimi i punonjësve,
2. Mosdeklarimi i pagave reale,
3. Mosdeklarimi i saktë i kohëspunës,
4. Mosdeklarimi i saktë i kategorisësë profesionit dhe kategorisësë sigurime,

- Tatimpagues të cilët bëjnë deklarim sigurimesh shoqërore me vlerë 0-1 lekë,
- Tatimpaguesve me lëvizje të shpeshta të punonjësve;

Tabela përmbledhëse e planit sektorial në tregun e punës

	Letra 1 (10/2019-09/2020)	**Letra 2 (03/2020 bashkëpunim me BB)**	**Letra 3 (Plani operac. 2020) (08/2020-12/2020)**
Nr. Tatimpaguesve dërguar letër	11,941	3,618	5,270
Nr. Tatimpaguesve me rritje page	3,711		904
Nr. punonjësve dërguar letër	19,229	3,714	10,170
Rezultatet e evidentuara më poshtë			
Nr. punonjësve që nuk gjenden në LP deri 09/20 (larguar)	5,567		73
Nr. punonjësve për të cilët është rritur paga	5,750		1,665
Efekti i rritjes Kontribute	183,672,250		17,587,535
Efekti i rritjes TAP	78,629,187		5,202,469
Rritja Total (10/2019-09/2020)	**262,301,437**		**22,790,004**

1.2.1 Nisma e parë e ndërmarrë nga DMR në lidhje me nën deklarimin e pagave.

Nga analiza e të dhënave nga DMR të listë pagesave të dorëzuara në sistem është evidentuar risku i nëndeklarimit të pagave. Janë identifikuar 33 profesione të ndryshme për të cilat nga analiza e kryer mbështetur në të dhënat e disponueshme si dhe informacione të tjera, është arritur në konkluzionin që tatimpaguesit nuk deklarojnë nivelin real të pagave të punonjësve të tyre. Si fazë e parë e strategjisë së trajtimit, është përcaktuar dhe realizuar, dërgimi i letrave të personalizuara si për punëdhënësit (tatimpaguesit) ashtu dhe punëmarrësit si nëpërmjet postës ashtu dhe në llogarinë elektronike në sistemin *C@ts* për tatimpaguesit.

Letra 1 (10/2019 – 09/2020

Nr.	**DRT**	**Nr. Tatimpaguesve**	**Nr.Punonjësve**
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	313	500
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	221	441
3	Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	229	992
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	1,401	2,168
5	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	659	1,056
6	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	841	1,461
7	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	316	533
8	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	449	730
9	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	170	316
10	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	385	623
11	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	239	391
12	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	589	963
13	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	5,561	8,255
14	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	568	800
TOTALI		**11,941**	**19,229**

Si rezultat i njoftimeve të mësipërme të administratës tatimore u arrit që:

- 5750punonjësveju rrit paga;
- 5567 punonjës u larguan nga puna dhe nuk u gjendën më në listë pagesat e mëvonshme;
- 183.672.250 lekëështë efekti i rritjes së kontributeve nga ndërhyrja e tatimeve;
- 78.629.187lekëështëefekti i rritjes tatimit të ardhurave personaleTAP.

1.2.2 Nisma e ndërmarrë nëbashkëpunim me BankënBotërorenë lidhje me nëndeklarimin e pagave.

Nga analiza e pagave të deklaruara u vlerësuan si paga me nëndeklarim të gjitha pagat për profesionet inxhinier, ekonomist, farmacist, administrator, kuzhinier, laborant, bukëpjekësetj., deri nëvlerën 30 000 lekë. Në total është vendosur që tëdërgohejletër e personalizuar për 3618 tatimpagues dhe 3714 punonjës ose tëdërgohen dy lloje letrash, si përpunëdhënësin edhe përpunëmarrësin, njëra me një tekst me përmbajtje ñSTRONGò dhe tjetra me tekst me përmbajte ñSOFTò. Në letrat përpunëmarrësit ju kërkohej që të deklaronin nivelin real të pagës përpunonjësit e tyre dhe nga ana tjetërpunëmarrësve ju kërkohej që tëkërkonin deklarimin real tëpagës së tyre nga punëdhënësi.

Letrat 2(03/2020)në bashkëpunime BB

I. TOTALI I LETRAVE DËRGUAR PUNËDHËNËSVE SOFT & STRONG

Nr.	DRT	Soft	Strong	Totali
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	42	36	**78**
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	24	30	**54**
3	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	19	16	**35**
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	242	240	**482**
5	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	71	99	**170**
6	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	117	126	**243**
7	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	34	37	**71**
8	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	75	62	**137**
9	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	34	24	**58**
10	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	53	66	**119**
11	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	35	25	**60**
12	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	88	82	**170**
13	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	896	893	**1789**
14	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	79	73	**152**
Grand Total		**1809**	**1809**	**3618**

II. TOTALI I LETRAVE DËRGUAR PUNËMARRËSVE SOFT & STRONG

Nr.	DRT	Soft	Strong	Totali
1	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	41	24	**65**
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	30	24	**54**
3	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	30	13	**43**
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	263	264	**527**
5	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	66	71	**137**
6	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	109	106	**215**
7	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	22	40	**62**
8	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	53	59	**112**
9	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	13	16	**29**
10	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	67	42	**109**
11	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	24	27	**51**
12	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	69	106	**175**
13	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	1075	939	**2014**
14	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	65	56	**121**
Grand Total		**1927**	**1787**	**3714**

Për sa më sipër, për këtë nismë e cila u realizua edhe me specialistë të Bankës Botërore nuk u mundësua analiza e **saj sepse përkoi me periudhën e mbylljes së vendit si rezultat i pandemisë Covid-19, por efektet e saj mund të ishin analizuar në vijim duke paraqitur rezultatet DRT.**

1.2.3 Nisma në lidhje me deklarimin e pagës bruto 1 lek dhe lëvizjet e shpeshta të punonjësve

Janë identifikuar 3532 tatimpagues që deklarojnë punonjës me page bruto 1 lek dhe 1044 tatimpagues që bëjnë shpesh lëvizje të punonjësve të tyre, lëvizur punonjësi me shumë se 1 herë në muaj. Për këto tatimpagues janë dërguar letra të personalizuar ku ju bëhej me dije se administrata tatimore ka konstatuar që deklarojnë punonjës me 1 lek apo kanë lëvizje të shpeshta të punonjësve brenda të njëjtës periudhë tatimore mujore dhe ju kërkohej që të deklaronin nivelin real të pagës për punonjësit e tyre si dhe ju bë me dije se do të vazhdojnë të jenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm. (kryesisht këta janë punonjës të enteve publike sha, ujësjellësi)

1.2.4 Nisma e ndërmarrë në lidhje me nëndeklarimin e pagave (26000 lek), plani operacional Korrik-Dhjetor 2020 nr. 1244, datë 03.07. 2020.

Nga analiza e pagave të deklaruara në muajin qershor 2020 u vlerësuan si paga me nëndeklarim të gjitha pagat për profesionet inxhinier, ekonomist, farmacist, mekanik, murator, saldator, teknik etj., në vlerën 26000 lekë (në nivelin e pagës minimale). Në total u identifikuan 5359 tatimpagues dhe 10785 punonjës, por 89 tatimpagues të DTM-se u kthyen mbrapsht nga kjo e fundit pasi në qershor ishin kontaktuar edhe një herë nga DTM-ja për nivelin e ulët të fondit të pagave. Janë nisur 5270 letra për punëdhënësit dhe 10170 letra për punëmarrësit në të cilat ju kërkohej që të deklaronin nivelin real të pagës për punonjësit e tyre dhe nga ana tjetër punëmarrësve ju kërkohej që të kërkonin deklarimin real të pagës së tyre nga punëdhënësi.

Letra 3 (Plani operacional 2020) (08/2020-12/2020)

Nr.	DRT	Nr. Tatimpaguesve	Nr.Punonjësve
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	74	340
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	107	216
3	Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	100	204
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	667	1,172
5	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	349	661
6	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	428	903
7	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër	105	220
8	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	266	433
9	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	100	184
10	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	171	350
11	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	114	245
12	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	284	574
13	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	2,298	4,299
14	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	207	369
TOTALI		**5,270**	**10,170**

Si rezultat i njoftimeve të mësipërme të administratës tatimore u arrit që:

- 1,665 punonjësve ju rrit paga;
- 73 punonjës u larguan nga puna dhe nuk u gjendën më në listë pagesat e mëvonshme;
- 17,587,535 lekë është efekti i rritjes së kontributeve nga ndërhyrja e tatimeve
- 5,202,469 lekëështëefekti i rritjes tatimit të ardhurave personale TAP

1.2.5 *Nisma* e *marrë për DRT Tiranë dhe DTM si fazë pilot është bërë krahasimi i nivelit të pagave ndërmjet periudhave 12/2019 dhe 06/2020 për të evidentuar dhe kontaktuar tatimpaguesit me ulje të pagave për punonjës me shumë se 5.000 lekë/muaj.*

Në bazë të këtij pilotimi janë nisur informacione specifike në formë tabelash për këto dy drejtori të cilat e ndjekin në vijimësi këtë fenomen me risk në tatim pagues.

1.2.6 *Nisma për ndryshime në sistemin "C@ts" për të mos lejuar përdorimin e kategorisë së punonjësve që fillojnë punë për herë të parë në më shumë se dy periudha tatimore pa patur një (e-sig27) (formular që evidenton ndryshimin e punonjësve si në marrje ashtu dhe largim nga puna) në mes të periudhave tatimore.*

Në bazë të kësaj nisme nga DMR nga e-tax-helpdesk (zyra që ndërhyn në sistem) për këtë nisëm është bërë ndryshimi përkatës në sistemin *"C@ts"*.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 DMR ka përpunuara të dhëna nëpërmjet programit Excel të cilat janë dërguar në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë për tu marrë parasysh gjatë aktivitetit të saj në kuadër të minimizimit të borxhit tatimor. Shkresa e dërguar është më nr. 19075, datë 01.10.2020 bashkangjitur së cilës ka CD me të dhëna mbi kriteret e borxhit tatimor të thyera nga tatimpaguesit të cilat janë :

- Rritje e borxhit të TVSh-së,
- Rritje e borxhit për të gjitha llojet e tatimeve,
- Pagesë e vonuar e TVSh-së, 12 muaj,

Për sa më sipër për këto nisma dhe plane sektoriale të hartuara dhe të realizuara nga DMR duhet theksuar se të gjitha të dhënat i kërkohen drejtorisë TIK e cila pasi i gjeneron nga sistemi i vihen në dispozicion DMR. Punonjësit e kësaj drejtorie përpunojnë informacionin nëpërmjet programit Excel, proces i cili zgjat dhe është i vështirë për tu përpunuar bazuar në volumin e madh të informacioni. Kështu vetëm një listë pagesë mujore e punonjësve të regjistruar në listë pagesat e administratës tatimore ka rreth 700 mijë pozicione pune. Në këtë këndvështrim, kjo gjë duhet zgjidhur apo kryer nëpërmjet përmirësimit të sistemit ekzistues ose zgjedhur një formë tjetër apo programi cili do të lehtësonte shumë punën e DMR e cila duhet të merret me analiza më të thelluara të riskut e fenomeneve që i lindin administratës tatimore në lidhje me tatimpaguesit në përmirësimin e shërbimit ndaj tij dhe shmangien e evazionit fiskal e jo të merret me përpunime të panumërta të dhënash nëpërmjet programit Excel që kërkojnë kohë dhe punonjës të shumtë në numër.

2. Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndër-institucionale

Në bazë të marrëveshjeve ndërinstitucionale ndërmjet DPT, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Drejtoria e Proceseve të Biznesit ka evidentuar regjistrat elektronik të palëve të treta që janë të publikuara në GOV Net të cilat i disponon AKSHI-ne në bashkëpunim me të po mundësohet përfshirja e këtyre të dhënave në *Data Warehouse e sistemit të fiskalizimit* (bazë qendrore të dhënash që administrohet nga AKSHI).

Për sa më sipër në kuadër të këtij bashkëpunimi me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, DPT nëpërmjet DMR ka firmosur memorandumit e bashkëpunimit me OSHEE (Operatori i Shpërndarjesh së Energjisë Elektrike), Bashkinë e Tiranës dhe është në proces firmosje me Shoqatën e Eksperteve Kontabël (IEKA) dhe UKT (Ujësjellës Kanalizime Tiranë). Do të ishte mirë që kjo iniciativë të shtrihej në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të këtij informacioni do të mundësohej përfshirja e të gjithë tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave për të gjithë vendin me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve.

3. Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë Kërkesë për Rimbursim

Gjatë Vitit 2020 kanë ardhur 155 kërkesa për rimbursim nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH të cilat janë për 691 tatimpagues të ndryshëm. Sipas analizave 3 mujore bazuar në ekzekutimet e Modulit të Riskut, 151 tatimpagues janë propozuar për kontroll, më poshtë tabela e specifikuar sipas muajve të vitit 2020:

Përmbledhje e kërkesave për rimbursim

Muaji	Numri i kërkesave të ardhura	Numri i tatimpaguesve që kërkojnë Rimbursim TVSH-je	Numri i tatimpaguesve që propozohen për kontroll bazuar në Analizën e Riskut
JANAR	4	16	10
SHKURT	14	50	26
MARS	14	60	15
PRILL	21	83	26
MAJ	15	67	13
QERSHOR	17	82	6

KORRIK	15	65	10
GUSHT	7	23	6
SHTATOR	16	71	15
TETOR	12	54	8
NENTOR	10	64	9
DHJETOR	10	56	7
TOTALI	155	691	151

- ✓ është kryer 4 (katër) herë për vitin 2020 ekzekutimi i modulit të riskut apo i bashkësisë së parametrave të riskut, kriteret për rimbursimin e TVSH-së, si më poshtë:
- shkurt - prill 2020 datë 10.02.2020;
- maj - korrik 2020 datë 08.05.2020;
- gusht - shtator 2020 datë 10.08.2020;
- nëntor - janar 2021 datë 10.11.2020.

- ✓ gjithashtu konstatohet se në rregulloren për rimbursimin e TVSh-së, mbështetur në Analizën e Riskut, miratuar me urdhrin nr. 19/1, datë 28.04.2020, rregullat e aplikuara në modulin e riskut për rimbursimin e TVSh-së janë 13 (trembëdhjetë),si më poshtë:

1. Rritje e borxhit të TVSh-së ,
2. Rënie e Pagesës së TVSh-së ,
3. Qarkullim i lartë pagesë e ulët kombëtare,
4. Vlera e eksporteve më e madhe se mesatarja e sektorit,
5. Ndryshim i deklaratës se TVSh-së ,
6. Deklarim i vonuar i TVSh-së 12 muaj,
7. Pagese e vonuar e TVSh-së 12 muaj,
8. Marzhi i fitimit, TVSh më e vogël se sektori (Sh-B/SH); pa shitje dhe blerje te përjashtuara,
9. B/SH > 90% (Raporti i performancë s së kompanisë > 90%,
10. B/Sh e Kompanisë - B/Sh e Sektorit > 15% : Raporti i performancës së TVSh-së ,
11. Fitim ne TF dhe ne TVSH, Blerje >= Shitje,
12. Kontrolli i furnitorëve të tatimpaguesit,
13. Kontrolli i shitjeve bazuar në deklaratat e blerësve të tatimpaguesit.

4. Ndryshimi i përgjegjësive tatimore bazuar në tëdhënat e pajisjeve fiskale dhe deklaratat mujore të TVSh-së.

Gjatë vitit 2020 nga ana e DMR në mënyrë periodike janë analizuar të dhënat e pajisjeve fiskale, në bazëtë deklaratave mujore të TVSh-sëpër të parë sjelljen e tatimpaguesve në raport me përgjegjësinë tatimore që ato përfaqësojnë dhe janë dërguar nëpër DRT në mënyrë periodike.

Tabela përmbledhëse sipas muajve të vitit 2020.

Muaji	Nr.TP që janë evidentuar për ndryshim nga Deklaratat e TVSh-së	Nr.TP qëjanë evidentuar për ndryshim përgjegjësie nga tëdhënat e pajisjeve fiskale
Janar		22
Shkurt	11	41
Mars		
Prill		47
Maj		
Qershor		106
Korrik		
Gusht		
Shtator		
Tetor	529	
Nëntor	227	
Dhjetor	225	

Totali	**992**	**216**

Nga verifikimet dhe analiza e realizuar nga DMR për të gjitha rastet e mësipërme janë konstatuar:

- 992 tatimpagues të evidentuar për ndryshim përgjegjësie tatimore në BM bazuar në deklaratat mujore të TVSh-së;
- 216 tatimpagues të evidentuar për ndryshim përgjegjësie tatimore që janë dërguar pranë DRT-ve për verifikim për ndryshim përgjegjësinë tatimore në BM dhe BV me TVSh bazuar në të dhënat mujore të pajisjeve fiskale;
- Më poshtë Lista e TP sipas DRT që ndryshojnë përgjegjësitë tatimore bazuar në deklaratën e TVSh-së për vitin 2020.

Nr.	DRT	Numri i subjekteve që plotësojnë kriteret për ndryshim përgjegjësie dërguar në DRT	Numri i subjekteve që kanë ndryshim përgjegjësie në BM
1	DRT Tiranë	638	627
2	DRT Elbasan	29	27
3	DRT Durrës	69	69
4	DRT Shkodër	15	15
5	DRT Fier	43	42
6	DRT Vlorë	53	50
7	DRT Korçë	40	36
8	DRT Lezhë	24	24
9	DRT Gjirokastër	15	14
10	DRT Berat	17	15
11	DRT Sarandë	17	16
12	DRT Dibër	11	11
13	DRT Kukës	21	21
	Totali	**992**	

5. Ndryshimi i përgjegjësive tatimore bazuar në të dhënat e deklaratave vjetore të TFTH-së 2020 .

Gjithashtu konstatohet :

Lista e TP që ndryshojnë përgjegjësitë tatimore bazuar në deklaratat e TFTH - së 2020

Nr.	DRT	Numri i subjekteve që plotësojnë kriteret për ndryshim përgjegjësie dërguar në DRT	Përpunuar nëpërmjet sistemit Excel nga DMR për ndryshim Përgjegjësie tatimore sipas rekomandimeve	Mos ndryshim për arsye të tjera**
1	DRT Tiranë	241	236	**5**
2	DRT Elbasan	8	7	**1**
3	DRT Durrës	14	11	**3**
4	DRT Shkodër	9	2	**7**
5	DRT Fier	19	18	**1**
6	DRT Vlorë	18	-	**18**
7	DRT Korçë	15	13	**2**
8	DRT Lezhë	10	8	**2**
9	DRT Gjirokastër	7	-	**7**
10	DRT Berat	8	4	**4**
11	DRT Sarandë	4	4	**-**
12	DRT Dibër	7	7	**-**
13	DRT Kukës	7	5	**2**
	Totali	**367**	**315**	**52**

Për sa më sipër konstatohet se janë 367 tatimpagues të evidentuar për ndryshim përgjegjësie tatimore nga ato dërguar pranë DRT-ve për verifikim dhe ndryshim përgjegjësinë tatimore ne BM

6. Ndryshimi i përgjegjësive tatimore bazuar në të dhënat e deklaratave vjetore të TVSH-së 2019 .

Lista e TP që ndryshojnë përgjegjësitë tatimore bazuar në deklaratat e TVSh-së 2019

Nr.	DRT	Numri I subjekteve që plotësojnë kriteret për ndryshim përgjegjësie dërguar në DRT	Përpunuar nëpërmjet sistemit Excel nga DMR për ndryshim Përgjegjësie tatimore sipas rekomandimeve	Mos ndryshim për arsye të tjera**
1	DRT Tiranë	546	536	**10**
2	DRT Elbasan	12	12	**-**
3	DRT Durrës	50	50	**-**
4	DRT Shkodër	21	20	**1**
5	DRT Fier	47	46	**1**
6	DRT Vlorë	45	42	**3**
7	DRT Korçë	29	29	**-**
8	DRT Lezhë	12	11	**1**
9	DRT Gjirokastër	18	18	**-**
10	DRT Berat	9	9	**-**
11	DRT Sarandë	8	8	**-**
12	DRT Dibër	5	5	**-**
13	DRT Kukës	7	6	**1**
	Totali	**809**	**792**	**17**

Për sa më sipër konstatohet se janë 809 tatimpagues të evidentuar për ndryshim përgjegjësie tatimore në BM bazuar në deklaratat mujore të TVSh-së për vitin 2019.

7. Evidentimi i TP që rezultojnë me mospërputhje të xhiros së deklaruar në të dhënat e pajisjeve fiskale me Xhiron në deklaratat mujore të TVSH-së.

Gjatë periudhës Shtator ï Dhjetor 2020 janë evidentuar tatimpaguesit të cilët kanë rezultuar me xhiro me kasë më të madhe se ajo e deklaruar në deklaratat e TVSH-së dhe u janë dërguar DRT-ve përkatëse. (kryesisht ka të bëjë me shtypje gabim në kasat fiskale)

Muaji	Diferenca xhiro me kasë -deklaruar
shtator	617
tetor	449
nëntor	244
dhjetor	356
Totali	**1666**

Për këto të dhëna nuk ka informacion sepse janë lënë detyrë DTR-ve të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e tyre.

8. Analiza periodike për tatime të veçanta dhe për sektorë të caktuar

Gjithashtu nga ana e DMR janë marrë edhe disa iniciativa të tjera që nxisin përmbushjen vullnetare, ndër të cilat përmendim:

- *Krahasimi xhiro me kase / deklaratë TF ose TFTH për vitin 2019*, ku janë evidentuar TP që rezultojnë me xhiro me kase për vitin 2019 por nuk kanë plotësuar deklaratën vjetore të TF dhe TFTH dhe TP që rezultojnë me xhiro me kasë më të madhe se 25.000 lekë në krahasim me deklaratën vjetore të TF ose TFTH për vitin 2019;
- *Evidentimi i TP me raportin blerje shitje me te madhe se 25% (përjashtuar blerjet për investim),* bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-së mujore janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me 25% blerje me shumë se pasi janë hequr blerjet dhe importet për investime. Këto TP janë kontaktuar nëpërmjet DRT-ve dhe në rastet e mos përmirësimit të treguesve janë dërguar për monitorim nga DVKT;
- *Evidentimi i TP që nuk deklarojnë faturat e energjisë elektrike* janë dërguar letra të personalizuara tatimpaguesve BV me TVSH të cilët gjatë vitit 2019 nuk kanë deklaruar fatura blerje të energjisë elektrike nga OSHEE në librat e blerjes.
- *Verifikimi i hartuesve te bilanceve 19A* janë evidentuar Kontabilistë/Ekspertë të cilët kanë dhënë shërbime lidhur me Bilancet 19A. TP u është dërguar Letër nga DRT-të përkatëse. Është gjykuar e nevojshme të analizohen transaksionet e kryera mes këtyre nipteve nga Drejtorisë së Hetimit në kuadër të evidentimit të dy risqeve bazë të cilat kanë rezultuar gjatë

Testimeve që DMR ka kryer për disa TP:

1. Risku i mos-deklarimit të faturave nga njëra palë;

2. Risku i shkëmbimit të faturave mes tyre me qëllim uljen e detyrimeve tatimore (veçanërisht TVSH)

- *Evidentimi i TP me fatura blerje me vlerë të lartë në fund të muajit Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020*
- *Evidentimi i TP me rënie të vazhdueshme të Qarkullimit*
- *Mesazh "Pop Up"* ï TP në sektorin e Hidrokarbureve që vendosin nipt jo të saktëTP me fatura shitje ku nipti i blerësit nuk është i saktë iu dërgua Mesazh Pop Up i cili u shfaq për 7 ditë me vijim.
- *Google FORM:* U krahasua numri i punonjësve të deklaruar në Google Form me numrin e punonjësve në deklaratat e listëpagesave Korrik 2020. Niptet të cilët kishin deklaruar më shumë punonjës në Google Form se në listëpagesë iu dërguan D.V.K.T për të kryer verifikimet përkatëse.
- *Mosdeklarimi i Faturës së Energjisë Elektrike* TP me vlerë konsumi vjetor mbi 200.000 lekëjanë njoftuar nga AT nëpërmjet Letrave që të bëjnë korrigjimet përkatëse në Librat e Blerjeve. TP me të dhëna tel të sakta që nuk kishin reaguar u dërguan në Qendrën e Thirrjeve që të kontaktohen dhe të merren arsyet se mosdeklarimit të faturës së energjisë eklektike.
- *Listat me subjekte te cilat kane Shitje me shkalle tatimore TVSH =6%, 10% TF=5%,* u evidentuan listat me subjekte të cilat kanë shitje me shkalle tatimore 6%, 10%, 5% të cilat iu dërguan DRT-ve për të kryer verifikimet përkatëse.
- *Njoftim i TP për të dorëzuar Deklaratat Tatimore nëpërmjet CallCenter- DSH*
  - Evidentimi i TP Mos-deklarues të Listë pagesave 3 Muajt e fundit
  - Evidentimi i TP Mos-deklarues të TVSH-së 3 Muajt e fundit
  - Evidentimi i TP me Vlerësim Automatik për TF 19A
- *Evidentimi i TP me Auto ngarkesë në Blerje më të madhe se Auto ngarkesa në Shitje Janar-Shtator,* u evidentua Lista e tatimpaguesve sipas DRT-ve, që rezultojnë me Diferencë (mbi 10,000 lekë) në Auto ngarkesë bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-sëpërperiudhën Janar ï Shtator 2020. Dërguar DRT-ve që pasi të bëjnë verifikimet përkatëse te marrin masa për korrigjimin e deklaratave.

  Për sa më sipër këto të dhëna të cilat përpunohen nga DMR i vihen në dispozicion DRT në formë elektronike për të cilat duhet të njoftojnë tatimpaguesit.

  Gjithashtu nga të dhënat dhe auditimi konstatohet se DMR nga ana e saj të dhënat i dërgon në DRT nëpërmjet e-mail të cilët janë të detajuar për çdo degë tatimore dhe me subjekte tatimpagues kështu konstatohet se për vitin 2020 janë dërguar këto e-maile si më poshtë në:

- *e-mailda të 18.02.2020*- bashkëlidhur lista me tatimpaguesit të cilët rezultojnë me diferencë më shumë se 20.000 lekë nga krahasimi i deklaratave mujore të TVSh-se dhe xhiros se deklaruar nëpërmjet pajisjeve fiskale për periudhën Janar-Dhjetor 2019.Drejtoritë Rajonale Tatimore duhet të verifikojnë rastet përkatëse duke hequr nga listat vlerën e xhiros se shtypur gabim sipas njoftimeve nga tatimpaguesit;
- *e-mail datë 04.02.20* - bashkëlidhur gjeni listën e tatimpaguesve aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-se për periudhën Janarð Dhjetor 2019. Pasi të bëni verifikimet përkatëse merrni masa për ndryshimin e përgjegjësive tatimore sipas rekomandimit në BM dhe raportoni për këto ndryshime brenda datës 31.01.2020;
- *e-mail* datë 14.08.2020 – dërgohet bashkëlidhur do të gjeni listën e tatimpaguesve të cilët duke krahasuar deklaratën e Tatim Fitimit 2019 (të ardhurat tatimore) me totalin e të ardhurave sipas deklaratave te TVSH-se Janar ï Dhjetor 2019 rezultojnë me diferenca më të mëdha se +/- 100.000 lekë;

- *e-mail* datë 24.08.2020 –bashkëlidhur lista e tatimpaguesve BV me TVSh të cilët gjatë vitit 2019 nuk kanë deklaruar fatura blerje të energjisë elektrike nga OSHEE në librat e blerjes. Bashkëlidhur modeli i letrës së personalizuar që duhet ti dërgohet çdo njërit prej tyre;
- *e-mail* datë 25.08.2020 – bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-së për periudhën Janar-Korrik 2020 janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me 25% blerje me shumë se shitje për periudhë Janar-Korrik 2020, pasi janë hequr blerjet dhe importet për investime.
  Për të patur efekt në vizitat fiskale e burimet e limituara të përdoren në maksimizim të rezultateve u morën në konsiderate ata TP të cilët kanë të ardhura mbi 7 milion lekë për periudhën Janar-Korrik 2020.
  DRT nëpërmjet inspektoreve të caktuar duhet të kontaktoje ne telefon tatimpaguesit ku ti bëjmë me dije analizën tone, problematikën e vënë re dhe t`i nxisin për përmbushje tatimore dhe nëse nuk kemi një reagim përmirësues të raportit blerje /shitje deri në momentin e deklarimit të librave të shitjeve dhe blerjeve për periudhën Gusht 2020, strukturat e monitorimit në terren ose strukturat e DRT-ve do të bëjnë vizita tematike për inventarët.
- *e-mail* datë 21.09.2020 – bazuar edhe në rekomandimet e KLSH në raportin e fundit bashkëlidhur lista e TP të cilët duhen verifikuar nga ana juaj nëse plotësojnë kushtet për aplikimin e normave të reduktuara të TF dhe të TVSH-së.
  Bashkëngjitur gjeni listën me subjekte të cilat kanë
  - Shitje me shkallë tatimore 6%
  - Shitje me shkallë tatimore 10%
  - Tatim fitim me shkallë standarde 5%.
  - Për subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme me shkallë tatimore 6% të verifikohet nëse plotësojnë kriteret ligjore në baze të nenit 49 ligji nr. 92/2014 ñPër Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSHò.
  - Të verifikohet nëse plotësohen kriteret për zbatimin e shkallës të reduktuar sipas nenit 11/1 VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, ñPër Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar.
  - Për subjektet që aplikojnë shkallën standarde të Tatim Fitimit prej 5% të verifikohet nëse plotësojnë kriteret ligjore në bazë të nenit 28 ligji nr. 8438, datë 28.12.1998Për Tatimin mbi të Ardhurat i ndryshuar.
  - Për subjektet që plotësojnë Rubrikën e Shitjeve me shkallë tatimore 10% të njoftohen për kryerjen e korrigjimeve përkatëse të deklaratave të TVSh-së.
- *e-mail datë 21.09.2020* –të deklaruara nga tatimpaguesit për Kontabilistët/Ekspertët që kanë plotësuar Bilancet- pasqyrat financiare të vitit 2019. Të gjitha emrat e Kontabilistëve/Ekspertëve e vet deklaruara nga tatimpaguesit u verifikuan nëse e kanë faturuar shërbimin për këta tatimpagues. Ky verifikim u krye ne librat e tyre te shitjes për periudhën Janar-Korrik 2020.
  Nga verifikimi rezulton :
  - 27 TP nuk kanë dorëzuar Libër Shitje për periudhën Janar- Korrik 2020
  - 451 Kontabiliste/Eksperte nuk kane deklaruar shërbimin në librat e shitjes për 2.751 tatimpagues ose rreth 40% e totalit

  Për sa më sipër duhet që çdo DRT sipas listës bashkëlidhur të printojë listën e tatimpaguesve të pa faturuar nga ana e Ekspertit/Kontabilist dhe t'ia dërgojë Eksperti/Kontabilisti së bashku me letrën shoqëruese që gjithashtu po e dërgojmë si model bashkëlidhur. Për të gjitha rastet që nuk kanë deklaruar libra shitje të kontaktohen nga ana juaj dhe të raportohen.
- *e-mail datë 21.10.2020* **-** bazuar në të dhënat e deklaratave te TVSH-se për përudhën janar-shtator 2020 janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me Blerje 25% me të lartë se Shitje për periudhën janar-shtator 2020 , pasi janë hequr Blerjet dhe Importet për investime.

Lista përbëhet nga 224 TP nga të cilët:

- 171 TP rezultojnë me Blerje 25% > Shitjet për periudhën janar- Shtator 2020
- 53 TP qe rezultuan me Blerje 25% > Shitjet gjatë periudhës Janar- Gusht 2020 te cilët edhe pas kontaktit nga Qendra e Thirrjes nuk kane reaguar.

- *e-mail datë 27.10.2020* - bashkëlidhur gjeni listën e tatimpaguesve aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSh-së për periudhën janar ï shtator 2020
  Pasi të bëni verifikimet përkatëse merrni masa për ndryshimin e përgjegjësive tatimore sipas rekomandimit në BM
- *e-mail datë 19.11.2020*-bashkëlidhur po Ju dërgojmë ndarë sipas çdo DRT-je listën e tatimpaguesve që nga krahasimi i xhiros së pajisjeve fiskale dhe qarkullimit në deklaratat e TVSh-se për muajin tetor 2020 rezultojnë me një diferencë më të madhe se 500.000 lekë.
  Janë përfshirë në lista vetëm TP e BM dhe ata që kanë deklaruar periudhën 2010 por janë BV me TVSh.
  Ju lutemi te verifikoni rastet dhe nëse tatimpaguesit nuk kanë njoftuar sipas procedurave për shtypje gabim të pajisjeve fiskale të merren masat përkatëse nga ana juaj.
- *e-mail datë 19.11.2020* - bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-se për periudhën janar-tetor 2020 janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me Blerje 25% më të lartë se Shitje për periudhën janar-tetor 2020 , pasi janë hequr Blerjet dhe Importet për investime.
  U përjashtuan ata tatimpagues të cilët kanë rezultuar me të njëjtën problematik të periudhës janar- korrik, gusht, shtator të cilat i janë dërguar më parë DRT-ve ose Q.TH. Gjithashtu janë hequr entet publike, OJF si dhe Subjektet Pasive, të çregjistruara apo me Kërkesë për çregjistrim.
  Për të patur efekt ne vizitat fiskale e burimet e limituara të përdoren në maksimizim të rezultateve u morën ne konsiderate ata TP të cilët kanë të ardhura mbi 9 milion lekë për periudhën janar-tetor 2020.
- *e-mail datë 27.11.2020* **-** bashkëlidhur gjeni Listën e tatimpaguesve aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave te TVSH-se për periudhën janar ï tetor 2020.
  Pasi të bëni verifikimet përkatëse merrni masa për ndryshimin e përgjegjësive tatimore sipas rekomandimit në BM;
- *e-mail datë 15.12.2020* **-** bashkëlidhur gjeni listën e tatimpaguesve aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSh-së për periudhën janar ï nëntor 2020.
  Pasi të bëni verifikimet përkatëse merrni masa për ndryshimin e përgjegjësive tatimore sipas rekomandimit ne BM dhe raportoni për këto ndryshime tek adresa a.m@tatime.gov.al brenda datës 21 dhjetor 2020;
- *e-mail datë 17.12.2020* **-** bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-se për periudhën janar-nëntor 2020 janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me Blerje 25% më të lartë se Shitje pasi janë hequr Blerjet dhe Importet për investime;
- *e-mail datë 21.12.2020* - bashkëlidhur po Ju dërgojmë ndarë sipas çdo DRT-je listën e Tatimpaguesve që nga krahasimi i xhiros se pajisjeve fiskale dhe qarkullimit në deklaratat e TVSh-së për muajin nëntor 2020 rezultojnë me një diference më të madhe se 500.000 lekë.
  Janë përfshirë në lista vetëm TP me formën ligjore BM dhe BV me TVSh që kanë deklaruar periudhën nëntor 2020;
- *e-mail datë 27.01.2021*- bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSh-së për periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me 2 problematikat si më poshtë:

- 44 TP që kanë plotësuar Rubrikën Shitje me 10% në Deklaratën e TVSh-së gjatë periudhës janar- dhjetor 2020,
- 7 TP që rezultojnë me Auto ngarkesë ne Blerje > Shitje gjatë muajit dhjetor
- Ju lutem te kryhet kontaktimi i 51 TP;

- *e-mail datë 04.032021*- bashkëlidhur gjeni Listën e tatimpaguesve aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave të Tatim fitimit të Thjeshtuar 2020 (Zëri te ardhura Tatimore)
  Pasi të bëni verifikimet përkatëse merrni masa për ndryshimin e përgjegjësive tatimore sipas rekomandimit ne BM sipas rastit;
- *e-mail datë 09.11.2020* – bashkëngjitur listën e TP Aktiv me Qarkullim mbi 14 mln lekë të cilët rezultojnë me Rënie Qarkullimi për periudhën gusht-shtator 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
  Nga lista totale janë hequr entet publike , subjektet që kanë eksporte gjatë vitit 2020 mbi 2 milion lekë, subjektet në Drejtorinë e Tatimpaguesve të mëdhenj si dhe Subjektet me aktivitet Tregti Karburanti .
  Për shkak të numrit të madh të subjekteve me rënie qarkullimi po ju dërgojmë listën me 1.262 TP në Sektorin e Tregtisë me qarkullin në të dy periudhat, rënie qarkullimi me > 100,000 lekë dhe që rënia është më e madhe se 20% duke krahasuar periudhat dhe në vijim me kërkesën tuaj ju nisim dhe sektorët e tjerë.
- *e-mail datë 11.12.2020* - nga analiza e faturave te deklaruara në datat e fundit të muajit Nëntor në Librat e Blerjes së gjithë popullatës së TP, u evidentuan TP që kanë deklaruar fatura blerje brenda vendit me vlerë më të lartë.
  Kjo me qëllim zbulimin e rasteve të marrjes së faturave fiktive të blerjes në ditët e fundit të muajit për të zvogëluar detyrimin tatimor të TVSh-së.
  Nga analiza vihet re se janë:

o 298 TP Aktiv me fatura blerje me vlerë të lartë në fund të muajit, përkatësisht data 29 dhe 30 Nëntor 2020,
  Këta TP kanë marrë 368 Fatura Blerje me vlerë mbi 1 mln lekë.
  Për sa më sipër për këto planë sektoriale të hartuara dhe të realizuara nga DMR duhet theksuar se të gjitha të dhënat i kërkohen drejtorisë TIK e cila pasi i gjeneron nga sistemi i vihen në dispozicion DMR ku punonjësit e saj përpunojnë informacionin nëpërmjet programit Excel, proces i cili zgjat dhe është i vështirë për tu përpunuar bazuar në volumin e madh të informacioni sepse, gjatë vitit 2020 në regjistrin e popullatës nga të dhënat e nëntor 2020 janë rreth:

✓ 24.200 TP MB që plotësojnë deklaratën vjetore të Tatim Fitimit,
✓ 34.200 TP BV me TVSh që plotësojnë deklaratën vjetore të Tatim të Thjeshtuar të Fitimit,
✓ 55.000 TP BV pa TVSh që plotësojnë deklaratën vjetore të Tatim të Thjeshtuar të Fitimit,
✓ 5.500 TP të tjera (OJF , Ente Publike , organizata) të cilët mund të plotësojnë TF ose TFTH,
✓ 58.400 TP që plotësojnë deklaratën mujore te TVSh-së
✓ Në listë pagesën e dhjetor 2020 rezultojnë 691.496 pozicione pune të deklaruara.

*****

Për sa më sipër në mënyrë të përmbledhur me gjithë punën e bërë nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut që nëpërmjet identifikimit mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi, kryerjes së analizave për risqet e evidentuara dhe hartimi i propozimeve dhe rekomandimeve për trajtimin e tyre në nivel sektorial, rajonal apo kombëtar konstatohen mangësi në drejtim të:

- implementimit të strukturës së Drejtorisë së Riskut ka filluar në korrik të vitit 2020, ose rreth 5 muaj e gjysmë me vonesë si dhe të mungesave në personel;
- për kontrollet nga ana e DRT nuk janë mbledhur vlerësimet e raporteve të tyre pasi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është në proces pune për një standardizim dhe unifikim të raporteve të kontrollit, sepse nga ana e DMR-së në mënyrën si hartohen raportet e kontrollit nga DRT është e pamundur unifikimi i vlerësimeve për saktësinë e shkeljeve ligjore apo të risqeve me shkelje të evidentuara në çdo rast, megjithëse DRT nga ana e tyre duhet të përgatisin raporte përgjithësuese për çka konstatohet dhe të japin në mënyrë periodike kush janë problematikat më të shpeshta të hasura dhe mendime për përmirësimin e kritereve të risqeve, të cilën ato pothuajse nuk e realizojnë;
- moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2015, vit në të cilin është instaluar dhe është arritur përdorimi i plotë i tij, por i janë përmirësuar rregullat brenda vetë modulit. Moduli i riskut është shumë i rëndësishëm të përmirësohet sepse në përmjet tij në mënyrë të shpejtë dhe të saktë përpunohen të dhënat e hedhura nga tatimpaguesit në sistem e arrihet:
  - identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen,
  - të verifikohet veprimtaria tregtare e tatimpaguesve të cilëve do dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi;
  - ndihmon administratën tatimore të zbulojë evazionin dhe mashtrimin tatimor,
  - shqyrton automatikisht një aspekt të veçantë të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi për periudhën për tre vitet e fundit,
  -etj.
- monitorimi është i rëndësishëm sepse duke i studiuar treguesit në mënyrë periodike dhe duke i analizuar në mënyrë të detajuar, do kemi mundësinë të njohim shkallën në të cilën tatimpaguesit përmbushin detyrimet e tyre tatimore, për periudha të caktuara dhe për lloje tatimi. Gjithashtu do të mund të ndërtojmë pasqyra në nivel DRT-je, Sektori dhe Tregu, ku të evidentojmë nivelin e përmbushjes tatimore, si dhe të shikojmë mundësinë për të identifikuar risqe të reja. Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash ku tregues kryesorë të performancës janë:
  - Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve;
  - Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit ï reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk;
  - Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit ï reduktimi i hendekut të përmbushjes.
  - Vlera dhe numri i deklaratave të korrigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta;
  - Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT.
- nisma e ndërmarrë në bashkëpunim me Bankën Botërore në lidhje me nën deklarimin e pagave nuk u mundësua analiza e saj për efekt sepse përkoi me periudhën e mbylljes së vendit si rezultat i pandemisë Covid-19, por efektet e saj mund të ishin analizuar në vijim duke paraqitur rezultatet DRT.
- nismat dhe planet sektoriale të hartuara dhe të realizuara nga DMR, përpunohen nga punonjësit e kësaj drejtorie nëpërmjet programit Excel, proces i cili zgjat dhe është i vështirë për tu përpunuar bazuar në volumin e madh të informacioni. Kështu vetëm një listë pagesë mujore e punonjësve të regjistruar në listë pagesat e administratës tatimore ka rreth 700 mijë pozicione pune. Në këtë këndvështrim, kjo gjë duhet zgjidhur apo kryer nëpërmjet përmirësimit të sistemit ekzistues ose zgjedhur një formë tjetër apo program i cili do të lehtësonte shumë punën e DMR e cila duhet të merret me analiza më të thelluara të riskut e fenomeneve që i lindin administratës tatimore në lidhje me tatimpaguesit në përmirësimin e

shërbimit ndaj tij dhe shmangien e evazionit fiskal e jo të merret me përpunime të panumërta të dhënash nëpërmjet programit Excel që kërkojnë kohë dhe punonjës të shumtë në numër, gjithashtu sepse, gjatë vitit 2020 në regjistrin e popullatës nga të dhënat e nëntor 2020 janë rreth:

- 24.200 TP MB që plotësojnë deklaratën vjetore të Tatim Fitimit,
- 34.200 TP BV me TVSh që plotësojnë deklaratën vjetore të Tatim të Thjeshtuar të Fitimit,
- 55.000 TP BV pa TVSh që plotësojnë deklaratën vjetore të Tatim të Thjeshtuar të Fitimit,
- 5.500 TP të tjera (OJF , Ente Publike , organizata) të cilët mund të plotësojnë TF ose TFTH,
- 58.400 TP që plotësojnë deklaratën mujore te TVSh-së,
- Në listë pagesën e dhjetor 2020 rezultojnë 691.496 pozicione pune të deklaruara.

- në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, DPT nëpërmjet DMR ka firmosur memorandumit e bashkëpunimit me OSHEE (Operatori i Shpërndarjesh së Energjisë Elektrike), Bashkinë e Tiranës dhe është në proces firmosje me Shoqatën e Eksperteve Kontabël (IEKA) dhe UKT (Ujësjellës Kanalizime Tiranë). Do të ishte mirë që kjo iniciativë të shtrihej në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të këtij informacioni do të mundësohej përfshirja e të gjithë tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave për të gjithë vendin me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve;
- mungesa e një koordinimi më të mirë ndërmjet DRT-ve dhe Drejtorive funksionale në DPT me DMR të cilat duke qenë më pranë problematikave dhe fenomeneve duhet të informojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe rast pas rasti DMR për risqe potenciale si bazë në hartimin e strategjive për nxitjen e përmbushjes, sepse punonjësit e DRT janë direkt me realitetin e sjelljes së tatimpaguesit.
- Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoritë Funksionale në DPT bazuar në proceset e tyre të punës, dhe zbatimit të detyrave funksionale nuk i evidentojnë të gjitha problematikat, fenomenet, ngjarjet, sjelljet, eksperiencat, perceptimet, qëndrimet që hasin dhe që mund të konsiderohen risk për realizimin e objektivave të Administratës Tatimore;
- Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoritë Funksionale në DPT nuk i paraqesin apo dërgojnë në DMR informacion në periodicitet vjetor nevoja për përmirësim të Modulit të Riskut aktual, ashtu edhe në mundësinë e përshtatjes së sjelljeve të saj në terma afatgjatë gjatë hartimit te strategjive të trajtimit të riskut dhe grup risqeve të evidentuara si një avantazh për Administratën Tatimore;
- në realizimin e analizave dhe përcaktimi i kritere të risku të cilat shmangin abuzimin dhe evidentojnë ata tatimpagues me risk në shmangien përgjegjësisë tatimore të TVSh-së dhe tatim fitimi nga administrata tatimore nga ekzistenca e një risku potencial që një numër i madh tatimpaguesish reduktuan xhiron e deklaruar për të përfituar nga lehtësi tatimore, bazuar në ndryshimet ligjore VKM nr. 576 datë 22.07.2020 dhe me ligj nr. 106 datë 29.07.2020 lidhur me ndryshimin e pragjeve të qarkullimit për tu përfshirë në përgjegjësinë tatimore 10 milion lekë dhe për Tatim Fitimi 14 milion lekë.

Gjetja Mangësi në identifikimin mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht të tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial të cilët duhet të trajtohet nga administrata tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi, kryerjes së analizave për risqet e evidentuara dhe hartimi i propozimeve dhe rekomandimeve për trajtimin e tyre në nivel sektorial, rajonal apo kombëtar.

Situata: - Implementimi i strukturës së re të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut ka filluar në korrik të vitit 2020, ose rreth 5 muaj e gjysmë me vonesë si dhe ka mungesa në personel për këtë drejtori.

- Nga auditimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut konstatohet se, moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti

2015, vit në të cilin është implementuar sepse ky modul shqyrton automatikisht aspekte të veçantë të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi. Ky azhornim bëhet i domosdoshëm për të qenë në koherence me gjithë ndryshimet që ka pësuar legjislacioni fiskal ndër vite, vetë administrata tatimore por edhe profili i tatimpaguesve. Kjo me qëllim identifikimin dhe verifikimin e tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial në harmoni me procedurat ligjore në fuqi dhe ndihmon administratën tatimore të zbulojë evazionin dhe mashtrimin tatimor. Konkretisht gjatë vitit 2020, një numër i madh tatimpaguesish reduktuan xhiron e deklaruar për të përfituar nga lehtësi tatimore, bazuar në ndryshimet ligjore VKM nr. 576 datë 22.07.2020 dhe me ligj nr. 106 datë 29.07.2020 lidhur me ndryshimin e pragjeve të qarkullimit për tu përfshirë në përgjegjësinë tatimore 10 milion lekë dhe për Tatim Fitimi 14 milion lekë;

Gjithashtu, pavarësisht ekzistencës së modulit të riskut, nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe përpunimit të dhënave bëhen manualisht, nëpërmjet programit Excel që kërkon kohë dhe punonjës të shumtë në numër. Kështu psh. vetëm një listë pagesë mujore e punonjësve të regjistruar në listëpagesat e administratës tatimore ka rreth 700 mijë pozicione pune.

- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, në procesin e identifikimit dhe vlerësimit risqeve bazohet edhe në gjetjet e përgjithshme të raporteve të kontrollit të kryera nga DRT-të. Konstatohet se këto raporte kontrolli për vetë mënyrën si hartohen nga drejtoritë e kontrollit në DRT, e bëjnë të pamundur unifikimin e vlerësimeve të rrjedhura nga shkeljet ligjore të evidentuara rast pas rasti, kjo për faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është në proces pune për një standardizim dhe unifikim të tyre. Gjithashtu DRT nga ana e tyre nuk përgatisin raporte përmbledhëse për çka konstatohet dhe të raportojnë në mënyrë periodike kush janë problematikat më të shpeshta të hasura dhe mendime për përmirësimin e kritereve të risqeve në bashkëpunim me DMR.

-Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, DPT nëpërmjet DMR ka firmosur memorandumit e bashkëpunimit me OSHEE (Operatori i Shpërndarjesh së Energjisë Elektrike), Bashkinë e Tiranës dhe është në proces firmosje me Shoqatën e Eksperteve Kontabël (IEKA) dhe UKT (Ujësjellës Kanalizime Tiranë). Do të ishte mirë që kjo iniciativë të shtrihej në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të këtij informacioni do të mundësohej përfshirja e të gjithë tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave për të gjithë vendin me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve.

Kriteri: Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,
Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
Rregullore dhe Manuale për funksionimin e drejtorisë;
Manuali i Menaxhimit të Riskut;
Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore

Impakti: Është shumë e rëndësishme marrja e masave efikase nëpërmjet përcaktimit të detyrave të strukturave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre, arritjen e objektivave, përmirësimet ligjore në përmirësimin e sistemit të riskut, në përputhje me prioritetet e DPT në mbrojtje të interesave të tatimpaguesit.

Shkaku: Mungesë e bashkëveprimit midis drejtorive me qëllim përsosjen e sistemit të rriskut dhe hedhjes së të dhënave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim **-** Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar modulin e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore për të zbuluar evazionin dhe mashtrimin tatimor.

- Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për standardizimin e raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundësuar unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara. Në çdo rast të përgatiten raporte përgjithësuese në mënyrë periodike me problematikat më të shpeshta të hasura dhe me mendime për përmirësimin e kritereve të risqeve.

- Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, të punojë që kjo iniciativë të shtrihej në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të informacionit do të mundësohej përfshirja e të gjithë tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve.

-Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

<u>Drejtorisë së Kontrollit Tatimor</u>

Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit.
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT dhe DRT

Baza Ligjore

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,
- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Rregullore dhe Manuale për funksionimin e drejtorisë;
- Manuali i Kontrollit Tatimor;
- Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore
- Akte të tjera ligjore e nënligjore.

Nga auditimi dhe dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se:

Å Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT *ka funksion* kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në të gjitha DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

Å *Objektivi kryesor* i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale.

Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për vitin 2020 është miratuar me Urdhrin nr. 79 datë 27.03.2020, nr. 1181/6 Prot datë 27.03.2020.

Drejtoria e Kontrollit tatimor përbëhet si më poshtë:

1. *Drejtori i Drejtorisë*
2. *Sektori i Kontrollit Tatimor (1+5)*
3. *Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit (1+5)*
4. *Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave (1+2)*

Para miratimit të kësaj strukture, Drejtoria e Kontrollit Tatimor ka patur në përbërje dy sektorë,

- Sektorin e Kontrollit Tatimor (1+10)
- Sektorin e Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave (1+2)..
- Ndërsa me strukturën e re shtohet edhe Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit (1+5) i cili ndërmjet të tjerave ka patur si qëllim projektin e Fiskalizimit për monitorim dhe udhëheqje metodologjike si sektor i dedikuar (pjesë e kontrollit nga zyra), por sa konstatohet ky sektor nuk ka qenë plotësisht në eficensë sepse sa është cilësuar edhe më poshtë nuk është punuar shumë në monitorim nga zyra si dhe projekti i fiskalizimit nuk është implementuar plotësisht dhe nuk është shtrirë në të gjitha subjektet për monitorimin e atyre që nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë detyrimet e tyre në përputhje me ligjin për faktin se fiskalizimi hyn në fuqi më 1 korrik 2021 ose rreth dy vjet nga krijimi i këtij sektori.

Në lidhje me akt konstatimin nr. 2 është paraqitur observacioni me nr 8715/17 datë 18,08,2021 nga DPT e prot në KLSH me nr. 513/4, datë 20,08,2021 i cili ka të bëjë me saktësimin e përgjegjësisë nga Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave te Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit, saktësime të cilat qëndrojnë dhe janë reflektuar në materiali shtjellues për Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe gjetjet në vijimësi.

Organika e Drejtorisë së kontrollit për vitin 2020 dhe 2021

Viti 2020

	Pozicioni	**Kategoria**	**Numër**	**Emër**	**Mbiemër**
1	Drejtor	III-a		I.	A.
	Sektori i Kontrollit Tatimor		**11**		
1	Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	pa plotësuar	
2	Inspektor i Parë	III-b	1	A.	G.
3	Inspektor i Parë	III-b	1	N.	M.
4	Inspektor i Parë	III-b	1	A.	C.
5	Inspektor i Parë	III-b	1	P.	S.
6	Inspektor i Parë	III-b	1	A.	Ll.
7	Inspektor i Parë	III-b	1	pa plotësuar	
8	Inspektor i Dytë	IV- a	1	J.	Sh.
9	Inspektor i Dytë	IV- a	1	pa plotësuar	
10	Inspektor i Dytë	IV- a	1	pa plotësuar	
11	Inspektor i Dytë	IV- a	1	pa plotësuar	
	Sektori i Cilësisë Standardizi Proced		**3**		
1	Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	B.	B.
2	Inspektor i Parë	III-b	1	L.	Gj.
3	Inspektor i Parë	III-b	1	V.	Dh.

Viti 2021

Pozicioni	Kategoria-pagës	numër	Emër	Mbiemër	Nr. Vendim Emërimi	Datë Vendim Emërimi
Drejtor Drejtorie	III-a	1	B.	H.	3508/1	08-Mar-21
Sektori i Kontroll Tatimor		**6**				
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	O.	C.	25438/1	31-Dec-20
Inspektor i Parë	III-b	1	M.	A.	19526/1	13-Oct-20
Inspektor i Parë	III-b	1	N.	M.	1177	21-Nov-16
Inspektor i Parë	III-b	1	A.	Ll.	22643/1	04-Dec-20
Inspektor i Dyte	IV-a	1	K.	D.	24915/3	14-Jan-21
Inspektor i Dyte	IV-a	1	N.	K.	547/1	26-Jan-21
Sektori i ProcKonMonito		**6**				
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	Vakant			
Inspektor i Parë	III-b	1	P.	S.	13644/1	20-Jul-20
Inspektor i Parë	III-b	1	A.	G.	13640/1	20-Jul-20
Inspektor i Parë	III-b	1	A.	Ç.	13645/1	20-Jul-20
Inspektor i Dyte	IV-a	1	J.	Sh.	13639/1	20-Jul-20
Inspektor i Dyte	IV-a	1	Vakant			
Sektori i Cilës StantProc		**3**				
Përgjegjës Sektori	III-a/1	1	B.	B.	218	13-Feb-17
Inspektor i Parë	III-b	1	L.	Gj.	1019	21-Nov-16
Inspektor i Parë	III-b	1	V.	Dh.	1018	21-Nov-16

Për sa më sipër konstatohet se për vitin 2020 Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk është plotësuar më numër punonjësish e kryesisht Sektori i Kontrollit Tatimor ka mangësi në 50 % çka pengon në realizimin e objektivave të saj. Gjithashtu dhe riorganizimi i saj ka konsistuar në ndarjen e kësaj drejtorie në sektorë d.m.th. shtimin e sektorëve duke mbajtur të njëjtin numër punonjësish.

Në objektivat e Drejtorisë për vitin 2020 bazuar në Strategjinë e miratuar të Administratës Tatimore 2017-2021 konstatohet se, planet operacionale të drejtorive në DPT janë të hartuara në bazë të objektivave strategjik të saj e konkretisht:

Objektivi 1:Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.

Nën objektivi 1.2: Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

Objektivi 2: Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor.

Nën objektivi 2.1: Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut

Nën objektivi 2.2: Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore

Objektivi 3:Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Nën objektivi 3.2: Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

Disa nga aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2020, në përputhje me objektivat janë:

1. *Përgatitja në mënyrë të vazhdueshme e një seri pyetje dhe përgjigje për publikim në faqen e internetit;*

Realizimi:

- Janë informuar në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare mbi ndryshimet ligjore për shkak të Covid-19
- Njoftime që lidhen me çështje kontrolli si dorëzimi i pasqyrave financiare, vendime ortakesh, dorëzim inventari etj.

a. 06.01.2020 Kujtesë tatimpaguesve për dorëzimin e librave të shitje/blerjes.
b. 17.02.2020 Administrata Tatimore Shqiptare dhe ajo e Maqedonisë së Veriut thellojnë bashkëpunimin ndër institucional;
c. 28.02.2020 Për deklarimin e te ardhurave nga shitja në furnizimin e ndërtesave;
d. 07.03.2020 Njoftim mbi dorëzimin e pasqyrave financiare për vitin fiskal 2019;
e. 07.04.2020 Kujtesë për tatimpaguesit - Afatet e deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore nuk kanë ndryshuar;
f. 08.05.2020 Deklarimi i listë pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Prill 2020;
g. 09.07.2020 Fillon zbatimi i Planit të masave për sezonin turistik 2020;
h. 04.07.2020 Njoftim mbi dorëzimin e pasqyrave financiare për vitin fiskal 2019;
i. 19.08.2020 ku duhet të paraqiten tatimpaguesit për problematikat e lidhura me çështjet e detyrimeve tatimore të papaguara;
j. 05.01.2021 Njoftim për dorëzimin e inventarit analitik të datës 31.12.2020.

2. *Opsionet për zvogëlimin e hendekut të përmbushjes në TVSH sipas rekomandimeve të FMN-së.*
Realizimi:

- Në zbatim të rekomandimit si dhe të projektit të fiskalizimit në bashkëpunim me grupin e punës është mundësuar hartimi i metodologjisë së kontrollit në kuadër të Projektit të Fiskalizimit. Manuali do të shërbejë kryesisht Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për të gjitha hapat dhe procedurat që duhen ndjekur nga monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i tatimpaguesve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. *Bashkëpunimi me drejtori dhe struktura të tjera siç është Drejtoria e Menaxhimit të Riskut për sektorët të identifikuar me risk, hartimi dhe zbatimi i një vargu projektesh me fokus te përmirësimi i përmbushjes, duke përdorur teknika moderne të MRP-së.*
Realizimi:
Analizë e nën sektorëve të ndryshëm dhe hartimi i planeve operacional ku baza është ndërgjegjësimi i tatimpaguesve nëpërmjet letrave dhe informimit të tyre. Në bazë të analizave të modulit të riskut u hartua ''Plani Operacional Korrik – Dhjetor 2020'' nr. 1244, datë 03.07.2020 miratuar me vendim komiteti nr.18 Prot, datë 03.07.2020.
Ky plan ka patur si *qëllim* ndërgjegjësimi dhe nxitja e rritjes së deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore si dhe parandalimi, evidentimi dhe goditja e paligjshmërisë në fushën e tatim-taksave për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në zonat turistike, ose bizneset sezonale në të gjithë qarqet e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonit turistik veror 2020 si dhe verifikime dhe kontrolle në bizneset që paraqesin risk të lartë dhe kapacitet potencialisht të lartë për të kontribuar në rritjen e të ardhurave tatimore.
<u>*Objektivat* e këtij plani kanë qenë:</u>
a. Garantimi i përmbushjes vullnetare dhe zbatimi i legjislacionit tatimor.
b. Rritja e xhiros së deklaruar; deklarimit të punësimit dhe të regjistrimit të subjekteve tregtare;
c. Rritja e të ardhurave tatimore nga sektori i turizmit
d. Rritja e Tatim Fitimit të deklaruar për tatimpaguesit që deklarojnë zero në mënyrë fiktive dhe ata që nuk deklarojnë
e. Rritja e mbledhjes/pagimit të TVSH kryesisht për tatimpaguesit me gjendje të lartë kreditore
f. Rritja e deklarimeve për primet e sigurimit për shoqëritë e sigurimit,
g. Rritja e ndërgjegjësimit për deklarimin e punonjësve.
Drejtimet Kryesore të Planit Operacional kanë qenë:
I. Plani Sektorial i Turizmit,
II. Analiza dhe verifikimi për TVSh-së,

III. Kontrolli nga zyra,
IV. Verifikimi i pasqyrave financiare,
V. Sigurimet shoqërore dhe Shëndetësore,
VI. Shitja dhe blerja tek tatimpaguesit me status të ndryshëm nga aktivi,
VII. Verifikimi i primit të sigurimit për shoqëritë e sigurimit.

Strukturat pjesëmarrëse për realizimin e këtij plani janë:

- Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Rajone;
- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Drejtoria e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Drejtoritë Rajonale Tatimore (Drejtoritë e Kontrollit Tatimor);
- Drejtoritë Rajonale Tatimore (Drejtoritë e Shërbimit Tatimpagues);

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në këtë plan ka këto detyra:

Në përmbushje të qëllimit të planit operacional për sezonin veror 2020 Drejtoria e Kontrollit Tatimor do të menaxhojë dhe koordinojë punën me Drejtoritë e Kontrollit në Drejtoritë Rajonale në mënyrë që të zbatohen dhe arrihen objektivat kryesorë të vendosur.

Pas evidentimit të tatimpaguesve nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut sipas kritereve dhe analizave të riskut më lart, fushat kryesore ku do të ndërmerren veprime konkrete nga inspektorët e kontrollit janë:

(I) Monitorimi i deklarimeve me kasë

Bazuar në rezultatet e planeve të veprimit nga vitet e kaluara për shkak të volumit të madh të transaksioneve subjektet në sektorin e turizmit përgjatë sezonit turistik kanë tendencë që të kryejnë më shumë aktivitet pa deklaruar më kasë apo dhënë kupon tatimor.

Për këtë arsye për të luftuar këto shkelje dhe rritur ndërgjegjësimin e përdorimit të kasës fiskale dhe kuponit tatimor nga Drejtoritë e Kontrollit Tatimor do të ketë:

a) Krahas monitorimit nga grupet e monitorimit për pajisje fiskale dhe kuponë të prerë edhe kontrolle fiskale në formën e vizitave fiskale.
b) Vizita të fiskale do të planifikohen për një numër subjektesh që do të përcaktohet nga informacioni që do të përcillet nga grupet e monitorimit si dhe nga kriteret e rikut të DMR.
c) Grupi i punës pranë DPT të monitorojë dhe koordinojë punën.

(II) Deklarimet me shkallë tatimore 6% të TVSH

Për sektorin e turizmit aplikimi i shkallës së TVSH në 6% për strukturat akomoduese krahas faktit që është një lehtësirë fiskale, mbetët në fokus të administratës tatimore aplikimi i saktë dhe shmangia e abuzimeve sidomos në rastet e subjekteve që kanë aktivitet jo vetëm të strukturave akomoduese.

Me qëllim shmangien e këtyre abuzimeve gjatë sezonit veror kur edhe volumi i aktiviteti është më i lartë do të behët:

a. Nga tatimpagues që deklarojnë me 6% TVSH, por që nga verifikimi i informacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk kanë aplikuar për pajisjen me certifikatë si strukturë akomoduese do kryhen rivlerësime të shitjeve të kryera me 6%.
b. Gjatë vizitave fiskale bazuar në programin e kontrollit do të bëhet verifikimi i raportit të TVSh në shitje/TVSh në blerje, gjendjes se inventarit dhe vlerësimit nëse blerjet janë me dokumentacion të rregullt tatimor.

(III) Verifikimi i shpenzimeve

Pjesë e planit operacional, për sektorin e turizmit do jetë gjithashtu kontrolli dhe verifikimi i shpenzimeve për këtë sektor:

a. Verifikimi i shpenzimeve për paga, qira, energji elektrike , tatim në burim në krahasim me shpenzimet e deklaruara në deklarate tatimore për vitin 2019,dhe 2018, si dhe me deklarimit e muajve gjatë 2020

b. Verifikim i të ardhurave të deklaruara për periudhën 4 mujore qershor-shtator 2018-2019 dhe shpenzimeve për qira, energji elektrike, paga, tatim ne burim.
c. Vlerësimi i diferencave ndërmjet shpenzimeve të deklaruara në deklaratën e TF ose TFTH dhe shpenzimeve për paga tatim ne burim etj.

(IV) Verifikimi i punonjësve të deklaruar

Në sektorin e turizmit punësimi është kryesisht sezonal dhe me një qarkullim të lartë vjetor. Lidhur me kontrollin e situatës për deklarimin e punonjësve do të kryhen:

a. Verifikime të raportit: i numrit të punonjësve në krahasim me qarkullimin e realizuar për periudhën 4-mujore qershor-shtator (2018&2019), dhe krahasimi me muajt paraardhës gjatë 2020
b. Verifikimi me vizita fiskale i punonjësve të padeklaruar.
c. Verifikimi i tatimpaguesve deklarimin me statusin praktikat.
d. Verifikimi i nivelit të pagave për të konstatuar nëse deklarimet kryhen për pagat reale.

Realizimi i planit

Nga të dhëna e grumbulluara në zbatim të planit operacional të DPT periudha korrik dhjetor 2020 lidhur me kontrollet nga zyra dhe vizitat fiskale konstatohet se:

- Lidhur me *kontrollet nga zyra* të planifikuara nga DPT-ja në kuadër të Planit Operacional Korrik-Dhjetor 2020, kemi këto rezultate në nivel të përgjithshëm:

DRT	Target/ Planifikuar	Përfunduar				Nr. i kontrolleve në proces
		Nr. TP	Vlera e gjetjeve 000 lekë	% e realizimit	Nr. i Kontrolleve pa gjetje	
Berat	192	192	1,953	100%	182	
Dibër	48	48	2,400	100%	38	
DTM	63	63	109,043	100%	50	
Durrës	309	309	72,297	100%	183	
Elbasan	152	152	21,690	100%	110	
Fier	191	191	48,682	100%	94	
Gjirokastër	126	126	23,803	100%	84	
Korçë	88	88	4,301	100%	75	
Kukës	22	22	230	100%	15	
Lezhë	56	56	16,621	100%	33	
Sarandë	31	31	-	100%	31	
Shkodër	125	125	39,660	100%	29	
Tiranë	468	413	105,857	88%	319	55
Vlorë	182	182	2,819	100%	175	
TOTAL	2,053	1,998	449,356	97%	1,418	55

Siç vërehet, rezulton se targeti i përgjithshëm i Kontrolleve nga Zyra është arritur në nivelin 97%. Të gjitha DRT-të i kanë mbyllur Kontrollet nga Zyra të planifikuara në kuadër të Planit Operacional, me përjashtim të DRT Tiranë e cila ka ende Kontrolle nga Zyra në proces.

Gjithashtu të ndara sipas problematikave (arsyeve të daljes për kontroll), kontrollet nga zyra të përfunduara paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Problematika	Nr. i TP	Pesha ndaj Totalit (%)	Gjetjet (000 lekë)	Pesha ndaj Totalit (%)	Gjetjet Mesatare (000 lekë)
Rritje e Qarkullimit, rënie e TVSH-së	14	0.70%	-	0.00%	-
Kontribuuesit më të mëdhenj (70%) të ardhurave	8	0.40%	50	0.01%	6
Gjendje e larte kreditore mbi 1 milion	829	41.49%	162,037	36.06%	195
Monitorim < 14 mln lek	148	7.41%	2,253	0.50%	15
TP me deklaratë 0 TF 19A	403	20.17%	191,156	42.54%	474
Vlerësim Automatik	465	23.27%	90,425	20.12%	194
Verifikimi i sigurimeve	130	6.51%	2,196	0.49%	17
TP e skemës së mashtrimit	1	0.05%	1,222	0.27%	1,222
TOTAL	1,998	100%	449,339	100%	225

Sipas tabelës peshën më të madhe të kontrolleve nga zyra të përfunduara, si në nivel tatimpaguesish ashtu edhe në nivel gjetjesh, e zënë tatimpaguesit me problematikë ñ*Gjendje e lartë kreditore mbi 1 mln lekë*ò, ñ*Deklaratë TF 19A me 0*ò dhe ñ*Vlerësim Automatik*ò.
Nga analiza e secilin prej këtyre zërave sipas tabelës më sipër konstatohet se:

- *Gjendje e lartë kreditore mbi 1 mln lekë* 86 % e vlerës totale të gjetjeve (ose 139,351,000 lekë nga 162,037,000 lekë), për tatimpaguesit me problematikë ñ*Gjendje e lartë kreditore mbi 1 mln lekë*ò, ka ardhur si pasojë e uljes së gjendjes kreditore pas kontrollit. Pjesa tjetër janë detyrim TVSH-je dhe gjobë,
- *Deklaratë TF 19A me 0,* 93% e vlerës totale të gjetjeve (ose 177,041,000 lekë nga 191,156,000 lekë), për tatimpaguesit me problematikë ñ*Deklaratë TF 19A me 0*ò, ka ardhur si pasojë e ndryshimit të deklaratës TF 19A nga tatimpaguesi dhe rritjes së vetë deklarimit, pas njoftimit të bërë nga inspektori. Pjesa tjetër e gjetjeve ka ardhur si pasojë e vlerësimit të deklaratës TF 19A nga inspektori,
- *Vlerësim Automatik,* 73% e vlerës totale të gjetjeve (ose 65,600,000 lekë nga 90,425,000 lekë), për tatimpaguesit me problematikë ñ*Vlerësim Automatik*ò, ka ardhur si pasojë e dorëzimit të deklaratës TF 19A nga tatimpaguesi dhe rritjes së vetë deklarimit, pas njoftimit të bërë nga inspektori. Pjesa tjetër e gjetjeve ka ardhur si pasojë e vlerësimit të deklaratës TF 19A nga inspektori,
- *Verifikimi i sigurimeve-listë pagese me 1 lek,* 81% e vlerës totale të gjetjeve (ose 1,778,760 lekë nga 2,196,000 lekë) për tatimpaguesit me problematikë ñ*Verifikimi i sigurimeve-listë pagesë me 1 lek*ò, ka ardhur si pasojë e ndryshimit të listë pagesave nga tatimpaguesi dhe rritjes së vetë deklarimit, pas njoftimeve të bëra nga inspektorët. Pjesa tjetër e gjetjeve ka ardhur si pasojë e vlerësimit të listë pagesave nga inspektorët.

- Lidhur me *Vizitat Fiskale* të planifikuara nga DPT-ja në kuadër të Planit Operacional Korrik-Dhjetor 2020, kemi këto rezultate në nivel të përgjithshëm:

DRT	Target/ Planifikuar	Përfunduar				Nr. i kontrolleve në proces
		Nr. TP	Vlera gjetjeve 000 lekë	% e realizimit	Nr. i Kontrolleve pa gjetje	
Berat	16	16	1,620	100%	-	-
Dibër	12	12	303	100%	5	-
DTM	37	37	2,394	100%	26	-
Durrës	132	132	10,324	100%	89	-
Elbasan	7	7	36	100%	5	-
Fier	69	69	5,182	100%	15	-
Gjirokastër	9	9	143	100%	4	-
Korçë	20	20	1,236	100%	7	-
Kukës	1	1	67	100%	-	-
Lezhë	18	18	12,879	100%	5	-
Sarandë	2	2	-	100%	2	-
Shkodër	25	25	1,548	100%	3	-
Tiranë	69	22	2,848	32%	6	47
Vlorë	14	14	5,898	100%	9	-
TOTAL	431	384	44,477	89%	176	47

Siç vërehet rezulton se targeti i përgjithshëm i Vizita Fiskale është arritur në nivelin 89%. Të gjitha DRT-të i kanë mbyllur Vizitat Fiskale të planifikuara në kuadër të Planit Operacional, me përjashtim të DRT Tiranë e cila ka ende Vizita Fiskale në proces.
Gjithashtu të ndara sipas problematikave (arsyeve të daljes për kontroll), Vizitat Fiskale të përfunduara paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Problematika	Nr. i TP	Pesha ndaj Totalit (%)	Gjetjet (000 lekë)	Pesha ndaj Totalit (%)	Gjetjet Mesatare (000 lekë)
Rritje e Qarkullimit, rënie e TVSH-së	50	13.02%	12,955	29.13%	259
Nënkontraktor ndërtimi	101	26.30%	13,610	30.60%	135
Klientë tek TP e sektorit të tregtisë	44	11.46%	4,725	10.62%	107
Gjendje e larte kreditore mbi 1 milion	163	42.45%	8,213	18.47%	50

TP e skemës së mashtrimit	**26**	**6.77%**	**4,974**	**11.18%**	**191**
TOTAL	**384**	**100%**	**44,477**	**100%**	**116**

Në zbatim të këtij plani operacional nga Drejtoria e Kontrollit është konstatuar :

1- *Ndikimi i Planit Operacional, në drejtim të ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për përmbushjen e detyrimeve, si dhe në drejtim të realizimit të ardhurave të mbledhura (realizimi i planeve mujore të DRT-së).*

Plani operacional në tërësi ka ndikuar pozitivisht në ndërgjegjësimin dhe nxitjen e rritjes së deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore si dhe parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë në fushën e tatim-taksave. Njëkohësisht ky plan ka ndikuar pozitivisht dhe në realizimin e planeve mujore në mbledhjen e të ardhurave. Si rezultat i kontrolleve të kryera në zbatim të Planit Operacional subjektet kanë reflektuar në ulje të gjendjes kreditore të TVSh-së. Subjektet kanë rritur qarkullimin, deklaruar në afat deklaratëne TVSh-së, si dhe paguar detyrimet.

Ndikimi i Planit Operacional, ka qenë i ndjeshëm kryesisht tek subjektet me tepricë të lartë kreditore TVSh-je, nga kontrolli dhe monitorimi nga zyra, është vërejtur se teprica kreditore është ulur ndjeshëm në përfundim të Planit Operacional. Gjithashtu ka pasur ndikim të rëndësishëm dhe në deklaruesit me 0 dhe 1 lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe përveç vetëkorrigjimeve, ka pasur rivlerësime për një numër të konsiderueshëm tatimpaguesish;

2- *Vështirësitë, organizative dhe teknike, që hasur gjatë realizimit të këtij plani.*

Vështirësia kryesore ishte mënyra direkt e komunikimit me Tatimpaguesin gjë e cila nuk mund të realizoj si pasojë e kushteve të pandemisë *Covid-19*, gjithashtu numri i ulët i inspektorëve në raport me numrin e subjekteve të planifikuar për tû kontrolluar si pasojë e masave anticovid por dhe të kalimit të pandemisë tek vetë punonjësit. Inspektorët e kontrollit kanë qenë të mbingarkuar me verifikime në vend, vizita fiskale, ndjekje subjektesh për arkëtimet mujore për realizimin e të ardhurave të TVSh-së, kontrolle të plota si dhe rimbursime si dhe angazhimi i tyre tek *"pagat e luftës"*.

3- *Problematikat të tjera.*

Gjatë realizmit të detyrave të Planit Operacional ka patur raste të përsëritura me tatimpagues të cilët nuk reflektonin dhe pas komunikimeve të vazhdueshme u ndërgjegjësuan dhe reaguan pozitivisht reflektuar kjo në ndryshimet e deklarimeve të tyre. Në listat e dërguara nga DPT si për kontroll nga zyra dhe vizita fiskale, një numër i madh tatimpaguesish që janë përzgjedhur për kontroll nga zyra si rezultat i tepricës së lartë kreditore kanë qenë me status pasiv, ndërsa nga tatimpaguesit aktiv disa prej tyre e kanë tepricën kreditore të akumuluar deri në nëntor 2014 dhe kjo tepricë nuk i mbartet në vazhdim, ndërsa një pjesë janë fasonë të cilët marrin rimbushim. Një problematike tjetër është se nuk është dhënë teprica kreditore e këtyre subjekteve në momentin e zgjedhjes për kontroll, me qëllim që të bëhet një vlerësim në lidhje me gjendjen e kësaj teprice në momentin e kontrollit. Shumë tatimpagues në listat e dërguara nuk kanë përgjegjësi tatimore që nga Viti 2001.

Janë përzgjedhur nga DPT tatimpagues me xhiro kase më të madhe se deklarata e TF ose TTHF 2019. Një numër i konsiderueshëm prej këtyre tatimpaguesve janë me status BV. Vlerësimi i kësaj deklarate nuk ka efekt fiskal.

4- *Për sa më sipër nisur nga praktika e punës për realizimin e këtij plani, me synim përmirësimin e punës për Planin Operacional që do të hartohet gjatë vitit në vazhdim, janë dhënë disa komente propozime dhe mendime edhe të DRT-ve si:*

- të rritet numri i vizitave fiskale dhe të shikohen me prioritet subjektet me aktivitete brenda vendit.(të përjashtohen importuesit 100%),
- në hartimin e planeve të mëvonshëm të përfshihen dhe përfaqësues nga DRT-të, kjo nisur nga problematika e ndryshme që mund të jenë evidentuar në terren nga këto DRT,

- konsultimi i listave të ndryshme nga Risku-DPT me DRT, për të nxjerre ata tatimpagues që kanë shmangie më të madhe në zbatimin e legjislacionit tatimor,
- listat e planifikuara nga DPT para se të kalojnë në fazën përfundimtare për tu planifikuar për kontroll të rakordohen dhe konsultohen me qëllimin që subjektet për të cilët mendohet se nuk është i domosdoshëm kontrolli të përjashtohen.
- DRT të propozoj subjekte të cilat mendon se duhet të përfshihen në këtë listë, të caktohet një përqindje nga plani total ku DRT-të kenë pjesën e tyre për propozimet për kontrolle,
- te planifikohet monitorimi dhe evidentimi i subjekteve të cilët ushtrojnë aktivitet në fushën e turizmit duke krijuar regjistër të veçantë vetëm për këtë kategori, gjë e cila mendohet së është shume produktive nëse është e përfunduar deri në muajin Qershor,
- kryerja e analizave paraprake, bashkëpunimi midis Drejtorisë se Riskut ne DPT dhe ne DRT-te, si dhe Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT, apo dhe në DRT-të për të identifikuar tatimpagues potenciale për kryerjen e vizitave fiskale DKT ne DPT,
- të shtohen indikatorët e riskut, me natyrë aktiviteti, informacioni të jetë i plotë, dhe të shtohet nr. vizitave fiskale, për të bërë të mundur verifikimin në vend të çdo problematike, pasi kontrollet nga zyra të përdoren vetëm në rastet e diferencave të krijuara nga deklaratat e TP me pajisjet fiskale etj.,
- të rritet e bashkëpunimi me struktura të tjera në varësi të DPT apo të përfshihen dhe funksione apo drejtori të tjera, si dhe angazhimi me inspektorate të ndryshme si AKU, Inspektoratin e Punës, etj.,
- të përzgjidhen për kontroll tatimpagues të ndarë sipas sektorëve të cilët kanë tregues fiskale nën nivelin e degës ku operojnë,
- të përzgjidhen subjekte të cilët nga analiza e riskut rezultojnë me fatura të padeklaruara në blerje- shitje,
- tatimpaguesit me xhiro të ulët si dhe ato të kontrolluara deri në një vit më parë të mos parashikohen si tatimpagues me risk të lartë për kontroll për vizitë fiskale, kontrolli i plotë për këto subjekte do kishte me rezultate se vizita fiskale,
- numri i inspektoreve në DRT, sidomos të kontrollit nga zyra, krahasuar me numrin e lartë të tatimpaguesve ndaj të cilëve është ushtruar kontroll, është i vogël. Shtimi i numrit te inspektoreve është i nevojshëm. Në këtë mënyre çdo inspektor do ketë kohën e mjaftueshme të merret me situatën e çdo tatimpaguesi, të rrisin cilësinë e detyrave të kryera si dhe cilësinë e shërbimit ndaj tatimpaguesit.

4. *Përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të rreziqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor;*

Realizimi:

- Analizimi i të dhënave dhe raporteve të kontrollit në përputhje me legjislacionin.
- Analiza e të dhënave të raporteve të kontrollit tatimor dhe nxjerrje e rekomandimeve.

Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit ka ndjekur zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, si dhe mbi bazën e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji, ka analizuar e përpunuar vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale si dhe ka mbajtur evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR.

Të gjitha të dhëna e raportuara nga DRT-te, mbas analizimit dhe përpunimit i dërgohen Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, në DPT.

Çdo muaj hartohen evidencat mbi kontrollet e planifikuara dhe ato të kryera në fakt si për kontrollin në vend ashtu dhe për vizitat fiskale. Përveç numrit të kontrolleve janë dhe të gjitha evidencat mbi gjetjet dhe rivlerësimet e bëra sipas DRT-ve.

Sa është rezultati i zbulimeve për çdo DRT dhe në total DPT, sa kontrolle të plota dhe sa vizita fiskale në nr. dhe në vlerë.

Realizimi i numrit të kontrolleve, zbulimet mujore dhe progresive për çdo DRT –ë, si dhe sa kontrolle janë me zbulime dhe sa pa zbulime (analize) si dhe numri i kontrolleve të kryera me zbulime e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit kaluar për çdo DRT.

Zbulimet sipas llojit te tatimit

- *Zbulimet për TVSH e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për Tatim Fitimin e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për Sigurime Shoqërore e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për TAP e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për të Tjera krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Analizohet nëse ka tatimpagues që janë kontrolluar me indice nga Prokuroria si dhe nëse ka kontrolle me vlera të mëdha zbulimi dhe sa ndikon kjo vlerë në raport me zbulimet që kanë rezultuar në DRT-të dhe sa ne total si DPT.*
- *Analizohet sa kontrolle janë kryer sipas Moduleve 1, 2,3,*

Gjithashtu veç punës mujore, e bazuar në të dhënat e raportuara me evidencat mujore të DRT-ve për kontrollet e kryera dhe rezultatet e zbulimeve periudhën 2020, janë kryer dhe analizat e punës lidhur me performancat për periudhën,3, 6, 9 dhe 12 mujore ku janë trajtuar analiza të gjendjes dhe ecurisë së punës si dhe nxjerrjen e problematikave të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT-të .

- Hartimi Rregullores për Inspektorin e kontrollit tatimor të Drejtorisë të Kontrollit Tatimor, në DPT me nr.25441 prot, datë 31.12.2020. (si pjese e rekomandimeve te KLSH-se)
- Hartimi i Udhëzuesit nr. 1 për verifikimin e pasqyrave financiare nga DRT për vitin 2019.
- Është në proces hartimi dhe zbatimi i standardizimit të formateve të kontrollit tatimor sipas udhëzimeve të ekspertëve të FMN, për:
  - unifikim të procedurave teknike të kryerjes së kontrollit tatimor në tatimpaguesit,
  - Formatizimin dhe Standardizimin e Raport Kontrolleve të plota,
  - Rimbursimin,
  - Vizitat fiskale të kryera nga DRT,
  - pasqyrimi në sistemin *C@ts*içdo pike e programit,.

5. *Përmirësimi i cilësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare.*

Realizimi:

- Identifikimi i hartuesve të pasqyrave financiare, gjatë dorëzimit në sistemin *C@ts* të tyre, dhe ndryshimet e nevojshme. Zhvillime në sistem për të dhënat e administratorëve, hartuesve të pasqyrave me qëllim krijimin e një data basë me këto të dhëna.
- Hartimi i rregullores mbi analizën e pasqyrave financiare, elementet për rishikim dhe mënyra e kontrollit nga inspektoret (miratuar Udhëzues nr. 3 datë 31.08.2021 òPër zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare të vitit fiskal 2019.

6. *Hartimi i një qasjeje tërësore dhe të integruar në drejtim të mos deklarimit të punonjësve.*

Realizimi:

Hartimi i një mini plani sektorial mbi punësimin, i cili nisi që në fund të vitit 2019. Dërgimi i letrave të personalizuara të gjithë tatimpaguesve me rënie të pagave të muajit Qershor 2020 krahasuar më Dhjetor 2019. (marrë parasysh dhe periudhën e pandemisë e cila devijoi një sërë aktivitetesh normale të drejtorisë dhe të gjithë DPT)

7. *Rishikimi i Rregullores për përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontroll, mënyrën e kontrollit në DRT.*

Realizimi:

- Është hartuar rregullorja e kontrollit në DRT nga inspektorët e DKT Rregullore nr. 25441 datë 31.12.2020

8. *Zhvillimi i sistemeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë rishikimin vjetor dhe përditësimin në kohë të urdhërove ekzistues, udhëzimeve, procedurave, rregullave mbi funksionimin dhe rregullat e tjera të Administratës Tatimore, në lidhje me zbatimin, mbivendosjen dhe cilësinë e tyre;*
Realizimi:

- Përgjigje në kohë e shkresave në mënyrë të vazhdueshme dhe reflektimi në analiza të detajuara të drejtorisë së kontrollit.
- standardizimi i formateve të raporteve të kontrollit për tu përfshirë në sistemin C@ts dhe analizave përkatëse. Janë finalizuar draftet për raport kontrollet si kontroll në vend, vizita fiskale dhe kontrolle për rimbursim për tu përfshirë në sistemin C@TS, por për shkak të pandemisë përfshirja është shtyrë në objektivat e 2021

9. *Kontrolle në Drejtoritë Rajonale Tatimore nga Struktura e Kontrollit në DPT;*
Realizimi:
A.

- Për shkak të situatës COVID gjatë 2020, janë zhvilluar kontrolle dhe verifikime nga struktura e DK në DPT nëpër Drejtoritë Rajonale sipas autorizimeve më poshtë:

I. Autorizimi nr. 20409 Prot, datë 20.10.2020 "Për kryerje Monitorimi dhe Kontrollit" në DRT Durrës, Berat, Fier, Korçë, Gjirokastër, Lezhë, Tiranë dhe Vlorë. Qëllimi ishte monitorimi dhe kontrolli, në funksion të zbatimit të planit operacional për periudhën Korrik-Dhjetor 2020;*(kontrolli është realizuara nga inspektorët z. N. M. dhe z. J. Sh.)*

II. Autorizimi nr. 19297 Prot datë 06.10.2020 në DRT Berat dhe Gjirokastër.*(kontrolli është kryer nga inspektoret znj. V. Dh. dhe znj. L. Gj.)*

III.

I. <u>Për Autorizimin nr. 20409 Prot, datë 20.10.2020 konstatohet:</u>

- ❖ Sipas autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020 ku afati i kryerjes së kontrollit është nga data 20.10.2020 deri në datën 31.12.2020, konstatohet se më datën 31.10.2020 grupi i kontrollit të DPT-së është tërhequr nga kryerja e këtij program monitorimi dhe kontrolli me urdhrin verbal të eprorëve, gjë e cila është konfirmuar në njoftimin me e-mail të datë 16.11.2020 drejtuar z. A. Ç. zv/Drejtor i Përgjithshëm dhe i Komanduar Drejtor i Drejtorisë Kontrollit si edhe në raportin paraprak të kontrollit sqaruar më poshtë, gjithashtu me e-mail është njoftuar herë pas herë znj. O. U. në cilësinë e kryetarit të grupit që ndjek planin operacional korrik ï dhjetor 2020;
- ❖ Çështjet e monitoruara dhe kontrolluara janë:

1. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, në tatimpagues me rritje të qarkullimit dhe rënie të pagesës së TVSH;
2. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, të tatimpaguesve që janë kontribuuesit më të mëdhenj në realizimin e të ardhurave;
3. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, të tatimpaguesve në sektorin e tregtisë me gjendje të lartë kreditore;
4. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, të tatimpaguesve me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimit;
5. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, të tatimpaguesve me objekt aktiviteti në fushën e tregtisë.
6. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, të tatimpaguesve të skemës së mashtrimit;
7. Monitorimi i kontrolleve dhe vizitave fiskale të bëra nga DRT-ja, në lidhje me procedurat e kryerjes së kontrollit tatimor në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, Kreu X, "Kontrolli Tatimor".

8. Në përfundim të kontrollit, të hartohen Akt Konstatimet për shkeljet e konstatuara dhe të hartohen Raport Kontrolli dhe Raporti Përfundimtar i kontrollit me detyra për ndjekje dhe zbatim.

❖ Për periudhën 11 ditore nga grupi i kontrollit të DPT-së janë kontaktuar 5 DRT dhe konkretisht:

- DRT Durrës;
- DRT Fier;
- DRT Gjirokastër;
- DRT Korçë;
- DRT Vlorë.
- nuk është realizuar kontaktimi e për pasojë kontrolli në DRT Lezhë, Tiranë, Berat.

❖ Sipas planit korrik - dhjetor operacional 2020, me autorizimin nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli me nr. 20409/1, datë 20.10.2020 në bazë të kontrolleve të kryera janë dorëzuar projektraportet e kontrollit si më poshtë:

- Projekt Raporti DRT Fier nr. 20409/6, datë 03.02.2021
- Projekt Raporti DRT Vlorë nr. 20409/4, datë 03.02.2021
- Projekt Raporti DRT Durrës nr. 20409/5, datë 03.02.2021
- Projekt Raporti DRT Gjirokastër nr. 20409/3, datë 03.02.2021
- Projekt Raporti DRT Korçë nr. 20409/7, datë 03.02.2021

Për projektraportet paraprake të hartuara nga grupi dhe të nisura sipas shkresave të mësipërme i është nisur i është dërguar informacion me e-mail z. O. C. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në vend në datën 29.01.2021 e konkretisht:

Nga inspektorët e kontrollit në DKT në DPT, të cilët kanë qenë pjesë e grupit të punës që ka ndjekur Planin Operacional Korrik-Dhjetor 2020, në zbatim Autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me Nr. 20409, datë 20.10.2020, si dhe programit të kontrollit bashkëlidhur me nr. 20409/1, datë 20.10.2020, është ushtruar kontroll në DRT Durrës, Korçë, Fier, Gjirokastër dhe Vlorë.

Sipas Autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 20409, datë 20.10.2020, dhe programit të kontrollit bashkëlidhur nr. 20409/1, datë 20.10.2020, afati i kryerjes së kontrollit është prej datës 20.10.2020 deri në datën 31.12.2020, por me datën 31.10.2020 grupi i kontrollit është tërhequr nga kryerja e këtij program Monitorimi dhe Kontrolli me urdhrin e eproreve. Në përfundim të monitorimit dhe kontrollit në datën 20.11.2020, janë hartuar Akt Konstatimet përkatëse me personat përgjegjës.

Në vijim, ju informojmë se nga inspektorët e grupit të kontrollit sipas autorizimit të mësipërm, në datën 27.11.2020 është hartuar Projekt Raport Kontrolli i cili në mungesë të Përgjegjësit të Sektorit dhe Drejtorit të Kontrollit ju është dorëzuar me shkresën përcjellëse të datës 01.12.2020 bashkëlidhur Projekt Raportit, sipas formatit zyrtar eprorëve më lartë.

Në zbatim të procedurave të manualit të kontrollit KAPITULLI IX :

ñ 9.2 Procedurat e evadimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit

Në përfundim të kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit në DRT, sipas përcaktimit në Autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm, grupi i inspektorëve të kontrollit harton Raportin e Kontrollit mbi gjetjet dhe konstatimet e pasqyruar në akt-konstatimet dhe proces-verbalet e mbajtura në vend në procesin e kontrollit dhe ja përcjell Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit. Përgatit një informacion përmbledhës për Drejtorin e Kontrollit në DPT dhe për Drejtorin e Përgjithshëm, lidhur me përfundimin e kontrollit dhe rezultatet e tij.

Më poshtë është kopja nga Manuali

9.2 Procedurat e kalimit të Raportit të Kontrollit:

Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, ndjek në vazhdimësi procesin e realizimit të kontrollit në DRT sipas pikave të programit të kontrollit, kërkon informacion dhe ndërhyn për realizimin e pikave të programit dhe bën vërejtje për kryerjen e tyre në përputhje me planin e kontrollit

dhe problematikave të evidentuara nga Drejtoria e Kontrollit apo informacione te tjera nga sektorë të DPT. Grupi i inspektorëve të kontrollit Raportin e Kontrollit dhe informacionin mbi gjetjet dhe akt konstatimet apo procesverbalet ja kalon Përgjegjësit të Sektorit brenda 7 ditëve shqyrton Raportin e Kontrollit dhe nëse ka vërejtje dhe sugjerime i pasqyron ato me shkrim dhe ja dërgon grupit të inspektorëve të kontrollit, të cilët brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vërejtjeve dhe sugjerimeve, i shqyrtojnë dhe i përfshijnë në Raportin e Kontrollit dhe ja ridërgojnë Përgjegjësit të Sektorit.

Përgjegjësi i Sektorit pasi merr raportin e kontrollit në të cilin janë pasqyruar vërejtjet e tij, brenda dy ditëve ja kalon për shqyrtim dhe miratim Drejtorit të Kontrollit Tatimor.

Pas kësaj etape, Drejtori i Kontrollit Tatimor menaxhon Raport Kontrollin në një afat të justifikueshëm në përputhje me drejtimin institucional, por jo me vonë se një muaj.

Drejtoria Rajonale Tatimore, brenda 15 ditëve nga data e marrjes ose që vlerësohet se është marrë Raporti i Kontrollit, kthen përgjigje bashkë me observacionet në rast se ka. Në Raportin Përfundimtar të kontrollit do të pasqyrohet nëse observacionet janë marrë në konsideratë ose jo, si dhe shpjegimet përkatëse.

Pas tejkalimit të këtij afati, Raporti i Kontrollit konsiderohet i vlefshëm dhe kthehet në Raport Përfundimtar Kontrolli dhe i niset DRT-së përkatëse.

9.3 Evadimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Raporti i Kontrollit dhe raporti përfundimtari i kontrollit hartohen në tri kopje, nga të cilat një kopje i dërgohet DRT objekt kontrolli, një kopje arshivohet në DPT dhe një kopje mbahet në DKT në DPT.

Raporti përfundimtar i kontrollit, hartohet dhe i dërgohet brenda 15 ditëve punë DRT-së nga data që është marrë së bashku me Akt- Evadimin dhe detyrat për të ardhmen.

Në përfundim hartohet një informacion (Memo) për Drejtorin e Përgjithshëm mbi përfundimin e kontrollit, detyrat për të ardhmen dhe propozimet për masat organizative dhe disiplinore.ò

Për sa me lartë, nga ana e DRT-ve të monitoruara nuk ka ardhur asnjë përgjigje për sa i përket Projekt Raport Kontrollit dhe në bazë të manualit të kontrollit, citoj: ñ*Drejtoria Rajonale Tatimore, brenda 15 ditëve nga data e marrjes ose që vlerësohet se është marrë Raporti i Kontrollit, kthen përgjigje bashkë me observacionet në rast se ka. Në Raportin Përfundimtar të kontrollit do të pasqyrohet nëse observacionet janë marrë në konsideratë ose jo, si dhe shpjegimet përkatëse. Pas tejkalimit të këtij afati, Raporti i Kontrollit konsiderohet i vlefshëm dhe kthehet në Raport Përfundimtar Kontrolli dhe i niset DRT-së përkatëse*.ò.

Nisur nga sa më sipër, nga grupi i inspektoreve të kontrollit te DPT-se, është kërkuar miratimi i vazhdimit të procedurave të mëtejshme për Hartimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe shkresave përcjellëse së bashku me detyrat**.**

- Nga kontrolli dhe monitorimi i disa vizitave fiskale (numri është i kufizuar për shkak të kohës) kanë rezultuar problematika të cilat janë evidentuar në Projekt Raportet e Kontrollit dhe Raportet Përfundimtare të Kontrollit (Tematik) mbajtur në datën 02.06.2021 sipas DRT-ve, dhe dorëzuar në datën 03.06.2021 Drejtorit të Kontrollit në DPT, së bashku me shkresat përcjellëse dhe Memot për Drejtorin e Përgjithshëm te Tatimeve, kështu megjithëse për këtë autorizim koha ka qenë shumë e kufizuar është arritur në evidentimin e disa mangësive dhe vlerave përkatëse për të cilat nga ana e DRT duhet të merren masa në arkëtimin e tyre e konkretisht:

  <u>*Në DRT Korçë*</u> nga grupi i kontrollit te DPT-se është analizuardeklarimii shitjeve nga TP nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale dhe krahasimi i tyre me shitjet e deklaruara në situatën financiare në sistemin*C@ts* (analiza është bërë vetëm për TVSH-në)

  Analiza është kryer për vitin ushtrimor 2019 dhe periudhën Janar-Shtator 2020, nga ku rezultuan diferenca në deklarim dhe konkretisht:

- *Për vitin ushtrimor 2019* deri në momentin e kontrollit dhe të dhënave të përpunuara janë 115 tatimpagues të cilët kanë deklaruar TVSH në shitje nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale me shumë se në FDP mujore, me efekt financiar prej 6,862,000 lekë numër dhe vlerë që mund të rritet. Më poshtë tabela me analizat përkatëse për vitin 2019:

Viti 2019

	Nr. Raste	Detyrim	Ulje kredie	**Total**
Kryer vlerësimi	15	2,142,848	0	**2,142,848**
Filluar vlerësimi	9	58,451	0	**58,451**
Do i behet vlerësim	52	1,640,121	10,880	**1,651,001**
Ndryshuar deklarata nga subjekti	10	942,388	210,094	**1,152,482**
Pritet informacion nga subjekti para se fillohet vlerësimi	23	822,068	0	**822,068**
Raste mjekësie (të diskutueshme)	6	1,035,150	0	**1,035,150**
Efekti total	115	6,753,509	220,974	**6,862,000**

- *Për periudhën janar – shtator 2020* deri në momentin e kontrollit dhe të dhënave të përpunuara janë 188 tatimpagues të cilët kanë deklaruar TVSH në shitje nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale me shumë se në FDP mujore, me efekt financiar prej 17,831,728 lekë numër dhe vlerë që mund të rritet. Më poshtë tabela me analizat përkatëse për vitin 2020: Viti 2020

	Nr. Raste	Detyrim	Ulje kredie	Totali
Kryer vlerësimi	0	0	0	**0**
Filluar vlerësimi	0	0	0	**0**
Do i behet vlerësim	48	3,125,132	0	**3,125,132**
Ndryshuar deklarata nga subjekti	41	2,793,212	1,708,139	**4,501,351**
Pritet informacion nga subjekti para se fillohet vlerësimi	96	9,839,189	0	**9,839,189**
Raste mjekësie (te diskutueshme	3	366,056	0	**366,056**
Efekti total	188	15,336,916	1,708,139	**17,831,728**

Në DRT Gjirokastër nga grupi i kontrollit te DPT-se është analizuar deklarimii shitjeve nga TP nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale dhe krahasimi i tyre me shitjet e deklaruara në situatën financiare në sistemin *C@ts* (analiza është bërë vetëm për TVSH-në) Analiza është kryer për vitin ushtrimor 2019 dhe periudhën Janar-Shtator 2020, nga ku rezultuan diferenca në deklarim dhe konkretisht:

- *Për vitin ushtrimor 2019* deri në momentin e kontrollit dhe të dhënave të përpunuara TVSH e vlerësuar apo ndryshuar deklarata nga TP është në vlerën **2,314,911 lekë,**
- *Për periudhën janar – shtator 2020* deri në momentin e kontrollit dhe të dhënave të përpunuara TVSH e vlerësuar apo e ndryshuar deklarata nga TP është në vlerën **3,177,223 lekë**.

Në DRT Durrës nga grupi i kontrollit te DPT-se megjithëse informacioni është paraprak pasi nuk ka përfunduar verifikimi dhe vlerësimi për të gjithë TP, është analizuar deklarimii shitjeve nga TP nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale dhe krahasimi i tyre me shitjet e deklaruara në situatën financiare në sistemin *C@ts* (analiza është bërë vetëm për TVSH-në) Analiza është kryer për vitin ushtrimor 2019 dhe periudhën Janar-Shtator 2020, nga ku rezultuan diferenca në deklarim dhe konkretisht:

- *Për vitin ushtrimor 2019* deri në momentin e kontrollit dhe të dhënave të përpunuara janë 686 tatimpagues të cilët kanë deklaruar TVSH në shitje nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale me shumë se në FDP mujore, me efekt financiar prej 97,090,154 lekë numër dhe vlerë që mund të rritet. Më poshtë tabela me analizat përkatëse për vitin 2019:

Viti 2019

	Nr. raste	Detyrim	Ulje kredie	**Total**
Kryer vlerësimi	7	1,615,170	68,2420	**2,297,590**
Filluar vlerësimi	12	-	-	**-**
Do i behet vlerësim	-	-	-	
Ndryshuar deklarata nga subjekti	53	1,084,220	9,595,425	**10,679,645**
Pritet informacion nga subjekti para se fillohet vlerësimi	479			**84,112,919**

Raste mjekësie (te diskutueshme	15	-	-	**-**
Gabim kase	110	-	-	**-**
Efekti total	686	2,699,390	10,277,845	**97,090,154**

- *Për periudhën janar – shtator 2020* deri në momentin e kontrollit dhe të dhënave të përpunuara janë 665 tatimpagues të cilët kanë deklaruar TVSH në shitje nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale me shumë se në FDP mujore, me efekt financiar prej 83,346,901 lekë numër dhe vlerë që mund të rritet. Më poshtë tabela me analizat përkatëse për vitin 2020:

Viti 2020

	Nr. raste	Detyrim	Ulje kredie	**Totali**
Kryer vlerësimi	-	-	-	**-**
Filluar vlerësimi	4	-	-	**-**
Do i behet vlerësim	-			
Ndryshuar deklarata nga subjekti	52	890,460	9,336,982	**10,227,442**
Pritet informacion nga subjekti para se fillohet vlerësimi	541	-		**73,119,459**
Raste mjekësie (te diskutueshme	5	-	-	**-**
Gabime kase	63			
Efekti total	665	890,460	9,336,982	**83,346,901**

Për sa më sipër konstatohen mangësi në drejtim të:

- mospërfundimit të analizave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për vitin 2019 kur pothuajse ka kaluar viti 2020 i trajtimit të diferencave të TVSh-së të transmetuara nga pajisjet fiskale standarde apo sistemeve fiskale krahasuar me situatën financiare të shfaqur në sistemin C@ts përbën risk për evidentimin e tyre në kohë dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore në të ardhurat tatimore;
- mosmarrja e masave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për arkëtimin e detyrimeve përkatësisht:
  - DRT Korçë për vlerën prej ï 24,693,728 lekë
  - DRT Gjirokastër për vlerën prej ï 5,492,134 lekë
  - DRT Durrës për Vlerën prej ï 180,437,055 lekë

❖ Gjithashtu nga ana e grupit të kontrollit të DPT-së, janë përpiluar dhe dorëzuar dhe shkresat për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT, për fillimin e masës disiplinore për inspektorët e kontrollit të DRT-ve, Korçë, Vlorë dhe Fier konkretisht:

- DRT Fier,

Për shkeljet e konstatuara, të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit si dhe bazuar në ligjin nr.152/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, neni 59, pika 4/b, propozojnë fillimin e procedimit disiplinor për Inspektorët e Kontrollit Operacional në DRT Fier, më poshtë shënuar:

- *z. J. H. dhe zj. Xh. B.* me detyrë Inspektorë Kontrolli në Sektorin e Operacioneve te Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Inspektorët gjatë kontrollit tatimor të ushtruar në subjektin ñMò shpk me NIPT J nuk kanë zbatuar të plotë pikën e parë të programit të kontrollit që ka të bëje me xhiron e realizuar ditore dhe vendin e ushtrimit te veprimtarisë. Për sa i përket analizës së shitjeve të transmetuar nga pajisjet fiskale standarde dhe deklarimit të shitjeve në situatën financiare për periudhën objekt kontrolli, inspektorët e kontrollit nuk kanë bërë asnjë analizë të detajuar. Inspektorët e kontrollit gjatë kontrollit tatimor të ushtruar në subjektin ñMò shpk me NIPT J nuk kanë zbatuar ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore ne RSh.òi ndryshuar, udhëzimit në zbatim të tij, neni 80.3, neni 81.1/1, neni 83 dhe neni 84, udhëzimin ne zbatim te tij, neni 30 deri ne nenin 38, inspektorët e kontrollit nuk i ka dhënë të drejtën e kundërshtimit te rezultateve te kontrollit tatimpaguesit si dhe shkresës sqaruese me nr.6794/1

datë 27.04.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vizita fiskale duhet të trajtohet nga ana procedurale si kontroll i plotë.

- DRT Korçë,
  Për shkeljet e konstatuara, të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit si dhe bazuar në ligjin nr. 152/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, neni 59, pika 4/b, propozojnë fillimin e procedimit disiplinor për Inspektorët e Kontrollit Operacional në DRT Korçë, më poshtë shënuar:

- *z. A. M. dhe z. B. K. me detyrë Inspektorë Kontrolli në Sektorin e* Operacioneve të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë. Inspektorët e kontrollit gjatë kontrollit tatimor të ushtruar në subjektin ñEò sha me NIPT K, nuk kanë zbatuar të plotë pikën e parë të programit të kontrollit që ka të bëjë me xhiron e realizuar ditore dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë. Inspektorët e kontrollit gjatë kontrollit tatimor të ushtruar në subjektin ñEò sha me NIPT K, nuk kanë zbatuar ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore ne R. Sh.òi ndryshuar, udhëzimit në zbatim të tij, neni 80.3, neni 81.1/1, neni 83 dhe neni 84, udhëzimin ne zbatim te tij, neni 30 deri ne nenin 38, inspektorët e kontrollit nuk i ka dhënë të drejtën e kundërshtimit të rezultateve të kontrollit tatimpaguesit si dhe shkresës sqaruese me nr. 6794/1 datë 27.04.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vizita fiskale duhet të trajtohet nga ana procedurale si kontroll i plotë.

- DRT Vlorë,
  Për shkeljet e konstatuara, të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit si dhe bazuar në ligjin nr. 152/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, neni 59, pika 4/b, propozojnë fillimin e procedimit disiplinor për Inspektorin e Kontrollit Operacional në DRT Vlorë, më poshtë shënuar:

- *z. D. B.* me detyrë Inspektor Kontrolli në Sektorin e Operacioneve te Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë. Inspektori i kontrollit nuk ka realizuar pikat e 6 dhe 7 të programit të kontrollit që ka të bëje me analizimin e artikujve kryesor që kanë sjellë rritjen e stokut dhe krahasimin me shitjet e tyre gjatë muajve të fundit, bazuar në inventarin fizik të tyre, si dhe evidentimin, saktësimin dhe analizën rënie/rritje të xhiros dhe treguesve të TVSh-së, argumentimi i analizës së tyre mbi bazën e dokumentacionit në subjekt dhe krahasuar me subjekte të ngjashme apo tregues në shkallë dege. Nga inspektori i kontrollit nuk është bërë evidentimi i pajisjeve fiskale standarde si dhe analizimi i transmetimit të tyre krahasuar me FDP-në nisur dhe nga natyra e aktivitetit të tatimpaguesit (marker ku shitjet janë në konsumator final në 99% të rasteve). Për sa i përket analizës së shitjeve të transmetuar nga pasjet fiskale standarde dhe deklarimit të shitjeve në situatën financiare për periudhën objekt kontrolli, inspektori i kontrollit nuk ka bërë asnjë analizë të detajuar. Inspektori i kontrollit gjatë kontrollit tatimor të ushtruar në subjektin ñM Pò, regjistruar në organet tatimore me Nipt M, nuk kanë zbatuar ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore ne RSh.òi ndryshuar, udhëzimit në zbatim të tij, neni 80.3, neni 81.1/1, neni 83 dhe neni 84, udhëzimin ne zbatim te tij, neni 30 deri ne nenin 38, inspektorët e kontrollit nuk i ka dhënë të drejtën e kundërshtimit të rezultateve të kontrollit tatimpaguesit si dhe shkresës sqaruese me nr. 6794/1 datë 27.04.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vizita fiskale duhet të trajtohet nga ana procedurale si kontroll i plotë.

  Për sa i përket përmirësimit të mëtejshëm të punës në Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT e monitoruara, u la detyrë të ndiqen e zbatohen masat si më poshtë:

  (në të gjitha DRT-të e monitoruara problematikat e evidentuara janë pothuajse të njëjta)

1. DRT-të duhet të zbatojë ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore ne R. Sh.òi ndryshuar, udhëzimit ne zbatim te tij, nenin 80.3,neni 81.1/1,neni 83 dhe neni 84, si dhe shkresës sqaruese me nr. 6794/1 date 27.04.2020 te Drejtorit te Përgjithshëm të Tatimeve,

vizitat fiskale duhet te trajtohen nga ana procedurale si kontroll i plotë, pasi duhet të ndiqet procedura e Raportit Paraprak dhe Raportit Përfundimtar. Gjithashtu DRT-të duhet të zbatojë ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëòi ndryshuar, udhëzimin ne zbatim te tij, nenin 30 deri ne nenin 38, nene në të cilat janë përcaktuar te drejtat e tatimpaguesit.

Menjëherë

2. DRT-të për sa i përket analizës së shitjeve të transmetuar nga pajisjet fiskale standarde apo sistemeve fiskale dhe deklarimit të shitjeve ne librin e shitjeve dhe situatën financiare për periudhën objekt kontrolli, duhet bëjë analize të detajuar, pasi ka raste mospërputhje të deklarimeve të transmetuara nga pajisjet fiskale standarde apo sistemeve fiskale me analizën e shitjeve bërë nga inspektoret e kontrollit.

Vazhdimisht

3. Inspektoret e kontrollit të DRT-të duhet të bëjnë analizë në mënyrë të plotë dhe të detajuar të pikave të programit të kontrollit. *Vazhdimisht*
4. DRT-të duhet të bëjë analizën e shitjeve në konsumator final sipas librit të shitjes apo faturave tatimore të shitjes krahasuar me shitjet në konsumator final të transmetuara nga sistemi fiskal standard, si dhe diferencimin e çmimit të shitjes me shumicë (në TP me qëllim rishitje) me çmimin e shitjeve me pakicë (konsumator final).

Vazhdimisht

5. DRT-të duhet të bëjë evidentimin dhe analizën e adresave te TP dhe pajisjeve fiskale nëse adresat e TP duhet të jenë të pajisura me pajisje fiskale standarde apo sisteme fiskale, dhe nëse të dhënat e këtyre pajisjeve përputhen me të dhënat e shfaqura në organet tatimore sistemin NEXUS. *Vazhdimisht*
6. Për sa i përket diferencave të deklarimit të shitjeve nga tatimpaguesit nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale krahasuar me shitjet e deklaruara në situatën financiare në sistemin C@ts për vitin 2019 DRT-të duhet të beje evidentimin e TP që janë me përgjegjësi tatimore TF që të bëhen vlerësimet përkatëse.*Menjëherë*
7. DRT-të për sa i përket diferencave të deklarimit të shitjeve nga tatimpaguesit nëpërmjet pajisjeve fiskale standarde, sistemeve fiskale krahasuar me shitjet e deklaruara në situatën financiare në sistemin C@ts për vitin 2020, duhet të bëjë vlerësimet përkatëse .

Menjëherë

Për sa më sipër nga të dhënat e këtij kontrolli konstatohet se:

- ❖ nuk është realizuar kontrolli në DRT Lezhë, Tiranë, Berat,
- ❖ grupi i kontrollit të DPT-së është tërhequr nga kryerja e këtij program monitorimi dhe kontrolli me urdhrin verbal të eprorëve, gjë e cila është konfirmuar në njoftimin me e-mail të datë 16.11.2020 drejtuar z. A. Ç. zv/Drejtor i Përgjithshëm dhe i Komanduar Drejtor i Drejtorisë Kontrollit si edhe në raportin paraprak të kontrollit,
- ❖ gjithashtu me e-mail është njoftuar herë pas herë znj. O. U. në cilësinë e kryetarit të grupit që ndjek planin operacional korrik ï dhjetor 2020;
- ❖ për projektraportet paraprake të hartuara nga grupi dhe të nisura sipas shkresave të mësipërme i është nisur i është dërguar informacion me e-mail z. O. C. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në vend në datën 29.01.2021 si dhe problematika për kohën e kufizuar dhe ndërprerje të këtij kontrolli në tre DRT dhe nga grupi i kontrollit nuk është marrë përgjigje,
- ❖ gjithashtu janë konstatohen mangësi në drejtim të:

- mos përfundimit të analizave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për vitin 2019 kur pothuajse ka kaluar viti 2020 i trajtimit të diferencave të TVSh-së të transmetuara nga pajisjet fiskale standarde apo sistemeve fiskale krahasuar me situatën financiare të shfaqur në sistemin C@ts përbën risk për evidentimin e tyre në kohë dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore në të ardhurat tatimore;

- mosmarrja e masave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për arkëtimin e detyrimeve përkatësisht:
- DRT Korçë për vlerën prej ï 24,693,728 lekë
- DRT Gjirokastër për vlerën prej ï 5,492,134 lekë
- DRT Durrës për Vlerën prej ï 180,437,055 lekë

II. Për autorizimin nr. 19297 Prot datë 06.10.2020 në DRT Berat dhe Gjirokastër, konstatohet:
Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit për Vitin 2020 në bazë të Autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.19297prot, datë 06.10.2020, ka ushtruar kontroll tematik në DRT Berat dhe Gjirokastër.
Kontrolli tematik i ushtruar në *DRT Berat* ka filluar në dt. 19.10.2020 dhe ka mbaruar 10.12.2020 (brenda afatit) evaduar në muajin janar 2021. Lidhur me afatin e kryerjes së kontrollit sqarojmë se: Gjatë periudhës së kontrollit grupi u punës nga datat 04.11.2020 - 10.11.2020 dhe nga datat 04.12.2020 -10.12.2020, ka kryer detyrën e përhershme mujore (përpunimin e evidencave mujore të rezultateve të kontrolleve të ardhura nga 14 DRT-të) Në datat 11, 12, 13 nëntor 2020 dhe datat 11,14,15 dhjetor 2020 përpunimin e kontrolleve në proces.
Kontrolli tematik i ushtruar në DRT Gjirokastër ka filluar në dt.25.01.2021-12.03.2021 (brenda afatit) evaduar në muajin korrik 2021. Lidhur me afatin e kryerjes së kontrollit sqarojmë se: Gjatë periudhës së kontrollit grupi u punës nga datat 05.02.2021-10.02.2021, nga data. 05.03.2021- 10.03.2021,ka kryer detyrën e përhershme mujore (përpunimin e evidencave mujore të rezultateve të kontrolleve të ardhura nga 14 DRT-të) Në datë 11, 12, Shkurt 2021 dhe datë, 11, 12, Mars 2021 përpunimin e kontrolleve në proces.
Kontrolli tematik i kryer në DRT Berat dhe Gjirokastër, ka përfshirë veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit, Sektorit të Kontrollit për periudhën: Janar 2019 ï Gusht 2020

Gjatë kontrollit tematik të kryer në DRT Berat dhe Gjirokastër janë kontrolluar Çështjet:

1. Çështje procedurale:

- Çelja e çështjes për kontroll, nga Përgjegjësi i Zyrës së Kontrollit në vend;
- Njoftim Lajmërimi për kontroll, drejtuar subjektit dhe inspektori i kontrollit ;
- Fillimi i kontrollit në vend nga inspektori i kontrollit (brenda 30 ditëve, 81, pika 1/1);
- Evidentimi i nxjerrjes për kontroll të subjektit, nga: Risku DPT apo DRT;
- Periudhat e kontrollit, nëse janë menjëherë vijuese pas kontrollit paraardhës, apo ka shkëputje.
- Respektimi i afatit kohor të qëndrimit për kontroll në vend (tek subjekti);
- Respektimi i Afatit të dërgimit të Raport Kontrollit, subjektit të kontrolluar (7 ditë pas përfundimit të kontrollit, 83/1);
- Ndjekja/respektimi i procedurës miratuese të Raportit të Kontrollit dhe hedhja në sistem (83/3); Kontrolli i afateve në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit të Kontrollit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit, në zbatim të neneve 83 dhe 84 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, në zbatim të tij.
- Nëse ka observacion, hedhja në sistem e tij, trajtimi në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, respektimi i kohës (83/6) së shqyrtimit të observacionit;
- Respektimi i afatit të hartimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe nisja tatimpaguesit, brenda 14 ditëve nga marrja e observacionit (84/1);
- Hedhja në sistemin C@ts, i dokumentacionit të mësipërm, sipas afateve të përfundimit dhe të nisjes së tatimpaguesit.

- Kontrolli i programeve të kontrollit në përshtatje me llojin e aktivitetit ekonomik të subjektit që kontrollohet në zbatim të manualit të kontrollit dhe respektimi i pikave të programit në kontrollin e ushtruar.

  Çështje të përgjithshme të përmbajtjes:

  Shqyrtimi dhe verifikimi i cilësisë së Raporteve Përfundimtare të Kontrollit sipas inspektorëve të kontrollit.
- Respektimi i kontrollit për lloji të tatimit/eve të miratuar për kontroll nga analiza e riskut;
- Trajtimi në raportin e kontrollit, i llojit të tatimit veçmas për çdo periudhë tatimore të miratuar.
- Krahasimi i nivelit të treguesve në fillimin e kontrollit dhe ndryshimi i tyre për çdo periudhë objekt kontrolli, sipas llojit të tatimi të planifikuar për kontroll;
- Vlerësimi i pagesës së TVSh-së dhe tatimit mbi fitimin (apo ulja ose jo e kredisë, humbjes) për secilën periudhë nën kontroll (krahasuar me të dhënat e analizës së riskut në fillimin e kontrollit) niveli i këtyre treguesve të arritur pas kontrollit dhe krahasimi me nivelin e tyre në fillim të kontrollit;
- Efektshmëria e nxjerrjes nga risku i subjekteve për kontroll. Nga kontrolli me zgjedhje i subjekteve, a ka raste kur subjektet megjithëse kanë dalë për kontroll sipas faktorëve të analizës së riskut, zbulimet janë në nivel të ulët dhe përsëri pas kontrollit këto subjekte rezultojnë me risk.

  Për këto dy Raporteve të Kontrollit është rekomanduar:

  - Në lidhje me zbatimin e procedurës së hedhjes në sistemin C@ts, të çdo dokumenti që përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor sipas afateve të përcaktuara, grupi i kontrollit ka konstatuar se jo në të gjitha rastet ishin zbatuar procedurat brenda afatit.
- *Rekomandim1.*

  Në zbatim të shkresave të nisura nga Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave në DKT, Drejtoria e Kontrollit në DRT, duhet të zbatojë procedurën (hapi-inspektor-përgjegjës-drejtor kontrolliï drejtor rajonal) si dhe pasqyrimin (hedhjen) në sistemin informatikë të tatimeve *C@ts*, të çdo dokumenti që përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proces-verbal, inventarë, akte-konstatimi etj.) sipas udhëzimeve të dhëna në shkresat e nisura, me qëllim unifikimin dhe standardizimin e procedurave të kontrollit tatimor.

  Vazhdimisht

  -Krahasimi i nivelit të treguesve (vlerësimi i pagesës së TVSh-së dhe tatimit mbi fitimin) për secilën periudhë në kontroll (krahasuar me të dhënat e analizës së riskut në fillimin e kontrollit)dhe niveli i këtyre treguesve të arritur pas kontrollit grupi I kontrollit ka konstatuar se jo ne te gjitha rastet pasqyrohet ne aktet e kontrollit.
- *Rekomandim 2.*

  Me mbylljen e kontrollit tatimor, në raportin përfundimtar të kontrollit, të pasqyrohen jo vetëm zbulimet, por edhe niveli i ri (ndryshimi) i treguesve fiskal/llojeve të tatimit pas kontrollit (ishte-bëhet). Kjo jo vetëm për të dhënë sa më të qarta efektet e kontrollit, por edhe për arsye se në disa raste, megjithëse subjekti ka dalë për kontroll të plotë tatimorë, pra me rrisk, zbulueshmëria nga kryerja e kontrollit është e tillë, sa që edhe pas kryerjes së kontrollit, treguesit e rriskut ngelen të pa ndryshuar. ***Vazhdimisht***

  -Lidhur me analizën e efektshmërisë së kontrolleve të ushtruar në subjekte, nisur nga arsyet e planifikimit për kontroll, si nga risku i DPT-së, apo propozime nga vet DRT-të, *grupi I kontrollit ka konstatuar se* në raportet e kontrollit nuk është trajtuar kjo problematikë.
- *Rekomandim 3.*

  Drejtoria e Kontrollit në DRT-të, në lidhje me efektshmërinë e nxjerrjes nga risku i subjekteve për kontroll të bëjë analiza dhe ti japë përgjigje departamentit të analizës së riskut nëpërmjet plotësimit të formularit përkatës i cili duhet të pasqyrohet në sistemin *C@ts* si në

rastet e përzgjedhura nga DMR-ja ashtu edhe në rastet kur janë propozime nga DRT-të.

Vazhdimisht

-Nga grupi i kontrollit është konstatuar se : analiza e treguesit të tatim fitimit në disa raste është bërë kryesisht duke trajtuar në raport të dhënat e treguesve te pasqyrave financiare te bilancit, pa kryer një analizë dhe shqyrtim te tyre duke u nisur nga vëllimi e treguesve të shitjes norma e fitimi,

- *Rekomandim 4.*

Në raportet e kontrollit analiza e posteve të bilancit, nuk duhet të ketë karakter formal, por duke analizuar/shprehur për faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e tyre sipas periudhave nën kontroll dhe justifikimi i ndryshimeve, mbi bazë dokumentacioni.

Vazhdimisht

B.

Në zbatim të planit operacional për tremujorin e parë të vitin 2020 e në vijim konstatohet se:

- Nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim program kontrolli në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë se Kontrollit Tatimor dhe përmbushjen e kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshme në të gjitha DRT,
- Nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim kontrolli i performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës në DRT, përdorimi i kritereve të duhura për vlerësim, me qëllim që të prodhojë efekte në plotësimin e detyrave të ngarkuara.
- Nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim kontrolli analizat dhe raportet e vizitave fiskale të zhvilluara duke mbajtur akt konstatime për inspektorët përgjegjës dhe propozuar masa konkrete për shkeljet e konstatuara.

C.

DKT përveç kontrolleve të cilat mund ti realizojë direkt në DRT nga sa konstatohet gjatë vitit 2020 nuk janë realizuar për shkak të mbylljes si rezultat i situatës së pandemisë Covid-19si dhe përfshirjes gjatë këtij viti evidentimin e ankesave e azhurnimin e ndihmave financiare 1 dhe 2 ose *"pagave luftës",* por mund që nëpërmjet sistemit C@ts të verifikohet kontrollohet veprimtaria e DRT dhe puna e Drejtorive të Kontrollit nga zyra edhe nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts në zbatim të rregullores dhe manualit të DKT kështu :

- <u>në zbatim të rregullores se DKT pika 6.</u> *Monitoron arritjet e drejtoritë rajonale tatimore kundrejt planeve për funksionin e kontrollit, investigon ndryshimet, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar arsyet e çdo shmangie; Merr pjesë në analizat periodike të sektorëve të operacioneve të kontrollit në drejtoritë rajonale tatimore dhe evidenton mangësitë e gjetura gjatë kontrolleve mujore të kryera nga sektorët e kontrollit në drejtoritë e kontrollit në DRT. Shqyrton Raport-kontrollet e drejtoritë rajonale tatimore lidhur me nivelin tekniko-profesional dhe mënyrën sesi janë kryer, jep opinione për cilësinë e Raport-Kontrolleve dhe punën e çdo inspektori;*
- <u>në zbatim të manualit të kontrollit tatimor Kapitulli VII pika 8.1</u>Objektivi kryesor i Sektori i Kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit në DPT si një strukturë e specializuar është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale, për:

- Kontrollin e deklaratave tatimore, llogarive, librave dhe regjistrimeve tatimore të tatimpaguesit;
- Zhvillimin dhe sigurimin e zbatimit të procedurave korrekte të kontrollit tatimor;
- Kontrollin dhe matjen e performancës së drejtorive të kontrollit të drejtorive rajonale.

- Vlerësimet tatimore nga zyra
- pika 8.2 Sektori monitoron arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigon ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur është e nevojshme.

- nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@tsmund të verifikohet kontrollohet dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e DK në DRT si:
  - analizave të situatave kreditore debitor e tatimpaguesve për sigurimet,
  - analiza e efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra,
  - analiza nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve,
  - analiza si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit,
  - analiza për kështet e tatimfitimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi,
  - analiza për kontrollet nga zyra,
  - analiza për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit,
  - analiza sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur sõka apelime,
  - analiza si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT,
  - analiza e gjendjes kreditore të TVSh-së,
  - analiza mbi situatat e parregullta sa janë dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët e kontrollit nga zyra,
  - analiza se ku bazohen dhe si zgjidhen rastet për kontroll nga inspektorët e kontrollit në DRT.

D.

Për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 në kuadër të prioriteteve të reja të Administratës Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor:

1. Ka qenë pjesë e grupeve të punës për dy paketat e ndihmës financiarë. Zhvillimi në sistem i formularëve për aplikim nga tatimpaguesi për ndihmën financiare, ndjekja e procesit deri në finalizimin e pagesave nëpërmjet llogarive bankare. Trajtimi i ankesave të ndryshme nga disa burime dhe raportimet periodike mbi dy paketat e ndihmës financiare.

- Rishikimi i draft VKM për ndihmën financiare,
- Hartimi i rregulloreve mbi zbatimin e ndihmës financiare,
- Pjesë e grupeve të punës për zbatimin e VKM për ndihmën financiare,
- Raportime periodike për Drejtorin e Përgjithshëm, MFE si dhe zyrën e shtypit,
- Etj.

Të gjitha rregulloret janë miratuar sipas Komitetit të Reformave kështu:

- Komiteti i Reformave, në mbledhjen nr.17 datë 02.04.2020 vendosi Miratimin e Rregullores ñPër përcaktimin e procedurave për dhënien e ndihmës financiare për subjektet përfituese gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e pandemisë Covid-19ò, pas reflektimit të ndryshimeve të dakortësuara nga anëtarët e Komitetit të Reformave në mbledhje,
- Komiteti i Reformave, në mbledhjen nr.18 datë 21.04.2020 vendosi:
  - Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren Nr. 6247/1 Prot., datë 02.04.2020 ñPër miratimin e rregullave dhe procedurave për dhënien e ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milion lekë, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e pandemisë Covid-19.
  - Miratimin e Rregullores ñPër miratimin e rregullave, të dokumentacionit dhe procedurave për dhënien e ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19.

- Miratimin e Rregullores ñPër masat e veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 që duhet të ndjekin Drejtoria e Përgjithshme dhe drejtoritë rajonale tatimore në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020, të ndryshuar, lidhur me ankesat/denoncimet për kështet e qirave.
- Gjithashtu DKT në DPT është përfshirë gjatë këtij viti në evidentimin e ankesave e azhurnimin e ndihmave financiare 1 dhe 2 ose *"pagave luftës",* e konkretisht:
  *Ndihmave financiare 1 ose"pagave luftës 1"*në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 24.03.2020, ñPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyroreò, VKM nr.254, datë 27.03.2020, ñPër përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e Covid-19ò.
  Inspektorët e kontrollit në DKT në DPT e konkretisht A. G, A. Ll., sipas urdhrit nr. 27, datë 02.04.2020 me nr. 6249 prot., datë 02.04.2020 kanë kryer verifikime me përzgjedhje, sipas përcaktimit në Urdhër, të listave të përfituesve nga paketa e parë e pagave të listës. Listat janë përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut periodikisht dhe pas verifikimeve, rezultatet bëheshin të ditura për pjesën tjetër të grupit të punës.
  Ndihmave financiare II ose"pagave luftës 2" në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, VKM nr. 305, datë 16.4.2020, ñPër përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19ò e cila synonte tôu japë ndihmë në formën e grandeve të drejtpërdrejta punonjësve të ndërmarrjeve, për të përballuar dëmin e shkaktuar nga përhapja e pandemisë Covid-19 dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarisë ekonomike gjatë dhe pas përhapjes së pandemisë Covid-19, si dhe individëve ndryshuar me VKM nr. 341 datë 23.04.2021.
  Në bazë të urdhrit nr. 31 datë 21.04.2021 me nr. Prot. 6892 datë 21.04.2021 Drejtoresha e Kontrollit Tatimor ka drejtuar grupin e punës për paketën II gjithashtu dhe inspektori N. M. ka qenë anëtar i grupit të punës.
  Përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit kanë verifikuar me zgjedhje procedurën e ndjekur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, hapat e ndjekur në zbatim të VKM dhe rregullores së hartuar për këtë qëllim dhe pas verifikimeve ka raportuar grupit të punës për verifikimet e kryera dhe problematikat e evidentuara.
  Për sa më sipër për këto dy paketa Ndihmave financiare I dhe II konstatohet se:
  *Ndihmave financiare 1 ose"pagave luftës 1"*është miratuar më çështje në sistemin C@ts nga inspektorët e DRT-ve për çdo subjekt të vlerësuar përfitues. Ndërsa tek *ndihmave financiare II ose"pagave luftës 2"*plotësimi i kushteve të VKM vlerësohej automatikisht nga sistemi dhe përcaktoheshin subjektet përfitues. Në të dyja rastet IT gjeneronin listat e përfituesve (sipas ngarkesës në bazë 1 ditore ose 2 ditore) dhe i përcillte tek grupet e punës. Përfaqësuesit e drejtorisë së menaxhimit të riskut bënin filtrim të listave sipas kritereve të riskut të vendosura në përputhje me kushtet e VKM-së respektive. Më pas listën e përcillte te grupi i punës ku përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit më përzgjedhje verifikonin procedurën e ndjekur. Përveç zbatimit të VKM-ve përkatëse që subjekti të shpallej përfitues duhej të ishte aktivitet i mbyllur sipas urdhrave më poshtë:

- Urdhër nr. 193 datë 20.03.2020 i MSHMS
- Urdhër nr. 190, datë 19.03.2020 i MSHMS (shfuqizon Urdhrat nr. 135 dhe nr. 135/1 date 09.03.2020 te MSHMS)
- Urdhër nr. 165, datë 12.03.2020 i MSHMS
- Urdhër nr. 164, datë 12.03.2020 i MSHMS
- Urdhër nr. 156, datë 10.03.2020 i MSHMS

- Urdhër nr. 135, datë 09.03.2020 i MSHMS
- Urdhër nr. 135/1, datë 09.03.2020 i MSHMS
- Urdhër nr. 223, datë 01.04.2020 (ndryshon Urdhrin nr. 156 më lart) i MSHMS
- Urdhër nr. 221, datë 01.04.2020 (ndryshon Urdhrin nr. 165 më lart) i MSHMS
- Urdhër nr. 217 datë 01.04.2020 (ndryshon Urdhrin nr. 164 më lart) i MSHMS
- Urdhër nr. 216 datë 01.04.2020 (ndryshon Urdhrin nr. 190 më lart) i MSHMS

Verifikimet nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit kryheshin si më poshtë:

1. Çështja verifikohej në sistemin C@ts nëse është hapur dhe miratuar.
2. Aktiviteti i subjektit përputhej me aktivitet e mbyllura për shkak të pandemisë Covid 19,
3. Xhiroja e subjektit a është në përputhje me kushtet e VKM- përkatëse,
4. Punësimi i punonjësit ose largimi nga puna është brenda afateve të përcaktuar për paketat e pagave të luftës,
5. Punonjësi a është i dy punësuar dhe a kishte përfituar më parë.

Rastet e verifikuara dhe problematikat e hasura raportoheshin të grupi i punës përkatës dhe diskutoheshin në mbledhje. Pasi konsultohej në listën përfundimtare e cila gjenerohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pas reflektimit të problematikave të hasura nga Drejtoria e Kontrollit. Lista përfundimtare përcillej për pagesa te Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Gjatë procesit të shpërndarjes së *Ndihmave financiare 1-2 ose"pagave luftës 1-2*, ka patur një sërë problematikash me llogaritë bankare të mbyllura apo ankesa nga subjektet mos përfituese. Për të cilat përfaqësuesit e Drejtorisë së Kontrollit janë angazhuar në verifikimin, shqyrtimin dhe ndjekjen e këtyre problematikave deri në zgjidhjen përkatëse dhe informimin e subjektit.Kështu:

- Për çdo listë janë verifikuar afërsisht 1-2% e çdo liste sipas tabelës mëposhtme:

	nr. nipte verifikuar	nr. punonjësish verifikuar
Paketa I	858	2.315
Paketa II	480	1.960

Verifikimet janë kryer më përzgjedhje rastësore ku është patur kujdes të shikohej procedura për çdo lloj aktiviteti dhe për çdo DRT.

- Lidhur me ankesat nga qytetaret janë trajtuar nga grupet e punës në DPT duke:

- Kthyer përgjigje subjektit;
- Përcjell për kompetencë DRT;
- Trajtuar problematika në DPT (nëpërmjet grupit të punës përkatës ose palës mirëmbajtëse të sistemit për aplikimet automatike).

Më tej nga, Grupi i Koordinatorëve në DPT, nga shqyrtimi i informacioneve të ardhura në rrugë elektronike, nga të gjitha DRT-të, rezulton se ankesat dhe pretendimet kanë qenë kryesisht me këtë problematikë:

1-ankesa në lidhje me aksesim për saktësim të dhënash bankare;

2-ankesa për rihapje çështje dhe mundësim aksesi për aplikim;

Në lidhje me grupin e parë të ankesave që konsiston në ndryshimin e emrit të bankës dhe të numrit IBAN, të dhënat janë si më poshtë:

- për me grupin e pare të ankesave janë trajtuar afërsisht 1080 tatimpagues,
- për grupin e dytë, ankesat lidhen me rihapjen e çështjeve dhe mundësi aksesi për aplikim pasi individët nuk kanë aplikuar për Ndihmën Financiare, janë trajtuar afërsisht 1136 raste.
- Gjithashtu përveç rasteve mësipërme janë trajtuar një numër i konsiderueshëm ankesash që vinin direkt nga subjektet ose vetë individët aplikues, proces që ka zgjatur deri në korrik 2020.

2. Si pasojë e pandemisë, Drejtoria e Kontrollit Tatimor ka hartuar një shkresë mbi mënyrën e zhvillimit të kontrolleve ku ato të pafilluara u pezulluan deri në një situatë të rregullt të pandemisë, ndërkohë që do të vijonin ato që nuk kërkonin prezencë fizike të inspektoreve.

- Shkresa nr. 5897 datë 19.03.2020 Dërgohet për njohje dhe zbatim, Qëllimi: shkresë për pezullimin e kontrolleve në subjekt për shkak të Covid-19,
- Shkresa nr. 17611 datë 11.09.2020 Dërgohet udhëzues, Udhëzuesi nr. 3 datë 31.08.2020 òPër zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare të vitit fiskal 2019.

10. *Plani vjetor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor ashtu si dhe i drejtorive të tjera është miratuar me vendim komiteti si më poshtë:*

- Komiteti Operacional, në mbledhjen nr.16, datë 06.02.2020 ka vendosur:
- Miratimin e përmbushjes dhe analizës së planeve operacionale 2019;
- Miratimin e Raportit Vjetor 2019;
- Miratimin e Planit Operacional për vitin 2020 dhe kalendarit të Mbledhjeve të Komiteteve për vitin 2020 nga anëtarët e Komiteteve;
- Miratimin e Planit të Ardhurave për DRT-të për vitin 2020;
- Miratimin e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore për rastet e emergjencave civile;
- Publikimin në web të rezultateve të matjes së kënaqësisë së stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe hartimin e një plan masash dhe propozimesh nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për rritjen e kënaqësisë së stafit.
- Komiteti Operacional, në mbledhjen nr.17, datë 04.05.2020 ka vendosur:
- Miratimin e Përmbushjes së Planeve Operacionale për periudhën Janar-Mars, 2020 të Drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Objektivat e parealizuara gjatë periudhës Janar-Mars, 2020 të jenë pjesë e planeve operacionale për 3-mujorin pasardhës. (Për shkak të situatës Covid-19).
- Komiteti Operacional, në mbledhjen nr.19, datë 21.12.2020 ka vendosur:
- Miratimin e Përmbushjes së Planeve Operacionale për vitin 2020;
- Përcaktimi i objektivave kryesorë për vitin 2021;
- Miratimin e Treguesve të Performancës për strukturat e administratës tatimore.

*****

Nga të dhënat dhe dokumentacion i Sektorit Cilësisë dhe Standardizimit për vitin 2020 konstatohet se :

- ndjek planet e kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, nga DMR (70% të modulit 1 të DMR si dhe 30% e propozuara nga DRT dhe të miratuara) mbi bazën e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji.
- analizon dhe përpunon vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale,
- mban evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR,
- të gjitha të dhëna e raportuara nga DRT-të, mbas analizimit dhe përpunimit i dërgohen Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, në DPT.

Tabelë e realizimit të kontrolleve për vitin 2020 të detajuar sipas DRT-veplan, fakt,zbulime(70+30%)

DRT	Kontrolle e planifikuara 12 mujori 2020 (70+30%)			Kontrolle e kryera 12 mujori 2020			Zbulimet sipas llojeve te tatimeve				
	Gjithsej	Të plota	v. fiskale	Gjithsej	Të plota	v. fiskale	TVSH	T.FITIMI	Sigurime shoqërore	Te Tjera	Gjithsej
Berat	48	16	32	44	13	31	27168	13659	165	945	41937
Dibër	41	25	16	30	18	12	15040	805	804	391	17040
Durrës	211	59	152	233	49	184	3922816	2421398	12895	2775	6359884

Elbasan	104	71	33	82	52	30	39760	11015	20980	836	72591
Fier	174	91	83	160	70	90	74352	20418	489	3957	99216
Gjirokastër	37	23	14	28	14	14	14493	4069	214	1355	20131
Korçë	127	95	32	112	73	39	20153	7612	458	4525	32748
Kukës	24	21	3	24	23	1	4342	2343	0	1812	8497
Lezhë	27	17	10	24	15	9	474109	247377	0	1026	722512
Sarandë	25	2	23	25	2	23	2273	617	0	100	2990
Shkodër	74	39	35	63	35	28	48562	83356	15	7754	139687
Vlore	83	42	41	79	36	43	57758	9560	125	595	68038
Tirane	314	171	143	285	178	107	352221	280285	14789	66746	714040
VIP	251	**127**	**124**	243	114	129	422467	**728769**	**9672**	54774	**1215682**
Totali	**1540**	**799**	**741**	**1432**	**692**	**740**	**5475514**	**3831283**	**60606**	**147590**	**9514993**

Numri i kontrolleve të kryera për vitin 2020 e krahasuar me vitin 2019(70+30%)

Emërtimi	**Totali i rasteve te kontrollit**		**Zbulimet ne vlere**		**Tatimet sipas zërave / Totalin e zbulimeve**	**Tatimet sipas zërave / Totalin e zbulimeve**	**Numri i kontrollev e në %**	**Zbulimet sipas zërave në %,**
	2020	*2019*	*2020*	*2019*	*2020*	*2019*	*2020/2019*	*2020/2019*
1.Kontroll fakt biznes i vogël	**0**	**0**	**0**	**0**	**0,0%**	**0,0%**	**0,0%**	**0,0%**
2.Kontroll fakt biznes i madh	**1.432**	**2.146**	**9.514.993**	**10.732.774**	**100,0%**	**100,0%**	**66,7%**	**88,7%**
2.1. TVSH			5.475.514	4.382.773	57,5%	40,8%		**124,9%**
2.2. Tatim fitimi			**3.831.283**	1.652.237	40,3%	15,4%		**231,9%**
2.3. Sigurime Shoq e Shëndet			60.606	26.597	0,6%	0,2%		**227,9%**
2.4. Tatim mbi te ardhurat			3.710	206	0,0%	0,0%		**1801,0%**
2.5. Akcizë				0	0,0%	0,0%		**#DIV/0!**
2.6. Lojëra fati				0	0,0%	0,0%		**#DIV/0!**
2.7. Taksa nacionale				3.581	0,0%	0,0%		**0,0%**
2.8. Të tjera			143.880	4.667.380	1,5%	43,5%		**3,1%**
Shuma (1 + 2)	**1.432**	**2.146**	**9.514.993**	**10.732.774**	**100,0%**	**100,0%**	**66,7%**	**88,7%**
Ulje humbje			**12.273.154**	**30.650.735**				

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se realizimi i numrit të kontrolleve për periudhën 12 muajt e vitit 2020 e krahasuar me të njëjtën periudhë të viti 12/2019 është realizuar në masën 67% të kontrolleve ndërsa realizimi i zbulimeve është në masën 89 %, e krahasuar me periudhën 12/ 2019, çka tregon se gjatë vitit 2020 nuk është punuar mirë si në realizimin e kontrolleve të planifikuara dhe nëzbulimet e konstatuara nga ana e DRT-ve.

Evidenca progresive për realizimin e planit të kontrollit 12 mujor 2020(70+30%)

Nr.	DRT	**Kontrolle e planifikuara 12 mujori 2020**			**Kontrolle e kryera 12 mujori 2020**			Realizimi i planit të kontrolleve në %		
		Gjithsej	**Te plota**	**v. fiskale**	**Gjithsej**	**Te plota**	**v. fiskale**	**Gjithsej**	**Te plota**	**v. fiskale**
1	**Berat**	48	16	32	44	13	31	91.7	81.3	96.9
2	**Dibër**	41	25	16	30	18	12	73.2	72.0	75.0
3	**Durrës**	211	59	152	233	49	184	110.4	83.1	121.1
4	**Elbasan**	104	71	33	82	52	30	78.8	73.2	90.9
5	**Fier**	174	91	83	160	70	90	92.0	76.9	108.4
6	**Gjirokastër**	37	23	14	28	14	14	75.7	60.9	100.0
7	**Korçë**	127	95	32	112	73	39	88.2	76.8	121.9
8	**Kukës**	24	21	3	24	23	1	100.0	109.5	33.3
9	**Lezhë**	27	17	10	24	15	9	88.9	88.2	90.0
10	**Sarandë**	25	2	23	25	2	23	100.0	100.0	100.0
11	**Shkodër**	74	39	35	63	35	28	85.1	89.7	80.0
12	**Vlorë**	83	42	41	79	36	43	95.2	85.7	104.9
13	**Tiranë**	314	171	143	285	178	107	90.8	104.1	74.8
14	**VIP**	251	**127**	**124**	243	114	129	96.8	89.8	104.0

	Totali	**1540**	**799**	**741**	**1432**	**692**	**740**	**93.0**	**86.6**	**99.9**

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se nga 1540 kontrolle gjithsej të planifikuara për vitin 2020 janë realizuar 1432 kontrolle ose 108 kontrolle nuk janë realizuar nga të cilat 107 janë kontrolle të plota. Gjithashtu nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se disa **DRT janë me mosrealizime të mëdha të kontrolleve e konkretisht DRT Dibër me 7 kontrolle të mos realizuara, DRT Durrës me 10 kontrolle, Elbasan me 19 kontrolle, Fier me 21 kontrolle, Gjirokastër me 9 kontrolle, Korçë me 22 kontrolle, VIP me 13 kontrolle të mosrealizuara**.

Realizimi i numrit të kontrolleve, zbulimet mujore dhe progresive për çdo DRT-ë,

		Nr. Kontrolleve të kryera 2020		**Zbulime në 000/leke**				
		Plota	**Vizite fiskale**	**Gjithsej**	**TVSH**	**Tatim Fitimi**	**Sig. Shoqërore**	**Te tjera**
1	**Berat**	13	31	41,937	27,168	13,659	165	945
2	**Dibër**	18	12	17,040	15,040	805	804	391
3	**Durrës**	49	184	6,359,884	3,922,816	2,421,398	12,895	2,775
4	**Elbasan**	52	30	72,591	39,760	11,015	20,980	836
5	**Fier**	70	90	99,216	74,352	20,418	489	3,957
6	**Gjirokastër**	14	14	20,131	14,493	4,069	214	1,355
7	**Korçë**	73	39	32,748	20,153	7,612	458	4,525
8	**Kukës**	23	1	8,497	4,342	2,343	0	1,812
9	**Lezhë**	15	9	722,512	474,109	247,377	0	1,026
10	**Sarandë**	2	23	2,990	2,273	617	0	100
11	**Shkodër**	35	28	139,687	48,562	83,356	15	7,754
12	**Vlorë**	36	43	68,038	57,758	9,560	125	595
13	**Tiranë**	178	107	714,040	352,221	280,285	14,789	66,746
14	**DTM**	**114**	129	**1,215,682**	**422,467**	728,769	9,672	54,774
	Totali	**692**	**740**	**9,514,993**	**5,475,514**	**3,831,283**	**60,606**	**147,590**

Krahasimi viti 2019 me vitin 2020 të rezultatit zbulimeve për çdo DRT dhe në total DPT, kontrolle të plota, vizita fiskale në numër dhe në vlerë

	Rrethet	Nr. Kontrolleve të kryera									
		Plota			Vizite fiskale			Nr. Inspektorëve progresive për 12 Muaj/nrinsp X 12 muaj)		Nr. Kontroll/ insp/muaj	
		2020	2019	Ne %	2020	2019	Ne %	2020	2019	2020	2019
		1	2	3= 1 / 2	4	5	6=4/5	7	8	9=(1+4)/7	10=(2+5)/8
1	Berat	13	40	32.5	31	30	103.3	56	60	0.8	1.2
2	Dibër	18	38	47	12	5	240.0	45	48	0.7	0.9
3	Durrës	49	81	60	184	213	86.4	239	230	1.0	1.3
4	Elbasan	52	88	59	30	36	83.3	125	117	0.7	1.1
5	Fier	70	119	59	90	106	84.9	157	194	1.0	1.2
6	Gjirokastër	14	30	47	14	16	87.5	44	48	0.6	1.0
7	Korçë	73	128	57.0	39	42	92.9	146	157	0.8	1.1
8	Kukës	23	16	144	1	6	16.7	33	36	0.7	0.6
9	Lezhë	15	20	75.0	9	11	81.8	41	42	0.6	0.7
10	Sarandë	2	20	10.0	23	8	287.5	22	22	1.2	1.3
11	Shkodër	35	81	43.2	28	46	60.9	105	106	0.6	1.2
12	Vlorë	36	46	78.3	43	51	84.3	84	96	0.9	1.0
13	Tiranë	178	375	47	107	211	50.7	499	724	0.6	0.8
14	VIP	114	139	82	129	144	89.6	601	628	0.4	0.5
	Totali	**692**	**1221**	**57**	**740**	**925**	**80.0**	**2196**	**2508**	**0.7**	**0.9**

Nga analiza e tabelës së mësipërme konstatohet se rezultatet e vitit 2019 janë më të larta së ato të vitit 2020 kështu numri i kontrolleve të plota në 2020 krahasuar me 2019 është 43 % më i ulët, gjithashtu dhe numri i vizitave fiskale është 20 % më i ulët.

Gjithashtu nëse analizojmë për vitin 2020 zbulimet sipas llojit të tatimit konstatohet se:

- *Zbulimet për TVSH e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për Tatim Fitimin e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për Sigurime Shoqërore e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për TAP e krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Zbulimet për të Tjera krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar*
- *Analizohet nëse ka tatimpagues që janë kontrolluar me indicie nga të tretet si dhe nëse ka kontrolle me vlera të mëdha zbulimi dhe sa ndikon kjo vlerë në raport me zbulimet që kanë rezultuar në DRT-të dhe sa ne total si DPT.*

- Zbulimet për kontroll është 6644 mijë lekë, ndërsa për vitin për të njëjtën periudhe të vitit të kaluar ishte 5002 mijë lekë, pra kemi rritje të zbulimit për kontroll ose e realizuar 133 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar;
- Forca zbuluese për inspektor për kontroll është 4333 mijë lekë dhe për të njëjtën periudhe të vitit të kaluar ishte 4293 mije lekë, pra kemi rritje të zbulimit për kontroll realizuar me 101 % krahasuar me të njëjtën periudhe të vitit të kaluar;
- Zbulimet e TVSH, janë **5.475.514 mijë lekë** (detyrim + ulje tepricës kreditore + gjoba), ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar zbulimet për TVSh janë **4.382.773 mijë lekë**. Siç vihet re periudha 12/2020 ka një realizim në 125%;
- Zbulimet për Tatim Fitimi janë : **3.831.283 mijë lekë** Detyrim plus gjoba, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar zbulimet janë **1.652.237 mijë lekë**, pra për 12/2020, zbulimi realizuar në 232 %;
- Zbulimet për Sigurimet shoqërore për periudhën Janar ï Dhjetor 2020 janë **60.606 mijë lekë** Detyrim plus gjoba, ndërsa për të njëjtën periudhe të vitit të kaluar zbulimet janë **26.597 mijë lekë**, pra për vitin 2020 realizuar 228 %;
- Zbulimet për Të Tjera janë **147.590 mijë lekë** Detyrim plus gjoba, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar 2019, zbulimet për ketë lloj tatimi janë **4.671.168 mijë lekë** ose për periudhën 12/2020 është realizuar **3.2 %.**

Një tregues tjetër për periudhën Janar-Dhjetor 2020, është se në **11** tatimpagues janë gjetur zbulimet në vlerën 7.986.537 mijë lekë ose 84% e zbulimeve kundrejt vlerës totale të zbulimeve vjetore për 14 DRT-të që është **9.514.994 mij**ë **lek**ë, kështu kemi për :

- DRT Durrës zbulime të cilat janë rrjedhojë e vlerësimit alternative nga zyra në tatimpaguesin **T E C me NiptK** nëvlerën **6.254.868 mijë lekë** (detyrime + gjoba), ose 98% e zbulimeve vjetore të kësaj drejtorie e rivlerësuar dhe raportuar në muajin Dhjetor 2020;
- DRT Lezhë vetëm për 1 subjekte vlera e zbulimit është **672.403 mijë lekë** dhe përbën 93 % të zbulimeve 12 mujore, nga rivlerësimi alternative të kryer për tatimpaguesin K me NiptK;
- DTM vetëm për 1 subjekte vlera e zbulimit është 521.337 mijë lekë dhe përbën 43 % të zbulimeve 12 mujore;
- DRT Tiranë vetëm për 1 tatimpagues B e T I me Nipt L, vlera e zbulimit është **215.464 mije lekë** dhe përbën 30 %, plus dhe 6 tatimpagues të tjerë me zbulime të konsiderueshme të cilat përbejnë 66% të zbulimeve 12 mujore të kësaj Drejtorie .

Lista e tatimpaguesve me zbulime të mëdha periudha Janar-Dhjetor 2020.

DRT	Subjekti	Nipti	Zbulime	Përzgjedhja			Kontrolluar
			Gjithsej	Rasti 1	Rasti 2	Rasti 3	

Tiranë	T	K	22.358		po		Shkurt 2020
Tiranë	E	J	39.522		po		Shkurt 2020
Tiranë	D	L	33.588	po			prill 2020
Tiranë	O	L	41.976	po			prill 2020
Tiranë	G	L	37.892		po		prill 2020
Tiranë	T	L	77.648			Po	Korrik 2020
DTM	O	K	521.337		PO		Shtator 2020
Tiranë	B	L	215.464	po			Shtator 2020
Shkodër	U	J	69.481	po			Shtator 2020
Lezhë	K	K	672403				Tetor 2020
Durrës	T	K	6254868		po		Dhj-20

Gjithashtu nëse analizojmë dhe kontrollet janë kryer sipas Moduleve 1, 2,3, e konkretisht:

- *Moduli 1* kemi kontrollet e kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson 70% e kontrolleve të planifikuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe kontrolle të kryera nga ku konstatohet se: këto janë më shumë kontrolle në numër gjithsej 1136 kontrolle ose sa 79 % kundrejt numrit të kontrolleve të kryer në total por me zbulime në masën më të ulët ose sa 20% e zbulimeve gjithsej, më e detajuar tabela më poshtë

Moduli 1 (70% DMR)

DREJTORIA RAJONALE	gjithsej	Kontrolle të kryera raste 1 me zbulim	pa zbulime	pa zbul %	Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime te tjera	Totali
Berat	36	28	8	22.2	22377	11450	158	215	34199
Dibër	23	19	4	17.4	12245	569	362	341	13517
Durrës	200	85	115	57.5	28631	6135	89	692	35547
Elbasan	58	52	6	10.3	20635	7579	279	370	28863
Fier	124	105	19	15.3	27792	7980	8	1607	37387
Gjirokastër	21	20	1	4.8	3521	1976	1	231	5729
Korçë	88	58	30	34.1	13889	5044	412	4311	23656
Kukës	17	17	0	0.0	1855	668	0	750	4770
Lezhë	20	16	4	20.0	457433	236586	0	795	694814
Sarandë	25	12	13	52.0	2273	617	0	100	2990
Shkodër	51	50	1	2.0	38316	65245	0	239	103800
Vlorë	64	62	2	3.1	49734	6180	0	471	56385
Tirana	231	172	59	25.5	263369	167482	1445	9927	442223
DTM	178	97	81	45.5	224246	122855	485	26603	390225
Totali	1136	793	343	30.2	3642642	640366	3238	46652	1874105

Në nr. 1136 gjithsej janë kontrolle të kryera për vitin 2020 ku përfshihen edhe subjektet e mbartura në vite sipas planifikimeve (1136ï 692 kontrolle të planifikuara në 2020 = 444 kontrolle të planifikuara nga vitet e tjera dhe nëproces që janë kontrolluar gjatë vitit 2020. Në nr. 444 kontrolle janëpërveç të prapambetura në vite edhe kontrollet e muajit nëntor, dhjetor të vitit 2019 të cilat në bazë tëprocedurës tatimore duhet që subjekti të njoftohet 30 ditë para fillimit të kontrollit. (sqaruar edhe më poshtë).

*Raste **2**(30% propozuar dhe miratuar)*

- *Moduli 2* kemi kontrollet e kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson 30 % e kontrolleve të planifikuara nga DRT, ku në këtë modul konstatohet se: niveli i zbulimit është me i lartë të cilat janë në numër më të vogël kontrollesh 285 kontrolle por zbulimet sa janë 79 % të zbulimit total, por këtu duhet thënë se kjo vjen si rezultat i 2 rasteve në DRT Durrës se cila në muajin Dhjetor 2020 ka kryer rivlerësim alternative në tatimpaguesin T ECme zbulime të mëdha të cilat ndikojnë në këtë modulin 2, më detajuar tabela më poshtë:

DREJTORIA RAJONALE	Kontrolle të kryera rasti 2	Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime te tjera	Totali

	gjithsej	me zbulim	pa zbulime	pa zbul%					
Berat	8	6	2	25.0	4723	2277	8	730	7738
Dibër	7	7	0	0.0	2795	236	442	50	3523
Durrës	33	28	5	15.2	3894186	2415263	12805	2083	6324337
Elbasan	23	20	3	13.0	11610	2944	20686	316	35556
Fier	36	34	2	5.6	46560	12438	481	2350	61829
Gjirokastër	7	7	0	0.0	10972	2093	213	1124	14402
Korçë	24	16	8	33.3	6266	2567	45	214	9092
Kukës	7	7	0	0.0	1133	1532	0	1062	3727
Lezhë	4	4	0	0.0	16676	10791	0	231	27698
Sarandë	0	0	0	#DIV/0!	0	0	0	0	0
Shkodër	12	11	1	8.3	10247	18111	15	7515	35888
Vlorë	15	15	0	0.0	8024	3380	125	124	11653
Tirana	46	38	8	17.4	87308	69266	13244	22762	192580
DTM	63	54	9	14.3	178946	602818	9187	27463	818414
Totali	**285**	**247**	**38**	**13.3**	**4279446**	**3143716**	**57251**	**66024**	**7546437**

Sipas tabelës së mësipërme gjatë vitit 2020 janë kryer në total 285 kontrolle në të cilat janë edhe kontrolle të planifikuara nga vitet më parë dhe të realizuar gjatë vitit 2020. (285 ï 124 kontrolle të kryera dhe të planifikuara gjatë vitit 2020 = 161 kontrolle janë të mbartura nga vitet e tjera dhe të kryera gjatë vitit 2020).
Të dhëna të hollësishme për listën e kontrolleve sipas Drejtorive Rajonale jepen në aneksin nr. 1/1, bashkangjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

Për sa më sipër e përmbledhur kemi tabelën si më poshtë nga analiza e së cilës konstatohet:

DRT	total subjekte	të përfunduara	të pa përfunduara	vlera e zbulimeve/000 lekë	Muaj pa propozime për kontroll
Tiranë	63	5	58	17115	Janar, Shkurt, Prill, Maj Qershor, Dhjetor
Lezhë	2	0	0	0	Janar, Shkurt, mars, Prill, Maj Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Dhjetor
Berat	7	5	2	7727	Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik
Dibër	11	6	5	3476	Janar, Shkurt, Prill, Maj, Qershor, Dhjetor
Durrës	33	18	15	23251	Prill, Maj Qershor
Kukës	9	2	7	1363	Prill, Maj Qershor, nëntor
Elbasan	32	23	9	32191	Janar, Prill, Maj Qershor
Gjirokastër	12	6	6	11261	Prill, Maj Qershor
Vlorë	17	7	10	5900	Prill, Maj Qershor
DTM	53	21	32	78839	Prill, Maj Qershor, Shtator, Nëntor
Shkodër	9	5	4	1404	Prill, Maj Qershor, Korrik, Shtator, nëntor
Korçë	30	16	14	2619	Janar, Prill, Maj Qershor
Fier	33	10	23	3459	Janar, Shkurt, Prill, Maj Qershor
Sarandë	1	0	0	0	Janar, Shkurt, mars, Prill, Maj Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Dhjetor
Total	**312**	**124**	**185**	**188605**	

Sipas tabelës së mësipërme kemi:

- 312 kontrolle rasti 2 janë propozuar për tu kryer gjatë vitit 2020 nga të cilat janë kryer konkretisht 124 kontrolle,
- 185 kontrolle janë planifikuar të kryen gjatë vitit 2020 por nuk janë kryer por mbeten për vitin pasardhës,
- për muajin dhjetor 2020janë planifikuar 39 kontrolle numri i të cilave duhet të zbriten nga numri i tatimpaguesve që nuk është kryer kontrolli (185-39= 146) kontrolle të pa kryera sepse sipas ligjit të procedurave neni 81 njoftimi i kontrollit tatimor pika 1/1 njoftimi për fillimin e kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara fillimit te kontrollit tatimor;
- të gjitha DRT nuk kanë planifikuar nga ana e tyre kontrolle çka i ngarkon ato me përgjegjësi në kryerjen e analizave për nxjerrjen e tatimpaguesve me më rrisk për territorin që mbulojnë.

Raste 3 (me indice nga të tretët)

- *Moduli 3* kemi kontrollet e kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson dhe raste 3 zënë 1 % të zbulimeve në total.

DREJTORIA RAJONALE	gjithsej	Kontrolle të kryera raste 3 Me Zbulim	pa zbulime	pa zbul %	Total zbulime TVSH	Total zbulime TF	Total zbulime sigurime	Total zbulime te tjera	Totali
Berat	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Durrës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Elbasan	1	1	0	0	7515	492	15	150	8172
Fier	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjirokastër	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korçë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kukës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lezhë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Sarandë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkodër	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vlorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tirana	8	6	2	25	1543	43539	100	34055	79237
DTM	2	2	0	0	3668	3029	0	345	7042
Totali	**11**	**9**	**2**	**18**	**12726**	**47060**	**115**	**34550**	**94451**

*****

Gjithashtu konstatohet se shumë kontrolleve në vite janë në proces të pa mbyllura nga viti 2014, konkretisht në mënyrë të detajuar këto të dhëna për vitet 2014-2020paraqiten sipas tabelave më poshtë:

DRT	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Total
Berat							1	1
Dibër							5	5
DTM			1	1	1	4	60	67
Durrësi							22	22
Elbasan							9	9
Fier							55	55
Gjirokastër							9	9
Korçë							29	29
Kukës					1	1	10	12
Lezhë						2	4	6
Sarandë						1		1
Shkodër		5	7	1			7	20
Tiranë		2	5	14	34	108	118	281
Vlorë						1	19	20
Total	**0**	**7**	**13**	**16**	**36**	**117**	**348**	**537**

Viti	Nr.gjithsej	Pa Filluar	Pezulluar	Fazat nëtëcilën ndodhet Kontrolli					
				Projekt Raport Kontrolli Inspektor	Përgjegjësi Operacional	Drejtori Kontrollit	Dërguar raport paraprak	Opservacion nga Subjekti	Raporti Përfundimtar
2014									
2015	7	5	2						
2016	13	8	2	3					
2017	16	3	5	8					
2018	36	16	3	17					
2019	117	45	2	57		1	12		
2020	348	117		148	2	18	54	6	3
Total	537	194	14	233	2	19	66	6	3

Nga analiza e tabelave të mësipërme konstatohet se deri në fund të dhjetorit të vitit 2020, janë gjithsej 537 kontrolle, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë gjithsej 537 kontrolle të ndara në:

- të pezulluara - 14 kontrolle;

- të pa filluara - 194 kontrolle;
- të dërguar projektraporti i kontrollit - 233 kontrolle
- tëmbajtura nga përgjegjësi i kontrollit- 2kontrolle
- të mbajtura nga Drejtori i Kontrollit - 19 kontrolle
- të dërguara projekt/paraprak i kontrollit- 66 kontrolle
- kontrolle në pritje të observacionit nga subjektet - 6 kontrolle
- të dërguara raporti përfundimtar - 3 kontrolle

Për sa më sipër me gjithë punën e bërë në këtë drejtim konstatohet se:

- për vitin 2020 kjo situatë është e papranueshme me gjithë justifikimet se janë pezulluar kontrollet në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 156 prot, datë 10.03.2020, dhe në zbatim të saj të shkresës së DPT me nr. 5897 prot, datë 19.03.2020 për pezullimin e përkohshëm të kontrolleve në vend deri në normalizimin e situatës. Kjo gjithashtu nuk mund të justifikohet edhe për faktin sepse situata me gjithë vështirësitë është normalizuar disi më vonë si dhe ato mund të ishin mbyllur edhe gjatë vitit 2021;
- nuk ka një bashkërendim të saktë midis të tre instancave DMR, DKT dhe DK në DRT, nëpërmjet një regjistri, programi, data baze apo implementuar në sistemin *C@ts* ku të jenë rakorduar në mënyrë të saktë dhe automatike moduli 70%, moduli 30%, etj., nga momenti i nxjerrjes nga sistemi i DMR, miratimi për kontroll i regjistrimit të kontrollit e deri në përfundimin e tij në çdo fazë të kontrollit për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve;
- kontrollet e lëna pa u mbyllur nuk mund të kenë asnjë justifikim por mos mbyllja e tyre në afate ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e Drejtorisë së Kontrollit në vitet sipas përkatësisë dhe organizimit si dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore dhe Drejtorët e Kontrollit të DRT;
- megjithëse për vitin 2019 dhe 2020 nga ana e Drejtorisë së Kontrollit janë bërë njoftime mbi kontrollet e papërfunduara në afat gjendja është e njëjtë dhe madje vijon që numri i tyre të shtohet në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar nenet 81, 83 dhe 84, kështu kemi njoftimet si më poshtë:
  - nr. 3723, datë 18.02.2019 ñMbi kontrollet tatimor të papërfunduara në afatò;
  - nr. 3723/11, datë 17.04.2019 ñPër zbatimin e afateve të përfundimit të akteve të kontrolleve tatimoreò;
  - nr. 23284, datë 30.12.2019 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Tiranë, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
  - nr. 23291, datë 30.12.2019 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Durrës, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
  - nr. 23291/1, datë 04.02.2020ñPër fillimin e masës disiplinoreò për kontrollet në proces dhe të pafilluara(të prapambetura), drejtuar Burimeve Njerëzore në DPT, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për 11 inspektorë, 1PërgjegjësSektorit të Kontrollit Tatimor dhe Drejtorit të Kontrollit Tatimor në këtë DRT Durrës;
  - nr. 15098, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Dibër, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
  - nr. 15098, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Sarandë, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;

- nr. 15100, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Lezhë, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15101, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Korçë, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15102, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Kukës, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15103, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Vlorë, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15104, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Durrës, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15105, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Tiranë, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15106, datë 30.07.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT DTM, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;
- nr. 15412, datë 04.08.2020 ñPër kontrollet në proces dhe të pafilluara dhe nxjerrjen e përgjegjësisëò drejtuar DRT Shkodër, në të cilën kërkohet fillimi i ecurisë disiplinore për inspektorët e përgjegjësit e sektorit të kontrollit tatimor dhe drejtorin e kontrollit tatimor;

*****

Administrata tatimore në zbatim të nenit 85 të ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, pikës 85 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, rregullores së brendshme të Drejtorisë së kontrollit Tatimor si dhe pika 2.3 Manualit të Kontrollit, shqyrton kërkesat për rikontroll tatimor. Për vitin 2020 konstatohet se, rikontrollet janë realizuar me indicie të Prokurorisë së Shkallës së Parë, rekomandimeve të lëna nga KLSH, rekomandimeve nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DHT si dhe në 2 raste nga DKT në DPT e konkretisht, sipas listës të paraqitur në aneksin nr. 1/2, bashkangjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

Për sa më sipër në mënyrë të përmbledhur mund të themi se me gjithë punën e bërë nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për vitin 2020 duhet të ishte punuar më shumë në drejtim të :

- udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor;
- monitorimit të punës së drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor sepse konstatohen disa mangësi e konkretisht:
  - krijimi i Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit i cili si pjesë e kontrollit nga zyra nuk ka qenë plotësisht në eficensë sepse nuk ka kryer shumë monitorime nga zyra si dhe projekti i fiskalizimit nuk është implementuar plotësisht dhe nuk është shtrirë në të gjitha subjektet që nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë detyrimet e tyre në përputhje me ligjin për faktin se fiskalizimi hyn në fuqi më 1 korrik 2021 ose rreth dy vjet nga krijimi i këtij sektori;
  - për vitin 2020 Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk është plotësuar më numër punonjësish e kryesisht Sektori i Kontrollit Tatimor ka mangësi në 50 % ;
  - riorganizimi ka konsistuar në ndarjen e kësaj drejtorie në sektorë d.m.th. shtimin e sektorëve duke mbajtur të njëjtin numër punonjësish;
  - nga kontrollet e ushtruara nga DKT e DPT në DRT konkretisht:
    - nuk është realizuar kontrolli në DRT Lezhë, Tiranë, Berat,

- grupi i kontrollit të DPT-së është tërhequr nga kryerja e këtij program monitorimi dhe kontrolli me urdhrin verbal të eprorëve, gjë e cila është konfirmuar në njoftimin me e-mail të datë 16.11.2020 drejtuar z. A. Ç. zv/Drejtor i Përgjithshëm dhe i Komanduar Drejtor i Drejtorisë Kontrollit si edhe në raportin paraprak të kontrollit,
- gjithashtu me e-mail është njoftuar herë pas herë znj. O. U. në cilësinë e kryetarit të grupit që ndjek planin operacional korrik ï dhjetor 2020;
- për projektraportet paraprake të hartuara nga grupi dhe të nisura sipas shkresave të mësipërme i është nisur i është dërguar informacion me e-mail z. O. C. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në vend në datën 29.01.2021 si dhe problematika për kohën e kufizuar dhe ndërprerje të këtij kontrolli në tre DRT dhe nga grupi i kontrollit nuk është marrë përgjigje,
- gjithashtu janë konstatohen mangësi në drejtim të:

- mos përfundimit të analizave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për vitin 2019 kur pothuajse ka kaluar viti 2020 i trajtimit të diferencave të TVSh-së të transmetuara nga pajisjet fiskale standarde apo sistemeve fiskale krahasuar me situatën financiare të shfaqur në sistemin C@ts përbën risk për evidentimin e tyre në kohë dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore në të ardhurat tatimore;
- mos marrja e masave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për arkëtimin e detyrimeve përkatësisht:

- DRT Korçë për vlerën prej ï 24,693,728 lekë
- DRT Gjirokastër për vlerën prej ï 5,492,134 lekë
- DRT Durrës për Vlerën prej ï 180,437,055 lekë

- në zbatim të planit operacional për tremujorin e parë të vitin 2020 e në vijim konstatohet se:

- nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim program kontrolli në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë se Kontrollit Tatimor dhe përmbushjen e kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshme në të gjitha DRT,
- nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim kontrolli i performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër , Berat, Durrës në DRT, përdorimi i kritereve të duhura për vlerësim, me qëllim që të prodhojë efekte në plotësimin e detyrave të ngarkuara.
- nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim kontrolli analizat dhe raportet e vizitave fiskale të zhvilluara duke mbajtur akt konstatime për inspektorët përgjegjës dhe propozuar masa konkrete për shkeljet e konstatuara.

- mund të realizohej nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts të verifikohet kontrollohet dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e DK në DRT si:

- analizave të situatave kreditore debitor e tatimpaguesve për sigurimet,
- analiza e efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra,
- analiza nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve,
- analiza si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit,
- analiza për kështet e tatimfitimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi,
- analiza për kontrollet nga zyra,
- analiza për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit,
- analiza sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur sôka apelime,
- analiza si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT,
- analiza e gjendjes kreditore të TVSh-së,

- analiza mbi situatat e parregullta sa janë dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët e kontrollit nga zyra,
- analiza se ku bazohen dhe si zgjidhen rastet për kontroll nga inspektorët e kontrollit në DRT.
- realizimi i numrit të kontrolleve për periudhën 12 muajt e vitit 2020 e krahasuar me të njëjtën periudhë të viti 12/2019 është se realizuar në masën 67% të kontrolleve;
- ndërsa realizimi i zbulimeve është në masën 89 %, e krahasuar me periudhën 12/ 2019;
- nuk ka një bashkërendim të saktë midis të tre instancave DMR, DKT dhe DK në DRT, nëpërmjet një regjistri, programi, data baze apo implementuar në sistemin *C@ts* ku të jenë rakorduar në mënyrë të saktë dhe automatike moduli 70%, moduli 30%, etj., nga momenti i nxjerrjes nga sistemi i DMR, miratimi për kontroll i regjistrimit të kontrollit e deri në përfundimin e tij në çdo fazë të kontrollit për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve;
- nga 1540 kontrolle gjithsej të planifikuara për vitin 2020 janë realizuar 1432 kontrolle ose 108 kontrolle nuk janë realizuar nga të cilat 107 janë kontrolle të plota;
- disa DRT janë me mosrealizime të mëdha të kontrolleve e konkretisht:
- DRT Dibër me 7 kontrolle të mos realizuara,
- DRT Durrës me 10 kontrolle të mos realizuara,
- Elbasan me 19 kontrolle të mos realizuara,
- Fier me 21 kontrolle të mos realizuara,
- Gjirokastër me 9 kontrolle të mos realizuara,
- Korçë me 22 kontrolle të mos realizuara,
- VIP me 13 kontrolle të mos realizuara.
- rezultatet e vitit 2019 janë më të larta së ato të vitit 2020 kështu numri i kontrolleve të plota në 2020 krahasuar me 2019 është 43 % më i ulët, gjithashtu dhe numri i vizitave fiskale është 20 % më i ulët;
- për periudhën Janar-Dhjetor 2020, konstatohet se në vetëm 11 tatimpagues janë gjetur zbulimet në vlerën 7.986.537 mijë lekë ose 84% e zbulimeve kundrejt vlerës totale të zbulimeve vjetore për 14 DRT-të që është 9.514.994 mijë lekë;
- në kontrollet e planifikuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson 70 % të cilët janë më shumë në numër gjithsej 1136 kontrolle ose sa 79 % kundrejt e numrit të kontrolleve të kryer në total shkalla e zbulimeve është në masën më të ulët ose sa 20 % e zbulimeve gjithsej;
- kontrollet e kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson 30 % e kontrolleve të planifikuara nga DRT, niveli i zbulimit është me i lartë megjithëse janë në numër më të vogël kontrollesh 285 kontrolle por zbulimet sa janë 79 % të zbulimit total, por këtu duhet thënë se kjo vjen si rezultat i 2 rasteve në DRT Durrës e cila në muajin Dhjetor 2020 ka kryer rivlerësim alternative;
- të gjitha DRT nuk kanë planifikuar nga ana e tyre kontrolle në muaj të veçantë për vitin 2020, ndërsa ato të Lezhës dhe Sarandës nuk kanë planifikuar asnjë kontroll nga na e tyre për vitin 2020;
- mos përfundimit të kontrolleve nga viti 2015, sepse deri në fund të dhjetorit të vitit 2020, janë gjithsej 537 kontrolle, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë gjithsej 537 kontrolle të ndara në:
- të pezulluara - 14 kontrolle;
- të pa filluara - 194 kontrolle;
- të dërguar projekt raporti i kontrollit - 233 kontrolle
- të mbajtura nga përgjegjësi i kontrollit - 2 kontrolle
- të mbajtura nga Drejtori i Kontrollit - 19 kontrolle
- të dërguara projekt/paraprak i kontrollit - 66 kontrolle
- kontrolle në pritje të observacionit nga subjektet - 6 kontrolle

- të dërguara raporti përfundimtar - 3 kontrolle
  - për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ana e DKT nuk është punuar mjaftueshëm kështu konstatohet se:
  - marrja e masave konkrete për zbatimin rekomandimet e ka filluar me shumë vonesë dhe më konkretisht mbas plotësimit të vendit bosh të drejtorit të kësaj drejtorie me personin konkret,
  - marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka filluar më datë 14.04.2021 ose 5 muaj e gjysmë me vonesë,
  - për zbatimin e rekomandimeve është mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresave në DRT dhe nuk janë marrë veprime të mëtejshme për marrjen e përgjigjeve përfundimtare dhe realizimin e tyre së bashku me efektet përkatëse,
  - për rekomandimet që nuk janë pranuar nuk i është kthyer përgjigje e dokumentuar KLSH-së mbi arsyet përfundimtare të moszbatimit të tyre të miratuara nga Drejtoria Juridike dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPT.

Në lidhje me akt konstatimin nr. 2 janë paraqitur 3 observacione me nr. 8715/17 datë 18,08,2021 nga DPT e prot në KLSH me nr. 513/4, datë 20,08,2021, nr. 8715/18 datë 18.08.2021 nga DPT e prot në KLSH me nr. 513/5, datë 20.08.2021 dhe nr. 8715/24 datë 23.08.2021 nga DPT e prot në KLSH me nr. 513/14, datë 25.08.2021 të cilët janë trajtuar rast pas rasti më sipër në materialin shtjellues të zbatimit të rekomandimeve të gjithë DPT dhe sipas përkatësisë të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor më poshtë.

Gjetja Mangësi në funksion të performancës së realizimit të detyrave, udhëheqjes metodologjike në funksionimim të kontrollit tatimor dhe monitorimin e punës së DK të drejtorive tatimore rajonale.

Situata: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për vitin 2020 konstatohen mangësi në drejtim të udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimit të punës së drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor sepse konstatohen disa mangësi e konkretisht: krijimi i Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit i cili si pjesë e kontrollit nga zyra nuk ka qenë plotësisht në eficencë sepse nuk ka kryer shumë monitorime nga zyra si dhe projekti i fiskalizimit nuk është implementuar plotësisht dhe nuk është shtrirë në të gjitha subjektet që nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë detyrimet e tyre në përputhje me ligjin, për faktin se fiskalizimi hyn në fuqi më 1 korrik 2021 ose rreth dy vjet me vonesë.

-Për vitin 2020 Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk është plotësuar me numër punonjësish e kryesisht Sektori i Kontrollit Tatimor ka mangësi në 50 %.

Riorganizimi ka konsistuar në ndarjen e kësaj drejtorie në sektorë, pra në shtimin e sektorëve duke mbajtur të njëjtin numër punonjësish

-Nga auditimi i planit kontrolleve ushtruar nga DKT e DPT në DRT konkretisht konstatohet se:

-Nuk është realizuar kontrolli në DRT Lezhë, Tiranë, Berat.

-Grupi i kontrollit të DPT-së është tërhequr nga kryerja e këtij program monitorimi dhe kontrolli me urdhrin verbal të eprorëve, gjë e cila është konfirmuar në njoftimin me e-mail të datë 16.11.2020 drejtuar z.A. Ç. zv/Drejtor i Përgjithshëm dhe i Komanduar Drejtor i Drejtorisë Kontrollit si edhe në raportin paraprak të kontrollit.

-Gjithashtu me e-mail është njoftuar herë pas herë znj. O. U. në cilësinë e kryetarit të grupit që ndjek planin operacional korrik ï dhjetor 2020.

-Për projekt raportet paraprake të hartuara nga grupi dhe të nisura sipas shkresave të mësipërme i është nisur i është dërguar informacion me e-mail z.

O. C. në cilësinë e Përgjegjësitë e Sektorit të Kontrollit në vend në datën 29.01.2021 si dhe problematika për kohën e kufizuar dhe ndërprerje të këtij kontrolli në tre DRT dhe nga grupi i kontrollit nuk është marrë përgjigje,
-Gjithashtu konstatohen mangësi në drejtim të:
-mos përfundimit të analizave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për vitin 2019 kur pothuajse ka kaluar viti 2020 i trajtimit të diferencave të TVSh-së të transmetuara nga pajisjet fiskale standarde apo sistemeve fiskale krahasuar me situatën financiare të shfaqur në sistemin C@ts përbën risk për evidentimin e tyre në kohë dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore në të ardhurat tatimore.
-Mos marrja e masave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për arkëtimin e detyrimeve përkatësisht:
DRT Korçë për vlerën prej - 24,693,728 lekë,
DRT Gjirokastër për vlerën prej - 5,492,134 lekë,
DRT Durrës për Vlerën prej -180,437,055 lekë
-Në zbatim të planit operacional për tremujorin e parë të vitin 2020 e në vijim konstatohet se: nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim program kontrolli në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë se Kontrollit Tatimor dhe përmbushjen e kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshme në të gjitha DRT; nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim kontrolli i performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës në DRT, përdorimi i kritereve të duhura për vlerësim, me qëllim që të prodhojë efekte në plotësimin e detyrave të ngarkuara; nuk është realizuar për vitin 2020 e në vijim kontrolli analizat dhe raportet e vizitave fiskale të zhvilluara duke mbajtur akt konstatime për inspektorët përgjegjës dhe propozuar masa konkrete për shkeljet e konstatuara.
-Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-venëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet kontrollohet dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e DK në DRT si:
analizave të situatave kreditore debitor e tatimpaguesve për sigurimet;
analiza e efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra;
analiza nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve;
analiza si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit;
analiza për kështet e tatimfitimit për rastet që është ndërhyrë pas këstit që vendos sistemi;
analiza për kontrollet nga zyra;
analiza për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit;
analiza sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur s'ka apelime;
analiza si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT;
analiza e gjendjes kreditore të TVSh-së;
analiza mbi situatat e parregullta sa janë dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët e kontrollit nga zyra;
analiza se ku bazohen dhe si zgjidhen rastet për kontroll nga inspektorët e kontrollit në DRT.

-Realizimi i numrit të kontrolleve për periudhën e vitit 2020 e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 është rezulton në masën 67% të kontrolleve;ndërsa realizimi i zbulimeve është në masën 89 %, e krahasuar me periudhën 12/ 2019.

-Nga 1540 kontrolle gjithsej të planifikuara për vitin 2020 janë realizuar 1432 kontrolle ose 108 kontrolle nuk janë realizuar nga të cilat 107 janë kontrolle të plota ku me mosrealizime të mëdha të kontrolleve janë DRT: Dibër me 7 kontrolle, Durrës me 10 kontrolle, Elbasan me 19 kontrolle, Fier me 21 kontrolle, Gjirokastër me 9 kontrolle, Korçë me 22 kontrolle, dhe VIP me 13 kontrolle të mos realizuara.

-Numri i kontrolleve të plota në 2020 krahasuar me 2019 është 43 % më i ulët, gjithashtu dhe numri i vizitave fiskale është 20 % më i ulët;

-Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, konstatohet se në vetëm 11 tatimpagues janë gjetur zbulimet në vlerën 7,986,537 mijë lekë ose 84% e zbulimeve kundrejt vlerës totale të zbulimeve vjetore për 14 DRT-të që është 9,514,994 mijë lekë;

-Në kontrollet e planifikuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson 70 % të cilët janë më shumë në numër gjithsej 1136 kontrolle ose sa 79 % kundrejt e numrit të kontrolleve të kryer në total shkalla e zbulimeve është në masën më të ulët ose sa 20 % e zbulimeve gjithsej;

-Kontrollet e kryera për periudhën 12 mujore 2020 që përfaqëson 30 % e kontrolleve të planifikuara nga DRT, niveli i zbulimit është me i lartë megjithëse janë në numër më të vogël kontrollesh 285 kontrolle por zbulimet sa janë 79 % të zbulimit total, por këtu duhet thënë se kjo vjen si rezultat i 2 rasteve në DRT Durrës e cila në muajin Dhjetor 2020 ka kryer rivlerësim alternative;

-Të gjitha DRT nuk kanë planifikuar nga ana e tyre kontrolle në muaj të veçantë për vitin 2020, ndërsa ato të Lezhës dhe Sarandës nuk kanë planifikuar asnjë kontroll nga na e tyre për vitin 2020.

-Nuk ka një bashkërendim të mirë dhe qartësisht të përcaktuar midis të tre instancave DMR, DKT dhe DK në DRT, nëpërmjet një regjistri, programi, data baze apo implementuar në sistemin *C@ts* ku të jenë rakorduar në mënyrë të saktë dhe automatike moduli 70%, moduli 30%, etj., nga momenti i nxjerrjes nga sistemi i DMR, miratimi për kontroll i regjistrimit të kontrollit e deri në përfundimin e tij në çdo fazë të kontrollit për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve.

-Nuk janë përfunduar kontrolle nga viti 2015, sepse deri në fund të dhjetorit të vitit 2020 janë gjithsej 537 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë të ndara në:

të pezulluara - 14 kontrolle;
të pafilluara - 194 kontrolle;
të dërguar projekt raporti i kontrollit - 233 kontrolle
të mbajtura nga përgjegjësi i kontrollit - 2 kontrolle
të mbajtura nga Drejtori i Kontrollit - 19 kontrolle
të dërguara projekt/paraprak i kontrollit - 66 kontrolle
kontrolle në pritje të observacionit nga subjektet - 6 kontrolle
të dërguara raporti përfundimtar - 3 kontrolle

Kriteri: -Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 ñKodi i Procedurës Penale i Republikës së

Shqipërisëò, i ndryshuar;
-Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;
-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,
-Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
-Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
-Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
-Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
-Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësoreò, i ndryshuar; ndryshuar me ligjin nr. 25/2019, datë 25.04.2019,
-Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër Informacionin e klasifikuar ñSekret Shtetërorò, i ndryshuar;
-Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 ñPër Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmitò;
-Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër informacionin e klasifikuar sekret shtetërorò, i ndryshuar;
-VKM nr. 400, datë 22.04.2009 ñPër detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Hetimit Tatimorò;
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 0.209.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar;
-Udhëzimi nr. 16, datë 03.05.2010 ñPër administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskaleò;
-Manual i Hetimit Tatimor, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.14, datë 13.03.2017, ndryshuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 28, datë 28.06.2018,
-Manuali i Hetimit Tatimor dhe Manuali i Verifikimit dhe Koordinimit në Teren miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.19/2, datë 28.04.2020,
-Rregullores së Bashkëpunimit Midis Funksioneve të Veçanta nr. 41 datë 13.06.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
-Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 22225 datë 16.07.2015 ñPër konstatimin dhe dokumentimin e shkeljeve tatimore, administrative gjatë kontrolleve të ushtruara nga ana e strukturave të Verifikimit në Terren dhe Hetimit Tatimor (Taks Forcë)ò;
-Rregullore e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017;
-Të tjera akte ligjore, nënligjore, udhëzues dhe rregullatorë për funksionimin dhe drejtimin e punës.

Impakti: Në monitorimin për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e evazionit fiskal fushën e tatim-taksave.

Shkaku: Mungesë e bashkëveprimit dhe zbatimit të ligjit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Drejtoria e Kontrollit Tatimor të realizojë në vijim kontrollin e performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, në DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës në DRT, bazuar në kritere për vlerësim, me qëllim plotësimin e detyrave të parealizuar në objektivat e saj për vitin 2020 e në vijim.

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e parealizuar dhe monitorimin e munguar nga Drejtoria Kontrollit Tatimor gjatë vitit 2020. Kjo me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të gjitha drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor.
- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të urdhërojë përfundimin e kontrollit të ndërprerë në DRT Lezhë, Tiranë, Berat, në bazë të autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020 për saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të vlerësuara si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për drejtuesit të cilët kanë anuluar pa shkak kontrollin në DRT Lezhë, Tiranë, Berat, në bazë të autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020.
-Drejtoria e Kontrollit të hartojë praktika verifikimi nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts nëpërmjet analizave: të situatave kreditore- debitor të tatimpaguesve për sigurimet; të zbatimit të procesit të rimbursimit; të gjendjes kreditore të TVSh-së; analiza për kështet e tatimfitimit për rastet që është ndërhyrë pas këstit që vendos sistemi, kryqëzimin me të dhënat nga sistemi doganor, etj., me qëllim identifikimin fenomeneve dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.
- Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të ngrihet grup pune me përfaqësuesit e DMR dhe struktura e DKT për të mundësuar një rakordim të saktë, automatik dhe të gjurmueshëm të kontrolleve të përzgjedhura sipas modulit 70%, dhe propozimeve në nivelin 30%, me qëllim monitorimin e realizimit të planit të kontrolleve deri në përfundimin dhe raportimin tyre, për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve.
- Drejtoria e Kontrollit në DPT të nxjerrë përgjegjësitë për kontrollet e planifikuara për vitin 2020 dhe të parealizuara ku mosrealizimet më të mëdha janë në DRT: Dibër , Durrës , Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, dhe DTM.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrolli të nxjerrë përgjegjësitë për gjithsej 537 kontrolle nga viti 2015, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, të planifikuara në vite e të parealizuara.
- Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

<u>Drejtorisë së Hetimit Tatimor</u>.

Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit Tatimor u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë nga ku u konstatua se:

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion.
- Informacione, relacione e materiale të paraqitura nga strukturat e DPT
  Baza Ligjore
- Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 ñKodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,

- Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
- Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësoreò, i ndryshuar; ndryshuar me ligjin nr.25/2019, datë 25.04.2019,
- Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër Informacionin e klasifikuar ñSekret Shtetërorò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 ñPër Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmitò;
- Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër informacionin e klasifikuar sekret shtetërorò, i ndryshuar;
- VKM nr. 400, datë 22.04.2009 ñPër detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Hetimit Tatimorò;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 0.209.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 16, datë 03.05.2010 ñPër administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskaleò;
- Manual i Hetimit Tatimor, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.14, datë 13.03.2017, ndryshuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 28, datë 28.06.2018,
- Manuali i Hetimit Tatimor dhe Manuali i Verifikimit dhe Koordinimit në Teren miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.19/2, datë 28.04.2020,
- Rregullores së Bashkëpunimit Midis Funksioneve të Veçanta nr. 41 datë 13.06.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 22225 datë 16.07.2015 ñPër konstatimin dhe dokumentimin e shkeljeve tatimore, administrative gjatë kontrolleve të ushtruara nga ana e strukturave të Verifikimit në Terren dhe Hetimit Tatimor (Taks Forcë)ò;
- Rregullore e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017;
- Tëtjera akte ligjore, nënligjore, udhëzues dhe rregullatorëpër funksionimin dhe drejtimin e punës.

*****

Objektivat e Drejtorisë për vitin 2020 janë bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën 2017-2021 në 3 shtylla kryesore për Drejtorinë e Hetimit Tatimor. Matrica në format Excel është ndërtuar, në përgjigje të objektivave dhe nën objektiva për Drejtorinë e Hetimit Tatimor, bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore.

Drejtoria e Hetimit Tatimor gjatë vitit 2020 ka patur ristrukturim të plotë dhe ka kryer detyrat funksionale dhe përmbushjen e përgjegjësive në zbatimin e legjislacionit tatimor e Planit Operacional të Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin. Gjithashtu dhe në vijim të planeve mujore të punës. Sipas informacionit materialet shkresore/plane të klasifikuara referuar ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, ñPër Informacionin e Klasifikuar "Sekret Shtetëror", të VKM me nr. 123, datë 15.03.2001 ñPër rregullat e procesit të klasifikimit të Sekretit Shtetërorò, janë depozituar në kartotekën e Drejtorisë së Hetimit Tatimor me nr. 26, prot. datë 07.02.2020, nr. 27,prot. datë 07.02.2020, nr. 157,prot. datë 04.03.2020, nr. 248,prot. datë 12.06.2020, nr. 293,prot. datë 21.07.2020, nr. 433,prot. datë 23.11.2020, nr. 450 prot. datë 14.12.2020.

*****

Nga auditimi strukturës së Drejtoria e Hetimit Tatimor për vitin 2020konstatohet se ajo ka pësuar ndryshimet në zbatim të urdhrave të Kryeministrit kështu:

- *Për periudhën 01.01.2020- 06.04.2020*, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka qenë e organizuar në nivel qendror dhe rajonal, sipas strukturës miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr.86 datë 03.05.2019 si më poshtë:

✓ Drejtoria e Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
✓ Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Verior (Shkodër);
✓ Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror (Tiranë);
✓ Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor (Fier).

❖ Drejtoria e Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përbërje të saj ka patur sektorët:

- Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës;
- Sektori i Hetimit Tatimor;
- Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Sektori i Monitorimit dhe Kundërvajtjeve Administrative.

❖ DrejtoritëeHetimitTatimornëRajoneushtrojnëfunksionetdhedetyratetyre,tëndaranëdy sektorë:

- Sektori i Hetimit Tatimor.
- Sektori i Monitorimit Territorial.

Organigrama e DHT Janar- Prill 2020në DPT dhe DRT





Struktura e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me emrat përkatës sipas pozicionit të punës, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 86 datë 03.05.2019, paraqitet në aneksin 1/4 bashkangjitur projektraportit të auditimit.

Për sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2019 deri më prill 2020 për rreth 16 muaj kemi mosplotësim të organikës me punonjës në pozicionin e përgjegjës sektori dhe inspektor hetimi kështu:

- nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës së bashku me 1 punonjës të këtij sektori,
- nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit së bashku me 4 punonjës të këtij sektori, kur gjithsej janë 9 punonjës ose 45% më pak punonjës së organika
- nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

- Për periudhën 06.04.2021- 31.12.2020 Drejtoria e Hetimit Tatimor është organizuar vetëm në nivel qendror miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 33 datë 12.02.2020 si më poshtë:
  Në zbatim të strukturës së re të administratës tatimore qendrore, Drejtoria e Hetimit Tatimor është organizuar në nivel qendror dhe ka në përbërje të saj:

- Sektorin e Administrimit të Informacionit dhe Analizës,
- Sektorin e Hetimit Tatimor,
- Sektorin e Parandalimit të Pastrimitt ë Parave.

Organigrama e DHT Maj 2020 e vijim në DPT



Për sa më sipër për periudhën në vijim maj 2020 deri më 31.12.2020 konstatohet se:

- nuk është kryer ristrukturimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në afatet e përcaktuara po rreth 2 muaj me vonesë,
- nuk është plotësuar pozicioni i punës i Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor,
- nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës,
- nuk është plotësuar Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të parave me numrin e punonjësve ku konstatohet se nga 3 punonjës ai ka vetëm 1 punonjës;
- Nga Drejtori i Hetimit nuk janë plotësuar kërkesat e udhëzimit për procedurat tatimore në të cilën shprehet se në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për tû punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke sjellë që shumë vende pune të jenë të paplotësuara.

  Nga auditimi i ndryshimeve të strukturës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor dhe i legjislacionit të funksionimit të saj në përputhje me atë tatimor konstatohet se, Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron funksionet dhe kryejnë detyrat e saj në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2018 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò;
- Rregullores e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017.
- Manualit i Hetimit Tatimor dhe Manuali i Verifikimit dhe Koordinimit në Teren miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.19/2, datë 28.04.2020.

A. Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron funksionet dhe kryejnë detyrat e saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar si më poshtë:

KREU II -PARIMET, ORGANIZIMI DHE PERSONELII ADMINISTRATËS TATIMORE

Neni 13- Organizimi i administratës tatimore

1. Administrata tatimore përbëhet nga:

a) administrata tatimore qendrore, ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme eTatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj;

b) administrata tatimore vendore, ku përfshihen zyrat tatimore, nën autoritetin eqeverisjes vendore.
2. Administrata tatimore qendrore është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Financave.
Neni 16- Struktura e administratës tatimore qendrore
1. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in.
2. Organigrama e administratës tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
3. Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori dhe njësi të tjera sipas funksioneve të mëposhtme:
a) Funksionet bazë dhe operacionale, ku bëjnë pjesë:
i) shërbimi, regjistrimi dhe edukimi i tatimpaguesit;
ii) menaxhimi i riskut, rimbursimi i tatimeve, kontrolli tatimor;
iii) mbledhja e detyrimeve tatimore/zbatimi i masave shtrënguese;
iv) hetimi tatimor;
v) investigimi i brendshëm antikorrupsion, auditi i brendshëm.
b) Funksionet mbështetëse, ku bëjnë pjesë: financa, statistikat dhe analiza, teknologjia e informacionit, shërbimi ligjor e teknik, shërbimet administrative, burimet njerëzore dhe marrëdhëniet institucionale.
4. shfuqizohet.
5. Funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtorive rajonale, të secilës drejtori, si dhe të njësive të tjera të administratës tatimore qendrore përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave.
6. Ministri i Financave mund të vendosë që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të nënkontraktohen subjekte private, të specializuara, për realizimin e funksioneve të parashikuara në pikën 3 shkronja ñbò të këtij neni.

KREU XII -HETIMI TATIMOR
Neni 105 - Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor
1. Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.
2. Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:
a) mbledhjen e informacionit tatimor;
b) hetimin tatimor;
c) zbatimin e masave shtrënguese;
ç) marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.
3. Punonjësit e njësive të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
4. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi.
5. Detyrat dhe funksionet e drejtorisë së hetimit tatimor, në zbatim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe drejtorët e hetimit tatimor në drejtoritë rajonale tatimore emërohen nga Ministri i Financave.

B. Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në republikën e Shqipërisëò i ndryshuar:

KREU XII - HETIMI TATIMOR

105. Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor

105.1 Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara, hetimi dhe zbatimi në përbërje të administratës tatimore qendrore, që kanë funksion parësor mbledhjen e informacionit tatimor, hetimin e rasteve tatimore, zbatimin e masave shtrënguese, marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.

Misioni dhe objektivat e njësive të hetimit tatimor përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe kryerjes së detyrave të tyre janë: Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i shkeljeve penale tatimore nëpërmjet kryerjes së veprime hetimore për rastet e dyshuara të shkeljes së Kodit Penal në fushën e tatimeve dhe taksave, duke kryer veprimet procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në përputhje me kompetencat që kanë sipas legjislacionit të fushës ñPër organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësoreò, si dhe bashkërendimin e punës me Prokurorinë për ndjekjen e hetimit;

Mbledhja, përpunimi dhe shkëmbimi i informacionit mbi zbatimin e legjislacionit tatimor, si dhe në përputhje me ligjin ñPër procedurat tatimore në RSHò me qëllim zbulimin e shkeljeve penale në fushën e tatimeve dhe taksave, të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë;

Mbledhja, përpunimi dhe shkëmbimi i informacionit për sa u përket çështjeve në fushën e pastrimit të parave të lidhura me çështjet tatimore, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

Zbatimi i masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin tatimor në bashkëpunim me strukturat përkatëse të mbledhjes së borxhit tatimor, me qëllim mbledhjen e tatimeve dhe taksave të papaguara;

Marrjen dhe aplikimin e masave (dënimeve) administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore dhe në këtë udhëzim, që kanë të bëjnë me verifikimin dhe konstatimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomiko-tregtare pa u regjistruar, mbajtjen, transportimin përdorimin dhe tregtimin e mallrave pa dokumentacionin e duhur tatimor, punonjës të padeklaruar në organin tatimor etj., pa u kufizuar vetëm në to.

105.2 Punonjësit e strukturës së hetimit tatimor, gëzojnë atributet e policisë gjyqësore në përputhje me përcaktimet në ligjin ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësoreò dhe në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

105.3 Punonjësit e strukturës së hetimit tatimor pajisen me armë, në përputhje me ligjin e fushës ñPër armëtò. Miratimi i lejes për mbajtjen e armës jepet nga Ministria e Brendshme, pas autorizimit të ministrit të Financave.

105.4 Strukturat e hetimit tatimor në përputhje me strukturën organizative të administratës tatimore qendrore dhe në zbatim të nenit 16 të ligjit dhe pikës 16 të këtij udhëzimi janë të organizuara në Drejtori të Hetimit Tatimor në nivel qendror pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe në nivel rajonal pranë Drejtorive Rajonale Tatimore. Në nivel qendror, Drejtoria e Hetimit Tatimor është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në nivel rajonal, Drejtoritë e Hetimit Tatimor janë përkatësisht tre të tilla: Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror që kryen funksionet e saj pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor që kryen funksionet e saj pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier; Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Verior që kryen funksionet e saj pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër; Drejtoritë e hetimit tatimor në rajone mbulojnë pjesë të caktuara të territorit të vendit siç është përcaktuar në strukturën organizative dhe organigramën e administratës tatimore qendrore. Ato ushtrojnë funksionet e tyre dhe kryejnë detyrat e përcaktuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, në përputhje

me rregulloren e brendshme të administratës tatimore qendrore, si dhe me manualin e hetimit tatimor.

105.5 Drejtori i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve drejton gjithë veprimtarinë e kësaj strukture në nivel qendror dhe në rajone. Ai emërohet nga Ministri i Financave dhe për kryerjen e funksioneve dhe detyrave të strukturave të hetimit tatimor, raporton periodikisht dhe sa herë që i kërkohet te ministri i Financave.

105.5.1 Drejtori i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve drejton dhe organizon punën për menaxhimin e strukturave të hetimit në nivel qendror dhe rajonal. Ai harton dhe miraton te drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve kriteret specifike që duhet të plotësojnë punonjësit e strukturave të hetimit tatimor me qëllim kryerjen e procedurave të rekrutimit, emërimit, largimit dhe marrjen e masave disiplinore në përputhje me Kodin e Punës. Në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për tô punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione.

105.5.2 Për detyrat që lidhen me mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, hetimin e veprave penale dhe pastrimin e parave, menaxhimi i strukturave rajonale të hetimit tatimor, sikurse edhe sistemi i raportimit, organizohen në linjë vertikale përkatësisht nga drejtoritë e hetimit tatimor në rajone në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT dhe anasjellas.

105.5.3 Për kryerjen e funksioneve që lidhen me zbatimin e masave shtrënguese dhe kryerjen e verifikimeve dhe aplikimin e dënimeve për kundërvajtjet administrative, strukturat e hetimit në rajone bashkërendojnë punën me strukturat dhe funksionet e tjera operacionale rajonale. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton rregulloren e bashkërendimit të punës ndërmjet strukturave të zbatimit në rajone dhe strukturave të drejtorive rajonale tatimore.

105.5.4 Qarkullimi i informacionit të klasifikuar, i raporteve, të dhënave dhe dokumentacionit që ka lidhje me hetimin e veprave penale në fushën tatimore, bëhet duke zbatuar dispozitat e legjislacionit të fushës në fuqi. Drejtoria e hetimit tatimor në DPT dhe drejtoritë e hetimit tatimor në Rajone, krijojnë arkivin e të dhënave të klasifikuara, si dhe zbatojnë protokollin e veçantë me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor. Drejtori i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, merr masat për ngritjen e kartotekës dhe pajisjen me vulën përkatëse sipas përgjegjësisë ligjore.

C. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò

1. Drejtoria e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është përgjegjëse për drejtimin në mënyrë të unifikuar të strukturave të hetimit tatimor. Drejtoria e Hetimit Tatimor varet nga zëvendësdrejtori i Përgjithshëm Operacional dhe përgjigjet para drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për të gjithë veprimtarinë e strukturave të hetimit tatimor.

2. Drejtoria e Hetimit Tatimor ka detyrë:

a) të parandalojë, zbulojë, dokumentojë e ndërpresë veprimtarinë kriminale në fushën e tatimeve dhe të taksave, si dhe të bëjë hetimin paraprak të veprave penale, që parashikohen në nenin 131 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, dhe në nenet 180-182 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Hetimi paraprak kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;

b) të bëjë rekomandim për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, për marrjen e masave në mbrojtje të sistemit tatimor nga mashtrimet, evazioni fiskal dhe veprimtaria kriminale;

c) të mbledhë, përpunojë, ruajë, analizojë, shfrytëzojë dhe shpërndajë informacionin për shkeljet e dyshuara, të mundshme ose faktike, në fushën e tatimeve dhe të taksave nga subjektet tatimpaguese. Mbledhja, dokumentimi, ruajtja e shfrytëzimi i informacionit bëhen në përputhje me rregullat e miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, duke zbatuar rregullat e ruajtjes së sekretit;
ç) të marrë të dhëna nga burime legale ose nga bashkëpunimi i fshehtë me individë. Bashkëpunimi i fshehtë me individë, shtetas shqiptarë apo të huaj, bëhet kurdoherë me marrëveshje, në bazë të vullnetit të lirë, pa shpërblim ose me shpërblim, duke ruajtur, kurdoherë, sekretin e marrëveshjes dhe të informacionit;
d) të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, njësinë e pastrimit të parave, Policinë e Shtetit dhe shërbimet e tjera inteligjente, duke shkëmbyer informacione, duke dhënë ose duke marrë ekspertiza të kualifikuara, në funksion të zbulimit të krimeve në fushën e tatimeve, pastrimit të parave etj. Për këtë ajo cakton punonjës të specializuar, për të bashkërenduar punën me këto institucione.
3. Punonjës të autorizuar të Drejtorisë së Hetimit Tatimor kanë të drejtë të thërrasin për të pyetur përfaqësues të subjektit tatimpagues, dëshmitarë ose shtetas të tjerë, që kanë dijeni për vepra penale në fushën e tatimeve dhe të taksave. Këta punonjës mund të këqyrin objektet ku ndodhen dokumentet dhe mallrat, që shërbejnë si burim prove për hetim, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe duke hartuar dokumentet e duhura, që parashikon ky kod.
4. Punonjësit e njësive të hetimit tatimor për gjurmimin dhe hetimin e veprave penale, fiksimin dhe dokumentimin e provave, përdorin mjete teknike dhe elektronike, të posaçme. Llojet e mjeteve dhe rregullat e përdorimit të tyre përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
5. Drejtuesit e strukturave të tjera, brenda sektorit tatimor, bashkëveprojnë me Drejtorinë e Hetimit Tatimor, duke dërguar atje materiale dhe informacione për subjekte të veçanta tatimpaguese, për të cilat dyshohet se mund të kryejnë ose kanë kryer evazion fiskal ose mashtrim tatimor.
6. Fondi për shpërblimin e burimeve njerëzore me të cilët ka marrëveshje për bashkëpunim të fshehtë, caktohet zë më vete në buxhetin vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Rregullat dhe masat e shpërblimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që deri më 30.5.2009, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimi

D. Rregullores Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017:

DREJTORIA E HETIMIT TATIMOR
Neni 138 -Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor
Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimin, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal, të kundërvajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.
Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore; 1. Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor: a) mbledhjen dhe analizën e informacionit; b) hetimin tatimor; c) zbatimin e masave shtrënguese; d) marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore. Punonjësit e hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
Neni 139 -Organizimi dhe funksionimi i Hetimit Tatimor

Hetimi Tatimor është i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe funksionon si vijon: - Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT; - Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Verior; - Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror; - Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor.
Për zbatimin e detyrave të tyre funksionale sektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT dhe Drejtorët e Hetimit Tatimor në Rajone raportojnë tek Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT. Sektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Rajone raportojnë tek Drejtori i Hetimit Tatimor në Rajon dhe sektorët përkatës në DPT. Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT, ka në përbërje të saj sektorët e mëposhtëm: - Sektori i Analizës; - Sektori i Hetimit; - Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave; - Sektori i Zbatimit (Task ï Force).

Neni 140- *Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor*

1. Siguron funksionimin normal të gjithë strukturës së Hetimit Tatimor, nga qendra në rajone, në mënyrë që çdo punonjës të njohë dhe të zbatoj detyrat e tij funksionale;
2. Përcakton prioritetet e hetimit tatimor bazuar në strategjitë e përcaktuara nga DPT për realizimin e planit të ardhurave;
3. Jep udhëzime dhe miraton planin operacional vjetor të sektorëve në DPT dhe drejtorive në Rajone;
4. Drejton dhe kontrollon formulimin dhe zbatimin e planeve operacionale, merr raporte lidhur me zbatimin e tyre dhe përgatit informacion përmbledhës për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve dhe Ministrin e Financave;
5. Ofron mbështetje ndaj strukturave të administratës tatimore në funksion të realizimit të planit të ardhurave.
6. Bashkërendon punën për formulimin dhe zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve lidhur me problemet e konstatuara dhe përcaktimin e detyrave për përmirësimin e situatës;
7. Harton dhe miraton te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve kriteret specifike që duhet të plotësojnë punonjësit e strukturave të hetimit tatimor për tu emëruar në detyrë;
8. Propozon tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për tû punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione;
9. Rekomandon programet e trajnimit dhe ia paraqet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, kur raportet e inspektimit konstatojnë mangësi në aftësitë profesionale dhe procedurale të punonjësve;
10. Bashkëpunon me strukturat e tjera si; Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe institucione të tjera të shtetit shqiptar, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit; për parandalimin, zbulimin dhe goditjen e veprimtarive të kundërligjshme, në fushën ekonomiko-financiare;
11. Miraton dhe kontrollon Hetimet e Përgjithshme dhe Parësore të Sektorit të Analizës, Hetimet Penale të Sektorit të Hetimit, të Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Planet Operacionale të Sektorit të Zbatimit në DPT;
12. Kryen vlerësimin e punës të personelit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, propozon shpërblimet financiare sipas performancës së tyre dhe propozon masa disiplinore për ata që nuk zbatojnë detyrat funksionale;
13. Propozon ndryshime në strukturën e hetimit tatimor, bazuar në problematikat e hasura gjatë kontrolleve.
14. Bashkëpunon me Drejtorinë Ligjore në hartimin e Manualit të Hetimit Tatimor si dhe propozon ndryshime për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
15. Miraton formularët, të cilët do të përdoren nga strukturat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor me një relacion shpjegues për përdorimin e tyre.

16. Kontrollon me grup pune veprimtarinë e Drejtorive në rajone dhe përgatit qarkore për problemet e konstatuara, masat e marra dhe detyrat për të ardhmen.
17. Shpërndan dhe kontrollon korrespondencën e ardhur nga Institucionet e tjera shtetërore sipas përkatësisë, në sektorët e hetimit në DPT ose Drejtoritë në rajone, si dhe zbatimin e afateve të trajtimit të saj.
18. Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor duhet të informojë dhe përgatisë në mënyrë periodike, materialet që duhen publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 141 Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Analizës në DPT

Neni 142 Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Analizës në DPT

Neni 143 Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit në DPT

Neni 144 Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Hetimit në DPT

Neni 145 Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave

Neni 146 Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave

Neni 147 Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Zbatimit (Task- Forcë)

Neni 148 Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Zyrës në Sektorin e Zbatimit (Task-Forcë)

Neni 149 Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Zyrës në Sektorin e Zbatimit (Task- Forcë) në DPT

Neni 150 Përgjegjësitë dhe detyrat e Zyrës së Monitorimit dhe Koordinimit në Sektorin e Zbatimit

Neni 151 Ndjekja e denoncimeve që vijnë në DPT Denoncimet e ardhura ndiqen nga një inspektor i Zyrë së Monitorimit, që caktohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Zbatimit.

Neni 152 Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të kartotekës

Neni 153 Krijimi Dokumentit të Klasifikuar

Neni 159 Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorive të Hetimit Tatimor në Rajone

Neni 160*Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Hetimit Tatimor në Rajon*

1. Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Rajon emërohet nga Ministri i Financave, merr detyra dhe i raporton Drejtorit të Hetimit Tatimor në DPT dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me kërkesë të këtij të fundit;
2. Drejton dhe kontrollon punën e sektorëve të Analizës, Hetimit dhe Zbatimit;
3. Përcjell për miratim tek Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT planet mujore dhe vjetore operacionale të Drejtorisë së Hetimit në Rajon si dhe ndjek zbatimin e tyre.
4. Drejton punën për formulimin, përhapjen dhe zbatimin e udhëzimeve lidhur me shërbimet e analizës, hetimit dhe zbatimit;
5. Studion dhe shpërndan korrespondencën sipas sektorëve duke i orientuar ata sipas problematikave të konstatuara;
6. Njofton zyrtarisht Drejtoritë Rajonale Tatimore për fillimin e hetimit penal nga prokuroria për subjekte të juridiksionit të tyre;
7. Bashkërendon punën midis Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Rajon dhe zyrat e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore të juridiksionit që mbulon Drejtoria e Hetimit Tatimor në Rajon;
8. I dërgon Prokurorive të Rretheve Gjyqësore listën e Oficerëve të Policisë Gjyqësore me të cilët do të bashkëpunohet;
9. Bashkërendon punën me strukturat e tjera ligj zbatuese, me qëllim shkëmbimin e informacionit, realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe forcimin e luftës kundër krimit financiar;
10. Mbështet funksionet e tjera të administratës tatimore rajonale për zbatimin e masave shtrënguese të Drejtorive Rajonale Tatimore;

11. Miraton hetimet parësore në përputhje me përcaktimet në manualet përkatëse të Hetimit Tatimor;
12. Kryen vlerësimin vjetor dhe periodik të punës për përgjegjësit e sektorëve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Rajon dhe miraton vlerësimet vjetore e periodike për punonjësit e tjerë;
13. Organizon dhe kontrollon zbatimin e rregullave për administrimin e informacionit të klasifikuar dhe punën e punonjësit të kartotekës për ruajtjen e këtij informacioni;
14. Nxjerr urdhra dhe programe pune për strukturat vartëse në përputhje me kompetencat e tyre sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
15. Firmos prezencën në punë për personelin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Rajon.
Neni 161 Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Analizës në Drejtoritë e Hetimit Tatimor në Rajon
Neni 163 Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit në Rajon
Neni 164 Detyrat e Inspektorit të Hetimit në Rajon
Neni 166 Zyra e Koordinimit në Sektorin e Zbatimit në Rajone
Neni 167 Zyra e Zbatimit dhe Inspektori i Zbatimit në Rajon

E. Manualit i Hetimit Tatimor dhe Manuali i Verifikimit dhe Koordinimit në Teren miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 19/2, datë 28.04.2020.
Hetimi Tatimor është organizuar në nivel qendror në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si më poshtë:

- Sektori i Hetimit Tatimor;
- Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës;

Organizimi i strukturës organizative të Drejtorisë së Hetimit Tatimor. Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron funksionet e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.Për zbatimin e detyrave të tyre funksionale Sektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, raportojnë tek Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT.Drejtori i Hetimit në DPT, duhet të angazhohet për vlerësimin e punës dhe performancës së personelit.

Për sa më sipër nga analizimi i legjislacionit të mësipërm në kuadër të strukturës, kompetencave, mënyrës së emërimit dhe ndryshimeve të strukturës, hartimit të rregulloreve dhe detyrave funksionale së konstatohet se:

- Legjislacioni i cituar më sipër nuk ka bashkëveprim të unifikuar midis tyre;
- Ligji i procedurave tatimore nuk ka përputhje në strukturën të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, Drejtoritë e Hetimit të ndarë në tre rajone dhe DRT sepse ligji nuk ka të parashikuar një ndarje të tillë por as dhe riorganizimin e bërë përsëri;
- Udhëzimi i procedurave tatimore ka të përcaktuar organizimin Drejtoritë Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor të cilat tashmë janë shkrirë në bazë të riorganizimit të ri dhe ky udhëzim nuk ka ndryshuar;
- Drejtori i Hetimit vetëm emërohet nga Ministri i Financave e raporton tek ai por ai nuk ka pavarësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sepse në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò, ai varet nga zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm, gjithashtu ai vetëm propozon punonjës për tu punësuar në strukturat e hetimit por nuk ka statusin e vendimmarrjes për ta si dhe nuk është vendimmarrës për gjithë veprimtarinë e kësaj drejtorie;
- Sipas ligjit të procedurave tatimore konstatohet se:
  - Detyrat dhe funksionet e drejtorisë së hetimit tatimor, në zbatim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

- Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe drejtorët e hetimit tatimor në drejtoritë rajonale tatimore emërohen nga Ministri i Financave; të cilat nuk janë realizuarnë zbatim të këtyre kërkesave;
- Rregullorja e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017 nuk është ndryshuar në funksion të ndryshimit të strukturës së Drejtorisë së Hetimit në DPT dhe shkrirjes së Drejtorive të Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor;

Gjatë vitit 2020, bazuar në objektivat strategjikë të hartuara dhe miratuara si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka punuar në funksion të mbledhjes dhe realizimit të ardhurave buxhetore dhe parandalimit të rasteve të evazionit tatimor, bazuar në Manualin e Hetimit Tatimor, Rregulloren ñPër funksionimin e administratës tatimore qendroreò, Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në zbatim të tij, si dhe në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, kanë konsistuar në këto drejtime:

Sektori i Hetimit për periudhën Janar-Dhjetor 2020, ushtron funksionet e tij në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 105, në lidhje me procedurat në administrimin e informacionit dhe analizës së subjekteve tatimpagues mbi bazë risku i cili përcakton se:

- Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore;
- Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:
  - Mbledhjen e informacionit tatimor;
  - Hetimin tatimor;
  - Zbatimin e masave shtrënguese;
  - Marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.

  Detyrat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore. Gjithashtu, punonjësit e hetimit tatimor gjatë kryerjes së detyrave mbështeten edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore si:
- Rregullore e Brendshme, ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017;
- Manualin e Hetimit Tatimor të miratuar me urdhër nr. 19/2 datë 28.04.2020.

Marrja dhe administrimi i informacionit nga ky sektor bëhet nga dy burime:

- **brenda sistemit tatimor;**
- **jashtë sistemit tatimor;**

*Burime nga brenda sistemit tatimor*është burimi kryesor i cili i referohet informacionit që përcillet sipas një periodiciteti të përcaktuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT. Ky informacion mbështetet mbi një bashkësi kriteresh risku të gjeneruara automatikisht nga moduli i riskut po ashtu edhe të përpunuara manualisht. Bashkësia e kritereve përzgjidhet në funksion të kompetencave funksionale që ushtron Drejtoria e Hetimit Tatimor dhe gjithashtu është objekt i vazhdueshëm rishikimi në varësi të ndryshimit të vlerësimit të risqeve, si dhe shtimit të dhënave të disponueshme. *Në këtë drejtim* duhet punuar duhet të mundësohet më shumë propozime për përmirësimin e tyre sepse janë bazë për kryerjen e veprimeve të shpejta dhe të sakta në evidentimin e subjekteve të cilët kanë shkelur legjislacionin tatimor. Megjithëse sipas të dhënave në përfundim të analizave të kryera për disa aktivitete dhe sektorë, në vijim të bashkëpunimit të DHT me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, Sektorin e

Analizës së Riskut, janë përcaktuar disa prej risqeve kryesore dhe frekuenca e tyre sipas sektorëve si dhe propozimi i rregullave të reja që ndihmojnë për të evidentuar më saktë tatimpaguesit me shkelje të legjislacionit tatimor, si:

- Të kryhet një korrelacion i drejtë midis qarkullimit së tatimpaguesit me nr. e punonjësve apo fondin e pagave (përveç sektorit të shërbimit).
- Për aktivitetet në fushën e tregtisë të ndërlidhet llogaria e inventarit në fund të vitit me qarkullimin vjetor. (ka patur raste që inventari të fund të vitit të jetë në vlerë të përafërt me qarkullimin e deklaruar (krijon dyshimin e nën deklarimit të shitjeve).

Kriteret e përcaktuar konsistojnë në:

NR.	KRITERI	LLOJI TATIMIT	PËRSHKRIMI
1	DEBTVAT	TVSH	Rritje e borxhit të TVSH-së.
2	ALLBEDT	Të gjitha	Rritje e borxhit për të gjitha llojet e tatimeve.
3	PITPL	TFTH	Humbje e vazhdueshme e TFTH 2 vite
4	CITPL	TF	Humbje e vazhdueshme e Tatim Fitimit 2 vite
5	PRDECB	TF	Marzhi i fitimit nga TF më i ulët krahasuar me sektorin.
6	TCSALA	TAP	Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga si dhe ñnëndeklariminpër profesion të caktuarò nga mesatarja e sektorit ku operon tatimpaguesi
7	TPLTOB	TVSH	Qarkullim i lartë pagesë e ulët-krahasuar me sektorin
8	TPLTO	TVSH	Qarkullim i lartë pagesë e ulët e TVSH
9	IOCITA	TVSH + TF	Deklarim fitimi në TVSH po humbje në deklaratat e TF krahasuar me sektorin
10	IOCIT	TVSH + TF	Deklarim fitimi në TVSH po humbje në deklaratat e TF krahasuar me veten
11	TPBPR	TVSH	Tatimpaguesit priren të kenë një raport që thuajse barazon blerjet me shitjet
12	TCSALB	TAP	Mos deklarim i pagës reale të punonjësve krahasuar me mesataren e profesionit
13	VAT REF1S	TVSH	Mosdeklarim i saktë i shitjeve. Kryqëzim i numrave serial të faturave.
14	VAT REF2	TVSH	Rritje e kredisë së TVSH-së duke rritur në mënyrë fiktive blerjet.
15	VAT REF3	TVSH	Rritje e kredisë së TVSH-së duke nëndeklaruar shitjet
16	VAT G3S	TVSH	Niptshitës që shesin tek subjektet me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, te çregjistruar.
17	VAT G3B	TVSH	Niptblerës që blejnë tek subjektet me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, te çregjistruar.
18	VAT G2S	TVSH	Niptme status pasiv, kërkesë për çregjistrim, të çregjistruar figurojnë shitës në librat e blerjes tek të tretët.
19	VAT G2B	TVSH	Nipt me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, të çregjistruar që figurojnë blerës në librat e shitjes të tretëve.
20	VAT REF4	TVSH	Importues në dogana por pasivë në tatime

Subjektet tatimpaguesve me risk, vihet në dispozicion nga DMR, pasi përpunohen deklarimet e pasqyrat financiare të deklaruara për vitin ushtrimor paraardhës.

Për vitin 2019 subjektet e administruara përfshinë6176 tatimpagues me nga 2 deri në 6 rregulla të thyera të riskut e cila vijon më tej me procedurat e përzgjedhjes dhe verifikimit që konsistojnë në, ndarjen e subjekteve sipas rregullave të thyera të riskut e xhiros së realizuar e konkretisht :

1. Subjekte që kishin thyer kryesisht kritere risku si më poshtë:

- **VAT G2S** - Nipt-e me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, të çregjistruar që figurojnë shitës në librat e blerjes tek së të tretëve;
- **VAT G2B** - Nipt-e me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, të çregjistruar që figurojnë blerës në librat e shitjes së të tretëve;
- **WHDP** - Ulje e vazhdueshme në deklaratën e Tatimit në Burim për 3 muaj të njëpasnjëshëm (analizohet viti i fundit);
- **TCSALA** - .Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga si dhe ñnën deklarimin për profesion të caktuarò nga mesatarja e sektorit ku operon tatimpaguesi;

Këto subjekte me kriteret e mësipërme të thyera i janë kaluan Sektorit të Monitorimit për verifikime të mëtejshme nga struktura e Verifikimit në Terren sipas Rajoneve përkatëse, ku janë rreth 4000 subjekte

2. Subjekte që kishin thyer kryesisht kritere risku si më poshtë:

- **TPLTO**- Qarkullim i lartë pagesë e ulët e TVSH;
- **VAT REF2**- Rritje e kredisë së TVSH-së duke rritur në mënyrë fiktive blerjet;
- **PRDECB**- Marzhi i fitimit nga TF më i ulët krahasuar me sektorin;

- **TPBPR**- Tatimpaguesit priren të kenë një raport që thuajse barazon blerjet me shitjet.
  Në bazë kritereve të mësipërme është proceduar me ndarjen sipas veprimtarisë së tatimpaguesve dhe kodeve ekonomik përkatës, me fokus sektorët dhe aktivitetet ku nëpërmjet veprimeve të mëtejshme verifikuese dhe analizuese në përpunimin e listës të subjekteve me kritere risku të thyera kanë konsistuar nga:
- Sektori i ndërtimit, gjithsej 453 subjekte dhe janë kryer analizat paraprake për 292 subjekte;
- Sektori i tregtimit të hidrokarbureve, gjithsej 179 subjekte;
- Sektori i tregtimit të kafesë, pije dhe duhan, gjithsej 103 subjekte;
- Subjekte me aktivitet Telekomunikacion, Call Center gjithsej 139 subjekte.

  *Për vitin 2020*subjektet e administruara përfshinë 4230 tatimpagues me nga 4 deri në 9 rregulla të thyera të riskut e cila vijon më tej me procedurat e përzgjedhjes dhe verifikimit që konsistojnë në:

➢ Ndarjen e subjekteve sipas numrit të rregullave të thyera të riskut e xhiros së realizuar e konkretisht konstatohen se janë:

o 134 subjekte, tatimpagues me 7, 8 dhe 9 rregulla të thyera të riskut;
o 507 subjekte, tatimpagues me 6 rregulla të thyera të riskut;
o 1332 subjekte, tatimpagues me 5 rregulla të thyera të riskut;
o 2267 subjekte, tatimpagues me 4 rregulla të thyera të riskut,

këto subjekte me risk kanë aktivitete në një numër të konsiderueshëm të sektorëve dhe janë të pozicionuar sipas kodesh ekonomikë si :

- në fushën e inxhinierisë, dentistëve, juridike, të udhëtimit, nxjerrëse e përpunuese, etj.;
- në fushën e shërbimeve të ndryshme, telekomunikacionit, sportit, arsimit, sigurimit, radios e filmit, ndërmjetësimit, operatorëve turistik etj.;
- në fushën e grumbullimit e përpunimit, prodhimit në disa sektorë, transportit detar e tokësor etj.;
- në fushën e ndërtimit sipas sektorëve përkatës, infrastrukturës, hotelerisë etj.;
- në fushën e tregtimit sipas sektorëve përkatës, me shumicë e pakicë, etj.;

➢ Për përzgjedhjen e aktiviteteve e sektorëve, është mbajtur parasysh plani-operacional 2020, planet e punës mujore, si dhe ecuria e aktiviteteve si pasojë e situatës së krijuar,e konkretisht:

a. Mbi këtë bazë për sektorin e ndërtimit u procedua me ndarjen e filtrimin e subjekteve sipas kodeve ekonomik përkatës dhe në këtë përzgjedhje u morën subjektet me 5 e më shumë rregulla të thyera të riskut, të gjeneruara pas filtrimit sipas kodeve ekonomik të cilët i përkasin sektorit të ndërtimit.Kështunëanalizën dhe problematikat e përgjithshme për përcaktimin e kritereve të thyera me frekuencë më të lartë janësi më poshtë:

- **TPBPR-** Tatimpaguesit priren të kenë një raport që thuajse barazon blerjet me shitjet.
- **TPLTO-** Qarkullim i lartë pagesë e ulët e TVSH.
- **TCSALA-** Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga si dhe ñnëndeklarimin për profesion të caktuarò nga mesatarja e sektorit ku operon tatimpaguesi.
- **PRDECB-** Marzhi i fitimit nga TF më i ulët krahasuar me sektorin.
- **VAT G3B-**Nipt-e blerës që blejnë tek subjektet me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, te çregjistruar.
- **VAT G3S-**Nipt-e shitës që shesin tek subjektet me status pasiv, kërkesë për çregjistrim, te çregjistruar.
- **VAT REF1S-** Mosdeklarim i saktë i shitjeve. Kryqëzim i numrave serial të faturave.
- **VAT REF2-** Rritje e kredisë së TVSH-së duke rritur në mënyrë fiktive blerjet.

  Në bazë të tyre pasi janë përzgjedhur subjektet me numrin më të lartë të rregullave të thyera të riskut dhe xhiro më të lartë dhe verifikimit nëse ndonjë prej subjekteve të listës ishte në

procedure hetimore apo kontrolli nga DRT-të, janë përzgjedhur rreth 200 subjekte të fushës së ndërtimit si dhe problematika kryesore që do të verifikohen;

- Deklaratat e tatim fitimit; norma e ulët e fitimit të deklaruar në krahasim me volumin e të ardhurave të realizuara, si efekt i rritjes fiktive të shpenzimeve (blerjeve) për periudhën;
- Kontrolli i numrit të punonjësve të deklaruar ne listë pagesa, sipas profesioneve specifike në ndërtim, për funksionet që kryejnë ne subjekt; raportin e numrit te punonjësve me volumin e punimeve si dhe duke patur parasysh pagat sipas profesioneve.
- Deklarimet e shitjes-blerjes në rastin e subjekteve gjatë periudhës me status pasiv;
- Transaksionet e kryera në shitblerjen e apartamenteve të banimit nga individët, si në rastet kur transaksioni është kryer njëherësh (vetëm me një faturë tatimore shitje) edhe në rastet kur transaksioni kryhet me këste;
- Dokumentimi i veprimtarisë me nën kontraktorët (nëse ka), ku fshihet fiktiviteti dhe shmangja e pagesës së TVSH, për rastet kur i kryen vetë dhe i faturon fiktivisht me nën kontraktorë;
- Mos shlyerja e detyrimeve tatimore kur tatimpaguesi rezulton me tepricë kreditore apo dhe me fitim;
- Kryerja e veprimeve ndërmjet subjekteve me NIPT- të ndryshëm por me të njëjtin administrator dhe të njëjtën adresë; deklarimet për kryerjen e transaksionit kur është vetë shitës dhe vetë blerës;

b. Nisur nga specifika e aktivitetit në këtë sektor, disa prej subjekteve u verifikuan edhe në lidhje me konsumin e karburantit në drejtim të:

- Pesha specifike që zë karburanti në blerjet totale të shoqërisë;
- Kapaciteti i magazinimit të kësaj sasie (a ka shoqëria sistem magazinimi, cisterna të pozicionuara në bilanc si asete apo të deklaruara si adresë sekondare);
- Administrimi e verifikimi i dokumentacionit të makinerive, pajisjeve, makinave të tonazheve të ndryshme për të parë konsumin maksimal të tyre dhe të kryqëzohet ky informacion me blerjet e shoqërisë (gjatë analizave të mëtejshme paraprake);
- Verifikimi i sasisë së karburantit të deklaruar në fund të vitit (sasi, vlerë), duke e krahasuar me sasitë periodike të blerjeve gjatë vitit duke bërë një krahasim të aftësive magazinuese periodike dhe aftësisë magazinuese të fundit të vitit (duhet të jetë e sistemuar);
- Kreditimin e TVSh-së së karburantit sipas legjislacionit në fuqi si dhe ndarjen sipas kategorive të aktivitetit;

Në vijim u përzgjodhën subjektet rreth 50 subjekte me më shumë rregulla të thyera dhe xhiro më të lartë, pas edhe verifikimit të tyre nëse janë në hetim paraprak apo në proces kontrolli nga DRT përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur veprimtaria e Drejtorisë së Hetimit për vitin 2020 ka konsistuar në këto drejtime:

✓ Analiza paraprake hetimore e tatimpaguesve me risk, mbi bazën e kritereve të thyera të riskut, dhe analizës së sektorëve me prioritet sipas aktiviteteve të përcaktuar në sektorët:

- Ndërtim, Trageti karburanti, artikujsh farmaceutik dhe call center, gjithsej **52** subjekte;
- Trageti karburanti, janë përzgjedhur **190** subjekte;
- Trageti artikujsh farmaceutik, janë përzgjedhur **80** subjekte;
- Ndërtim dhe infrastrukturë, si blerës të mëdhenj karburanti, tregtim gazi. Janë përzgjedhur **202** subjekte;
- Studio kontabiliteti, gjithsej **12** studio me rreth **704** subjekte.
- Përmbarues privatò, Gjithsej **3** subjekte;

✓ Administrimi, ndjekja e kërkesave të ardhura në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, nga institucione të ndryshme apo Prokuroritë, Gjykata, Drejtoritë e Policive, OFL, KLP, etj., brenda afateve. Gjithsej **1580** shkresa.

- ✓ Shkresa të trajtuara sipas ligjit për informacioni e klasifikuar ñSekret Shtetërorò, të thjeshta dhe të klasifikuara (DPPP dhe RAD) **151 total**.

Për sa më sipër duke krahasuar procedurat e njëjta të ndjekura për vitet 2019 dhe 2020, nuk mund të arrijmë në konkluzione të plota nëse ishte i domosdoshëm dhe efektiv ky ndryshim në strukturat e hetimit sepse nuk jepen rezultatet konkretë të aktivitetit dhe se çfarë është arritur megjithatë vërejmë se numri i subjekteve të administruara si tatimpagues është më i lartë për vitin 2020 në krahasim me 2019 kjo për arsye se:

1. Fusha e aktiviteteve ekonomike të analizuara sipas kritereve të riskut për vitin 2019, ka qenë më e madhe krahasuar me vitin 2020, sepse gjatë vitit 2019 në strukturën e DHT ka qenë dhe struktura e Verifikimit në Terren e cila në vitin 2020 si efekt i ndryshimeve të strukturës organizative të DHT ka kaluar si Drejtori më vete;
2. Ndarja dhe përzgjedhja e tatimpaguesve me bazë risku për vitin 2019 është bërë si fillim sipas rregullave të riskut, duke përzgjedhur kritere në funksion të procedurave të punës të sektorëve të veçantë në DHT sepse struktura e Verifikimit në Terren me organizim në 3-Rajone, ka qenë pjesë e DHT dhe më pas procedohej për hetim të tatimpaguesve duke i ndarë sipas sektorëve ekonomik me prioritet dhe rregullave të riskut në funksion të procedurave të mëtejshme hetimore, në zbatim të planeve të punës dhe operacional;
3. Për vitin 2020, përzgjedhja e tatimpaguesve me bazë risku u bë sipas numrit të rregullave të thyera të riskut dhe për kriteret me frekuencë më të lartë, të cilët evidentonin problematikat e konstatuara në sektorët ekonomik e analizuar. Kjo e lidhur dhe me procedurat e mëtejshme hetimore, në funksion të strukturës së re organizative e manualit të punës së DHT;
4. Gjatë vitit 2019 dhe 2020 janë 8 (tete) kritere risku të përdorura të cilët janë të njëjtë për të dy periudhat megjithëse gjatë vitit 2019 në Drejtorinë e Hetimit ishte dhe Sektori i Verifikimit në teren dhe duhet të ishin përdorur edhe kritere më specifike apo teknike për fushën e hetimit;
5. Gjatë vitit 2020 ka patur vështirësi nga reduktimi i punës në një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve dhe sektorëve të ekonomisë si pasojë e pandemisë dhe përqendrim të ekonomisë në sektorë që gjeneronin të ardhura ku kufizimet nga situata e krijuar ishin më të vogla.

- ✓ Denoncime/ankesa.

Gjithashtu trajtim i denoncimeve/ankesave është pjesë e detyrave funksionale të strukturave të hetimit tatimor. Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës ka administruar denoncimet e ardhura në forma të ndryshme në periudhën Janar- 12 Maj 2020, pas kësaj periudhe ky sektor ka kaluar në varësi të Drejtorisë Verifikimit dhe Koordinimit në Teren si pasojë e riorganizimit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të dhënat e të cilave po i paraqesim më poshtë:

Forma e denoncimit	Nr. i denoncimeve të ardhura	Nr. i denoncimeve të trajtuara	Me Penalitet
Platforma Bashkëqeverisjes	41	31	11
E-mail (denoncime@tatime.gov.al)	73	47	14
Telefon-Takim (0800 14 14)	447	217	97
Tableta WhatsApp, Viber 0697073733	29	14	3
TOTAL	**590**	**309**	**125**

Gjatë periudhës Janar- 12 Maj 2020, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor kanë mbërritur nga burime të ndryshme rreth 590 raste denoncimesh prej të cilave janë përfunduar 309e tyre ose 50%si dhe nga denoncimet e trajtuara në fund të kontrolleve të ushtruara janë konstatuar rreth 125 shkelje tatimore.

Për sa më sipër me gjithë punën e bërë në këtë drejtim ajo nuk ka qenë e mjaftueshme sepse për këtë periudhë kanë mbetur pa u përfunduar ose në proces rreth 50% e rasteve të

denoncimeve të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues.

✓ Referime për veprat penale Janar- Dhjetor 2020.
Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Hetimit Tatimor gjithashtu është angazhuar në parandalimin dhe zbulimin e rasteve të evazionit fiskal shkeljet e të cilave kanë përbërë vepër penale dhe janë denoncuar në prokurori. Sipas denoncimeve dhe shkeljeve të konstatuara në numër, vlerë dhe referimit të nenit përkatës të shkeljes po paraqesim tabelën si më poshtë:

Viti 2020

lekë

Nr.	Vepra penale	Neni K P	Nr. Ref	Vlera
1	Krijimi i skemave mashtruese me TVSH	144/a	5	1,087,293,255.00
2	Fshehje e të ardhurave	180	73	1,475,643,381.00
3	Mospagim taksash e tatimesh	181	85	1,937,086,955.00
5	Punësim i paligjshëm	170/a	8	
6	Pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a	16	
7	Të tjera		9	619,383,400.00
8	**Totali**		**196**	**5,119,406,991**

Për sa më sipër Sektori i Hetimit ka referuar në Prokurori 196 raste me vlerë prej 5,119,406,961 lekë.

Viti 2019

lekë

Nr.	Vepra penale	Neni K P	Nr. Ref	Vlera
1	Krijimi i skemave mashtruese me TVSH	144/a	7	804,033,418.00
2	Fshehje e të ardhurave	180	123	8,503,645,009.00
3	Mospagim taksash e tatimesh	181	96	1,471,123,810.00
4	Organizim i Lotarive të palejuara	197	2	
5	Punësim i paligjshëm	170/a	33	
6	Pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a, 182	21	
7	Të tjera		2	
8	**Totali**		**284**	**10,778,802,237**

Referime të veprave penale në prokurori ndër vite



Për sa më sipër Sektori i Hetimit për vitin 2020 ka referuar në prokurori 196 raste me vlerë prej 5,119,406,961 lekë, ndërsa për vitin 2019 ka referuar në prokurori 284 rate më një vlerë prej 10,778,802,237 lekë çka tregon se kemi një rënie të këtyre rasteve në vitin 2019 kjo krahasuar edhe me vitin 2018 ku rënia është akoma më e madhe.
Gjithashtu nga auditimi dhe të dhënat e paraqitura konstatohet se Drejtoria e Hetimit Tatimor ka kryer propozime për vlerësim të situatës financiare dhe propozime për kontroll për vitin 2020 për 296 raste, nga të cilat 144 janë kanë përfunduar dhe kanë rezultuar me gjetje në vlerë prej 494,529,550 lekë (detyrime+ gjoba)ndërsa për 152 rastet e tjera janë në proces ndjekje nga DRT, por nga ana e kësaj drejtorie nuk ka të dhëna se në çfarë faze janë çka tregon se nuk ka një bashkëpunim ndërmjet saj dhe DRT, gjë e cila ngarkon me përgjegjësi DRT dhe drejtorin e Drejtorisë së Hetimit.

Një drejtim tjetër i punës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor është dhe hetimi i pastrimit të parave nga Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave kështu për periudhën Janar ï Dhjetor 2020 konstatohet se:

- Shkresa të trajtuara sipas ligjit për informacioni e klasifikuar ñSekret Shtetërorò ï Periudha Janar ï Dhjetor 2020 janë si më poshtë :
  - Shkresa të marra në total të klasifikuara ï 104
  - Kërkesa për informacion nga institucione të ndryshme ï 13
    - Kthim përgjigjesh nga kërkesat për informacion ï 13

  - Dërgim informacioni ï 91shkresat e dërguara si informacione nga DPPPP, nga të cilat:
    - Kthim përgjigjesh ï 29 shkresa për raste të trajtuara.
- Puna e kryer në total
  - Shkresa të punuara në totalï 151 (shkresa të thjeshta dhe të klasifikuara) ;
  - Shkresa të thjeshta - 105 (shkresat e thjeshta të trajtuara);
  - Shkresa të klasifikuara - 56 (shkresat totale të klasifikuara të punuara);
    - Trajtim shkresa DPPP - 42 (Shkresat e trajtuara dhe dërguara për DPPPP;
    - RAD - 12 (Raportimi i Aktivitetit të Dyshimtë).
- Subjekte/individ të cilët kanë paguar tatimin mbi të ardhurat e padeklaruara dhe të pa trajtuara më parë:

1. Në total raste - 8(tetë).
2. Shuma e deklaruar - 17.270.956 lekë.
3. Paguar në total- 2.519.516 lekë.

- Rastet në hetim

1. Raste në ndjekje / hetim në total - 86 (tetëdhjetë e gjashtë) raste.

- Propozim për kontroll/vlerësim tatimor

1. Propozimet për kontroll tatimor - 22 (njëzet e dy)

Për sa më sipër në përmbledhje të punës bërë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në funksion të mbledhjes së informacionit, përpunimit, analizimit të tij, për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale në fushën e tatim-taksave dhe parandalimin e pastrimit të parave,marrje ne masave shtrënguese dhe monitorimin e tatimpaguesve, për të mundësuar pagimin në mënyrë vullnetare, të detyrimeve tatimore nga ana e tyre konstatohen disa mangësi në drejtim të:

- mosplotësim të organikës me punonjës në pozicionin e përgjegjës sektori dhe inspektor hetimi kështu:
- nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës së bashku me 1 punonjës të këtij sektori,
- nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit së bashku me 4 punonjës të këtij sektori, kur gjithsej janë 9 punonjës ose 45% më pak punonjës së organika
- nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.
- për periudhën në vijim maj 2020 deri më 31.12.2020 konstatohet se:
- nuk është kryer ristrukturimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në afatet e përcaktuara po rreth 2 muaj me vonesë,
- nuk është plotësuar pozicioni i punës i Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor,
- nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës,
- nuk është plotësuar Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të parave me numrin e punonjësve ku konstatohet se nga 3 punonjës ai ka vetëm 1 punonjës;
- Nga Drejtori i Hetimit nuk janë plotësuar kërkesat e udhëzimit për procedurat tatimore në të cilën shprehet se në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tâu përzgjedhur për tâu punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke sjellë që shumë vende pune të jenë të paplotësuara.
- nga analizimi i legjislacionit të Drejtorisë Hetimit Tatimor në kuadër të strukturës, kompetencave, mënyrës së emërimit dhe ndryshimeve të strukturës, hartimit të rregulloreve dhe detyrave funksionale së konstatohet se:
- Legjislacioni i cituar më sipër nuk ka bashkëveprim të unifikuar midis tyre;
- Ligji i procedurave tatimore nuk ka përputhje në strukturën të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, Drejtoritë e Hetimit të ndarë në tre rajone dhe DRT sepse ligji nuk ka të parashikuar një ndarje të tillë por as dhe riorganizimin e bërë përsëri;
- Udhëzimi i procedurave tatimore ka të përcaktuar organizimin Drejtoritë Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor të cilat tashmë janë shkrirë në bazë të riorganizimit të ri dhe ky udhëzim nuk ka ndryshuar;
- Drejtori i Hetimit vetëm emërohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, e raporton tek ai por nuk ka pavarësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sepse në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò, ai varet nga zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm, gjithashtu ai vetëm propozon punonjës për tâu punësuar në strukturat e hetimit, por nuk ka statusin e vendimmarrjes për ta si dhe nuk është vendimmarrës për gjithë veprimtarinë e kësaj drejtorie;
- Sipas ligjit të procedurave tatimore konstatohet se:
- Detyrat dhe funksionet e drejtorisë së hetimit tatimor, në zbatim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

- Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe drejtorët e hetimit tatimor në drejtoritë rajonale tatimore emërohen nga Ministri i Financave; të cilat nuk janë realizuar në zbatim të këtyre kërkesave;
- o Rregullorja e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017 nuk është ndryshuar në funksion të ndryshimit të strukturës së Drejtorisë së Hetimit në DPT dhe shkrirjes së Drejtorive të Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor;
- × duke krahasuar procedurat e njëjta të ndjekura për vitet 2019 dhe 2020, nuk mund të arrijmë në konkluzione të plota nëse ishte i domosdoshëm dhe efektiv ky ndryshim në strukturat e hetimit sepse nuk jepen rezultatet konkretë të aktivitetit dhe se çfarë është arritur, megjithatë vërejmë se numri i subjekteve të administruara si tatimpagues është më i lartë për vitin 2020 në krahasim me 2019 kjo për arsye se:
- o Fusha e aktiviteteve ekonomike të analizuara sipas kritereve të riskut për vitin 2019, ka qenë më e madhe krahasuar me vitin 2020, sepse gjatë vitit 2019 në strukturën e DHT ka qenë dhe struktura e Verifikimit në Terren e cila në vitin 2020 si efekt i ndryshimeve të strukturës organizative të DHT ka kaluar si Drejtori më vete;
- o Ndarja dhe përzgjedhja e tatimpaguesve me bazë risku për vitin 2019 është bërë si fillim sipas rregullave të riskut, duke përzgjedhur kritere në funksion të procedurave të punës të sektorëve të veçantë në DHT sepse struktura e Verifikimit në Terren me organizim në 3-Rajone, ka qenë pjesë e DHT dhe më pas procedohej për hetim të tatimpaguesve duke i ndarë sipas sektorëve ekonomik me prioritet dhe rregullave të riskut në funksion të procedurave të mëtejshme hetimore, në zbatim të planeve të punës dhe operacional;
- o Për vitin 2020, përzgjedhja e tatimpaguesve me bazë risku u bë sipas numrit të rregullave të thyera të riskut dhe për kriteret me frekuencë më të lartë, të cilët evidentonin problematikat e konstatuara në sektorët ekonomik e analizuar. Kjo e lidhur dhe me procedurat e mëtejshme hetimore, në funksion të strukturës së re organizative e manualit të punës së DHT;
- o Gjatë vitit 2019 dhe 2020 janë 8 (tete) kritere risku të përdorura të cilët janë të njëjtë për të dy periudhat megjithëse gjatë vitit 2019 në Drejtorinë e Hetimit ishte dhe Sektori i Verifikimit në teren dhe duhet të ishin përdorur edhe kritere më specifike apo teknike për fushën e hetimit;
- o Gjatë vitit 2020 ka patur vështirësi nga reduktimi i punës në një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve dhe sektorëve të ekonomisë si pasojë e pandemisë dhe përqendrim të ekonomisë në sektorë që gjeneronin të ardhura ku kufizimet nga situata e krijuar ishin më të vogla.
- × kanë mbetur pa u përfunduar ose në proces rreth 50 % e rasteve të denoncimeve të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues
- × Drejtoria e Hetimit Tatimor ka kryer propozime për vlerësim të situatës financiare dhe propozime për kontroll për vitin 2020 për 296 raste, nga të cilat 144 janë kanë përfunduar dhe kanë rezultuar me gjetje në vlerë prej 494,529,550 lekë (detyrime+ gjoba)ndërsa për 152 rastet e tjera janë në proces ndjekje nga DRT, por nga ana e kësaj drejtorie nuk ka të dhëna se në çfarë faze janë çka tregon se nuk ka një bashkëpunim ndërmjet saj dhe DRT, gjë e cila ngarkon me përgjegjësi DRT dhe drejtorin e Drejtorisë së Hetimit.
- × nuk paraqet të dhëna mbi korrespondencat me Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtoritë e DPT si dhe Drejtoritë Rajonale si dhe të dhëna mbi ecurinë e realizimit të kontrollet që janë propozuar nga Drejtoria e Hetimit për DRT;
- × argumentet e dhëna mbi vënien në dispozicion të disa dosjeve subjektesh për të audituar procedurat e ndjekura nga organi tatimor dhe jo dokumentacionin e tatimpaguesit me pretendimet se:

  "Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo

procedural penal, të kundërvajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

Legjislacioni tatimor dhe ai penal përmbajnë dispozita të cilat listojnë të gjitha veprimet e kundërligjshme që përbëjnë shkelje te dispozitave te legjislacionit tatimor, disa prej te cilave përbejnë edhe vepra penale. Për ndjekjen e veprave penale në fushën e tatimeve, Ligji i procedurave tatimore ka krijuar struktura të veçanta të përpunimit të informacionit dhe hetimit të veprave penale. Punonjësit e njësive të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Për informacionin e mbledhur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për tatimpaguesit në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, dokumentimit të shkeljeve, konsiderohen konfidenciale, dhe mos respektimi i këtij detyrimi për administratën konsiderohet si cenim i së drejtës për tatimpaguesin. Gjatë procesit të dokumentimit dhe dërgimit të materialeve procedurale e deri në marrjen e vendimit të formës së prerë të gjykatës, tatimpaguesi prezumohet i pafajshëm si një nga elementët për një proces të rregullt ligjor. Dhënia e informacionit për tatimpaguesit në proces hetimi tatimor cenon këtë parim dhe dëmton emrin e mirë si një vlerësim i përgjithshëm i aktivitetit të biznesit.

Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 25"Nëpunësit dhe punonjësit e Administratës tatimore ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare tetatimpaguesit që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës", neni 31 "Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore"; ku mos respektimi i këtij detyrimi për administratën konsiderohet si cenim i së drejtës për tatimpaguesin.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Bazuar më nenin 35, pika 2, akti themeltar përcakton "Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj"", nuk qëndron sepse:

- ✓ Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi më i lartë i kontrollit është organ i pavarur dhe në veprimtarinë e tij udhëhiqet nga Kushtetuta e Shqipërisë neni 162-165 mbi mënyrën e funksionimit të tij,
- ✓ Ligji 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë;
- ✓ Ligji i Kontrollit të Lartë të Shtetit lejon marrjen e dokumentacionit shtetëror nga institucionet shtetërore si dhe sanksionon në mënyrë të veçantë ruajtjen e kofidencialitetit dhe etikën në punë.

Gjetja Mangësi në funksion të mbledhjes së informacionit, përpunimit, analizimit të tij, për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale në fushën e tatim-taksave dhe parandalimin e pastrimit të parave, marrjen e masave shtrënguese dhe monitorimin e tatimpaguesve, për të mundësuar pagimin në mënyrë vullnetare, të detyrimeve tatimore.

Situata: - Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në kuadër të auditimit të strukturës, kompetencave, mënyrës së emërimit dhe ndryshimeve të strukturës, hartimit të rregulloreve dhe detyrave funksionale së konstatohet se: legjislacioni i veprimtarisë së DHT nuk ka bashkëveprim të unifikuar midis tyre; Ligji i procedurave tatimore nuk ka përputhje në strukturën të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT; Udhëzimi i procedurave tatimore ka të përcaktuar organizimin Drejtoritë Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor të cilat tashmë janë shkrirë në bazë të riorganizimit të ri dhe ky udhëzim nuk ka ndryshuar;

Drejtori i Hetimit vetëm emërohet nga Ministri i Financave dhe raporton tek ai por ai nuk ka pavarësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sepse në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò, ai varet nga zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm, gjithashtu ai vetëm propozon punonjës për tu punësuar në strukturat e hetimit por nuk ka statusin e vendimmarrjes për ta si dhe nuk është vendimmarrës për gjithë veprimtarinë e kësaj drejtorie, sepse sipas ligjit të procedurave tatimore; Rregullorja e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017 nuk është ndryshuar në funksion të ndryshimit të strukturës së Drejtorisë së Hetimit në DPT dhe shkrirjes së Drejtorive të Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor;

- Nga auditimi i rezultateve të veprimtarisë së DHT në përputhje me përgjegjësitë ligjore, për vitet 2019 dhe 2020, nuk mund të arrijmë në konkluzione të plota nëse ishte i domosdoshëm dhe efektiv ky ndryshim në strukturat e hetimit sepse nuk jepen rezultatet konkretë të aktivitetit dhe se çfarë është arritur. Gjithashtu, në lidhje procedurat e ndjekura, Drejtoria e Hetimit Tatimor nuk paraqiti të dhëna mbi korrespondencat me Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtoritë e DPT si dhe Drejtoritë Rajonale si dhe të dhëna mbi ecurinë e realizimit të kontrolleve të propozuara. Kjo e argumentuar me pretendimet e legjislacionit të veprimtarisë së DHT se ñ...*për informacionin e mbledhur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për tatimpaguesit në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, dokumentimit të shkeljeve, konsiderohen konfidenciale, dhe mos respektimi i këtij detyrimi për administratën konsiderohet si cenim i së drejtës për tatimpaguesin si dhe dhënia e informacionit për tatimpaguesit në proces hetimi tatimor cenon këtë parim dhe dëmton emrin e mirë si një vlerësim i përgjithshëm i aktivitetit të biznesit...", etj.,* duke krijuar kështu një kufizim për realizimin e objektivave të auditimit për këtë çështje.
- Drejtoria e Hetimit Tatimor ka kryer propozime për vlerësim të situatës financiare dhe propozime për kontroll për vitin 2020 për 296 raste, nga të cilat 144 janë kanë përfunduar dhe kanë rezultuar me gjetje në vlerë prej 494,530 mijë lekë (detyrime+ gjoba) ndërsa për 152 rastet e tjera janë në proces ndjekje nga DRT, por nga ana e kësaj drejtorie nuk ka të dhëna se në çfarë faze janë çka tregon se nuk ka një bashkëpunim ndërmjet saj dhe DRT, gjë e cila ngarkon me përgjegjësi DRT dhe drejtorin e Drejtorisë së Hetimit.

Konstatohet se në fund të vitit 2020 kanë mbetur pa u përfunduar rreth 50% e rasteve të denoncimeve nga të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues.

-Nga auditimi në Drejtorinë e Hetimit Tatimor konstatohet, mosplotësim i organikës me punonjës në pozicionin e përgjegjës sektori dhe inspektor hetimi kështu: nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës së bashku me 1 punonjës të këtij sektori, nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit së bashku me 4 punonjës të këtij sektori, kur gjithsej janë 9 punonjës ose 45% më pak punonjës së organika, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave. Gjithashtu për periudhën në vijim maj 2020 deri më 31.12.2020 konstatohet se: nuk është kryer ristrukturimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në afatet e përcaktuara po

rreth 2 muaj me vonesë, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës, nuk është plotësuar Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të parave me numrin e punonjësve ku konstatohet se nga 3 punonjës ai ka vetëm 1 punonjës;

Nga Drejtori i Hetimit nuk janë plotësuar kërkesat e udhëzimit për procedurat tatimore në të cilën shprehet se në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për tû punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke sjellë që shumë vende pune të jenë të paplotësuara.

Kriteri: -Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 ñKodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;

-Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar,

-Ligji nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;

-Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;

-Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;

-Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;

-Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësoreò, i ndryshuar; ndryshuar me ligjin nr.25/2019, datë 25.04.2019,

-Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër Informacionin e klasifikuar ñSekret Shtetërorò, i ndryshuar;

-Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 ñPër Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmitò;

-Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 ñPër informacionin e klasifikuar sekret shtetërorò, i ndryshuar;

-VKM nr. 400, datë 22.04.2009 ñPër detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Hetimit Tatimorò;

-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 0.209.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar;

-Udhëzimi nr. 16, datë 03.05.2010 ñPër administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskaleò;

-Manual i Hetimit Tatimor, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.14, datë 13.03.2017, ndryshuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 28, datë 28.06.2018,

-Manuali i Hetimit Tatimor dhe Manuali i Verifikimit dhe Koordinimit në Teren miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.19/2, datë 28.04.2020,

-Rregullores së Bashkëpunimit Midis Funksioneve të Veçanta nr. 41 datë 13.06.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

-Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 22225 datë 16.07.2015 ñPër konstatimin dhe dokumentimin e shkeljeve tatimore, administrative gjatë kontrolleve të ushtruara nga ana e strukturave të Verifikimit në Terren dhe

Hetimit Tatimor (Taks Forcë)ò;
-Rregullore e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017;
-Të tjera akte ligjore, nënligjore, udhëzues dhe rregullatorë për funksionimin dhe drejtimin e punës.

Impakti: Është shumë e rëndësishme marrja e masave, duke parashikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë në funksion të mbledhjes së informacionit, përpunimit, analizimit të tij, për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale në fushën e tatim-taksave.

Shkaku: Mungesë e bashkëveprimit dhe zbatimit të ligjit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: -Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të iniciojë përditësimin e Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñ*Për përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimor*ò, në koherencë me ndryshimet strukturore të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, rritjen e pavarësisë së saj dhe harmonizimin e këtij akti nënligjor me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore.
-Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që Drejtoria e Hetimit Tatimor të përfundojë vlerësimin e situatës financiare të subjekteve të propozuara për kontroll gjatë vitit 2020 për 152 raste nga 296 raste gjithsej të cilat janë në proces ndjekje nga DRT *s*i dhe të përfundojnë analizimin e rreth 50 % të rasteve të denoncimeve të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues.
-Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim më Drejtorinë Juridike të analizojë dhe të japë përgjigje të argumentuar për mos paraqitjen e të dhënave dhe për mos vënien në dispozicion të dosjeve të subjekteve, me qëllimin auditimin e përputhshmërisë ligjore dhe procedurale të ndjekur nga struktura e Hetimit Tatimor, në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të shmangieve fiskale.
-Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH.

Në Drejtorinë e Rimbursimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Regjistri i kërkesave për rimbursimin e TVSH-së sipas sistemit C@TS dhe sistemit Excel të mbajtur manualisht, Lista mujore e rimbursimeve dhe evidenca statistikore mbi rimbursimin e TVSh 12 mujore të DRTVSH-se dërguar për Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit/ Sektori i Analizës dhe Statistikës në DPT, Raport vjetor i DPT për vitin 2020, Raportim mbi gjendjen e stokut të rimbursimit në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit, Shkresat e Drejtorisë së Thesarit Tiranë, Data-base të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

Baza Ligjore

Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar Udhëzimi Nr. 24 datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar,
Ligji Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar,

Udhëzimi Nr. 6 datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar,
Ligji organik, ligji vjetor dhe udhëzimet e Ligjit të Buxhetit,
VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, e ndryshuar,
Urdhri Nr. 2 datë 13.01.2017 për miratimin e rregullores ñPër rimbursimin e TVSh-së mbështetur në analizën e riskutò, të protokolluar me Nr. 939 datë 13.01.2017.
Udhëzimi Nr. 19 datë 3.11.2014 ñPër zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësore për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuarò, i ndryshuar.
Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut.
Manualin për rimbursimin e TVSH-së.
Rimbursimi i TVSH-së: Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.
Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:
Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSh-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
Të kryejë procedurën e rimbursimit të TVSh-së bazuar në analizën e riskut;
Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSHï së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim TVSh-je është bërë:
-nga organizatat jofitimprurëse për TVSh-në e paguar në blerje, për mallra të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit si pjesë e veprimtarisë së tyre bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme;
-nga çdo udhëtar jo i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për blerje mallrash të destinuara për tu transportuar në bagazhin personal të udhëtarëve;
-në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, në bazë të parimit të reciprocitetit për TVSH-në e paguar për blerjet brenda vendit nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre.

Gjate periudhës ushtrimore 2020, pranë DRT-se janë regjistruar **1476 kërkesa** për rimbursim të TVSH-SË nga 1273 kërkesa te regjistruara ne 2019, me vlere totale**21,621, 455 ijë leke** nga 26,252 milion leke ne 2019, ku vetëm 2 kërkesat e TAP ishin ne vlerën 6,494 milion leke.
-Gjithsej **janë pranuar 1,068 kërkesa**, me vlere **15,556 milionleke**. Krahasuar me vitit 2019, numri i kërkesave të pranuara për rivlerësim është rritur me 98 kërkesa më shumë, ndërkohë që vlera e kërkesave të pranuara është ulur me 7,151 milion lekë, kjo pasi në vitin 2019, vetëm 2 kërkesat e TAP ishin ne vlerën 6,494 milion leke,
-**Nuk janë pranuar 408 kërkesa** me vlere **6,065 milionleke** (nga 290 kërkesa ne 2019, me vlere 3,545 milionleke), për mosplotësim te kritereve ligjore.
Konstatohet se, nga **1,068 kërkesa te pranuara,**
-65 kërkesa me vlere **443 milionleke** janë bere nga tatimpagues te klasifikuar si eksportues me Risk Zero, kërkesa e te cilëve duhet te miratohen dhe rimbursohet automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
-580 kërkesa me vlere **7,552 milionleke** janë bere nga tatimpagues te klasifikuar si eksportues, kërkesa e te cilëve duhet te miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;

-423 kërkesa me vlere **7,561 milionleke** janë bere nga tatimpagues te klasifikuar si jo-eksportues, kërkesa e te cilëve duhet te miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, me raport kontrolli.

Kërkesat e rimbursimit, miratimi dhe pagesa e rimbursimit janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2020	
		Nr	Vlere
1	**Kërkesa**	**1476**	**21,621,455**
2	Kërkesa te pranuara	1068	15,556,315
3	Kërkesa të refuzuara	408	6,065,140

(Burimi: Raporte statistikore DPT Punoi: KLSH)

- **Mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2020 në zërin Rimbursim TVSH-je,**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 20120 bazuar ne Ligjin Nr. 88/2019 "Për Buxhetin e Vitit 2020", është njohur me planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, me shkresat nr. 1375 prot., datë 22.01.2020, protokolluar në DPT me nr. 1727 prot., datë 24.01.2020. Për vitin 2020 rimbursimi për TVSH-në bazuar në Ligjin e Buxhetit të vitit 2020 dhe Aktit Normativ nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar, është **programuar në shumën për 21,000,000 mijë** lekë dhe është **realizuar në shumën16,511,532 mijë lekë** duke rezultuar me një mosrealizim për 4,488,468 mijë lekë ose 21,37% më pak kundrejt planit të rimbursimit.

Në mijë lekë

E M E R T I M I	Realizimi Faktik 2019	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Diferenca Fakt Plan	% ndaj Planit
- Rimbursimi i kryer	23,509,456	21,000,000	21,000,000	16,511,532	-4,488,468	-78,63%

Tabela në vijim paraqet realizimin mujor të Rimbursimit të TVSH-së kundrejt planit,

Në mijë lekë

Nr	Periudha	Plani 2020	Realizimi Faktik	Diferenca Plan/Fakt	Diferenca ne %
1	Janar	1,700,000	1,477,273	222,727	87%
2	Shkurt	1,700,000	733,181	966,819	43%
3	Mars	1,700,000	866,587	833,413	51%
4	Prill	1,700,000	1,596,414	103,586	94%
5	Maj	1,700,000	1,247,345	452,655	73%
6	Qershor	1,700,000	1,324,745	375,255	78%
7	Korrik	1,800,000	1,512,015	287,985	84%
8	Gusht	1,800,000	1,400,140	399,860	78%
9	Shtator	1,800,000	1,715,183	84,817	95%
10	Tetor	1,800,000	1,512,147	287,853	84%
11	Nëntor	1,800,000	1,210,777	589,223	67%
12	Dhjetor	1,800,000	1,915,724	-115,724	106%
	Totali	**21,000,000**	**16,511,532**	**4,488,468**	**79%**

Tabela në vijim paraqet realizimin faktit të Rimbursimit të TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale kundrejt planit të buxhetit.

Në mijë lekë

DRT Tatimore	Plani 2020	Realizimi Faktik	Diferenca Plan/Fakt	Diferenca ne %
D. R. T. Berat	400,000	339,840	60,160	85%
D. R. T. Dibër	170,000	623,942	-453,942	367%
D. R. T. Durrës	1,700,000	1,023,624	676,376	60%
D. R. T. Elbasan	360,000	481,247	-121,247	134%

D. R. T. Fier	1,000,000	872,629	127,371	87%
D.R. T. Gjirokaster	140,000	47,279	92,721	34%
D. R. T. Korcë	255,000	344,687	-89,687	135%
D. R. T. Kukës	70,000	49,942	20,058	71%
D. R. T. Lezha	90,000	84,384	5,616	94%
D. R. T. Saranda	85,000	81,898	3,102	96%
D. R. T. Shkodra	350,000	182,602	167,398	52%
D. R. T. Tirana	2,600,000	1,733,021	866,979	67%
D. R. TM	13,400,000	10,415,273	2,984,727	78%
D. R. T. Vlora	380,000	231,161	148,839	61%
Shuma	**21,000,000**	**16,511,532**	**4,488,468**	79%

Konstatohet që, Drejtoritë Rajonale të Dibrës, Elbasanit dhe Korçës kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për rimbursimin shumën totale për 664,877 mijë lekë ose ka tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, si në vijim:

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 453,942 mijë lekë ose në masën 267% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 121,247 mijë lekë ose në masën 34% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 89,687 mijë lekë ose në masën 35% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

Referuar sa më lart, peshën më të madhe të Rimbursimit të TVSH-së, e vë Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën për 10,415,273 mijë lekë ose 63%, të realizimit faktik të Rimbursimit të TVSH-së, Ndërkohë që kjo Drejtori në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton me një realizim të planit në masën 78%.

Grafiku në vijim paraqet peshën që zënë Drejtoritë Rajonale në realizimin faktik të Rimbursimit të TVSH-së,



***Në konkluzion**:* Shpenzimet e Rimbursimeve të TVSH-së, për Drejtoritë Rajonale Dibër, Korçë dhe Elbasan, kanë tejkaluar dukshëm planin e rimbursimeve, veprime këto në kundërshtim me nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror qe zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

- **Tatimpaguesit me peshë të konsiderueshme të Rimbursimit të TVSH-së**

Në totalin e TVSH-së së rimbursuar gjate vitit 2020 në shumën 16,511,532 mijë lekë, shumat më të larta të rimbursimit , në mënyrë analitike pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Shumat me të larta të paguara për rimbursim ne 2020

Në mijë lekë,

NIPT	Tatim Paguesit	Rimbursuar
K	T Albania	4,344,341
L	A A E	1,457,442
K	B pa shpk	614,501
K	A	530,458
J	M	448,401
L	S. h	386,679
K	T A T & M Sh.a	354,975
L	K P M	283,506
L	A lo	241,872
K	B	235,756
K	D e shpk	194,196
L	S t	137,609
L	Df	126,477
L	H s	125,969
J	A sha	117,092
K	F	115,178
L	A o shpk	114,490
L	Sa shpk	113,691
K	R - 04	113,643
L	E h shpk	94,137
Totali		**10,150,411**

(Burimi: DPT)

Referuar sa më lart, konstatohet se, vlerën më të madhe të Rimbursimit të TVSH-së në vitin 2020, e ka tatimpaguesi T Albania, në vlerën totale për 4,344,341 mijë lekë ose sa 26% e totali të përgjithshëm të TVSH-së së Rimbursuar e ndjekur nga subjekti A A E i cili është rimbursuar në vlerën për 1,457,442 mijë lekë ose sa 9% e totali të përgjithshëm të TVSH-së së Rimbursuar.

- **<u>Tatimpagues të rimbursuar me metodën FIFO dhe me Këste</u>**

a. Në periudhën ushtrimore 2020, janë miratuar dhe rimbursuar **1008 kërkesa** te trajtuara sipas metodës FIFO me vlere totale **8,942,910 mijëleke** nga të cilat 864,171 mijë lekë janë rimbursuar nëpërmjet metodës së kompensimit dhe 8,941,910 mijë lekë janë Rimbursuar me Thesar. Aneksi nr. 1, Për sa më lart, te gjitha kërkesat FIFO te miratuara për periudhën janar-dhjetor 2020 janë rimbursuar duke bere qe mos te kemi stok te kërkesave nën 150 milion leke ne fund te vitit 2020. Tabela në vijim paraqet kërkesat e aprovuara për Rimbursimin e TVSH-së sipas Drejtorive Rajonale për vitin 2020,

Drejtoria Tatimore	Kerkesa të Aprovuara	Vlera e Miratuar/ mijë lekë
BERAT	52	339,840
DIBER	19	623,942
DURRES	245	1,023,623
ELBASAN	42	480,043
FIER	101	872,629
GJIROKASTER	16	47,279
KORCE	61	344,687
KUKES	2	49,942
LEZHE	11	84,384
SARANDE	15	81,898
SHKODER	41	182,602
TIRANE	176	1,281,935
DTM	169	3,299,917
VLORE	58	229,186
TOTALI	**1008**	**8,941,910**

b. Pagesa e tatimpaguesve **jo FIFO** ka vijuar duke rimbursuar me këste ne total**7,565,894 mijëlekë** për periudhën Janar-Dhjetor 2020.Konstatohet se, pjesa me e madhe vlerës se rimbursuar rreth 63 % është dhënë për tatimpaguesit e Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj ndikuar nga tatimpaguesit e trajtuar jo FIFO.

Ne lidhje me **kohën e procesimit** konstatohet se, koha mesatare e miratimit te kërkesës për rimbursim te TVSH-se, nga data e kërkesës deri në datën miratimit te kërkesës, për periudhën Janar - Dhjetor 2020, koha mesatare e procesimit ka qene **70 ditë**, ku **27 %** te kërkesave janë procesuar brenda **30 ditëve** dhe rreth **59 %** e kërkesave janë procesuar brenda afatit **60-ditore** dhe **13 %** e kërkesave janë procesuar mbi **120 dite** dhe kryesisht arsyeja ka qene mospagimi i detyrimeve për ñ1900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësoreò, nga ana e tatimpaguesve. Tabela në vijim paraqet kohën mesatare të procesimit të Rimbursimit të TVSH-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat të cilat kanë kaluar afatin e procesimit mbi 120 ditë.

Dite	<31	31-60	61-90	91-120	>120	Total
Numer	269	325	190	94	130	**1008**
%	27	32	19	9	13	**100**

Referuar sa më lart, koha mesatare e procesimit me pagesën e Rimbursimit të TVSH-së është 51 ditë nga data e miratimit të kërkesës nga Tatim Paguesi. Aneksi 1, bashkëngjitur paraqet listën e pagesave të Rimbursimit të TVSH-së me metodën FIFO dhe pagesat me këste (Jo FIFO)

Mbi marrëveshjet për pagesën me këste të TVSH-së, të miratuar për rimbursim në zbatim të VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste te Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, te miratuar për rimbursim"

DPT, në mbështetje te ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008, "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe te VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste te Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, te miratuar për rimbursim" ku citohet se: *"Në rastet kur tatimpaguesit realizojnë investime në vlera të larta apo kanë blerje mallrash/shërbimesh me TVSH, të cilat krijojnë tepricë të lartë kreditore të TVSH-së për t'u rimbursuar, administrata tatimore kërkon nga tatimpaguesi dhe, pasi merr dakordësinë e tij me shkrim, mund të lidhë marrëveshje për pagesë me këste të shumës së miratuar për t'u rimbursuar*

- Administrata tatimore i propozon tatimpaguesit lidhjen e një marrëveshjeje për pagesën me këste të shumës së miratuar për t'u rimbursuar në rastet e mëposhtme: a) shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar është mbi 150.000.000 lekë", ka miratuar Urdhrin, Nr 20, date 02.03.2020, për miratimin e formatit te projekt-marrëveshjes "Për pagesën me këste te tatimit mbi vlerën e shtuar, te miratuar për rimbursim". Lidhur me zbatimin e urdhrit të lart cituar, u kërkuan dhe u shqyrtuan praktikat e kërkesave të miratuara, për të cilat organi tatimor ka negociuar me tatim paguesit me qëllim lidhjen e Akt Marrëveshje. Tabela në vijim paraqet marrëveshjet e lidhura nga DPT me Tatimpaguesit në periudhën 2020.

NIPT	Subjekti	Data e miratimit	Vlera e Marreveshjes	Nr. Keste	Periudha e Likujdimit	Vlera e Kestit
J	A sha	21.08.2020	234,184	10	Gusht 2020-Maj 2021	23,418
L	A shpk	25/09/2020	178,642	10	Shtator 2020-Qershor 2021	17,864
L	A e	29.05.2020	957,442	5	Maj-Shtator 2020	191,488
K	B shpk	30.07.2020	2,116,508	24	Korrik 2020-Qershor 20200	3/100,000 mijë lekë, ndërsa këstet e tjera

						nga 86,500 mijë lekë
L	H s	26.08.2020	251,937	10	Gusht 2020-Maj	25,194
L	K shpk	29.12.2020	193,523	10	Dhjetor 2020-Shtator 2021	19,352

1. A me NIPT L, nënshkruar me date 29.05.2020, Nr.9104 Prot., për shumen e mbetur **957,442 mijë leke**, për tu rimbursuar me 5 këste, nga **191,488 mijë leke** secili. Kësti i pare filloi ne Maj 2020 dhe kësti i fundit u dha ne Shtator 2020.

Nga auditimi i pagesave referuar databazës së Thesarit, u konstatua se, DPT, ka kryer në kohë pagesën e kësteve për periudhën 2020.

2. BShpk, me NIPT K, nënshkruar me date 30.07.2020, për te dyja kërkesat e miratuara dhe pa likuiduar ne shumen gjithsej **2,116,508 mijë leke,** për tu rimbursuar me 24 këste, nga **100,000 mijë leke** 3 këstet e para dhe nga **86,500 mijë leke** këstet e tjera. Kësti i pare filloi ne Korrik 2020 dhe kësti i fundit do jepet ne Qershor 2022.

3. A Shame NIPT J, nënshkruar me date 21.08.2020, Nr. 8066/5 Prot., për shumen **234,184 mijë leke**, për tu rimbursuar me 10 këste, nga **23,418 mijë leke** secili. Kësti i pare filloi ne Gusht 2020 dhe kësti i fundit do jepet ne Maj 2021.

Nga auditimi i pagesave referuar data bazës së Thesarit, u konstatua se, DPT, ka kryer në kohë pagesën e kësteve për periudhën Gusht- Dhjetor 2020.

4. H S me NIPT L, nënshkruar me date 26.08.2020, për të dyja kërkesat e miratuara dhe pa likuiduar ne shumen gjithsej **251,937 mijë leke**, për tu rimbursuar me 10 këste, nga **25,194 mijë lekë** secili. Kësti i pare filloi ne Gusht 2020 dhe kësti i fundit do jepet ne Maj 2021.

Nga auditimi i pagesave referuar data bazës së Thesarit, u konstatua se, DPT, ka kryer në kohë pagesën e kësteve për periudhën Gusht- Dhjetor 2020.

5. A shpkme NIPT L, nënshkruar me date 25.09.2020, për shumen **178,642 mijë leke**, për tu rimbursuar me 10 këste, nga **17,864 mijë leke** secili. Kësti i pare filloi ne Shtator 2020 dhe kësti i fundit do jepet ne Qershor 2021.

Nga auditimi i pagesave referuar data bazës së Thesarit, u konstatua se, DPT, ka kryer në kohë pagesën e kësteve për periudhën Gusht- Dhjetor 2020.

6. K Shpk me NIPT L, nënshkruar me date 29.12.2020, për shumen **193,523 mijë leke**, për tu rimbursuar me 10 këste, nga **19,352 mijë leke** secili. Kësti i pare filloi ne Dhjetor 2020 dhe kësti i fundit do jepet ne Shtator 2021.

Nga auditimi i pagesave referuar data bazës së Thesarit, u konstatua se, DPT, ka kryer në kohë pagesën e kësteve për periudhën Dhjetor 2020.

6. Lidhur me **T Albania**, subjekti ka propozuar te lidhim marrëveshje ku te llogariten edhe interesat, gjë qe është jashtë trajtimit te VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste te tatimit mbi vlerën e shtuar, te miratuar për rimbursim".

Gjate vitit 2020, TAP është rimbursuar çdo muaj me këste ku vlera totale e pagesave të kryera nëpërmjet Thesarit është 4,344,341 mijë lekë.

Konstatohet se DPT ka njoftuar në rrugë elektronike Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për marrëveshjet e lidhura.

- **<u>Mbi stokun e rimbursimit të TVSH-së</u>**

a.Stoku i rimbursimit të TVSH-së është vlera e TVSH-së e aprovuar për tu rimbursuar nga administrata tatimore, në pritje për tu kaluar në degën e thesarit. Në evidencën e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së dhe për Drejtorinë e të Ardhurave dhe Kontabilitetit, për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSh-së në bazë vjetore**, gjendja e stokut** te rimbursimit në **31.12.2020** është në shumën **9,797,309 mijë lekë.**

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së me shkresën Nr.3870 prot, datë 02.03.2020 në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabiliteti për datën 31.12.2020 ka raportuar gjendjen e stokut të rimbursimit, shumën 9,797,309 mijë lekë. Ky raportim në këtë Drejtori dhe në MFE, është në zbatim të udhëzimit nr. 8, të MFE Për përgatitjen e pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes qendrore.

Tabela në vijim paraqet stokun e Rimbursimit të TVSH-së, me datë 31.12.2020.

(Në mije lekë)

NIPT	Subjekti	Lloji i aktivitetit	Stoku 31.12.2020	Stoku 31.12.2020
L	H	investim/HEC	125,969	1%
K	B	Nxjerrja e hidrokarbure, etj.	1,557,007	16%
J	A sha	Sherbime ne administrimin e sherbimeve ajrore, etj	117,092	1%
L	A shpk	Rritje dhe tregtim peshku	107,185	1%
L	K shpk	Kultivimi i peshkut, kulturat ujore	174,170	2%
K	T	Gazsjellësi TAP	7,117,301	73%
K	D	investim/HEC	99,357	1%
L	P E	investim/HEC	22,579	0%
K	K sha	Prodhim dhe tregtim i hekurit	476,650	5%
	TOTAL		**9,797,309**	**100%**

(Burimi: DPT)

Tabela në vijim paraqet gjendjen e stokut të detyrimeve të prapambetura, sipas formulës ku: Stoku në fund të periudhës = Stoku në çelje+Kërkesat periudhësï Kompensime-Rimbursimet e kryera.

NIPT	Subjekti	Stoku me 01.01.2020	Kërkesa miratuar në vitin 2020	Shuma kompesuar	Paguar Thesar	Stoku me 31.12.2020
		1	**2**	**3**	**4**	**5=1+2-3-4**
L	K	21,975			21,975	0
L	Al		187,603	1,192	186,410	0
J	A sha		237,490	3,305	117,092	117,093
L	A shpk		178,642	-	71,457	107,185
L	A	1,457,442		-	1,457,442	0
K	B shpk		822,943	-	614,501	208,442
K	B shpk		1,348,564			1,348,564
K	D shpk		293,553	-	194,196	99,357
L	H	185,312		-	59,343	125,969
L	H	66,625			66,625	0
L	K shpk		194,852	1,329	19,352	174,170
J	M		118,559	-	118,559	0
J	M		143,478	-	143,478	0
K	T albania		173,097	-	173,097	0
K	T albania	2,157,262			2,157,262	0
K	T albania	1,067,080			1,067,080	0
K	T albania	2,030,044			1,120,000	910,044
K	T albania	4,265,650		-		4,265,650
K	T albania		1,989,978	48,372		1,941,606
K	K sha		476,650	-		476,650
L	P e		22,578	-		22,578
		11,251,390	**6,187,986**	**54,198**	**7,587,869**	**9,797,309**

-Nga auditimi u konstatua se, nëse do te referohemi *sistemit C@TS në lidhje me të dhënat sipas tabelës së mësipërme pra nëse do të kërkojmë një kartelë analitike të subjektit ku të paraqitet gjendja e stokut të rimbursimit të TVSH-së, vlera e miratuar për rimbursimin e tvsh-së, pagesat si dhe gjendja në fund e llogarisë së tatimpaguesit, kjo e dhënë nuk sigurohet nga sistemi C@TS, pasi në momentin e miratimit përfundimtar të kërkesës për rimbursim, kjo shumë del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim*. Në vijim të gjithë të dhënat në lidhje subjektet të cilëve i është miratuar kërkesa për rimbursimin

e TVSH-së mbahen nga jashtë në exel nga Drejtori i Rimbursimit të TVSH-së dhe inspektorët përkatës.
Nga auditimi u konstatua se, DPT në mbyllje të periudhës ushtrimore **nuk mban akte rakordimi**me tatimpaguesit në lidhje me **detyrimin e konstatuar për rimbursimin e tvsh-së** në mbyllje të periudhës ushtrimoreme qëllim vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiarë, në zbatim të udhëzimit të MFE, nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare të NJQPò pikës *3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 30 ku citohet:Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve.*

Me qëllim verifikimin e saktësisë së veprimeve të kryera në lidhje me gjendjen e stokut të rimbursimit të tvsh-së, u verifikua praktika e rimbursimit të tatimpaguesit
1.H shpk me NIPT L, kategoria Jo Eksportues, e cila përmban:
-Kërkesën për rimbursimin e tvsh-së për periudhën qershor 2018-dhjetor 2018, protokolluar ne DPT me nr. 3137/2, datë 22.02.2019 të tatimpaguesit në vlerën për **189,780 mijë lekë.**
-Aktin e evidentimit fillestar të hartuar nga inspektori i DPT-së, datë 26.02.2020, ku evidentohet se shuma e kërkuar përputhet me të dhënat e sistemit.
-Njoftimin për pranimin e kërkesës për rimbursimin e tvsh-së, drejtuar tatimpaguesit me shkresën nr. 3137/1, datë 27.02.2019 të DPT-së.
-Shkresën e Drejtorit të Drejtorisë së Sektorit të analizës së riskut nr. 1636/432, datë 28.02.2019 me subjekt Kthim përgjigje, në lidhje me situatën dhe pozicionin e subjektit pas analizës së riskut.
-Shkresën e Drejtorit të Rimbursimit, nr. 3137/4, datë 06.03.2019 me subjekt óDërgohet shkresë për veprimô drejtuar Drejtorisë Tatimore Tiranë me qëllim, kontrollin në vend referuar kërkesës së tatimpaguesit.
-Shkresa nr. 3324/8, datë 30.05.2019 të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me subjekt óDërgohet raporti i kontrollit të kryer për tatimpaguesin H S shpk, prot në DPT, me nr. 3137/5, datë 03.06.20219, ku konstatohet se, sipas kontrollit vlera e miratuar për rimbursim është **185,312 mijë lekë**.
-Në lidhje me këtë vlerë të miratuar, nëpërmjet shkresës DRTvsh-së, ka njoftuar tatimpaguesit H S shpk.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, DTM, me shkresën nr. 10758/5 datë **07.11.2019, i** është drejtuar AKBN dhe për dijeni dhe DPT-së dhe H S shpk, me shkresën me subjekt óDërgim informacioniô, ku kërkohet informacion mbi rastet kur janë kryer punime ndërtimi në sektorin energjitik pa leje apo në tejkalim të lejes përkatëse.
Me datë **11.06.2020**, dhe shkresë nr. 2965/1, prot në DPT me nr. 10652, datë 16.06.2020, me subjekt ó Dërgim informacioni. DMT, i ka përcjellë DPT-së, dokumentacionin e ardhur nga AKBN. Marrëveshja për pagesën me këste të TVSh-së të miratuar për rimbursim me tatimpaguesin H S shpk, lidhur më datë **10.08.2020** me nr. Prot 15838, në vlerën për **251,937 mijë lekë**, duke përfshirë edhe kërkesën e miratuar për rimbursimin e TVSh-së në vlerën e mbetur nga 2019 për 66,625 pas procedurave përkatëse.
2. P E shpk. Nga auditimi i praktikës së rimbursimit të TVSh-së për tatimpaguesin P E shpk me NIPT L, i cili në mbyllje të periudhës ushtrimore, rezulton në listën e detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së në vlerën për **22,578 mijë lekë** u konstatua se, me shkresën prot ne DPT me nr. 188, datë **07.01.2021** të shoqërisë P E shpk, me subjekt óKërkohet anulimi i rimbursimit të TVSH-sëô citohet: ..... *kërkojmë nga ana juaj anulimin e rimbursimit të TVSh-së sipas raporti kontrollit të cituar më sipër dhe lejimin e kësaj vlere si të kredituesshme me qëllim pagimin e detyrimeve që i lindin shoqërisë tonë ndaj administratës tatimore si*

rrjedhojë e aktivitetit që ushtrojmë. Për sa më lart, kjo vlerë **duhej të zbritej nga ana e DPT-së, nga stoku i detyrimeve të prapambetura** për rimbursimin e TVSH-së.

3.K I shpk. Nga auditimi i praktikës së rimbursimit të TVSH-së për shoqërinë **KIshpk** me NIPT K, me aktivitet kryesor prodhimi dhe tregtimi i hekurit për ndërtim, eksportues **(jo me risk zero)** rezultoi se:

-Kërkesa për rimbursimin e TVSh-së në vlerën për **476,650 mijë lekë** është protokolluar ne DPT me nr. 4044, datë **21.02.2020.**

-Aktin e evidentimit fillestar të hartuar nga inspektori i DPT-së, datë 26.02.2020, ku evidentohet se shuma e kërkuar në vlerën për **476,650 mijë lekë** përputhet me të dhënat e sistemit dhe se tatimpaguesi nuk rezulton me detyrime.

-Njoftimin për pranimin e kërkesës për rimbursimin e TVSh-së, drejtuar tatimpaguesit me shkresën nr. 4044/1, datë 27.02.2019 të DPT-së.

-Shkresën e Drejtorit të Drejtorisë së Sektorit të Analizës së Riskut nr. 2330/31, datë 03.03.2019 me subjekt Kthim përgjigje, në lidhje me situatën dhe pozicionin e subjektit pas analizës së riskut, ku ky subjekt përcaktohet **me risk të lartë.**

-Shkresën e Drejtorit të Rimbursimit, nr. 4044/2, **datë 11.03.2020** me subjekt ôDërgohet shkresë për veprimô drejtuar Drejtorisë Tatimore Tiranë me qëllim, kontrollin në vend referuar kërkesës së tatimpaguesit që i korrespondon periudhës gusht 2018-dhjetor 2019.

-Aktin e Evidentimit Fillestar të hartuar nga inspektori i DPT-së, datë **01.04.2020,** ku evidentohet se shuma e kërkuar në vlerën për **476,650 mijë lekë** përputhet me të dhënat e sistemit dhe se tatimpaguesi nuk rezulton me detyrime.

-DRTVSH-së me shkresën me nr. 4044/3, datë **07.04.2020**, me subjekt ôDërgohet shkresë për konfirmimin tuaj, ka njoftuar tatimpaguesin K I sha, për miratimin e rimbursimit të TVSH-së për periudhën Gusht 2018-Dhjetor 2019 në vlerën për 476,650 mijë lekë dhe njëkohësisht ka paraqitur kërkesën për miratimin e marrëveshjes për likuidimin me këste të vlerës së rimbursimit të TVSh-së ku në neni 5, Detyrimet e administratës tatimore kësteve mujore të rimbursimit të TVSh-së, të kësaj draft marrëveshje parashikohen në vlerën për 21,656 mijë lekë në muaj për periudhën maj 2020-shkurt 2022. Konstatohet se kjo marrëveshje nuk është e firmosur nga ana e tatimpaguesit si dhe referuar dokumentacionit, megjithëse DPT, ka miratuar rimbursimin e vlerës së TVSH-së, në lidhje me këtë subjekt nuk rezulton asnjë këst i paguar. Ky miratim është bërë në zbatim të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 ôPër procedurat tatimore në RSHô, i ndryshuar, neni 75/1, udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 .

-Konstatohet se, me shkresën nr. 2166/9, datë **01.06.2020** të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me subjekt ôDërgohet raporti i kontrollit të kryer për tatimpaguesin K I shpk me NIPT K, prot në DPT, me nr. 40446/6, datë 02.06.20220 konstatohet se, sipas kontrollit vlera e miratuar për rimbursim është **473,381 mijë lekë**. Pra shkresa nr. 2166/9, datë 01.06.2019 e DTM, është protokolluar në DPT, **në tejkalim të afateve ligjore** për rimbursimin e tvsh-së së me afërsisht **2 muaj**.

Pra për sa më lart, kërkesa për rimbursimin e vlerës së TVSh-së megjithëse është trajtuar nga ana e Drejtorisë së Sektorit të Analizës së Riskut **me risk të lartë**, është miratuar nga DPT, **2 muaj më parëse përfundimi i Raportit të Kontrollit**nga ana e DTM, në zbatim të VKM nr. 953, datë 29.12.2014, i ndryshuar pika 3, neni 10, ku citohet: *Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshire eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Në të kundërt, brenda afatit 30-ditor nga* ***data e***

paraqitjes së kërkesës për rimbursim *kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.*

-Nga auditimi u konstatua se, deri në mbajtjen e këtij Akt Konstatimi, DPT**, nuk ka likuiduar tatimpaguesin me arsyetimin se ky i fundit është në proces gjyqësor,** veprime të marra këto në zbatim të Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së, ku citohet: *Nëse në çdo fazë të procesit të rimbursimit nëpunësi i DRTVSH-së merr dijeni zyrtarisht se ndaj tatimpaguesit që ka bërë kërkesën për rimbursim kanë filluar veprime hetimore nga strukturat kompetente, bazuar në dyshimet të konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave apo evazionit fiskal, kërkesa për rimbursim e tatimpaguesit mund të klasifikohet si kërkesës me Risk të Lartë dhe të pezullohet. Pezullimi zgjat deri në përfundimin e veprimeve hetimore. Nëse në përfundim të veprimeve hetimore rezulton se tatimpaguesi ka konsumuar veprën penale të fshehjes së të ardhurave kërkesa refuzohet sipas formatit nr. 5 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, në të kundërt, procesi i rimbursimit vijon sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.*

Referuar për sa më lart, konstatohet se, ka një moskonsistence me filtrat e riskut ndërmjet VKM-së dhe Rregullores së ne Rregulloren e Rimbursimit e cila i jep të drejta nëpunësit qe trajton kërkesën për rimbursim, të pezullojë kërkesën në rastet kur ndaj tatimpaguesit kanë filluar *veprime hetimore nga strukturat kompetente.*

4. K A A. Nga auditimi i praktikës së rimbursimit të TVSH-së për shoqërinë **K A A** me NIPT L, me aktivitet kryesor kultivimi intensiv i peshkut, u konstatua se, kërkesa për rimbursimin e TVSh-së së periudhës Mars 2017- Janar 2020, në vlerën për **197,497 mijë lekë** është protokolluar ne DPT me nr. 11867, **datë 26.06.2020.** Me datë **02.07.2020,** me shkresën nr. 11867/2, me subjekt ôDërgohet shkresë për veprimô Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, i është drejtuar DRTM, me qëllim kontrollin në vend për rimbursimin e TVSh-së në vlerën për 197,497 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se, shkresa nr. 2998/6 datë **30.10.2020** e DTM, është protokolluar në DPT, **në tejkalim të afateve ligjore** për rimbursimin e TVSh-së së me afërsisht **3 muaj**. Referuar kësaj shkrese, shuma e miratuar pas aktit të kontrollit është 194,851 mijë lekë të cilës duke i zbritur kompensimet për detyrime në vlerën për 1,329 mijë mbetën për tu rimbursuar **193,522 mijë lekë.** Referuar marrëveshjes me shoqërinë K A A me NIPT L, kështet e likuidimit të vlerës së rimbursimit të TVSh-së janë në vlerën për 19,352 mijë lekë në muaj duke filluar nga muaji dhjetor 2020.

5.B P A LTD me NIPT K, e cila përmban:

-Kërkesën për rimbursimin e TVSh-së për periudhën tetor 2019-shkurt 2020, protokolluar ne DPT me nr. 4168, datë 31.03.2020 të tatimpaguesit në vlerën për **1,358,082 mijë lekë.**

-Aktin e evidentimit fillestar të hartuar nga inspektori i DPT-së, datë 03.04.2020, ku evidentohet se shuma e kërkuar përputhet me të dhënat e sistemit.

-Njoftimin për pranimin e kërkesës për rimbursimin e TVSh-së, drejtuar tatimpaguesit me shkresën nr. 6148/1 datë 09,04,2020 të DPT-së.

-Shkresën e Drejtorit të Rimbursimit, nr. 6148/2, datë 21.04.2020 me subjekt ôDërgohet shkresë për veprimô drejtuar Drejtorisë Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj dhe Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut me qëllim, kontrollin në vend referuar kërkesës së tatimpaguesit.

-Shkresën e Drejtorit të Drejtorisë së Sektorit të Analizës së Riskut nr. 1636/432, datë 28.02.2019 me subjekt Kthim përgjigje, në lidhje me situatën dhe pozicionin e subjektit pas analizës së riskut.

-Shkresa nr. 2780/8, datë 27.07.2020 të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me subjekt ôDërgohet raporti i kontrollit të kryer për tatimpaguesin B P A LTD, prot në DPT, me nr. 6148/3, datë 27.0.2020, ku konstatohet se, sipas kontrollit vlera e miratuar për rimbursim është **1,348,564 mijë lekë** nga 1,358,082 mijë lekë të kërkuara. Në këtë shkresë DTM shprehet se tatimpaguesi ka një detyrim për gjobë TVSh-je në vlerën për 735 mijë lekë.

-Në lidhje me këtë vlerë të miratuar, nëpërmjet shkresës DRTvsh-së, ka njoftuar tatimpaguesit B P A LTD datë 29.07.2020
-Me shkresën nr. 13540/1, datë 30.07.2020, DRTVSH-së , me subjekt ñDërgohet shkresë për konfirmim òi është drejtuar tatimpaguesit BP A, me anë të cilës kërkon lidhjen e marrëveshjes për likuidimin e detyrimit me pagesë me këste në zbatim të VKM 146, datë 13.02.2020. Referuar kësaj draft marrëveshje shuma e detyrimit total është 2,116,507 mijë lekë ku kështet e likuidimit sipas DRTVSH-së parashikohen të jenë për periudhën Korrik-Shtator 2020, nga 100,000 mijë leke dhe kështet e periudhës shtator 2020-qershor 2022 të jenë 86,500 mijë lekë. Me shkresën nr. 13540 datë 16.07.2020 ref. protokollit të DPT-së, kjo marrëveshje është miratuar nga subjekti, ndërkohë që është propozuar mundësia e rritjes së shumës së tre kësteve të para.
Për sa më lart, nga DRTVSH-së, ka proceduar me pagesat referuar kësaj marrëveshje.
b. Konstatohet se, **janë pranuar në total 235 kërkesa për Rimbursimin e TVSH-së**, të cilat në mbyllje të periudhës ushtrimore **rezultojnë të pa miratuara.** Tabela në vijim paraqet kërkesat e pranuara por të pa miratuara ende në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020,

Në lekë

Muaji	Eksp, me Risk Zero.	Vlera	Ekspor, te Tjere	Vlera	Jo Eksportues.	Vleta	Tot Kerkesa	Tot Vlera
	1	2	3	4	5	6	7=1+3+5	8=2+4+6
Janar					1	16,115,147	1	16,115,147
Shkurt			1	9,925,763	1	920,617	2	10,846,380
Mars			2	14,472,732			2	14,472,732
Prill							0	0
Maj					5	129,299,093	5	129,299,093
Qershor					9	29,100,785	9	29,100,785
Korrik					4	30,038,631	4	30,038,631
Gusht			1	1,182,497	8	484,842,291	9	486,024,788
Shtator			3	158,607,320	26	918,469,424	29	1,077,076,744
Tetor			9	43,039,750	32	242,612,984	41	285,652,734
Nentor			2	103,572,222	41	806,609,377	43	910,181,599
Dhjetor	5	41,912,204	42	532,687,397	43	960,198,978	90	1,534,798,579
Totali	**5**	**41,912,204**	**60**	**863,487,681**	**170**	**3,618,207,327**	**235**	**4,523,607,212**

Nga auditimi i kërkesave të pranuara por të pa miratuara në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020 me qëllim përfshirjen e tyre në stokun e detyrimeve të prapambetura u konstatua se:
Në Ligjin 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, ñRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika1, citohet:ò..... ***brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit****dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditoresi të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.*
Në VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10, ku citohet: *Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, me*

përjashtim të kërkesave të personave të tatueshëm që rezultojnë me status të aktivitetit "pasiv", të cilët detyrimisht do të rimbursohen pas përfundimit të procedurës së kontrollit tatimor.

Pika 4 citohet: *Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikën 1 t këtij neni,* ***rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës*** *duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.*

Pra nëse i referohemi Ligjit 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar , vërehet se, **i gjithë procesi i Rimbursimit të tvsh-së, duhet të zgjasë jo më shumë se 60 ditë dhe moslikujdimi brenda këtij afati i kërkesave të pranuara por jo të miratuara në vlerën për *1,992,004 mijë lekë (2,182,199 mijëlekë shuma e kërkuar e pa miratuar minus 190,194, mijë lekë kërkesa të cilat deri në mbyllje të vitit 2020, nuk kanë plotësuar kushtet për rimbursim).*pavarësisht kryerjes ose jo të procesit të kontrollit tatimor, konsiderohet si një detyrim i pa paguar.** Tabela 1 në vijim paraqet kërkesat e bëra nga ana e tatimpaguesve dhe pa miratuara nga **DPT**të cilave i ka kaluar afati i rimbursimit të TVSH-së.

Në lekë

Muaji	Ekspor. te Tjere	Vlera	Jo Eksportues.	Vleta	Tot Kerkesa	Tot Vlera
	1	2	3	4	5=1+3	6=2+4
Janar			1	16,115,147	1	16,115,147
Shkurt	1	9,925,763	1	920,617	2	10,846,380
Mars	2	14,472,732			2	14,472,732
Prill					0	0
Maj			5	129,299,093	5	129,299,093
Qershor			9	29,100,785	9	29,100,785
Korrik			4	30,038,631	4	30,038,631
Gusht	1	1,182,497	8	484,842,291	9	486,024,788
Shtator	3	158,607,320	26	918,469,424	29	1,077,076,744
Tetor	9	43,039,750	32	242,612,984	41	285,652,734
Nentor	2	103,572,222			2	103,572,222
Dhjetor						
Totali	**18**	**330,800,284**	**86**	**1,851,398,972**	**104**	**2,182,199,256**

b.1 Tabela 2 në vijim, paraqet kërkesat për rimbursim të cilat në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë me raport kontrolli nda DRT-të por të pa miratuara nga ana e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së.

DRT	NIPT	Subjekti	Data e kerkeses	Shuma e Kerkuar (leke)	Kate	Dergimi per Kontroll te DRT	Marrja e Kontrollit nga DRT	Vlera e Miratuar nga Kontrolli (leke)
TIRANE	[redacted]		04.03.2020	11,976,656	2	19.03.2020	13.07.2020	11,424,049
DURRES			17.06.2020	698,310	2	25.06.2020	10.08.2020	672,237
SHKODER			30.06.2020	1,513,607	2	09.07.2020	13.10.2020	1,429,411
DURRES			18.08.2020	74,549,141	3	27.08.2020	19.11.2020	73,977,123
FIER			01.09.2020	40,813,071	3	15.09.2020	22.12.2020	40,813,071
SARANDE			03.09.2020	17,941,599	3	17.09.2020	9.12.2020	17,697,853
FIER			04.09.2020	1,136,141	2	15.09.2020	9.12.2020	429,934
FIER			17.09.2020	4,732,747	3	28.09.2020	25.11.2020	4,407,945
DURRES			16.10.2020	4,048,569	3	27.10.2020	22.12.2020	4,048,569
SHKODER			19.10.2020	1,668,731	3	27.10.2020	22.12.2020	1,594,516
SARANDE			23.10.2020	4,538,526	3	04.11.2020	15.12.2020	4,426,806
DURRES			23.10.2020	7,795,908	2	04.11.2020	22.12.2020	7,773,241
DURRES			26.10.2020	5,697,312	3	12.11.2020	21.12.2020	5,380,788
SARANDE			29.10.2020	6,934,339	3	12.11.2020	21.12.2020	6,909,337
SARANDE			03.11.2020	4,486,430	3	17.11.2020	30.12.2020	4,418,242
SARANDE			13.11.2020	1,663,888	3	24.11.2020	30.12.2020	1,647,888
				190,194,975				**187,051,010**

Nga auditimi u konstatua se, për subjektet e trajtuara në tabelën bashkëngjitur, DRTVSH, nuk ka miratuar vlerën e rimbursimit të TVSh-së në vitin 2020, pasi ka konstatuar mangësi në dokumentacionin e ardhur nga DRT-të, apo një pjesë e subjekteve të lartpërmendura ka rezultuar me detyrime në sistemin e DPT-së.

Si konkluzion:Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë 88 kërkesa të pranuara në vlerën totale për 1,992,004 mijë lekë të cilat megjithëse kanë kaluar 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nuk janë rimbursuar. **Si rezultat vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së, në opinionin tonë është 11,789,313 mijë lekë (9,797,309 mijë e paraqitur nga DPT plus 1,992,004 mijë lekë kërkesa të pranuara).** *Mos respektimi i afateve kohore në lidhje me dërgimin e kërkesës për kontroll DRT-ve, moskryerja në kohë nga ana e* ***Drejtorive Rajonale*** *e verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit dhe e miratimit të tepricës kreditore ka prezantuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve para riskut të krijimit të Detyrimeve të Prapambetura në një kohë kur, për vitin 2020, shpenzimet për Rimbursimin e TVSH-së, janë realizuar në masën 79%. Për sa më lart vlera* ***totale ekërkesave për rimbursimin e TVSH-së*** *në vlerën për* ***1,992,004 mijë lekë*** *(2,182,199 mijëlekë shuma e kërkuar e pa miratuar minus 190,194, mijë lekë kërkesa të cilat deri në mbyllje të vitit 2020, nuk kanë plotësuar kushtet për rimbursim) do të mund të ishin paguar me fondet buxhetore të vitit ushtrimor 2020. Veprime këto të cilat japin ndikim edhe në performancën e institucionit. Gjithashtu* ***kryerja e pagesës nga ana e DPT-së*** *brenda afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim në zbatim të pikës 3, rë VKM nr. 953, datë 29.12.2014****, pa miratimin e raportit të kontrollit të drejtorive rajonale sidomos për vlerat e larta*** *paraqet një riskt të shtuar për DPT-në për të gjithë ato raste kur vlera e kërkesës së pranuar për rimbursim është më e ulët se vlera e miratuar nga raporti i kontrollit.*
Tabela në vijim paraqet në mënyrë analitike kërkesat e pranuara por të pamiratuara në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020 me vlerë mbi 50,000 mijë lekë.

Kërkesat analitike ne proces me vlere mbi 50 milion					
Nr.	**DRT**	**NIPT**	**SUBJEKTI**	**Data e kërkesës**	**Shuma e Kërkuar në lekë.**
1	TIRANE	L	G C	12.06.2019	66,082,820
2	TIRANE	L	SH shpk	26.05.2020	110,816,722
3	DURRES	L	B shpk	18.08.2020	74,549,141
4	DTM	K	B shpk	21.08.2020	323,465,427
5	DTM	L	A sha	02.09.2020	58,366,472
6	FIER	L	Y shpk	03.09.2020	101,570,731
7	DTM	K	T shpk	10.09.2020	77,521,633
8	DTM	K	T shpk	21.09.2020	74,803,065
9	DTM	J	G shpk	22.09.2020	423,908,752
10	DTM	J	E shpk	25.09.2020	51,444,594
11	DTM	L	A shpk	28.09.2020	106,036,585
12	DTM	L	J dsh	12.11.2020	153,795,732
13	DTM	L	A shpk	17.11.2020	348,795,148
14	DTM	K	A shpk	17.11.2020	76,706,227
15	DTM	L	R sha	01.12.2020	78,460,000
16	TIRANE	K	T shpk	04.12.2020	109,908,188
17	DTM	K	T sh.a	07.12.2020	52,055,747
18	TIRANE	L	T sha	10.12.2020	53,467,619
19	DTM	L	A shpk	10.12.2020	138,767,250
20	DURRES	L	B shpk	11.12.2020	71,135,350
21	DTM	K	B shpk	24.12.2020	111,125,688
22	DTM	K	G shpk	24.12.2020	133,118,011

23	DTM	K	A shpk	30.12.2020	52,011,045
24	TIRANE	J	M	30.12.2020	121,162,283

c.Ne zbatim të urdhrit Nr. 28, date 08.04.2020, nr. 6380 Prot, në mbështetje te Ligjit nr. 9920, date 19.05.2008, ñPër procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 92/2014, ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, Drejtoria e Rimbursimit te TVSH-se ka raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave si dhe ka publikuar në faqen zyrtare të DPT-së, stokun e detyrimeve të prapambetura, tremujor dhe progresiv për periudhën ushtrimore 2020.

- **Rakordimi me Degën e Thesarit në bazë të SIFQ**

Dega e Thesarit Tiranë, në zbatim të nr. 06, datë 27,02,2014 dhe udhëzimit nr. 4/1, datë 23,05,2014 të MFE Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 13,05,2008 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ka dërguar ka dërguar ne forme shkresore pagesat progresive të rimbursimit dërguar, të evidentuara në tabelën si më poshtë vijon

Data DPT	Prot. DPT	Muaji	Vlera Progresive	Vlera Mujore
		Janar		0
30/04/2020	7317	Shkurt	2,110,454,468	2,110,454,468
20/04/2020	7277	Mars	3,077,041,596	966,587,128
11/05/2020	7814	Prill	4,673,455,653	1,596,414,057
08/06/2020	9874	Maj	5,920,800,520	1,247,344,867
13/07/2020	13097	Qershor	7,245,545,912	1,324,745,392
10/08/2020	17285	Korrik	8,757,561,376	1,512,015,464
11/11/2020	21770	Gusht	10,157,701,719	1,400,140,343
11/11/2020	21771	Shtator	11,872,884,796	1,715,183,077
11/11/2020	21771	Tetor	13,383,277,615	1,510,392,819
07/12/2020	23628	Nentor	14,594,054,205	1,210,776,590
29/01/2021	2130	Dhjetor	**16,507,803,784**	1,913,749,579
		Totali		**16,507,803,784**

Nga auditimi u konstatua se, vlera progresive e shpenzimeve për Rimbursuar e TVSh-së në konfirmohen nëpërmjet shkresave mujore të Drejtorit të Përgjithshëm me subjekt dërgohet Evidenca e të Ardhurave Tatimore për periudhën 2020. Konstatohet se, vlera e Rimbursimit të TVSH-së, **vetëm për vlerën e rimbursuar nga DRTVSH**, për vitin 2020, në vlerën për 16,507,804 mijë lekë, është konfirmuar me shkresën nr. 733, datë 15,01,2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së,

Në observacionin e paraqitur nga Drejtori i DRTTVSH-së me datë 30.09.2021 citohet:
Bazuar në materialin e paraqitur nga auditi i KLSH-së, Projekt Raporti i AuditimitNr. 513/23 Prot, Date 01.09.2021, marrë në dorëzim datë 01.09.2021, bazuar në programin e auditimit nr. 513/1, datë 14.05.2021, sipas drejtimit Nr. 2.c ñ*Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe perputhshmerine me kërkesat e kuadrit rregullator ne fuqi te veprimtarisë se Drejtorisë se Rimbursimit te TVSH-se*ò parashtrojmë argumentet tonë si më poshtë:
Paraprakisht shprehim konsideratën tonë për punën dhe përkushtimin e treguar nga ana e grupit të audituesve të KLSH-së, lidhur me analizën dhe verifikimet e kryera për punën dhe veprimtarinë e DRTVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Sikundër shprehet edhe në konstatimin Tuaj, DRTVSH në DPT e bazon veprimtarinë e saj në Legjislacionin Tatimor që rregullon funksionet dhe procedurat e rimbursimit të TVSH-së, në aktet nënligjore, në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore, Rregulloren dhe Manualin e Rimbursimit si edhe në shkresa me karakter administrative të brendshëm që dalin në mënyrë periodike, referuar fenomeneve që konstatohen në kryerjen e detyrës funksionale të kësaj drejtorie.

Nga sa më sipër, në vëmendjen tuaj, mund të parashtrojmë se krahas punës menaxhuese dhe metodike mbi trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së, DRTVSH në DPT kryen një volum të madh në përpunimin e shkresave hyrëse dhe dalëse nga subjektet, Drejtoritë Rajonale Tatimore, Institucione të ndryshme, etj., si dhe është pjesëmarrëse në hartimin dhe ndjekjen e planeve për aktivitetet e drejtorisë. Një pjesë të rëndësishme zënë dhe të gjitha shkresat metodologjike të hartuara mbi fenomene të ndryshme dhe problematika për Drejtoritë Rimbursimit të TVSH-së në DPT. Gjithë sa parashtrojmë përbën një volum pune të konsiderueshëm dhe kërkon kohë, për tëju përgjigjur në afat dhe me cilësi nga pikëpamja profesionale por dhe juridike e çështjeve që parashtrohen.
Duke analizuar konstatimet e paraqitura nga ana Juaj, parashtrojmë sa më poshtë, me besimin se nga ana Grupit të Audituesve të KLSH, do të vlerësohen dhe merren në konsideratë në hartimin e Raportit të Kontrollit:
Lidhur me konstatimin - *Stoku i rimbursimit të TVSH-së;*
Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë 88 kërkesa të pranuara në vlerën totale për 1,992m004 mijë lekë të cilat megjithëse kanë kaluar 60 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nuk janë rimbursuar. Si rezultat vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së, në opinionin tone është 11,789,313, mijë lekë. (9,797,039 mijë lekë e paraqitur nga DPT plus 1,992,004 mijë lekë kërkesa të pranuara).
Lidhur me stokun e vlerësuar sipas mënyrës së grupit të KLSH, DRTVSH nuk është dakord sepse është në kundërshtim me definicionin e ñStokutò ku ñ***STOKU*** *i rimbursimit të TVSH-së është vlera e TVSH-së e aprovuar për tu rimbursuar nga administrata tatimore, në pritje për tu kaluar në degën e thesarit*ò
Pra, stoku i llogaritur sipas metodës së KLSH-së merr në vlerësim edhe kërkesat të cilat janë në proces, të pa aprovuara, detyrimi i të cilave është i pa maturuar, ku teprica kreditore është e lire dhe e përdorshëm nga tatimpaguesi (shumë raste është përdorur).
Stoku i rimbursimit të TVSH-së duhet të llogaritet sipas definicionit:
Stoku në fund të periudhës = Stoku në çelje + Kërkesat e miratuara gjatë periudhës ï Kompensimet - Rimbursimet e kryera.
Stoku në datë 31.12.2020 vlerësuar dhe raportuar nga DPT është **9,797,039 mijë lekë** dhe **jo 11,789,313 mijë lekë** sa vlerëson KLSH me metodën e aplikuar prej sajë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Krupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionin Tuaj sqaron se, i qëndron arsyetimit të shprehur në Raportin e auditimit në lidhje me vlerën për 1,992,004 mijë lekë si stok të rimbursimit të TVSH-së në mbyllje të periudhës ushtrimore përveç vlerës së shprehur nga DPT dhe shton se: referuar Ligjit 9920, datë 19,05,2008 ñPër procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 75/1, ñRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika1 dhe VKM nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10, vërehet se i gjithë procesi i rimbursimit të TVSh-së, *duhet të përfundojë brenda 60, ditëve.Pra, pas përfundimit të afatit ligjor tatimpaguesit i lind një e drejtë e konstatuarpër rimbursimin e TVSh-së.* Në Standardin Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 1) ñ Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare ñ citohet: ñ*Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin*.
Për sa shpjeguar më lart, në vlerësimin e audituesve të KLSH-së, kjo vlerë duhet ti shtohet shumës së stokut të rimbursimit të TVSh-së dhe të paraqitet në pasqyrat financiare të institucionit.

Gjetja:

Drejtoritë Rajonale Dibër, Korçë dhe Elbasan, kanë tejkaluar dukshëm planin në vlerën për 664,877 mijë lekë për Shpenzimet e Rimbursimeve të TVSH-së.

Situata:

Nga auditimi mbi rimbursimin e TVSh-së, u konstatua se, Drejtoritë Rajonale të Dibrës, Elbasanit dhe Korçës kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara për vlerën 664,877 mijë lekë ose kanë tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, si në vijim :

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 453,942 mijë lekë ose në masën 267% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 121,247 mijë lekë ose në masën 34% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 89,687 mijë lekë ose në masën 35% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së. Veprime të tilla nga këto Drejtori Rajonale bien në kundërshtim me nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror qe zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Kriteri :

-nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror qe zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Ndikimi Mosrespektimi i legjislacionit tatimor.

Rëndësia E lartë.

Rekomandim

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se mund të procedohet me kryerjen e pagesave, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve për Drejtoritë Rajonale të cilat prezantojnë situate të tilla.

Gjetja:

DRTVSH në mbyllje të periudhës ushtrimore nuk mban akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me **detyrimin e konstatuar për rimbursimin e tvsh-së** .

Situata:

Në evidencën e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së e cila i dërgohet Drejtorinë e të Ardhurave dhe Kontabilitetit, për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSh-së në bazë vjetore**, gjendja e stokut** te rimbursimit në **31.12.2020** është në shumën **9,797,309 mijë lekë.**

Nga auditimi u konstatua se, nëse do te referohemi sistemit C@TS në lidhje me të dhënat sipas tabelës së mësipërme pra nëse do të kërkojmë një kartelë analitike të subjektit ku të paraqitet gjendja e stokut të rimbursimit të TVSH-së, vlera e miratuar për rimbursimin e TVSh-së, pagesat si dhe gjendja në fund e llogarisë së tatimpaguesit, kjo e dhënë nuk sigurohet nga sistemi C@TS, pasi në

momentin e miratimit përfundimtar të kërkesës për rimbursim, kjo shumë del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim. Në vijim të gjithë të dhënat në lidhje subjektet të cilëve i është miratuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së mbahen nga jashtë në Excel nga Drejtori i Rimbursimit të TVSH-së dhe inspektorët përkatës.

Nga auditimi u konstatua se, DPT në mbyllje të periudhës ushtrimore nuk mban akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me **detyrimin e konstatuar për rimbursimin e tvsh-së** në mbyllje të periudhës ushtrimore me qëllim vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiare.

Kriteri :

Udhëzimi i Ministrit të MFE, nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare të NJQPò pikës *3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 30 ku citohet:Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve.*

Efekti

Dokumentimi I vërtetësisë së detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiare.

Rëndësia

E mesme

Rekomandim

Drejtoria e Rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të marrë masat e nevojshme me qëllim që, në mbyllje të periudhës ushtrimore të mbajë akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me **detyrimin e konstatuar për rimbursimin e TVSh-së** dhe një kopje të këtij dokumenti ta paraqesë në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Kontabilitetit me qëllim dokumentimin e vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiarë.

Gjetja:

Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë 88 kërkesa të pranuara në vlerën totale për 1,992,004 mijë lekë të cilat megjithëse kanë kaluar 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nuk janë rimbursuar. Si rezultat vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së, në opinionin tonë është 11,789,313 mijë leke. (9,797,309 mijë e paraqitur nga DPT plus 1,992,004 mijë lekë kërkesa të pranuara).

Situata:

Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë **104 kërkesa** për rimbursimin e TVSh-së të pranuara por të pa miratuara në vlerën totale për **2,182,199 mijë lekë** të cilat megjithëse kanë kaluar 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, ñRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika1,dhe VKM Nr. 953datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10 dhe pika 4.

Gjithashtu konstatohet se, DRTVSH, **nuk ka miratuar** 16 kërkesa në vlerën për **190,194 mijë lekë** megjithëse janë kontrolluar nga DRT-të, pasi ka konstatuar mangësi në dokumentacionin e ardhur nga DRT-të, apo një pjesë e subjekteve të lartpërmendura ka rezultuar me detyrime në sistemin e DPT-së.

Nëse i referohemi Ligjit 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar , vërehet se, ***i gjithë procesi i***

Rimbursimit të TVSh-së, duhet të zgjasë jo më shumë se 60 ditë dhe mos likuidimi brenda këtij afati i kërkesave të pranuara por jo të miratuara në vlerën për 2,182,199 mijë lekë, pavarësisht kryerjes ose jo të procesit të kontrollit tatimor, konsiderohet si një detyrim i pa paguar.

Mos respektimi i afateve kohore në lidhje me procesin e rimbursimit të TVSh-së nga ana e DRTVSH-së dhe DRT-ve, ka prezantuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve para riskut të krijimit të Detyrimeve të Prapambetura në një kohë kur, për vitin 2020, shpenzimet për Rimbursimin e TVSH-së, janë realizuar në masën 79%. Për sa më lart vlera ***totale ekërkesave për rimbursimin e TVSH-së*** *të cilat do të mund të ishin paguar me fondet buxhetore të vitit ushtrimor 2020 është* ***1,992,004 mijë lekë*** *(2,182,199 mijëlekë shuma e kërkuar e pa miratuar minus 190,194, mijë lekë kërkesa të cilat deri në mbyllje të vitit 2020, nuk kanë plotësuar kushtet për rimbursim). Veprime këto të cilat japin ndikim edhe në performancën e institucionit. Gjithashtu kryerja e pagesës nga ana e DPT-së brenda afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim në zbatim të pikës 3, rë VKM nr. 953, datë 29.12.2014, pa miratimin e raportit të kontrollit të drejtorive rajonale paraqet një risk të shtuar për DPT-në për të gjithë ato raste kur vlera e kërkesës së pranuar për rimbursim është më e ulët se vlera e miratuar nga raporti i kontrollit.*

Kriteri :

Në Ligjin 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, ñRimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimoreò, pika1, citohet:ò..... ***brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit****dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditoresi të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.*

Në VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 3, neni 10, ku citohet: *Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve ,përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Në të kundërt, brenda afatit 30-ditor nga* ***data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim*** *kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.*

Pika 4 citohet: *Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikën 1 t këtij neni,* ***rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës*** *duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.*

Ndikimi/Efekti

Kryerja e pagesës nga ana e DPT-së brenda afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim në zbatim të pikës 3, të VKM nr. 953, datë 29.12.2014, pa miratimin e raportit të kontrollit të drejtorive rajonale paraqet një risk të shtuar për DPT-në për të gjithë ato raste kur vlera e kërkesës së

pranuar për rimbursim është më e ulët se vlera e miratuar nga raporti i kontrollit.

Rëndësia E lartë.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme për respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSh-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së e qëllim miradministrimin e fondeve buxhetore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të ndërmarrë një iniciativë ligjore me qëllim ndryshimin e VKMNr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, dhe konkretisht pika 3, neni 10, duke hequr frazën:*Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet*

Rekomandimi: *sistemit të thesarit,*

Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Për auditimin e këtij drejtimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1) Urdhrat për miratimin e strukturës organizative të DPT për vitet 2019-2020.
2) Plani operacional vjetor për monitorimin dhe mbledhjen me forcë të borxhit (2019-2020)
3) Evidencat për detyrimet tatimore të papaguara për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020
4) Evidenca e aktmarrëveshjeve me këste
5) Evidenca e masave shtrënguese
6) Çdo dokumentacion i nevojshëm në lidhje me zbatimin e programit.

Vështrim i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, nenet 88-103, DPT si pjesë përbërëse e Administratës Tatimore në tërësi, ka detyrimin ligjor nëpërmjet ushtrimit të kompetencës të mbledhë **detyrimin tatimortë papaguar** për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në kuptim të ligjit,neni 6ñDetyrim tatimorò,quhet ñ*Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor…. Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj*ò.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Struktura.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP) është njësi në varësi të DPT-së dhe ka funksionuar e funksionon në zbatim të Urdhrave respektivë të Kryeministrit nr. 86, datë 3.5.2019 ñ*Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 2.8.2016 "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore*ò dhe nr.33, datë 12.2.2020 ñ*Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore*ò.

DMDTP, për periudhën 01.01.2020-24.07.2020 ka funksionuar me **7**(shtatë) punonjës në strukturë organike, nga 8 gjithsej të përcaktuar në Urdhrin nr. 86, datë 3.5.2019 (*përfshirë drejtor dhe përgjegjës sektori*) ndarë në 2 sektorë:
-Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve (*2 punonjës*)

-Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara (*1 përgjegjës dhe 4 punonjës*).
Deri në fund të vitit 2020, DMDTP ka funksionuar me strukturë jo të plotë, me 4 **vende të lira/vakante**, jo në përputhje me strukturën organike miratuar me Urdhër nr. 33, datë 12.2.2020 të Kryeministrit.

DMDTP, në funksion të detyrave të saj përcaktuar në legjislacionin e procedurave tatimore, ka për detyrë të zbatojnë procedurat e përshkruara në Manualin e Mbledhjes me Forcë të Detyrimeve të Papaguara i cili mbështet në nenin 135, paragrafi ñ3ò dhe ñ4ò, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, Strukturat e Mbledhjes me Forcë në DPT dhe Drejtoritë Rajonale. Në zbatim të Urdhrit nr.33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit u implementua struktura e re organizative e administratës tatimore e cila konsiston ndër të tjera edhe në krijimin e drejtorive përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara në rajone, parashikuar shprehimisht në pikën 5, të nenit 88, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar. Referuar këtyre ndryshimeve strukturore nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka dalë Urdhri nr. 64, datë 24.08.2020 ñPër ngritjen e grupit të punës për konsolidimin e procedurave të drejtorisë së mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguaraò i ndryshuar në vijim me Urdhrin nr. 69, datë 15.09.2020. Në zbatim të Urdhrit është përgatitur Drafti i përditësuar i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara i cili deri në fund të vitit 2020- periudha e auditimit, rezulton të ishte ende në proces konsultimi duke përfunduar në 2021 dhe dërguar për zbatim me shkresën nr. 11912 prot., datë 29.06.2021 Drejtorive të Mbledhjes së detyrimeve Tatimore të Papaguara në 4 rajonet.

Titulli i gjetjes: Funksionimi iDMDTP me strukturë jo të plotë, 4 vende të lira/vakante.

Situata: **1.**Për periudhën 01.01.2020-24.07.2020 konstatohet **1(një)vend i lirë/vakant**në pozicioninDrejtor Drejtorie, deri me hyrjen në fuqi të strukturës së re.
2.Për periudhën 24.07.2020- 31.12.2020, me ndryshimet strukturore bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.33, datë 12.02.2020 kjo drejtori përbëhet nga 12 punonjës në organikë që gëzojnë statusin e nëpunësit civil (*11inspektorë +1 Drejtor*) dhe është organizuar në 3 sektorë:
-Sektori i Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë (*1 përgjegjës dhe 2 inspektorë*),
-Sektori Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese (*1 përgjegjës dhe 3 inspektorë*)
-Sektori Monitorimit & Analizës (*1 përgjegjës dhe 3 inspektorë*).
Për këtë periudhë konstatohen **4** (katër) **vende të lira/vakante**:
-Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese: me 2(dy) vende të lira/vakante, në pozicionin: P/Sektori 1(një) dhe inspektor 1 (një). Vendi i lirë/vakant në pozicionin P/Sektori, figuron ñde factoò, pasi ñde jureò është e emëruar znj. F. L., e cila ka qenë me leje të zakonshme duke filluar nga data 03.08.2020 dhe në vijim/me raport mjekësor nga data 17.08.2020 deri në 15.10.2020, datë në të cilën është transferuar në Drejtorinë e Kontrollit të Specializuar.
-Sektori Monitorimit & Analizës: me 2 vende të lira/vakantë, në pozicionin P/Sektori 1(një) dhe inspektor 1(një).
Mos plotësimi i vendeve të lira/vakante konform strukturës së miratuar

ka sjellë mosfunksionim me kapacitet të plotë të kësaj drejtorie, tagër ky në kompetencë të titullarit institucionit D. I. dhe Departamentit të Administratës Publike.

2. Manuali i Mbledhjes me Forcë, me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni fiskal si dhe me ndryshimet strukturore të DMDTP tashmë të organizuara në 4 rajone, për periudhën nën auditim **ishte në proces përditësimi** i cili përfundoi në 2021 dhe i është dërguar për zbatim Drejtorive të MDTP në rajone.

Kriteri: Urdhri nr. 86, datë 3.5.2019 dhe nr.33, datë 12.2.2020 i Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendroreò.

Ndikimi/Efekti: Funksionimi me kapacitet jo të plotë i DMDTP.

Shkaku: Mosplotësimi i vendeve të lira/vakante me strukturën e miratuar.

Rëndësia: I ulët

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

Funksionimi.

Për vitin 2020, me Vendim të Kryetarit të Komitetit Operacional përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve znj. D. I. nr. 16, datë 06.02.2020, është miratuar plani operacional për vitin 2020.

Plani Operacional i DMDTP si pjesë e Planit Operacional të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përmban këto drejtime në zbatim të të cilave janë marrë këto masa:

1-*Zhvillimi i një qasje, që do të inkurajojë përmbushjen vullnetare nga tatimpaguesit e rregullt dhe ata të cilët qëllimisht bëjnë gabime, dhe zbatimi i mbledhjes me forcë ose vendosja e penaliteteve vetëm për ato tatimpagues të cilët qëllimisht nuk pajtohen me legjislacionin tatimor***.**

Në lidhje me zbatimin e këtij drejtimi është vijuar për çdo muaj përcjellja e listave për Qendrën e Thirrjeve për tatimpaguesit, të cilët kanë vetë deklaruar por nuk kanë paguar brenda afatit detyrimet e vetë deklaruara, me qëllim ndjekjen shlyerjes së këtyre detyrimeve të papaguara sipas prioriteteve, nisur nga vlerat më të mëdha të detyrimit. Brenda datës 16 të çdo muaji, evidentohen tatimpaguesit vetë deklarues që nuk kanë paguar në kohë detyrimet tatimore për TVSH, si dhe çdo datë 22, detyrimet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, TAP dhe e të tjera.

2-*Informimi i punonjësve të Administratës Tatimore në kohë reale për ndryshimet në legjislacionin tatimor.*

Në zbatim të këtij drejtimi të planit gjatë vitit 2020, bashkëpunimi i DMDTP me Qendrën e Trajnimeve të Administratës së Tatimeve dhe Doganave (QTATD) ka vijuar në bazë të kalendarit të trajnimeve ku si temë e veçantë është Mbledhja e të Ardhurave Tatimore. Stafi i DMDTP janë informuar mbi ndryshimet ligjore si dhe rekomandimet apo raportet e eksperteve te FMN/KLSH.

3-*Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;*

Për këtë drejtim të planit operacional, ka vijuar kryqëzimi i vazhdueshëm i informacionit me Drejtorinë e Kontrollit dhe te Riskut dhe struktura të tjera në Administratën Tatimore, me qëllim parandalimin e krijimit të borxheve të reja si dhe menaxhimin më të mirë të situatës së stokut të borxhit. Në funksion të kësaj janë evidentuar tatimpaguesit me risk, të dalë sipas

kritereve të borxhit në Modulin e Riskut. Materiali i dërguar nga Drejtoria e Riskut me shkresën nr.19075 prot., date 01.10.2020 i është dërguar dhe po ndiqet nga Drejtoritë Rajonale të Detyrimeve Tatimore të Papaguara të Mbledhjes, me anë të e-mail datë 13.10.2020. Me shkresën nr.23072/1prot., datë 04.12.2020 i janë dërguar Drejtorisë së Riskut, problematikat, fenomenet e hasura gjatë ushtrimit të detyrave funksionale nga punonjësit e Drejtorisë së Mbledhjes dhe që konsiderohen me risk për realizimin e objektivave të drejtorisë.

Drejtorisë së Kontrollit i është dërguar shkresa nr.20051 prot, datë 15.10.2020 ku është kërkuar sistemim i situatës për tatimpaguesit të cilët rezultojnë debitorë dhe kreditorë në të njëjtën kohë, me qëllim sistemimin e situatës së tyre dhe uljen e nivelit të borxhit.

4-*Monitorimi i veçante për ecurinë e stokut të borxhit.*

DMDTP çdo muaj, ka nxjerrë të dhëna dhe ka analizuar situatën e detyrimeve tatimore të papaguara, sipas raportimit të Drejtorive Rajonale të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Në respekt të ligjit, për zbatimin e masave shtrënguese dhe analizës së detajuar të detyrimeve tatimore të papaguara është kërkuar informacion për çështjet në ankim administrativ/rrugë gjyqësore, përkatësisht Drejtorisë së Apelimit Tatimor dhe Drejtorisë Ligjore dhe Teknike në DPT. (*përkatësisht meshkresat nr.17143 prot, datë 02.09.2020 dhe nr.17143/1 prot., datë 16.10.2020 drejtuar Drejtorisë se Apelimit Tatimor dhe shkresa nr.17087 prot., datë 02.09.2020 dërguar Drejtorisë Teknike dhe Ligjore)*.

5-*Centralizimi i funksioneve të drejtorisë së Mbledhjes me Forcë.*

DMDTP, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.33, datë 12.02.2020 për ñ*Miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore*ò, është përqendruar në 4 rajone, Rajoni Qendror, Jugor, Verior dhe NJTM. Në zbatimin e këtij drejtimi të planit operacional konstatohet se DMDTP ka mungesë stafi, pasi ka vende vakante/të lira brenda drejtorisë ashtu dhe në Rajone që përfshijnë DRT-të sipas ndarjes në rajone.

4-Masat e marra për rikuperimin e detyrimeve tatimore te papaguara.

Në zbatim të këtij drejtimi të planit operacional, konstatohet se gjatë vitit 2020 janë ndërmarrë një varg iniciativash për të forcuar funksionin e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara në kohë, me fokus forcimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e proceseve të punës, lehtësimin e proceseve të komunikimit me tatimpaguesit me qëllim ndjekjen e menjëhershme të borxhit të ri, duke parandaluar kthimin e tij në borxh të vjetër, për mos përshkallëzimin e stokut të borxhit aktual. (*përkatësisht meshkresën nr.19427 prot, date 07.10.2020 drejtuar drejtorisë Teknike dhe Ligjore lidhur me propozimet për ndryshime te akteve ligjore dhe nënligjore*).

Titulli i gjetjes: Mos kryerja e inspektimeve në rajone në zbatim të planit operacional.

Situata: Në zbatim të planit operacional për vitin 2020, nga kjo drejtori **nuk janë kryer inspektimet** në 4 rajonet/ Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM pranë Drejtorive Rajonale, me argumentin e shpalljes së gjendjes së ñkarantinësò për Covid 19. Në këto kushte, përmes daljes së akteve ligjore e nënligjore për të përballuar situatën, janë krijuar përfitime për subjektet tatimpagues, me qëllim lehtësimin në afatet e vetë deklarimit dhe njëkohësisht përmbushjen e detyrimeve tatimore. Gjithashtu dhe për funksionimin e Administratës Tatimore, bazuar në Vendimin Nr.156, datë 10.03.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dalë në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19 dhe bazuar në urdhrin nr.38 datë 12.05.2020, të Departamentit të Administratës

Publike ñPër miratimin e rregullores tip ñPër marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19ò, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Urdhrin nr.25 datë 11.03.2020 ka hartuar një plan masash ñPër zbatimin e planit të masave në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19ò.
Në kuadër të planit të masave të miratuar me urdhrin e sipërcituar, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit Covid 19 dhe vijimësinë e punës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Administratës Tatimore, nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara janë anuluar inspektimet nëpër Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM me qëllim minimizimin e rrezikut të infektimit nga COVID-19 për nëpunësit/punonjësit.

Kriteri: Plani operacional për vitin 2020 miratuar me Vendim nr. 16, datë 06.02.2020 të Kryetarit të Komitetit Operacional përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve znj. D.I.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i planit operacional në lidhje me inspektimet e ushtruara në rajone.

Shkaku: Aktet nënligjore dalë në kushtet e ñkarantinësò,në drejtim të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Rëndësia: I ulët

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa që në të ardhmen inspektimet në rajone të intensifikohen, duke përmbushur edhe detyrat e parashikuara në planin operacional miratuar me Vendimin nr. 16, datë 06.02.2020.

-Detyrimet tatimore të papaguara në afat.

Bazuar në Manualin e Mbledhjes, pika 3.3.1, ku përcaktohet:

ñ*Çdo muaj, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtoritë Rajonale duhet t'i dërgojë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT raporte, evidenca dhe analiza të cilat pasqyrojnë situatën e borxhit. ..Raportimet periodike mujore të Drejtorive Rajonale duhet të dërgohen në rrugë elektronike brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës dhe me postë zyrtare brenda datës 14 të çdo muaji pasardhës pranë DPT/Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë. Raportimet duhet të bëhen sipas evidencave të miratuara*é ò, DMDTP në funksion të këtij detyrimi ligjor, merr të dhënat e dërguara nga 4 rajonet (*në juridiksionin e të cilave përfshihen Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse*), përmes evidencave që raportohen çdo muaj nga ato.

Sistemi C@TS mundëson ekzekutimin e veprimeve automatike të lidhura me menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, në opsionin e sistemit emërtohet ñMbledhje me Forcëò. Veprimet e mbledhjes, kryhen automatikisht nga sistemi dhe me kalimin e afatit për detyrimet tatimore, procesi i mbledhjes me forcë aktivizohet, dhe të gjitha transaksionet që e kanë kaluar afatin gjenden në sistem.

Situata e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

NR	DRT	Gjendja detyrimeve ne fillim te Janarit		Detyrime te shtuara		Detyrime pakesuar				Vlera e detyrimeve ne fund te Dhjetorit		Ne proces gjyqësor	
						Arketuar Gjithsej		Kthyer per Sistemim					
		nr.subj.	shuma	nr.subj.	shuma	nr.subj.	shuma	nr.subj.	shuma	nr.subj.	shuma	nr. Subj.	shuma
1	Qendror	103,608	87,354,018	133,763	14,150,609	72,161	10,027,235	2,317	983,849	108,364	90,493,543	1,142	9,247,334
2	VIP	203	11,242,411	813	6,473,028	672	4,510,442	73	695,620	271	12,509,377	80	3,268,056
3	JUG	29,010	*8,398,207*	24,085	2,160,009	22,173	1,995,747	244	*104,322*	30,678	*8,458,147*	*61*	*398,431*
4	VERI	18,421	9,999,592	28,212	*2,543,716*	16,528	*1,413,727*	567	122,238	29,538	11,007,343	179	808,527

	TOTALI	151,242	116,994,227	186,873	25,327,363	111,534	17,947,151	3,201	1,906,029	168,851	122,468,410	1,462	13,722,348

Shënim: *Rajoni Jugor përfshin DRT- Fier, Vlore, Sarande, Gjirokastër, Berat*
Rajoni Verior përfshin DRT- Shkodër, Lezhe, Kukës, Dibër
VIP -Njësia e Tatimpaguesve te Mëdhenj

Referuar treguesve të sipërm, gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në fillim viti 01.01.2020 është në vlerën 116.9 miliard lekë dhe në fund viti 31.12.2020 është në vlerën 122.4 miliard lekë. Nga këto të dhëna rezulton se detyrimet tatimore të papaguarakanë pësuar një rritje neto prej 5.4 miliard lekë në fund të vitit.

Vlera e detyrimeve të papaguara (pa përfshirë proceset gjyqësore).



Në detyrimet tatimore për vitin 2020, në vlerën prej 122.4 miliard lekë e cila ndiqet deri më 31 Dhjetor 2020, është e përfshirë edhe vlera prej 13.7 miliard lekë që zë 11% të stokut të detyrimeve të papaguara, e cila është në proces gjyqësor deri në fund të Dhjetorit 2020.

Proceset gjyqësore sipas rajoneve:

Referuar të dhënave të DMDTP në tabelën më sipër, proceset gjyqësore me vlerë më të madhe sipas rajoneve renditen në këtë trend:

Rajoni Qendror me 9.2 miliard të vlerës për 1142 subjekte, ndjekur nga VIP-t me vlerë 3,2 miliard për 80 subjekte. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, detyrimet tatimore ka pësuar rritje për 3 rajonet, përjashtuar Rajonin e Jugut, ku rritja është e ulët. Sipas rajoneve gjendja paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr.	Rajoni	Gjendja e detyrimeve në fund të vitit 2020	
		Nr. Subjekteve	Shuma
1	Qendror	108364	90,493,543
2	VIP	271	12,509,377
3	Jug	30678	8,458,147
4	Veri	29538	11,007,343
5	**Total**	**168851**	**122,468,410**

Burimi: DMDTP-përpunuar nga KLSH

Nga treguesit në tabelë, peshën më të madhe në total të stokut të detyrimeve e zë Rajoni Qendror me 73,7% e ndjekur nga VIP-at me 10,2%, Rajoni Verior me 9% e më pas Rajoni i Jugut me 7,1 %.

Titulli i gjetjes: Rritja e detyrimeve tatimore të papaguara në vlerën 5,4 miliardnë fund të vitit/dhjetor 2020 krahasuar me fillim vitin/janar 2020.

Situata: Referuar treguesve të siguruar nga DPT/DMDTP, gjendja e detyrimeve të papaguara për vitin 2020/(fund viti), ka pësuar një rritje neto prej 5,4

	miliard lekë krahasuar me fillim vitin 2020. Në vlerën e detyrimeve tatimore të papaguara deri më 31 Dhjetor 2020, prej 122.4 miliard lekë është përfshirë vlera prej 13.7 miliard lekë që përbën 11% të stokut të detyrimeve tatimore të papaguara dhe që përfaqëson detyrimet që rrjedhin nga proceset gjyqësore për 1462 subjekte, sipas të dhënave të raportuar nga 4 rajonet.
Kriteri:	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, nenet 88-103, Manuali Mbledhjes, pika 3.3.1.
Ndikimi/Efekti:	Rritje neto të detyrimeve tatimore në fund të vitit 2020.
Shkaku:	Shtesat e detyrimeve tatimore nga vlerësimet dhe rivlerësimet e Administratës Tatimore, mos përmbushja e detyrimeve tatimore që krijohen rishtas, kalimet në regjim pasiv që përbëjnë 70,4% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë 51 miliard lekë ose 76,2% të masës së detyrimeve tatimore si dhe ndikimi i situatës Covid 19 e cila ngadalësoi ritmet e mbledhjes së detyrimeve tatimore.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Të merren masa nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për minimizimin detyrimeve tatimore të papaguara përmes mbledhjes së tyre duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar.

Ecuria dhe gjendja e detyrimeve te papaguara në afat deri me 31 dhjetor 2020 paraqitet:

Bazuar në të dhënat e dërguara nga Rajonet/DRT përmes evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre, ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri me 31.12.2020 paraqitet:

Detyrime të papaguara në afat në datë 01.01.2020	117	mld lekë
Gjendja në datë 31 Dhjetor 2020	122,4	mld lekë

"Detyrimet e pakësuara" sipas periudhës tatimore **2020 vs 2019** paraqiten si më poshtë:



Burimi: DMDTP

Referuar të dhënave në tabelë vënë në dispozicion nga DMDTP, rezulton se ñdetyrimet e pakësuaraò janë 6 miliard lekë më pak në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Ulja e detyrimeve për periudhën janar-dhjetor 2020 është ndikuar nga situata aktuale e pandemisë. Në detyrimet e pakësuara përfshihen arkëtimet dhe sistemimet e bëra gjatë periudhës.

Vlera e detyrimeve te arkëtuara gjatë vitit 2020

Në mld/ lekë



Burimi: DMDTP

Arkëtimi i detyrimeve tatimore referuar të dhënave të sipërme, për vitin 2020 është në vlerën 18 miliard lekë ndërsa arkëtimi i detyrimeve në fund viti/dhjetor 2020 krahasuar me fillim vitin/janar 2020 është në vlerën 0,4 miliard më shumë, rritja e arkëtimeve ka një kurbë të ulët.

“Detyrimet e shtuara” sipas periudhave tatimore **2019 vs 2020** paraqiten si më poshtë:



Burimi:DMDTP

Referuar të dhënave në tabelë vënë në dispozicion nga DMDTP, rezulton se ñdetyrimet e shtuaraò janë më pak në vlerë 9,9 miliard lekë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Rritja më e madhe e këtyre detyrimeve i takon muajit Prill 2020, për shkak të situatës së pandemisë.

Ecuria e stokut të detyrimeve tatimore të papaguara sipas periudhave.



Në Gusht 2020, me ndryshimet strukturore drejtoria mori emërtimin Drejtori e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, e cila ka si qëllim rritjen e efikasitetit dhe eficencës operacionale në mbledhjen e detyrime tatimore të papaguara. Ndryshimi strukturor konsolidoi funksionin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara tashmë në ndarjen administrative në 4 rajone, DMDTPï Rajoni Qendror, DMDTPï Rajoni Verior, DMDTPï Rajoni Jugor dhe DMDTP-Tatimpaguesit e Mëdhenj.

Me gjithë situatën e krijuar nga pandemia COVID 19, mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara si pasojë e masave të ndërmarra nga qeveria për shtyrjen e afatit për shlyerjen e detyrimeve tatimore nuk ka lejuar krijimin e detyrimeve te reja gjatë periudhës Gusht 2020-Dhjetor 2020.

-Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat deri me datë 01.08.2020 122,3 miliard lekë

- Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat deri me datë 31.12.2020 122,4 miliard lekë

Titulli i gjetjes: Rritja e detyrimeve tatimore të papaguara nga gushti 2020 deri dhjetor 2020.

Situata: Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat deri me datë 01.08.2020 122,3 miliard lekë
Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat deri me datë 31.12.2020 122,4 miliard lekë
Nga të dhënat e sipërme rritja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat për periudhën nga gushti 2020 deri dhjetor 2020 është në vlerën 0,1 miliard lekë.

Kriteri: Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar,

Ndikimi/Efekti: Rritje në vlerë të ulët (*0.1 miliard lekë*) e detyrimeve tatimore të papaguara, për periudhën Gusht 2020-Dhjetor 2020.

Shkaku: Masat e ndërmarra nga qeveria për shtyrjen e e afatit për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Rëndësia: I ulët

Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për minimizimin detyrimeve tatimore të papaguara përmes mbledhjes së tyre, duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar.

Detyrimet tatimore të papaguara v. 2020 ndarë sipas Rajoneve.



Në të dhënat e marra nga DMDTP, rezulton se peshën më të madhe të detyrimeve të papaguara e zë Rajoni Qendror me 74% të totalit ndjekur nga NJTM me 10% të totalit të detyrimeve.

Detyrimet tatimore të papaguara në afat deri më datën 31 Dhjetor 2020 specifikuar sipas zërave përbërës paraqiten si më poshtë:

- Principali i Detyrimeve me 60 %
- Penalitete 35%
- Kamatëvonesa 5%

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se principali i detyrimeve tatimore të akumuluara përben rreth 60% të shumës totale të detyrimeve tatimore, ndërkohë që pjesa tjetër e këtyre detyrimeve 41% e mbetur, përbëhet nga penalitetet dhe kamatëvonesat.

Në treguesit e detyrimeve për vitin 2020, bëjnë pjesë gjithashtu edhe sistemimet, që përfaqësojnë zbatime të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kompensim të detyrimeve të papaguara me tepricat kreditore të tatimpaguesve, etj.

Detyrimet tatimore të papaguara sipas llojit të tatimit.



Mbi gjendjen e stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, nga ana e DMDTP është vënë në dispozicion evidenca ku rezulton zëri TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 34% ose në vlerë absolute 41.9 miliard lekë, ndjekur nga Tatim Fitimi me 27% ose në vlerë absolute 33.4 miliard lekë, zëri ñTë Tjeraò me 24% ose në vlerë absolute 28.1 miliard lekë, Sigurimet Shoqërore &Shëndetësore me 14% ose në vlerë absolute 17 miliard lekë dhe TAP me 2% ose në vlerë absolute 2,1 miliard lekë.

Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2019 vs 2020



Nga treguesit e sipërm vënë në dispozicion nga DMDTP, referuar vitit 2019, vërehet se TAP ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel, ndërkohë që detyrimi i papaguar për TVSH është rritur me 1.51 miliard lekë, Tatim Fitimi me 1.8 miliard lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 1,85 miliard lekë dhe zëri ñTë Tjerañ me 0,26 miliard lekë.Në zërin detyrime ñTë tjeraò përfshihen detyrime jo tatimore si: taksa, tarifa, etj.

në lekë

Formulari per evidentimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore
Sipas llojit te tatimit (progresivi)
Gjendja 31.12.2020

LLOI I TATIMIT	Gjendja detyrimeve ne fillim te muajit dhjetor shuma	Detyrime te shtuara gjate muajit shuma	Detyrime pakesuar gjate muajit Arketuar Gjithsej shuma	Kthyer per Sistemim Shuma	Vlera gjithsej e detyrimeve ne fund te muajit dhjetor shuma
Tatim Fitimi	31,637,015	6,412,875	3,844,633	812,806	33,392,452
TVSH	40,398,965	5,886,782	3,845,049	533,630	41,907,068
Sig.Shoqerore	15,112,681	9,874,922	7,957,410	64,393	16,965,799
TAP	1,961,275	859,215	737,250	24,786	2,058,454
Te tjera	27,884,291	2,293,568	1,562,809	470,414	28,144,636
TOTALI	**116,994,228**	**25,327,361**	**17,947,151**	**1,906,029**	**122,468,409**

Formulari për evidentimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore
Sipas llojit te tatimit (progresivi)
Gjendja 31.12.2019

LLOI I TATIMIT	Gjendja detyrimeve ne fillim te muajit janar shuma	Detyrime te shtuara gjate muajit shuma	Detyrime pakesuar gjate muajit Arketuar Gjithsej shuma	Kthyer per Sistemim shuma	Vlera e detyrimeve ne fund te dhjetor shuma
Tatim Fitimi	30,203,618	13,127,706	6,749,421	4,944,888	31,637,015
TVSH	39,321,591	14,491,515	5,628,158	7,785,983	40,398,965
Sig.Shoqerore	13,829,721	9,825,059	7,418,921	1,123,178	15,112,681
TAP	1,597,106	1,077,834	489,132	224,533	1,961,275
Te tjera	22,748,501	14,419,149	2,163,690	7,119,670	27,884,291
	107,700,537	**52,941,263**	**22,449,321**	**21,198,251**	**116,994,228**

Konstatohet se evidencat me të dhënat për detyrimet tatimore të papaguara përpunohet nga Drejtoria e Mbledhjes së DTP në DPT/Sektori i Monitorimit&Analizës referuar të dhënave të dërguara në formë sintetike nga rajonet çdo muaj, në numër dhe në vlerë.

Mosha e detyrimeve te papaguara ne afat deri 31.12.2020

Në mijë lekë

MOSHA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA NE AFAT DERI NË 31.12.2020						
Periudha	detyrimet deri 3 muaj	detyrimet 3 - 6 muaj	detyrimet 6-12 muaj	detyrimet nga 1-2 vjet	detyrimet nga 2-5 vjet	detyrimet mbi 5 vjet
Detyrime të papaguara në afat	**4,652,467**	**5,744,053**	**12,385,214**	**16,419,808**	**54,081,761**	**29,185,106**
Pesha specifike në %	**4%**	**5%**	**10%**	**13%**	**44%**	**24%**

Në totalin e stokut të detyrimeve tatimore prej **122,4**miliard lekë detyrimet paraqiten:

- *Detyrimet deri në 3 muaj* ***4% ndaj totalit të stokut***
- *Detyrimet nga 3 - 6 muaj* ***5% ndaj totalit të stokut***
- *Detyrimet nga 6-12 muaj* ***10 % ndaj totalit të stokut***
- *Detyrimet nga 1-2 vjet* ***13% ndaj totalit të stokut***
- *Detyrimet mbi 2 vjet* ***68% ndaj stokut të detyrimeve nga të cilat:***

  Detyrimet nga 2-5 vjet **44% ndaj totalit të stokut**

  Detyrimet mbi 5 vjet **24% ndaj totalit të stoku**



Referuar moshës së detyrimeve të papaguara vihet re se peshën më të madhe të stokut sipas moshës e zënë detyrimet mbi 2 vjet me peshë 68%, si dhe detyrimi me i ri (*nënkupton detyrimin e lindur rishtas*) është arkëtuar duke përdorur analizën e profilit të riskut (*detyrimi më i ri dhe vlera më e lartë*) si dhe duke ndjekur vetëdeklarimet për çdo muaj nga Sektori i Analizës në Rajonet e Mbledhjes, me qëllim rritjen e performacës në arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Detyrimet tatimore sipas statusit të tatimpaguesit.

- *Subjektet Aktiv zënë 42% të numrit total të subjekteve debitorë me një vlerë prej 39,7miliard lekë ose 32% të masës totale të borxhit.*
- *Subjektet Pasiv zënë 58% të numrit total të subjekteve debitor me një vlerë prej 82,6 miliard lekë ose 68% të masës totale të borxhit.*

Tabela 2: Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesve

Në 000/lekë

Nr.	Rajoni	Nr. i Tatimpaguesve Aktivë	Vlera e Borxhit për Tatimpaguesit Aktivë	Nr. i Tatimpaguesve Pasivë	Vlera e Borxhit për Tatimpaguesit Pasivë	Borxhi deri më 31.12.2020	
						Nr. i Tatimpaguesve	Vlera e Borxhit
1	Qendror	38,512	21,542,964	69,852	68,950,579	108,364	90,493,543
2	NJTM	262	11,118,156	9	1,391,221	271	12,509,377
3	Jug	14,037	3,362,434	16,641	5,095,713	30,678	8,458,147
4	Veri	18,404	3,761,151	11,134	7,246,194	29,538	11,007,343
	Totali	**71,215**	**39,784,705**	**97,636**	**82,683,707**	**168,851**	**122,468,410**

Burimi:DMDTP

Tabela 3: Mosha e detyrimeve tatimore në totalin e tatimpaguesve debitorë *Në 000/lekë*

MOSHA E BORXHIT	*Detyrimet Tatimore*											
	TATIM MBI TË ARDHURËN PERSONALE		*TATIM FITIMI*		*TVSH*		*SIGURIME SHOQËRORE & SHËNDETËSORE*		*TË TJERA*		*TOTALI*	
	nr. i rasteve	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*
borxhi deri ne 3 muaj	12,097	115,233	10,317	1,170,050	18,688	1,569,291	112,374	1,400,709	17,578	397,185	171,054	4,652,467
borxhi nga 3 - 6 muaj	14,099	114,830	24,035	2,194,638	26,769	1,600,376	115,864	1,592,411	19,147	241,798	199,914	5,744,053
borxhi nga 6-12 muaj	17,757	160,739	16,461	2,354,441	27,544	2,830,432	108,538	1,528,499	36,363	5,511,103	206,663	12,385,214
borxhi nga1-2 vjet	19,740	272,159	82,517	6,385,503	41,797	5,105,012	163,527	2,592,385	65,434	2,064,750	373,015	16,419,808
borxhi nga 2-5 vjet	37,782	723,861	253,656	15,288,686	107,594	19,682,147	254,017	5,211,775	188,675	13,175,292	841,724	54,081,761
borxhi mbi 5 vjet	33,610	671,631	36,221	5,999,134	21,768	11,119,811	123,414	4,640,021	71,826	6,754,509	286,839	29,185,106
TOTALI	**135,085**	**2,058,454**	**423,207**	**33,392,452**	**244,160**	**41,907,068**	**877,734**	**16,965,799**	**399,023**	**28,144,638**	**2,079,209**	**122,468,410**

Burimi:DMDTP

Mosha e detyrimeve tatimore sipas llojit në bazë rajoni.

Tabela 4: Mosha e detyrimeve ï Rajoni Qendror

Në 000/lekë

MOSHA E BORXHIT	*Detyrimet Tatimore*											
	TATIM MBI TË ARDHURËN PERSONALE		*TATIM FITIMI*		*TVSH*		*SIGURIME SHOQËRORE & SHËNDETËSORE*		*TË TJERA*		*TOTALI*	
	nr. i rasteve	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*
borxhi deri ne 3 muaj	7,420	62,322	9,185	506,096	13,004	890,215	70,886	992,365	16,452	301,058	116,947	2,752,057
borxhi nga 3 - 6 muaj	9,898	59,648	22,079	909,870	22,076	1,020,910	72,902	1,258,369	18,125	199,258	145,080	3,448,056
borxhi nga 6-12 muaj	13,396	74,526	12,161	1,731,041	19,546	2,221,036	53,869	995,685	28,079	5,076,896	127,051	10,099,185
borxhi nga1-2 vjet	13,005	131,856	74,199	3,067,819	26,005	3,001,258	87,183	1,648,654	48,511	895,426	248,903	8,745,014
borxhi nga 2-5 vjet	30,689	565,179	239,572	11,355,413	89,997	15,390,552	164,501	3,991,927	140,253	11,608,569	665,012	42,911,640
borxhi mbi 5 vjet	32,407	609,618	24,805	4,855,811	15,823	7,731,486	51,895	3,910,864	27,705	5,429,813	152,635	22,537,592
TOTALI	**106,815**	**1,503,150**	**382,001**	**22,426,050**	**186,451**	**30,255,458**	**501,236**	**12,797,865**	**279,125**	**23,511,021**	**1,455,628**	**90,493,543**

Burimi:DMDTP

Tabela5: Mosha e detyrimeve tatimore ï Rajoni i Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Në 000/ lekë

MOSHA E BORXHIT	*Detyrimet Tatimore*											
	TATIM MBI TË ARDHURËN PERSONALE		*TATIM FITIMI*		*TVSH*		*SIGURIME SHOQËRORE & SHËNDETËSORE*		*TË TJERA*		*TOTALI*	
	nr. i rasteve	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*	*nr. i rasteve*	*shuma*
borxhi deri ne 3 muaj	254	21,337	120	245,571	430	250,896	1,086	69,730	465	66,036	2,355	653,570
borxhi nga 3 - 6 muaj	215	12,726	113	959,007	182	90,940	796	34,331	124	13,415	1,430	1,110,419
borxhi nga 6-12 muaj	238	23,198	118	274,605	253	115,922	816	55,795	179	182,375	1,604	651,895
borxhi nga1-2 vjet	238	13,949	248	2,384,217	388	812,872	675	17,269	706	597,427	2,255	3,825,734
borxhi nga 2-5 vjet	594	25,368	479	2,853,581	871	2,049,570	1,797	56,334	1,385	382,794	5,126	5,367,647
borxhi mbi 5 vjet	44	1,575	14	13,587	129	723,600	197	27,811	43	133,538	427	900,110
TOTALI	**1,583**	**98,154**	**1,092**	**6,730,567**	**2,253**	**4,043,800**	**5,367**	**261,270**	**2,902**	**1,375,585**	**13,197**	**12,509,377**

Burimi:DMDTP

Tabela 6: Mosha edetyrimeve tatimore – Rajoni Jugor

Në 000/lekë

MOSHA E BORXHIT	Detyrimet Tatimore											
	TATIM MBI TË ARDHURËN PERSONALE		TATIM FITIMI		TVSH		SIGURIME SHOQËRORE & SHËNDETËSORE		TË TJERA		TOTALI	
	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma
borxhi deri ne 3 muaj	2,250	15,999	211	9,673	3,824	141,956	28,571	93,819	307	7,621	35,163	269,068
borxhi nga 3 - 6 muaj	2,946	29,468	1,140	42,944	3,341	125,452	34,866	191,665	368	19,229	42,661	408,758
borxhi nga 6-12 muaj	2,740	46,359	1,696	216,759	6,055	379,832	43,089	256,226	3,573	83,323	57,153	982,499
borxhi nga1-2 vjet	3,481	58,698	4,264	662,167	10,668	770,554	46,117	479,221	8,948	284,451	73,478	2,255,091
borxhi nga 2-5 vjet	2,485	44,675	8,672	365,573	9,258	921,295	51,322	460,190	33,495	695,385	105,232	2,487,118
borxhi mbi 5 vjet	1,159	60,438	5,655	589,417	4,125	463,513	44,015	335,344	23,648	606,901	78,602	2,055,613
TOTALI	**15,061**	**255,637**	**21,638**	**1,886,533**	**37,271**	**2,802,602**	**247,980**	**1,816,465**	**70,339**	**1,696,910**	**392,289**	**8,458,147**

Burimi:DMDTP

Tabela 7: Mosha e detyrimeve tatimore ï Rajoni Verior

Në 000/lekë

MOSHA E BORXHIT	Detyrimet Tatimore											
	TATIM MBI TË ARDHURËN PERSONALE		TATIM FITIMI		TVSH		SIGURIME SHOQËRORE & SHËNDETËSORE		TË TJERA		TOTALI	
	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma	nr. i rasteve	shuma
borxhi deri ne 3 muaj	2,173	15,575	801	408,710	1,430	286,223	11,831	244,794	354	22,470	16,589	977,772
borxhi nga 3 - 6 muaj	1,040	12,988	703	282,817	1,170	363,074	7,300	108,046	530	9,895	10,743	776,820
borxhi nga 6-12 muaj	1,383	16,656	2,486	132,035	1,690	113,641	10,764	220,794	4,532	168,509	20,855	651,635
borxhi nga1-2 vjet	3,016	67,655	3,806	271,300	4,736	520,328	29,552	447,240	7,269	287,446	48,379	1,593,969
borxhi nga 2-5 vjet	4,014	88,639	4,933	714,119	7,468	1,320,730	36,397	703,324	13,542	488,544	66,354	3,315,356
borxhi mbi 5 vjet			5,747	540,320	1,691	2,201,212	27,307	366,002	20,430	584,257	55,175	3,691,791
TOTALI	**11,626**	**201,513**	**18,476**	**2,349,301**	**18,185**	**4,805,208**	**123,151**	**2,090,200**	**46,657**	**1,561,121**	**218,095**	**11,007,343**

Burimi:DMDTP

Subjektet me detyrime tatimore me mbi 100 milion:

Nga auditimi i detyrimeve tatimore sipas të dhënave nga DMDTP pasqyruar në tabelën në aneksin nr.1/3, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve, rezulton se tatimpaguesit që përbëjnë peshë më të madhe në stokun e detyrimeve tatimore për vitin 2020, janë 125 subjekte, me një detyrim tatimore mbi 100 milion lekë me një detyrim total prej 67miliard lekë ose rreth 54,7 % e stokut të detyrimeve tatimore të raportuar në fund të vitit 2020. Sipas rajoneve këto subjekte paraqiten si më poshtë:

Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesit v.2020 paraqiten:

Në 000/lekë

Nr.	Rajoni	Nr. Tatimpag. Aktivë	Vlera e detyrimeve për Tatimpaguesit Aktivë	Nr. Tatimpag. Pasivë	Vlera e detyrimeve për Tatimpag. Pasivë/kerkese per crregjistrim	Detyrimi deri më 31.12.2020	
						Nr. Tatimpag.	Vlera e detyrimit
1	Qendror	11	4,822,802	72	44,213,994	83	49,036,796
2	NJTM	18	9,930,244	3	1,333,314	21	11,263,557
3	Jugor	3	591,394	4	664,446	7	1,255,840
4	Verior	5	668,416	9	4,796,414	14	5,464,830
	Totali	**37**	**16,012,855**	**88**	**51,008,167**	**125**	**67,021,022**

Sipas statusit detyrimet e këtij grupi paraqitet:

Tatimpaguesit Aktiv përbëjnë 29,6% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë 16 miliard lekë ose 23,8% të masës së detyrimeve tatimore.

Tatimpaguesit Pasiv përbëjnë 70,4% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë 51 miliard lekë ose 76,2% të masës së detyrimeve tatimore.

Masat shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe arkëtimet.

Për vitin 2020, ka vijuar zbatimi i procedurës në kuadër të rikuperimit të detyrimeve të vetë deklaruara pa u kthyer në borxh në bashkëpunim me Qendrën e Thirrjeve për tatimpaguesit debitorë me qëllim vetë përmbushjen e detyrimit nga ana e tatimpaguesve.

Funksioni i mbledhjes me forcë kryhet në secilën nga DRT që përfshihen në 4 rajonet. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimoreò, i ndryshuar parashikojnë instrumentat që DPT duhet dhe mund të përdorë për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

Progresiv 2020 (Janar - Dhjetor 2020) *000/leke*

	LLOJET E MASAVE SHTRENGUESE	Te Vendosura		Te Arketuara	
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma
		(1)	(2)	(3)	(4)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	93,986	78,875,059	102,775	6,562,404
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	114,283	85,147,844	111,846	5,532,650
3	Urdhër ekzekutime	16,264	1,089,955	5,837	212,140
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	40,790	15,133,038	4,748	363,159
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	50,187	20,914,634	4,288	223,348
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	30,566	13,695,677	2,745	186,470
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	18,121	19,722,411	2,324	190,640
8	Urdhër sekuestrimi	7,270	4,460,600	725	37,256
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	9,328	18,493,883	2,788	226,534
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	2,575	13,209,085	105	18,422
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore	261	21,577	342	33,189
	TOTALI			**238,523**	**13,586,213**

Burimi: DMDTP

Për vitin 2020, nga të dhënat referuese të DMDTP arkëtimi i detyrimit tatimor si pasojë e vendosjes së masave shtrënguese është në total 13,6 miliard lekë.

Lloji i masës shtrënguese që është **aplikuar më shumë ndaj tatimpaguesve është "urdhër bllokimi i llogarisë bankare" në 114,283 raste dhe janë arkëtuar 5,5 miliard lekë, ndërsa më shumë janë arkëtuar nga aplikimi i masës shtrënguese "njoftim dhe kërkesa për pagesë" në vlerën6,5 miliard lekëpër 93,986 raste**. Arkëtimet që rrjedhin nga vendosja e masave shtrënguese për vitin 2020, përfshijnë dhe masat vendosura në periudhat e mëparshme.

Rajoni Qendror

	LLOJET E MASAVE SHTRENGUESE	Te Vendosura		Te Arketuara	
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma
		(1)	(2)	(3)	(4)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	57,179	54,216,646	34,072	1,377,654
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	67,521	68,901,560	56,401	4,185,125
3	Urdhër ekzekutime	486	69,186	405	64,569
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	20,024	9,186,276	3,283	325,683
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	28,195	9,186,276	3,400	159,778
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	8,903	9,186,276	1,358	156,862
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	8,903	9,186,279	868	140,511
8	Urdhër sekuestrimi	6,880	4,243,889	601	27,656
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë				
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98				
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit				
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	6,963	8,584,044	2,298	137,900
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	1,652	10,620,736	3	548
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore			110	28,562
	TOTALI			**102,799**	**6,604,848**

Burimi : DMDTP

Rajoni Verior

	LLOJET E MASAVE SHTRENGUESE	Te Vendosura		Te Arketuara	
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma
		(1)	(2)	(3)	(4)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	8,364	7,792,929	33,810	540,026
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	23,642	13,195,794	33,146	722,923
3	Urdhër ekzekutime	12,804	943,246	3,438	43,370
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	17,334	4,358,681	771	22,359
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	17,509	9,290,549	266	6,076
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	17,163	2,294,660	299	3,284
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	4,718	8,321,393	139	1,454
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	523	8,156,098	150	53,116
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	610	2,322,267	12	8,778
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore	2	564	2	564
	TOTALI	**102,669**	**56,676,181**	**72,033**	**1,401,950**

Burimi : DMDTP

NJTM

	LLOJET E MASAVE SHTRENGUESE	Te Vendosura		Te Arketuara	
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma
		(1)	(2)	(3)	(4)
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,563	10,370,284	1,617	3,852,415
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	70	901,144	50	193,890
3	Urdhër ekzekutime	13	45,507	13	45,527
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	3	237,591		
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	3	237,591		
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	3	237,591		
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	3	237,591		
8	Urdhër sekuestrimi	6	183,529	4	6,455
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë				
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98				
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit				
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	2	127,510		
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	3	237,591		
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore				
	TOTALI			**1,684**	**4,098,287**

Burimi: DMDTP

Rajoni Jugor *000/leke*

	LLOJET E MASAVE SHTRENGUESE	**Te Vendosura**		**Te Arketuara**	
		Nr.raste	**Shuma**	**Nr.raste**	**Shuma**
		(1)	**(2)**	**(3)**	**(4)**
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	26,880	6,495,200	33,276	792,309
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	23,050	2,149,346	22,249	430,712
3	Urdhër ekzekutime	2,961	32,016	1,981	58,674
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	3,429	1,350,490	694	15,117
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	4,480	2,200,218	622	57,494
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	4,497	1,977,150	1,088	26,324
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	4,497	1,977,148	1,317	48,675
8	Urdhër sekuestrimi	384	33,182	120	3,145
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-

12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	1,840	1,626,231	340	35,518
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	310	28,491	90	9,096
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore	259	21,013	230	4,063
	TOTALI			**62,007**	**1,481,127**

Burimi: DMDTP

Rajoni që ka arkëtuar më tepër detyrime tatimore nga vendosja e masës shtrënguese ñ*njoftim dhe kërkesa për pagesë*ò është NJTM në shumën prej 3,8miliard lekë për 1,563raste i ndjekur nga Rajoni Qendror me vlerë arkëtimi 1,3 miliard lekë për 57,179 raste.

Nga ana e Rajoneve të Mbledhjes ka vijuar zbatimi i procedurës së komunikimit me tatimpaguesit duke patur për qëllim vetëpërmbushjen vullnetare të detyrimeve të papaguara si dhe sqarimin e procedurave te mbledhjes me forcë të cilat do të vijojnë në zbatim të ligjit. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DPT ka monitoruar ecurinë e stokut të detyrimeve, ka kryer analiza të situatës së detyrimeve në nivel subjektesh dhe veçanërisht atyre më të mëdha, masave të ndërmarra në lidhje me to në përputhje me aktet ligjore ne fuqi.
Ka vijuar zbatimi i procedurës në bashkëpunim me Qendrën e Thirrjeve në kuadër të rekuperimit të detyrimeve të vetëdeklaruara pa u kthyer detyrime tatimore të papaguara në afat si dhe korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë/Drejtorinë e Apelimit Tatimor si dhe me Drejtorinë Teknike dhe Ligjore dhe drejtori të tjera në lidhje me dhënien e informacionit periodik në datë 04 të çdo muaji, për tatimpaguesit të cilët janë në proces ankimi administrativ.
Gjithashtu, për vitin 2020, rezulton se përmes shkresës nr. 19427 prot., datë 07.10.2020 drejtuar Drejtorisë Teknike dhe ligjore, DPT ka iniciuar përmirësim ligjor në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò i ndryshuar në lidhje me kthimin në ñtitull ekzekutivò të aktit administrativ ñNjoftim Vlerësimi Tatimorò për të cilin nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrative e gjyqësor, etj.
Marrëveshjet me këste.
Në zbatim të Urdhrit nr.33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, është implementuar struktura e re organizative e administratës tatimore, e cila konsiston ndër të tjera edhe në krijimin e drejtorive përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, parashikuar shprehimisht edhe në pikën 5, të nenit 88, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar.
Në rastet kur, Tatimpaguesi paraqet pranë DRT-së së juridiksionit, një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste për detyrimet e papaguara, afatet dhe procedurat që ndiqen janë ato të parashikuara shprehimisht në nenin 77 dhe 78, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar.
Kërkesa duhet të trajtohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes dhe në rastet kur kërkesa pranohet, marrëveshja nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatim ore. Trajtimi i kërkesës bëhet nga Inspektori i kontrollit nga zyra që ka në ndjekje tatimpaguesin i cili analizon kërkesën, verifikon situatën e tatimpaguesit lidhur me gjendjen kreditore dhe debitorë, kryen kompensimin e detyrimeve nëse është e nevojshme dhe verifikon statusin e masave shtrënguese, kryesisht nëse kanë filluar procedurat e shitjes në ankand të pasurive të konfiskuara për efekt të detyrimit tatimor të pashlyer. DMDTP mban regjistrin analitik të aktmarrëveshjeve të pagesës me këste, mbi bazën e të dhënave të dërguara nga Rajonet.
Nga të dhënat referuese të DMDTP, gjatë periudhës **Janar-Korrik2020** nga Rajonet në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 77, **janë lidhur 472 marrëveshje me kësteme vlerë totale 1,2 miliard lekë.**

Rreth 36% e shumës së debisë ose në vlerë 417,3 milion, për të cilën është lidhur Aktmarrëveshja (AM) është paguar në momentin e lidhjes, si kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit. **Gjatë vitit 2020, vlera e arkëtuar nga marrëveshjet e mbartura dhe ato të lidhura rishtas është 545 milion lekë**. **Marrëveshjet e anuluara në total janë 142 ku përfshihen dhe AM e lidhura në vitin e mëparshëm**.
Sipas Rajoneve marrëveshjet e lidhura, pagesat e kryera, pagesat në momentin e lidhjes së AM paraqiten në tabelë:

Në lekë

Drejtoritë Rajonale	A-M të lidhura	Subjekt. që lidhin A-M	Vlera Totale e debisë për të cilën është lidhur A-M	Pagesa në momentin e lidhjes A-M (vlera fillestare e pag.)	Vlera e paguar gjatë muajit nga A-M e mbartura	A-M të anulluara
Berat	9	9	4,118,727	1,532,096	3,007,820	3
Diber	10	10	17,775,449	4,679,158	8,540,357	5
Durres	79	79	165,243,754	98,933,008	62,823,726	23
Elbasan	54	54	55,086,205	19,249,272	17,700,463	12
Fier	38	38	57,605,677	11,964,604	42,308,788	12
Gjirokaster	6	6	17,999,791	5,870,115	2,992,718	6
Korçe	33	33	25,229,038	6,069,034	15,912,200	17
Kukes	12	12	21,120,522	11,051,551	6,176,621	5
Lezhe	9	9	41,593,692	10,224,205	28,859,325	2
Sarande	29	29	29,802,573	8,347,813	7,070,824	12
Shkoder	19	19	16,944,027	4,944,192	13,001,893	6
Tirane	112	112	345,728,506	143,027,929	190,783,113	23
VIP/NJTM	19	19	308,314,555	78,388,975	125,885,973	3
Vlore	43	43	44,890,249	13,096,177	19,926,278	13
Total	**472**	**472**	**1,151,452,765**	**417,378,129**	**544,990,099**	**142**

Burimi: DMDTP

Nga të dhënat e tabelës rezulton se DRT Tiranë ndjekur nga VIP/NJTM ka vlerat më të mëdha të detyrimeve tatimore të papaguara për të cilat janë lidhur aktmarrëveshja.
Nga periudha gusht 2020 deri dhjetor 2020 ndjekja e aktmarrëveshjeve me kusht bëhet nga Drejtoritë e Kontrollit Tatimor dhe jo nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara pranë Rajoneve, referuar ndryshimeve ligjore dhe strukturore që ka pësuar DMDTP në zbatim tëUrdhrit nr.33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit si dhe pikës 5, të nenit 88, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar.

(***Për sa sipër, referuar konstatimeve më lart është mbajtur Akt konstatimi nr.1 datë 9.8.2021)***

IV. 3. Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore.

A. Planifikimi i të ardhurave tatimore të vitit 2020, ndryshimet, plani përfundimtar dhe shpërndarja e tij sipas Drejtorive Rajonale dhe zërave, miratimi i tyre.

Baza Ligjore
Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore, i ndryshuar,
-nr.25, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareveò;
-nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
-nr.88/2019, datë 18.12.2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar;
-nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
-nr.92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
-nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar;
-nr.9975, datë 28.07.2008 ñPër taksat kombëtareò, i ndryshuar;
-nr.9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve

shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
-nr.114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò;
-nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar;
-nr.33/2017 ñPër pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimoreò.
-Akte të tjera nënligjore në zbatim të tyre.
Nga auditimi u shqyrtua dokumentacioni si në vijim: Shkresat e MFE për planin e të ardhurave për tu mbledhur nga administrata tatimore gjatë vitit 2020, me bazuar në ligjin 88/2019, datë 15.12.2019 ñPër Buxhetin e Vitit 2020ò, si dhe ndryshimet përkatëse në planin e të ardhurave;
Pjesë nga Raporti Vjetor 2020 i DPT; informacione të përgatitura nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit; informacione të përgatitura nga ana e Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit; treguesit e të ardhurave për vitin 2020 dhe realizimet; dokumentacione tjera të administruar gjatë auditimit.
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Nga auditimi konstatohet se, për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar e njëjta metodologji mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT, ku plani i ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpërndahet bazuar në pjesën që zë çdo drejtori në nivel 10 vjeçar dhe 3 vjeçar për secilin zë të të ardhurave dhe Sektori Statistikës në DPT vendos variantin e tij të shpërndarjes së planit, i cili më pas miratohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Grupit të Punës dhe më tej për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm.

- **Detajimi planit të buxhetit të vitit 2020.**
  Detajimi i planit të buxhetit për Të Ardhurat nga Tatimettë programin 1140 ñMenaxhimi i të Ardhurave Tatimoreò të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është sipas shkresave në vijim,
  -ñPlani i të ardhurave për administratën tatimore për vitin 2020ò me nr.1375 prot., datë 22.01.2020, protokolluar në DPT me nr.1727 prot., datë 24.01.2020,
  -ñPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò me nr.1376 prot., datë 24.01.2021, protokolluar ne DPT me nr.1728 prot., datë 24,01,2020.
  - ñMbi taksën nacionale të tjeraò për vitin 2020 me nr.1373 prot., datë 22.01.2020, protokolluar në DPT me nr.1729 prot. Datë 24,01,2020.
  Tabela në vijim paraqet, planin e Të ardhurave Tatimore, bazuar në ligjin e buxhetit të vitit 2020.

Në mijë lekë

	E M E R T I M I	Realizimi Faktik 2019	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Diferenca	Ndryshimi Plan/Fakt
		1	2	3=2-1	
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	**259,461,414**	**280,455,000**	**20,993,586**	**8%**
A	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)**	**165,294,011**	**181,000,000**	**15,705,989**	**10%**
1	TVSH (bruto)	49,456,618	58,900,000	9,443,382	19%
	- TVSH (neto)	25,947,162	37,900,000	11,952,838	46%
	- Rimbursimi i kryer	23,509,456	21,000,000	-2,509,456	-11%
2	Tatim mbi Fitimin	36,484,399	38,000,000	1,515,601	4%
3	Ardhura Personale	46,226,037	47,500,000	1,273,963	3%
4	Taksat Nacionale	13,211,686	14,540,000	1,328,314	10%
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	18,754,453	21,150,000	2,395,547	13%

6	Lojrat e Fatit	910,263	910,000	-263	0%
7	Te tjera pa identifikuar	-0.02		0	-100%
8	Denimet Administrative	250,556		-250,556	-100%
B	**Te Ardhurat Tatimore (neto)**	**141,784,555**	**160,000,000**	**18,215,445**	**13%**
C	**Kontributet e Sigurimeve**	**94,167,402**	**99,455,000**	**5,287,598**	6%
D=B+C	**TOTAL TË ARDHURA (Neto)**	**235,951,958**	**259,455,000**	**23,503,042**	**10%**

- **Struktura e të ardhurave.** Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:
  A. Të ardhurat tatimore. Siç shihet nga të dhënat e mësipërme p lani i **të ardhurave tatimore për tu arkëtuar** në vitin 2020 është në vlerën **181,000 milion leke**, i cili në krahasim me realizimin faktik të ardhurave të vitit 2019 ka pësuar një rritje me 10%, ose është rritur në vlerën për 15,705 milionë lekë.Planifikimi i të ardhurave sipas zërave, në krahasim me realizimin faktik të vitit të mëparshëm buxhetor është rritur si në vijim.
  Të ardhurat nga TVSH Bruto është planifikuar me rritje në masën 19 %, ndërkohë që TVSH për tu rimbursuar gjithsej, është parashikuar më i ulët në masën 11%.
  Të ardhurat nga Tatim mbi Fitimin, janë planifikuar me një rritje në masën 4 %,
  Të ardhurat Ardhura Personale janë planifikuar me një rritje në masën 3%.
  Të ardhurat nga Taksat dhe Tarifa Nacionale janë planifikuar me një rritje në masën 10%.
  Të ardhurat nga Taksa e Qarkullimit Rrugor janë planifikuar me një rritje në masën 13%.
  B. Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Për vitin 2020, Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve gjithsej, janë planifikuar me një rritje në masën 6 % krahasuar me vitin 2019 ose janë planifikuar në vlerën për **99,455 milion lekë.**
- **Mbi ndryshimet e planit të buxhetit të vitit 2020 me Akte Normative.**
  Me Akti Normativ, nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime në Ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar, konstatohet se plani i të ardhurave krahasuar me planifikimin fillestar është ulur në vlerën për 33,975 milion lekë ose në masën 12% si pasojë e gjendjes së emergjencës shëndetësore si rrjedhojë e impaktit negativ të covid-19. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin e të ardhurave buxhetore për vitin 2020 të DPT-së.

Në mijë lekë

	E M E R T I M I	**Realizimi Faktik 2019**	**Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit**	**Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020**	**Diferenca**	**Diferenca %**
		1	**2**	**3**	**4=3-2**	
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	**259,461,414**	**280,455,000**	**246,480,000**	**-33,975,000**	**-12%**
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	**165,294,011**	**181,000,000**	**155,580,000**	**-25,420,000**	**-14%**
1	TVSH (bruto)	49,456,618	58,900,000	50,660,000	-8,240,000	-14%
	- TVSH (neto)	25,947,162	37,900,000	29,660,000	-8,240,000	-22%
	- Rimbursimi i kryer	23,509,456	21,000,000	21,000,000	0	0%
2	Tatim mbi Fitimin	36,484,399	38,000,000	30,390,000	-7,610,000	-20%
3	Ardhura Personale	46,226,037	47,500,000	41,080,000	-6,420,000	-14%
4	Taksat Nacionale	13,211,686	14,540,000	13,624,000	-916,000	-6%
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	18,754,453	21,150,000	19,200,000	-1,950,000	-9%
6	Lojrat e Fatit	910,263	910,000	626,000	-284,000	-31%
7	Te tjera pa identifikuar	-0.02		0	0	
8	Denimet Administrative	250,556		0	0	
B	**Te Ardhurat Tatimore (neto)**	**141,784,555**	**160,000,000**	**134,580,000**	**-25,420,000**	**-16%**
C	**Kontributet e Sigurimeve**	**94,167,402**	**99,455,000**	**90,900,000**	**-8,555,000**	**-9%**
D=B+C	**TË ARDHURA TOTAL (Neto)**	**235,951,958**	**259,455,000**	**225,480,000**	**-33,975,000**	**-13%**

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme plani përfundimtar i **të ardhurave tatimore për tu arkëtuar** në vitin 2020 është në vlerën **155,580 milionë lekë**, i cili në krahasim me planifikimin fillestar sipas Ligjit të Buxhetit të vitit 2020, ka pësuar një ulje me 14%, ose është ulur në vlerën për 25,420 milionë lekë. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2019, ky

plan është më i ulët në vlerën për 9,714 milion lekë ose në masën 6% më pak.
Planifikimi i të ardhurave sipas zërave, në krahasim me planin fillestar është si vijon:
-Të ardhurat nga TVSH Bruto kanë pësuar një ulje në masën 14 % ose në vlerën për 8,240 milion lekë , ndërkohë që TVSH për tu rimbursuar gjithsej, nuk ka pësuar ndryshime.
-Të ardhurat nga Tatim mbi Fitimin, kanë pësuar një ulje në masën 20% ose në vlerën për 7,610 milion lekë.
-Të ardhurat Ardhura Personale kanë pësuar një ulje në masën 14% ose në vlerën për 6,6420 milion lekë.
-Të ardhurat nga Taksat dhe Tarifa Nacionale kanë pësuar një ulje në masën 6% ose në vlerën për 916 milion lekë.
-Të ardhurat nga Taksa e Qarkullimit Rrugor kanë pësuar një ulje në masën 9% ose në vlerën për 1,950 milion lekë.
B. Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Për vitin 2020, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve gjithsej, kanë pësuar një ulje në masën 9% ose në vlerën për 8,555 milion lekë.

- **Shpërndarja e Planit të të Ardhurave sipas Drejtorive Rajonale.**
Plani i miratuar për të ardhurat tatimore për vitin 2020 detajohet dhe miratohet nga Komiteti i Përmbushjes i krijuar në zbatim të urdhrit nr.09, datë 06.02.2020 ñPër detajimin e planit të të ardhurave për vitin 2020ò i cili me vendimin nr.16 Datë 21.02.2020 ka miratuar dhe planin e të ardhurave tatimore për vitin 2020 për çdo Drejtori Rajonale Tatimore, i cili në vijim është përcjellë me shkresë secilës DRT. Nga auditimi konstatohet se për shpërndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie është zbatuar e njëjta metodologji, mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore.Më konkretisht**,** plani i ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpërndahet bazuar në Metodologjinë e shpërndarjes së planit në nivel DRT vënë në dispozicion nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës/Sektori i Statistikë Analizë, bazuar në përqindjet historike që zënë të ardhurat e realizuara në raport me totalin e arkëtimeve të tre viteve të fundit, për secilin zë të të ardhurave. Më pas, projektplani dërgohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Komitetit të Përmbushjes dhe më tej për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm, procedurë kjo e ndjekur ndër vite nga DPT.
Pesha specifike e çdo DRT në arkëtimin e të ardhurave tatimore, sipas të dhënave të vëna në dispozicion, paraqitet në tabelën në vijim ku DRT Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe ajo e Tiranës zënë përkatësisht 46% dhe 40% të të ardhurave të vitit 2020, ndërsa DRT-të e tjera, kanë një peshë specifike të ulët ndaj totalit të të ardhurave, duke variuar nga 1 % deri në 3 %.

Në mijë lekë

Nr.	Drejtoritë Rajonale Tatimore	Fakti 2019	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Diferenca	Diferenca	Pesha specifike kundrejt planit me ndrysh.
		1	2	3	4=3-2	%	
1	D.R. Tatimore Berat	1,153,686	1,065,000	875,000	-190,000	-18%	1%
2	D.R. Tatimore Dibra	1,249,457	1,420,000	1,235,000	-185,000	-13%	1%
3	D.R. Tatimore Durresi	5,216,129	5,430,000	4,150,000	-1,280,000	-24%	3%
4	D.R. Tatimore Elbasani	2,472,427	2,330,000	1,960,000	-370,000	-16%	1%
5	D.R. Tatimore Fieri	3,426,366	2,630,000	2,100,000	-530,000	-20%	2%
6	D.R. Tatimore Gjirokastra	965,132	810,000	710,000	-100,000	-12%	1%
7	D.R. Tatimore Korca	2,083,188	2,035,000	1,750,000	-285,000	-14%	1%
8	D.R. Tatimore Kukesi	811,427	697,000	602,000	-95,000	-14%	0%
9	D.R. Tatimore Lezha	1,509,981	1,448,000	1,225,000	-223,000	-15%	1%
10	D.R. Tatimore Saranda	1,037,213	817,000	680,000	-137,000	-17%	1%

11	D.R. Tatimore Shkodra	1,719,869	1,845,000	1,520,000	-325,000	-18%	1%
12	D.R. Tatimore Tirana	59,329,272	62,500,000	54,358,000	-8,142,000	-13%	40%
13	D.R. Tatimore TM	58,747,574	75,003,000	61,770,000	-13,233,000	-18%	46%
14	D.R. Tatimore Vlora	2,062,835	1,970,000	1,645,000	-325,000	-16%	1%
	Te Ardhurat Tatimore Neto	**141,784,555**	**160,000,000**	**134,580,000**	**-25,420,000**	**-16%**	

B. Realizimi i të ardhurave tatimore sipas llojit të tyre dhe problematika që lidhet me to. Ndryshimet në legjislacionin fiskal, vendimet teknike të DPT për vitin 2020 dhe impakti i tyre në të ardhurat tatimore.

Sipas Ligjit për Buxhetin e vitit 2020 dhe bazuar në ndryshimet sipas Akteve Normative përkatëse, respektivisht Akti Normativ I, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019, ñPër buxhetin e vitit 2020ò; dhe krahasuar me realizimin faktik 2019, situata paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

	E M E R T I M I	Realizimi Faktik 2019	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Fakti 2020	Diferenca Plan/Fakt	Realizimi %	Pesha specifike kundrejt Faktit
		1	2	3	4	5=4-3		
A+C	**DPT TOTAL BRUTO**	**259,461,414**	**280,455,000**	**246,480,000**	**235,499,428**	**-10,980,572**	**-4.45%**	
A	**Te Ardhurat Tatimore /Arketim.**	**165,294,011**	**181,000,000**	**155,580,000**	**141,382,556**	**-14,197,444**	**-9.13%**	
1	TVSH (bruto)	49,456,618	58,900,000	50,660,000	46,174,825	-4,485,175	-8.85%	33%
	- TVSH (neto)	25,947,162	37,900,000	29,660,000	29,663,293	3,293	0.01%	21%
	- Rimbursimi i kryer	23,509,456	21,000,000	21,000,000	16,511,532	-4,488,468	-21.37%	12%
2	Tatim mbi Fitimin	36,484,399	38,000,000	30,390,000	28,358,795	-2,031,205	-6.68%	20%
3	Ardhura Personale	46,226,037	47,500,000	41,080,000	37,069,163	-4,010,837	-9.76%	26%
4	Taksat Nacionale	13,211,686	14,540,000	13,624,000	11,903,013	-1,720,987	-12.63%	8%
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	18,754,453	21,150,000	19,200,000	17,033,877	-2,166,123	-11.28%	12%
6	Lojrat e Fatit	910,263	910,000	626,000	726,963	100,963	16.13%	1%
7	Te tjera pa identifikuar	-0.02		0	0	0		0%
8	Denimet Administrative	250,556		0	115,920	115,920		0%
B	**Te Ardhurat Tatimore (neto)**	**141,784,555**	**160,000,000**	**134,580,000**	**124,871,024**	-9,708,976	-7.21%	88%
C	**Kontributet e Sigurimeve**	**94,167,402**	**99,455,000**	**90,900,000**	**94,116,872**	**3,216,872**	**3.54%**	
D=B+C	**DPT TOTAL NETO**	**235,951,958**	**259,455,000**	**225,480,000**	**218,987,895**	**-6,492,105**	**-2.88%**	

Grafiku në vijim, paraqet planifikimin dhe realizimin e të Ardhurav Doganore për Vitin 2020.



Për vitin 2020, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 246, 480 milion lekë dhe janë realizuar 235.499 milion lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 10,981 mijë lekë ose 4.45 % më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, me realizim të ardhurash 259, 461 milion lekë, rënia e të ardhurave tatimore është 23,911 milion lekë më pak ose 9.24 % më pak. Nëse i referohemi të thënave të Thesarit konstatohet se, të ardhurat e realizuar për vitin ushtrimor për DPT-në janë në vlerën për 235,673 milion lekë, pra me një diferencë për 174,2 milion lekë më shumë në rakordimet më Degën e Thesarit se realizimi i të ardhurave të deklaruara. Nga auditimi u konstatua se, DPT nuk raporton si të ardhur, të ardhurat e mbledhura nga DPT, por që i takojnë institucioneve të tjera buxhetore për të cilat DPT nuk ka një plan të ardhurash dhe që rezultojnë në vlerën për 3,500 milion lekë, si dhe ardhur nga

rivlerësimi i pasurisë në zbatim të udhëzimit të MFE, Nr. 2727, datë 4.2.2020 Për procedurat e zbatimit të Ligjit nr. 90/2019, ñPër Rivlerësimin e Pasurisë së Paluajtshmeò dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit. Tabela në vijim paraqet në mënyrë analitike diferencën e krijuar në raportimin e të ardhurave.

Në mijë lekë.

Llogaria	Përshkrimi	Vlera
`	Tarife përShërbimet Konsullore	241,231
7110102	Tarife Përpajisjen me DëshmiAftësiepër Drejtim Automjeti	279,842
7110115	Tarife shërbimipër kalimin e kufirit me avion	803,842
7110117	Tarife shërbimipërshërbimet e radiokomunikacionit	474,567
7110119	Tarife shërbimipërpërdorimin e aparateve televizive	1,238,289
4481100	Agjent shërbimesh viti ne vazhdim Per tatimin e thjeshtuar	370,162
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	92,096
A	Totali I të ardhurave të cilat nuk janë pjesë e planifikimit të DPT dhe nuk janë përfshirë në realizimin faktit të të ardhurave të DPT-së.	3,500,030
B	Te ardhura nga rivlerësimi I pasurisë së paluajtshme	3,325,747
B-A	Diferenca me Thesarin	-174,283

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

A. Të Ardhurat Tatimore

Për vitin 2020, të ardhurat tatimore janë programuar 155.6 miliard lekë dhe janë realizuar **141.4 miliard lekë,** me një mosrealizim prej 14.2 miliard lekë ose 9.13 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën të ardhurat u realizuan 165.3 miliard lekë, rezultatet janë në ulje me 23.9 miliard lekë më pak ose 14.47 % më pak.

Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2020 dhe faktin e vitit 2019, për periudhën Janar ï Dhjetor 2020, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

A.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Për 12 mujorin 2020, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 29.6 miliard lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 29.7 miliard lekë, me një mbi realizim në vlerë prej 3.3 milionë lekë ose 0.01 % më shume.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 25.9 miliard lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 3.7 miliard lekë më shumë ose 14.3 % më shumë.

Tabela në vijim paraqet tatim paguesit më të mëdhenj të TVSH-së, të cilët i përkasin DTM-së

Në mijë lekë

Nr.	Nipt	Subjekt	Shuma
1	L	F SH U	1,097,940
2	K	A	1,059,465
3	L	O I S SH	966,277
4	K	V ALBANIA	962,667
5	J	A	571,101
6	J	GJ K	552,157
7	J	A	425,689
8	J	K	361,230
9	K	DALB	354,414
10	K	PH M A SHPK	309,101
11	J	O T	295,331
12	K	E A	295,029
13	J	C B SH	244,017
14	L	I A	243,188
15	K	M	237,458
16	J	A	225,280
17	K	A	205,783

18	K	A C	201,523
19	J	B KT	189,317
20	K	TE G	186,442
21	K	A D D	181,766
22	K	D	181,474
23	L	SAlbania	174,645
24	J	R B SH.A	173,139
25	K	S A Albania	167,888
26	L	K Z	165,465
27	J	IS	161,778
28	L	A A E	144,499
29	L	I B S	134,291
30	J	S	130,944
		Totali	**10,599,295**

A.2 Rimbursimi i Tvsh-së Për 12 mujorin 2020 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 21.0 miliard lekë dhe është realizuar në vlerën 16.5 miliard lekë me një mosrealizim prej 4.5 miliard lekë ose 21.37 % më pak.Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 në të cilën janë rimbursuar 23.5 miliard lekë, rimbursimet janë realizuar me 7.0 miliard lekë më pak ose 29.77% më pak.

A.3 Tatimi mbi Fitimin Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 30.4 miliard lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 28.4 miliard lekë, me një mosrealizim prej 2.0 miliard lekë ose 6.68% më pak.Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 36.4 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 8.1 miliard lekë më pak ose 22.27% më pak.

A.4 Tatimi mbi të Ardhurat Personale. Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 41.1 miliard lekë dhe është realizuar 37.1 miliard lekë, me një mosrealizim prej 4.0 miliard lekë ose 9.76 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 46.2 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 9.2 miliard lekë më pak ose 19.81% më pak.

A.5 Taksat Kombëtare dhe Tarifa. Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 13.6 miliard lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 11.9 miliard lekë, me një mosrealizim 1.7 miliard lekë ose 12.63% më pak.Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 13.2 miliard lekë, mbledhja e taksave është në ulje prej 1.3 miliard lekë ose 9.91 % më pak.

A.6 Taksa e Qarkullimit Rrugor Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 19.2 miliard lekë, janë arkëtuar 17.0 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 2.2 miliard lekë ose 11.28 % me pak.Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 18.8 miliard lekë, të ardhurat janë realizuar me ulje prej 1.7 miliard lekë ose 9.17 % me pak.

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 32.7% të të ardhurave tatimore.

Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 26.2 % të të ardhurave tatimore,

Tatimi mbi fitimin zë 20.1 % të të ardhurave tatimore,

Taksa e qarkullimit me 12.0% të të ardhurave tatimore.



B. Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2020, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 90.9 miliard lekë dhe janë realizuar **94.1 miliard lekë**, me një rritje prej 3.2 miliard lekë ose 3.54 % më shumë. Tabela në vijim paraqet realizimin faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2018-2020.

Mijë lekë

E M E R T I M I	Realizimi Faktik 2018	Realizimi Faktik 2019	Realizimi Faktik 2020
Të ardhura nga Kontributet e Sigurimeve	88,778,080	94,167,402	94,116,872

Konstatohet se në vitin 2020, të të ardhurave nga kontributet, krahasuar me vitin 2019, janë pakësuar në vlerën për 50,530 mijë lekë, vit në të cilin ka ndikuar dukshëm covid-19.

Grafiku në vijim paraqet të ardhurat nga kontributet sipas sektorëve të punësimit.



Sektori i punësimit	Vlera Mijë lekë	Pesha specifike
në Sektorin e Ndërtimit	5,523,486	5.87%
në Sektorin e Prodhimit	14,691,808	15.61%
në Sektorin e Shërbimit	57,424,510	61.01%
në Sektorin e Transportit	2,289,263	2.43%
në Sektorin e Tregtisë	14,187,806	15.07%
Totali	**94,116,872**	

- **<u>Realizimi i të ardhurave tatimore sipas Drejtorive Rajonale Tatimore.</u>**

Të ardhurat bruto tatimore dhe nga kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 235,499 milion lekë ose janë realizuar në masën 95,5% në vlerën për 10,980 milion lekë më pak se planifikimi i të ardhurave. Konstatohet se peshën kryesore në realizimin e të ardhurave tatimore e zënë DR Tatimpaguesit e Mëdhenj me një vlerë për 88,708 milion lekë ose 38 % të të ardhurave bruto e ndjekur nga DRT Tiranë në vlerën për 87,575 milion lekë ose në masën 37% të totalit të të ardhurave faktike. DRT Mëdhenj paraqitet me një mosrealizim të planit të të ardhurave në masën për 8,3% ose në vlerën për 8,031 milion lekë. Konstatohet se DRT Dibër ka realizuar planin e të ardhurave bruto në vlerën për 2,797 milion lekë duke reflektuar një **performancë jo të mirë** me një **mosrealizim** të planit të të ardhurave në masën **16,64%**

ose në vlerën për 558 milion lekë më pak se plani. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të të ardhurave sipas Drejtorive Tatimore Rajonale.

Në mijë lekë

DRT	Te ardhura Total Bruto			Te ardhura Tatimore Neto		
	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Realizimi ne %	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Realizimi ne %
Berat	3,545,000	3,436,374	-3.06%	3,145,000	3,096,533	-1.54%
Diber	3,355,000	2,796,761	-16.64%	3,185,000	2,172,819	-31.78%
Durres	13,780,000	13,211,494	-4.13%	12,080,000	12,187,869	0.89%
Elbasan	6,420,000	6,521,513	1.58%	6,060,000	6,040,265	-0.33%
Fier	7,800,000	7,481,537	-4.08%	6,800,000	6,608,907	-2.81%
Gjirokaster	2,450,000	2,659,726	8.56%	2,310,000	2,612,447	13.09%
Korce	5,435,000	5,240,820	-3.57%	5,180,000	4,896,133	-5.48%
Kukes	1,952,000	2,074,051	6.25%	1,882,000	2,024,108	7.55%
Lezhe	3,555,000	3,438,400	-3.28%	3,465,000	3,354,016	-3.20%
Sarande	1,765,000	1,830,667	3.72%	1,680,000	1,748,769	4.09%
Shkoder	5,730,000	5,485,549	-4.27%	5,380,000	5,302,947	-1.43%
Tirane	88,948,000	87,575,965	-1.54%	86,348,000	85,842,942	-0.58%
DTM	96,740,000	88,708,521	-8.30%	83,340,000	78,293,249	-6.06%
Vlore	5,005,000	5,038,051	0.66%	4,625,000	4,806,890	3.93%
Total	**246,480,000**	**235,499,428**	**-4.45%**	**225,480,000**	**218,987,896**	**-2.88%**

Grafiku në vijim, paraqet realizimin faktik të të ardhurave bruto për vitin 2020, sipas Drejtorive Rajonale.



Për vitin buxhetor 2020, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në lidhje me rakordimin e Të ardhurave Tatimore Fiskale mujore dhe progresive për vitin 2020. DPT rakordon të ardhurat e arkëtuara në sistemin E-tax dhe të pasqyruara në SIFQ. Në të ardhurat tatimore për vitin 2020 përfshihet edhe e ardhura nga rivlerësimi i pasurisë, tatim i cili bazuar në udhëzimin Udhëzim Nr. 2727, datë 4.2.2020 Për procedurat e zbatimit të Ligjit nr. 90/2019, ñPër Rivlerësimin e Pasurisë së Paluajtshmeò dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit, derdhet direkt në Thesar në të ardhurat dytësore të DRT-ve.

- **Mbi analizën e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje"**

  Nga auditimi, u konstatua se në përbërje të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuara sipas natyrës dhe llojit të të ardhurave janë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 ñMjete në ruajtjeò e cila përfaqëson **arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemimin e tyre.** Konstatohet se për vitin 2020, vlera e llogarisë 466 ñMjete në ruajtjeò, e përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave është në vlerën për **22,915 milion lekë** (pa përfshirë llogarinë 4665511 Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar, vlerë e cila nuk është përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave të DPT-së pasi kjo e ardhur kalon tek njësitë vendore. Kjo llogari funksionon në sistemin E Tax për te gjitha deklaratat tatimore ne sistem dhe që kontabilizohen te ardhura për lloj tatimi (deklarate) për te cilën ne momentin procesimit të një pagese ende nuk ka nje detyrim të kontabilizuar. Funksionimi i

kësaj llogarie përfshin ne pjesën me te madhe kontabilizimin e pagesave per këstet e tatim fitimit te cilat nuk kane një deklarate ne sistem ne momentin e pagesës pasi ajo deklarohet ne 3 mujorin e pare te vitit pasardhës.

Në nenin 46, Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të Rregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, të miratuar me urdhrin 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, citohet ñDrejtoria e Kontrollit Tatimor menaxhon procesin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratave tatimore dhe veprimtarisë së tatimpaguesve të mbulon Drejtoria Rajonale Tatimore. Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është menaxheri i këtij procesi.

Në lekë

4665	Depozitime te tjera (per tu sistemuar në të Ardhmen)	23,007,918,762
4665100	Depozitime te tjera ne ruajtje , Te vitit ushtrimor	-
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	80,487,387.
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	21,452,940,092.
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	529,791,037.
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	600,562,925.
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	195,503.
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	866,983.
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	4,719,759.
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjobat	5,617,404.
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sig shoqërore, shendet, TAP)	240,641,411.
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	92,096,261.

Tabela në vijim paraqet lëvizjet e llogarisë 4665504 ñDepozitime të përkohshme për deklaratën e TVSH-sëò, dhe llogarisë 4665504 ñDepozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionaleò, sipas muajve dhe sipas DRT-ve.

Në lekë

Periudhat	Depozitime të përkohshme për Deklaratën TVSH-së/4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale/4665505
Janar	184,975,294	150,281,087
Shkurt	108,800,378	450,100,236
Mars	-107,533,080	-345,996,704
Prill	-53,102,508	-39,327,260
Maj	-12,320,745	128,858,492
Qershor	111,551,982	-343,324,411
Korrik	68,907,991	200,179,278
Gusht	-51,504,726	-90,219,179
Shtator	10,771,538	589,986,851
Tetor	250,371,999	-45,958,803
Nentor	-139,528,082	-253,999,013
Dhjetor	158,400,996	199,982,351
12 Mujori	**529,791,037**	**600,562,925**

Në mënyrë grafike, lëvizjet e llogarisë ñPagesat e përkohshme për Deklaratën e TVSH-sëò, paraqiten si në vijim.



Në mënyrë grafike, lëvizjet e llogarisë ñPagesat e përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionaleò, paraqiten si në vijim.



Nga grafiku konstatohet se, lëvizjet më të mëdha kjo llogari i ka në muajin dhjetor të vitit, duke ndikuar në të ardhurat tatimore gjithsej të raportuara nga DPT për periudhën ushtrimore si dhe në saktësinë e raportimit sipas zërave të të ardhurave në llogaritë e dedikuara sipas klasifikimit buxhetor në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, pika 2.3. Tabela në vijim paraqet lëvizjet e llogarisë 4665504 **"Depozitime të përkohshme për deklaratën e TVSH-së"**, sipas DRT-ve.

Në mijë lekë

	DRT	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
1	Diber	124	7	20	215	65	74	34	20	3,514	221	-269	4,989	**9,013**
2	Berat	6,576	5,133	-1,475	-1,424	-1,247	-710	-494	1,378	3,664	1,244	3,579	-6,758	**9,465**
3	Durres	1,440	1,243	287	1,225	-1,763	-233	-21	1,254	5,879	-1,604	-3,097	347	**4,956**
4	DTM	123,271	84,011	-91,767	-54,586	-10,669	105,516	71,436	-60,580	-65,873	256,545	-154,395	111,885	**314,793**
5	Tirana	21,430	7,382	411	922	124	7,081	-2,506	-1,300	28,060	-2,443	-4,981	1,119	**55,298**
6	Korce	933	2,410	-2,047	-66	30	-37	-511	273	5,601	-3,801	7,736	-2,468	**8,052**
7	Gjirokaster	1,796	-1,545	184	70	-180	-7	-86	101	87	498	387	-26	**1,278**
8	Vlore	688	2,223	-412	135	730	-400	345	370	1,763	-571	11,042	2,780	**18,691**
9	Elbasan	904	-28	241	-23	30	-283	479	-479	1,207	-256	3,000	13,719	**18,512**
10	Shkoder	5,840	4,695	2,760	1,167	1,634	1,853	1,170	-245	14,213	-1,022	4,381	32,413	**68,858**
11	Fier	20,776	-2,610	-10,407	-477	-1,630	-1,094	-862	632	14,185	714	-11,966	2,584	**9,844**
12	Sarande	556	3,401	-3,138	-187	15	47	-321	-97	463	36	3,636	1,576	**5,987**
13	Lezhe	204	2,755	-2,193	-70	280	-3	213	1,197	78	122	2,110	-1,747	**2,946**
14	Kukes	438	-275	1	-3	261	-250	32	5,972	-2,068	688	-689	-2,011	**2,098**
	Totali	**184,975**	**108,800**	**-107,533**	**-53,103**	**-12,321**	**111,552**	**68,908**	**-51,505**	**10,772**	**250,372**	**-139,528**	**158,401**	**529,791**

Në mënyrë grafike, lëvizjet e llogarisë ñPagesat e përkohshme për Deklaratën e TVSH-së, sipas DRT-ve, paraqiten si në vijim.

Në mijë lekë









Tabela në vijim paraqet lëvizjet e llogarisë 4665504 **"Depozitime të përkohshme për Taxën Nacionale"**, sipas DRT-ve.

Në mijë lekë

DRT	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Diber	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
Berat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
Durres	0	1	0	0	0	0	177	-177	0	0	0	0	**1**
DTM	150,002	449,999	-346,096	-39,353	128,805	-343,357	200,002	-90,002	290,000	-45,975	45,975	200,013	**600,013**
Tirana	154	31	104	-5	81	5	0	14	299,993	3	-300,000	0	**380**
Korce	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
Gjirokaster	71	0	-5	25	1	20	0	0	0	5	-5	0	**111**
Vlore	0	62	0	-23	0	0	0	0	-5	0	0	0	**34**
Elbasan	54	6	0	0	0	0	0	-54	0	8	1	0	**15**
Shkoder	0	0	0	29	-29	0	0	0	0	0	0	0	**0**
Fier	0	0	0	0	0	8	0	0	0	0	0	0	**8**
Sarande	0	0	0	0	1	0	0	0	-1	0	31	-31	**0**
Lezhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
Kukes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**
Totali	**150,281**	**450,100**	**-345,997**	**-39,327**	**128,858**	**-343,324**	**200,179**	**-90,219**	**589,987**	**-45,959**	**-253,999**	**199,982**	**600,563**

Në mënyrë grafike, lëvizjet e llogarisë ñPagesat e përkohshme për Deklaratën e për Taxën Nacionale, sipas DRT-ve, paraqiten si në vijim.



Si konkluzion: *Për sa më lart vlera për* ***23,007 milion lekë, vetëm për vitin 2020,*** *e mbetur pezull dhe e pa kontabilizuar në llogarit e të ardhurave paraqet një rrisk të shtuar në:*
-Realizimin fiktiv të të ardhurave si pasojë e parapagimeve nga ana e tatimpaguesit me kërkesë të DRT-ve si realizim faktik të ardhurash.
-planifikimin jo të saktë të shpenzimeve nga ana e ISSH dhe FSDKSH-së pasi kontabilizimi i pagesave të tatimpaguesve në këtë llogari përfaqëson një të ardhur të munguar për ISSH-në dhe FSDKSH-në.
-mbarja e kësaj llogarie do të ndikonte në kontributet për pension të individëve pagesa e të cilëve ka mbetur pezull në këtë llogari.

Gjetja:	Performancë jo të mirë në mbledhjen e të ardhurave nga DRT Dibër dhe Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj,
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, Të ardhurat bruto tatimore dhe nga kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 235,499 milion lekë ose janë realizuar në masën 95,5% në vlerën për 10,980 milion lekë më pak se planifikimi të të ardhurave. Konstatohet se peshën kryesore në realizimin e të ardhurave tatimore e zënë DR Tatimpaguesit e Mëdhenj me një vlerë për 88,708 milion lekë ose 38 % të të ardhurave, Megjithëse përfaqëson 38 %, të të ardhurave bruto, **DRT Mëdhenj**, paraqitet me **një mosrealizim të planit të të ardhurave në masën për 8,3%** ose në vlerën për 8,031 milion lekë. Konstatohet se, DRT Dibër ka realizuar planin e të ardhurave bruto në vlerën për 2,797 milion lekë duke reflektuar një **performancë jo të mirë** me një **mosrealizim** të planit të të ardhurave në masën **16,64%** ose në vlerën për 558 milion lekë më pak se plani. *Konstatohet se,* ***nuk kanë performancë të mirë*** *në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore DRT, Vlorë Tiranë, Durrës ku konstatohet se, vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar për këtë zë në mbyllje të periudhës 2020, përfaqëson 25-27% të realizimit faktik të të ardhurave, e ndjekur nga DRT Shkodër, dhe Lezhë. Ndërkohë që DRT, me përformancën më të mirë paraqitët DTM ku vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar përfaqëson 1.1% të realizimit faktik të të ardhurave.* *Mos arkëtimi i të ardhurave nga kontributet nga ana e DPT-së, për* ***16,521,124 mijë lekë*** *nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.*
Kriteri :	Vendimi nr.16 Datë 21.02.2020 i Komitetit të Përmbushjes i cili ka miratuar planin e të ardhurave tatimore për vitin 2020 për çdo Drejtori Rajonale Tatimore
Ndikimi/Efekti	Mosrealizimi i planit sjell mos arritjen e objektivave të institucionit.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave nga këto Drejtori Rajonale me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

Gjetja:	Mbi llogarinë 466 ñMjete në ruajtjeò e cila përfaqëson **arkëtimet e**

paidentifikuara deri në sistemimin e tyre

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2020, vlera e llogarisë 466 ñMjete në ruajtjeò, e cila përfaqëson **arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemimin e tyre** e përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuara sipas natyrës dhe llojit të të ardhurave është në vlerën për **22,915 milion lekë** (pa përfshirë llogarinë 4665511 Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar, vlerë e cila nuk është përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave të DPT-së pasi kjo e ardhur kalon tek njësitë vendore.Konstatohet se, lëvizjet më të mëdha kjo llogari i ka në muajin dhjetor të vitit, duke ndikuar në të ardhurat tatimore gjithsej të raportuara nga DPT për periudhën ushtrimore si dhe në saktësinë e raportimit sipas zërave të të ardhurave në llogaritë e dedikuara sipas klasifikimit buxhetor në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, pika 2.3.

Situata: *Për sa më lart vlera për **22,915 milion lekë, vetëm për vitin 2020,** e mbetur pezull dhe e pa kontabilizuar në llogarinë e të ardhurave paraqet një risk të shtuar në:*

-Realizimin fiktiv të të ardhurave si pasojë e parapagimeve nga ana e tatimpaguesit me kërkesë të DRT-ve si realizim faktik të ardhurash

*Vlera për **240,641 mijë lekëembetur pezull dhe e pa kontabilizuar në llogarinë e të ardhurave nga kontributet** e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përfaqëson 0,26 % të të ardhurave totale vjetore nga kontributet e sigurimeve ka efekt në:*

-planifikimin jo të saktë të shpenzimeve nga ana e ISSH dhe FSDKSH-së pasi kontabilizimi i pagesave të tatimpaguesve në këtë llogari përfaqëson një të ardhur të munguar për ISSH-në dhe FSDKSH-në.

-mbarja e kësaj llogarie do të ndikonte në kontributet për pension të individëve pagesa e të cilëve ka mbetur pezull në këtë llogari.

Kriteri : -nenin 46, Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të ñRregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimoreò të miratuar me urdhrin 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, citohet ñ*Drejtoria e Kontrollit Tatimor menaxhon procesin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratave tatimore dhe veprimtarisë së tatimpaguesve të mbulon Drejtoria Rajonale Tatimore. Drejtori I Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është menaxheri I këtij procesi.*

Efekti Ndikim në të ardhurat tatimore gjithsej të raportuara nga DPT për periudhën ushtrimore si dhe në saktësinë e raportimit sipas zërave të të ardhurave në llogaritë e dedikuara sipas klasifikimit buxhetor në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, pika 2.3.

Rëndësia E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve të marrin masat e nevojshme për mbikëqyrjen e punës së DRT-ve në drejtim të sistemimit të arkëtimeve të pa identifikuarame qëllim minimizimin e vlerës së paraqitur në llogarinë 466 ñMjete në ruajtjeò dhe klasifikimin e saktë të të ardhurave tatimore.

3.C Saktësia e mbledhjes së të ardhurave për ISSH dhe FSDKSH. Rakordimi i vlerave, dërgimi i list-pagesave dhe lista e debitorëve. Transferimi i të ardhurave të mbledhura te ISSH dhe FSDKSH nëpërmjet thesarit. Totali i deklarimeve dhe raporti i pagesave në nivel tatimpaguesish.

Për auditimin e kësaj çështje u shqyrtua dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit si dhe të dhëna të detajuara marrë nga AKSHI më lidhje me listë pagesat e deklaruara dhe të paguara dhe debitorët për kontributet me të dhëna për vitin 2020 dhe progresive. Në zbatim të nenit 4 dhe 14 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Administrata Tatimore Qendrore është e ngarkuar për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar në rolin e agjentit tatimor që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe **mbledhjen e kontributeve**. Të ardhurat nga kontributet nënkuptojnë të ardhurat nga pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

3.c.1 Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

-ñPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò **në zbatim të ligjit 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020"**, është detajuar me shkresën e MFE me nr.1376 prot., datë 24.01.2021, protokolluar ne DPT me nr.1728 prot., datë 24,01,2020. Referua kësaj shkresë plani i të ardhurave për FSDKSH-në për vitin 2020, është në vlerën për **99,455,000 mijë lekë.**

-Me Akti Normativ, nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime në Ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar, konstatohet se plani i të ardhurave krahasuar me planifikimin fillestar është ulur në vlerën për 8,555,000 mijë lekë ose në masën 9 % si pasojë e gjendjes së emergjencës shëndetësore si rrjedhojë e impaktit negativ të covid-19.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të cilat mblidhen nga DPT për llogari të ISSH-së dhe FSDKSH-së.

Mijë lekë

E M E R T I M I	Realizimi Faktik 2019	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Diferenca	Diferenca %
	1	2	3	4=3-2	
Kontributet e Sigurimeve	**94,167,402**	**99,455,000**	**90,900,000**	**-8,555,000**	**-9%**

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizim e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat në bazë të legjislacionit mblidhen nga DPT.

Mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Plani 2020 Akti Normativ	Realizimi Faktik 2020	%
Berat	2,270,000	2,244,680	99%
Diber	1,950,000	1,901,750	98%
Durres	7,930,000	8,165,852	103%
Elbasan	4,100,000	4,225,605	103%
Fier	4,700,000	4,755,100	101%
Gjirokastër	1,600,000	1,757,785	110%
Korçë	3,430,000	3,532,991	103%
Kukës	1,280,000	1,402,599	110%
Lezhe	2,240,000	2,232,975	100%
Sarande	1,000,000	1,086,503	109%
Shkodër	3,860,000	3,742,707	97%
Tirane	31,990,000	33,806,546	106%
DTM	21,570,000	22,182,121	103%
Vlore	2,980,000	3,079,655	103%
Totali	**90,900,000**	**94,116,872**	104%

Në realizimin e të ardhurave, si edhe në procesin e planifikimit, peshën specifike më të lartë e zë DRT Tiranë me afro 36% dhe DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj me 24%, të totalit të të ardhurave. Vetëm tre DRT rezultojnë me mos realizim të planit të të ardhurave. Më konkretisht: DRT-të Berat, Dibër dhe Shkodër, ndërkohë që DRT-të e tjera rezultojnë me një tejkalim të planit të të ardhurave nga mbledhja e kontributeve të sigurimeve. Më konkretisht, tejkalimin më të lartë e kanë DRT-të Gjirokastër, Kukës dhe Sarandë. Nga auditimi u konstatua se, DPT, përfshin sit ë ardhur nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe të ardhurat nga **kamatvonesat dhe gjobat** të cilat janë të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe vlerën e **llogarisë 466** e cila përfaqëson **detyrimin e paguar për kobtributet i cili ka mbetur pezull** pa u kontabilizuar ende në llogarinë përkatëse të të ardhurës. Vlera totale e këtyre të ardhurave të përfshira në zërin ñTë ardhura nga kontributetò, rezulton në vlerën për 794,822 mijë lekë. Tabela në vijim paraqet në mënyrë analitike llogaritë e të ardhurave të përfshira si e ardhur nga kontributet.

Në mijë lekë.

Llogari	Pershkrimi	Vlera
7090101	Kamat vonesa te kontrib te sig. shoqerore	126,442,402
7090104	Kamat vonesa te kontrib te sig. shendetsore	15,920,225
7115101	Gjoba te sigurimeve shoqerore	229,822,448
7115118	Gjoba te sigurimeve shendetsore	35,875,517
7115654	Gjoba per deklarim te vonuar Sig Shoq,shend,dhe tap	49,370,530
7115119	Gjoba per mosdeklarim punonjesish	96,749,372
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sigurime shoqerore, shendetesore dhe TAP)	240,641,411
	Totali I Përgjithshëm	**794,821,905**

Për sa më lart vlera e raportuar si e ardhur nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për **94,116,872 mijë lekë** është e përbërë nga **Të ardhura nga kontributet në vlerën për 93,322,050 mijë lekë** dhe të **ardhura të tjera për vlerën 794,821,905 mijë lekë**.

Lekë

A=1+2+3	75	Kontributet e Sigurimeve Gjithsej	93,322,049,685
1	750	Kontribute nga te punesuarit	35,911,908,884
	7500	Kontribute te sektorit buxhetor te punesuar	14,831,977,258
	7500100	Sigurime shoqerore	11,379,118,196
	7500200	Sigurime shendetsore	2,134,556,598
	7500400	Kontribute suplementar	1,318,302,464
1.1	7501	Kontribute te sektorit shteteror te punesuar	1,742,624,539
	7501100	Sigurime shoqerore	1,463,529,044
	7501200	Sigurime shendetsore	275,713,177
	7501400	Kontribute suplementar	3,382,318
1.2	7502	Kontribute te sektorit Privat te punesuar	19,337,307,087
	7502100	Sigurime shoqerore	15,691,219,465
	7502200	Sigurime shendetsore	3,606,149,563
	7502400	Kontribute suplementar	39,938,059
2	751	Kontribute nga te punedhenesi	53,483,748,914
2.1	7510	Kontribute te sektorit buxhetor te punedhenes	19,826,853,101
	7510100	Sigurime shoqerore	17,681,760,325
	7510200	Sigurime shendetsore	2,134,977,079
	7510400	Kontribute suplementar	10,115,697
2.2	7511	Kontribute te sektorit shteteror te punedhenes	2,566,118,362
	7511100	Sigurime shoqerore	2,290,392,221
	7511200	Sigurime shendetsore	275,725,691
	7511400	Kontribute suplementar	450
2.3	7512	Kontribute te sektorit Privat te punedhenes	31,090,777,451
	7512100	Sigurime shoqerore	27,439,873,291
	7512200	Sigurime shendetsore	3,602,650,635
	7512400	Kontribute suplementar	48,253,525
	7512999	Kontribute te paidentifikuara	
3	752	Kontribute nga te vetpunesuarit	3,926,391,887
3.1	7520	Kontribute nga te vetpunesuarit	3,926,391,887
	7520100	Sigurime shoqerore	3,064,474,829

	7520200	Sigurime shendetsore	861,917,058
B=5+6+7		**Te ardhura të tjera për llogari të kontributeve**	**794,821,905**
5		**Gjoba dhe kamatvonesa të kontributeve shoqërore**	**356,264,850**
	7090101	Kamat vonesa te kontrib te sig. shoqerore	126,442,402
	7115101	Gjoba te sigurimeve shoqerore	229,822,448
6		**Gjoba dhe kamatvonesa të kontributeve shendetësore**	**51,795,742**
	7090104	Kamat vonesa te kontrib te sig. shendetsore	15,920,225
	7115118	Gjoba te sigurimeve shendetsore	35,875,517
7		**Të ardhura të pa klasifikuara**	**386,761,313**
	7115654	Gjoba per deklarim te vonuar Sig Shoq,shend,dhe tap	49,370,530
	7115119	Gjoba per mosdeklarim punonjesish	96,749,372
	4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (Kontribute dhe TAP)	240,641,411
A+B		**Totali I Përgjithshëm**	**94,116,871,590**

Për sa më lart dhe referuar Raportit të DPT për periudhën 2020, Të ardhurat nga Kontributet janë në vlerën për **94,117 milion lekë.** Nëse i referohemi Raportit të Zbatimit ët Buxhetit të Shtetit për vitin 2020, të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KLSH konstatohet se, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve paraqiten në vlerën për **96,538 milion** lekë nga të cilat të ardhurat për kontributet shoqërore janë në vlerën për 83,515 milion lekë dhe të ardhurat për kontributet e sigurimeve shëndetësore janë në vlerën për 13,023 milion lekë.

Konstatohet se, ndërmjet MFE e cila është përgjegjëse për konsolidimin e treguesve fiskalë dhe DPT-së, metodologjia e raportimit të të ardhurave ga kontributet është e ndryshme pasi:
-DPT përfshin si të ardhur nga kontributet të ardhurat që sigurohen nga kamatvonesat dhe gjobat. Gjithashtu MFE në këtë zë përfshihen të ardhurat nga kontributet të cilat mblidhen nga vetë institucionet ISSH dhe FSDKSH. Tabela në vijim paraqet realizimin faktik të të ardhurave nga kontributet për periudhën 2018-2020.

Mijë lekë

E M E R T I M I	Realizimi Faktik 2018	Realizimi Faktik 2019	Realizimi Faktik 2020
Të ardhura nga Kontributet e Sigurimeve	88,778,080	94,167,402	94,116,872

Konstatohet se në vitin 2020, të të ardhurave nga kontributet, krahasuar me vitin 2019, janë pakësuar në vlerën për 50,530 mijë lekë, vit në të cilin ka ndikuar dukshëm covid-19.
Grafiku në vijim paraqet të ardhurat nga kontributet sipas sektorëve të punësimit.



Sektori I punësimit	Vlera Mijë lekë	Pesha specifike
në Sektorin e Ndërtimit	5,523,486	5.87%
në Sektorin e Prodhimit	14,691,808	15.61%
në Sektorin e Shërbimit	57,424,510	61.01%
në Sektorin e Transportit	2,289,263	2.43%
në Sektorin e Tregtisë	14,187,806	15.07%
Totali	**94,116,872**	

Për vitin buxhetor 2020, janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në lidhje me rakordimin e Të ardhurave fiskale mujore dhe progresive për vitin 2020.

- **Mbi analizën e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në sistemin E-Tax.**

Llogaria 466 ñKreditore për mjete ne ruajtjeò në vlerën për**240,641 mijë lekë** paraqet shumen e arkëtimeve te papërdorura ne sistemin E tax si mjete ne ruajtje vetëm për tatimoret në DPT. Në këtë llogari kontabilizohen te ardhura për te cilën ne momentin procesimit te një pagesës ende nuk ka një detyrim te kontabilizuar apo kur ka pasaktësi në deklarim nga ana e tatimpaguesve në lidhje me derdhjen e detyrimit.
Referuar nenit 79 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, radha e pagesës së kontributeve dhe detyrimeve tatimore paraqitet si vijon:
a) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore;
b) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit;
c) Kontributet e detyrueshme suplementare të sigurimeve shoqërore;
d) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit;
e) tatimet; f) kamatëvonesat; g) gjobat
Monitorimi i sistemit të pagesave si për detyrimet tatimore ashtu edhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është realizuar nga Sektori I Kontabilitetit dhe Pagesave I cili raporton dhe identifikon **pagesat pezull** dhe sistemimin e tyre në llogarinë e duhur të tatim paguesit. Për të verifikuar saktësinë e informacionit Sektori I Kontabilitetit dhe I Pagesave krahason ekstraktin bankar për pagesat e jashtme me të dhënat e ardhura elektronikisht nga SIFQ për ato që konsiderohen pagesa të brendshme dhe komunikon me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për saktësimin dhe sistemimin e informacionit. Gjatë vitit 2020 Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës ka sistemuar 1,140 raste të pagesave të mbetur pezull. Marrëdhënia ndërmjet DPT dhe Bankave të nivelit të dytë në lidhje me korrigjimin e veprimeve të gabuara është rregulluar me marrëveshje të përbashkëta të nënshkruara nga Ministri i Financave, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Drejtorët përkatës të Bankave të Nivelit të Dytë.
Në nenin 46, Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të Rregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, të miratuar me urdhrin 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, citohet ñDrejtoria e Kontrollit Tatimor menaxhon procesin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratave tatimore dhe veprimtarisë së tatimpaguesve të mbulon Drejtoria Rajonale Tatimore. Drejtori I Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është menaxheri I këtij procesi.
Si konkluzion:*Vlera për* ***240,641 mijë lekëembetur pezull dhe e pa kontabilizuar në llogarinë e të ardhurave nga kontributet*** *e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përfaqëson 0,26 % të të ardhurave totale vjetore nga kontributet e sigurimeve ka efekt në:*
-planifikimin jo të saktë të shpenzimeve nga ana e ISSH dhe FSDKSH-së pasi kontabilizimi i pagesave të tatimpaguesve në këtë llogari përfaqëson një të ardhur të munguar për ISSH-në dhe FSDKSH-në.
-mbarja e kësaj llogarie do të ndikonte në kontributet për pension të individëve pagesa e të cilëve ka mbetur pezull në këtë llogari.

3.c.2 Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (FSDKSH)
-ñPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò në zbatim të ligjit 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, është detajuar me shkresën e MFE me nr.1376 prot., datë 24.01.2021, protokolluar ne DPT me nr.1728 prot., datë 24,01,2020. Referua kësaj shkresë plani i të ardhurave për FSDKSH-në për vitin 2020, është në vlerën për **13,929,000 mijë lekë.**
-Plani i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Aktit Normativ nr. 28, datë 01,07,2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019,datë

18,12,2020ò është dërguar DPT-së me shkresën e MFE nr. 1452, datë 29,07,2020 me nr. Prot pranë DPT me nr. 15093, datë 30,07,2020.

Për FSDKSH-së plani i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shëndetësore është dërguar më shkresën e DPT-së nr. 15093/3, datë 06.08.2020 me subjekt ñDërgohet plani i të ardhurave për vitin 2020ò. Referua kësaj shkresë plani i të ardhurave për FSDKSH-në për vitin 2020, është në vlerën për **12,880,000 mijë lekë.** Nga auditimi u konstatua se, DPT, mbështetur në udhëzimin ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i është drejtuar në mënyrë periodike FSDKSH-së në lidhje me të ardhurat e realizuara për kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2020, janë dërguar pranë FSDKSH-së me shkresën nr. 738, datë 15.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2020, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore është realizuar në masën për **12,943.486 mijë lekë**.Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Në mijë lekë

	E M E R T I M I	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Ndryshimi Plan/Fakt
		1	2	3=2-1	
C	Kontributet e Sigurimeve shëndetësore	13,929,000	12,880.000	12,943,486	6%

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të realizimit të kontributeve shëndetësore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2020.

Në mijë lekë

	Drejtoritë Rajonale	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Diferenca	%
1	D. R. T. Berat	321,753	304,172	-17,581	95%
2	D. R. T. Diber	276,373	240,756	-35,617	87%
3	D. R. T. Durres	1,124,275	1,105,463	-18,812	98%
4	D. R. T. Elbasan	581,203	574,053	-7,150	99%
5	D. R. T. Fier	666,373	657,336	-9,037	99%
6	D. R. T. Gjirokaster	226,681	225,872	-809	100%
7	D. R. T. Korce	486,247	488,589	2,342	100%
8	D. R. T. Kukes	181,360	164,576	-16,783	91%
9	D. R. T. Lezhe	317,378	302,457	-14,921	95%
10	D. R. T. Sarande	141,817	152,211	10,394	107%
11	D. R. T. Shkoder	547,065	501,860	-45,206	92%
12	D. R. T. Tirane	4,535,200	4,622,339	87,138	102%
13	D. R.T. P,M	3,051,877	3,189,610	137,732	105%
14	D. R. T. Vlore	422,396	414,191	-8,205	98%
	Totali	**12,880,000**	**12,943,486**	**63,486**	**100,5%**

Refefuar tabelës së mësipërme konstatohet se, Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore për vitin 2020, janë realizuar në masën 105%, ku efektin më të madhe në realizimin e planit, e ka Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj e cila ka një realizim të planit në masën 105% dhe që përfaqëson 25% të të ardhurave e ndjekur nga DRT Tiranë në masën 102% të planit dhe që përfaqëson 36% të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

3.c.3 Mbi planifikimin, realizimin dhe monitorimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore (ISSH)

-ñPlani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò në zbatim të ligjit 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, është detajuar me shkresën e MFE me nr.1376 prot., datë 24.01.2021, protokolluar ne DPT me nr.1728 prot., datë 24,01,2020. Referua kësaj shkresë plani i të ardhurave për ISSH-në për vitin 2020, është në vlerën për **85,526,000 mijë lekë.**

Për ISSH-së plani i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore është dërguar më shkresën e MFE-së nr. 14452, datë 29.07.20 me subjekt ñDërgohet plani i të ardhurave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò. Referua kësaj shkresë plani i të

ardhurave për ISSH-në për vitin 2020, është në vlerën për **78,020,000 mijë lekë.** Ky plan është dërguar i detajuar pranë ISSH-së, me shkresën e DPT-së, nr. 15093/2, datë 06.08.2020.
Nga auditimi u konstatua se, DPT, mbështetur në udhëzimin ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i është drejtuar në mënyrë periodike ISSH-së në lidhje me Të ardhurat e realizuara për kontributet e sigurimeve shëndetësore.
Të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2020, janë dërguar pranë ISSH-së me shkresën nr. 736, datë 15.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2020, plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore është realizuar në masën për **80,786,625 mijë lekë**.Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.

	E M E R T I M I	Plani 2020 referuar Ligjit te Buxhetit	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Ndryshimi Plan/Fakt
		1	2	3=2-1	
C	Kontributet e Sigurimeve shoqërore	85,526,000	78,020,000	80,786,625	4%

Tabela në vijim, paraqet realizimin e planit të realizimit të kontributeve shoqërore sipas Drejtorive Rajonale, për vitin 2020.

Në mijë lekë

Nr.	Drejtoritë Rajonale	Plani 2020 Akti Normativ 28 dt 01.07.2020	Realizimi Faktik 2020	Diferenca	%
1	D. R. T. Berat	1,948,247	1,903,725	-44,522	-2%
2	D. R. T. Dibër	1,673,627	1,654,660	-18,967	-1%
3	D. R. T. Durrës	6,805,725	7,022,459	216,734	3%
4	D. R. T. Elbasan	3,518,797	3,621,041	102,244	3%
5	D. R. T. Fier	4,033,627	4,056,609	22,982	1%
6	D. R. T. Gjirokastër	1,373,319	1,513,207	139,888	10%
7	D. R. T. Korçë	2,943,753	3,034,407	90,654	3%
8	D. R. T. Kukës	1,098,640	1,191,021	92,381	8%
9	D. R. T. Lezhe	1,922,622	1,925,276	2,654	0%
10	D. R. T. Sarande	858,183	929,129	70,946	8%
11	D. R. T. Shkodër	3,312,935	3,221,805	-91,130	-3%
12	D. R. T. Tirane	27,454,800	29,096,819	1,642,020	6%
13	D. R. Tatimpaguesit e Mëdhenj	18,518,123	18,974,656	456,533	2%
14	D. R. T. Vlore	2,557,604	2,641,810	84,207	3%
	Totali	**78,020,000**	**80,786,625**	**2,766,625**	4%

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se, Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2020, janë realizuar në masën 104%, ku konstatohet se, efektin më të madhe në realizimin e planit, e ka Drejtoria e Tatim Tiranë e cila ka një realizim të planit në masën 106% dhe që përfaqëson 36% të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e ndjekur nga DR Tatimpaguesit e Mëdhenj në masën 102% **të planit dhe që përfaqëson 23% të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore.**

***Si konkluzion**, Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe të raportimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat mblidhen nga DPT, u konstatua se, referuar **shkresave** mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020 të dërguara nga DPT në **ISSH dhe FSDKSH**, konstatohet se, realizimi i të ardhurave nga kontributet në vlerën totale për **93,730,110 mijë lekë** është i ndarë në: të ardhura nga kontributet e sigurimet shëndetësore në vlerën për 12,943,486 mijë leke dhe të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën për 80,786,625 mijë lekë, ndërkohë që në Raportin Vjetor të vitit 2020, të ardhurat nga kontributet paraqiten në vlerën për **94,876,872 mijë lekë**, pra me një diferencë për **386,762 mijë lekë** më shumë se raportimi i bërë në ISSH dhe FSDKSH. Konstatohet se për efekte raportimi DPT përfshin sit ë ardhur nga kontributet*

*edhe të ardhurat nga gjobat për deklarim të vonuar të kontributeve dhe **TAP,** gjoba për mos deklarim punonjësish dhe depozitime të përkohshme për listë pagesën e kontributeve dhe **TAP** në vlerën totale për 386,762 mijë lekë, vlerë e cila nuk është e përfshirë në raportimet që bëhet në ISSH dhe FSDKSH referuar shkresave mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020, vlerë e cila nuk përfshihet si e ardhur nga këto dy institucione.*

- **Mbi listën e debitorëve të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore.**

  Në zbatim të Rregullores së brendshme ñPër funksionimin e administratës tatimore qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.193, datë 12.08.2020, struktura direkte përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve është Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara e cila ka si objekt të punës së saj udhëheqjen metodologjike dhe funksionin monitorues mbi DRT lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, neni 43, i rregullores. Nga, auditimi i të dhënave të llogarisë 468 ñDebitorë të tjerëò, të Pasqyrave Financiare të Konsoliduar të DPT-së, u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, vlera e detyrimeve për **kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** është në shumën për **16,521,124 mijë lekë** nga të cilat **debitorë për kontributet shoqërore** në vlerën për **14,811,796 mijë lekë** dhe **debitorë për kontributet shëndetësore** në vlerën për **1,709,327 mijë lekë.**Konstatohet se, krahasuar me vitin 2019, kjo vlerë është shtuar në shumën për 1,608,249 mijë lekë ose është rritur në masën 11% më shumë se vlera e debitorëve të vitit 2019. Konstatohet se, vlera e debitorëve të krijuar para vitit 2020, është në vlerën për 12,505,281 mijë lekë dhe vlera e debitorëve të krijuar rishtazi në vitin 2020, është në shumën për 4,015,843 mijë lekë. Tabela në vijim paraqet detyrimet e pasqyruara sipas sistemit E Tax të DPT-së që përfshin të Dhënat e DPT-së, së bashku me të dhënat e DRT-ve të cilat mbahen jashtë sistemit E-Tax.

Në mijë lekë

Llog.	Emertimi	Detyrime gjendje me 31.12.2019	Detyrime gjendje me 31.12.2020	Detyrime te cilat i perkasin vitit 2020	Detyrime te cilat i perkasin para vitit 2020
		1	2=3+4	3	4
A	**Sigurime shoqerore**	**13,465,426**	**14,811,796**	**3,405,735**	**11,406,062**
75021	Sig. Shoqerore te punesuar	7,883,698	8,086,556	923,388	7,163,169
75121	Sig. Shoqerore punedhenes	5,581,728	6,725,240	2,482,347	4,242,893
B	**Sigurime shendetsore**	**1,447,449**	**1,709,327**	**610,108**	**1,099,219**
75122	Sig.shëndetsore te punesuar	645,509	771,804	297,393	474,411
75022	Sig shëndetsore punedhenes	801,940	937,523	312,715	624,808
A+B	**Debitorë Kontribute Totale**	**14,912,874**	**16,521,124**	**4,015,843**	**12,505,281**

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, debitorët për kontributin e sigurimeve shoqërore në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, janë në vlerën për 14,811,796 mijë lekë dhe përfaqësojnë 90% të vlerës së detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **Mbi listën e debitorëve të kontributeve shëndetësore (FSDKSH).**

  Tabela në vijim paraqet vlerën totale të debitorëve të kontributeve shëndetësore sipas DRT-ve.

Në mijë lekë

DRT	Detyrime 31.12.2019	Detyrime 31.12.2020	Nga Detyrime te cilat i perkasin vitit 2020	Nga Detyrime gjendje, te cilat jane para 2020
		1=2+3	2	3
Berat	18,588	**24,172**	11,509	12,662
Dibër	22,067	**29,388**	12,451	16,937
DTM	43,792	**44,746**	27,903	16,843
Durrës	182,686	**205,277**	71,277	133,999
Elbasan	62,399	**83,484**	36,702	46,781
Fier	78,591	**94,412**	41,068	53,343
Gjirokastër	33,278	**36,202**	7,753	28,449
Korçë	96,856	**105,245**	23,909	81,336
Kukës	9,535	**11,030**	4,239	6,791
Lezhë	41,699	**51,619**	20,757	30,862

Sarandë	17,156	**19,897**	9,124	10,773
Shkodër	76,072	**91,332**	32,934	58,398
Tiranë	688,998	**823,957**	281,314	542,643
Vlorë	75,731	**88,567**	29,166	59,402
Grand Total	**1,447,449**	**1,709,327**	**610,108**	**1,099,219**

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, vlera e debitorëve për kontributet shoqërore është 1,709,327 mijë lekë nga e cila 1,099,219 mijë lekë janë detyrime të krijuara para vitit 2020 dhe që përfaqëson 64 % të vlerës totale të detyrimeve dhe vlera për 610,108 mijë lekë janë detyrime të cilat janë krijuar në vitin 2020 dhe përfaqëson 36% të detyrimeve totale. Tabela në vijim paraqet peshën që zënë debitorët e kontributeve shëndetësore mbi realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2020.

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2020	Debitore gjendje me 31.12.2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 te cilat i perkasin vitit 2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 , te cilat jane para 2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore
	1	2	3=2/1	4	5=4/1	6	7=6/1
D. R. T. Berat	304,172	**24,172**	7.95%	11,509	3.78%	12,662	4.16%
D. R. T. Diber	240,756	**29,388**	12.21%	12,451	5.17%	16,937	7.03%
D. R. T. Durres	1,105,463	**205,277**	18.57%	71,277	6.45%	133,999	12.12%
D. R. T. Elbasan	574,053	**83,484**	14.54%	36,702	6.39%	46,781	8.15%
D. R. T. Fier	657,336	**94,412**	14.36%	41,068	6.25%	53,343	8.12%
D. R. T. Gjirokaster	225,872	**36,202**	16.03%	7,753	3.43%	28,449	12.59%
D. R. T. Korce	488,589	**105,245**	21.54%	23,909	4.89%	81,336	16.65%
D. R. T. Kukes	164,576	**11,030**	6.70%	4,239	2.58%	6,791	4.13%
D. R. T. Lezhe	302,457	**51,619**	17.07%	20,757	6.86%	30,862	10.20%
D. R. T. Sarande	152,211	**19,897**	13.07%	9,124	5.99%	10,773	7.08%
D. R. T. Shkoder	501,860	**91,332**	18.20%	32,934	6.56%	58,398	11.64%
D. R. T. Tirane	4,622,339	**823,957**	17.83%	281,314	6.09%	542,643	11.74%
D. R.Tatimpaguesit	3,189,610	**44,746**	1.40%	27,903	0.87%	16,843	0.53%
D. R. T. Vlore	414,191	**88,567**	21.38%	29,166	7.04%	59,402	14.34%
Totali	**12,943,486**	**1,709,327**	**13.2%**	**610,108**	**4.7%**	**1,099,219**	**8.5%**

***Konstatim**: Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, **nuk kanë performancë të mirë** në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore DRT, Vlorë dhe Korçë ku konstatohet se, vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar për këtë zë në mbyllje të periudhës 2020, përfaqëson 22% të realizimit faktik të të ardhurave, e ndjekur nga DRT Shkodër, Durrës dhe Lezhë. Ndërkohë që DRT, me performancën më të mirë paraqitët DTM ku vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar përfaqëson 1.4% të realizimit faktik të të ardhurave.*

- **<u>Mbi listën e debitorëve të kontributeve shoqërore (ISSH).</u>**

Tabela në vijim paraqet vlerën totale të debitorëve të kontributeve shoqërore sipas DRT-ve.

Në mijë lekë

DRT	Detyrime gjendje me 31.12.2019	Detyrime gjendje me 31.12.2020	Nga Detyrime 31.12.2020 te cilat i perkasin vitit 2020	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 , te cilat jane para 2020
Berat	208,630	**242,027**	62,254	179,773
Dibër	264,675	**307,271**	92,657	214,614
DTM	276,198	**215,755**	140,622	75,133
Durrës	1,886,303	**2,028,415**	399,063	1,629,352
Elbasan	466,206	**533,714**	150,770	382,944
Fier	666,114	**749,101**	200,398	548,703
Gjirokastër	224,899	**210,694**	46,331	164,364
Korçë	504,637	**545,397**	111,754	433,643
Kukës	286,490	**224,143**	29,564	194,579
Lezhë	398,746	**454,005**	107,758	346,247
Sarandë	174,935	**186,495**	42,101	144,394
Shkodër	624,291	**734,238**	206,565	527,673
Tiranë	6,801,990	**7,632,571**	1,662,192	5,970,379
Vlorë	681,312	**747,970**	153,706	594,264
Grand Total	**13,465,426**	**14,811,796**	**3,405,735**	**11,406,062**

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, vlera e debitorëve për kontributet shoqërore është 14,811,796 mijë lekë nga e cila 11,406,062 mijë lekë janë detyrime të krijuara para vitit 2020 dhe që përfaqëson 77 % të vlerës totale të

detyrimeve dhe vlera për 3,405,735 mijë lekë janë detyrime të cilat janë krijuar në vitin 2020 dhe përfaqëson 23% të detyrimeve totale.

Tabela në vijim paraqet peshën që zënë debitorët e kontributeve shoqërore mbi realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2020.

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2020	Debitore gjendje me 31.12.2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 te cilat i perkasin vitit 2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 , te cilat jane para 2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore
	1	2	3=2/1	4	5=4/1	6	7=6/1
D. R. T. Berat	1,903,725	**242,027**	12.71%	62,254	3.27%	179,773	9.44%
D. R. T. Diber	1,654,660	**307,271**	18.57%	92,657	5.60%	214,614	12.97%
D. R. T. Durres	7,022,459	**2,028,415**	28.88%	399,063	5.68%	1,629,352	23.20%
D. R. T. Elbasan	3,621,041	**533,714**	14.74%	150,770	4.16%	382,944	10.58%
D. R. T. Fier	4,056,609	**749,101**	18.47%	200,398	4.94%	548,703	13.53%
D. R. T. Gjirokaster	1,513,207	**210,694**	13.92%	46,331	3.06%	164,364	10.86%
D. R. T. Korce	3,034,407	**545,397**	17.97%	111,754	3.68%	433,643	14.29%
D. R. T. Kukes	1,191,021	**224,143**	18.82%	29,564	2.48%	194,579	16.34%
D. R. T. Lezhe	1,925,276	**454,005**	23.58%	107,758	5.60%	346,247	17.98%
D. R. T. Sarande	929,129	**186,495**	20.07%	42,101	4.53%	144,394	15.54%
D. R. T. Shkoder	3,221,805	**734,238**	22.79%	206,565	6.41%	527,673	16.38%
D. R. T. Tirane	29,096,819	**7,632,571**	26.23%	1,662,192	5.71%	5,970,379	20.52%
D. R.TM	18,974,656	**215,755**	1.14%	140,622	0.74%	75,133	0.40%
D. R. T. Vlore	2,641,810	**747,970**	28.31%	153,706	5.82%	594,264	22.49%
Totali	**80,786,625**	**14,811,796**	**18.3%**	**3,405,735**	**4.2%**	**11,406,062**	**14.1%**

***Konstatim**: Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, **nuk kanë performancë të mirë** në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore DRT, Vlorë, Durrës, Tiranë, Lezhë ku konstatohet se, vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar për këtë zë në mbyllje të periudhës 2020, përfaqëson 26-28% të realizimit faktik të të ardhurave, e ndjekur Ndërkohë që DRT, me performancën më të mirë paraqitët DTM ku vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar përfaqëson 1.1% të realizimit faktik të të ardhurave.*

Tabela në vijim paraqet vlerën totale të debitorëve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas DRT-ve.

Në mijë lekë

Drejtoritë Rajonale	Realizimi Faktik 2020	Debitore gjendje me 31.12.2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 te cilat i perkasin vitit 2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore	Nga Detyrime gjendje me 31.12.2020 , te cilat jane para 2020	% e Detyrimeve ndaj te Ardhurave Vjetore
	1	2	3=2/1	4	5=4/1	6	7=6/1
D. R. T. Berat	2,207,897	**266,199**	12.06%	73,764	3.34%	192,435	8.72%
D. R. T. Diber	1,895,416	**336,659**	17.76%	105,109	5.55%	231,550	12.22%
D. R. T. Durres	8,127,922	**2,233,692**	27.48%	470,341	5.79%	1,763,351	21.69%
D. R. T. Elbasan	4,195,095	**617,197**	14.71%	187,472	4.47%	429,726	10.24%
D. R. T. Fier	4,713,945	**843,513**	17.89%	241,466	5.12%	602,047	12.77%
D. R. T. Gjirokaster	1,739,079	**246,896**	14.20%	54,084	3.11%	192,812	11.09%
D. R. T. Korce	3,522,996	**650,642**	18.47%	135,663	3.85%	514,979	14.62%
D. R. T. Kukes	1,355,598	**235,173**	17.35%	33,803	2.49%	201,369	14.85%
D. R. T. Lezhe	2,227,733	**505,624**	22.70%	128,515	5.77%	377,108	16.93%
D. R. T. Sarande	1,081,340	**206,392**	19.09%	51,225	4.74%	155,167	14.35%
D. R. T. Shkoder	3,723,664	**825,570**	22.17%	239,499	6.43%	586,072	15.74%
D. R. T. Tirane	33,719,158	**8,456,529**	25.08%	1,943,506	5.76%	6,513,023	19.32%
D. R.TM	22,164,266	**260,501**	1.18%	168,525	0.76%	91,976	0.41%
D. R. T. Vlore	3,056,002	**836,538**	27.37%	182,872	5.98%	653,666	21.39%
Totali	**93,730,110**	**16,521,124**	**17.6%**	**4,015,843**	**4.3%**	**12,505,281**	**13.3%**

***Konstatim**: Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se, **nuk kanë performancë të mirë** në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore DRT, Vlorë Tiranë, Durrës ku konstatohet se, vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar për këtë zë në mbyllje të periudhës 2020, përfaqëson 25-27% të realizimit faktik të të ardhurave, e ndjekur nga DRT Shkodër, dhe Lezhë. Ndërkohë që DRT, me performancën më të mirë paraqitët DTM ku vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar përfaqëson 1.1% të realizimit faktik të të ardhurave.*

*Mos arkëtimi i të ardhurave nga kontributet nga ana e DPT-së, për **16,521,124 mijë lekë** nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të*

kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **Mbi dorëzimin e listëpagesave të ISSH-së.**

Në referencë të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPT dhe ISSH me nr.1142, datë 19.05.2017, përveç dërgimit të listë pagesave me ebservice online, bëhet edhe dërgimi periodik me kërkesë me e-mail, nga personat e kontaktit në ISSH tek personat e kontaktit në DTIK në DPT. Informacioni kërkohet dhe dërgohet 3-4 ditë pas përfundimit të periudhave 3 mujore të deklarimit (pas datës 20 të muajit pasardhës të përfundimit të cdo 3 mujori) elektronikisht dhe me e-mail. Informacioni konsiston në të dhëna statistikore mbi numrin e tatim paguesve aktivë, mbi numrin e kontribuesve, të ndarë sipas DRT-ve, sipas llojit të biznesit, formës ligjore, për çdo muaj të 3 mujorit.

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019.

DRT	Listepagesa totale	Normale	Ndryshime	Pa deklaruar	Paguar plotesisht (pervec TAP)	Derguar ne ISSH
	1=2+3	2	3			
Berat	**50,364**	48,993	1,371	312	47,970	47,924
Dibër	**28,532**	26,599	1,933	426	26,949	26,920
DTM	**13,340**	10,597	2,743	11	13,174	13,168
Durrës	**165,106**	157,567	7,539	4,204	147,006	146,883
Elbasan	**98,623**	92,525	6,098	1,286	89,879	89,814
Fier	**121,246**	115,583	5,663	1,349	111,620	111,534
Gjirokastër	**31,688**	30,449	1,239	368	29,735	29,693
Korçë	**76,391**	73,426	2,965	1,378	70,937	70,830
Kukës	**15,865**	14,755	1,110	378	14,878	14,847
Lezhë	**51,332**	49,082	2,250	591	46,326	46,275
Sarandë	**34,532**	33,333	1,199	356	32,611	32,589
Shkodër	**78,987**	75,106	3,881	1,758	72,316	72,236
Tiranë	**602,641**	571,861	30,780	15,681	541,563	541,193
Vlorë	**71,828**	68,903	2,925	1,729	65,337	65,266
TOTAL	**1,440,475**	**1,368,779**	**71,696**	**29,827**	**1,310,301**	**1,309,172**

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas Periudhave Tatimore për vitin 2020.

Periudha	Nr subjektev	Listepagesa totale	Normale	Ndryshime	Pa deklaruar	Paguar plotesisht	Derguar ne ISSH
2001	115,209	119,400	112,485	6,915	2,724	109,734	109,732
2002	114,737	119,018	112,283	6,735	2,454	109,042	109,038
2003	114,340	120,384	111,972	8,412	2,368	110,545	110,541
2004	114,306	118,860	111,841	7,019	2,465	109,175	109,162
2005	115,283	119,103	112,874	6,229	2,409	109,130	109,121
2006	117,013	120,743	114,605	6,138	2,408	110,438	110,432
2007	117,853	121,028	115,337	5,691	2,516	110,021	110,012
2008	117,750	120,665	115,361	5,304	2,389	109,483	109,472
2009	118,218	121,007	115,824	5,183	2,394	109,701	109,693
2010	118,012	120,803	115,436	5,367	2,576	108,557	107,499
2011	118,073	119,914	115,400	4,514	2,673	107,533	107,529
2012	117,812	119,550	115,361	4,189	2,451	106,942	106,941
TOTAL		**1,440,475**	**1,368,779**	**71,696**	**29,827**	**1,310,301**	**1,309,172**

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2020 për Sektorin Shtetëror

(Buxhetorët).

DRT	Listepages	Normale	Ndryshime	Pa deklarua	Paguar plotesis	Derguar ne ISSH
Berat	941	897	44	-	941	911
Dibër	1,023	953	70	6	1,023	1,006
DTM	260	252	8	-	260	260
Durrës	1,520	1,348	172	5	1,516	1,458
Elbasan	1,586	1,429	157	1	1,564	1,524
Fier	1,436	1,249	187	1	1,434	1,391
Gjirokastër	1,142	1,078	64	-	1,142	1,112
Korçë	1,428	1,361	67	-	1,428	1,360
Kukës	897	818	79	5	896	876
Lezhë	866	768	98	-	857	827
Sarandë	537	500	37	-	537	530
Shkodër	1,468	1,330	138	1	1,467	1,413
Tiranë	4,916	4,380	536	53	4,871	4,791
Vlorë	839	763	76	5	839	807
TOTAL	**18,859**	**17,126**	**1,733**	**77**	**18,775**	**18,266**

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019 për Sektorin Shtetëror (Jo- Buxhetorët).

DRT	Listepagesa te	Normale	Ndryshime	Pa deklaruar	Paguar plotesisht	Derguar ne ISSH
Berat	145	124	21	-	131	130
Dibër	111	107	4	12	111	111
DTM	232	192	40	-	232	232
Durrës	170	160	10	4	158	158
Elbasan	220	186	34	8	211	210
Fier	259	251	8	1	226	226
Gjirokastër	148	142	6	6	148	148
Korçë	212	193	19	22	211	211
Kukës	64	60	4	7	64	64
Lezhë	79	72	7	-	65	65
Sarandë	87	84	3	-	87	86
Shkodër	196	168	28	5	172	172
Tiranë	835	786	49	32	730	726
Vlorë	177	168	9	-	163	163
TOTAL	**2,935**	**2,693**	**242**	**97**	**2,709**	**2,702**

Listëpagesat e deklaruara dhe dërguara në ISSH sipas DRT-ve për vitin 2019 për Sektorin Privat.

Privat	Listepagesa te	Normale	Ndryshime	Pa deklaruar	Paguar plotesisht	Derguar ne ISSH
Berat	49,278	47,972	1,306	312	46,898	46,883
Dibër	27,398	25,539	1,859	408	25,815	25,803
DTM	12,848	10,153	2,695	11	12,682	12,676
Durrës	163,416	156,059	7,357	4,195	145,332	145,267
Elbasan	96,817	90,910	5,907	1,277	88,104	88,080
Fier	119,551	114,083	5,468	1,347	109,960	109,917
Gjirokastër	30,398	29,229	1,169	362	28,445	28,433
Korçë	74,751	71,872	2,879	1,356	69,298	69,259
Kukës	14,904	13,877	1,027	366	13,918	13,907
Lezhë	50,387	48,242	2,145	591	45,404	45,383
Sarandë	33,908	32,749	1,159	356	31,987	31,973
Shkodër	77,323	73,608	3,715	1,752	70,677	70,651
Tiranë	596,890	566,695	30,195	15,596	535,962	535,676
Vlorë	70,812	67,972	2,840	1,724	64,335	64,296
TOTAL	**1,418,681**	**1,348,960**	**69,721**	**29,653**	**1,288,817**	**1,288,204**

Shënime:

Periudha ï Periudha tatimore mujore.

DRT - Drejtoria Rajonale Tatimore.

Tipi i Deklaruesit ï Lloji i tatim paguesit sipas pronësisë dhe formës ligjore (Shtetëror buxhetor, shtetëror jo buxhetor, sektori privat).

Nr i Subjekteve - Numri total i tatim paguesve që kanë deklaruar ose duhet të deklaronin një listë pagesë për periudhën në fjalë.

Listëpagesa Totale - Numri i listë pagesave total të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatim paguesi ose ndryshime nga inspektori.

Normale ï Numri i të gjithë listë pagesave të deklaruara nga tatim paguesi në versionin e parë.

Ndryshime - Numri i të gjithë listë pagesave të ndryshuara nga tatim paguesi ose inspektori në të gjitha versionet.

Pa Deklaruar - Numri total i tatimpaguesve që nuk kanë deklaruar një listë pagesë për periudhën në fjalë, por duhet ta deklaronin atë.

Paguar plotësisht (përveç TAP)-Numri i listë pagesave të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatimpaguesi ose ndryshime nga inspektori, për të cilat

është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal për kodet e të ardhurave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. (Ky është numri i listëpagesave që duhet të dërgohen në ISSH).
Dërguar në ISSH - Numri i listë pagesave të regjistruara në sistem për të gjitha versionet, normale dhe ndryshime nga tatim paguesi ose ndryshime nga inspektori, për të cilat është paguar plotësisht vlera e detyrimit principal për kodet e të ardhurave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe janë dërguar në ISSH elektronikisht nëpërmjet web-service.

Gjetja:	Gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë gabimisht në zërin òTatime dhe taksaô
Situata:	Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe të raportimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat mblidhen nga DPT, u konstatua se, referuar **shkresave** mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020 të dërguara nga DPT në **ISSH dhe FSDKSH**, konstatohet se, realizimi i të ardhurave nga kontributet në vlerën totale për **93,730,110 mijë lekë** është i ndarë në: të ardhura nga kontributet e sigurimet shëndetësore në vlerën për 12,943,486 mijë leke dhe të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën për 80,786,625 mijë lekë, ndërkohë që në Raportin Vjetor të vitit 2020, të ardhurat nga kontributet paraqiten në vlerën për **94,876,872 mijë lekë**, pra me një diferencë për **386,762 mijë lekë** më shumë se raportimi i bërë në ISSH dhe FSDKSH. Konstatohet se për efekte raportimi DPT përfshin sit ë ardhur nga kontributet edhe të ardhurat nga **gjobat** për deklarim të vonuar të kontributeve dhe **TAP,gjoba** për mos deklarim punonjësish dhe depozitime të përkohshme për listëpagesën e kontributeve dhe **TAP** në vlerën totale për 386,762 mijë lekë, në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, vlerë e cila nuk është e përfshirë në raportimet që bëhet në ISSH dhe FSDKSH referuar shkresave mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020, vlerë e cila nuk përfshihet si e ardhur nga këto dy institucione.
Kriteri :	Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 cituar ñLlogaria 70 òTatime dhe taksat dhe tatimetò Në këtë kategori përfshihen tatimet dhe taksat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes qendrore (tatimet e taksat kombëtare) dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, kamatëvonesat që lidhen me to, si dhe ato tarifa të vendosura nga këto dy qeverisje në kthim të të cilave nuk ka kosto. Ndërsa gjobat që lidhen me tatimet dhe taksat janë përfshirë në titullin e të ardhurave jo tatimoreò.
Ndikimi/Efekti	Mos raportim i saktë i të ardhurave nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në raportin vjetor të DPT-së.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim unifikimin e vlerës së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shprehur në raportimet e DPT-së me vlerën e raportuar si e ardhur nga kontributet për institucionet e ISSH-së dhe FSDKSH-së.

IV. 4.Auditim i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe mbi hartimin e pasqyrave financiare

a. Programimi i PBA 2020-2022 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2020. Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2020 dhe ndryshimet gjatë vitit.Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor, kundrejt treguesve të planifikuar dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
b. Fondet e shpenzuara për shkak të situatës Covid 19, miratimi dhe administrimi i tyre sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, pika nr.4, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Pasqyrat financiare të nënshkruara nga dega e thesarit.;
Dokumentacioni lidhur me kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor;
Aktet e rakordimi me degën e thesarit për shpenzimet.;
Dokumentacioni lidhur me PBA 2020-2022;
Evidencat për raportimin e detyrimeve të prapambetura etj. dokumente;
Të dhëna në format elektronik nga subjekti i audituar etj.

Programimi i PBA 2020-2022 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2020. Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2020 dhe ndryshimet gjatë vitit.

- ✓ **Planifikimi në fazën e I-rë të PBA 2020-2022**

- Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore 2020-2022 janë miratuar me VKM 117, datë 13.03.2019 ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2020-2022ò, në nivel programi. Totali i shpenzimeve për DPT për këtë fazë të PBA është miratuar në vlerën 2,663,000,000 lekë, nga të cilat shpenzimet korente në vlerën 2,580,000,000 lekë, ose në masën 97%, ndërsa shpenzimet kapitale në vlerën 83,000,000 lekë, ose në masën 3% të shpenzimeve totale.

Kërkesave buxhetore 2020-2022, Faza I e programit **01140 "Menaxhimi i të ardhurave Tatimore"**, janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. nr. 8666, datë 30.04.2019``Dërgohet projekt buxheti për vitet 2020-2022``.
Këto kërkesa përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimin nr. 07, datë 28.02.2018 ñPër procedurat standarde të përgatitjes së PBAò, si dhe udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2018 ñPër përgatitjen e PBA 2020-2022ò. Projektimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, në vlerën 2,663,000,000 lekë, nga të cilat shpenzimet korente në vlerën 2,580,000,000 lekë dhe shpenzimet kapitale në vlerën 83,000,000 lekë, sipas të dhënat e mëposhtme:

Në lekë

	Emërtimi	PBA 2020-2022 Faza e I (viti 2020)
600	Paga	1.500.000.000
601	Sigurime Shoqërore	300.000.000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	778.740.000
605	Transferta Korente të Huaja	1.260.000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	-
I	**Shpenzime Korrente**	**2.580.000.000**
230	Kapitale të Patrupëzuara	7.000.000
231	Kapitale të Trupëzuara	76.000.000
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	**-**
230	Kapitale të Patrupëzuara	-
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	**-**
II	**Shpenzime Kapitale**	**83.000.000**
III	**Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti**	**-**
I+II +III Totali I Shpenzimeve		**2.663.000.000**

Në planifikimin e investimeve në vlerën 83,000,000 lekë për fazën I të PBA 2020-2022 janë parashikuar projektet si më poshtë:

Në 000/lekë

Renditja sipas prioritetev e	Titulli i projektit	Llog ekonomike	Kodi i projektit	Data e fillimit dhe përfundimit të projektit	Vlera Totale e projektit	Shpenzimet e planifikuara për vitin 2020 (Faza I e PBA)
1	Pagesa kontributit vjetor Fiscalis 2020	230	M100255	2015-2020	30,764	7,000
2	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT	231	18AV806	2019-2021	170,000	51,000
3	Blerje paisje zyre elektronike, kompjuterike	231		**2020-2022**	60,000	10,000
4	Blerje paisje zyre	231		**2020-2022**	63,000	15,000
	Shuma					83,000

- ✓ **Planifikimi në fazën e II-[rë] të PBA 2020-2022**

- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2020-2O22, janë miratuar me VKM nr.523, datë 25.07.2019 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2020- 2022", në nivel programi.

Kërkesave buxhetore 2020-2022, Faza II e programit 01140 ñMenaxhimi i të ardhurave Tatimoreò, janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 16206, datë 31.08.2019``Dërgohet programi buxhetor afatmesëm 2020-2022``. Planifikimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga MFE, në vlerën 3,213,000,000 lekë.

Këto kërkesa janë përgatitur në zbatim të udhëzimit nr.21, datë 10.07.2019 ñ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022ò.

Totali i kërkesave shtesë në këtë fazë përfundimtare të PBA 2020-2022 për DPT është në vlerën 221,976,113 lekë, në llogarinë 231 ñShpenzime kapitale të trupëzuaraò, i përkasin dy projekteve:

a-Përmirësimi i Modulit te Menaxhimit te Kontrollit te Faturimit, me kërkesë shtesë në vlerën 176,976,113 lekë. Ky projekt ka filluar në vitin 2018 me vlerë totale të kontratës 1,727,792,000 lekë.

b-Shkëmbimi Automatik I Informacionit, me kërkesë shtesë në vlerën 45,000,000 lekë (investim i ri).

Detajimi i buxhetit, faza II e PBA 2019-2022:

Në lekë

	Emërtimi	**PBA 2019-2021 Faza e II**	
		Tavanet viti 2020	**Kërkesa shtesë**
600	Paga	1.500.000.000	
601	Sigurime Shoqërore	300.000.000	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	778.740.000	
605	Transferta Korrente të Huaja	1.260.0000	
I	**Shpenzime Korrente**	**2.580.000.000**	
230	Kapitale të Patrupëzuara	7.000.000	
231	Kapitale të Trupëzuara	626.000.000	221.976.113
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm		
230	Kapitale të Patrupëzuara		
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj		
II	**Shpenzime Kapitale**	**633.000.000**	**221.976.113**
I+II	**Totali I Shpenzimeve**	**3.213.000.000**	**221.976.113**

Në planifikimin e investimeve për fazën II të PBA 2020-2022 në vlerën 633,000,000 lekë janë parashikuar projektet në vijim:

Në lekë

Renditja sipas prioriteteve	Titulli i projektit	Llog ekonomike	Kodi i projektit	Data e fillimit dhe përfundimit	Totali i investimit të projektit	Shpenzimet e planifikuara për vitin 2020 (Faza II e PBA)
1	Pagesa kontributit vjetor Fiscalis 2020	230	M100255	2015-2020	30,764,000	7,000,000
2	Permiresimi i Modulit te Menaxhimit te Kontrollit te Faturimit	231	M100500	2018-2020	1,727,792,000	540,000,000
3	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT	231	18AV806	2019-2021	170,000,000	60,000,000
4	Zhvillimi dhe mbajtja në funksion e data ëarehouse	231	18AV807	2019-2019	30,000,000	-
5	Blerje paisje zyre elektronike, kompjuterike	231		2020-2022	60,000,000	16,000,000
6	Blerje paisje zyre	231		2020-2022	63,000,000	10,000,000
	Shuma					633,000,000

- ✓ **Çelja e fondeve buxhetore me ligjin e buxhetit 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin 2020", detajimi i tyre.**

Mbështetur në tavanet buxhetore të miratuar me ligjin e buxhetit nr.88/2019, datë 18.12.2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò për programin ñ Menaxhimi i të Ardhurave Tatimoreñ, çelja e buxhetit në fillim të vitit buxhetor 2020 për shpenzimet korrente, është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr. 24325/100, datë 27.01.2020, në vlerën 2,530,000,000 lekë, ndërsa për shpenzimet kapitale me shkresë nr.1296/2, datë 11.03.2020 për shpenzimet kapitale, në vlerën 417,000,000.

Me shkresën nr. 212/1 datë 04.02.2020 është dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë shkresa për``Detajimin e fondeve buxhetore të shpenzimeve korrente për vitin 2020``. Me shkresën nr. 3348, datë 13.02.2020 është dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë shkresa për``Detajimin mujor të shpenzimeve korrente për vitin 2020``.

Me miratimin e buxhetit të vitit 2020, nëpërmjet ligjit 88/2019, datë 18.12.2019 ñPër buxhetin 2020ò, konstatohet se vlera totale e shpenzimeve të miratuara për DPT është ulur me 266,000,000 lekë, nga të cilat shpenzimet kapitale zënë 216,000,000 lekë ose 81% të vlerës së ulur, krahasuar me vlerën e parashikuar në fazën II të PBA 2020-2022. (Vlera e miratuar e shpenzimeve në fazën II të PBA është 3,213,000,000 lekë, ndërsa me ligjin ñPër buxhetin 2020ò, është miratuar vlera totale e shpenzimeve 2,947,000,000 lekë).

Këto ndryshime janë pasqyruar edhe në ndryshimet e listës së investimeve, të cilat pas daljes së ligjit ñPër buxhetin 2020ò dhe rialokimit, kanë vlerën 417,000,000 lekë, trajtuar më hollësisht në vijim të materialit.

Shpenzimet e miratuara me ligjin e buxhetit 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin 2020":

Shpenzime Korrente në vlerën totale 2,530,000,000 lekë, nga të cilat:

Llogaria 600 ñPaga dhe shtesaò në vlerën 1,500,000,000 lekë;

Llogaria 601 ñSigurime shoqëroreò në vlerën 300,000,000 lekë;

Llogaria 602 ñBlerje mallra e shërbimeò në vlerën 728,740,000 lekë;

Llogaria 605 ñTransferta të jashtmeò në vlerën 1260,000 lekë.

Shpenzime Kapitale në vlerën totale 417,000,000 lekë, nga të cilat:

Llogaria 230 ñShpenzime kapitale të pa trupëzuarò në vlerën 7,000,000 lekë;

Llogaria 231 ñShpenzime kapitale të trupëzuaraò në vlerën 410,000,000 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas tavaneve të miratuara, shpenzimet buxhetore të programit ñ**Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**ò, faza I e PBA, faza II, si dhe vlerat e miratuara me ligjin e buxhetit **88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin 2020"** (plani fillestar), në formë tabele paraqiten si vijon:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2019	Faza e I PBA 2020	Faza e II PBA 2020	Fondi i miratuar me ligjin e buxhetit 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020" (Plani fillestar)
600	Paga	1.298.563.000	1.500.000.000	1.500.000.000	1.500.000.000
601	Sigurime Shoqërore	215.722.000	300.000.000	300.000.000	300.000.000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	574.146.000	778.740.000	778.740.000	728.740.000
605	Transferta Korente të Huaja	1.120.000	1.260.000	1.260.000	1.260.000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	31.764.000	-	-	-
I	**Shpenzime Korrente**	**2.121.315.000**	**2.580.000.000**	**2.580.000.000**	**2.530.000.000**
230	Kapitale të Patrupëzuara	5.553.000	7.000.000	7.000.000	7.000.000
231	Kapitale të Trupëzuara	743.352.000	76.000.000	626.000.000	410.000.000
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	**-**	**-**	**-**	**-**
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	**-**	**-**	**-**	**-**
II	**Shpenzime Kapitale**	**748.905.000**	**83.000.000**	**633.000.000**	**417.000.000**
III	**Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti**	**-**	**-**	**-**	**-**
I+II +III Totali i Shpenzimeve		**2.870.220.000**	**2.663.000.000**	**3.213.000.000**	**2.947.000.000**

Nga auditimi konstatohet se shpenzimet korente për fazën I, fazën II të PBA nuk kanë ndryshime. Pas daljes së ligjit ñPër buxhetin e vitit 2020ò), programimi i këtyre shpenzimeve ka ndryshuar shumë pak krahasuar me dy fazat e PBA (Nga 2,580,000,000 në 2,530,000,000 lekë).

Shpenzime kapitale të trupëzuara kanë ndryshime të konsiderueshme midis vlerës së planifikuar në fazën e parë të PBA-së 2020-2022 dhe vlerës së planifikuar për këto zëra në buxhetin vjetor me miratimin e ligjit ñPër buxhetin 2020ò.

Në fazën e parë të PBA-së 2020-2022 këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 76,000,000 lekë, në fazën e dytë 626,000,000 lekë, ose 820% më shumë, ndërsa vlera e miratuar në buxhetin vjetor është 410,000,000 lekë, 540% më shumë se faza I e PBA dhe 34% më pak se vlera e parashikuar në fazën II të PBA 2020-2022.

Titulli i gjetjes

Mos planifikim në fazën I të PBA 2020-2022 i shpenzimeve për investimin me kod M100500 "Përmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit", si dhe planifikimi në fazën II të këtij investimi në vlerën 176,976 mijë lekë më pak nga vlera e planifikuar në kontratë.

Situata

Nga krahasimi i listës së investimeve të programuara në përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit të vitit 2020, konstatohet se projekti i investimit me kod M100500 ñPërmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimitò, megjithëse investim në proces, pasi ka filluar në vitin 2018, nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2020-2022, ndërkohë që janë planifikuar shpenzime kapitale të reja në këtë fazë (si dhe fazën e dytë të PBA) për dy projekte: 1-Blerje pajisje zyre elektronike, kompjuterike në vlerën 60,000,000 lekë dhe 2-Blerje pajisje zyre në vlerën 63,000,000 lekë (Pavarësisht se këto dy projekte nuk janë realizuar, për shkak të uljes së tavaneve buxhetore për investimet me daljen e ligjit të buxhetit për vitin 2020). Gjithashtu në fazën e dytë të PBA vlera e likuidimit për këtë projekt është planifikuar 540,000,000 lekë, nga 716,976 mijë lekë e planifikuar në kontratë, pra 176,976 mijë lekë më pak nga detyrimi i kontratës. Referuar auditimit të mëparshëm, konstatohet se

vlera e këtij investimi për vitin 2020 prej 716,976 mijë lekë nuk është parashikuar as në listën e Investimeve Publike 2019-2021 të projekt buxhetit të vitit 2019.
Projekti i investimit me kod **M100500 "Përmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit te Faturimit" ë**shtë prokuruar nga Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit (AKSHI) **me afat 48 muaj**, vlerë të kontratës **2,238,184 mijë lekë, s**ipas të dhënave të mëposhtme:

Në mijë lekë

Llogaria	Vlera	Vlera	Pershkrimi	Viti
2313500	170,025		Parapagim per kontraten	2018
231500	840,790		Permiresimi i Modulit te Menaxhimit te Kontrrollit te Faturimit	2019
231500	716,976		Permiresimi i Modulit te Menaxhimit te Kontrrollit te Faturimit	2020
6025400		64,500	Mirembjtje e Permiresimit të Modulit te Menaxhimité	2020
6025400		258,000	Mirembjtje e Permiresimit të Modulit te Menaxhimité	2021
6025400		187,892	Mirembjtje e Permiresimit të Modulit te Menaxhimité	2022
Totali	**1,727,791**	**510,392**		

Ky projekt ka vlerën e investimit prej **1,727,791 mijë lekë dhe vlerën e mirëmbajtjes 510,392 mijë lekë. Vlera e investimit ka filluar në vitin 2018 e shtrirë në tre vite, ku në secilin vit do të likuidoheshin vlerat si vijon:**
-viti 2018, vlera 170,025 mijë lekë;
-viti 2019, vlera 840,790 mijë lekë;
Viti 2020, vlera 716,976 mijë lekë

Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		
Vlera e parashikuar për likujdim sipas kontratës	Vlera e likujduar në fakt	Vlera e parashikuar për likujdimsipas kontratës	Vlera e likujduar në fakt	Vlera e parashikuar për likujdimsipas kontratës	Vlera e likujduar në fakt	Detyrimi i ngelur për likujdimmë 31.12.2020
170,025	170,025.887	840,790	668,952.161	716,976	350,000	512,786.943

<u>Kriteri</u>
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:
- pikën 6/f, të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 të Ministrisë së Financaveñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëmò, ku citohet se: "Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme përmbajnë: ...f) shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: i. koston e plotë të projektit; ii. vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës; iii. vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor; iv. vlerën e mbetur për t"u financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit...".*
-pikën nr. 58 të UMFE nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku thuhet: Gjithashtu Plani vjetor i buxhetit, i akorduar në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqëson limitin maksimal të lejuar për t'u shpenzuar nga njësitë shpenzuese. Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë detajojnë fonde për të paguar detyrimet e mbartura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve".
<u>Efekti:</u>Mosplanifikimi i plotë në PBA i detyrimeve të mbartura nga angazhime buxhetore të mëparshme, sjellin mos likuidim të detyrimeve brenda parashikimeve të kryera.
<u>Shkaku</u>: Mos përfshirja në PBA e të gjithë vlerës së parashikuar për tâu financuar në vitin buxhetor për projekte/angazhime të mara më parë.
Rëndësia: E mesme
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Buxhetit dhe Financës znj. D. C.
Në mënyrë të përmbledhur lista e investimeve të planifikuara në fazën e parë, fazën e dytë të PBA, planin fillestar me daljen e ligjit të buxhetit për vitin 2020, planin e ndryshuar gjatë vitit dhe realizimin në fakt të këtyre shpenzimeve, jepen në aneksin nr.2, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

- ✓ **Mbi transferimin e fondeve buxhetore.**

Për shkak të situatës së emergjencës të shpallur me anë të VKM-së nr.750, datë 27.11.2019``Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore në qarqet Durrës e Tiranë``, DPT ka bërë kërkesë për fonde shtesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me anë të shkresës nr.529/2, datë 11.2.2020, protokolluar në DPT me nr.3926, datë 20.02.2020 si dhe shkresës nr.3498/1,datë 28.2.2020 protokolluar në DPT me nr.23307/3, datë 03.03.2020 MFE është shprehur së nuk miraton shtesë, por ka lënë si mundësi alokimit të fondeve buxhetore.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2020, me miratimin e MFE, është bërë rishpërndarja e fondeve buxhetore në zërin shpenzime korente si vijon:

Llogaria 600 ñPagaò, është pakësuar në vlerën 240,188,520 lekë;

Llogaria 601 ñSigurime Shoqëroreò, është pakësuar në vlerën 45,000,000 lekë;

Llogaria 602 ñMallra dhe Shërbime të tjeraò, është shtuar në vlerën 152,012,362 lekë;

Llogaria 605 Transferta Korente të Huaja është shtuar në vlerën 2,250,000 lekë

Llogaria 606 ñTransferta për buxhete familjar dhe individò, është shtuar në vlerën 32,326 lekë.

Lëvizja totale e fondeve buxhetore përbënë vlerën 98,600 lekë, e cila përbën 4% të vlerës së buxhetit fillestar.

Procedurat e ndjekura për transferimin e fondeve buxhetore për shpenzimet korente janë kryer në përputhje me ligjin e buxhetit 88/2019, datë 18.12.2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, si dhe udhëzimit plotësues të MFE nr.2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të viti 2020ò.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur planin fillestar të shpenzimeve korente me ndryshimet e pësuara gjatë vitit.

Në 000/lekë

Art.	Shpenzime Korrente	Buxheti	Rialokime	Plan i
600	Paga	1,500,000	(240,188)	1,259,812
601	Sigurime Shoqërore	300,000	(45,000)	255,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	728,740	152,012	880,752
603	Subvencione	-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme	-	-	-
605	Transferta Korente të Huaja	1,260	2,250	3,510
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	-	32,326	32,326
Totali		***2,530,000***	***(98,600)***	***2,431,400***

- ✓ Plani në llog. 600 ñPaga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeliò në fillim të vitit 2020 është 1,500,000,000 lekë, ndërsa në fund të vitit 2020 ky plan është 1,259,811,480 lekë, kjo llogari është realizuar në vlerë 1,228,606.421 lekë, si dhe në % është realizuar 98 %. Ndryshimi (pakësimi) prej 240,188,520 lekë në plan, është si rezultat i ndryshimeve bazuar në shkresën nr. 5780/5 prot., datë 27.04.2020 të MFE, protokolluar në DPT me nr. 7235 prot. datë 29.04.2020 me lëndë ñPërcillet shkresa me nr. 5780/4 prot., datë 24.04.2020 ñMiratim limitiò, si dhe në VKM - në nr. 926 datë 25.11.2020 ñPër rishpërndarje fondesh në buxhetin e viti 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetoreò, në vlerën 210 milion lekë (VKM . 926 datë 25.11.2020 ka pakësuar fondet korente në vlerën totale 255,000,000 lekë, nga të cilat 210,000,000 lekë janë pakësuar në llogarinë 600 dhe 45,000,000 lekë janë pakësuar në llogarinë 601). Nga Drejtori i Buxhetit shpjegohet se fondet e lira në llogarinë 600 dhe 601 vijnë si rezultat i ndryshimit të strukturës së administratës tatimore gjatë periudhës së parë të vitit 2020, ku zvogëlimi i numrit të punonjësve për shkak të ristrukturimit ka shoqëruar fondet e lira të institucionit. Ndryshimet dhe realizimi sipas DRT për llog. 600 janë në aneksin nr.2/1, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

✓ Plani i llog 601ñSigurime Shoqërore dhe shëndetësoreò për vitin 2020 në janar është 300 milion lekë ndërsa në dhjetor është 255 milion lekë. Ky ndryshim (pakësim) në vlerën 45 milion lekë, është bërë bazuar në VKM nr. 926 datë 25.11.2020 ñPër rishpërndarje fondesh në buxhetin e viti 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetoreò. Llogaria 601 ñSigurime Shoqërore dhe shëndetësoreò është realizuar në vlerën 202,471,310 lekë, ose në masën 79 %. Ndryshimet dhe realizimi sipas drejtorive për llog. 601 janë në aneksin nr.2/2, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

✓ Plani i llog. 602 òShpenzime operativeò në muajin janar është 728 milion leke, ndërsa në muajin dhjetor është 878 milion lekë. Ndryshimet (shtesat) në këtë llogari janë bërë bazuar shkresën e MFE me nr. 5780/5 prot., datë 27.04.2020, në shkresën e MFE me nr. 8745/1 prot., datë 26.05.2020 në shkresën e MFE me nr. 2835/12 prot. datë 18.06.2020, me aktin normativme nr. 28 datë 02.07.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 88/2019ò për buxhetin e vitit 2020ò të ndryshuar, me shkresën e MFE nr 21240/2 prot., datë 13.11.2020, si dhe me aktin normativ të MFE me nr. 34 datë 16.12.2020 për MFE. Llogaria 602 ñShpenzime operativeò, për 15 Drejtoritë Rajonale, është realizuar në vlerën 727,233,941 lekë, ose në masën 77%. Ndryshimet dhe realizimi sipas drejtorive për llog. 602 janë në aneksin nr.2/3, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

Për vitin 2020 realizimi i shpenzimeve në total sipas zërave është si vijon:

Llog. 600 ñPaga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeliò është realizuar në masën 97% , llogaria 601 ñSigurime Shoqërore dhe Shëndetësoreò është realizuar në masën 79%, ndërsa llog. 602 ñ Shpenzime operativeò është realizuar në masën 83 %.

Sipas Drejtorive Rajonale shpenzimet janë realizuar sipas tabelës :

DRT	Llog. 600	Llog. 601	Llog. 602
Berat	95	85	78
Dibër	93	75	96
Durrës	97	81	85
Elbasan	96	79	99
Fier	98	84	99
Gjirokastër	97	88	79
Korçë	97	86	73
Kukës	92	56	87
Lezhë	94	76	86
Sarandë	93	74	86
Shkodër	97	68	67
Vlorë	97	75	77
Tirana Deg.1	99	91	71
Tir Deg.Vip	98	86	56
Drejt.Pergj.Tat	99	68	83
Totali	98	79	83

Në llog.602 DRT e cila ka realizuar më pak shpenzimet operative është Drejtoria e Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, e cila vjen si rezultat i mos realizimit të zërit ñShpenzime për mirëmbajtje të zakonshmeò në masën 0%.

Në vijim paraqiten shkresat dhe argumentet me të cilat është bërë transferimi i fondeve buxhetore në zërin shpenzime korente:

1. Me shkresën nr.3926/1, datë 19.03.2020 ñKërkesë për transferim fondi në shpenzimet korrente``, është përcjellë kërkesa për rialokim fondi nga artikulli 600 në artikullin 602 në vlerën 30,000,000 lekë., miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr. 5780/3, datë 15.04.2020. Arsyeja e kësaj kërkesë është për përballimin e emergjencës së shpallur me anë të VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 ``Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore në qarqet Durrës e Tiranë``. Është pakësuar zëri 600 për kodin 91004AA në vlerën 30,000,000 lekë dhe është shtuar zëri 602 për kodin 91004AA në vlerën 30,000,000 lekë.

2.Me shkresën nr.3152/5, datë 15.05.2020 ``Kërkesë për transferim fonde shpenzime korrente`` në vlerën 6,000,000 lekë për përballimin e situatës emergjente për Drejtoritë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Durrës, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë Nr. 8745/1, datë 26.05.2020, është pakësuar zëri 602 me kod produkti 91004AA në vlerën 6,000,000 lekë për Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe shtuar për Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë zëri 602 me kod produkti 91004AA në vlerën 6.000.000 lekë. Arsyeja e këtij alokimi është për realizimin e transferimit të bazës materiale të Drejtorisë Rajonale Tiranë,rrjedhojë e situatës së emergjencës të shpallur me anë të VKM-së nr.750, datë 27.11.2019``Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore në qarqet Durrës e Tiranë``.
3. Me shkresën nr.4817/5, datë 09.06.2020 ``Kërkesë për rialokim fondesh buxhetore në shpenzime korrente për vitin 2020``, në vlerën 3,837,638 lekë, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr. 2835/12, datë 18.06.2020, është pakësuar zëri 602, kod produkti 91004AA në vlerën 3,837,638 lekë dhe është shtuar zëri 605 me kod 91004AA në vlerën 1,100,000 lekë dhe zëri 606 me kod 91004AA ne vlerën 2,737,638 leke. Arsyeja e këtij alokimi: Bazuar në ligjin nr. 146/2013, datë 06.05.2013 ñ Për Ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimoreñ, i cili parashikon që vendet shkëmbejnë automatikisht informacionin tatimor, në ñMarrëveshjen Shumëpalëshe të Autoriteteve Kompetente për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiareñ nënshkruar datë 29.10.2014, miratuar me VKM Nr.178, datë 09.03.2016, si dhe ligjin nr. 4/2020 ñ Për Shkëmbimin Automatik të informacionit të Llogarive Financiareñ, Shqipëria angazhohet të fillojë shkëmbimin automatik të informacionit në vitin 2020. Për këtë nevojitet pagesa e një tarife vjetore (fee), për aksesim në Sistemin e Përbashkët të Transmetimit (CTS), si rezultat i marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet DPT-së dhe OECD-së për``Ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në çështjet Tatimore``. Gjithashtu arsyeja e alokimit ka qenë plotësim i nevojave për fond të veçantë për vitin buxhetor 2020.
4. Në vijim të kërkesave buxhetore nga ana e Drejtorive Rajonale Tatimore si dhe nevojave për shlyerjen e detyrimeve nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është kërkuar me anë të shkresës nr. 21847, datë 11.11.2020, rialokimi në shpenzimet korrente në vlerën 40,431,385 lekë, pakësuar në artikullin 602 Kod produkti 91004 AA të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe shtuar në artikullin 602 për Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier e 602 Kod produkti 91004 AC (Vendime gjyqësore të ekzekutuara). Kjo kërkesë është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 21240/2, datë 13.11.2020dhe shkresën nr. 21240/4, datë 03.12.2020.
5. Me anë të shkresës nr.17533/19, datë 16.12.2020 është përcjellë në zbatim të VKM Nr.926, datë 25.11.2020, miratimi i pakësimit të fondeve në shpenzimet korrente përkatësisht në vlerat 210,000,000 lekë në artikullin 600 dhe 45,000,000 lekë në artikullin 601.
6. Me shkresën nr.23412/28, datë 23.12.2020 është përcjellë në zbatim të Akti Normativ nr.34, datë 16.12.2020, detajimi i shtesave dhe paksimeve të ndryshimeve të planit të buxhetit për shpenzimet korrente ku përkatësisht për programin ñ Menaxhimi i të Ardhurave Tatimoreò, ka pakësim në produktet 91004 AA ñTatimpagues të asistuarò në vlerën 60,000,000 lekë e 91004 AB ñ Inspektime,hetime tatimore ò në vlerën 100,000,000 dhe shtesë në produktin 91004 AC (Vendime gjyqësore të ekzekutuara) në vlerën 160,000,000 lekë.
7. Me anë shkresës nr. 20988/1, datë 04.11.2020 është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesa për rialokim, bazuar në kërkesën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër për fond të veçantë në vlerën 188,520 lekë, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr. 20956/3, date 24.11.2020.

Tabela përmbledhëse DPT për çeljen e fondeve, shtesat dhe paksimet jepet në aneksin nr. nr.2/4, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

- ✓ **Për transferimin e fondeve për shpenzime kapitale**.

Pas miratimit të ligjit Nr. 4/2020 ñ Për shkëmbimin automatik te informacionit të llogarive financiareñ si dhe konfirmimit nga AKSHI me shkresënr.2109/1, datë 05.05.2020, me anë të shkresës nr. 7658/1, datë 12.05.2020 ñKërkesë për transferim fonde në shpenzime kapitale`` në vlerën 23,700,000 lek është përcjellë në MFE kërkesa për rialokim, miratuar nga MFE me shkresë nr. 8301/3, datë 26.05.2020. Është shtuarnë vlerën 23,700,000 lekë zëri 231 për projektin e ri ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò dhe është pakësuar në vlerën 23,700,000 lekëzëri 231 me kod projekti 18AV806 ñKrijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT ò.

Ky transferim përbën 5.6% të shpenzimeve kapitale.

Konstatohet se kërkesat për transferim fondesh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kanë relacion shpjegues, në përputhje me pikën 71 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò.

Llogaria ekonomike	Kod Projekti	Planifikimi PBA 2020-2022	Plani fillestar	Plani I ndryshuar	Emri Projektit	Rialokim Shkrese Nr. 7658/1, date 12.05.2020 , miratuar nga MFE Nr. 8301/3, date 26.05.2020
2310000	18AV806	60,000,000	60,000,000	36,300,000	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRT	(23,700,000)
2300000	M100255	7,000,000	7,000,000	7,000,000	Pagesë kontributi vjetor Fiscalis 2020	
2310000	M100500	540,000,000	350,000,000	350,000,000	Përmirësimi I Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit	
2310000	18AV811	0	-	23,700,000	Ngritja e sistemit per shkembimin e informacionit financiar me entitetet e huaja	23,700,000
		607,000,000	417,000,000	417,000,000		

- ✓ **Ndryshimet e planit të buxhetit të vitit 2020 me Akte Normative**

Me aktin normativ nr.28, datë 02.07.2020, shpenzimet korrente shtohen në vlerën 127,000,000 lekë në artikullin 602, me kod produkti 91004 AB ñInspektime, hetime tatimoreò (Blerje shërbim automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët`). Shërbim qëllimi i të cilit është të realizohet automatizimi dhe monitorimi i inspektimeve në terren në Administratën Tatimore. Ky projekt synon të thjeshtojë dhe të informatizojë punën e përditshme të inspektoreve në zbatimin e urdhrave të punës si dhe në arritjen e objektivave të administratës tatimore në lidhje me luftën kundër informalitetit. Me anë te këtij procesi synohet të rritet edhe efikasitetin e vetë inspektorëve duke i dhënë mundësinë këtyre të fundit të kenë informacionin e duhur, në momentin e duhur mbi urdhrat e punës si dhe informacionin e nevojshëm mbi subjektet tatimpaguese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- ✓ **Niveli e realizimit të planit përfundimtar, kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.**Për sa i përket programit 01140 ñMenaxhimi i të ardhurave tatimoreò, realizimi kundrejt treguesve të planifikuar, në mënyrë të përmbledhur paraqitet në jepet në aneksin nr. nr.2/5, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

Emri i Grupit	**Ministria e Financave**	**Tatimore**					**Kodi i Grupit**	10
Programi	**Menaxhimi I të Ardhurave**						**Kodi i Programit**	1140
Art.	**Emërtimi**	**(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2019**	**(2) PBA Plan Viti 2020**	**(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020**	**(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020**	**(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhës/ progresiv**	**(6) Fakti i Periudhës/ progresiv**	**(7)=(6)-(5) Realizimi në %**
600	Paga	1,298,563	1,500,000	1,500,000	1,259,812	1,259,812	1,228,606	98
601	Sigurime Shoqërore	215,722	300,000	300,000	255,000	255,000	202,471	79
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	574,146	778,740	728,740	880,752	880,752	727,234	83
603	Subvencione	-	-	-	-	-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme	-	-	-	-	-	-	-
605	Transferta Korente të Huaja	1,120	1,260	1,260	3,510	3,510	3,132	89
606	Trans për Buxh. Fam. Dhe individ	31,764	-	-	32,326	32,326	16,134	50
Nën-Totali	**Shpenzime Korrente**	**2,121,315**	**2,580,000**	**2,530,000**	**2,431,400**	**2,431,400**	**2,177,577**	**90**
230	Kapitale të Patrupëzuara	5,553	7,000	7,000	7,000	7,000	6,250	89
231	Kapitale të Trupëzuara	743,352	626,000	410,000	410,000	410,000	409,266	100
232	Transferta Kapitale							
Nën-Totali	**Shpenzime Kapitale me financim tëbrendshëm**	**748,905**	**633,000**	**417,000**	**417,000**	**417,000**	**415,516**	**100**
Nën-Totali	**Shpenzime Kapitale me financim te huaj**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**748,905**	**633,000**	**417,000**	**417,000**	**417,000**	**415,516**	**99.6**
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limiti		-					-	
Totali shpenzimeve (korrente + kapitale +shp nga te ardhurat jashte limiti)		***2,870,220***	***3,213,000***	***2,947,000***	***2,848,400***	***2,848,400***	***2,593,093***	***91***
Paga e luftës (Artikulli 606)						12,306,000	12,052,395	98
Gjobat e kufirit						26,000	11,685	45
Totali së bashku me pagat e liftës dhe gjobat e kufirit						15,180,400	14,657,173	

Programit 01140 ñMenaxhimi i të ardhurave tatimoreò është realizuar në masën 91%, në vlerën 2,593,093 mijë lekë, kundrejt vlerës 2,848,400 lekë të planifikuar në planin përfundimtar.
Krahasuar me vitin 2019, në të cilin shpenzimet totale kanë pasur vlerën 2,870,220 mijë lekë, shpenzimet e vitit 2020 kanë pësuar ulje në masën 10%, ose në vlerën 277,127 mijë lekë më pak.
- Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 90%, në vlerën 2,177,577 mijë lekë kundrejt 2,431,400 lekë të planit përfundimtar, ose me një mosrealizim në vlerën 253,823 mijë lekë.
Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet korrente zënë peshën kryesore prej 84%.
Shpenzimet operative ï Mallra dhe shërbime të tjera (artikulli 602) brenda shpenzimeve korrente, përbën 34%, ose në vlerën 727,234 mijë lekë, ndërsa pagat e personelit zënë 57% të shpenzimeve korrente.
- **Shpenzimet kapitale** janë realizuar në masën 99.6%, në vlerën 415,515,516 lekë kundrejt 417,000,000 lekë të planit përfundimtar, ose me një mosrealizim në vlerën 1,484,484 lekë.
Shpenzimet kapitale zënë 16% të shpenzimeve totale të kryera.
- **Shpenzimet për paga**janë realizuar në masën 98%, në vlerën 1,228,606 mijë lekë kundrejt 1,259,812 lekë të planit përfundimtar, ose me një mosrealizim në vlerën 31,206 mijë lekë. Këto shpenzime zënë 48% të shpenzimeve totale të kryera.
Për vitin buxhetor 2019 janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar brenda afateve kohor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò. U paraqitën shkresat për raportet e monitorimit çdo 4 mujor dhe vjetor.
Raportet e monitorimit nuk janë hedhur në faqen online të DPT.

- ✓ **Raportimi i detyrimeve të prapambetura**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka raportuar çdo tremujor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura, konkretisht:
1. Shkresa nr.1300, datë 21.01.2020 ``Dërgohet raportimi periodik në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi deri në 31 Dhjetor 2019``.
2. Shkresa nr.6774, datë 17.4.2020``Dërgohet raportimi periodik në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi deri në 31 Mars 2020``;
3. Shkresa nr.12932, datë 10.7.2020``Dërgohet raportimi periodik në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi deri në 30 Qershor 2020``;
4. Shkresa nr.19665, datë 12.10.2020 `` Dërgohet raportimi periodik në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi deri në 30 Shtator 2020``
5. Shkresa nr.18049, datë 16.09.2020``Informacion mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për 8-mujorin 2020``;
6Shkresa nr.24210, datë 15.12.2020``Informacion mbi detyrimeve të prapambetura për 11-mujorin 2020``;
7. Shkresa nr.252, datë 08.1.2021 ``Dërgohet raportimi periodik në lidhje me detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi deri në 31 Dhjetor 2020``;
8. Shkresa nr.2689, datë 11.02.2021``Informacion lidhur me detyrimet e prapambetura për 12 mujorin 2020``- Degës së Thesarit Tiranë.
9. Shkresa nr.2895, datë 15.2.2020`` Konfirmim e detyrimeve të prapambetura për 12 mujorin 2020`` -Degës së Thesarit Tiranë;
Raportet periodike për detyrimet e prapambetura nuk janë hedhur në faqen online të DPT.
Përbërja e detyrimeve të prapambetura të raportuar nga DPT në MFE për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Vlerë
1	Vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna	**184,758,547**
2	Vendime gjyqësore që lidhen me subjektet private	664,090,061
	Detyrime për investime	***569,126,942***
	Detyrime për shtypshkrime	***82,645,332***
	Total detyrimet më 31.12.2020	1,500,620,882

Në raportimin që është bërë në MFE është plotësuar shtojca 3 dhe shtojca 3/1 në përputhje me pikën 115 të udhëzimit plotësues të MFE nr.2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò.

Titulli i gjetjes:

a-Mos raportimi nga ana e Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në MFE të vlerës së stokut të rimbursimit të TVSH-së në vlerën 9.7 miliard lekë, në formatin e detyrimeve të prapambetura. b- Krijimi i detyrimeve të prapambetura për shkak të marrjes së angazhimeve buxhetore pa fonde në dispozicion.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë stokun e rimbursimit të TVSH-së në vlerën 9.7 miliard lekë, në kundërshtim me shtojcën 4 ñDetyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-sëò.

Situata: Vlera e detyrimeve prej 1,500,620,882 lekë e raportuar në MFE rakordon me vlerën e raportuar në pasqyrat financiare të DPT, konkretisht: në aktiv llogaria 486 ñShpenzime te periudhave te ardhshmeò dhe në pasiv llogaria 467 ñKreditore te ndryshëmò.

Vlera e detyrimeve për zbatimin e vendimeve gjyqësore që lidhen me subjektet private më 31.12.2020 në vlerën 664,090,061 lekë, e raportuar nga Drejtoria e Financës përbëhen nga subjektet si vijon:

Nr.	Subjekti	NIPT	Data e dorëzimit të praktikës	Çelje detyrimi 2020	Tarifa përmbarimore	Likuiduar 2020	Detyrim, fund 2020
1	L	J	17.05.2019	2,542,738	-	-	2,918,361
2	B	K	24/01/2020	**66,393,943**	-	-	**66,393,943**
3	F K	K	4/2/2020	**563,859,444**	18,000,000	-	581,859,444
4	P C	K	4/12/2020	12,918,313			12,918,313.
	Total						664,090,061

Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për zbatimin e vendimeve gjyqësorë me subjektet private

Nga lista e detyrimeve **për zbatimin e vendimeve gjyqësore me subjektet private,** të lëna nga auditimi i mëparshëm janë likuiduar 3 vendime në vlerën **56,731,440 lekë si vijon:**

Nr.	Subjekti	NIPT	Data e dorëzimit të praktikës	Çelje detyrimi 2019	Tarifa përmbarimore		Likuiduar 2019	Detyrim, fund 2019	Likujduar gjatë vitit 2020
1	G	K	05.07.2018	30,686,415	1,472,948		10,840,000	21,319,363	21,319,363
2	C A	K	26.12.2018	56,591,671	2,716,400		32,160,000	27,148,071	27,148,071
3	A	J	29.08.2019	7,623,623	640,383		-	8,264,006	8,264,006
	Totali							**56,731,440**	**56,731,440**

Të tre subjektet e mësipërme për detyrimin e mbartur nga viti 2019 janë likujduar plotësisht.

Detyrimet për investime në vlerën 569,126,942 lekë përbëhet nga 11 fatura të pa likuiduara 5 prej të cilave i përkasin muajit tetor 2020 dhe 6 prej tyre muajit nëntor 2020.

Ky detyrim lidhet me dy investime të cilat janë prokuruar nga AKSHI:

1-Përmirësimi i modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit

2-Ngritja e Sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja

Sqarime për dy projektet:

1-Kontrata: Përmirësimi i modulit të Manaxhimit të Kontrollit të Faturimit (fiskalizimi).

Kontrata nr.6756 date 27/11/2018 vlerë totale 1,727,792,000, me kod projekti M100500, detyrim që i përket OE fitues J S sh.p.k. Kjo kontratë është kontratë investimi dhe mirëmbajte

dhe është prokuruar nga AKSHI në 27.11.2018 dhe ka qenë e shtrirë për tre vite 2018, 2019, 2020.

Nga auditimi i mëparshëm për këtë investim është konstatuar: *Projekti i investimit me kod M100500 "Përmirësimi i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit", nuk është pjesë e fazës së parë të PBA 2019-2021. Referuar fazës së dytë të PBA-së 2019-2021, projekti i mësipërm megjithëse datë fillimi ka vitin 2018 dhe datë mbarimi vitin 2020, fondet buxhetore për vitin 2020 dhe 2021 janë planifikuar në vlerën 0 lekë. Gjithashtu në listën e* ***Investimeve Publike 2019-2021****, të projekt buxhetit të vitit 2019,* ***nuk është parashikuar vlera e këtij investimi për vitin 2020*** *e cila referuar kontratës së lidhur për këtë projekt është* ***716,976 mijë lekë,*** *jo në përputhje me e pikës 6 të Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 të Ministrisë së Financave.* Gjithashtu për vitin 2020 nuk janë çelur fondet buxhetore në përputhje me vlerën e ngelur si detyrim për këtë vit, duke mos marrë në konsideratë kohëzgjatjen e kontratës dhe detyrimin për shlyerjen në kohë të vlerës së parashikuar në kontratë. Detyrimi i përket investimit, jo mirëmbajtjes. Për vitin 2020 parashikimi në PBA e 2020-2022 ka qenë në vlerën 540 milion lekë, çelja e fondeve nga MFE për buxhetin e vitit 2020 është 350 milion lekë, shumë më e ulët se detyrimi i ngelur. Ky projekt ka vlerën e investimit prej **1,727,791 mijë lekë dhe vlerën e mirëmbajtjes 510,392 mijë lekë. Vlera e investimit ka filluar në vitin 2018 e shtrirë në tre vite, ku në secilin vit do të likuidoheshin vlerat si vijon:**

-viti 2018, vlera 170,025 mijë lekë;

-viti 2019, vlera 840,790 mijë lekë;

Viti 2020, vlera 716,976 mijë lekë

Viti në të cilin duhet të përfundonte projekti: viti 2020.

Likuidimi në fakt është sipas të dhënave në tabelën në vijim:

Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		
Vlera e parashikuar për likujdim sipas kontratës	Vlera e likujduar në fakt	Vlera e parashikuar për likujdimsipas kontratës	Vlera e likujduar në fakt	Vlera e parashikuar për likujdimsipas kontratës	Vlera e likujduar në fakt	Detyrimi i ngelur përlikujdimmë 31.12.2020
170,025	170,025,887	840,790	668,952,161	716,976	350,000	512,786,943

Pra sipas kohështrirjes së kontratës projekti duhet të kishte përfunduar së likuiduari gjatë vitit 2020, por në fakt detyrimi më 31.12.2020 konstatohet të jetë 512,787 mijë lekë, ose 30% e vlerës së kontratës, pa likuiduar, jashtë afatit të planifikuar për likuidimin e projektit. Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës deklarohet se nuk ka shtesë kontrate për shtyrjen e afatit të investimit.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura në vlerën 512,787 mijë lekë për projektin "Përmirësimi i modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit" (fiskalizimi), ka ardhur si shkak i mos shlyerjes së detyrimeve të plota vjetore nga DPT që nga viti 2018, 2019 dhe 2020 për këtë investim, të cilat vijnë si rezultat i mos çeljes së fondeve të parashikuara për këtë investim nga MFE. DPT ka bërë 2 kërkesa për shtesë fondi për këtë kontratë, sipas përshkrimeve të mëposhtme, por nga MFE nuk janë alokuar fonde të reja përveç vlerës 350 milion:

a-Shkresa nr. 17144, datë 2.9.2020`` Kërkesë për shtesë fondi për **Fiskalizimin** në vlerën 538,813,952 lekë;

b-Shkresa nr .21901/1, datë 12.11.2020``Kërkesë e përsëritur për mundësimin e fondeve për : **Fiskalizimin** në vlerën 538,813,952 lekë, për projektin Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja në vlerën 56,340,000 lekë;

2-Kontrata "Ngritja e Sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja" , me kod produkti 18AV811, (kontrata 3275 date 10/07/2020 vlere 80,040,000 lekë), (operatori fitues IC D). Procedura e prokurimit është zhvilluar nga AKSHI gjatë vitit 2020, për llogari të DPT. Parashikimi në PBA 2020-2022 për këtë investim nuk është bërë pasi ligji

për këtë qëllim ka dalë në vitin 2020 pas hartimit të PBA (ligji nr. 4/2020 ñPër shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare), miratuar në datën 30.1.2020.
-Vlera e plotë e projektit: 80,040 mijë lekë;
-Fillimi i projektit viti 2020;
-Mbarimi i projektit viti 2020;
-Çelja e fondeve në PBA zero lekë;
-Likuiduar gjatë vitit 2020, vlera 23,700 mije lekë
-**Detyrimi më 31.12.2020, vlera 56,340 mijë lekë, ose 58% të vlerës së investimit, detyrim jashtë afatit të parashikuar në kontratë për likuidimin e projektit.** Ky projekt është zhvilluar si procedurë prokurimi nga AKSHI për llogari të DPT.
Fillimi dhe miratimi i zhvillimit të kësaj procedure prokurimi nga DPT, është bërë pa pasur fonde në dispozicion. DPT për mbulimin me fonde të këtij investimi DPT ka bërë kërkesë për alokim fondi nga projekti ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò në vlerën 23.700.000 lekë, me shkresën nr.7658/1, datë 12.05.2020``Kërkesë për transferim fonde në shpenzime kapitale`` në vlerën 23.700.000 lekë nga Projekti: ñKrijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center), sistemi telefonik voip dhe monitorimi për realizimin e projektit ``Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja``. Transferimi është bërë më miratim të MFE. Është pakësuar zëri 231 me kod projekti 18AV806 në vlerën 23,700,000 lekë dhe është shtuar zëri 231 për projektin e ri në vlerën 23,700,000 lekë.
Pra, nuk janë çelur fonde për projektin ñNgritja e Sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò , me kod produkti 18AV811, por DPT ka pakësuar fonde në vlerën 23,700,000 lekë nga një investim dhe i ka kaluar këto në një investim tjetër, duke krijuar dy probleme: Marrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion për investimin ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò dhe, mos shlyerjen e plotë të detyrimet të parashikuar në PBA dhe planin fillestar vjetor për projektin ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò (për këtë investim planifikuar fonde në vlerën 60,000,000 lekë, por në fakt likuiduar **35,565,516 lekë).** Investimi ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò, ka filluar në vitin 2019 me afat përfundimi në vitin 2021. Pakësimi i fondeve të planifikuara në buxhet nga një investim i caktuar me kohështrirje tre vjeçare, për të cilin është parashikuar që në fillim vlera e fondeve për secilin vit, çrregullimin e grafikut të likuidimit, me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura në momentin e përfundimit të afatit të investimit.
Fillimi dhe miratimi i zhvillimit të procedurës së prokurimi ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, nga DPT është bërë pa pasur fonde në dispozicion për këtë projekt, i cili nuk ka qenë i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe në planin fillestar vjetor. Ndryshimi i planit fillestar vjetor dhe futja e këtij projekti në listën e investimeve, është bërë me kërkesë të DPT, jo si rezultat i çeljes së fondeve të reja buxhetore, por si rezultat i transferimit të fondeve prej 23,700 mije lekë, nga projekti ekzistues ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò. Ky transferim ka qenë i gabuar, i pa argumentuar, pasi këto fonde nuk kanë qenë fonde ñtepërò për këtë projekt, por fonde të planifikuara dhe të nevojshme për tu shpenzuar për të. Si rezultat për projektin ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, më 31.12.2020 DPT ka krijuar një detyrim të ri të prapambetur në vlerën 56,340 mijë lekë, ose 58% të vlerës së investimit, si dhe ka lënë pa mbuluar me fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2020, investimin ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i

qendërzuar për DPT/DRTò, për vlerën 23,700 mije lekë. Pra e gjithë vlera e investimit prej 80,040,000 lekë, është angazhim i ri buxhetor pa pasur fonde në dispozicion, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, pika 153-162.
Mos shlyerja e detyrimeve për angazhimet e mara buxhetore, është në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis palëve, si dhe me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar
Kriteri: Marrja e angazhimeve buxhetore për këtë projekt nga DPT është kryer në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis si dhe në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi strukturat të cilat kanë marrë pjesë në këtë proces inicimi dhe aprovimi: Nëpunësin Autorizues znj. D. I. dhe Nëpunësin Zbatues zjn. D. C.
Gjithashtu në respektim të nenit 70 -Lidhja e kontratës, të VKM 914 datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ku thuhet se: *Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor",* DPT nuk duhet të kishte lejuar që AKSHI të realizonte lidhjen e kontratës, përderisa fondet nuk kanë qenë të çelura në llogarinë e DPT në thesar për vlerën totale të kontratës.
DPT për mbulimin me fonde të këtij investimi DPT ka bërë kërkesë për alokim fondi nga projekti ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò në vlerën 23,700,000 lekë, me shkresën nr.7658/1, datë 12.05.2020``Kërkesë për transferim fonde në shpenzime kapitale`` në vlerën 23,700,000 lekë nga Projekti : Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverësh (data center),sistemi telefonik voip dhe monitorimi për realizimin e projektit ``Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja``. Transferimi është bërë më miratim të MFE.
Është pakësuar zëri 231 me kod projekti 18AV806 në vlerën 23,700,000 lekë dhe është shtuar zëri 231 për projektin e ri në vlerën 23,700,000 lekë.
Në vazhdim me shkresa nr.8112/2, datë 03.06.2020``a) Kërkesë shtesë për projektin Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja`` në vlerë implementimi **56,120,000 lekë** me TVSH, pas rialokimit të vlerës 23,700,000 lekë për implementimin. b)Shtesë fondi për ``Blerje shërbimi i automatizimit dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët`` në vlerën 127,440,000 lekë, c) detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore të formës së prerë në vlerën 728,351,449 lekë.

Titulli gjetjes: Krijim stoku të artikujve të shtypshkrimeve të blera nga DPT.
Situata: Në vlerën e detyrimeve të prapambetura më 3.12.2020 prej 1,500,620,883 lekë, përfshihet edhe detyrimi prej 82,645,332 lekë që DPT ka për likuidimin e shtypshkrimeve të ndryshme. Ky detyrim vjen për shkak të stokut të këtyre shtypshkrimeve të blera prej DPT dhe të pa shitura ende. Në fund të vitit, Drejtoritë Rajonale Tatimore kthejnë pranë DPT të gjithë stokun e pa shitur të produkteve si bileta, pulla me të cilat furnizohet Ministria e Jashtme, blloqe tatimore, dëftesa tatimore, etj, të cilat ngelën mall stok i pa likuiduar. Ky stok likuidohet nga fondet i të ardhurave dytësore, të cilat sigurohen nga shitja e këtyre shtypshkrimeve.
Vlera prej 82,645,332 lekë në fund të vitit 2020 është një vlerë e konsiderueshme, e cila duhet të përbëjë shkak për DPT, për rishikimin e sasive të furniturave me shtypshkrimeve në

lidhje të ngushtë me nevojat reale dhe të ndara në disa furnitura gjatë vitit me sasi të ulët. Duke marrë në konsideratë dinamikën e ndryshimeve ligjore, një stok i konsiderueshëm shtypshkrimesh, mbart risk që një lloje i caktuar shtypshkrimi/dokumenti, të mos nevojitet më për përdorim, për arsye të humbjes së aktualitetit, situata të cilat shoqërohen me kosto financiare për buxhetin e shtetit kur ka ende mall stok të pa shitur.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, 11 dhe nenin 12 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò.

Shkaku: Blerje e pa studiuar mire në lidhje me nevojat reale për përdorim.

Rëndësia: E mesme

Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për vendimet gjyqësore

Mbështetur në tavanet buxhetore të miratuar me ligjin e buxhetitnr.88/2019, datë 18.12.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2020*ò për programin ñMenaxhimi i të Ardhurave Tatimoreñ, fondi planifikuar në fillim të vitit buxhetor 2020, për vendimet gjyqësore të formës së prerë ka vlerën 300 milion lekë.

Përgjatë vitit buxhetor 2020 ka pasur dy ndryshime të fondeve në këtë zë si rrjedhojë e rialokimit dhe ndryshimit nga akti normative, si vijon:

1.Me shkresën nr. 21847, datë 11.11.2020, është kërkuar nga DPT rialokimi në shpenzimet korrente në vlerën 40,431,385 lekë, pakësuar në artikullin 602 Kod produkti 91004 AA të DPT dhe shtuar në artikullin 602 për Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, Kod produkti 91004 AC (Vendime gjyqësore të ekzekutuara) në vlerën 30 milion lekë. Kërkesa e mësipërme është miratuar nga MFE me shkresë nr. 21240/2, datë 13.11.2020dhe shkresë nr. 21240/4, datë 03.12.2020.

Pra me këtë rialokim fondi për zbatimin e vendimeve gjyqësore është shtuar me 30 milion lekë.

2.Në zbatim të akti normativ nr.34, datë 16.12.2020, me shkresën nr.23412/28, datë 23.12.2020 është përcjellë detajimi i shtesave dhe paksimeve të ndryshimeve të planit të buxhetit për shpenzimet korrente ku për programin ñ Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore ñ ka pakësim në produktet 91004 AA ñTatimpagues të asistuarò në vlerën 60 milion lekë e 91004 AB ñInspektime, hetime tatimoreò në vlerën 100 milion dhe shtesë në produktin 91004 AC (Vendime gjyqësore të ekzekutuara) në vlerën 160 milion lekë. Pra nëpërmjet aktit normative nr.34, datë 16.12.2020, është shtuar fondi për zbatimin e vendimeve gjyqësore me vlerën 160 milion lekë.

Në 000/lekë

Emërtimi	**Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020**	Rialokim me shkresën nr. 21847, datë 11.11.2020	Rialokim në zbatim të A.N.nr.34, datë 16.12.2020	Plan përfundimtar	Realizimi
Planifikimi për vendime gjyqësore të ekzekutuara	300,000	30,000	160,000	490,000	434,333

Plani përfundimtar për vitin buxhetor 2020 për produktin ñVendime Gjyqësore të ekzekutuaraò është 490 milion lekë, për të cilin realizimi është 434.3 milion lekë, nga të cilat 377.6 milion lekë për gjyq fituesit ish punonjës të Administratës Tatimore dhe 56.7 milion lekë për subjekte tatimore me vendime gjyqësore te formës së prerë. Detyrimi i ngelur për DPT më 31.12.2020 për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna është 184,758,547 lekë për 168 punonjës. Në formë tabele, lista e ish punonjësve të likuiduar gjatë vitit 2020, paraqitet në aneksin nr.2/6, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

Detyrimi i ngelur për DPT më 31.12.2020 për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna është 184,758,547 lekë për 168 punonjës, sipas listës së mëposhtme të nxjerrë nga grupi i auditimit, mbi data-bazën e të dhënave të Drejtorisë së Buxhetit dhe

Financës, paraqitur në aneksin nr.2/7, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve. Vlera e raportuar nga DPT si detyrim për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna në 31.12.2019 është 404,442,528lekë. Nga auditimi konstatohet se nga 198 vendime gjyqësore për të cilat është kryer pagesa prej 377,601,994 lekë, 162 prej tyre, ose 82% janë kryer nëpërmjet përmbarimit, duke mos kryer likuidimin vullnetar dhe duke shpenzuar ngas buxheti i vitit 2020 për këtë shërbim vlerën 21,958,525 lekë.

<u>Titulli i gjetjes</u>: **Vonesa të konsiderueshme për disa vendime, midis datës së zbardhjes së vendimit nga Gjykata dhe depozitimit të tij nga DPT. Efekte financiare negative në buxhetin e shtetit për shkak të humbjes së proceseve gjyqësore me ish punonjës të larguar nga puna.**

Situata: Gjatë vitit 2020 nga buxheti i DPT, për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për çështje që lidhen me largimin e punonjësve nga puna nga ky institucion, është shpenzuar vlera 377,601,994 lekë, për 198 punonjës, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar këto procese gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve nga puna ka qenë i pa rregullt dhe nga institucioni i DPT nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të kuadrit rregullator në fuqi për këtë çështje. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime, do të ndikonte pozitivisht në përcaktimin e gabimeve teknike procedurale të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi nga DPT gjatë procesit të largimit të punonjësve nga puna dhe, si rezultat eliminimin e tyre në të ardhmen, duke ulur si numrin e rasteve edhe efektin financiar negativ në buxhetin e shtetit që sjell humbja e çdo vendimi gjyqësor.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr.60, të UMFE nr.9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, ku thuhet: *Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative*.

Nga informacioni i marrë nga drejtoria juridike konstatohet se kanë marrë formë të prere dhe janë përcjellë në finance 26 vendime gjyqësore për largimin e punonjësve nga puna. Bazuar në këtë informacion rezultojnë të pa regjistruar 2 vendime gjyqësore në financë.

Në projektraport grupi i auditimit është shprehur se: nuk është ndjekur si duhet radha e pagesës së gjyqfituesve, për arsye se gjatë këtij viti u konstatuan gjyq fitues me datë depozitimi të hershme të vendimit të Gjykatës, që nuk kanë marrë pagesë në 2020, ndërkohë që janë kryer pagesa për gjyq fitues me datë depozitimi të vendimit pas tyre, veprime jo në përputhje me pikën 5 Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 04.06.2014.

***Pretendim i subjektit të audituar**: Për sa më sipër është bërë observacion nga znj. D. C., protokolluar në KLSH me nr.513/24, datë 13.09.2021, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Nuk jam dakord me këtë konkluzion të audituesit, pasi nuk ka thyerje të radhës së pagesave të vendimeve gjyqësore. Vendimet gjyqësore regjistrohen në financë, pasi vjen dokumentacioni i plotë nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike. Procedurat janë të ndryshme për gjyqfitues të ndryshëm, pasi gjendja e tyre nuk është e njëjtë. Drejtoria e financës ka vënë në dispozicion raportimin zyrtar për pagesat e kryera në korrik 2020 dhe dhjetor 2020. Në këtë material është çdo gjë e sqaruar analitikisht dhe me dokument bashkëlidhur. Bashkëlidhur këtij observacioni do të gjeni dosjet analitike të çdo gjyqfituesi të përmendur si thyerje radhe.*

***Qëndrim i grupit të auditimit**: Gjatë procesit të auditimit, në përgjigje të kërkesës së grupit të auditimit keni dhënë informacion për radhën e pagesave të gjyqfituesve, sipas datës dhe numrit të urdhër shpenzimit dhe nuk është konstatuar prishje e radhës së pagesës në këtë informacion. Konkluzioni është nxjerrë referuar bazës kryesore të të dhënave të pagesës së*

vendimeve gjyqësore që administrohet prej Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në dokumentet bashkangjitur observacionit Ju justifikoni këtë konstatim të audituesit (janë persona të cilët janë punësuar dhe ju keni pezulluar vetë pagesën e vendimit gjyqësor, deri në sqarimin e situatës, nëse do të vazhdojë më tej pagesa, etj.). Për arsye se keni fakte dhe prova të reja, observacioni Juaj merret në konsideratë, pra nuk ka nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit thyerje të radhës së pagesës së vendimeve gjyqësore.

Për mosrespektimin e kritereve ligjore në largimin e punonjësve nga puna, të cilat janë shoqëruar me efekte financiare në buxhet kanë përgjegjësi Titullarët e Institucionit, si dhe stafi që ka përgatit praktikën për largimin e punonjësit, sipas vitit të largimit të punonjësit nga puna, pavarësisht se vendimi shfaqet në një kohë të mëvonshme.

Për mos analizimin e vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrjen e përgjegjësive për këto vendime ka përgjegjësi znj. D. I., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë Juridike dhe Ligjore u konstatua se ka diferenca të konsiderueshme në kohë midis datës së daljes së vendimit të formës së prerë nga Gjykata dhe datës së depozitimit të këtij vendimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ndërkohë që institucioni angazhon juristë përkatës për ndjekjen e çdo procesi gjyqësor.

Nga 26 vendime të formës së prerë për punonjësit e larguar nga puna, të dërguar nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës gjatë viti 2020, disa prej tyre janë shpallur nga Gjykata disa vite më parë, por të depozituar në DPT janë në vitin 2020 si: vendimi nr. 10, date 27.12.2013, depozituar në DPT në vitin 2020 (nr. 22801/2 Prot.,datë 15.12.2020), vendimi nr. 12, datë 22.01.2014, depozituar në DPT në vitin 2020 (nr. 2527 Prot., datë 03.02.2020), vendim nr.28 datë 19.01.2015, depozituar në DPT në vitin 2020 (nr. 3176 Prot., datë 12.02.2020),vendim nr.3139 datë 14.09.2018, depozituar në DPT në vitin 2020 (nr. 13205 Prot., datë 14.07.2020) etj sipas tabelës në vijim.

Mosnjohja në kohë nga ana e DPT më shpalljen e vendimit të formës së prerë të gjykatës, shkakton mosnjohjen në kohë të detyrimit të këtij institucioni, kur vendimi është fituar nga gjyqëfituesi (ish punonjësi), si dhe vonesa në ekzekutimin e vendimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 5, 6 dhe 7 të nenit 101 ñ Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit të çështjeve ligjoreò; Neni 15 i ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 ñKodi i procedurës civile i Republikës se Shqipërisëò.

Për anomalitë e mësipërme ka përgjegjësi Drejtoria dhe Ligjore dhe Teknike, sipas personave përkatës që kanë ndjekur procesin gjyqësore dhe vitin e shpalljes së vendimit nga Gjykata (që duhet të përcaktohen nga Titullari), si dhe vetë Titullari i Institucionit që nuk a analizuar këtë çështje.

Në aneksin nr.2/8, bashkangjitur raportit të auditimit, në rubrikën e anekseve, jepet lista e vendime gjyqësorë që janë përcjellë nga Drejtoria dhe Ligjore dhe Teknike në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, ku janë të evidentuar edhe diferencat në kohë midis shpalljes së vendimit të formës së prerë nga Gjykata dhe depozitimit të vendimit në DPT.

Kriteri: Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò, UMFE nr.9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar,

Ndikimi: Mos depozitimi në kohë në DPT i vendimeve të zbardhura nga Gjykata, sjellë vonesa në njohjen e situatës së gjyqfituesve, vonesa në marrjen e masave për planifikimin e fondeve për shlyerje të vendimit. Mos analiza e vendimeve gjyqësore nga ana e Titullarit, ulë mundësinë e korrigjimit të praktikave të gabuara të ndjekura nga DPT në proceset e largimit të punonjësve nga puna, të cilat kanë qenë të gabuara, prandaj dhe është humbur çështja gjyqësore. Analiza evidenton gabimet dhe nxjerrë përgjegjësitë.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për çështjet e mësipërme të vendimeve gjyqësore.

Fondet e shpenzuara nga DPT për shkak të situatës së covid 19

Për të përballuar situatën e pandemisë gjatë vitit 2020, është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt:Blerje mallra dhe shërbime për përballimin e situatës se shkaktuar nga COVID ï 19, për të cilën është lidhur kontrata në vlerën 14,622,723 lekë me TVSh.

Gjatë vitit 2020 DPT ka bërë edhe administrimin e ndarjes së ñpagave të luftësò, për të cilën nga MFE në llogarinë 606, me rritje të autorizuar në DPT ka çelur fondin në vlerën 12764,978,000 lekë, nga i cili është ndarë vlera 12,404,292,782 lekë. Janë 5 paketa për këtë qëllim me VKM të posaçme dhe për çdo paketë DPT ka ngritur grupe pune për hartimin e listave të përfituesve, të cilat pas përfundimit të tyre janë dorëzuar në financë për ekzekutim. VKM sipas paketave si vijon:

Paketa e ndihmës financiare VKM nr.254, datë 27.03.2020``*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhurat vjetore deri në 14 milion lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës së të ardhurave nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid -19* ``.

Paketa e ndihmës financiare VKM nr.3 05, datë 16.04.2020``*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19*``.

Paketa e ndihmës financiare VKM nr.651, datë 13.08.2020``*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare, si pasojë e Covid-19, për të punësuarit apo të ish të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetës.*

Paketa e ndihmës financiare VKM nr.856 datë 04.11.2020``*Për ndihmën financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollet e sigurisë, në kuadër të parandalimit e të kontrollit të pandemisë Covid-19.*

Paketa e ndihmës financiare VKM nr.1100, datë 16.12.2020``*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.651, datë 13.08.2020, të Këshillit të Ministrave, `Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare , si pasojë e Covid-19, për të punësuarit publik, qytetas dhe ndërqytetës*``.

4.Mbi hartimin e pasqyrave financiare

c. Hartimi i pasqyrave financiare vjetore. Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, veçanërisht në:

-zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, paraqitja e shtesave apo përmirësimeve të kryera gjatë vitit në aktivin e duhur.

-zërin "Të drejta të arkëtueshme" analizuar sipas llojit të tatimit. Testimi i të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyrave financiare.

-zërin "Detyrime ndaj të tretëve" sipas llojit (përfshirë detyrimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe TVSH). Kontabilizimi dhe raportimi i tyre në kuadër të raportimit periodik të detyrimeve të prapambetura në MFE, sipas llojit dhe kohës së krijimit të tyre.

Kontrolli periodik i aktiveve

1-Procesi i inventarizimit të aktiveve në administratën e DPT

Për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve, nga Drejtori i Përgjithshëm znj. Dalina Ibrahimaj, ka dalë urdhri nr. 23556 prot., datë 07.12.2020 me lëndë ñPër ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj për vitin 2020ò. Në pikën nr. 6 të këtij urdhri është përcaktuar: ñMateriali përmbledhës së bashku me raportin informues do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Buxhetiti e Financës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse brenda datës 15.01.2021ò.

Komisioni i inventarizimit përbëhet nga: znj. A. K., z. S. Sh., znj. G. S., znj. B. B., z. J. M. (i cili është caktuar me urdhrin nr, 23556/1, datë 22.12.2020). Me shkresën nr.23556/2, datë 07.01.2021, me lëndë ñKërkesë për shtyrje afatiò, komisioni i inventarizimit ka kërkuar shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën nr.6 të urdhrit nr. 23556 prot., datë 07.12.2020, për shkak të situatës së pandemisë. Me urdhrin nr. 23556/5, datë 20.12.2020, Drejtori i Përgjithshëm znj. D. I., ka miratuar shtyrjen e afatit të përfundimit të inventarizimit, duke përcaktuar se ñMateriali përmbledhës së bashku me raportin informues do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Buxhetiti e Financës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse brenda datës 25.01.2021ò.

Me shkresën nr. 1402 prot., datë 25.01.2021, me lëndë ñDërgohet raporti përfundimtar mbi inventarizimin fizik të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve dhe gjendjes materiale të magazinave, sipas inventarit kontabël datë 30.11.2020ò, komisioni i inventarizimit ka njohur drejtorin e Përgjithshëm, Drejtorin e Financës dhe Buxhetit, Drejtorin e Shërbimeve Mbështetëse, me rezultatet e inventarizimit. Në raportin përfundimtar mbi inventarizimin fizik të aktiveve, komisioni nuk ka konstatuar diferenca midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike të aktiveve dhe ka përfunduar procesin e inventarizimit brenda afatit të përcaktuar në urdhër.

Në raportin përmbledhës komisioni i inventarizimit ka hartuar edhe shumat e vlerave të aktiveve sipas llogarive ekonomike, të cilat kanë diferenca të konsiderueshme me vlerën e pasqyruar në pasqyrat financiarë për këto llogari, sipas tabelës në vijim:

Nëlekë

Nr. Llogarisë	Sipas procesit te inventarizimit			Vlera bruto kontabël e aktiveve sipas pasqyrave financiare	Diferenca midis vlerës bruto në pasqyrat financiare dhe vlerës së raportuar nga komisioni inventarizimit
	Vlera bruto kontabël	Vlera bruto fizike	Diferenca		
212	144,572,341	144,572,341	-	144,572,338	0
213	201,624,796	201,624,796	-	1,273,065,259	1,071,440,463
214	31,194,062	31,194,062	-	202,088,046	170,893,984
215	81,641,931	81,641,931	-	96,487,579	14,845,648
218	119,094,683	119,094,683	-	162,068,064	42,973,381
327	66,973	66,973	-	75,238	8,265
TOTALI	578,194,786	578,194,786	-		

Burimi:Raporti i komisionit mbi inventarizimin e DPT-së dhe të dhënat e pasqyrave financiare

Për diferencat e mësipërme midis shumave të vlerave të llogarive të aktiveve të raportuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerave të këtyre aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare nga komisioni i inventarizim u dha shpjegimi si vijon:

Llogaritë ekonomike të dërguara në tabelat e paraqitura në raportin përfundimtarë nga komisioni janë jo të plotë por pjesërisht, janë vetëm materialet në ngarkim të punonjësve në shumën 578,194,785.72 lekë.

Përsa i përket magazinave, janë kontrolluar fizikisht nga ana e komisionit, por shuma totale e magazinave nuk janë ndarë sipas llogarive ekonomike.

Pas rakordimit me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, vlerat e inventarit janë të njëjta me informacionin e dhënë nga ana e tyre. Inventari është kryer për periudhën nga 1 janar 2020 deri më 30 nëntor 2020.

Konstatohet se komisioni i inventarizimit nuk është pajisur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit me të dhëna përmbledhëse për numrin total të aktiveve dhe vlerën totale të tyre të

grupuar për secilën llogari më vete, në mënyrë që këtij informacioni ti referohej në hartimin tabelës përmbledhëse të vlerave të aktiveve sipas llogarive ekonomike. Kjo do të ndihmonte dhe lehtësonte punën e komisionit për hartimin në mënyrë përmbledhëse të vlerave të aktiveve sipas llogarive kontabël.
Në aktin e konstatimit është trajtuar se ñNga auditimi i raportit përmbledhës të hartuar nga komisioni i inventarizimit konstatohet se prej tij nuk është bërë vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, pasi nuk është shprehur për këtë çështje në asnjë nga fletët e inventarizimit, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.85, germa (c) e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, ku thuhet:*Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për...Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre...*
***Pretendim i subjektit të audituar**: Për sa më sipër është bërë observacion nga anëtarët e komisionit të inventarizimit znj. A. K, z. S. Sh, znj. G. S, znj. B. B, z. J. M, protokolluar në KLSH me nr. 513/3, datë 20.08.2021, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Në procesverbalet e inventarizimit të cilat janë depozituar në DPT Komisioni i inventarizimit ka bërë shënime në kolonën e fundit të fletës së inventarizimit "komente", vetëm në rastet kur ka konstatuar aktive të dëmtuara. Bashkëlidhur oprservacionit janë dërguar 11 faqe dokumentacion i inventarizimit, të cilat kanë shënime nga ana e komisionit në kolonën komente, për gjendjen e aktiveve të cilat janë konstatuar si aktive që duhet të vlerësohen dhe janë bërë përshkrime për gjendjen e tyre fizike (11 fletët e dorëzuar përbëjnë procesverbalin nr.25 të hartuar nga komisioni i inventarizonit.*
***Qëndrim i grupit të auditimit**: Për arsye se keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni Juaj merret në konsideratë dhe për këtë arsye komisioni nuk është përgjegjës për mos kryerjen e vlerësimit paraprak të aktiveve gjatë procesit të inventarizimit.*

Titulli i gjetjes: Mostransferim i aktiveve nga DPT te AKSH, në kundërshtim me urdhrin e dalë për këtë qëllim,.
Situata: Në raportin përfundimtar mbi inventarizimin fizik të aktiveve, pika nr.5, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se: ñ*Sa i përket përgjegjëses materiale të magazinës M263, znj. S. H. janë disa materiale të cilat nuk janë verifikuar fizikisht nga ana e komisionit dhe përgjegjësia materiale e kësaj magazine ka cilësuar në kartelën përkatëse se këto materiale rezultojnë të shoqëruara me faturat përkatëse të daljes nga magazina me vlerë 225,334,395 lekë, si dhe nuk është bërë tërheqja e tyre nga organi publik i përcaktuar".*
Nga informacioni i marrë gjatë procesit të auditimit u konstatua se situata e mësipërme për materiale të magazinës M263 vazhdon të jetë e njëjtë dhe kjo çështje lidhet me programe kompjuterike të cilat duhet të ishin transferuar nga DPT te AKSHI nëpërmjet kalimit kapital.
Bazuar në informacionin shkresor dhe dokumentacionin e dhënë nga grupi i punës së DPT, i ngritur për këtë çështje, ky proces i pa përfunduar për transferim aktivesh, ka pasur historikun si vijon:
Në zbatim të VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për "Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" , i ndryshuar, neni IV pika 18, është ngritur urdhri i përbashkët nr.8778 prot, datë 02.05.2019, ndërmjet Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Në këtë urdhër është përcaktuar:
1.Grupet e punës të ngritura për këtë qëllim të përcaktojnë listën e aktiveve për infrastrukturën hartdware dhe sistemet IT, objekt kalimi kapital, si dhe të identifikojnë të drejtat dhe detyrimet e i institucioneve në lidhje me aktivet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, AKSHI dhe grupet e punës për zbatimin e këtij urdhri dhe kryerjen e veprimeve

përkatëse për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të aktiveve për infrastrukturën hartdware dhe sistemeve të IT.
3.Afati për zbatimin e këtij urdhri të jetë 7 ditë kalendarike nga nënshkrimi i tij.
Ky urdhër është pasuar me urdhrin e brendshëm nr.9379 prot., datë 09.05.2019 për krijimin e grupit të punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për kalimin e aktiveve në inventarin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
Grupi i punës përbëhet nga E. C. (Sektori i Shërbimeve Mbështetëse), A. K. (Drejtoria Juridike) dhe H. K. (specialist në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës).
Bazuar në pikën 2 dhe 3 të urdhrit nr. 9379 prot, datë 09.05.2019, detyrat e grupit të punës është përcaktimi i listës se inventarit të aktiveve për infrastrukturën hartdware dhe sistemet IT të DPT dhe kalimi i këtyre aktiveve në inventarin e AKSH-it. Urdhri nuk ka përcaktuar afate, por ka hyrë ne fuqi menjëherë.
Nga grupi i punës të DPT janë kryer një sere takimesh me përfaqësuesit e grupit te punës se AKSHI-it, dokumentuar me proces verbale.
Grupi i punës i DPT ka marrë informacion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe zyrat e financës në Drejtoritë Rajonale Tatimore për listën e inventarit te infrastrukturës SoftŴare dhe hartdware, në pronësi te DPT qe duhet te behën kalim tek AKSHI.
Në datën 21.05.2019 në takimin e përbashkët me përfaqësues të komisionit te AKShI-t ky informacion i është dhënë këtij të fundit, për përcaktim se cila prej aseteve do të kalojnë tek AKSHI.
Në datën 31.07.2019, me shkresën nr. 14753 prot., i është dërguar grupit të punës së AKSHI-t, kërkesë për konfirmim të listës së aktiveve.
Në datën 18.11.2019 në prani të grupeve të punës për të dy institucionet DPT dhe AKSHI, është mbajtur proces verbal i kalimit te aktiveve për infrastrukturën hartdware dhe sistemet IT, nga DPT në cilësinë e institucionit dorëzues dhe AKSH në cilësinë e institucionit të marrjes ne dorëzim.
Ky proces-verbal është firmosur nga grupi i dorëzimit për Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve dhe dy anëtare te komisionit te marrjes ne dorëzim nga AKSHI, z. A. A. dhe znj. S. S. (nga shtate anëtarë gjithsej)
Në datë 22.11.2019 nëpërmjet shkresës nr. 21323/1 prot., nga DPT është dërguar tek AKSHI material për të përmbyllur procesin e kalimit kapital të këtyre aktiveve.
Për të bere të mundur përfundimin e kësaj procedure, nga punonjësit e AKSHIT të cilët punojnë në DPT, është bere dorëzimi në magazinën e DPT i aktiveve të cilat janë objekt kalimi kapital nga DPT te AKSHI. Këto aktive të natyrës software, me dokumentacion janë dorëzuar në magazinën e DPT, por në fakt janë në përdorim të punonjësve te AKSHI-t që janë pranë DPT.
Në përgjigje të shkresës së DPT, nr. 21323/1 prot., AKSHI është përgjigjur me shkresën nr. 4639/2 date 03.09.2019 ku janë evidentuar lista e plote e aktiveve që do ti kalojnë AKSHIT si dhe është kërkuar që nga DPT të plotësohet kodi në burim për këto sisteme.
Nëpërmjet shkresës Nr 17659 prot , date 11.09.2020 nga ana e grupit te punës në DPT i është kërkuar Drejtorisë TIK në DPT, vënia në dispozicion e kodit në burim për sistemet dhe me memon nr. 17659/1 prot, datë 12.10.2020 nga ana e drejtorisë TIK në DPT është vendosur ne dispozicion kodi në burim për sistemet M-tax dhe E-tax, ndërsa për sistemet Nexus (kasat), harta dixhitale dhe BI është komunikuar se mungon kodi në burim.
Në datën 15.12.2020 dokumentacioni i sipërcituar i është ri dorëzuar se bashku me memon informuese Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e grupit të punës, në zbatim te urdhrit nr. 9379 prot, datë 09.05.2019.
Nga Drejtori i Përgjithshëm ka dalë urdhri nr. 94 date 30.12.2020 me lende "Për një ndryshim ne urdhrin nr 9379, datë 09.05.2019" , ku citohet se ne përfundim te detyrës së

ngarkuar sipas këtij urdhri, grupi i punës harton një raport përmbledhës të cilin ja paraqet Z K. Sh. –Zv Drejtor i Përgjithshëm i tatimeve për konfirmim.

Si përfundim deri tani është bere vetëm kalimi i aseteve (softe dhe hardwer) nga punonjësit e IT në magazinë, për te bere te mundur procedurën e kalimit të tyre pranë institucionit përfitues (AKSHIT), por jo transferimi i tyre nga DPT te AKSHI.

Kriteri:VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për ñRiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò , i ndryshuar, neni IV pika 18; urdhri i përbashkët nr.8778 prot, datë 02.05.2019, ndërmjet Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Ndikimi: Aktivet janë në përdorim faktik të punonjësve të IT së AKSHI-t, ndërsa nga ana formale ato janë dorëzuar në magazinën e DPT. Kjo mospërputhje nuk pasqyron përgjegjësin materialnë dhe përdoruesin e vërtet të aktivit.

Shkaku: Mos zbatim i urdhrit të përbashkët midis DPT dhe AKSHI për transferimin e aktiveve dhe mos zgjidhja teknike midis palëve e mungesës së kodit në burim për disa prej aktivet.

Rëndësia: e lartë

Titulli i gjetjes: Mos dorëzim i aktiveve që kanë pasur në ngarkim, përpara largimit nga puna, për disa nga punonjësit e DPT.

Situata: Me shkresën nr. 1402/1, datë 02.02.2021, të Drejtores së Financës znj. D.C., komisionit të inventarizimit i janë kërkuar shpjegime dhe saktësime për disa çështje të inventarizimit si mos kryerja e inventarizimit të disa aktiveve që janë në ngarkim të personave të cilët nuk kanë qenë prezent për arsye të ndryshme (covid 19 etj). Në përgjigje të kërkesës së mësipërme komisioni i inventarizimit ka vijuar punën plotësuese.

Në përfundim të procesit të inventarizimit, me shkresën nr. 1402/6, datë 10.03.2021, me lëndë ñKthim përgjigjeò, komisioni i inventarizimit ka informuar Drejtorinë e Financës, Drejtorin e Përgjithshëm dhe drejtorin e Shërbimeve Mbështetëse, me informacion shtesë i cili është pjesë e informacionit të inventarizimit të përshkruar në shkresën nr. 1402 prot., datë 25.01.2021. Në shkresën nr. 1402/6, datë 10.03.2021, komisioni i inventarizimit sqaron se: ñ*Komisioni nuk arriti të kryej verifikim fizik të materialeve në magazinë M14 Programe, pasi nuk gjendet*. (Vlera e këtyre programeve është 423,460 lekë dhe përbëhet nga tre programe). Komisioni i inventarizimit ka konstatuar se ñDisa ish punonjës të cilët janë larguar si pasojë e shkëputjes nga puna në DPT, rezultojnë ende me materiale në ngarkim, si vijonò:

Magazina	Emër Mbiemër	Vlera Materiale në ngarkim	Gjendja
M116	B. Ll.	163,017	Me covid
M14	Programe	423,460	Nuk gjenden
M145	F. K.	8,260	Larguar nga puna
M210	E. R.	13,500	Larguar nga puna
M224	R. S.	48000	Larguar nga puna
M262	B. K.	109,966	Larguar nga puna
M266	D. B.	900	Larguar nga puna
M355	H. M.	6,000	Larguar nga puna
	Total	773,103	

Punonjësit e mësipërm të cilët kanë ende aktive në ngarkim janë larguar nga puna sipas datave në vijim:

B.L. transferuar në DRT Tiranë në datën 23.07.2020 (23.07.2020 nga Inspektor i Parë, Dr. Auditit të Brendshëm kalon në pozicionin Inspektor i Parë, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DRT Tiranë).

F. K: Në datën 21.06.2019 është pezulluar nga shërbimi civil.

E. R: 14.11.2018 Përgjegjës Sektori, Drejtoria Ligjore dhe Teknike, largim me masë disiplinore.

R. S: 03.06.2019- 06.04.2020 nga pozicioni Inspektor Zbatimi, në Sektorin e Zbatimit Task Forcë në DPT kalon me ristrukturim në pozicionin Inspektor Zyra e Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative, në DRT Fier. Në datën 06.04.2020 lirim nga detyra për shkak ristrukturimi.
B K: 03.06.2019- në vazhdim Nga Inspektor Zbatimi në Sektorin e Zbatimit Task Forcë në DPT kalon me ristrukturim Inspektor Zyra e Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative, në DRT Fier
24.01.2020 Inspektor Zyra e Veprimeve ne Terren dhe Masave Administrative, në DRT Fier në Inspektor Zyra e Veprimeve në Terren dhe Masave Shtrënguese në DRT Tiranë
06.04.2020 Inspektor Zyra e Veprimeve në Terren dhe Masave Shtrënguese në DRT Tiranë kalon Inspektor Sektori i Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DRT Tiranë me Ristrukturim
D. B: 03.06.2019 Inspektor Zbatimi, Sektori i Zbatimit Task Forcë në DPT transferim për shkak ristrukturimi në Inspektor Zbatimi, Sektori i Monitorimit Territorial në DRT Shkodër. Në datën 01.04.2020 lirim nga detyra me dorëheqje.
Për mos dorëzimin e aktiveve nga punonjësit e larguar nga puna, kanë përgjegjësi vetë punonjësit, si dhe Titullari i Institucionit, i cili nuk ka përcaktuar në urdhër strukturën për që do të ndjek dorëzimin e aktiveve nga punonjësi që largohet, por vetëm strukturën për dorëzimin e detyrës.
Kriteri: Punonjësit që nuk kanë dorëzuar detyrën kanë vepruar në kundërshtim me:
-UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 13, ku thuhet: Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit te përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektove sipas specifikave te aktiveve.
-VKM nr. 124, datë 17.2.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, ku thuhet:
27. Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil.
28. Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe te njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar.
29. Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimit. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera.
30. Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29 të këtij vendimi, konsiderohet shkelje e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore.
Ndikimi*:* Mos dorëzimi i aktiveve nga punonjësit e larguar nga puna, përvecse është shkelje e rëndë e disiplinës, sjell premisa për humbjen apo keqpërdorimin e tyre.
Shkaku: Mos zbatimi nga vet punonjësi i kuadrit rregullator në fuqi për detyrimin që ka për dorëzimin e inventarit fizik.
përpara largimit, si dhe mos përcaktim në urdhrin e Titullarit të detyrimit që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve dhe mos përcaktimi i strukturës që do të ndjek procesin e dorëzimit të aktiveve.
Rëndësia: e mesme
Pretendimi i subjektit:*Për sa më sipër në fazën e projektraporit është bërë observacion nga znj. F. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, protokolluar në KLSH me nr.513/13, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Mos dorëzimi i mjeteve të punës nga ish punonjësit nuk është përgjegjësi e Drejtorit të Shërbimeve, por e strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore. Në momentin që çdo punëmarrës merr në ngarkim aktive, përgjegjësia*

është individuale për dorëzimin e tyre. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse nuk merr dijeni zyrtarisht për largimin e punonjësve nga puna dhe nuk është strukturë që përfshihet në marrëdhëniet e punës. Bashkangjitur janë urdhrat për largimin apo transferimin e punonjësve që nuk kanë dorëzuar aktive, në të cilat konstatohet qartë se Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse nuk përfshihet në këtë proces.

Qëndrim i grupit të auditimit: *Sqaromë se inventari fizik në vlerën 773,103 i konstatuar nga komisioni i inventarizimit, se në gjendjen kontabël është i regjistruar ende në emër të punonjësve, ekziston, pra nuk ka humbje apo shpërdorime, por mos rinovim kartelash inventarizimi, të cilat bëhen nga struktura e financës, por pasi del urdhri për këtë qëllim, për kalimin e inventarit nga një punonjës që largohet te një punonjës tjetër, apo në magazinë, sipas rastit. Edhe në subjekt, edhe në observacionin tuaj, grupit të auditimit nuk ju janë paraqitur urdhra të tillë për kalim të inventarit fizik nga punonjësit e larguar në persona të tjerë përgjegjës. Nga auditimi i urdhrave të nxjerrë nga Titullari për largimin apo transferimin e punonjësve që nuk kanë dorëzuar inventarin fizik, konstatohet se Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse nuk është e përfshirë në zbatimin e këtyre urdhrave. Në urdhër është përcaktuar vetëm strukturat që do të merren me dorëzimin e detyrës nga punonjësi, por nuk është përcaktuar struktura për ndjekjen e dorëzimit të inventarit fizik nga punonjësi. Në urdhër nuk është përcaktuar Drejtor e Shërbimeve për ndjekjen e këtij procesi. Duhet theksuar se dorëzimi nga punonjësi i dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, nuk është e njëjtë me dorëzimin e inventarit fizik, sepse janë dy dorëzime në dy struktura të ndryshme.*

Duke qenë se në urdhrat e largimit nuk është përcaktuar se cila strukturë do të ndjek dorëzimin e inventarit fizik nga punonjësi që largohet, kundërshtia Juaj është e drejtë. Por pasi është kryer procesi i inventarizimit nga komisioni, Drejtoria e Shërbimeve është njohur me rezultatet e inventarizimit dhe me këtë konstatim, që inventarit fizik i punonjësve të larguar është ende në emër të tyre. Pas këtij momenti fillon përgjegjësia Juaj, sepse duhet të ishin marrë masa që ky inventar fizik të hiqej nga këta persona dhe të kalonte ose në persona të tjerë ose në magazinë, sipas rastit. Pra duhet të kishte dalë urdhër i iniciuar nga ana juaj për sistemimin e këtij inventari fizik. Nga ana tjetër, grupi i auditimit konstaton mospërfshirjen e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës në zgjidhjen e kësaj anamalie, pasi kjo strukturë vërtet bënë regjistrimet përfundimtare kontabël të inventarizimit fizik, bazuar në urdhrat, fletëhyrjet, fletëdaljet etj, por është njohur me këtë fakt që në fillim me largimin e punonjësit, si dhe në vijimësi nga komisioni i inventarizimit. Në kushtet e pasjes dijeni të këtij fakti, duhet të kishte kërkuar nga struktura e Drejtorisë së Shërbimeve, apo edhe nga Titullari, që të sistemohej kjo anomali, pasi vetë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës nuk i korespodon gjendja fizike e aktiveve me gjendjen kontabël përsa i përket ndarjes së këtyre aktiveve te punonjësit. Konstatohet mungesë bashkëpunimi midis këtyre dy strukturave lidhur me parregullsinë e mësipërme dhe të dy Drejtorët F. H. dhe D. C. kanë përgjegjësi (pa përjashtuar këtu përgjegjësinë e vetë punonjësit). Gjykojmë se nga ana e Titullarit është e nevojshme nxjerrja e një akti administrativ të brendshëm, ku të përcaktohen në mënyrë të përmbledhur detyrimet që ka punonjësi përpara largimit apo transferimit nga puna, si dhe cilat janë strukturat përgjegjëse të DPT që ndjekin këtë proces, cila është detyra e së cilës strukturë. Duke qenë e përmbledhur dhe e përshkruar vetëm në një akt kjo procedurë, e bënë më të qartë dhe më të lehtë zbatimin si nga punonjësi, ashtu edhe nga strukturat e DPT që përfshihen në këtë proces.

Mbi procedurën e inventarizimit të Drejtorive Rajonale Tatimore kanë dalë urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit. Ky proces ka përfunduar brenda afateve të përcaktuar në urdhër dhe përpara hartimit të pasqyrave financiare, sipas të dhënave si vijon:
DRT Fier, urdhri nr.13857, date 29.12.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 29.01.2021; DRT Durrës, urdhri nr.27, datë 31.12.2020, përfunduar procesi i inventarizimit

më 18.01.2021, DRT Vlorë, urdhri nr.8606/1, date 24.09.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 17.02.2021; DRT Shkodër, urdhri nr.22, date 02.12.2020 përfunduar procesi i inventarizimit më 15.12.2020; DRT Kukës, urdhri nr.3428, date 30.12.2020 përfunduar procesi i inventarizimit më 21.01.2021; DRT Elbasan, urdhri nr.6377, datë 11.09.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 22.09.2020; DRT Korë, urdhri nr.12480, datë 25.09.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2020; DRT Dibër, urdhri nr.3271 datë 18.11.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 10.12.2020; DRT Berat, urdhri nr.2273, datë 07.12.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2020; DRT Sarandë, urdhri nr.4947 datë 06.11.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 30.12.2020; DTM, urdhri nr.9384, datë 24.11.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 11.12.2020; DRT Tiranë, urdhri nr.47, datë 11.11.2020, përfunduar procesi i inventarizimit më 25.12.2020, DRT Gjirokastër përfunduar procesi i inventarizimit më 05.01.2021, DRT Lezhë përfunduar procesi i inventarizimit më 18.03.2021.

Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi për vitin 2020, në administratën e DPT.

Titulli i gjetjes: Mos kryerje e vlerësim të aktive për të gjitha aktivet e DPT, por vetëm për ato që ndodhen në magazinë, si dhe mos përfundim i këtij procesi për mungesën e zëvendësimit të njërit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit.

Situata: Për vitin buxhetor 2020 nuk është ngritur komision për vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, por gjatë vitit 2020 ka vijuar punën komisioni i vlerësimit i ngritur për llogari të vitit buxhetor 2019, me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, nr.21428/2, datë 17.02.2020 ñPër ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeveò. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga 5 punonjës: zj. D. C. (kryetar komisioni, me detyrë nëpunës zbatues), z. P.P, zj. A. S, zj. P. S, z.Y T. Afati për përfundimin e këtij procesi është data 03.03.2020.

Znj. A. S, nuk ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit të aktiveve për shkak të situatës Covid 19, si nëne me dy fëmijë. Për këtë pamundësi mospjesëmarrje, znj. A. S, ka informuar komisionin e vlerësimit me e-mail, në datën 19.03.2020. Për këtë qëllim është njoftuar Drejtoria e Shërbimeve nëpërmjet postës elektronike, nga kryetare e komisionit, znj. C. dhe është kërkuar zëvendësimi i znj. S.

Në pikën nr. dhe 4 të urdhrit është përcaktuar se: ñKomisioni në përfundim të vlerësimit përgatit materialin për nxjerrje jashtë përdorimit të vlerave materiale në magazinë. Përgatit raportin përfundimtar brenda datës 03.03.3020 dhe ja paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeveò.

Me shkresën nr.4300, datë 25.02.2020 komisioni i vlerësimit ka njoftuar Drejtorinë e Administratës dhe Prokurimeve se nga ana e komisionit të inventarizimit fizik të aseteve nuk është propozuar lista e materialeve në magazinë për vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit dhe ka kërkuar ti vihen në dispozicion listën e materialeve për të cilat do të bëhet vlerësimi për nxjerrje jashtë përdorimit. Në përgjigje të shkresë së komisionit, nga znj. F. H, me detyrë Drejtore e Administratës dhe Prokurimeve, është kthyer përgjigje se: Në përfundim të punës së tij, komisioni i inventarizimit, ka dërguar raportin përfundimtar me shkresën nr.21428/1, prot., datë 20.01.2020, në të cilin nuk është bërë ndonjë sugjerim për materiale jashtë përdorimit. Nga Drejtore e Administratës dhe Prokurimeve është sugjeruar që lista e materialeve duhet të bëhet nga vetë komisioni vlerësimit, duke i parë një për një aktivet.

Në datën 03.03.2020 komisioni i vlerësimit me shkresën nr. 21428/3, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, ka kërkuar prej këtij të fundit shtyrjen e afatit të procesit të vlerësimit.

Me urdhrin nr. 21428/6 prot., datë 18.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është zëvendësuar anëtari i komisionit z. Y. T. me znj. A. M. Në këtë urdhër afati i përfundimit të

vlerësimit të aktiveve është përcaktuar sërish data 18.03.2020, e njëjtë me datën e daljes së urdhrit.
Në vijim, komisioni i vlerësimit të aktiveve me shkresën nr.21428/14, datë 20.05.2020, me lëndë: ñRaportim nga komisioni i vlerësimit të vlerave materiale në magazinën e DPTò, ka informuar Titullarin znj. D. I. lidhur me përfundimin e procesit të vlerësimit të aktiveve. Në këtë raport komisioni evidenton se ky proces është i kryer me një anëtar komisioni mangut, për shkak të mos pjesëmarrjes në këtë proces të znj. A. S. Komisioni është shprehur: ñDuke u gjendur në këtë situata ku zëvendësimi i anëtarit të komisionit por dhe ecurisë së afateve kohore të komisionit të vendoset në një moment të dyrë, vendimmarrja do të merret nëmomentin e plotësimit të kushteve të mësipërme, pra zëvemdësimin e anëtarit të komisionit nëqoftë se do të vazhdojë të jetë e njëjta situatë, shfuqizimin e VKM nr.243 datë 24.03.2020. Pas plotësimit të plotë të këtyre elementëve komisioni do të dalë në vendim të unifikuar...ò .
U paraqitë shkresa elektronike (me e-mail) të znj. D. C., me detyrë Drejtore e Buxhetit dhe Financës, drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve në datën 01.04.2020, ku evidentohet se për ndryshimin e anëtarit të komisionit është njoftuar në datën 31.3.2020.
Si konkluzion:
Komisioni i vlerësimit të aktiveve (katër prej anëtarëve, nga pesë të caktuar në urdhër), me shkresën nr.21428/14, datë 20.05.2020, kanë informuar Titullarin znj. D. I. lidhur me përfundimin e procesit të vlerësimit të aktiveve. Në këtë raport komisioni evidenton se ky proces është i kryer me një anëtar komisioni mangët, për shkak të mos pjesëmarrjes në këtë proces të znj. A. S., për arsye objektive. Raporti i hartuar nga katër anëtarë komisioni, nga pesë të caktuar në urdhër, është raport përfundimtar i këtij komisioni, por që duhet të ishte i konfirmuar nga pesë anëtarë dhe jo nga katër, ashtu si ka dalë edhe urdhri. Shkak i hartimit të raportit të vlerësimit të aktiveve nga katër persona, është mos zëvendësimin e njërit prej anëtarëve të komisionit nga Titullari.
Titullari i Institucionit znj. D. I. nuk ka monitoruar si duhet procesin e vlerësimit të aktiveve nga komisioni, pasi nuk ka zëvendësuar znj. A. S. nga komisioni i vlerësimit, në kundërshtim me pikën nr.96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, ku thuhet: ñ*Procesi i vlerësimit te aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit...Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit".*
- Urdhri për vlerësimin e aktiveve përfshin vetëm vlerësimin e vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (përmbajtja e titullit të urdhrit: ñPër ngritjen e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeveò) dhe nuk përfshin aktive të tjera jashtë magazinave (aktivet që kanë në përdorim punonjësit). Duke marrë në konsideratë se sipas pikës nr.102 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, lista e aktiveve që do të vlerësohen hartohet nga Nëpunësi Zbatues, mbështetur në vlerësimin paraprak të gjendjes faktike të aktiveve të raportuar nga komisioni i inventarizimit**,** normave të amortizimit, afatit te skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, informacionit zyrtar te marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë te njësisë, përgjegjësia e mësipërme për mos përfshirjen në listën e vlerësimit, të aktiveve që janë në përdorim të punonjësve është përgjegjësi e Nëpunësit Zbatues znj. D. C.
Kriteri pikën nr.96 dhe 102 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi: Mos kryerja e plotë e vlerësimit të të gjitha aktiveve, nuk jep mundësinë e marrjes së masave në kohën e duhur për riparimin, zëvendësim etj., të aktiveve, duke rritur rriskun e dëmtimit të mëtejshëm të atyre.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi për çështjen e vlerësimit të aktiveve.
Rëndësia: E lartë

Hartimi i pasqyrave financiare

Evidentimi i veprimtarisë financiare, mbajtja e kontabilitetit dhe konsolidimi i llogarisë vjetore, realizohet në 15 njësitë e sistemit tatimor ,14 Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku administrimi i llogarive të shpenzimeve administrative të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është detyrë funksionale e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Pasqyrat Financiare të Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në degën e thesarit Tiranë me shkresën nr. 5983, datë 30.03.2021, në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat ë përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshmeò.

Pasqyrat financiare të aparatit të DPT, si dhe pasqyrat e konsoliduar përmbajnë formatet e mëposhtme:

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 6 - Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Formati 8 - Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Bashkangjitur pasqyrave të mësipërme të aparatit të DPT, janë kartelat e llogarive.

Për sa më sipër në pasqyrat financiare vjetore të aparatit dhe të konsoliduara, mungon formati nr.5 ï ñShënimet shpjegueseò, e cila përmban pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, në kundërshtim me pikën 25 dhe 26 dhe 84 të udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, i cili përcakton se ky format është pjesë e pasqyrave financiare vjetore. Në pikën 84 thuhet:

Dhënia e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme bëhet sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të emërtuar: "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore", i cili përbëhet nga 19 pyetje, që mbulojnë elemente të ndryshme të raportimit financiar të njësive

Pasqyrat financiare të konsoliduar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe degën e thesarit Tiranë me shkresën nr.9525, datë 28.05.2020, jo në përputhje me pikën 120 të Udhëzimit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat ë përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshmeò, i cili përcakton se këto pasqyra duhet të përfundojë brenda muajit prill të vitit pasardhës.

Pasqyrat financiare të aparatit dhe të konsoliduara të DPT janë të firmosura nga nëpunësi zbatues, por jo nga nëpunësi autorizues (përgjegjësi e këtij të fundit), në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 09.03.2018, aneksi nr.2 -Formatet e pasqyrave financiare dhe statistikore vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare, në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, paraqitja e shtesave apo përmirësimeve të kryera gjatë vitit në aktivin e duhur.

Gjendja e llogarive të aktiveve të Aparatit të DPT-së, për vitin 2020, krahasuar me vitin paraardhës 2019, si dhe ndryshimet në vlerë midis dy viteve (2020-2019), paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2020	Ushtrimi Paraardhës 2019	Diferenca 2020-2019
A	**A K T I V E T**	**3,120,623,621**	**2,130,942,097**	989,681,524
	I. Aktivet Afat shkurtra	**1,716,276,925**	**799,485,801**	916,791,124
	1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	**11,196,327**	**11,196,327**	0
520	Disponibilitete në Thesar	11,196,327	11,196,327	0
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**57,842,631**	**61,923,192**	-4,080,561
31	Materiale	52,209,984	59,480,012	-7,270,028
32	Inventar i imët	75,238	75,953	-715
35	Mallra	5,557,409	2,367,207	3,190,202
	3.Llogari të Arkëtushme	**146,617,084**	**321,725,032**	-175,107,948
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	769,485	769,485	0
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	145,847,599	320,995,547	-175,147,948
4	**4. Të tjera aktive afatshkurtra**	**1,500,620,883**	**404,641,249**	1,095,979,634
486	Shpenzime për periudhat e ardhshme	1,500,620,883	404,641,279	1,095,979,604
	II.Aktivet Afatgjata	**1,404,346,696**	**1,331,456,296**	72,890,400
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**30,707,600**	**0**	30,707,600
202	Studime dhe kërkime	30,707,600	0	30,707,600
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**1,248,592,273**	**612,824,929**	635,767,344
212	Ndërtesa e Konstruksione	112,970,971	118,916,811	-5,945,840
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,004,075,118	353,474,396	650,600,722
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	82,975,312	59,262,245	23,713,067
215	Mjete Transporti	16,006,836	45,967,716	-29,960,880
218	Inventar ekonomik	32,564,036	35,203,762	-2,639,726
	4.Investime	**125,046,823**	**718,631, 367**	-593,584,544
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		24,457,600	-24,457,600
231	Për Aktive Afatgjata materiale	125,046,823	694,173,767	-569,126,944

Burimi: DPT, Bilanci i Aparatit.

Bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të Aparatit të DPT, për vitin 2020, totali i aktivit ka vlerën 3,120,623,621 lekë, e cila përbëhet nga vlera e aktiveve afatshkurtra prej 1,716,276,925 lekë, ose 55% të totalit të aktiveve, si dhe vlera e aktiveve afatgjata prej 1,404,346,696 lekë, ose në masën 45% të totalit të aktiveve.

Krahasuar me vitin 2019 aktivet kanë një rritje prej 989,681,524 lekë, e cila përbëhet nga rritja e aktiveve afatshkurtra në vlerën 916,791,124 lekë, ose në masën 93% të totalit të rritjes vjetore, si dhe nga rritja e aktiveve afatgjata në vlerën 72,890,400 lekë, ose në masën 7% të totalit të rritjes vjetore.

Në vlerën e mësipërme të aktiveve përfshihet edhe vlera prej 1,500,620,883 lekë e llogarisë 486-Shpenzime për periudhat e ardhshme.

Sipas pasqyrës së formatit nr.7/a -Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në vlerë bruto aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale (pa përfshirë vlerën e investimeve llog. 230 dhe 231), në datën 31.12.2019 kanë vlerën 1,141,156,546 lekë, ndërsa më 31.12.2020 kanë vlerën 1,908,988,886 lekë. Pra gjatë vitit 2020 këto aktive janë rritur në vlerë bruto prej 767,832,340 lekë, e cila ka ardhur si rezultat shtesave prej 997,647,117 lekë (blerje e krijuar me pagesë në vlerën 984,642,460 lekë dhe shtesa pa pagesë jashtë sistemit në vlerën 13,004,657 lekë), si dhe pikësimeve prej 229,814,777 lekë, me emërtimin pakësime të tjera. Nuk ka dalje jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2020.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale në vlerën e kostos historike për vitin ushtrimor 2020:

Nr. rendor	Nr. llog		Çelje e vitit ushtrimor	Shtesa gjatë vititi	Paksimet gjate vitit	Teprica ne Fund
1	**20**	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**24,457,600**	**6,250,000**	**0**	**30,707,600**
3	202	Studime dhe kerkime	24,457,600	6,250,000		30,707,600
5	**21- 28**	**II. AAGJ/ MATERIALE**	**1,116,698,946**	**991,397,117**	**229,814,777**	**1,878,281,286**

8	212	Ndertime e Konstruksione	144,572,338			144,572,338
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	544,032,195	942,826,944	213,793,880	1,273,065,259
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	166,522,530	35,565,516		202,088,046
11	215	Mjete transporti	101,589,848	5,102,269	10,204,538	96,487,579
14	218	Inventar ekonomik	159,982,035	7,902,388	5,816,359	162,068,064
17		**T O T A L I (I + II)**	**1,141,156,546**	**997,647,117**	**229,814,777**	**1,908,988,886**

Burimi: DPT, Bilanci i Aparatit.

Sipas pasqyrës së formatit nr.7/b, në vlerë neto, aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale më 31.12.2019 kanë vlerën 637,282,532 lekë, ndërsa më 31.12.2020 kjo vlerë është 1,279,299,873 lekë. Pra gjatë vitit 2020 këto aktive janë rritur në vlerë neto 642,017,341 lekë.
Nga të dhënat e ñPasqyrës së pozicionit financiar -Formati 1ò, aktivet afatgjata materiale kanë vlerën neto 1,248,592,273 lekë dhe përbëhen nga: llogaria 212 -Ndërtesa e Konstruksione, llogaria 213 -Rruge, rrjete, vepra ujore, llogaria 214 -Instalime teknike, makineri e pajisje, llogaria 215 -Mjete Transporti, llogaria 218 -Inventar ekonomik.
Vlera neto prej 1,248,592,273 lekë në fund të vitit 2020, përfaqëson diferencën midis vlerës së kostos historike prej 1,878,281,286 lekë dhe amortizimit të akumuluar prej 629,689,012 lekë.

Llogaria 202 -Studime dhe kërkime. Bazuar në ñPasqyrën e pozicionit financiar-Formati 1ò, kjo llogari në datën 31.12.2020 ka vlerën neto 30,707,600 lekë dhe përfaqëson shpenzime për trajnime në zbatim të ligjit nr. 1/2015, datë 29.01.2015 ñPër ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen në programin e unionit ñFiscalis 2020ò.
Vlera neto e kësaj llogarie në ñPasqyrën e pozicionit financiar-Formati 1ò, rakordon me vlerën neto të pasqyrës Formati nr.7/b -Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto). Sipas pasqyrës Formati nr.7/b, krahasuar me vitin 2019 kjo llogari është rritur me vlerën 6,250,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e kësaj marrëveshje për vitin 2020 (*Në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, shumat për të cilat DPT ka detyrimin renditen si vijon: 25,000 euro për vitin 2015; 30,000 euro për vitin 2016; 35,000 euro për vitin 2017; 40,000 euro për vitin 2018; 45,000 euro për vitin 2019; 50,000 euro për vitin 2020)*.
Sipas Aneksit Statistikor Formati nr.7/a ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)ò dhe Aneksit Statistikor Formati nr.7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)ò, llogaria 202 ñStudime dhe kërkimeò është çelur në fillim të vitit 2020 me vlerë të kostos historike prej 24,457,600 lekë, vlerë e cila nuk rezulton të jetë paraqitur në llogarinë 202 të ñPasqyrën e pozicionit financiar -Formati 1ò, në kolonën ku pasqyrohen vlerat e ushtrimit paraardhës, por në llogarinë 230.

- ✓ **Llogaria 212 "Ndërtime dhe konstruksione"**. Bazuar në Formatin nr.7/a ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)ò, vlera e kostos historike për këtë llogari, si në çelje dhe në fund të vitit 2020 ka të njëjtën vlerë prej 144,572,338 lekë, e cila tregon se nuk ka pasur shtesa apo pakësim gjatë vitit 2020.Kjo vlerë rakordon me vlerën e raportuar nga komisioni i inventarizimit të aktiveve të vitit 2020. Kjo llogari përfaqëson vlerën e ndërtesës së Aparatit të DPT. Vlera neto është 112,970,971 lekë, e cila është rezultat i diferencës së vlerës bruto dhe vlerës së amortizimit prej 31,601,366 lekë. Norma e amortizimit të aplikuar 5% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò.
- ✓ **Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore**ò, në fund të vitit 2020, sipas ñPasqyrës së pozicionit financiar -Formati 1ò, ka vlerën neto 1,004,075,118 lekë, e cila rakordon me vlerën neto të pasqyrës ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto), Formati 7/b. Kjo llogari përfaqëson vlerën e programe, sofwte, licenca informatike së Aparatit të DPT-së.

Në vlerë neto kjo llogari, krahasuar me vitin 2019 është rritur me vlerën 650,600,722 lekë. Sipas Formatit 7/a ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)ò, kjo llogari në vlerë bruto, krahasuar me vitin 2019 është rritur me vlerën 729,033,064 lekë dhe ka këto të dhëna: çelje të vitit 2020 vlera 544,032,195 lekë, shtesa me emërtimin ñBlerje e krijuar me pagesëò në vlerën 942,826,944 lekë, pakësim në vlerën 213,793,880 lekë, gjendja në fund të vitit 2020 në vlerën 1,273,065,259 lekë. Vlera e amortizimit të akumuluar për këtë llogari është 268,990,141 lekë.

Vlera 213,793,880 lekë, për pakësim, përfaqëson daljet e aktiveve nga DPT te AKSHI

Për ñBlerje e krijuar me pagesëò në vlerën 942,826,944 lekë u paraqit kartela e llogarive me këtë vlerë. Sipas kontratës nr.6756, datë 27.11.2018 ``Përmirësimi i modulit te menaxhimit te kontrollit``, në nenin 3 vlera e kontratës është përcaktuar 2,238,184,687 leke, ndërsa në nenin 4 kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj mirëmbajtje. Vlera e investimit dhe vlera e mirëmbajtjes është parashikuar e ndarë si vijon: Investimi: për vitin 2018 vlera 170,025,887 leke, për vitin 2019 vlera 840,790,000 leke, për vitin 2020 vlera 716,976,113 leke. Mirëmbajtja: viti 2020 vlera 64,500,000 leke, viti 2021 vlera 258,000,000 leke dhe viti 2022 vlera 187,892,687 leke.

Për aktivet e llogarisë 213 është aplikuar norma e amortizimit 25%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

- ✓ **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"**, në fund të vitit 2020 sipas ñPasqyrës së pozicionit financiar -Formati 1ò, ka vlerën neto 82,975,312 lekë, e cila rakordon me vlerën neto të pasqyrës ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)ò, Formati 7/b. Kjo llogari përfaqëson vlerën për moto gjeneratorë, server, HP storage, hardware, kondicionerë, etj. informatike të Aparatit të DPT.

Në vlerë neto kjo llogari, krahasuar me vitin 2019 është rritur me vlerën 23,713,068 lekë. Sipas formatit 7/a ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)ò, kjo llogari në vlerë bruto, krahasuar me vitin 2019 është rritur me vlerën 35,565,516 lekë dhe ka këto të dhëna: çelje të vitit 2020 vlera 166,522,530 lekë, shtesa me emërtimin ñBlerje e krijuar me pagesëò në vlerën 35,565,516 lekë, e cila përfaqëson pagesa për sistemin ñVOIPò, sipas kontratës nr.7047, datë 28.12.2020 ``*Krijimi i një mjedisi të ri dhome serverash (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i qendërzuar për DRT/DPT (Faza 2)*ò . Neni 2 vlera e kontratës investim 90,708,000 (implementimi) dhe 35,640,000 mirëmbajtje për 24 muaj. Vlera e paguar për vitin 2020 implementim, pra investim, është 35.565.516 lekë (procedurë e zhvilluar nga AKSHI).

Gjendja në fund të vitit 2020 në vlerën bruto 202,088,046 lekë. Vlera e amortizimit të akumuluar për këtë llogari është 119,112,734 lekë.

Për aktivet e llogarisë 214 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

- ✓ **Llogaria 215 "Mjete transporti"**, në fund të vitit 2020 sipas ñPasqyrë së pozicionit financat -Formati 1ò, ka vlerën neto 16,006,836 lekë, e cila rakordon me vlerën neto të pasqyrës ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto), Formati 7/b. Kjo llogari përfaqëson vlerën e mjeteve të transportit të aparatit të DPT.

Gjendja në fund të vitit 2020 në vlerën bruto 96,487,579 lekë.

Vlera e amortizimit të akumuluar për këtë llogari është 80,480,743 lekë.

Në vlerë neto kjo llogari, krahasuar me vitin 2019 është zvogëluar me vlerën 29,960,880 lekë. Sipas formatit 7/a ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)ò kjo llogari në vlerë bruto, krahasuar me vitin 2019 është zvogëluar me vlerën 5,102,269 lekë dhe ka këto të dhëna: çelje të vitit 2020 vlera 101,589,848 lekë, shtesa me emërtimin ñShtesa pa pagesë jashtë sistemitò në vlerën 5,102,269 lekë, ñpakësim të tjeraò, në vlerën 10,204,538 lekë.

Shtesat në vlerën 5,102,269 lekë, vijnë si rezultat i kalimit të një mjeti nga DRT Tiranë në DPT, me fletë hyrjen nr.60, date 19.5.2020. Pakësim në vlerën 10,204,538 lekë, vijnë si

rezultat i kalimit të një mjeti nga DPT në DRT Tiranë, sipas procesverbali date 13.05.2020, si dhe kalimit të një mjeti tjetër nga DPT në Kryeministri, nëpërmjet shkresës nr. 2944/3, date 23.06.2020.

Për aktivet e llogarisë 215 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018

- ✓ **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"**, sipas ñPasqyrës së pozicionit financiar -Formati 1ò, në fund të vitit 2020 ka vlerën neto 32,564,036 lekë, e cila rakordon me vlerën neto të pasqyrës ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto), Formati 7/b.

Në vlerë neto kjo llogari, krahasuar me vitin 2019 është zvogëluar me vlerën 2,639,727 lekë.

Sipas formatit 7/a ñGjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)ò kjo llogari **në vlerë bruto**, krahasuar me vitin 2019 është rritur me vlerën 2,086,029 lekë dhe ka këto të dhëna: çelje të vitit 2020 vlera 159,982,035 lekë, shtesa me emërtimin ñShtesa pa pagesë jashtë sistemitò në vlerën 7,902,388 lekë, të cilat përfaqësojnë 163 Tableta Lenovo dhe një kompjuter desktop, të cilat janë bërë kalim nga drejtoritë rajonale në DPT, nëpërmjet 14 fletë hyrjeve.

Në këtë llogari ka pakësime me emërtimin ñPaksime të tjeraò, në vlerën 5,816,359 lekë, të cilat përfaqësojnë printer, kompjuter, Tableta Lenovo të cilat janë bërë dalje nëpërmjet 11 fletëdaljeve nga DPT në drejtoritë rajonale.

Gjendja në fund të vitit 2020 në vlerën bruto 162,068,064 lekë. Vlera e amortizimit të akumuluar për këtë llogari është 129,504,028 lekë.

Për aktivet e llogarisë 218 është aplikuar norma e amortizimit 20%, në përputhje me pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Për diferencat e mësipërme është bërë trajtimi më lart në procesin e inventarizimit të aktiveve.

- ✓ Llogaria 327 ñInventar i imëtò në pasqyrat financiare ka vlerën 75,238 lekë, e cila nuk rakordon me vlerën prej 66,973 lekë të raportuar nga komisioni i inventarizimit (raportuar 8,265 lekë më shumë në pasqyrat financiare.
- ✓ Për llogarinë 312 komisioni nuk është shprehur, pasi si shpjegohet dhe më lartë nuk ka bërë ndarje të aktiveve të magazinave.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) për DPT (Aparati)

Nr. Rrjeshti	Nr. Reference Llogarije	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	**20**	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**24,457,600**	**0**	**24,457,600**	**6,250,000**	**0**	**0**	**0**	**30,707,600**	**0**	**30,707,600**
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kërkime	24,457,600	0	24,457,600	6,250,000				30,707,600	0	30,707,600
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	**21- 28**	**II. AAGJ/ MATERIALE**	**1,116,698,946**	**503,874,015**	**612,824,932**	**991,397,117**	**141,545,076**	**229,814,777**	**15,730,079**	**1,878,281,286**	**629,689,012**	**1,248,592,273**
6	210	Toka,troje,Terene			0					0	0	0
7	211	Pyje,Kullota Plantacione			0					0	0	0
8	212	Ndërtime e Konstruksione	144,572,338	25,655,526	118,916,812		5,945,840			144,572,338	31,601,366	112,970,971
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	544,032,195	190,557,799	353,474,396	942,826,944	78,432,342	213,793,880		1,273,065,259	268,990,141	1,004,075,118
10	214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune	166,522,530	107,260,285	59,262,245	35,565,516	11,852,449			202,088,046	119,112,734	82,975,312
11	215	Mjete transporti	101,589,848	55,622,132	45,967,716	5,102,269	35,063,149	10,204,538	10,204,538	96,487,579	80,480,743	16,006,836
12	216	Rezerva shtetërore	0	0	0	0				0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0		0		0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	159,982,035	124,778,273	35,203,763	7,902,388	10,251,296	5,816,359	5,525,541	162,068,064	129,504,028	32,564,036
15	24	Aktive te Qend.te trupëzuara te dëmtuara	0		0					0	0	0
16	28	Caktime	0		0					0	0	0
17		**T O T A L I (I + II)**	**1,141,156,546**	**503,874,015**	**637,282,532**	**997,647,117**	**141,545,076**	**229,814,777**	**15,730,079**	**1,908,988,886**	**629,689,012**	**1,279,299,873**

Aktivet Afatgjata të pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar

Aktiveve Afatgjata në fund të vitit 2020 paraqiten në vlerën 2,049,256,954, kundrejt vlerës 2,026,180,548 lekë në vitin 2019 dhe përbëhen nga aktivet afatgjata jo materiale në vlerën 30,707,600 lekë, aktivet afatgjata materiale në vlerën 1,893,502,531lekë, investimet në vlerën 125,046,823 lekë. Krahasuar me vitin 2019, aktivet afatgjata janë rritur në vlerën 23,076,406 lekë.

-Gjendja e llogari aktivet afatgjata jo materiale paraqiten në vlerën 30,707,600 lekën dhe përbëhet nga Llogaria 202 ñStudime e Kërkimeò e cila përbëhet vetëm nga vlera e pasqyrave financiare të DPT, përshkruar më lart.

-Aktivet Afatgjata materiale paraqiten në vlerën 1,893,502,531 lekë, krahasuar me vitin 2019 janë rritur në vlerën 585,953,350 lekë. Aktivet afatgjata materiale përbëhen nga llogaria 210 - Toka, Troje, Tereneòò, në vlerën 16,194,396 lekë, llogaria 212 -ñNdërtesa e konstruksioneò në vlerën 583,677,730 lekë, llogaria 213 -ñInstalime dhe Rrjeteò në vlerën 1,004,117,569 lekë (rrjetet dhe sistemet TIK), llogaria 214 -ñInstalime teknike, makineri e pajisjeò në vlerën 101,045,195 lekë, llogaria 215 -ñMjete transportiò në vlerën 72,500,578 lekë, llogaria 218 - ñInventar Ekonomikò në vlerën 115,048,659 lekë, ñAktive Afatgjata të Dëmtuaraò në shumën 918,404 lekë.

-ñInvestimetò paraqiten në vlerën 125,046,823lekë dhe përbëhen nga llogaria 231 ñAktive afatgjata materialeò.

Pesha specifike e aktiveve afatgjata materiale të aparatit të DPT-së zë rreth 66 % të aktiveve të qëndrueshme të pasqyrave të konsoliduar. Tabela në vijim paraqet aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale të aparatit të DPT-së, si dhe peshën specifike që zë secili zë i aktiveve të aparatit te aktivet e konsoliduar të DPT.

Në lekë

Nr.	E M E R T I M I	I Konsoliduar	Aparati	Pesha
	I. Aktive Afatgjata jo Materiale	**30,707,600**	**30,707,600**	100
202	Studime dhe kërkime	30,707,600	30,707,600	100
	II. Aktive Afatgjata Materiale	**1,893,502,531**	**1,248,592,273**	66
210	Toka, troje, terene	16,194,396	0	-
212	Ndërtime e Konstruksione	583,677,730	112,970,971	19
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,004,117,569	1,004,075,118	100
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla	101,045,195	82,975,312	82
215	Mjete transporti	72,500,578	16,006,836	22
218	Inventar ekonomik	115,048,659	32,564,036	28
24	Aktive te Qend.te trupëzuara te demtuara	918,404	0	-
	III. Investime	**125,046,823**	**125,046,823**	100
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	125,046,823	125,046,823	100
T O T A L I (I + II+III)		2,049,256,954	**1,404,346,696**	69

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Për aktivet është llogaritur amortizimi në përputhje me normat e përcaktuara në pikën nr.36, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018.

Vlera e llogarisë 20 e Pasqyrës 7/b kuadron me vlerën e llogarisë 20 të pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu totali i llogarive 20-28 i pasqyruar në pasqyrën 7/b kuadron me vlerën totalë të llogarive 20-28 të pasqyrës së pozicionit financiar.

Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare në zërin "Të drejta të arkëtueshme" analizuar sipas llojit të tatimit. Testimi i të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyrave financiare.

Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës bazuar ne raportet e fund vitit ne sistemin C@TS harton pasqyrat financiare të të ardhurave të DPT dhe i dërgon për procedure te mëtejshme në

Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në DPT, si përfaqësuese e njësisë shpenzuese ne Degën e Thesarit Tirane për depozitimin e pasqyrave financiare te DPT.
Për vitin 2020 Bilanci i është dërguar DR Buxhetit dhe Financës me shkrese nr. 4667 prot., datë 11.03.2021, ndërsa bilanci i konsoliduar është dërguar me shkresën 7765 prot, datë 28.04.2020.
Rubrika "Llogaritë e Arkëtueshmeò e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT, paraqiten në shumën **233,779,789,633** lekë. Krahasuar me vitin 2019, llogari e cila ka vlerën 223,113,209,932, llogaritë e arkëtueshme janë rritur me vlerën 10,666,494,629 lekë, ose në masën 5% dhe përbëhen nga:
a-Llogaria 423, 429 "Detyrime të personelit për paradhënie e gjoba" në shumën 805,141 lekë (nga 804,841 lekë në vitin 019), e cila zë një peshë shumë të vogël në totalin e Aktiveve Afatshkurta. Në bilancin e aparatit të DPT kjo vlerë është 769,485 lekë.
b-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në shumën 132,891,465,891 lekë ose 57% e totalit të Aktiveve Afatshkurtra. Kjo llogari pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera, brenda dhe jashtë sistemit C@TS.
c- Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në shumën 100,887,518,601 lekë ose 43% e totalit të Aktiveve Afatshkurta, e cila përfaqëson dhe rakordon me llogaritë kundër parti të pasivit si më poshtë:
- Llogaria 401-408 Furnitorë e llogari te lidhura me to në vlerën 122,640,727 lekë; - Llogaria 421 Detyrime ndaj personelit në vlerën 16,076,626 lekë, -Llogaria 431 Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa në vlerën 1,631,865 lekë, - Llogaria 435 Detyrime për sigurime shoqërorenë vlerën 4,824,738 lekë, -Llogaria 436 Detyrime për sigurime shëndetësore në vlerën 673,643 lekë.
Në krahasim me vitin 2019 kjo llogari **(4342)** është ulur në vlerën 1,432,775,312 lekë, ose në masën 1.4%.
Rubrika "Të tjera aktive afatshkurtraò e pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar të DPT, ka vlerën 1,500,687,133 lekë dhe përbëhet vetëm nga **Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme",** e cila pasqyron shpenzimet që do të kryhen në periudhat pasardhëse. Kjo llogari (486) përbëhet nga vlera 1,500,620,883 lekë e pasqyruara në llogarinë 486 të pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-s dhe vlera 66,250 nga DRT.
Krahasuar me vitin 2018 (në të cilin kjo llogari ka vlerën 404,641,249 lekë), llogaria 486 është rritur për vlerën 1,095,979,634 lekë.

<u>Analiza e llogarisë 468 "Debitorë te ndryshëm"</u>

- Në pasqyrat financiare të Aparatit të DPT llogaria 468 ñDebitorë te ndryshëmò ka vlerën 0 (zero) lekë.

- Në pasqyrat financiare të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës llogaria 468 ñDebitorë te ndryshëmò ka vlerën 130,052,687,446 lekë, e cila përbëhet nga vlera 130,050,975,504 leke që përfaqëson situatën debitorë gjendje me 31.12.2020 për DPT (**situate ne sistemin C@TS** gjendje me 31.12.2020) dhe vlera 1,711,942 leke, e cila i përket Aparatit të DPT . Në këto pasqyra llogaria 468 kuadron me llog 4341 ñOperacione me shtetin -Detyrimeò (Tatime & Aparati).
Për verën 1,711,942 leke nga drejtoria e Financës u dha shpjegimi i mëposhtëm:
Debitorë të mbartur vitit 2018 si çelje fillestare detyrim i mbartur 2.226.825 lekë. Realizuar sistemim shpenzimi 4341 në vlerën 6.480 lekë furnitorë, detyrim i ish punonjësve të administratës tatimore :1. J. Sh. në vlerën 35.340 lekë, Xh. L. si detyrim nga Shkresë MFE 1336/2, datë 24.07.2019 në vlerën 420.500 lekë, paguar më shumë për vulë në vlerën 3.600 lekë ku vula nuk u konkretizua dhe vlera u kthye në buxhet, paguar më shumë detyrim 82.555 lekë. Vlera e mbetur në vitin 2019 në masën 1.711.942 lekë përbëhet nga ish punonjës dhe debitorë të vjetër të mbartur ndër vite *: B. R. 22.500 lekë, H. D. 101.986 lekë, F. P. 900 lekë,*

K. M. 12.480 lekë, P. Rr. 20.819, S. Sh. 900 lekë, Llogari mbetur në banke 900 lekë, debitore të tjerë 781.972 lekë.

- Në pasqyrat financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò, e cila pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera **brenda dhe jashtë sistemit C@TS**, ka vlerën 132,860,793,956 nga të cilat detyrimet e pasqyruara në sistemin C@TS janë në vlerën 130,050,975,504 lekë ndërsa detyrimet e kontabilizuara por të mbajtura jashtë sistemit C@TS janë në vlerën 2,809,818,452 lekë.

(Sqarojmë se në bilancin konsoliduar të DKS **për DRT Tiranë është e përfshirë vlera debitorë 2,265,440,526 lekë për DRT Tiranë, por jo** vlera prej 30,052,621 lekë e paraqitur në llogarinë 468 të bilancit të kësaj DRT, si dhe është e përfshirë vlera debitore 20,477,003 lekë për DRT Shkodër, por jo vlera 619,314 prej lekë, e paraqitur në llogarinë 468 të bilancit të DRT Shkodër)

Situata debitor gjendje me 31.12.2020 në vlerën 132,860,793,956 lekë është e kuadruar me analizën e llogarisë 468 sipas tatimit (tabela në vijim).

Në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT, llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò, ka vlerën 132,891,465,891 lekë, në të cilën përfshihet vlera e pasqyrave të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës (DKS) prej 132,860,793,956 lekë, si dhe llogaria 468 e DRT Tiranë në vlerën 30,052,621 lekë dhe llogaria 468 e DRT Shkodër në vlerën 619,314 lekë, vlera të pa përfshira në pasqyrat e konsoliduara të DKS.

Vlera e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, përbënë 57% e totalit të aktiveve afatshkurtra.

Sipas të dhënave të bilancit vlera e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò në 31.12.2020 ka një rritje prej 12,099,354,713 lekë më shumë se në vitin 2019, ose në masën 10% (më 31.12.2019 ka qenë 120,792,111,178 lekë).

Detyrimet që i përkasin vetëm vitit buxhetor 2020 në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, kanë pësuar ulje krahasuar me vitin 2019, pasi kjo vlerë për vitin.2020 është 19,674,353,380 lekë, ndërsa në 31.12.2019, pjesa që i përket vetëm vitit 2019 ka vlerën 23,242,426,041 lekë.

Peshën me të madhe të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, e zë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 46,856,261,351 lekë, tatimi mbi fitimin në vlerën 34,523,246,139 lekë, taksa e rrugës në vlerën 11,302,323,936 lekë, sigurime shoqërore e shëndetësore në vlerën 16,738,426,486 lekë. Në vijim paraqitet gjenda e debitorëve për vitin 2020 dhe vitit 2019 sipas llojit dhe periudhës së krijimit të tyre.

Përbërja e llogarisë 468 sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës paraqitet në tabelën në vijim:

Në lekë

Nr Llogarisë	Emërtimi	Detyrime gjendje me 31.12.2019	Detyrime gjendje me 31.12.2020	Detyrime gjendje me 31.12.2020 te cilat i përkasin vitit 2020	Detyrime gjendje me 31.12.2020, te cilat janë para vitit 2020
7,000	- Tatim mbi te ardhurat personale	2,030,518,264	2,106,358,390	302,157,574	1,804,200,816
7,001	- Tatim mbi fitimin	29,795,110,533	34,523,246,139	6,284,021,540	28,239,224,599
7,002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogel	2,810,854,674	2,968,379,504	229,320,852	2,739,058,652
7,009	- Tjera tatime	4,581,549,664	4,960,921,676	691,432,380	4,269,489,296
7,030	- Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	41,408,278,969	46,856,261,351	7,438,765,485	39,417,495,866
7,031	- Akciza	2,107,792,556	2,107,792,556	-	2,107,792,556
7,032	- Takse mbi sherbimet specifike(Lojra fati)	3,473,100,133	3,476,805,289	41,299,782	3,435,505,507
7,033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie	272,695,972	342,485,103	92,377,740	250,107,363
7,050	- Taksa e rruges	11,854,687,533	11,302,323,936	40,583,045	11,261,740,891
7,110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	26,392,485	21,789,526	1,303,025	20,486,501
7,115	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e	6,930,720,719	7,071,555,472	314,706,161	6,756,849,311

75	**Sigurime shoqerore e shendetsore**	**15,130,177,162**	**16,738,426,486**	**4,015,842,741**	**12,722,583,745**
	Sigurime shoqerore	**13,644,350,073**	**14,990,720,673**	**3,405,734,710**	**11,584,985,963**
75,021	Kontribute shoqerore te punesuar (punemarres)	8,032,043,413	8,234,901,820	923,387,933	7,311,513,887
75,121	Kontribute shoqerore punedhenes	5,612,306,660	6,755,818,853	2,482,346,777	4,273,472,076
	Sigurime shendetsore	**1,485,827,089**	**1,747,705,813**	**610,108,031**	**1,137,597,782**
75,122	Kontribute shëndetsore te punesuar (punemarres)	679,540,619	805,835,816	297,392,837	508,442,979
75,022	Kontribute shëndetsore punedhenes	806,286,470	941,869,997	312,715,194	629,154,803
	Detyrime per te tjera kontribute	-	-	-	-
	Te tjera	60,562,530	60,562,530	-	60,562,530
	Shtypshkrime	1,125,267	1,144,725	463,495	681,230
	1 % Grante	795,254	1,273,976	956,759	317,217
	Pulla (me çmim blerjeje)	307,749,738	321,467,298	221,122,801	100,344,497
	Totali sipas bilancit të konsoliduar të DKS	**120,792,111,452**	**132,860,793,956**	**19,674,353,380**	**113,186,440,576**
	Vlera e llog 468 për DRT Tiranë		30,052,621	30,052,621	
	Vlera e llog 468 për DRT Skodër		619,314	619,314	
	Totali sipas bilancit të konsoliduar të DPT		132,891,465,891		

Pretendim i subjektit të audituar*: Nga znj. M. S., me detyrë Drejtore e Kontabilitetit dhe statistikës, është bërë observacion, protokolluar në KLSH me nr. 513/11, datë 23.08.2021, në të cilën shkurtimisht thuhet:Kontabiliteti në DPT harton pasqyrat financiare të konsoliduara për të ardhurat tatimore për DPT dhe DRT. Pasqyrat financiare të DRT Tiranë dhe Shkodër të cilat kanë ardhur në Drejtorinë e Kontabilitetit, nuk përmbajnë vlera të detyrimeve për llogarinë 468 si përshkruhet në akt konstatim, si dhe nuk kemi asnjë konstatim nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës Këtu në DPT për këtë vlerë, të cilat janë përfshirë nga kjo drejtori në pasqyrat financiare të konsoliduara. Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, pasqyrat financiare të konsoliduara që ka dërguar pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës i ka shoqëruar me formatin nr. 5 "shënime shpjeguese dhe plotësuese".*

Qëndrim i grupit të auditimit: *Sipas pasqyrave financiare të dorëzuar nga DRT Tiranë, protokolluar në DPT me nr. 5709, datë 25.03.2021, konstatohet se llogaria nr. 468 e këtij bilanci të DRT Tiranë ka vlerën 30,052,621 lekë. Nga informacioni që kemi kërkuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, ky detyrim i pasqyruar në pasiv në vlerën 30,052,621 lekë, i përket muajit dhjetor 2020, për llogaritë 401- 408 (furnitorë), llog. 4 paga e muajit dhjetor 2020, si dhe TAP dhe Sigurime për muajin dhjetor 2020. E njëjta situatë është edhe për DRT Shkodër për vlerën përkatëse. Këto detyrime janë paraqitur edhe në aktiv të bilancit në llogarinë 468, por në fakt nuk është kjo llogaria kundërparti e llogarive të pasivit, por llogaria 4352 (të drejta të institucionit ndaj shtetit). Nuk ka efekte reale mbi vlerat që ju keni paraqitur në bilancin e Drejtorisë së Kontabilitetit. Përsa i përket formatit 5, në bilancin e Drejtorisë së Kontabilitetit ky format ekziston.*

Tabela në vijim paraqet gjendjen e detyrimeve me 31.12. 2020 ne DRT, jashtë sistemit C@TS + Sektori shpenzimeve

Në lekë

Nr	Nr llogarise	**Emertimi**	**Detyrime Gjendje me 31.12.2019**	**Detyrime gjendje me 31.12.2020**
1	**7000**	- Tatim mbi te ardhurat personale	58,993,901.00	58,993,901.00
2	**7001**	- Tatim mbi fitimin	2,883,175.00	2,772,290.00
3	**7002**	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	63,750.00	63,750.00
4	**7009**	- Tjera tatime	17,556,858.00	17,556,858.00
5	**7030**	- Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	10,609,113.00	10,609,113.00

6	**7031**	- Akciza	2,107,792,556.00	2,107,792,556.00
7	**7032**	- Takse mbi sherbimet specifike(Lojra	-	-
8	**7033**	- Takse mbi perd.mallrave e lejim	-	-
9	**7050**	- Taksa e rrugës	165,000.00	165,000.00
10	**7110**	- Tarifa administrative dhe rregullatore	-	-
11	**7115**	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e	10,113,513.00	10,113,513.00
12	75	**Sigurime shoqerore e shendetsore**	**217,302,943.00**	**217,302,943.00**
13		**Sigurime shoqerore**	**178,924,414.00**	**178,924,414.00**
14	**75021**	Kontribute shoqerore te punesuar	148,345,324.00	148,345,324.00
15	**75121**	Kontribute shoqerore punëdhënës	30,579,090.00	30,579,090.00
16		**Sigurime shendetsore**	**38,378,529.00**	**38,378,529.00**
17	**75122**	Kontribute shëndetsore te punesuar	34,031,663.00	34,031,663.00
18	**75022**	Kontribute shëndetsore punëdhënës	4,346,866.00	4,346,866.00
19		**Detyrime per te tjera jo tatimore**	**370,232,513**	**384,448,528**
20		Te tjera	60,562,530.00	60,562,530.00
21		Shtypshkrime	1,125,266.50	1,144,724.50
22		1 % Grante	795,253.73	1,273,976.14
23		Pulla (me çmim blerjeje)	307,749,738.00	321,467,297.58
24		**Totali**	**2,795,713,597.23**	**2,809,818,452.22**

Tabela e mëposhtme paraqet totalin e detyrimeve sipas llojit, të paraqitura në sistemin C@TS dhe detyrimet që mbahen jashtë sistemit.

Në lekë

	Nr Llogarise	**Emërtimi**	**Detyrime në sistemin C@TS, 31.12.2020**	**Detyrimet jashtë sistemit C@TS, 31.12.2020**	**Totali i detyrimeve 2020**
1	**7000**	- Tatim mbi te ardhurat personale	2,047,364,489	58,993,901.00	2,106,358,390
2	**7001**	- Tatim mbi fitimin	34,520,473,849	2,772,290.00	34,523,246,139
3	**7002**	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	2,968,315,754	63,750.00	2,968,379,504
4	**7009**	- Tjera tatime	4,943,364,818	17,556,858.00	4,960,921,676
5	**7030**	- Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	46,845,652,238	10,609,113.00	46,856,261,351
6	**7031**	- Akciza	-	2,107,792,556.00	2,107,792,556
7	**7032**	- Takse mbi sherbimet specifike (Lojra fati)	3,476,805,289	-	3,476,805,289
8	**7033**	- Takse mbi perd.mallrave e lejim	342,485,103	-	342,485,103
9	**7050**	- Taksa e rrugës (taksë kombëtare)	11,302,158,936	165,000.00	11,302,323,936
10	**7110**	- Tarifa administrative dhe rregullatore	21,789,526	-	21,789,526
11	**7115**	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e	7,061,441,959	10,113,513.00	7,071,555,472
12	**75**	**Sigurime shoqerore e shendetsore**	**16,521,123,543**	**217,302,943.00**	**16,738,426,486**
13		**Sigurime shoqerore**	**14,811,796,259**	**178,924,414.00**	**14,990,720,673**
14	**75021**	Kontribute shoqerore te punesuar	8,086,556,496	148,345,324.00	8,234,901,820
15	**75121**	Kontribute shoqerore punedhenes	6,725,239,763	30,579,090.00	6,755,818,853
16		**Sigurime shendetsore**	**1,709,327,284**	**38,378,529.00**	**1,747,705,813**
17	**75122**	Kontribute shëndetsore te punesuar	771,804,153	34,031,663.00	805,835,816
18	**75022**	Kontribute shëndetsore punedhenes	937,523,131	4,346,866.00	941,869,997
19		**Detyrime per te tjera kontribute**	-		-
20		Te tjera	-	60,562,530.00	60,562,530
21		Shtypshkrime	-	1,144,724.00	1,144,725
22		1 % Grante	-	1,273,976.00	1,273,976

23		Pulla (me çmim blerjeje)	1.	321,467,297.00	321,467,298
24		**Totali**	**130,050,975,504**	**2,809,818,452.22**	**132,860,793,956**

Titulli i gjetjes: Vlerë e lartë e detyrimeve tatimore jashtë sistemit C@TS.

Situata:

Në datën 31.12.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor jashtë sistemit **C@TS në vlerën** 2,809,818,452 lekë. Sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikëssituata e debitorëve jashtë këtij sistemi është në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo te gjitha deklaratat tatimore ishin te informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin ne ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore.

Pjesën me te madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohej dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,107,792,556 lekë i përket vetëm 2 tatimpaguesve, ñAò sha me Nipt J në vlerën 2,106,993,328 leke, subjekt i cili është në administrim te DRT Tirane dhe subjekti ñIò, me Nipt J, në vlerën 799,228 leke, subjekt i cili është në administrim të DR Tatimpaguesit e Mëdhenj.

Detyrimi për akcizën zë 75 % të totalit te detyrimeve jashtë sistemit C@TS, ndërsa 14 % te detyrimeve jashtë sistemit janë raportim nga Sektori i Shpenzimeve në DRT dhe DPT (aparati) te cilat nuk lidhen me te ardhurat tatimore për rrjedhoje është normale të jenë jasht sistemit C@TS. Vetëm 11% e detyrimeve jashtë sistemit C@TS, në vlerën **317,577,368 lekë** janë për të ardhura tatimore për te cilat Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektoret e kontrollit nga zyra, do të duhet ti hedhin në sistemin C@TS, pasi për këto detyrime ka module përkatëse në sistem, si në vijim:

Tatim mbi te ardhurat shuma 58,993,901 leke
Tatim fitimi shuma 2,772,290 leke
Taksa mbi biznesin e vogël shuma 63,750 leke
Te tjera tatime (ne burim) shuma 17,556,858 leke
Tatim mbi vlerën e shtuar shuma 10,609,113 leke
Taksa e rrugës shuma 165.000 leke
Gjoba dhe kamate vonesa shuma 10,113,513 leke
Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shuma 217,302,943 leke.

Detyrimet jashtë sistemit tatimor për te ardhurat tatimore zënë 1.8 % te totalit te detyrimeve për të ardhura tatimore e kontribute në total. Duke mare ne konsiderate qe detyrimi për Akcizën nuk mund te hidhet ne sistemin C@TS, pasi ky sistem sipas shpjegimeve nga DKS nuk ka te zhvilluar një modul për deklaratën e Akcizës pasi ne kohen kur sistemi i ri tatimor E Tax (janar 2015) është vene ne funksion, kjo e ardhur me ligj ka kaluar për administrim ne DPD qe nga viti 2012, pesha qe zënë këto detyrime është vetëm 0.2 % e totalit.

Kriteri:

Mos arkëtimi i detyrimeve të akcizës në vlerën 2,107,792,556 lekë është në kundërshtim me detyrën funksionale të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve tatimore të pa paguara të ñRregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimoreò, neni 28-36.

Mos hedhja në sistemin sistemin C@TS të vlerës 317,577,368 lekë është në kundërshtim me kapitullin 6, ku përcaktohen detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të ñRregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimoreò.

Ndikimi: Mos arkëtimin detyrimeve ndikon në uljen e të ardhurave, ndërsa mos regjistrimi i detyrimeve të cilat kanë në sistem modulin përkatës, lë jashtë këtij sistemi një pjesë të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi nga strukturat përkatëse të DPT.

Rëndësia: e lartë

Titulli i gjetjes:
Llogaria 486 në bilancin e konsoliduar të DPT nuk pasqyron gjendjen e saktë të shpenzimeve të periudhave të ardhshme.
Situata:
-Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", e cila pasqyron shpenzimet që do të kryhen në periudhat pasardhëse. Kjo llogari përbëhet nga vlera 1,500,620,883 lekë e pasqyruara në llogarinë 486 të pasqyrave financiare të Aparatit të DPT-s dhe vlera 66,250 nga DRT. Përbërja e kësaj llogarie është shpjeguar në llogarinë 467. Konstatohet se DPT nuk ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë stokun e rimbursimit të TVSH-së prej 9.7 miliard lekë dhe nuk e ka pasqyruar këtë vlerë as në llogarinë 486 -Shpenzime të periudhave të ardhshme, por në llogarinë 467. Mos përfshirja e stokun e rimbursimit të TVSH-së prej 9.7 miliard lekë në raportimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e pikës 115 të udhëzimit plotësues të MFE nr.2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të viti 2020ò dhe shtojcën 4 ñDetyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-sëò. Mos kontabilizi i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 -Shpenzime të periudhave të ardhshme, është në kundërshtim me pikës 42 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, ku thuhet se detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve duhet të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare në llogarinë 486 sipas llogarive specifike të kontabilitetit. Për këto anomali ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Financës znj. D. C.
Kriteri: MFE nr.2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të viti 2020ò dhe shtojcën 4 ñDetyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-sëò, Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi: Mos dhënie e informacionit të saktë në pasqyrat financiare për llogarinë 486 dhe në raportimin e detyrimeve të prapambetura.
Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore lidhur me raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe plotësimin në bilanc të llogarisë 486.
Rëndësia: e lartë
Vlerësimi i saktësisë, rregullshmërisë dhe plotësisë së paraqitjes së transaksioneve financiare në zërin "Detyrime ndaj të tretëve" sipas llojit (përfshirë detyrimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe TVSH). Kontabilizimi dhe raportimi i tyre në kuadër të raportimit periodik të detyrimeve të prapambetura në MFE, sipas llojit dhe kohës së krijimit të tyre.
Në bilancin e konsoliduar të DPT, pasivet (detyrimet) kanë vlerën 350,755,295,745 lekë (bilanci i apartit të DPT për këtë llogari ka vlerën 1,658,433,994 lekë).
-Llogaria 401-408 ñFurnitorë dhe llogari të lidhura me toò, në pasqyrat e konsoliduara të DPT ka vlerën 126,931,634 lekë, nga e cila vetëm vlera e aparatit të DPT është 122,640,727 lekë, ndërsa vlera 4,290,907 lekë përbëhet nga detyrimet që kanë DRT.
Në 31.12.209 llogaria 401-408 ka vlerën 287,301,076 lekë, pra gjatë vitit 2020 kjo llogari është ulur me vlerën 160,369,442 lekë, ose në masën 56%.
Përbërja e llogarisë 401-408 për vitin 2020: (vlerat kryesore si më poshtë)
Vlera prej 186,208 lekë, e cila përfaqëson detyrime ndaj shtypshkronjës së letrave me vlerë për pulla taksa dhe tarife për vitin 2020, me datë fature 4.12.2020, vlera prej 56,592,825 lekë e cila përfaqëson detyrim ndaj shtypshkronjës së letrave me vlerë për bileta transporti, fatura me datë 30.12.2020, vlera prej 64,924,831 lekë detyrim ndaj shtypshkronjës së letrave me vlerë për shtypshkrime, fatura datë 31.12.2020 (blloqe TVSh, dëftesa tatimore fatura

shoqërimi, faturë e thjeshtë tatimore), vlera 924,000 e cila përfaqëson detyrim ndaj furnitorit Sh, me fature të datës 28.12.2020, për pajisje teknike për regjistrim.
Gjithashtu në vlerën e mësipërme totale futen edhe detyrime të DRT për energji, telefon, ujë, shërbime postare.
-Llogaria 42 ñDetyrime ndaj personelitò, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 16,076,628 lekë. Kjo llogari përfaqëson detyrimet që institucioni ka ndaj personelit për pagën neto muaji dhjetor 2020
-Llogaria 431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 1,631,865 lekëdhe përfaqëson detyrimet e institucionit për TAP për muaji dhjetor 2020.
-Llogaria 435 ñSigurime shoqëroreò, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 4,824,738 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit për muajin dhjetor 2020.
Vlera e kësaj llogarie për aparatin e DPT është 4,824,738 lekë.
-Llogaria 436 ñSigurime shëndetësoreò në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 673,643 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit për muajin dhjetor 2020.
- Llogaria 44 ñInstitucione të tjera publikeò në bilancin e konsoliduar të DPT ka vlerën 7,913,104 lekë, e cila vjen e gjitha nga bilanci i konsoliduar i Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës dhe përfaqëson detyrime që kanë DRT ndaj njësive vendore për vlerën e tatim fitimit të thjeshtuar, për arkëtimin e të cilit DRT luajnë rolin e agjentit tatimor. Vlera e pa likuiduar prej 7,913,104 lekë përbëhet nga vlera 479,635 lekë e viti 2020 dhe vlera 7,433,469 lekë e vitit 2019.
Shuma prej 7,433,469 leke janë fonde te pa transferuara nga DRT te njësitë vendore te mbetura nga viti 2019
Shuma prej 479,635 leke janë fonde te cilat janë çelur në vitin 2020 dhe më 31.12.2020 rezultojnë te pa transferuara njësive vendore. Të dhëna sipas tabelës në vijim:

Drejtoria Rajonale	Shuma totale	Nga keto mbetur nga 2019	Shtuar gjate
DR Tatimpaguesit e Mëdhenj	1,996,552.00	1,996,552.00	
DRT Tirane	2,938,284.00	2,938,284.00	
DRT Vlore	266,238.00	266,238.00	
DRT Fier	2,712,030.00	2,232,395.00	479,635.00
Shuma	**7,913,104.00**	**7,433,469.00**	**479,635.00**

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 11,196,327 lekë, e cila është e mbartur nga vitet e kaluara dhe nuk ka dokumentacion për të justifikuar historikun e krijimit të saj.

Titulli i gjetjes: Llogaria 466 óKreditorë për mjete në ruajtjeô dhe llogaria 520 óDisponibilitete në thesarônuk paraqesin pamje reale dhe të saktë.
Situata: -Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në pasqyrat e konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës ka vlerën 115,458,699,848 lekë, ndërsa në pasqyrat financiare të pa konsoliduara të DSK ka vlerën 115,433,467,710 lekë (sipas tatimit ne SIFQ).
Vlera e DRT në pasqyrat e konsoliduara është 23,145,242 leke, jashtë sistemit SIFQ.
Kjo llogari përfaqëson shumën e arkëtimeve të papërdorura në sistemin E tax si mjete në ruajtje vetëm për tatimpaguesit, sipas llojit të deklaratës tatimore në SIFQ. Në këtë llogari kontabilizohen të ardhura për çdo lloj tatimi (deklaratë) për të cilën në momentin e procedimit të një pagese, ende nuk ka një detyrim të kontabilizuar. Funksionimi i kësaj llogarie përfshin në pjesën më të madhe kontabilizimin e pagesave për këstet e tatim fitimit të cilat nuk kanë një deklaratë në sistem në momentin e pagesës pasi ajo deklarohet në 3 mujorin e parë të vitit pasardhës.

Në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, neni 30 ñParapagimetò, thuhet: ñgjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetorò.

Kjo llogari është specifike në sektorin publik dhe në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të NJQPò, jepen dhe udhëzimet e regjistrimeve kontabël në këtë llogari: ñé në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do tâu kthehen nga kjo llogari të tretëveò, të tilla si: • Derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen; • Depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër; etj Arkëtimet e rrjedhura sipas përcaktimeve ligjore në lidhje me parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin regjistrohen në llogarinë analitike 4665003 ñdepozitime të përkohshme për tatimin mbi fitiminò. Skema e kontabilizimit, siç edhe është trajtuar në auditimin e vitit të kaluar, parashikon regjistrimin e parapagimeve të tatim fitimit në llogarinë 466 (4665003 analitike) por në ndryshim nga llogaritë e tjera të cilat rregullohen (debitohen) rast pas rasti me deklarimet periodike të subjektit tatimpagues, kjo llogari vazhdon të paraqesë gjendjen historike të parapagimeve ndërkohë që në sistemin C@TS këto parapagime sistemohen në mënyrë dinamike me deklarimin vjetor faktik të rezultatit financiar vjetor të subjektit. Kështu, në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003 më 31.12.2019 paraqitet në shumën 115,433,467,710 lekë.

Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2019, pa u sistemuar me deklarimet vjetore në 31.03.2020 për llogari të parapagimeve të bazuara në rezultatin tatimor të deklaruar për vitin 2019. Deklaratat vjetore për tatim fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS, por në kontabilitet kjo nuk gjen pasqyrim dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti si një zë ódetyrimiò në pasivin e bilancit të DPT-së me kunderparti ñllog.520 disponibilitete në thesarò.

Gjendja Llog.466 më 01.01.2020	**92.5 miliard lekë**
Arkëtime 2020	23 miliard lekë
Gjendja e llog.466 më 31.12.2020	**115.4 miliard lekë**
Nga të cilat:	
Arkëtime (Të ardhura) të raportuara për zërin ñtatim mbi fitiminò	21,4 miliard lekë
Teprica kreditore sipas C@TS 31.12.2020	14.1 miliard lekë

Në konkluzion, kjo llogari paraqitet në pasqyrat financiare të DPT-së e mbivlerësuar krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme (detyrim ndaj tatimpaguesve respektive) dhe si disponibilitet në thesar, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeò. Pavarësisht se kontabilizimet dhe raportimet financiare janë kryer në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit sipas pikës 49: ñ*Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar, gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshmeò*, pasqyra e pozicionit financiar nuk pasqyron gjendjen reale të detyrimit dhe disponibiliteteve në Thesar.

Referuar UMFE nr.8, pika 50 e tij ñ*Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me*

*thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (**të ardhurat e papërdorura,** si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet*), shuma e raportuar në llogarinë 520 (466) nuk paraqesin saktësisht ñtë ardhurat e papërdoruraò pasi këstet e parapaguara përdoren në momentin e deklarimit të tatim fitimit.

Situata e llogarisë 466 sipas të dhënave të DKS për vlerat e pasqyruara në sistemin C@TS, për vitin 2020, paraqitet në vijim:

4665	**Depozitime te tjera (per tu sistemuar ne te Ardhmen)**	**23,007,918,762.00**
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	80,487,387.00
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	21,452,940,092.00
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	529,791,037.00
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	600,562,925.00
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	195,503.00
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	866,983.00
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	4,719,759.00
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjobat	5,617,404.00
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sigurime shoqerore, shendetesore dhe TAP)	240,641,411.00
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	92,096,261.00

Situata progresive e llogarisë 466 sipas të dhënave të DKS për vlerat e pasqyruara në sistemin C@TS, më 31.12.2020 është si vijon:

4665	**Depozitime te tjera (per tu sistemuar ne te Ardhmen)**	**115,443,467,710.00**
4665502	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit në Burim	565,003,982.00
4665503	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatim Fitimit	107,697,566,344.00
4665504	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	2,935,734,481.00
4665505	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Taksave Nacionale	1,891,948,023.00
4665506	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Tarifave Kombëtare	17,257,922.00
4665507	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Lojrave të fatit	4,634,933.00
4665508	Depozitime të përkohshme për Deklaratën e Rentës Minerare	47,266,677,00
4665509	Depozitime të përkohshme për Gjobat	35,533,279.00
4665510	Depozitime të përkohshme për Listëpagesën (sigurime shoqerore, shendetesore dhe TAP)	1,399,375,865.00
4665511	Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar	849,146,204.00

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeò.

Ndikimi: Kjo llogari në fund të çdo periudhe nuk paraqet pamjen reale dhe të sakte të saj jo vetëm në kontabilitetin e pasqyrat financiare të DPT, por dhe në SIFQ.

Rëndësia: e lartë

Pretendime të subjektit të audituar: *Përsa me sipër është bërë observacion nga znj. M. S., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, protokolluar në KLSH me nr.513/11, datë 23.08.2021, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Konstatimi lidhur me tepricën e llogarisë 520 dhe 466 nuk është i drejtë sepse: referuar udhëzimit nr.8, datë datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme", veprimet për të cilat preken këto llogari janë:*

Debi llog 520 dispnibilitete në thesar

Kredi llogaria 466 mjete në ruajtje

Në momentin kur paguhet nuk ka detyrim të deklaruar: Debi llog 466, kredi llog 520. Në fund të vitit këto llogari nuk mbyllen, por dalin me tepricë debitorë dhe kreditore në pasqyrat financiare, të cilat janë të vërtetuara me akt rakordim me degën e thesarit që nga viti 2016. Viti i ri buxhetor këto teprica i paraqet me çelje në SIFQ, sipas gjendjes së një viti më parë. Kontabilizimi i kësteve paraprake, për tatimin mbi fitimin në llogarinë 4665503 është i drejtë dhe pasqyron të gjitha parapagimet për të cilat ende nuk është konstatuar një detyrim. Referuar parimit të kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatauara, kjo është

mënyra e saktë e kontabilizimit të të ardhurave të parashikuara. Përdorimi i saj në sistem bëhet në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm buxhetor, kur të gjithë tatimpaguesit dorëzojnë deklaratën finale lidhur me detyrimin për tu paguar për tatim fitimin e realizuar një vit më parë. Në këto kushte nuk ka teprica të këtyre llogarive.

Qëndrim i grupit të auditimit: *Çështja që Ju kundërshtoni është trajtuar gjerësisht në aktin e konstatimit dhe për të mos krijuar përsëritje nuk po i ritrajtojmë. Për arsye se nuk keni paraqitur fakte të reja, të ndryshme nga ato të cilat janë diskutuar me Ju gjatë procesit të auditimit në teren, observacioni Juaj nuk merret në konsideratë.*

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëmò, në pasqyrat financiare të aparatit të DPT ka vlerën 1,500,620,883 dhe rakordon me vlerën e llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò dhe ka përbërjen si vijon:

Nr.	Emërtimi	Vlerë
1	Vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna	**184,758,547**
2	Vendime gjyqësore që lidhen me subjektet private	664,090,061
	Detyrime për investime	***569,126,942***
	Detyrime për shtypshkrime	***82,645,332***
		1,500,620,882

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëmò, në pasqyrat financiare të konsoliduara të DPT ka vlerën 102,170,673,440 lekë, në të cilën bënë pjesë vlera e pasqyrave të aparatit të DPT prej 1,500,620,883 lekë, vlera prej 100,669,994,057 lekë e kësaj llogarie për pasqyrat e konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, (kundrejt vlerës 101,893,878,070 lekë më 31.12.2019 për këtë drejtori). Në vitin 2020 vlera e kësaj llogarie është ulur me 1,223,884,013 lekë ose në masën 1%.

a-Përbërja e llogarisë 467 sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës në vlerën 100,669,994,057 lekëparaqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr llogarisë	Emërtimi	**Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2019**	**Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2020**
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	567,648,683	569,959,087
7001	- Tatim mbi fitimin	14,185,419,463	14,148,401,952
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogël	1,160,728,822	1,197,070,177
7009	- Tjera tatime	1,996,915,959	1,880,024,664
7030	- Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	77,878,256,500	76,503,499,999
	nga kjo -Stoku rimbursimit të TVSH	*11,251,390,130*	*9,797,308,171*
7031	- Akciza	73,055,913	73,055,913
7032	- Takse mbi sherbimet specifike(Lojra fati)	71,775,534	68,968,791
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie (Renta minerare)	6,818,574	8,181,359
7050	- Taksa e rruges	126,687,189	309,072,651
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	24,220,764	22,093,856
7115	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdemtime	75,781,230	79,106,176
75	**Sigurime shoqerore e shendetsore**	**5,544,293,159**	**5,627,400,675**
	Sigurime shoqerore	5,503,711,208	5,581,889,022
	Sigurime shendetsore	40,581,951	45,511,653
	Arka rregjistruse	190,145	190,145
	Shtypshkrime	656,843	406,181
	Pulla (me çmim blerjeje)	181,429,293	182,562,431
		101,893,878,070	**100,669,994,057**

Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020
Totali ne PF te konsoliduara	**101,893,878,070**	**100,669,994,057**
E tax	90,136,556,303	90,365,876,466
Stoku i rimbursimit ne DPT të TVSH	11,251,390,130	9,797,308,171
Tatimore ne DRT (DETRIME jashtë sistemit)	323,655,356	323,650,663
Jo tatimore (sek shpenzime)	182,276,281	183,158,757

Vlerat që pasqyrohen në Sistemin E tax për llogarinë 467 paraqiten në tabelën në vijim:

Nr llogarise	Emërtimi	**Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2019**	**Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2020**
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	522,114,102	524,424,506
7001	- Tatim mbi fitimin	14,150,842,890	14,113,825,379
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogel	1,159,534,290	1,195,880,338
7009	- Tjera tatime	1,984,604,089	1,867,712,794
7030	- Tatimi mbi Vleren e Shtuar(TVSH)	66,582,896,295	66,662,221,753
7031	- Akciza		-
7032	- Takse mbi sherbimet specifike(Lojra fati)	70,775,534	67,968,791
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie (Renta minerare)	6,262,851	7,625,636
7050	- Taksa e rruges	126,687,189	309,072,651
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatore	24,220,764	22,093,856
7115	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	73,606,105	76,931,051
75	**Sigurime shoqerore e shendetsore**	**5,435,012,195**	5,518,119,711
	Sigurime shoqerore	5,394,928,684	5,473,106,498
	Sigurime shendetsore	40,083,511	45,013,213
		90,136,556,303	**90,365,876,466**

pasqyrave financiare viti 2020:

Nr llogarisë	Emërtimi	**Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2019**	**Detyrime Kreditore Gjendje me 31.12.2020**
7000	- Tatim mbi te ardhurat personale	45,534,581	45,534,581.00
7001	- Tatim mbi fitimin	34,576,573	34,576,573.00
7002	- Takse e tatim mbi biznesin e vogel	1,194,532	1,189,839.00
7009	- Tjera tatime	12,311,870	12,311,870.00
7030	- Tatimi mbi Vleren e Shtuar (TVSH)	11,295,360,205	9,841,278,246
	nga kjo -stoku rimbursimit	*11,251,390,130*	*9,797,308,171*
7031	- Akciza	73,055,913	73,055,913
7032	- Takse mbi sherbimet specifike(Lojra fati)	1,000,000	1,000,000
7033	- Takse mbi perd.mallrave e lejim veprimtarie (Renta minerare)	555,723	555,723
7050	Taksa e rruges & Taksa nacionale		-
7110	- Tarifa administrative dhe rregullatorë		-
7115	- Gjoba dhe kamatvonesa,sekuestrime e zhdemtime	2,175,125	2,175,125
75	**Sigurime shoqerore e shendetsore**	**109,280,964**	**109,280,964**
	Sigurime shoqerore	108,782,524	108,782,524
	Sigurime shendetsore	498,440	498,440
	Arka rregjistruse	190,145	190,145
	Shtypshkrime	656,843	406,181
	Pulla (me çmim blerjeje)	181,429,293	182,562,431
		11,757,321,767	**10,304,117,591**

Në llogarinë 467 pozicionohen te gjitha kreditë e deklaruara nga tatimpaguesit (TVSh-ja), mbi pagesat e rezultuara për çdo rast kur detyrimi ne deklarate është me i vogël se pagesa e kryer gjate vitit (për tatim fitimin), çdo rivlerësim ne ulje i një akti administrativ detyrimet e

te cilit janë paguar me pare se tëfillojë procesi i ankimimit te aktit administrative nga ana e tatimpaguesit.

Për Tatimin mbi vlerën e shtuar vlera për 76.5 miliard leke përfaqëson situatën kreditore ne sistemin E Tax dhe jashtë sistemit gjendje me 31.12.2020 ne llogarinë e çdo tatimpaguesi, nga fillimi i aktivitetit te tij deri me 31.12.2020, përfshirë dhe stokun e rimbursimit gjendje me 31.12.2020. Në E- tax kjo është në vlerën 66,662,221,753 leke.

Kredi ne kontabilitetin e DRT-ve sipas pasqyrave financiare dorëzuar ne DPT është 43,970,075 Leke.

Për **Tatim fitimin** vlera për 14.148 miliard leke përfaqëson situatën kreditore ne sistemin E Tax dhe jashtë sistemit gjendje me 31.12.2020 ne llogarinë e çdo tatimpaguesit nga fillimi i aktivitetit te tij deri me 31.12.2020 . Ne E tax kjo është ne vlerën 14,113,825,379 leke.

Kredi ne kontabilitetin e DRT-ve sipas pasqyrave financiare dorëzuar ne DPT është 34,576,573 Leke.

Akciza është kredi ne kontabilitetin e DRT sipas pasqyrave financiare dorëzuar ne Shumen 73,055,913 leke

Te tjera tatimore janë 4.134 miliard leke përfaqëson situatën kreditore ne sistemin E Tax dhe jashtë sistemit gjendje me 31.12.2020 ne llogarinë e çdo tatimpaguesit nga fillimi i aktivitetit te tij deri me 31.12.2020 . Ne E tax kjo është ne vlerën 4,071,709,623 leke.

Kredi ne kontabilitetin e DRTve sipas pasqyrave financiare dorëzuar ne DPT është 62.767.138 Leke.

Kontribute sig shoq e shëndetësore janë 5.627 miliard leke përfaqëson situatën kreditore ne sistemin E Tax dhe jashtë sistemit gjendje me 31.12.2020 ne llogarinë e çdo tatimpaguesit nga fillimi i aktivitetit te tij deri me 31.12.2020. Nw E- tax kjo është në vlerën 5,518,119,711 lekë.

Kredi ne kontabilitetin e DRTve sipas pasqyrave financiare dorëzuar ne DPT është 109,280,964 Leke.

Te tjera jo tatimore (sektori i shpenzimeve)janë 183,158,757 lekë.

Procesi i përdorimit te Kredisëështë dinamik ne system dhe ndryshon sa here reflektohet nje veprim ne llogarinë e tatimpaguesit (deklarim apo pagese). Me vendosjen e sistemit te ri tatimor kredia ne llogarinë e çdo tatimpaguesi përdoret ne mënyrë automatike.

<u>Të ardhurat: (cash floë)</u>

Nga auditimi kësaj pasqyre në bilancin e kansoliduar hartuar nga DKS totali i te ardhurve ka vlerën 239,177,334,965 lekë, e cila përbëhet nga vlera e bilancit të DPT (ku përfshihet vetëm vlera e sistemit c@ts E-taks për detyrimet tatimore, sigurimet dhe që ka vlerën 235,673,984,516. Diferenca prej 3,325,473,874 lekë përfaqëson të ardhura nga rivlerësimi I pasurive pagesë e të cilave paguhet në degët e thesarit pranë RRT dhe nuk pasqyrohet në sistemin E taks.

Vlera prej 235,673,984,516 e pasqyruar në sistemi Etaks dhe në pasqyrat financiare të DPT (të pa konsoliduara) është e njëjtë më rakordimin e bërë midis DPT dhe degës së thesarit Tiranë)

Llogaritja e provizoneve në pasqyrat financiare.

Nga auditmi u konstatua se në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provigjone, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr.6, ñProvizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuaraò, pika nr. 47, si dhe ñUdhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 34 ku thuhet:

ñProvizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tô paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto

provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë nëse: - Njësia ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur; - Është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të jetë e nevojshme për të përmbushur detyrimin; si dhe - Mund të bëhet një parashikim i besueshëm mbi vlerën e detyrimitò.
Nevoja e parashikimit të provizioneve lidhet me vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, me vendime të tjera lidhur me tatimpaguesit, si dhe me vlerën 2,182,199 mijë lekë i cili përbën detyrim të DPT për rimbursim të TVSH për 104 kërkesave të subjekteve të pranuara por të pa miratuara në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, të cilat kanë kaluar afatin 60 ditë. Vlera prej 2,182,199 mijë lekë, konsiderohet si një detyrim i pa paguar nga DPT dhe për këtë Drejtoria e rimbursimit të TVSH duhet të kishte përcjellë në Drejtorinë e Financës vlerën e mësipërme për kontabilizim. Përsa i përket zbatimit të vendimeve gjyqësore, kjo duhet të ishte llogaritur nga Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike.
Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.12.
Pretendim i subjektit të audituar: *Për sa përshkruhet më sipër lidhur me çështjet e buxhetit dhe pasqyrave financiare, është bërë observacion nga znj. D. I. me detyrë drejtor i përgjithshëm, z. K. Sh. me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm dhe z.A. C, zv/drejtor i përgjithshëm, protokolluar në KLSH me nr.513/22, datë 30.08.2021. Ky observacion trajton çështje të aktit të konstatimit, por për arsye të ardhjes jashtë aftëve, nuk është trajtuar në projektraport dhe për këtë arsye është pjesë e raportit të auditimit. Në mënyrë të përmbledhur, në observacion, lidhur me akt konstatimin nr.12 thuhet:*
Sipas akt konstatimit nr.12 janë evidentuar mangësi në shpenzime dhe detyrimet e prapambetura, ku janë vlerësuar përgjegjës titullari i institucionit dhe punonjës të tjerë sipas natyrës së problematikës. Titullari është vlerësuar përgjegjës për arsye se nuk ka monitoruar si duhet procesin e vlerësimit të aktiveve, si dhe nuk ka zëvendësuar një nga anëtarët e komisionit që ka munguar për arsye objektive, ndërkohë që nuk është vlerësuar përgjegjës asnjë nga anëtarët e komisionit që nuk kanë përfunduar detyrat e ngarkuara.
Pretendimi se komisioni në kushtet e mungesë së një anëtari nuk mund te dilte me vendimmarrje, është absurd dhe i pa trajtuar nga audituesit. Mungesa e një anëtari të komisionit nuk mund të pezullojë punën e komisionit. Audituesi ka konstatuar se edhe pas një vit e gjysmë pas ngritjes së komisionit, ky i fundit nuk ka përmbushur detyrën, por për këtë nuk ka përgjegjësi komisioni, por titullari i institucionit, pasi nuk ka kryer si duhet monitorimin e tij.
Qëndrim i grupit të auditimit*: Sqarojmë se komisioni ka dalë me raport vlerësimi në datën 20.05.2020 dhe ky është raporti final i tij, me të cilin është njohur Titullari i Institucionit. Komisioni ka theksuar se ky raport vlerësimi është hartuar nga katër anëtar, ndërkohë që urdhri për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve është me pesë anëtarë. Gjykojmë se për arsye të zbatimit të urdhrit të dalë nga Titullari, si dhe për arsye se përbërja e çdo komisioni është me numër tek, duhet të ishte zëvendësuar anëtari i cili nuk ka marrë pjesë për arsye objektive, me qëllim që raporti i komisionit nga ana formale të jetë në përputhje me urdhrin. Nuk shohim pengesë objektive për zëvendësimin e njërit prej anëtarëve të komisionit. Në mënyrë që edhe rezultati i vlerësimit të aktiveve të konfirmohej nga pesë anëtarë, ashtu si ka dalë dhe në urdhër. Sqarojmë se trajtimi i kësaj çështjeje ka për qëllim që në raste të tjera të ngjashme në të ardhmen, të kihet në konsideratë, se nëse urdhri del për ngritjen e një komisioni prej 5 personash, zbatimi i tij do të bëhet nga 5 persona e jo nga 4.*
Për sa më sipër kundërshtia Juaj, lidhur me faktin se Titullari nuk ka përgjegjësi në këtë çështje, nuk merret në konsideratë.
Përsa i përket z. K. Sh, nuk është ngarkuar me përgjegjësi për çështje të caktuara, lidhur me akt konstatimin nr,12

IV. 5.Mbi marrëdhëniet e punës dhe pagat në institucion:

a. Rekrutimet, transferimet dhe largimet për periudhën nën auditim, si dhe impakti i tyre në buxhetin e shtetit. Procedurat e ndjekura në bashkëpunim me DAP për plotësimin e vendeve vakante të organikës.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit nr.513/1, datë 14.05.2021, ñMbi marrëdhëniet e punës dhe pagat në institucionò, u shqyrtua me zgjedhje dokumentacioni si më poshtë:

1. *Struktura organike;*
2. *Rregullore e Brendshme;*
3. *Listëpagesat e punonjësve me gjithë dokumentacionin shoqërues;*
4. *Listëpagesat për kontributin e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi pagën;*
5. *Procedurat e emërimeve, transferimeve dhe largimeve nga puna;*
6. *Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;*
7. *Dosje personale.*

Struktura Organizative

Për periudhën objekt auditimi struktura e DPT ka qenë e organizuar: Në bazë të urdhrit nr. 86, datë 12.05.2019, "Për disa ndryshime në urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"* të ndryshuar, numri i përgjithshëm (Plan) për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2019, ka qenë **249** nëpunës/punonjës në total.

Me shkresën nr. 931 prot, datë 17.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm, është dërguar për mendim në MFE, Draft-Struktura organizative, Draft-Organigrama dhe Relacioni shoqërues.

Me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"*, numri i përgjithshëm i punonjësve/nëpunësve për vitin 2020 për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është **308** nëpunës/punonjës.

Ndryshimi i fundit strukturor është me urdhrin nr. 152, datë 19.11.2020, me shtimin e pozicionit të Koordinatorit për rrjetin Antikorrupsion i cili është finalizuar në datë 26.02.2021.

Ndryshimet për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve,janë kryer si më poshtë:

1. Riorganizimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut;
2. Drejtoria Teknike dhe Ligjore;
3. Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve dhe Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndëristuticional të bashkohen;
4. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, në varësi të shtyllës së dytë, do të kalojë në varësi të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Hartimit të Programeve;
5. Qendra e Pagesave bëhet sektor në varësi të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit;
6. Qendra e Thirrjeve bëhet sektor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve dhe jo Drejtori më vete;
7. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH vendoset nën shtyllën e Mbështetjes së Programeve;
8. Drejtoria e Auditit të Brendshëm, bëhet me dy sektorë;
9. Krijohet një Drejtori e re, si bashkim i dy drejtorive, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e përbërë nga dy sektorë:
10. Krijohet një drejtori e re, Drejtoria për Proceset e Biznesit, në varësi të shtyllës të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes të Programeve;
11. Krijohet një Sektor Komunikimi (1+2) në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm.

Pas ndryshimeve strukturore, lëvizja në numër pozicionesh për DPT, është me +59 pozicione.

Nga auditimi i përputhshmërisë së strukturës organizative u konstatua se, për periudhën objekt auditimi për muajt e zgjedhur, nuk ka tejkalim të strukturës si në numër total në punonjës ashtu edhe për njësitë përbërëse (drejtori apo sektorë). Gjithashtu për këto muaj struktura është realizuar nga planifikimi, mesatarisht me 79 %, paraqitur si më poshtë:

Tabela e realizimit të numrit të punonjësve për periudhënJanar – Dhjetor 2020

Nr.	Muaji	Punonjës Strukture dhe Shërbimi	Janar	Prill	Tetor	Dhjetor
Nr. Punonjësish plan		Nëpunës civil & Kod pune	249	249	308	308
		Kontratë e përkoh. VKM 47 dt.22.01.2020	0	30	30	30
Nr. Punonjësish fakt		Nëpunës civil & Kod pune	203	198	239	236
		Kontratë e përkoh. VKM 47 dt.22.01.2020	0	9	21	21
Realizimi në %		Nëpunës civil & Kod pune	81.5%	79.5%	77.6%	76.6%
		Kontratë e përkoh. VKM 47 dt.22.01.2020	0	30%	70%	70%

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPT, përpunuar nga audituesi.

Emërimet

Për periudhën objekt auditimi, emërimet në DPT, janë kryer duke u bazuar në:
1. Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, i Kryeministrit për miratimin e strukturës së DPT;
2. Ligji nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar;
3. Kodit të punës në RSH, ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar;
4. VKM nr. 229, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr. 586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, ñPër punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetëroreò;
5. VKM nr. 47, datë 22.01.2020, ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendroreò.

Në DPT, për vitin 2020 janë emëruar 16 nëpunës me status, nga të cilët 14 janë emërime të reja në periudhë prove, të detajuara në aneksin nr.3, bashkangjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve. Grupi i auditimit konstatoi se, ka patur lëvizje të shpeshta nëpunësish, brenda për brenda institucionit, duke u ngritur në detyrë dhe kategori page. Një rast konstatimi, ishte i E.S. Me shkresën nr. 1622/1 datë 29.01.2020, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNJ), ka filluar marrëdhëniet financiare, nëpunës civil në pozicionin Inspektor i I, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, në DPT, kategoria e pagës III-b.
Me shkresën nr. 13710/1 prot, datë 20.07.2020 të DBNJ, mbështetur në Vendimin nr. 2830/6 datë 15.07.2020, ñTransferim për shkak të ristrukturimit të institucionitò të DAP-it, është bërë transferimi i përhershëm, në pozicionin Inspektor në Sektorin e Auditimit të Këshillimit, Sigurisë dhe Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, në DPT, kategoria e pagës III-b.
Me shkresën nr. 19528/1 prot, datë 13.10.2020 të DBNJ, është bërë transferimi i përhershëm, në pozicionin Inspektor i I, në Sektorin e Analizës së Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në DPT, kategoria e pagës III-b.
Me shkresën nr. 23155/1 prot, datë 14.12.2020 të DBNJ, e filluar marrëdhëniet financiare nëpunës civil në pozicionin Përgjegjës Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhura, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, në DPT, kategoria e pagës III-a/1.
Emërimet e kryera me kod pune në DPT jepen në aneksin nr.3/1 bashkangjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve me kod pune konstatohet se, për punonjësinA. O. është ndjekur procedura me konkurrim. Kualifikimi dhe vjetërsia në profesion përputhen me kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të shpallura për pozicionet vakante.

Ndërsa në rastin e pozicionit vakant të Përgjegjësit në Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, mungon një procedurë e rregullt rekrutimi në të cilën të shpallet vendi vakant, të publikohen kërkesat e përgjithshme dhe pastaj të përzgjidhet fituesi. Ky pozicion është plotësuar me punonjësin E. S, të propozuar nga Zv.Drejtori i Përgjithshëm A. Ç. Me shkresën nr. 12529 prot., datë 03.07.2020, ñKërkesë për plotësim të vendit vakantò, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, citojmë shkresën:*"Me tagrin që ju lejon ligji e rregullorja, lutemi të plotësohet vendi, pa zgjatjen e procedurave konkurruese duke qenë se gjykojmë që plotësohen kushtet e nevoja urgjente të punës për hartimin e përgatitjen e planeve të punës dhe për nevoja të plotësimit të vendeve të punës, me ata punonjës të cilët kanë punuar më parë në administratën tatimore."*

Me vendimin nr. 536, datë 1307.2020, të Titullarit, është bërë emërimi i E. S, në pozicionin Përgjegjës, në Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, kategoria e pagës III-a/1. Diploma që zotëron, është Master Profesional, në Programin Administrim Biznesi, Profili Financë. Pas kërkesës së DBNJ, më datë 13.07.2020, punonjësi ka paraqitur vërtetimin i cili, vërteton se është student në Fakutetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, Master i Shkencave në Administrim Publik, në vitin e I, me sistem me kohë të plotë për vitin akademik 2019-2020. **U konstatua se, në formularin për përshkrimin e punës, punonjësi për këtë pozicion pune duhet të plotësojë kriteret: të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor"** të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë (é) në Shkenca Ekonomike/Juridike. Ndërkohë, punonjësi E. S, në momentin e emërimit **ishte duke e frekuentuar Master-n Shkencor.**

Pretendimi i Subjektit: *Për sa trajtohet në këtë çështje, janë bërë kundërshti nga subjekti i audituar, ku në mënyrë të përmbledhur është shprehur se: Janë evidentuar problematika të lidhura me punën dhe pagat në institucion, për të cilat është vlerësuar përgjegjës titullari i institucionit, zvdrejtori i përgjithshëm dhe drejtuesit e drejtorive respektive. Ka pasur lëvizje të shpeshta brenda institucionit, ka pasur emërime pa plotësuar kriteret e duhura.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Ashtu siç është trajtuar në Akt-Konstatim, por edhe në Projekt Raport, gjatë auditimit të dokumenteve të vënë në dispozicion grupit të audituesve, u evidentuan lëvizje të shpeshta të pozicioneve të punës së inspektorëve, duke sjellë pengesë në punën e përditshme si dhe në objektivat e vëna nga drejtuesit. Nga grupi i audituesve nuk u trajtua vetëm rasti i znj. E. S. por edhe i z. M. A.*

Në lidhje me emërime pa plotësuar kriteret e duhura, është trajtuar Akt-Konstatim, por edhe në Projekt Raport, se me vendimin nr. 536, datë 1307.2020, të Titullarit, është bërë emërimi i E. S, në pozicionin Përgjegjës, në Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, kategoria e pagës III-a/1. Diploma që zotëron, është Master Profesional, në Programin Administrim Biznesi, Profili Financë. Pas kërkesës së DBNJ, më datë 13.07.2020, punonjësi ka paraqitur vërtetimin i cili, vërteton se është student në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, Master i Shkencave në Administrim Publik, në vitin e I, me sistem me kohë të plotë për vitin akademik 2019-2020. U konstatua se, në formularin për përshkrimin e punës, punonjësi për këtë pozicion pune duhet të plotësojë kriteret: të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë (...) në Shkenca Ekonomike/Juridike. Ndërkohë, punonjësi E. S, në momentin e emërimit ishte duke e frekuentuar Master-n Shkencor. Për këtë emërim mban përgjegjësi titullari i institucionit, si dhe observimin tuaj nuk merret në konsideratë.

Për përgjegjësinë e zv.drejtorit të përgjithshëm, grupi i auditimit e ka marrë në konsideratë observimin tuaj, dhe është reflektuar në Raportin Përfundimtar.

Gjatë vitit 2020 në DPT ka patur 3 raste transferimesh të përkohshme. Nga auditimi konstatohet se nuk është tejkaluar afati i parashikuar për transferimin e përkohshëm të nëpunësve civil, të pasqyruar në tabelë:

Transferime të përkohshme në DPT

Nr.Vendimit	Data	Emri	Mbiemri	Shkaku i Vendimit	Pozicioni perpara transferimit	DRT	Pozicioni i transferimit	DRT
710/1	23-Jan-20	L.	L.	Transferim i perkohshem 6 muaj mbeshtetur ne shkresen e DAP	Inspektor i Parë (Drejtoria e Rimbursimit të TVSH) III-b	DPT	Inspektor i Parë (Sektori i Kontrollit Tatimor)	Tirane
3239/2	17-Mar-20	E.	P.	Transferim i perkohshem 6 muaj mbeshtetur ne shkresen e DAP	P/Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit III-a/1	DPT	P/Sektori i Çeshtjeve Jo-Tatimore	DPT
710	23-Tet-20	E.	N.	Transferim i perkohshem	Inspektor (Sektori i Trajnimit te Ankesave)	DPT	Inspektor (Sektori i verifikimit dhe Koordinimit ne Terren)	DPT

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT

Transferime të përhershme në DPT

Gjatë vitit 2020, në DPT ka patur raste transferimesh të përhershme. Të dhëna të zgjeruara në formë tabele për këtë çështje trajtohen në Aneksin nr.5 ñMbi marrëdhëniet e punës dhe pagat në institucionò.

Transferimet dhe lëvizjet e shpeshta brenda një drejtorie ose/dhe në drejtori të tjera, kanë sjellë pengesë në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive të caktuara, të punonjësve. Nga auditimi u konstatua, rasti i transferimit të inspektorit/auditues në DAB, M.A. Me shkresën nr. 2830/777 prot, datë **07.10.2020**, ñTransferim për shkak të ristrukturimit të institucionitò, DAP vendos transferimin e përhershëm të tij, në pozicionin Inspektor i I, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor për Bisnesin e Vogël, në DRT Tiranë.

Më datë **12.10.2020**, grupi i auditimit i DAB, i përfaqësuar nga M. A. dhe E. S, të angazhuar në auditimin e DRT Dibër, me nr. programi 1511 prot, datë fillimi 08.09.2020, dhe mbarimi **16.10.2020,** e kanë **ndërprerë auditimin,** për arsye të transferimit të tyre në drejtori të tjera.

Me kërkesën e datës **20.10.2020**, grupi audites ka kërkuar shtyrje të afatit të përfundimit.

Me urdhrin nr. 20408 prot, datë 20.10.2020, ñPër përfundimin e procedurave të auditimit në DRT Dibërò, të Drejtorit të Përgjithshëm, është autorizuar grupi i auditimit në përfundimin e plotë të auditimit.

Procedurat e ndjekura në bashkëpunim me DAP për plotësimin e vendeve vakante të organikës.

Në bazë të strukturës organike të DPT, në dhjetor 2020, rezultojnë 60 pozicione vakante:

- 9 pozicione të lira janë shpallur në DAP, në proces;
- 6 pozicione të lira janë ofruar për gjyqfitues;
- 1 pozicion i lirë i hedhur në portalin Administrata .al;
- 1 pozicion i lirë i shpallur pa fitues;
- 5 pozicione të lira të shpallur për ekselentët e vitit 2020, Thirrja 3.

Në lidhje me vendet vakante, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me strukturat drejtuese, kriteret për çdo pozicion duke sugjeruar tëi jepet prioritet plotësimit me gjyqfitues. Me shkresën nr. 3244/2 prot, datë 21.09.2020, ñInformacion dhe propozime për sistemimin e gjyqfituesveò të

DBNJ, i është drejtuar Komisionit të Posaçëm, duke i bashkëngjitur tabela me pozicionet vakante të ATQ, propozime të sistemimeve të gjyqfituesve, ku prioritet kanë zbatimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
Është mbajtur procesverbali me nr. 23750 prot, me datë 10.12.2020 në mbledhjen e Komisionit të Posaçëm, i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
Në kuadër të rekomandimeve të KLSH, mbi kontrollin e ushtruar në DPT, në vitin 2018 dhe 2019, Komisioni i Posaçëm vendosi të marrë në shqyrtim praktikat e plota të gjyqfituesve ï ish nëpunës civilë. Janë shqyrtuar paralelisht vendet vakante dhe praktikat e gjyqfituesve, me qëllim plotësim të vendeve vakante me gjyqfitues me vendim të formës së prerë. Megjithatë nga auditimi u konstatua se, ka ende një numër të konsiderueshëm gjyqfituesish, **59 persona të pasistemuar** si në vijim: Të dhëna të zgjeruara në formë tabele për këtë çështje trajtohen në Aneksin nr.5 ñMbi marrëdhëniet e punës dhe pagat në institucionò.

Mbi marrëdhëniet e pagave.
Gjatë auditimit të pagave dhe shpenzimeve për udhëtim e dieta u shqyrtuan: Struktura e miratuar nga KM; Akt emërimet; Listëprezencat; Listëpagesat; Urdhër shpenzimet; Urdhër shërbimet; Dokumentacioni justifikues/vërtetues dhe gjithë dokumentacioni shkresor i vënë në dispozicion grupit të auditimit nga strukturat respektive.
Për të verifikuar rregullshmërinë e kryerjes së pagesave të punonjësve, grupi i auditimit u bazua në përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektitò, i ndryshuar, lidhja 6/8 dhe aktet rregullatorë në fuqi, në rregulloren e brendshme ñPër funksionimin e administratës tatimore qendroreò, miratuar me urdhrin nr. 193, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE, përzgjodhi listëpagesat e muajve prill, tetor e dhjetor 2020. Nga testimet e kryera rezultoi se:
-Në listëprezencat e audituara, të muajve Janar, Mars, Shtator e Dhjetor 2020, rezultuan të nënshkruara nga titullarët e drejtorive dhe të shoqëruara me raporte mjekësore, në raste të mungesës shëndetësore të punonjësit;
-Shtesa për pozicion është paguar për kategoritë respektive në përputhje me përcaktimet e lidhjes nr.1 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 e ndryshuar;
-Shtesa për kushte pune është paguar për kategoritë respektive në përputhje me përcaktimet e lidhjes nr.6/8 të VKM nr.187, datë 08.03.2017 e ndryshuar;
-Në lidhje me pagën e grupit të cilës i referohet nivelit të diplomës së arsimit universitar, grupi i auditimit kryqëzoi informacionin e marrë nga DBNJ dhe DFB, në lidhje me nivelin e diplomave që zotërojnë punonjësit, që janë të administruara në dosjet personale të punonjësve në DPT, me listëpagesat që u morën me zgjedhje të rastësishme (Janar, Mars, Shtator e Dhjetor 2020) si dhe çdo dokumentacion tjetër që iôu vu në dispozicion grupit të auditimit, si akte emërimi, shkresa informuese nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në lidhje me vjetërinë në punë ose kualifikimet shtesë të kryera nga punonjësit e DPT, gjatë kohës së ushtrimit të detyrave në DPT.
Në zbatim të nenit 73, të rregullores së brendshme ñPër funksionimin e administratës tatimore qendroreò, miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 193, datë 12.08.2020, në përfundim të procedurave të rekrutimit, është kompetencë e Përgjegjësit të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit, në DBNJ përgatitja e akteve të emërimit, për të gjithë punonjësit e ATQ, në bazë të kërkesave ligjore, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

Për 37 punonjës sipas listës në aneksin nr.3/2, bashkëngjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se, në listëpagesat e pagave për vitin 2020, mungonte vjetërsia në punë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DFB dhe DBNJ, grupi i auditimit konstatoi se, mungesa e vjetërsisë në listëpagesë për vitin 2020, ka ardhur si rezultat i mosdorëzimit të librezës së punës në DBNJ, nga vetë punonjësit. Detyrim të cilin e përcakton pika 3/g , në Lidhjen 1 ñTë dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelitò, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020, ñPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò.
Me të dhënat që paraqet libreza e punës, kryhet llogaritja e shtesës për vjetërsi në punë, 1 % mbi pagën bazë për klasë, por jo më shumë se 25%. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë, siç e përcakton VKM nr. 202 datë 15.03.2017, ñPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 717, datë 23.06.2009, ñPër pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetoreò, të ndryshuar.

Tabela me të dhënat për pagat e DPT, viti 2020 ***Në lekë***

Nr.	Emërtimi	Janar	Prill	Tetor	Dhjetor
1	Shpenzime për pagat	16,828,984	18,592,449	20,053,177	19,807,155
2	Kontribute shoqërore & shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat personale	2,791,856	2,815,890	3,300,982	3,286,424
	TOTAL	**19,620,840**	**21,408,339**	**22,869,067**	**23,093,579**

b. Largimet nga puna dhe ndjekja e proceseve gjyqësore për ndërprerjet e marrëdhënieve të punës. Mënyra dhe radha e ndjekur për pagesën e punonjësve gjyqfitues me vendim gjykate të formës së prerë.

Largime me status në DPT për vitin 2020

Nr.Vendimit	Data	Emri	Mbiemri	Shkaku i Vendimit	Detyra	DRT
33	03-Shk-20	Xh.	C.	Lirim nga detyra/Kerkesen e tij	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve II-b	DPT
59	26-Shk-20	F.	G.	Lirim nga detyra/Kerkesen e saj	Specialist (Sektori i Prokurimeve) IV-a	DPT
68	06-Mar-20	A.	K.	Lirim nga detyra/Kerkesen e tij	Inspektor i Pare [Drejtoria e Investigimit te Brendshem (Antikorrupsioni)] III-b	DPT
555	05-Gsh-20	Xh.	S.	Lirim nga detyra/Kerkesen e saj	Specialist (Sektori i Çështjeve Tatimore) IV-a.	DPT
716	30-Tet-20	E.	P.	Lirim nga detyra/Kerkesen e saj	P/Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit III-a/1	DPT
723	16-Nën-20	E.	D.	Lirim nga detyra/Kerkesen e tij	Inspektor I Pare (Sektori TVSH-se)	DPT

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT

Largime me kod pune në DPT për vitin 2020

Nr.Vendimit	Data	Emri	Mbiemri	Shkaku i Vendimit	Detyra	DRT
272	06-Pri-20	K.	F.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor Hetimi (Sektori i Hetimit)	DPT
338	06-Pri-20	A.	Z.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor Hetimi (Sektori i Administrimit te Informacionit dhe Analizes)	DPT
339	06-Pri-20	M.	Sh.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor Hetimi (Sektori i Hetimit)	DPT
340	06-Pri-20	E.	L.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor Hetimi (Sektori i Hetimit)	DPT

341	06-Pri-20	A.	M.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor (Sektori i Monitorimit dhe Kundravajtjeve Administrative)	DPT
342	06-Pri-20	D.	M.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor (Sektori i Monitorimit dhe Kundravajtjeve Administrative)	DPT
343	06-Pri-20	F.	Sh.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Inspektor (Sektori i Monitorimit dhe Kundravajtjeve Administrative)	DPT
344	06-Pri-20	R.	Sh.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Pergjegjes (Zyra e Monitorimit dhe Koordinimit 2)	DPT
345	06-Pri-20	V.	P.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Pergjegjes Zyra e Veprimeve ne Terren dhe Masave Administrative	DPT
346	06-Pri-20	F.	T.	Lirim nga detyra per shkak te Ristrukturimit (Kod-Pune)	Pergjegjes Zyra e Veprimeve ne Terren dhe Masave Administrative	DPT
601	10-Sht-20	E.	T.	Mase disiplinore "Zgjidhje e menjehershme e justifikuar e kontrates se punes"	Inspektor (Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit)	DPT

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT

Bazuar në Urdhrin nr.5151 datë 28.10.2015 ñÇdo institucion i administratës shtetërore ka detyrimin të krijojë dhe përditësojë databazën e të dhënave gjyqësore. Grupit të auditimit ju vu në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit databaza me 220 rekorde në total. Prej tyre 181 janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil, të cilët marrin rrogë deri në rikthimin në pozicionin e mëparshëm apo ekuivalent të punës dhe 37 janë punonjës të larguar, marrëdhënia e punësimit të cilëve ka qenë e rregulluar me kod pune.
Në tabelën më poshtë, janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për shpenzimet gjyqësore për ish punonjës të larguar nga puna:
Detyrimet e prapambetura për shpenzimet gjyqësore

Në lekë

Statusi i punonjësit	Numri	Detyrimi i prapambetur 01.01.2019	Detyrime të lindura gjatë 2020	Paguar 2020	Detyrimi i prapambetur 31.12.2020
Ish nëpunës më status	181	377,756,884	144,920,008	280,063,592	184,747,857
Ish punonjës me kod pune	37	25,425,531	12,799,000	96,079,569	10,688
Listë Pritje	1	760,113	-	760,113	
Dëmshpërblim	1	500,000	-	500,000	
Totali	**220**	**404,442,528**	**157,719,318**	**377,403,274**	**184,758,545**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, DPT. Përpunuar nga grupi i auditimit

Gjatë vitit 2020 janë paguar nga DPT shpenzime gjyqësore për ish punonjës gjithsej në vlerën **377,403,274 lekë,** prej të cilave 280,063,592 lekë, kanë shkuar për ish nëpunës me status dhe 96,079,569 lekë për ish nëpunës me kod pune, vlerë e cilësuar si dëm në buxhetin e shtetit. Duke marr në konsideratë faktin që për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona, ish punonjësi që ka fituar gjyqin për largim të padrejtë nga puna dhe punonjësi i ri i rekrutuar, kjo situatë paraqitet më problematike, si dhe me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit.
Detyrimi i prapambetur për këto shpenzime në 31.12.2020 ka qenë **184,758,545 lekë**, nga të cilat 184,747,857 lekë, janë ndaj ish nëpunësve me status dhe 10,688 lekë, ndaj ish nëpunësve me kod pune. Në datën 31.12.2020 ky detyrim i prapambetur u takon 171 punonjësve. Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike databaza e punonjësve të larguar nga puna, e vendosur në aneks nr.3/3, të cilët janë ende në proces gjyqësor. Konstatohet se kjo databazë përbërë nga 16 procese gjyqësore, prej të cilëve 9 janë ish punonjës me status të nëpunësit civil dhe 7 janë ish punonjës me kod pune.
Siç konstatohet nga tabela e vendosur në aneksin 3/3 janë 16 vendime të formës së prerë, nga të cilat 7 janë rrëzuar, sipas informacionit të dorëzuar nga Drejtoria Ligjore Teknike.

Radha e likujdimit të shpenzimeve gjyqësore - FIFO

Në bazë të përcaktimeve të udhëzimit nr.1 datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritò, kryhet

mënyra e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme. Udhëzimi në pikën 4, përcakton se ñNjësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë databazë për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës.
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit databazën e vendimeve gjyqësore dhe përllogaritjen e detyrimit për çdo gjyqfitues.

Likuidimet e vitit 2020 për vendimet gjyqësore të formës së prerë për Administratën Tatimore Në lekë

Nr. Total kreditori	Tatimi në burim 2020	Likujdimi neto i gjyqfituesit 2020	Likujduar 2020 permbarim	Likujduar në total 2020
198	53.316.712	302.128.037	21.958.525	377.403.274

c. Marrëdhëniet e punës të rregulluar me kontrata të përkohshme dhe delegimet.

Kontratat e punës

Marrëdhëniet e punës në DPT, rregullohen në bazë të ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin e civilò, i ndryshuar; ñKodit të punës në RSHò/ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar; si dhe në zbatim të VKM nr. 47, datë 22.01.2020, ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendroreò, Titullari i Institucionit ka nxjerrë urdhrin nr. 11 datë 31.01.2020, ñPër detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, pjesë e administratës tatimoreò, për DPT detajimi i tyre paraqitet si më poshtë:

Kodi I Institucionit	Protokoll/Arkivë me 6 orë/dite vjetore	Mirëmbajtje 6 orë/dite vjetore	Sanitarë 6 orë/dite vjetore	Puonjës shërbimi
1010039 Aparati, DPT	3	2	1	30

Grupi i auditimit konstatoi që Kontrata Individuale e Punës i përfshin elementet e nevojshëm sipas kërkesave ligjore, nuk ka mangësi të elementëve të domosdoshëm në kontratat e punës, si datën e dhënies së saj, numri i protokollit dhe nënshkrimi nga të dy palët, punëdhënës e punëmarrës.

Delegimet

Urdhrat e delegimit/caktimit të nëpunësve të caktuar për kryerje të detyrave në pozicione të ndryshme, janë vendime të marra nga Titullari i Institucionit, bazuar në të gjithë kompetencat që ky pozicion ka, për këto vendimmarrje.
Për vitin 2020, delegimet e kompetencave në DPT, kanë qenë në numër, shumë më të reduktuar në krahasim me atë të vitit 2019.
Nga auditimi, u konstatua se pas përfundimit të urdhra-delegimeve, është bërë emërimi i tyre.

Delegime kompetencash në DPT

Nr.	Emër Mbiemër	Nr.i vendimit	Pozicioni i Emërimit	Drejtoria	Pozicioni i Delegimit	Drejtoria	Data e Delegimit	Nr. i Vendimi	Data e përfundimit
1.	I. K.	16346	Pergjegjes ne Sektorin e Analizes se Riskut	DPT	Drejtor Drejtoria e Menaxhimit te Riskut	DPT	20.08.2020	820/1	26.01.2021
2	A. P.	22232	Inspektor Dyte ne Sektorin e Kontrollit ne Vend	Tirane	Inspektor ne Drejtorine e Kontrollit te Specializuar	DPT	17.11.2020	2324/1	16.02.2021

Vendimet gjyqësore të vitit 2020, të formës së prerë janë 16 dhe të dhëna të hollësishme për to, paraqiten në aneksin nr.3/3, bashkëngjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve. Nga auditimi u konstatua se janë 14 gjyqfituesve të rikthyer në vitin 2020, lista e të cilëve jepet në aneksin nr.3/4, bashkëngjitur projektraportit të auditimit, në rubrikën e anekseve.

IV. 6. Për "Planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime.

a. Programimi i nevojave, disponibiliteti i fondeve, hartimi i regjistrit të prokurimeve;
b.Verifikimi i shpenzimeve të realizuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;
c. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);
d. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit të kontratave të punës publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.
Në zbatim të pikës nr.6 të programit të auditimit të mësipërm, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Dosjet shkresore të zbatimit të kontratave të lidhura;
-Dokumentacioni i bankës për likuidimin e angazhimeve buxhetore;
-Informacion elektroni i përgatitur nga subjekti;
Të dhëna nga sistemi elektronik i APP për procedurat e prokurimit publik etj.
DPT ka hartuar regjistrin e planifikimit dhe të realizimit të prokurimeve publike në fillim të vitit buxhetor si dhe ka bërë shtesat përkatëse gjatë vitit. Regjistri i planifikimit dhe i realizimit është dorëzuar në degën e thesarit si dhe në Drejtorinë e Buxhetit të MFE.
Regjistri përfundimtar vjetor i realizimit të prokurimeve është dërguar në Drejtorinë e Buxhetit të MFE me shkresën nr.621/69, prot, datë 01.02.2021.
Angazhimet buxhetore që janë kryer me prokurim publik me vlera të larta dhe të vogla për vitin 2020, rezultojnë të mbuluara me fonde, përveç procedurës së prokurimit me objekt ñNgritja e Sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, (investim) e zhvilluar si procedurë nga AKSHI gjatë vitit 2020 për llogari të DPT, me vlerë kontrate 80,040,000 lekë me TVSh është iniciuar dhe miratuar pa pasur fonde në dispozicion, e pa parashikuar në PBA 2020-2022 dhe as në planin fillestar vjetor. Për këtë kontratë gjatë vitit 2020 është likuiduar vlera **23,700,000 lekë, pa likuiduar vlera** 56,340,000.00 lekë, jashtë afateve kontraktuale (e gjithë vlera e kontratës duhet të ishte likuiduar gjatë vitit 2020).
Më gjerësisht kjo çështje është trajtuar në pikën e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

DPT për vitin 2020 ka realizuar 3 procedura prokurime me vlera të larta ñmarrëveshje kuadërò, për të cilat zhvillimi i procedurës së vlerësimit dhe shpalljes së fituesit është realizuar nga organi qendror blerës Ministria e Brendshme. Vlera e kontratës pa TVSh për këto procedura është 54,398,936 lekë.
Gjithashtu vetë DPT ka zhvilluar 11 procedura me vlera të vogla me vlerë të fondit limit 4,028,065 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 3,326,422 lekë pa TVSh.
Gjatë vitit 2020 nga DPT është ndjekur zbatimi i 3 kontratave marrëveshje kuadër në vlerën 58,331,594 lekë pa TVSh, të lidhura në vitin 2019, të cilat kanë kohështrirje edhe përgjatë vitit 2020. Të dhëna për prokurimet publike me vlera të larta jepen në aneksin nr.4, bashkangjitur raportit të auditimit, rubrika e anekseve.
Auditim për procedurën e prokurimit me objekt "Riparim, mirëmbajtje automjetesh"
Procedura e prokurimit, është zhvilluar me marrëveshje kuadër, pra Autoriteti kontraktor DPT ka deleguar të drejtën e prokurimit te Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP), e

cila, bazuar në nenin 2, pika 2.1 të VKM 914, ñRregullat e prokurimit publikò është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti kontraktor përfitues.
Njësia e prokurimit e DPT në datën 29.01.2020 ka hartuar fondin limit nëpërmjet metodës së testimit të tregut. Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit thuhet se fondi limit ka dalë shumë i lartë, në vlerën 44,409,632 lekë, ndërkohë që fondi i planifikuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ka vlerën 8,333,334 lekë, e cila është edhe vlera që i është përcjellë si fond limit Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP), me shkresën nr. 111/2, datë 31.01.2020.
Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka nxjerrë urdhrin e prokurimit në datën 25.06.2020, ku është përcaktuar lloji i procedurës së prokurimit ñProcedurë e hapurò, nëpërmjet marrëveshjes kuadër. Në urdhrin e prokurimit është përcaktuar: Lloji i marrëveshjes kuadër: Në zbatim të pikës 1/b, të nenit 47 të VKM 914, datë 29.125.2014 ñRregullat e prokurimit publikò, i ndryshuar, në kushtet kur procedura e prokurimit është e organizuar në 12 lot, do të përdoret marrëveshja kuadër me disa opoeratorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operatorë ekonomik fitues.
Me shkresën nr. 133, datë 27.01.2020, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) pranë Ministrisë së Brendshme, ka njoftuar DPT se brenda datës 3.02.2020 duhet të dërgojë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen nëpërmjet Marrëveshjes kuadër.
Në datën 07.01.2020, ka dalë urdhri nr.114 prot., i zv.drejtorit të përgjithshëm z. K. Sh. ñPër krijimin e komisionit për hartimin e termave të referencës dhe llogaritjen e fondit limit në dokumentat e tenderit me objekt ñRiparim automjetesh për vitin 2020-2021ò. Në këtë komision është përcaktuar z. E. C, me detyrë përgjegjës i sektorit të administratës, me profesion inxhinier mekanik, z. A. H., jurist, z. B. L., ekonomist.
Me shkresën nr.111/2, datë 31.01.2020, nga DPT janë dërguar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, termat e referencës dhe specifikimet teknike të shërbimit me objekt ñRiparim, mirëmbajtje automjetesh".
Në nenin nr.9.6 të rubrikës ñKushtet e vecanta të kontratësò, është përcaktuar se ñçdo faturë shërbimi duhet të shoqërohet me fletën e garancisë ku të dokumentohet qartë data e fillimit dhe mbarimit të garancisë (për zëvendësim me pjesë të reja garancia është 6 muajò. Në nenin nr.9.10 thuhet: ñPër pjesët dhe agregatet e riparuara, si dhe për pjesët dhe agregatet e reja, shoqëria duhet të ofrojë një garanci prej 6 muaj. Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë përbërëse e mini kontratës dhe të zbatueshme për këtë kontratëò.

Zbatimi i kontratave të lidhura

Zbatimi i kontratës për procedurën e prokurimit me objekt: LotiIII "Riparim, mirëmbajtje automjetesh",për autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Loji i procedurës: Procedure e hapur -MarrëveshjeKuadër, me nr. Ref-63213-06-29-2020. Procedura është zhvilluar dherealizuar në vitin 2020,ngaOrganiQendrorBlerës, në emër e për llogari te autoritetitkontraktor DPT
Nëpërfundimtë kësaj procedureprokurimi, është lidhur marrëveshja kuadër loti 3, midis Autoritetit Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) dhe kontraktorit ñAò ShPK, me nr.42/41 prot. datë 19.10.2020midis ofertuesit të shpallur fitues ñAò ShA. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër 24 muaj.
Në dosje ndodhet formulari i ofertës ekonomike të operatorit ñAò ShPK.
Autoritetikontraktor ka lidhur 3 (tre) kontratabrenda marrëveshjeskuadër, me kontraktuesin e shpallurfitues, konkretishtkontratën nr.1 me nr. 23277/1 prot., datë 04.12.2020 për vlerën

799,680 leke (me TVSH), kontratën nr.2 menr. 23621/4 prot., date 22.12.2020 për vlerën 1,628,640 leke (me TVSH), si dhe kontratën nr.3 menr. 23621/10 prot., date 27.12.2020, për vlerën 1,547,640 leke (me TVSH) përshërbimin eparashikuara,nëpërputhjemedokumentetetenderitdheofertënfituese.

Zbatimi i kontratës nr.1,menr.23277/1 prot., datë 04.12.2020

Me shkresën nr. 42/44 prot., date 20.10.2020 të organit qendror blerës, autoritetit kontraktor iështë dërguar autorizimi për lidhje kontrate: LotiIII "*Riparim, mirëmbajtje automjetesh* ",për autoritetin kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Më datë 28.10.2020 me shkresë nr.18723/8 prot., është dërguar lista e 45 makinave për kryerjen e procedurës së përcaktimit të difekreve, te operatori fitues ñAò ShA. Me shkresë nr.25/1, datë 25.11.2020 operatori fitues ka dërguar rezultatet e kryerjes së evidentimit të defekteve dhe shërbimeve për 8 makinat e para për vitin 2020. Për këtë qëllim janë mbajtur procesverbale midis DPT me përfaqësues z. E. Ç, person i autorizuar, drejtuesit të mjetit dhe Kontraktorit ñAò ShPK, nga auditimi i të cilëve konstatohet se nuk është plotësuar sasia e km të përshkruar nga automjeti në momentin e konstatimit të difektit.

Me shkresën nr.18725/11, datë 26.11.2020, DPT ka dërguar ftesën për ofertë Kontraktorit ñAò ShPK, ku e fton që të paraqitur ofertë për kryerjen e shërbimit për difektet e përcaktuara për 8 mjete.

Me shkresën nr.27/1 prot. Datë 27.11.2020 Kontraktori ñAò ShPK ka paraqitur ofertën ekonomike për difektet e përcaktuara në shkresën nr.25/1, datë 25.11.2020.

Nga krahasimi me zgjedhje i cmimeve të paraqitura në ofertën konkrete të kontratës nr.1, me çmimet e paraqitura në formularin e ofertës ekonomike, nuk u konstatuan diferenca.

Përpara lidhjes se kontratës, ofertuesi fitues ka bërë sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës totale tëkontratëspërfshireTVSH,menr.serial02256061date10.12.2020.

Në datën 04.12.2020 autoriteti kontraktor DPT ka lidhur me kontraktuesin e shpallurfitues, kontratën nr.1 menr. 23277/1 prot., me vlerën 799,680 leke (me TVSH) , përshërbimin eparashikuara,nëpërputhjemedokumentetetenderitdheofertënfituese.

Në nenin nr.9 të kontratës është parashikuar se koha maksimale e qëndrimit të makinave në riparim nuk duhet të kalojë 7 ditë (pune) pas lidhjes së kontratës..

Me autorizimin nr.18723/6prot.datë26.10.2020, është caktuar z.E. Ç. (ing mekanik), si person përgjegjës për ndjekjen e kontratës për autoritetin kontraktor DPT dhe verifikimin edefekteve sipas proces-verbalit nr.1 të përcaktuar në nenin 9 pika 9.3 dhe në përfundim, cilësinëeshërbimeve të kryera sipas proces-verbalit nr.2 të përcaktuar në nenin 9 pika 9.5,objektkontrate.

Kontraktuesi ñAò ShA, nga datat 7-10 dhjetor 2020, ka bërë dorëzimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor DPT, duke respektuar afatin 7-ditorngadataelidhjessekontratës së parëpërlëvriminemallravetepërcaktuaranënenin9,pika 9.8. .

Personi i autorizuar z.E.Ç, në datën 15.12.2020 ka mbajtur procesverbalin për marrjen në dorëzim të makinave që ju është kryer shërbimi sipasfaturavetatimore.

Në zbatimtenenit7,"KushtetePagesës", të rubrikës ñKushtet e veçanta të kontratësò, në të cilënparashikohet se pagesa duhet bërë brenda 30 ditëvenga data e pranimittemallrave, Autoriteti Kontraktor ka vijuar me kryerjen e pagesës për kontratën nr.1, sipas faturave me nr. 92512629 datë 08.12.2020; 93545521 datë 10.12.2020; 93545518 datë 09.12.2020; 93545520 datë 10.12.2020; 92512628 datë 08.12.2020; 93545519 datë 09.12.2020; 93512629 datë 07.12.2020; 93512627 datë 07.12.2020.

Pagesa është kryer me urdhër shpenzimet nr.1760-1766 datë 17.12.2020.

Në zbatim të VKM nr.914. datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 6, pika 3, me shkresën nr.23277/2, datë 09.12.2020, nga autoriteti kontraktor DPT është dërguar në ABP, formulari i njoftimit të kontratës së lidhur.

Zbatimi i kontratës nr.2 menumër protokolli23621/4 datë 22.12.2020

Janë hartuar procesverbalet midis Autoritetit Kontrktor DPT dhe operatorit ekonomik ñAò ShPK ku janë përshkruar identifikimi i difekteve të nevojshme për 7 mjete. Me shkresën nr. 23621/1, datë 14.12.2020, ñFtesë për ofertë, DPT i është drejtuar OE ñAò ShPK për të paraqitur ofertën për riparimin e 7 mjeteve, ku janë përcaktuar nevoja për shërbim (sipas procesverbalit të hartuar midis dy pakëve) dhe sasi e këtyre nevojave. Me shkresën nr. 23621/2, datë 15.12.2020, OE ñAò shpk ka paraqitur ofertat, në të cilat çmimet janë të njëjta me ofertën ekonomike.

Përpara lidhjes se kontratës, ofertuesi fitues ka bërë sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës totale tëkontratëspërfshireTVSh,menr.serial02256079datë22.12.2020.

Në datën 22.12.2020 autoriteti kontraktor DPT ka lidhur me kontraktuesin e shpallurfitues, kontratën nr.2 menr. 23621/4 prot., me vlerën 1,628,640 lekë (me TVSH), përshërbimin eparashikuara,nëpërputhjemedokumentetetenderitdheofertënfituese.

Në nenin nr.9 të kontratës është parashikuar se koha maksimale e qëndrimit të makinave në riparim nuk duhet të kalojë 7 ditë (pune) pas lidhjes së kontratës..

Kontraktuesi ñAò ShA, nga datat 22,23,24.12.2020 ka bërë dorëzimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor DPT, duke respektuar afatin 7-ditorngadataelidhjessekontratës së parëpërlëvriminemallravetepërcaktuaranënenin9,pika 9.8.

Personi i autorizuar z.E Ç, në datën 15.12.2020 ka mbajtur procesverbalin për marrjen në dorëzim të makinave që ju është kryer shërbimi sipasfaturavetatimore.

Rekomandimi 2: Komiteti i Përmbushjes, në përputhje me parimet e administrimit tatimor *për arritjen e efiçencës dhe efektivitetit të duhur*, nëpërmjet strukturave përgjegjëse në DPT, të vlerësojë metodologjinë e shpërndarjes së planit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve për çdo Drejtori Rajonale Tatimore, me qëllim përmirësimin e saj në funksion të një shpërndarje të drejtë të planit dhe në raport me mjedisin e biznesit ku DRT-re operojnë, ndryshimet që ato pësojnë si dhe burimeve njerëzore që këto drejtori kanë në dispozicion.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Komiteti i Përmbushjes në DPT

Përgjigja e Subjektit: Metodologjia e shpërndarjes së planit në nivel DRT, bazuar në të dhënat historike për çdo DRT përfshin në vetvete të gjithë faktorët që ndikojnë në realizimin e të ardhurave, si nr. i tatimpaguesve aktiv, të punësuarit, tipologjinë e biznesit etj. Lidhur me burimet njerëzore që ka në dispozicion çdo DRT ky nuk është një indikator që duhet marrë në konsideratë pasi mungesa e stafit në një DRT nuk parashikon që të ketë dhe ulje të ritmit të realizimit të të ardhurave në një kohë kur AT shumë funksion të saj i ka të zhvilluara me sisteme on line.

Statusi: *Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar nga subjekti.*

Rekomandim 3: Në funksion të hartimit të strategjive për miradministrimin fiskal, bazë për programimin e të ardhurave tatimore, brenda kuadrit të misionit të saj, DPT të shqyrtojë mundësinë e rritjes së kapaciteteve për ngritjen e një njësie mirëfilli për përgatitjen e statistikave të plota, koherente dhe në funksion të kryerjes së analizave mbi bazë risku të të ardhurave tatimore sipas komponentëve ndikues, duke maksimizuar mundësitë raportuese që sistemi C@TS ofron.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Kontabilitetit, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

Përgjigja e Subjektit: Ky rekomandim për Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës është i pa zbatueshëm**.** DPT nuk është strukture qe programon te ardhura e buxhetit te shtetit . Është MFE me strukturat e saj , Drejtoria e Harmonizimit Fiskal, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dheçështjeve Fiskale e cila ka ketë detyre funksionale. DPTmbështet MFE me te dhëna historike te cilat janë ne sistemin tatimor E tax për çdo lloj te ardhure. DKS për çdo muaj kryen analiza ne nivel tatimi dhe sipas sektorëve te ekonomisë te cilat i vihen ne dispozicion MFE . Kjo drejtori disponon të dhëna historike lidhur me treguesit statistikorë në vite. Me funksionin e sistemit të ri tatimor në Janar 2015 janë në sistem dhe lehtësisht të aksesueshme nga çdo përdorues sistemi për subjekte të veçanta apo me gjenerim

raportesh nga drejtoria IT në DPT për një numër të caktuar apo të gjithë tatimpaguesit. Të dhënat në sistem janë dinamike, referuar ligjit për procedurat tatimore i cili parashikon që një tatimpagues ka të drejtë të vetë korrigjojë deklaratat disa herë brenda 36 periudhave. Referuar strukturës organizative të ATQ çdo drejtori në DPT ka në varësi të saj sektorë analize sipas objektit të punës së saj. DKS ofron të dhëna statistikore çdo drejtorie në DPT sa herë ato paraqesin kërkesa.
Statusi: *Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar nga subjekti.*

Rekomandimi 4.1: MFE dhe DPT, të marri masa për të respektuar afatet ligjore të parashikuara në lidhje me ndryshimet në legjislacionin tatimor të cilat parashikohen se do të kenë një efekt në arkëtimin e të ardhurave buxhetore për vitin pasardhës. Këto në funksion të informimit në kohë të tatimpaguesve si dhe të një vlerësimi sa më të drejtë të impaktit të këtyre ndryshimeve në planin e të ardhurave tatimore. Në vijim, për çdo ndryshim ligjor DPT duhet të përgatisë jo vetëm njoftimet informuese por edhe dokumente sqaruese për tatimpaguesit me qëllim zbatimin e saktë të këtyre ndryshimeve nga ana e tyre.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin:
Drejtoria Teknike dhe Ligjore
Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve
(Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë).
Përgjigja e Subjektit: Strukturat përkatëse në DPT-ë për çdo ndryshim të legjislacionin tatimor përditëson njoftimet e saj në faqen zyrtare. Gjithashtu ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për informimin e tatimpaguesve duke publikuar në vijueshmëri sqaruese dhe vendime teknike. DPT-ja me strukturat e saj angazhohet të përditësojë çdo ndryshim ligjor ne vijim , që prek interesat e tatimpaguesve.
Statusi:*Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar nga subjekti.*

Rekomandimi 4.2: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT në bashkëpunim me DRT-re që administrojnë subjektet e evidentuara, të iniciohet verifikimi i grup- tatimpaguesve që kanë aplikuar shkallën e TVSH-së 10%, me qëllim vlerësimin dhe sistemimin e situatës së tyre tatimore si dhe verifikimin subjekteve që kanë aplikuar shkallën e reduktuar të tatimit mbi fitimin 5% jo në përputhje me Ligji nr.94/2018 datë 03.12.2018 dhekriteret e përcaktuara në VKM nr.730 datë 12.12.2018.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin Drejtoria e Kontrollit Tatimor Drejtoritë Rajonale Tatimore (*Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. P. S)*
Për zbatimin e këtij rekomandimi është hartuar shkresa nr. 2125, datë 14.04.2021, ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitò e cila ngarkon të gjitha Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT që në zbatim të ligjit nr. 92/2014, ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në RSHò i ndryshuar dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ñPër tatimin mbi të Ardhurat,ò i ndryshuar si dhe VKM nr. 730, datë 12.12.2018, të organizojë menjëherë punën si dhe të verifikojnë të gjithë subjektet që kanë zbatuar shkallë të reduktuar 6% dhe 10 % për TSH-në dhe 5 % për tatimin mbi fitimin që nga 1 janari 2019. Verifikimi do të bëhet nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, sipas ndarjes intervale të tatimpaguesve. Në rast konstatimi të parregullsive në deklarim, të propozohet menjëherë kryerja e kontrolleve të plota tatimore ne tatimpaguesit respektivë. Lidhur me ndjekjen dhe realizimin e kësaj detyre, do të raportohet në DKT në DPT brenda datës 10 të çdo muaji deri në përfundim të procesit. Raportimi do të kryhet nga Drejtori i Kontrollit Tatimor ne DRT.

Për sa më sipër konstatohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht sepse është dërguar vetëm shkresa e cituar sa më sipër dhe nuk ka të dhëna nga DRT mbi rezultatet e kontrolleve të kryera si dhe të dhëna për ndjekjen e zbatimit të tyre.
Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi*

Rekomandimi 4.3: Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit në DPT të analizojë menjëherë deklarimet historike të tatimpaguesve të cilët kanë aplikuar shkallët tatimore të reduktuara të TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin 5%, të hyra në fuqi më 01.01.2019 dhe përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në VKM, me qëllim përfshirjen e tyre në prioritetet e planeve të kontrollit tatimor për vlerësimin e saktësisë së deklarimeve.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin:

- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut
- Drejtoria e Kontrollit Tatimor
- Drejtoritë Rajonale Tatimore

(Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. P. S.)
Për zbatimin e këtij rekomandimi është hartuar shkresa nr. 2125, datë 14.04.2021, ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitò e cila ngarkon të gjitha Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT që në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2018, ñPër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar , neni 114/1, të ri verifikojë mos pagimin e kësteve të parapagimit të Tatimin mbi Fitimin për vitin 2019, 2020 si dhe mos aplikimin e gjobës në masën 10 %. Verifikimi do të bëhet nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, sipas ndarjes intervale të tatimpaguesve. Në rast konstatimi të parregullsive në deklarim, të propozohet menjëherë kryerja e kontrolleve të plota tatimore ne tatimpaguesit respektivë. Lidhur me ndjekjen dhe realizimin e kësaj detyre, do të raportohet në DKT në DPT brenda datës 10 të çdo muaji deri në përfundim të procesit. Raportimi do të kryhet nga Drejtori i Kontrollit Tatimor ne DRT.
Për sa më sipër konstatohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht sepse është dërguar vetëm shkresa e cituar sa më sipër dhe nuk ka të dhëna nga DRT mbi rezultatet e kontrolleve të kryera si dhe të dhëna për ndjekjen e zbatimit të tyre.
Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*
Rekomandimi 5: Strukturat përgjegjëse në MFE: Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit në DPT, të shqyrtojnë klasifikimet aktuale në raportimet e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore për qëllime të raportimit fiskal, në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin:
Strukturat përgjegjëse në MFE (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit) në bashkëpunim me
Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT
Përgjigja e Subjektit: Ky rekomandim për Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës është i pazbatueshëm. Plani kontabël i ka të mirë përcaktuara klasifikimet e të ardhurave nuk ka vend për rishikim.
Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar nga subjekti.

Rekomandim 6: Strukturat përgjegjëse në DPT, udhëhequr nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe strukturat e kontrollit tatimor të marrin menjëherë në analizë situatën tatimore të grup tatimpagues me impakt në të ardhurat e tatimit mbi fitimin, ndryshimet në deklarimet historike të këtyre subjekteve por edhe situatën e tyre lidhur me gjendjen debitorë dhe kreditore të mbartur, duke i dhënë prioritet analizës dhe vlerësimit të riskut të subjekteve që operojnë në sektorin e prodhimit (energjetik) dhe atë të ndërtimit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Menaxhimit të rriskut, Drejtoria e Kontrollit Tatimor (*Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. O. C. dhe z. A. Ç.*

Për zbatimin e këtij rekomandimi nga ana DKT në bashkëpunim me DMR në DPT, subjektet të cilat kryejnë aktivitet në fushën e ndërtimit janë përfshinë në planin e kontrollit operacional në muajit Korrik-Dhjetor 2020, ndërsa për subjektet në fushën e energjisë janë përfshirë në planet e kontrollit te vitit 2021. Për sa më sipër konstatohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht sepse nuk ka të dhëna të plota mbi numrin e subjekteve të përfshira në kontroll të ndara sipas DRT, ose më konkretisht çfarë është realizuar nga bashkëpunimi me DMR gjithashtu nuk ka të dhëna mbi rezultatet e kontrolleve të kryera si dhe të dhëna për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

Rekomandimi 7.1: Drejtoria e Kontrollit Tatimor në bashkëpunim me AKSHI-n në cilësinë dhe përgjegjësinë e shërbimit TI për DPT, të verifikojë procedurat e implementuara në sistem për gjenerimin e kështit të ri të tatimit mbi fitimin, pas deklarimeve të 31 Marsit.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, në bashkëpunim me AKSHI (*Nuk ka inspektor përgjegjës të ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi).*

Për zbatimin e këtij rekomandimi nga ana e DKT nuk është marrë asnjë masë konkrete me pretendimin se është i pazbatueshëm për arsye e gjenerimi i kësteve ndodh në mënyrë automatike dhe ka rregulla të përcaktuara nga grupi i punës. Gjenerimi i kësteve të tatimit mbi fitimin ka rregulla të mirë përcaktuara dhe të implmentuara në sistem, të cilat gjenerohen automatikisht pas dorëzimit të deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin.

Statusi: *Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar nga subjekti.*

Rekomandimi 7.2: Titullari i DPT të vlerësojërregullshmërinë e procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për rishikimin e kësteve të tatim fitimit në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Auditit të Brendshëm

Përgjigja e subjektit: Do të planifikohet për auditim Drejtoria e Kontrollit Tatimor këtu, me qëllim realizimin e auditimit: "Mbi vlerësimin e rregullshmërinë së procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për rishikimin e këstëve të tatim fitimit në përeputhje me nenin 30 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të Ardhuratò, i ndryshuar.".

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar nga subjekti.

<u>Pretendim i subjektit të audituar</u>: Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga auditimi i mëparshëm, në lidhje me rekomandimin 7.2, Drejtoria e Auditit të Brendshëm sqaron se, ky rekomandim ka lidhje me rekomandimin 7.1 "Drejtoria e Kontrollit Tatimor në bashkëpunim me AKSHI-n në cilësinë dhe përgjegjësinë e shërbimit TI për DPT, të verifikojë procedurat e implementuara në sistem për gjenerimin e kështit të ri të tatimit mbi fitimin, pas deklarimeve të 31 Marsit", rekomandim i cili rezulton i papranuar nga struktura përgjegjëse

DKT, në këto kushte dhe rekomandimi 7.2 i cili ka lidhje me rekomandimin 7.1 nuk është realizuar. Por nga DAB do të planifikohet për auditim DKT në DPT ku krahas fushave të tjera do të kihet në konsideratë dhe rekomandimi i dhënë.

Rekomandim 8.1: Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT duhet menjëherë të evidentojë për çdo DRT rastet në numër dhe vlerë gjobash të pa aplikuara, duke identifikuar inspektorët përgjegjës për çdo rast si dhe të vendosi sistemet e nevojshme të kontrollit për evidentimin dhe raportimin periodik me qëllim shmangien në të ardhmen të shkeljes së konstatuar.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizimin*: Drejtoria e Kontrollit Tatimor (Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. A. G. dhe z. N. K).*

Për zbatimin e këtij rekomandimi është hartuar shkresa nr. 2125, datë 14.04.2021, ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitòlidhur me dy çështjet e ngritura aty, ku ngarkohet DK në gjithë DRT-të :

a- të organizojnë menjëherë punën dhe të verifikojnë të gjithë subjektet që kanë zbatuar shkallë të reduktuar 6% dhe 10% për TVSH-në, si dhe 5% për Tatimin mbi Fitimin, që nga 1 Janar 2019. Verifikimi do të bëhet nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, sipas ndarjes së intervaleve të tatimpaguesve. Në rast konstatimi të parregullsive në deklarim, të propozohet menjëherë kryerja e kontrolleve të plota tatimore, në tatimpaguesit respektivë.

b- ngarkohet Drejtoria e Kontrollit Tatimor, në gjithë DRT-të, që në zbatim të nenit 30, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998, ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2018, ñPër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar, neni 114/1, të ri verifikojnë mospagimin e kësteve të parapagimit të Tatimit mbi Fitimin për vitin 2019, 2020, si dhe mos aplikimin e gjobës në masën 10%. Verifikimi do të bëhet nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, sipas ndarjes së intervaleve të tatimpaguesve. Në përfundim të verifikimit, të evidentohen rastet në numër dhe vlerë gjobë të pa aplikuara, si dhe personat përgjegjës!

Për sa më sipër konstatohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht sepse është dërguar vetëm shkresa e cituar sa më sipër dhe nuk ka të dhëna nga DRT mbi rezultatet e kontrolleve të kryera si dhe të dhëna për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

Rekomandimi 8.2. Titullari DPT të urdhërojë ngritjen e një grupi pune për identifikimin dhe evidentimin e procedurave që ekzekutohen manualisht në sistemin C@TS, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së kontrolleve të aplikacionit në formën e njoftimeve automatike sinjalizuese dhe raporteve të posaçme, plotësimin e gjurmës së auditimit së dhe çdo masë tjetër të nevojshme për sigurimin e zbatimit të ligjit në përputhje me parimet e shprehura në të *"Për zbatimin e njëjtë dhe efektiv nga ana e administratës tatimore".*

Struktura përgjegjëse për realizimin: Kabineti, Drejtoria e Proceseve të Biznesit.

Përgjigja nga subjekti: Drejtoria për Proceset e Biznesit ka përfshirë këtë rekomandim tek planit operacional 2021, roli i Drejtorisë së Proceseve të Biznesit si pjesë e Strukturës së DPT, është në funksion të evidentimit, përmirësimit dhe implementimit të proceseve të automatizuara me qëllim rritjen e efektivitetit të punës, matjen e treguesve cilësorë dhe sasiorë, uljen e rasteve abuzive dhe unifikimin e procedurave, harmonizimin e të dhënave për raportim për kontroll sa më efikas. Sipas këtij rekomandimi janë përcaktuar aktivitetet dhe nënaktivitet për zbatim sa më të mirë të këtij rekomandimi.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

Rekomandimi 9: DPT me strukturat e saj përgjegjëse: DKT dhe Drejtorinë tekniko-ligjore duhet menjëherë të hartojnë një procedurë për rakordimin periodik të detyrimeve të gjyq

fituesve, në numër dhe vlerë detyrimi, me qëllim pasqyrimin e saktë dhe në kohë të situatës së tatimpaguesve në funksion të raportimit koherent të dhe gjendjes së debitorëve në C@TS.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Teknike dhe Ligjore *(Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. J. Sh. dhe z. B. B.).*

Për zbatimin e këtij rekomandimi sipas informacionit të dhënë janë evidentuar rastet në proces gjyqësor por ende nuk është punuar për një procedurë ligjore.

Për sa më sipër nga të dhënat konstatohet se rekomandimi është pranuar dhe realizuar pjesërisht sepse nuk paraqiten të dhëna se kush janë subjektet e evidentuara në proces gjyqësor si dhe nuk është punuar për përcaktimin e procedure ligjore.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

Rekomandimi 10: DPT me strukturat e saj përgjegjëse: Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike të urdhërojë menjëherë kryerjen e një verifikimi për identifikimin e plotë të numrit të subjekteve në proces gjyqësor dhe vlerën e detyrimit respektiv të regjistruar në C@TS nga inspektorët e kontrollit por të kundërshtuar nga subjekti. Për çdo pasaktësi të konstatuar të sistemohet situata e tatimpaguesit dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Kontrollit Tatimor Drejtoria Teknike dhe Ligjore *(Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. J. Sh. dhe z. B. B.).*

Për zbatimin e këtij rekomandimi sipas informacionit të dhënë janë evidentuar rastet në proces gjyqësor por ende nuk është punuar për një procedurë ligjore.

Për sa më sipër nga të dhënat konstatohet se rekomandimi është pranuar dhe realizuar pjesërisht sepse nuk paraqiten të dhëna se kush janë subjektet e evidentuara në proces gjyqësor si dhe nuk është punuar për përcaktimin e procedure ligjore.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.*

Në lidhje me akt konstatimin nr. 2, ku janë trajtuar rekomandimet e mësipërme nga audituesi A. Z., nga DPT është paraqitur observacioni me nr 8715/17 datë 18.08.2021 (të dhëna të DPT), prot në KLSH me nr. 513/4, datë 20.08.2021 i cili ka të bëjë me saktësimin përkatësisë së përgjegjësisë nuk qëndron sepse duhet bashkëpunuar me DRT për të patur të dhëna të plota mbi ecurinë e proceseve gjyqësore deri në përfundimin e tyre.

Rekomandimi 11: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me strukturat e saj përgjegjëse të kryej menjëherë verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin të evidentuara sa më lartë, me qëllim vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së shumës së rimbursuar subjektit.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Auditit të Brendshëm

Përgjigja e Subjektit: Do të rishikohet plani vjetor i auditimit dhe planifikimi për auditim "Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për rastet e rimbursimit të shumave kreditore të tatimit mbi fitimin të evidentuara".

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar

Rekomandimi 12: Nga strukturat përgjegjëse në DPT të kryhet verifikimi dhe sistemimi i shumave të paguara pa u shoqëruar me një deklaratë detyrimi tatimor dhe të pa sistemuara në periudhat pasardhëse. Drejtoria e Kontrollit Tatimor në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të hartojë një procedurë/udhëzues për rakordimin periodik të

këtyre pagesave duke shmangur kështu rritjen artificiale të ardhurave dhe detyrimit kreditor të administratës tatimore.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës.

Për zbatimin e këtij rekomandimi nga ana e DKT nuk është marrë asnjë masë konkrete me pretendimin se është i pazbatueshëm për arsye se sistemi tatimor i përdor pagesat në mënyrë automatike dhe nuk ka vend për sistemime manuale.

Statusi:*Rekomandimi i pa pranuar dhe i pa zbatuar*

Rekomandimi 13: Drejtoria tekniko-ligjore të publikojë një material sqarues në vijim të Udhëzimit nr. 12 datë 15.03.2019 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò, i ndryshuar për të shpjeguar dhe ilustruar plotësimin deklaratës për të ardhurat në burim. DPT në bashkëpunim me MFE të marrë në konsideratë propozimin për ndryshimin e deklaratës për të ardhurat në burim për të shtuar rubrikën ñ të ardhura nga veprime me aksionetò për të shmangur kështu raportime të gabuara në llogarinë 7009100.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria Teknike dhe Ligjore (në bashkëpunim me MFE)

Përgjigja e Subjektit: Ky rekomandim nuk mund të zbatohet pasi shitja e aksioneve nuk është tatim në burim. Në nenin 33 ñMbajtja e Tatimit në Burimò, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, nuk është përcaktuar shitja e aksioneve për mbajtjen e tatimit në burim, por parashikohet vetëm si e ardhur e tatueshme në nenin 8 të ligjit të sipërcituar.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar*

Rekomandimi14: Struktura përgjegjëse në DPT të analizojë të dhënat historike të deklarimit të numrit të punonjësve dhe pagave, me qëllim identifikimin e grup-tatimpaguesve me risk për deklarime fiktive, me qëllim hartimin e strategjive dhe planeve të kontrolleve tatimore të dedikuara për sektor të caktuar të ekonomisë të karakterizuar nga një nivel i lartë informalizteti.

Afati:Menjëherë dhe në vijimësi

Struktura përgjegjëse për realizimin: Drejtoria e Menaxhimit të Riskut

Për realizimin e këtij rekomandimi, konstatohet se Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka bërë letër të personalizuar drejtuar punëmarrësve dhe punëdhënësve duke vënë në dukje profesione më paga me të ulëta.

1 - (Shtator 2019) Nga analiza e të dhënave të listë pagesave të dorëzuara është evidentuar risku i nën deklarimit të pagave. Janë identifikuar 33 profesione të ndryshme për të cilat nga analiza e kryer mbështetur në të dhënat e disponueshme si dhe informacione të tjera, është arritur në konkluzionin që tatimpaguesit nuk deklarojnë nivelin real të pagave të punonjësve të tyre. Si fazë e parë e strategjisë së trajtimit, është përcaktuar dhe realizuar, dërgimi i letrave të personalizuara si për punëdhënësit (tatimpaguesit) ashtu dhe punëmarrësit si nëpërmjet postës ashtu dhe në llogarinë elektronike në sistemin C@TS për tatimpaguesit. U dërguan letra për 19.229 raste (punonjës) ne te cilat ju kërkohej qe te deklaronin nivelin real të pagës për punonjësit e tyre dhe nga ana tjetër punëmarrësve ju kërkohej që të kërkonin deklarimin real të pagës së tyre nga punëdhënësi. Numri më i lartë i rasteve/ punonjësve për të cilat është dërguar letër i përket profesioneve: Drejtor, Ekonomist, Inxhinier, Shofer, Kuzhinier, Farmacist etj.

2 - (Mars OSE Shkurt 2020) Në bashkëpunim me Bankën Botërore u mor nisma për dërgimin e letrave të personalizuara për 3.618 punëdhënës nga të cilat për 1.809 u dërgua një letër me përmbajtje mesazhi "SOFT" dhe për 1809 të tjerë "STRONG". Në letër ju kërkohej TP që të deklaronin pagën reale për punonjësit e tyre dhe u bëhej me dije që ata do të jene nën vëzhgimin e administratës tatimore në lidhje me këtë fakt. Gjithashtu ju dërgua letër e personalizuar edhe punëmarrësve në lidhje me këtë fenomen dhe nxiteshin që të kërkonin deklarimin real të pagës së tyre nga punëdhënësi.
3 - (Korrik 2020) Nga analiza e të dhënave të listë pagesave të dorëzuara për vitin 2019 u vlerësuan me risk ata tatimpagues që kanë deklaruar pagën 1 Lek për punonjësit e tyre si dhe ata TP që rezultojnë të kenë lëvizje të shpejta të Esig-027. Për këto TP u vendos që të dërgohej letër e personalizuar ku ju citohej fakti që administrata tatimore ka vërejtur se ata rezultojnë të kenë lëvizje të shpejta të Esig-027 apo që është konstatuar që deklarojnë punonjës me 1 lek në LP dhe ju kërkohej që të reflektonin në deklarimin real të pagave për punonjësit e tyre. Në total u dërguan 4.495 letra nga të cilat 3.451 TP që rezultojnë të kenë deklaruar Paga= 1 Lek , 964 TP që rezultojnë të kenë lëvizje të shpejta të Esig-027 dhe 80 TP që rezultojnë të kenë paga 1 Lekë & Lëvizje të shpeshta të Esig-027.
4 - (Gusht 2020) Nga analiza e pagave të deklaruara në muajin qershor 2020 u vlerësuan si paga me nën deklarim të gjitha pagat për profesionet inxhinier, ekonomist, farmacist, mekanik, murator, saldator, teknik etj., në vlerën 26 000 leke (në nivelin e pagës minimale). Në total u identifikuan 5 359 tatimpagues dhe 10 785 punonjës, por 89 tatimpagues të DTM-së u kthyen mbrapsht nga kjo e fundit pasi në qershor ishin kontaktuar edhe një herë nga DTM-ja për nivelin e ulët të fondit të pagave. U nisen 5 270 letra për punëdhënësit dhe 10 170 letra për punëmarrësit në të cilat ju kërkohej që të deklaronin nivelin real të pagës për punonjësit e tyre dhe nga ana tjetër punëmarrësve ju kërkohej që të kërkonin deklarimin real të pagës së tyre nga punëdhënësi.
Statusi realizuar

Rekomandim 15: Ndryshimi ligjor i parashikuar për deklarimin e DIVA, i cili duke filluar nga viti 2020 do të prekë një fashë dhe profil më të gjerë individësh, duhet të trajtohet me risk të shtuar jo vetëm në lidhje me ndërgjegjësimin për deklarim por veçanërisht për kompleksitetin dhe vështirësitë në plotësimin e deklaratës e cila duhet të shoqërohet me njoftime sqaruese nga Drejtoria tekniko-ligjore, specifikisht në rubrikën e të ardhurave nga dy punësimi ku individit deklarues i lind detyrimi të bëjë vetë rillogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Brenda vitit 2020

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria Teknike dhe Ligjore Drejtoria e Proceseve të Biznesit.
Përgjigja e subjektit: Kyrekomandim është zbatuar pasi është mundësuar elektronikisht rillogaritja e tatimit për tu paguar (fusha 4), si dhe tatimi i paguar (fusha 22). Individi deklaraues duhet të plotësojë vetëm fushat e tjera nëse ka të ardhura të tjera të ndryshme nga punësimi.
Statusi:*Rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*
Rekomandim 16: DPT me strukturat e saj përgjegjëse, të urdhërojë ngritjen e një grupi pune me objektiv rakordimin e të dhënave për borxhin tatimor të raportuar, konsideruar këtu të gjitha problematikat e trajtuara në këtë auditim në lidhje me saktësinë e detyrimeve të subjekteve të lindura nga aktet administrative, procedurat e anulimeve/sistemimeve, vlerën e borxhit të pritshëm nga proceset gjyqësore në proces si dhe evidencat e borxhit të cilësuar ñjashtë sistemitò.

Afati: Brenda vitit 2020

Strukturë përgjegjëse për ndjekjen e tij, është caktuar Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Drejtoria e Kontrollit Tatimor dhe Drejtoria Teknike dhe ligjore.
Komentet në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi:
Nga DMDTP, e cila është një ndër strukturat përgjegjëse caktuar për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit **nuk është pranuar** ndjekja e këtijrekomandimi, me arsyetimin se: ñ*Ky rekomandim është i pazbatueshem nga kjo drejtori dhe nuk mund të pranohet, pasi* DMDTP*është përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese në përputhje me Ligjin Nr.9920, 19.05.2008 i ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij dhe jo për saktësimin e detyrime tatimore. Lidhur me detyrimet e subjekteve, të lindura nga aktet administrative, sistemi C@ts ne zbatim te Ligjit Nr.9920, 19.05.2008 i ndryshuar, neni 79, rregullon radhën e pagesës se detyrimeve. Si shkak i këtij rregulli, identifikimi i detyrimeve të subjekteve, të lindura nga aktet administrative nuk mund te realizohet ne mënyrë shteruese. Sa i përket vlerës se detyrimit tatimor te papaguar të pritshëm nga proceset gjyqësore në proces, është një e dhëne qe DMDTP ne rajone e administron ne baze te te dhënave te dërguara zyrtarisht nga Sektorët Juridik/Drejtoria Ligjore dhe Teknike, e cila nuk është në varësi të DMDTP-se. Edhe evidencat e detyrimeve tatimore te papaguara, të cilësuara "jashtë sistemit" janë te dhëna qe gjejnë pasqyrim ne kontabilitet, strukture jo ne varësi te DMDTP*-seò.
Statusi zbatimit të rekomandimit .
Statusi:*Rekomandimi i pa pranuar dhe i pa zbatuar.*

Rekomandim17: Ekipi i Menaxhimit të programit 01140 ñMenaxhimi i të ardhurave tatimoreò dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, duhet të marrin masa për identifikimin e drejtë të objektivave dhe produkteve të programit si në kuadër të buxhetimit afatmesëm ashtu dhe në atë të buxhetimit vjetor, me qëllim programimin real të shpenzimeve buxhetore sipas nevojave reale të institucionit, duke orientuar përdorimin e shpenzimet publike drejt efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.

Afati: Në vijimësi

Struktura përgjegjëse për realizim: Ekipi i Menaxhimit të programit të Fondeve Buxhetore (EMP).

Në gjetjen që shoqëron rekomandimin është evidentuar se vlera e parashikuar për vendime gjyqësore është më e ulët se vlera reale e nevojave të DPT, anomali e cila është konstatuar edhe gjatë këtij auditimi. Gjithashtu janë konstatuar gjatë procesit të auditimit edhe detyrime të pa likuiduar për projekte të iniciuara para vitit 2020.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi*

Rekomandim 18: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore të marrin masa që procesi i inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të bëhet sipas përcaktime ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që raportohet në pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Afati: Në vijimësi

Struktura përgjegjëse për realizim: Grupi i punës për nxjerrjen jashtë përdorimi për sa parashikohet në aktkonstatimin përkatës dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për përmirësimin e situatës në vijim.

Gjatë procesit të auditimit aktual nuk janë nxjerrë aktive jashtë përdorimit. Në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit janë konstatuar anomali të cilat janë trajtuar në aktin e konstatimit.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi*

Rekomandim 19.1: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të menjëhershme për raportimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, në Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë të detyrime të prapambetura, të cilat lidhen me detyrimet për vendime gjyqësorë përfshirë detyrimet për vendimet gjyqësore për subjektet tatimpaguese, stokun e rimbursimit të TVSH-së si dhe detyrime të tjera të institucionit.

Afati: Menjëherë

Struktura përgjegjëse për realizim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

- Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së

Përgjigja e subjektit: Mbi njohjen e detyrimeve të prapambetura është vepruar në zbatim të VKM nr. 37, datë 6.10.2020 ku i janë përcjell Degës së Thesarit Tiranë, janë regjistruar në SIFQ, dhe janë përcjell edhe në rrugë shkresore. Zbatimi i kësaj VKM ï je do të jetë detyrë e vazhdueshme e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës për çdo muaj. Detyrimet e prapambetura deri në Dhjetor janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 252 prot., datë 08.01.2021. Nga auditi u konstatua se stoku i rimbursimit të TVSH nuk është raportuar në MFE ne listën e detyrimeve të prapambetura.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi*

Rekomandim 19.2: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat të menjëhershme për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e data bazën e vendimeve gjyqësore për tatimpaguesit si dhe të njohë dhe kontabilizojë në pasqyrat financiare të vitit 2020, detyrimeve të prapambetura për këto vendime gjyqësore, mbi bazën e parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Afati: Në raportimin financiar për vitin 2020

Struktura përgjegjëse për realizim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Përgjigje nga subjekti: DFB ka qenë shumë e saktë n ë regjistrin e vendimeve gjyqësore ku deri më sot nuk ka asnjë ndryshim rendor të vendosur te vendimeve gjyqësore. Kjo vërtetohet edhe me likuidimet e bëra në muajin Korrik 2020 ku në asnjë moment nuk ka pasur qasje mbi renditje të gabuar të vendimeve gjyqësore. Kjo e konfirmuar edhe me rakordim shkresor dhe përcjellë për dijeni. Mbi njohjen e detyrimeve të prapambetura është vepruar në zbatim të VKM 37, datë 6.10.2020 ku janë përcjellë Degës së Thesarit Tiranë, janë regjistruar në SIFQ, dhe janë përcjellë edhe ne rrugë shkresore.

Komente të audituesit: Nga vendimet gjyqësore të lëna nga auditimi i mëparshëm janë kontabilizuar, por nga kërkesa që është bërë drejtorisë ligjore për vendimet gjyqësore të subjekteve është marrë përgjigje se këto vendime nuk kalohen në financë, por vetëm vendimet gjyqësore për punonjësit.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Rekomandim 19.3: Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës të marrin masa për klasifikimin e stokut të rimbursimit të TVSH-së në llogarinë 486 ñShpenzime për periudhat e ardhshmeò, me qëllim paraqitjen e saktë, të drejtë dhe të plotë të detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në raportimin financiar për vitin 2020

Struktura përgjegjëse për realizim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH

Përgjigje nga subjekti Stoku i rimbursimit nuk lidhet në mënyre absolute me DFB pasi DFB raporton në nivel shpenzues dhe në asnjë moment nuk ka asnjë qasje me Dr. e rimbursimit. Llogaria 486 ne kontekstin e shpenzimeve pra DFB ndryshon ne kontekstin si e ardhur pra klasa 6 ndryshon me klasën 7, ndaj nuk duhet te jete rekomandim për DFB.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar*

Rekomandimi 20: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë duhet të marrin masa për të përcaktuar skemën e kontabilizimit të veprime rregulluese për llogarinë 466 óKreditorë për

mjete në ruajtjeô dhe llogarinë 520 óDisponibilitete në thesarô me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të mjeteve disponibël në Thesar dhe detyrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj tatimpaguesit kreditor për tatimin mbi fitimin e mbi paguar.
Struktura përgjegjëse për realizim: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës.
Statusi:*Rekomandimi nuk është pranuar nga subjekti dhe nuk është realizuar*

Rekomandimi 21: Administrata tatimore duhet të riformulojë qëndrimin e saj zyrtar, lidhur me zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore për shërbimin faktoring si shërbim i përjashtuar nga TVSH, sipas kritereve të nenit 53 Ligjit nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar dhe kritereve të nenit 41.1 të UMF nr.6, datë 30.01.2015 ñ*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*ò, i ndryshuar. Përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet vetëm kur transaksioni i kryer është njëri nga shërbimet e parashikuara në këtë dispozitë. Çdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në mënyrë eksplicite në nenin 53 të ligjit, siç është dhe shërbimi financiar faktoring, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion financiar apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-ja pasi ky trajtim fiskal nuk është shprehur qartë dhe në mënyrë shteruese ne nenin 53 të 92/2014 ñPër tatimin mbi Vlerën e Shtuarò.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria Teknike dhe Ligjor
Përgjigja e Subjektit: Lidhur me qëndrimin zyrtar, për zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore për shërbimin faktoring si shërbim i përjashtuar nga TVSH do te zbatohet me korrektësi.Duke qënë se ky trajtim fiskal nuk është shprehur qartë në mënyrën shteruese në nenin 53 të ligjit 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuarò, në vijmësi në komunikimin shkresor me tatimpaguesit do të shprehim se: ñÇdo transaksion tjetër që nuk është i shprehur në mënyrë eksplicite në nenin 53 të ligjit, pavarësisht nëse është furnizuar nga një bankë ose institucion apo është furnizuar për një bankë ose institucion financiar, nuk përjashtohet nga TVSH-jaò.
Statusi:*Ky rekomandim konsiderohet i pranuar i realizuar.*

Rekomandimi 22: Administrata tatimore duhet të riformulojë qëndrimin e saj zyrtar, lidhur me zbatimin në praktikë për interesat e lindura dhe të paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 për të ardhurat nga interesat në momentit të pagimit të interesave në ditën e pagimit në ñcashò ose në ditën e maturimit apo rikapitalizimit të tyre, njësoj si veprohet nga Bankat apo institucionet e tjera financiare, të cilat deklarojnë dhe paguajnë në organin tatimor tatimin mbi interesat jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës, maturimit apo rikapitalizimit .

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria Teknike dhe Ligjore.
Përgjigja e Subjektit: Në rast se punëdhënësi ka marrë parasysh bazuar në dokumentacion investimin në total dhe ka zbatuar dispozitat e nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar, në momentin e pagesës apo maturimit të interesit Fondi i investuar llogarit, mban dhe paguan TAP. Në rast se tërhiqet dhe fondi i investuar atëherë edhe për principalin mbahet tatim. Në rastin kur nga punëdhënësi nuk është marrë në konsideratë investimi në Fond nga punëdhënësi dhe është tatuar paga bruto, shoqëria e investimit do të mbajë tatim vetëm për interesat e gjeneruara jo për fondin e investimit.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar në proces zbatimi.*

Rekomandimi 23: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të analizojnë dhe raportojnë periodikisht, pranë titullarit të institucionit, gjendjen e stokut të rimbursimit, jo vetëm në zbatimin e planit të

shpenzimeve të rimbursimit miratuar për vitin buxhetor por edhe pritshmërisë së kërkesës në vitin pasardhës, duke ruajtur nivelin e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar, si zë kryesor në të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria Rimbursimit të TVSH-së në DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit

Përgjigja e Subjektit: Ky rekomandim për Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës është i pazbatueshëm. Kjo Drejtori nuk ka në fokus të saj analizimin e stokut të rimbursimit.

Kjo Drejtori ka raportuar periodikisht çdo vit në pasqyrat financiare të DPT stokun e rimbursimit gjendje me 31 Dhjetor sipas raportimit zyrtar të DRTVSH.

DRTVSH bene raportim mujor lidhur me stokun e rimbursimit tek titullari i institucionit. Gjithashtu duke filluar nga muaji Prill 2020, ne zbatim te Urdhrit nr. 28, date 08.04.2020, përpilon dhe publikon ne Website te DPT, botimin e dedikuar tremujor per rimbursimin e TVSH-se ku evidentohen te dhëna lidhur me:

Numrin e kërkesave te trajtuar;

Numrin e kërkesave te Refuzuara;

Vlera e rimbursimit, (FIFO + Keste)

Stoku i rimursimit i detajuar.

Statusi: ***Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi***

Rekomandimi 24: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-se të kryejë rakordimet periodike mujore me degën e thesarit për rimbursimet e TVSH-se kaluar nëpërmjet SIFQ, duke hartuar Akt-Rakordim mujor me të dhënat analitike për pagesë për rimbursim dhe shumat përkatëse.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së

Përgjigja e Subjektit: DRTVSH kryen rakordime me degën e thesarit për çdo rimbursim qe dërgon ne thesar për te kaluar nëpërmjet SIFQ. Rakordimi behet me ane te komunikimit me email. Rimbursimet e rakorduar me degën e thesarit raportohen ne Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit prane DPT, çdo muaj ne nivel analitik.

Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.*

Rekomandimi 25: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të nenit 10.2 të VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 ñ*Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, të përkufizojë dhe qartësojë administratën tatimore në përkufizimin e ñEksportues me risk zeroò, pasi në procedurën e rimbursimit rezulton se i njëjti tatimpagues gjatë vitit kalendarik për çdo kërkesë rimbursimi nuk mban të njëjtin status.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Përgjigja e Subjektit: i njëjti rekomandim si për vitin 2018. Është zbatuar rekomandimi i vitit 2018 nga DRTVSH në bashkëpunim me DLT dhe është raportuar edhe shprehur në observacion për raportin e 2019. Gjithashtu DPT me propozimet për ndryshim te kërkuara ne Prill 2021, për VKM nr. 953 date 29.12.2014, Neni 10 òPërcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-sëò ka kërkuar saktësim te përkufizimit ñEksportues me rrisk zeroò.

Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar i zbatuar.*

Rekomandim 26.1: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet strukturave të saj, të hartojë Plan të Përgjithshëm Kontrolli për një vit kalendarik, i cili të miratohet brenda muajit dhjetor të vitit paraardhës. Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT të analizojë arsyet e zhvendosjes dhe moskryerjes së kontrollit operacional sipas planin të miratuar mujor/vjetor nga DPT. Pas verifikimit në drejtoritë rajonale me grup pune të ngritur për këtë qëllim të analizojë dhe marrë masat përkatëse për drejtuesit e DRT-re dhe strukturave të kontrollit në këto drejtori për mosveprim sipas planit të miratuar, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Manualin e Kontrollit Tatimor, me planin mujor të miratuar për kontroll nga DPT dhe kërkesat e Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore neni 116.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin Drejtoria e Kontrollit Tatimor Drejtoria e Menaxhimit të Riskut (*Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është znj. M. A.)*
Për zbatimin e këtij rekomandimi është hartuar shkresa nr. 7242, datë 19.04.2021, ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitò e cila citon dy rekomandimet 26.1 dhe 26.2 të KLSH si dhe ngarkon të gjitha Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT që në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2018, ñpër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar neni 80, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ñPër Tatimin mbi të Ardhuratò i ndryshuar Manualit të Kontrollit dhe rregullores së ATQ miratuar me urdhrin e ministrit të Financave nr. 19, datë 22.02.2017, të bëjë analizën mbi matjen e performancë së drejtorisë së kontrollit, duke patur parasysh e ndjekur prej tyre gjatë ushtrimit të detyrës trajtimin fiskal, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Analiza duhet të mbështetet kryesisht për sa më poshtë:

- Analizën e evidencës së kontrolleve të planifikuara dhe të realizuara, të evidentohen arsyet e zhvendosjes (shkresën e miratuar për shtyrjen e afatit, dokumentacioni për zgjatjen e afatit të kontrollit) dhe moskryerjes së kontrollit operacional sipas planit të miratuar mujor/vjetor nga DPT (në qoftë se)
- Të bëhet perfrormanca e indikatorëve të kontrollit (KPI) për çdo inspektor/punonjës të drejtorisë së kontrollit,
- Për planifikimet mujore dhe propozimet për kontroll nga ana e drejtorisë Rajonale Tatimore në zbatim të ñRregullores së Përzgjedhjes për Kontroll të Tatimpaguesveò duhet në analizën e evidencës së kontrolleve për çdo propozim të evidentohen arsyet e propozimet (shkresën për propozimet të bëra nga inspektorët e kontrollit nga zyra nr. protokollit dhe data)

Bashkangjitur përveç analizave sa më sipër po ju dërgojmë dhe evidencat që duhet të plotësoni mbi disa tregues kryesor të kontrolleve të kryera sipas periudhave (për periudhën 2019-2021)

Për sa më sipër konstatohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht sepse është dërguar vetëm shkresa e cituar sa më sipër por nuk ka të dhëna nga DRT mbi rezultatet e saj si dhe të dhëna për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi*

Rekomandimi 26.2: Drejtoria e Kontrollit në DPT të rrisë forcën zbuluese duke bërë identifikimin e gabimeve në vlerësimin nga kontrolli tatimor bazuar në vetë deklarimin e tatimpaguesit duke rritur forcën zbuluese ne vlerësim te detyrimeve tatimore dhe arkëtimin e tyre duke kontribuar në zbatimin e drejtë te ligjit me qëllim rritjen ardhurave tatimore dhe uljen në maksimum të evazionit dhe të shmangies tatimore, sipas kërkesave të Manualit të Kontrollit tatimor dhe Rregullores së Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017 nenet 116 të tij.

Afati: Në vijimësi

Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. O. C. dhe znj. M.A.

Për zbatimin e këtij rekomandimi ngrihet pretendimin se është i pazbatueshëm për arsye se Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka në funksion udhëheqjen metodologjike të Drejtorisë së Kontrollit në Rajone dhe nuk administron drejtpërdrejt tatimpaguesin. Rritja e vetë deklarimit të tatimpaguesit realizohet nga strukturat e Drejtorive Rajonale, gjithashtu rekomandimi është i pazbatueshëm, pasi DKT në DPT harton plane mbi bazën e fenomeneve te ndryshme për tu ndjekur nga Drejtoritë Rajonale.

Megjithatë sa cituara dhe më sipër në zbatimin e rekomandimit 26.1 është hartuar shkresa nr. 7242, datë 19.04.2021, ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitò e cila citon dy rekomandimet 26.1 dhe 26.2 të KLSH si dhe ngarkon të gjitha Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT, pra në këtë shkresë është cituar edhe rekomandimi 26.2, pra sa më sipër kemi dy qëndrime të inspektorëve të kontrollit.

Statusi:*Rekomandimi nuk është pranuar nga subjekti dhe rezulton i parealizuar*

Pretendim i subjektit të audituar: Në lidhje me akt konstatimin nr. 2 ku është trajtuar nga z. A. Z. zbatimi i rekomandimeve 26.1 dhe 26.2, është paraqitur observacioni me nr 8715/24 datë 23.08.2021 nga DPT e prot në KLSH me nr. 513/14, datë 25.08.2021 ku sqarojmë se në akt është trajtuar e gjithë puna e bërë nga ana e inspektorëve e cila për realizimin e rekomandimit 26.1 e cila duhet vlerësuar dhe është marrë parasysh që ky rekomandim është në vijimësi por mendojmë se ai duhet të plotësohet më të dhëna konkrete nga DRT për të kuptuar më mirë zbatimin e tij. Ndërsa qëndrimi për rekomandimin 262 nuk pranohet për arsye se argumentet për zbatimin ose jo të rekomandimit duhet të ishin dhënë më parë kur edhe kanë ardhur ato të zyrtarizuara DK dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve.

Pretendim i subjektit: Në lidhje me akt konstatimin nr. 2 ku është trajtuar nga z. A. Z. zbatimi i rekomandimeve 26.2 dhe 6, është paraqitur observacioni me nr. 513/21, datë 26.08.2021 nga DPT e prot. në KLSH me nr. 513/21, datë 30.08.2021, i cili ka ardhur jashtë afateve, por sqarojmë se eshtë përgjegjësi e strukturave të DPT që kanë caktuar me zbatimin e rekomandimeve punonjës që nuk janë më në DK, megjithëse bashkangjitur observacionit nuk ka shkresë të emërimit të z. O. C. në DRT Tiranë do të vlerësohet nga ana jonë.

Rekomandimi nr. 27: Titullari i institucionit të marrë masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar, vendosjen e rregullave dhe procedurave të qarta dhe efektive, zhvillimin e dedikuar profesional të stafit menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe menaxhimit të sistemit buxhetor, duke synuar eleminimin e dobësive të shfaqura në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Grupi i Menaxhimit Strategjik

Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 28.1: Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masat që nëpërmjet planifikimit vjetor dhe strategjik të orientojë veprimtarinë e DAB në përputhje me rolin dhe misionin për të cilin është krijuar dhe funksionon kjo strukturë dhe nëpërmjet veprimtarisë audituese të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit duke përdorur një qasje sistematike dhe të disiplinuar.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Auditit të Brendshëm

Me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm Tatimeve Nr 20410 datë 20.10.2020 është miratuar ñPlani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor 2021 për auditimin e brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeveò në hartimin e planin vjetor 2021 i bazuar në vlerësimin e riskut,

është patur parasysh misionin i DAB që jep siguri të arsyeshme Drejtorit të Përgjithshëm në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 28.2: Drejtuesi i DAB të marrë masa: a) që planet vjetore të punës të hartohen në përputhje me planet strategjike dhe në çdo rast ndryshimet të argumentohen dhe të miratohen nga titullari i institucionit. b) Në përfundim të hartimit të PRA dhe RFA, audituesit të shprehin opinionin e tyre mbi pesë komponentët e kontrollit të brendshëm sipas modelit COSO, si dhe një opinion të përgjithshëm vlerësues mbi veprimtarinë e subjektit të audituar që gjenerohet dhe analizat e plota dhe tërësore se si janë realizuar objektivat, si janë ndjekur dhe zbatuar prioritetet dhe strategjitë, si janë administruar paratë dhe aktivet. c) Të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara të menaxhimit, të vendosë një proces ndjekjeje, për të monitoruar dhe siguruar që aksionet e menaxhimit janë zbatuar në mënyrë efektive ose që menaxhimi i lartë ka pranuar rrezikun e mosveprimit. Të marrë në analizë gjendjen e rekomandimeve që aktualisht ndodhen në proces edhe pse afatet e zbatimit të tyre kanë përfunduar, duke i rivendosur ato në afat.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi
Personat përgjegjës për realizimin: Drejtuesi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm
Plani vjetor 2021 për auditimin e brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është hartuar në përputhje me Planin Strategjik vitet 2021-2023. Për çdo mision auditimi në përfundim të hartimit të PRA dhe RFA, grupi i auditimit shprehin opinionin mbi pesë komponentët e kontrollit të brendshëm sipas modelit COSO, si dhe një opinion të përgjithshëm vlerësues mbi veprimtarinë e subjektit të audituar. Procesi i monitorimi dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimi është i vazhdueshëm. Janë analizuar gjendja e rekomandimeve në proces dhe të pa realizuar.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi 29: DPT të kërkojë nga QKB, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 12420/1, datë 07.09.2017 dhe nr. 19812, datë 22.08.2017, për subjektet të cilët dhurojnë/tjetërsojnë aksione, që informacioni i dërguar elektronikisht nga QKB në DPT të identifikojë qartë elementët e ndryshimit të pronësisë në, ortakëri, numër aksionesh dhe vlerë, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për të shmangur riskun e krijimit të të ardhurave të munguara, në rastet kur tatimpaguesi nuk njofton administratën tatimore, në lidhje me ndryshimin e pronësisë.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi
Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve
Përgjigja e Subjektit: Nuk ka komente.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa realizuar.*

Rekomandimi 30: DPT të propozojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sanksionimin në germën ñaò të pikës 11 ñTransferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendoreò, të Udhëzimit nr.32 datë 31.12.2013 óPër tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogëlò, të një afati të caktuar brenda të cilit Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të derdhin në buxhetin e shtetit detyrimin për komisionin 1% të të ardhurave të grumbulluara për llogari të tyre nga DRT-të që veprojnë si agjentë tatimor.

Afati: Menjëherë
Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës

Përgjigje e subjektit: Njësive të qeverisjes vendore i transferohen 99 % e të ardhurave, 1 % të të ardhurave si agjent mbahet direkt në thesar në momentin e paraqitjes së akt-rakordimit referuar Udhëzimit nr.13 datë 06.05.2014 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr. 32 datë 31.12.2013 ñPër tatim fitimin e thjeshtuar për biznesin e vogëlò.

Koment i audituesit: Referuar Udhëzimit nr.13 datë 06.05.2014 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr. 32 datë 31.12.2013 ñPër tatim fitimin e thjeshtuar për biznesin e vogëlò, konstatohert se është bërë ndryshimi në vijim: ñ*Në pikën 11 "Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore", në germën "c" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:*

"Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese. Në akt rakordimin ehartuar në tri kopje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuar për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara.

Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të akt rakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale "Tatime me deklarim",në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës.

Drejtoritë rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të akt rakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë. Në bazë të akt rakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 "Transferta në institucionet nacionale" në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatikë nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 "Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale". Përsa përshkruhet më sipër çështja e rekomanduar është e zgjidhur nga udhëzimi i mësipërm.

Statusi:*Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.*

Rekomandimi 31.1: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me MFE të iniciojë procesin e hartimit të një strategjie të mirë studiuar, për të mundësuar arkëtimin e borxhit prej 18.7 miliard lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga rreth 422 ente publike dhe rreth 64,000 ente private, duke mbajtur parasysh faktin që, një numër i konsiderueshëm entesh publike kanë pushuar juridikisht së funksionari (Komunat apo Reparte Ushtarake etj.) dhe ende rezultojnë debitorë ndaj kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Strukturë përgjegjëse për ndjekjen e rekomandimit është caktuar Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve Tatimore të Papaguara në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Komentet në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi:

- ✓ Dërguar shkresë Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Tatimore në Rajone me nr. 143/2 datë 27.01.2021 dhe i është lënë afat raportimi çdo datë 10 të muajit, duke filluar nga data 10.03.2021.
- ✓ Dërguar shkresat Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe u është kërkuar zbatimi i shkresës me nr.143/2 date 27.01.2021:
- ✓ Me numër 143/16, datë 14.06.2021 (DMDTP Rajoni Jugor), me numër 143/15, datë 14.06.2021 (DMDTP Rajoni Qendror), me numër 143/14, datë 14.06.2021 (DMDTP Tatimpaguesit e Mëdhenj), me numër 143/13, date 14.06.2021 (DMDTP Rajoni Verior).

Statusi zbatimit të rekomandimit i zbatuar.

Rekomandimi 31.2: DPT të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me të dhënat më të fundit, të nxjerra nga sistemi C@TS, deri në datë 30.09.2020, të subjekteve buxhetore, debitore për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe tõ kërkoj që, strukturat përgjegjëse për Thesarin, në zbatim të pikës 113 të Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 20.01.2020, ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, të mos autorizojnë pagesën e pagës nëse, nga ana e subjekteve debitore, nuk është paraqitur njëkohësisht dhe pagesa për shlyerjen e detyrimeve kontributeve, sipas një plani pagesash të shlyerjes së stokut të detyrimeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP, për njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Afati: Menjëherë

Për rekomandimin 31.2, strukturë përgjegjëse për ndjekjen e tij, është caktuar Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve Tatimore të Papaguara në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- ✓ Dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresa nr. 21250/3 Prot, datë 01.02.2021.
- ✓ Dërguar shkresa nr. 2379/1 te prot, date 01.03.2021 nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me lëndë "Për mos lejimin e likuidimit të pagesës së parave nëse detyrimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore dhe TAP nuk shlyhet".
- ✓ Me shkresën nr. 21250/9 të prot, datë 16.03.2021 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon Drejtoritë Përgjegjëse të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, për qëndrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

Statusi zbatimit të rekomandimit i zbatuar.

Rekomandimi nr. 32.1: Strukturat drejtuese të DPT në bashkëpunim me MFE të analizojë shkaqet e ristrukturimeve të shpeshta me qëllim shmangien e tyre. Të merren masa për krijimin e një strukture organizative të qëndrueshme që garanton mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë në lidhje me pozicionet e punës.

Afati*: *Në vijimësi.

Personat përgjegjës për realizimin:

Komiteti Reformave në DPT- Sekretariati
Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
Departamenti i Administratës Publike (DAP)

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Sipas rekomandimeve të FMN dhe në kuadër të projektit të fiskalizimit është miratuar struktura e re organizative me Urdhër 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit në bashkëpunim me DAP dhe miratuar organigrama nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me nr. 1181/7 Prot., datë 27.03.2020. Implementimi i strukturës është finalizuar në muajin shtator 2020 me nxjerrjen e akteve nga DAP. Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2021 do të vlerësohet performanca e strukturave të reja apo riorganizimi brenda këtij 6-mujori do të dërgohet shkresë në MFE. (Me implementimin e strukturës, DBNJ ka kërkuar me shkrese nr. 12422 Prot., datë 02.07.2020 DRT/Drejtorive në DPT si dhe në mënyrë të vazhdueshme me email përcaktimin e KPI të rishikuar për gjithë strukturat e administratës tatimore si dhe për strukturat e reja, me qëllim ndjekje për 2021.

Koment i audituesit:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 32.2: Struktura drejtuese të DPT të marrin masa për ngritjen e nje grupi pune për rishikimin e rregullores, duke reflektuar të gjitha ndryshimet strukturore, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni pune.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realiziminTë gjitha Drejtoritë në DPT dhe Drejtoria Teknike dhe Ligjore.
Me urdhrin Nr.193, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është miratuar Rregullorja e re e Administratës Tatimore Qendrore. Me Urdhrin 192 datë 12.08.2020 është miratuar Rregullorja e Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore.
Koment i audituesit:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsideroheti pranuar dhe i zbatuar.*

Rekomandimi nr. 33.1: Struktura drejtuese të DPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masat për ndërprerjen e delegimeve për pozicionet vakante dhe plotësimin e pozicioneve vakante me vendime emërimi.

Afati: Në vijimësi

- **Personat përgjegjës për realizimin:**Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Departamenti i Administratës Publike (DAP).
Për shkak të implementimit të strukturës së re organizative të miratuar me Urdhrin 33 datë 12.02.2020 të Kryeministrit, aktet e delegimeve të kompetencave, ligjërisht nuk kanë më efekte ligjore. Aktualisht në fuqi janë 22 delegime dhe 13 vendime, për delegimin e përkohshëm janë ndërprerë. Plotësimi i vendeve vakante është procedurë në bashkëpunim me DAP. DBNJ ka vijuar hedhjen e vendeve vakante në sistemin online të DAP administrata.al., Aktualisht nga ana e DAP janë shpallur në faqen zyrtare 149 vende vakante dhe janë emëruar afërsisht 60 nëpunës. DBNJ do të vijojë hedhjen e tyre në sistemin on-line të DAP menjëherë me krijimin e pozicioneve të lira.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 33.2: Strukturat drejtuese të DPT të përcjellin problematikën në DAP me qëllim shmangien e parregullsive me pasojë favorizimin e punonjësve që nuk plotësojnë kualifikimin e nevojshëm për të qenë pjesë e shërbimit civil në DPT.

Afati: Në vijimësi

- **Personat përgjegjës për realizimin:**Departamenti i Administratës Publike (DAP) Komisionet e përhershme ose të posaçme të pranimit/lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë që kryesohen nga DAP; Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Është përcjellë për njohje dhe zbatim Departamentit të Administratës Publike, shkresa nr.2150/1 Prot. datë 18.12.2020, sipas gjetjeve në raportin e KLSH-së dhe detyrave të lëna. Drejtoria e Burimeve Njerëzore verifikon plotësimin e kritereve të posaçme të punës, të punonjësve të rekrutuar nga DAP. Mbahen korrespondenca të vazhdueshme me DAP për rregullsinë e procedurave të konkurrimit.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

Rekomandimi nr. 34.1: Strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masat për zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe punësimit që përfshin shpalljen në institucione për propozimet përkatëse, kriteret dhe afatet e aplikimit nga të punësuarit, procesin e kualifikimit, përzgjedhjes dhe shpalljen e fituesve duke i kushtuar vëmendje të veçantë dhe nevojës së argumentuar për punonjës shërbimi dhe matjes së performancës së tyre.

Afati: Menjëherë

- **Personat përgjegjës për realizimin:**Drejtuesit rajonalë (për dërgimin e kërkesave të mbështetura në argumente dhe vlerësim performance për punonjës me kontratë të përkohshme), Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

- Nga ana e e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të bërë me dije zbatimin e procedurave të rregullta, përputhshmërinë e kritereve dhe informacionin e argumentuar mbi nevojat për staf. Drejtoria e Burimeve Njerëzore i ka bërë me dije DAP në mënyrë të vazhdueshme për konstatimet që janë kryer rastësisht, për mospërputhje midis hedhjeve në sistem të vendeve dhe shpalljeve në faqen zyrtare të DAP.
  Me e-mail e datës 03.09.2019 si dhe me shkresën nr.17259 Prot. datë 17.09.2019 i është drejtuar të gjitha drejtorive për dërgimin e kërkesave dhe nevojave të argumentuara në vitin 2020. Në shkresën nr. 21943 Prot., datë 05.122019 i është bërë me dije Drejtorit të Përgjithshëm mbi dërgimin e kërkesave të argumentuara. Për performancën është përgatitur formulari vlerësimi (standard) për matjen e saj për punonjësit e shërbimit dhe është dërguar me shkresën nr.21426 Prot., datë 22.11,2019 për të gjitha DRT dhe Drejtoritë në DPT.
  Në zbatim të VKM nr 47 datë 22.01.2020 ñPër Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes vendore ñ, ka dalë Urdhri 11 datë 31.01.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm, ñPër detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, pjesë e Administratës Tatimore ñ, Urdhri nr.11/1 datë 31.01.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm ñPër përcaktimin e kritereve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, pjesë e Administratës Tatimoreò. Për vitin 2020 sipas kontratave të lidhura për çdo punonjës është bërë vlerësimi i performancës për secilin punonjës shërbimi.
  Sipas procedurës në fund të vitit 2020 (duke filluar nga muaji gusht, lidhur edhe me ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023ò i është kërkuar DRT dhe drejtorive këtu me e-malin e datës 28.08.2020 dërgimi i kërkesave të argumentuara për punonjës me kontratë të përkohshme.
  Me memon nr. 18395 Prot., datë 21.09.2020 është bërë me dije Drejtori i Përgjithshëm për kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme, për çdo drejtori.
  Me shkresën nr. 24714 Prot., datë 21.12.2020 i është dërguar për miratim MFE, kërkesa për miratimin e punonjësve të shërbimit, si dhe punonjësve me kontratë të përkohshme, mbështetur në kërkesat e DRT dhe drejtorive në DPT, së bashku me detajimin sipas drejtorive.
  Është miratuar VKM nr. 1151 Prot., datë 24.12.2020 ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò.
  Në zbatim të VKM-së ka dalë Urdhri nr. 3 datë 21.01.2021 ñPër detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 pjesë e Administratës Tatimoreò, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, së bashku me tabelën e detajimit, si dhe Urdhri nr. 3/1 datë 21.01.2021 ñPërcaktimin e kritereve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme (punonjësve të shërbimit).
  Deri tani sipas kërkesave të Drejtorive Rajonale, dërguar zyrtarisht janë emëruar 284 punonjës me kontratë të përkohshme dhe po vijon mbledhja e propozimeve për staf të përkohshëm nga çdo strukturë duke sjellë kërkesa të argumentuara për planifikimin 2022-2024.
  Statusi: *Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet* ***i pranuar dhe i zbatuar.***

Rekomandimi nr. 34.2: Drejtoria Ligjore, të marrë masa për ndjekjen e kujdesshme të proceseve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna në mënyrë që të minimizohen efektet negative në buxhet.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria Teknike dhe Ligjore

Drejtoria Teknike dhe Ligjore ka bërë përpjekjet maksimale brenda hapësirës ligjore për një përfaqësim sa më mirë në proces gjyqësore me objekt largimin e padrejta nga puna. Bazuar kjo dhe mbi të dhënat e viteve të kaluara krahasuar me vitet 2020-2021.

Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi nr. 1.1: DPT të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 1.552.000 lekë, sa përfituar padrejtësisht nga 14 punonjës ne kundërshtim me përcaktimet e lidhjes 2 të VKM-së nr.187 datë 08.03.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës etj.ò

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit me anë të shkresave nr. 15260-15273 prot, date 03/08/2020 ka informuar te gjithë punonjësit e cituar ne akt-konstatimin nr. 8 date 28.07.2020 te KLSh, për vlerat përkatëse, për tu kthyer për sa pretenduar se janë përfituar padrejtësisht. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit me shkresën nr. 25444-25457 prot, date 31/12/2020 ka njoftuar te gjithë punonjësit dhe ish- punonjësit per detyrimin për tu kthyer pranë dpt.

Një pjese e punonjësve kane rene dakord per kthimin e shumes me këste mujore e cila mbahet nga paga përkatësisht (F. Z, A. F, J. D.& E. N). një pjese kane filluar procese gjyqësore pasi kane pretendimet e tyre ne lidhje me keto konstatime, përkatësisht (E. B., A. Q, H. K, A. H, I. N) si dhe pjesa tjetër nuk janë me punonjes te administratës tatimore, përkatësisht (A. B, P. H, B. D, V. J, A. K).

Koment i audituesit:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 1.2: DBNJ në çdo rast për emërimet e reja në punë, në vijim të vendimeve të DAP dhe Drejtorit të Përgjithshëm të hartojë aktin e emërimit në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i VKM nr.187 datë 08.03.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, ...ò dhe rregullatorë në fuqi, neni 35 i Rregullores së Brendshme ñPër funksionimin e ATQò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19 datë 22.02.2017. Gjithashtu DBNJ në vijimësi, sipas rastit për punonjësit aktualë pjesë e organikës së DPT-së duhet të njoftojë zyrtarisht DBF në lidhje me ndryshimin e nivelit të diplomës së tyre.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Drejtoria e Burimeve Njerëzore edhe pa patur asnjë kërkesë për informacion nga struktura përgjegjëse për pagat ka dërguar informacion lidhur me nivelin e diplomave të punonjësve të DPT me shkresë zyrtare drejtuar DFB, e cila nuk është zbatuar. Shkresa nr. 7108 Prot., datë 04.04.2019 Aktet e emërimit të nëpunësve civilë nuk i bën DBNJ. Ky rekomandim nëse pranohet, mund të aplikohet vetëm për punonjësit me Kod Pune, që nuk janë pjesë e shërbimeve mbështetëse, të cilat kanë pagë grupi (për diplomë).

DBNJ i ka përcjellë DFB listën emërore të punonjësve aktualë së bashku me nivelin e diplomave zotëruese. Në vijim me shkresën nr. 15142/3 prot., datë 21.09.2020 DBNJ i ka përcjellë DFB nivelin e diplomave të disa punonjësve të sapo diplomuar. Në korrespodencën elektronike më DFB është kërkuar që në çdo rast mungese potenciale, DFB të paraqesë kërkesë për informacion apo saktësim.(e-mail datë 07.01.2021).

Për punonjës të cilët nuk kanë depozituar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar nga DBNJ, janë njoftuar të gjitha strukturat dhe u është bërë propozimi përkatës nga DBNJ. DBNJ ka propozuar ecuri disiplinore për personat përgjegjës.

Nga ana e DBNJ ka filluar hartimi i vendimeve në përputhje me Kodin e Punës si dhe duke shtuar elementin e nivelit të Diplomës në aktin e fillimit të marrëdhënieve financiare.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar pjesërisht dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 1.3: DBF në asnjë rast, për emërimet e reja në punë të mos procedojë me kryerjen e pagesës nëse nga ana e DBNJ nuk garantohet plotësia e informacionit, në zbatim të kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Afati: Në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Shkresa nr.7875/1, date 6.5.2021, Shkresa nr.8176, date 6.5.2021,Shkresa nr,15142, date 3.8.2020.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

Rekomandimi nr. 2: DBF të marrë masat për arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 110.900 lekë, përfituar nga punonjësit e sipërcituar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr. 997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
DFB me shkresën nr.25442-25443 prot date 31/12/2021 ka njoftuar te gjithë punonjësit për detyrimin për tu kthyer pranë dpt, përkatësisht z.B dhe z.M te cilët nuk janë dakordësuar duke ngritur pretendimet se shumat e përftuara janë konform rregullave dhe për te cilën kane ngritur padi ne organet kompetente.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsideroheti pranuar dhe në proces zbatimi.*

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE
Rekomandimi 1: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, deri në automatizimin e plotë të procedurës së rimbursimit, për kategorinë eksportues për kryerjen e rimbursimin e TVSH-së brenda afatit ligjor për rimbursim, të marri masa të menjëhershme për përmirësimin e Rregullores së TVSH-së me qëllim përmirësimin e procedurës së dërgimit për kontroll të kërkesave për rimbursim të vlerësuara sipas nivelit të riskut, duke u orientuar më shumë drejt kontrollit pas rimbursimit i cili të përfshije disa periudha tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-se lidhur me kështet e planifikuara për pagesë, të mbajë një regjistër ku të evidentojë tatimpaguesit dhe kështet e rimbursimit.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH
Përgjigja e Subjektit: Rregullorja është rishikuar gjatë vitit 2020, ka hyrë në fuqi dhe është në zbatim ne 28.04.2020. DRTVSH mban në excel një regjistër ku evidentohen tatimpaguesit dhe kështet e rimbursimit.
Statusi:Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar i zbatuar.

Rekomandimi 2: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, të marri masa të menjëhershme për përmirësimin e Rregullores së TVSH-së ku të pasqyrohen dhe saktësohen hapat procedural te mbajtjes së detyrimeve te papaguara dhe të krijuara rishtazi për evidentimin e stokut të TVSH-së duke përfshirë një format standard të miratuar mbi raportimin e tij, duke përfshirë të gjithë elementët e procesit të rimbursimit të TVSH-së deri në miratimin për pagesë. Deri në

përmirësimin e rregullores, për të gjitha kërkesat e pranuara, DRTVSH të dërgojë çdo muaj pranë Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit në DPT, evidencë analitike mbi detyrimet e prapambetura dhe/ose të krijuara rishtazi për shumat e miratuara të papaguara plotësisht ose pjesërisht të paguara si dhe për shumën e kërkuar ende të pa miratuar nga organi tatimor për rimbursimin e kërkuar.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH

Përgjigja e Subjektit: Rregullorja është rishikuar gjatë vitit 2020, ka hyrë në fuqi dhe është në zbatim ne 28.04.2020.DRTVSH mban në excel një regjistër ku evidentohen tatimpaguesit dhe kështet e rimbursimit. Në zbatim të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 ñ*Për monitorimin dhe publikimin periodik te stokut te detyrimeve te prapambetura te qeverisjes se pergjithshme*ò, mbi detyrimet e krijuara rishtazi dhe stokun e detyrimeve te prapambetura.

Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsideroheti pranuar i zbatuar.*

Rekomandimi 3.1: Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT-ve mbështetur në listën e subjekteve sipas shkresave e AKBN-së, në bashkëpunim me DRT-re që kanë nën juridiksion territorial këta tatimpagues dhe vlerësojnë vete deklarimin e secilit prej tyre, të ndjekë hap pas hapi, rast për rast dhe në kohë 59-60 rastet e konfirmuara me mungesë leje ndërtimi, dhe pas kontrollit nga zyra ose në vend sipas programit, të kërkojnë prej tyre të shprehet me vlerësim tatimor sipas procedurave të përcaktuara në neni 68.4 dhe 68.5 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore*ò, në rastet kur konstaton paligjshmëri.

Afati: Menjëherë

Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. P. S., z. A. G. dhe z. N. K..

Për zbatimin e këtij rekomandimi është hartuar shkresanr. 6229, datë 14.04.2021, në zbatim të rekomandimeve të KLSH, seksioni II pika 3.1 si dhe shkresave të dërguara nga DPT me nr. 16799/1, datë 27.09.2019, nr. 17042/1, datë 27.09.2019, nr. 18045/1, datë 14.10.2019 dhe nr. 17042/2, datë 24.12.2019 është kërkuar nga çdo DRT që:

- Për subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike-tregtare në ndërtimin e veprave hidroenergjitike, sipas konstatimeve të AKBN-së, në mënyrë urgjente të raportojnë për kryerjen e kontroll/verifikimeve, në subjekte që kanë kryer punime dhe kanë kredituar TVSH-në, në mungesë të lejes së ndërtimit nga organet kompetente, apo që kanë ndërtuar në tejkalim të lejes përkatëse, sipas listave të dërguara nga DPT,
- Në rast se ka ende subjekte të pa verifikuara apo kontrolluara, menjëherë të merren masa për kryerjen e kontroll/verifikimeve dhe të raportohet në DPT, për planifikimin dhe kryerjen e tyre.

Për realizimin e këtij rekomandimi, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, do të ndjekë hap pas hapi procesin duke ushtruar dhe kontrolle në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, për rregullshmërinë e kreditimit të TVSH-së, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, duke patur në fokus dhe pasjen e lejes së ndërtimit nga subjektet ndërtuese të HEC-ve, si një dokument thelbësor, për njohjen e kreditimit të TVSH-së. DKT ne DPT verifikon procedurat e ndjekura nga ana e DRT-ve si dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi si dhe të urdhëresave të ndryshme të hartuara.

Lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimit, do të raportohet në DKT në DPT. Raportimi do të kryhet brenda datës 15 të çdo muaji dhe do të jetë periodik i vazhdueshëm. Raportimi do të kryhet nga Drejtori i Kontrollit Tatimor ne DRT.

Për sa cituar më sipër në lidhje me këtë rekomandim të lënë nga KLSH-ja, nga kontrollet e disa viteve më parë lidhur me kreditimin e TVSH-së, nga subjektet ndërtuese hidroenergjitike, HEC-et, të cilët operojnë pa leje ndërtimi nga organet kompetente, apo në kalim të saj, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në bashkëpunimin me AKBN-në

si dhe në informacionin e ardhur nga kjo agjenci në vazhdimësi, në përputhje dhe me rolin e saj si udhëheqës metodologjik, jo vetëm që e ka përcjellë informacionin e dërguar, por dhe rast pas rasti në përputhje me specifikat e problematikës, ka kërkuar kryerjen e veprimeve konkrete, deri dhe bashkëpunimi me AKBN-në për kryerjen e kontrolleve tatimore.
Për sa më sipër konstatohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht megjithëse është ndjekur por dhe me shkresa e cituar sa më sipër por nuk ka të dhëna nga DRT mbi rezultatet përfundimtare të kontrolleve të kryera lidhur me kreditimin e TVSH-së, nga subjektet ndërtuese hidroenergjitike, HEC-et, të cilët operojnë pa leje ndërtimi.
Statusi:*Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi*

Komente nga subjekti i audituar: Në lidhje me akt konstatimin nr. 2, ku është trajtuar zatimi i rekomandimit të mësipërm nga audituesi A. Z, nga DPT është paraqitur observacioni me nr 8715/18 datë 18.08.2021 (DPT), e prot. në KLSH me nr. 513/5, datë 20.08.2021 ku sqarojmë se në akt është trajtuar e gjithë puna e bërë nga ana e inspektorëve e cila duhet vlerësuar por DK duhet të bashkëpunojë më shumë me DRT për përfundimin e saj.
Pretendim i subjektit: Në lidhje me akt konstatimin nr. 2 ku është trajtuar nga z. A. Z. zbatimi i rekomandimeve 8.1 dhe 3.1, është paraqitur observacioni me nr. 8715/31 datë 25.08.2021 dhe nr. 8715/32 datë 25.08.2021 nga DPT e prot. në KLSH me nr. 513/18, datë 26.08.2021, dhe nr. 513/19, datë 26.08.2021 të cilët kanë ardhur jashtë afateve, megjithatë sqarojmë se këto observacione janë të njëjtë me observacionin e paraqitur me nr. 8715/18 datë 18.08.2021 nga DPT e prot në KLSH me nr. 513/5, datë 20.08.2021 i cili është trajtuar në Projektraport e ku sqarojmë edhe një herë se në akt është trajtuar e gjithë puna e bërë nga ana e inspektorëve e cila duhet vlerësuar por DK duhet të bashkëpunojë më shumë me DRT për përfundimin e saj.

Rekomandimi 3.2: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, të listojë çdo subjekt që evidentohet nga AKBN ose struktura të tjera kontrolluese me mungesë leje ndërtimit ose tejkalim i saj, dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të bëhet faktor në parandalimin rimbursimit kur konstaton thyerjen e kritereve ligjore të rimbursimit.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Rimbursimit të TVSH
Përgjigja e Subjektit: Rekomandimi nuk pranohet. Drejtoria e Rimbursimit nuk kontrollon Lejet e Ndërtimit, janë Drejtoritë e Kontrollit në DRT që certifikojnë tepricën kreditore të rimbursueshme me anë të raportit të kontrollit.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsideroheti pa pranuar dhe i pa zbatuar.*
Rekomandimi 4.1: Drejtoria Ligjore dhe Teknike, të marr masa për përgatitjen e grafikut të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, sipas radhës së paraqitjes së kërkesave për ekzekutim. Ky grafik të miratohet nga nëpunësi Autorizues dhe të publikohet online.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 4.2: Nëpunësi Zbatues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të marr masa në vijimësi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj ish punonjësve të larguar nga puna në përputhje me grafikun ne miratuar.

Afati: Menjëherë

Rekomandimi 4.3: Drejtoria Ligjore dhe Teknike të përcjell informacione të vazhdueshme në strukturat e Burimeve Njerëzore dhe Financës, në lidhje me gjyq fituesit në momentin e njohjes me vendimin e formës së prerë, me qëllim njohjen, kontabilizimin e saktë të detyrimeve, planifikimin e fondeve buxhetore për pagesat në vitin e ardhshëm dhe trajtimin në kohë të praktikave të tyre nga ana e Komisionit të Posaçëm.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria Teknike dhe Ligjore, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Përgjigje e subjektit: DTL plotëson dhe përgatit dokumentacionin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundëson përcjelljen e tyre në strukturat kompetente, në zbatim Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjesò, në momentin e depozitimit të kërkesës për ekzekutim të vendimeve gjyqësore, DTL bën verifikimet nëse kërkesa e paraqitur është e plotë dhe në respektim të legjislacionit në fuqi dhe në rastin kur konstaton se kjo praktikë nuk është e plotë, kërkon plotësim të dokumentacionit me qëllim që të vijohet me procedurat e mëtejshme ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. DTL nuk mund të publikojë një grafikun për radhën e ekzekutimit përsa kohë që ka një strukture kompetente të sepse nuk është struktura që kryen likuidimin e ekzekutimeve.

Drejtoria Teknike dhe Ligjore në momentin e njoftimit nga ana e gjykatës së një vendimi gjyqësor ja përcjell për dijeni strukturave kompetente përkatësisht Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Më konkretisht me shkresën nr.3617/1 Prot., datë 12.03.2021 është përcjellë vendimi i formës së prerë për zj.V. P., me shkresën nr. 24366/1, datë 28.01.2021 është përcjellë vendimi i formës së prerë për zj. S. H. etj. Nga auditimi i zbatimit të radhës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për vitin 2020 u konstatuan disa parregullsi, pasi gjatë këtij viti, gjyqfitues me datë vendimi të hershme janë paguar, ndërkohë që nuk janë kryer pagesa për gjyqfitues të tjerë me datë vendimi pas tyre, etj, trajtuar më gjerësisht në pikën e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Statusi:*Rekomandimi 4.1, 4.2, 4.3 konsiderohet në proces zbatimi*.

Rekomandimi nr. 5.1: Strukturat Drejtuese, në cilësinë e Titullarit të DPT dhe Kryetarit të Komisionit të Posaçëm të marrin masa të mjaftueshme për menaxhimin dhe funksionimin e tij me qëllim trajtimin e menjëhershëm të 152 praktikave të gjyqfituesve, çdo vonesë e së cilës vazhdon të rëndojë buxhetin e shtetit, duke trajtuar me prioritet praktikat e gjyqfituesve që rezultojnë të punësuar në administratën shtetërore me qëllim ndërprerjen e një pagese nga buxheti i shtetit.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Komisioni i Posaçëm dhe Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve.

Gjatë vitit 2020 është bërë procesi i ristrukturimit i cili ka filluar në muajin shkurt dhe ka përfunduar në muajin shtator. Nga DBNJ është kërkuar interpretim dhe informacion nga DAP për Veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm. Shkresa nr. 3244 Prot., datë 12.02.2020 lënda ñKërkohet orientimò, me anë të së cilës është kërkuar orientim nëse gjatë kësaj periudhe, mund të ekzekutoheshin vendimet gjyqësor.

Nëse mund të ishin pjesë e vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit, praktikat e nëpunësve të AT, pjesë aktuale e saj por në pozicione me kategori page më të ulët, për të cilët gjykata ka vendosur rikthimin në të njëjtën kategori.

Me shkresën e DAP nr. 1030/1 Prot., datë 02.03.2020, protokolluar me tonën nr. 03.03.2020, paragrafi i parafundit theksohet se: *DPT duhet të procedojë menjëherë me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në vendet e lira që nuk përfshihen në ristrukturim, si dhe në vendet vakante që do të rezultojnë pas përfundimit të procedurës së ristrukturimit.Sistemimi nuk bëhet nga Komisioni i Ristrukturimit, i ndryshëm nga ai i posaçëm.* Në fund të procesit të ristrukturimit Drejtoria e Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 3244/2 Prot., datë 21.09.2020 i ka vënë në dispozicion Komisionit të Posaçëm të gjithë databazën e gjyqfituesve, vakancën në atë moment dhe propozime për sistemin.

Në mbledhjen e datës 10.12.2020 nga Komisioni i Posaçëm është bërë trajtimi i të gjitha praktikave (129) që gjendeshin në databazë edhe praktika të trajtuara për më shumë se

njëherë. Janë emëruar pas nxjerrjes se akt-emerimit nga DAP, gjithsej 14 gjyqfitues deri më 29.04.2021.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

Rekomandimi nr. 5.2: DBNJ në bashkëpunim me DAP të bëjnë verifikim të vazhdueshëm në lidhje me ish-punonjësit gjyqfitues të DPT që rezultojnë të dy punësuar në administratën publike dhe që marrin 2 paga buxheti i shtetit.

Afati: Menjëherë

- **Personat përgjegjës për realizimin:**Drejtoria e Burimeve Njerëzore (sekretariati teknik i KP) në bashkëpunim me DAP, Komisioni i Posaçëm, Drejtoria TIK.
Komisioni i Posaçëm këtë informacion mund/duhet ta marrë në ndihmë të vendimmarrjes së tij. Informacioni i vendoset në dispozicion sekretariatit teknik të KP nga Drejtoria TIK. DAP administron databazën e gjyqfituesve për këtë arsye ka të dhëna nëse një nëpunës kreditor në DPT është i emëruar në një pozicion tjetër të administratës publike.
Me shkresën nr. 18010 Prot., datë 16.09.2020 i është drejtuar Drejtorisë Teknike dhe Ligjore duke përcjellë informacionin lidhur me punësimin e gjyqëfituesve në sektorin publik.
Me shkresën nr. 3244/2 Prot., datë 21.09.2020 Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka përcjellë KP informacion dhe material mbi të gjitha praktikat gjyqësore.
Me shkresën nr. 18470 Prot., datë 22.09.2020 DBNJ, ka kërkuar informacion mbi vendbanimet e gjyqfituesve pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile.
Statusi:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

Rekomandimi nr. 5.3: Strukturat Drejtuese të DPT të kërkojnë marrjen e masave nga ana e DPT, për nxjerrjen e akteve të emërimit apo refuzimit për propozimet e bëra brenda kategorive nga Komisioni i Posaçëm në lidhje me sistemimin e gjyqfituesve. Nga ana e Komisionit të Posaçëm tâi kushtohet një vëmendje e veçantë ndjekjes së ekzekutimit të këtyre praktikave duke qenë se ekziston risku që me kalimin e kohës dhe ndryshimeve të strukturës, rekomandimet për sistemim të gjyqfituesve të mos jenë më të vlefshme. Në rast të tillë, këto praktika duhet të rikthehen si pjesë e data bazës së vendimeve gjyqësore dhe të ritrajtohen.

Afati: Menjëherë

- **Personat përgjegjës për realizimin:** Strukturat Drejtuese të DPT, Komisioni i Posaçëm, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve.
Në datën 10.11.2020 KP rishqyrtoi praktikat të gjyqfituesve të cilët janë rishqyrtuar një herë dhe për të cilët DAP nuk ka nxjerrë akte emërimi. U morën në shqyrtim 8 praktika gjyqfituesish, 4 nga të cilët janë kompetencë e drejtorisë Teknike dhe Ligjore dhe për 4 gjyqfitues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë përcjellë shkresat për shprehje pëlqimi për pozicionin e ofruar. Komisioni në mbledhjen e muajit dhjetor vlerësoi dhe morri në shqyrtim 129 praktika gjyqësore, të gjithë databazën e gjyqfituesve, sipas procesverbalit.
Shqyrtimi i praktikave u bë sipas Drejtorive Rajonale të ndara në qarqe, si dhe të dhënat dhe vendet vakante, të cilat u përcaktuan nga strukturat drejtuese, për tâia ofruar gjyqfituesve, bazuar edhe në shpalljet e kryera deri në atë moment nga DAP dhe ankesat gjatë ristrukturimit.
KP mori në shqyrtim praktikat, së bashku me dokumentacionin e plotë ligjor të gjyqfituesve të sipërcituar, ku analizoi vakancën e pozicioneve, rëndësinë dhe kriteret e pozicioneve, ndryshimet strukturore, si dhe pozicionimin aktual të gjyqfituesve, për raste konkrete, në përputhje me përvojën/eksperiencën, arsimimin dhe për më tepër disponimin e gjykatës, në zbatim të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshme për tâu ekzekutuar.

Një pjesë e gjyqfituesve u sistemua pranë Administratës Tatimore, një pjesë e gjyqfituesve janë propozuar në institucion tjetër ,sipas vendeve vakante në institucione të tjera, vënë në dispozicion nga DAP, pas kërkesës së DRT.

Për gjyqfitues të cilët DPT ka pamundësi objektive për sistemim, rekomandoi,sistemin nga DAP, në pozicione pune, në institucione të shërbimit civil, në zbatim dhe të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Janë përcjellë shkresa për shprehjen e pëlqimit 47 gjyqfituesve, nga të cilët kanë kthyer përgjigjigje dhe japin dakordësinë 14 gjyqfitues dhe 9 gjyqfitues nuk japin dakordësinë, për të cilët vazhdon procedura ligjore në bashkëpunim me DAP dhe strukturat e tjera brenda DPT.

Është bërë rishqyrtim i praktikave për gjyqfituesit A. P, A. Gj, E. B dhe Q. L, procesverbal datë 19.11.2020 si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka vijuar me akt rekomandimet :

- **A. Gj** Akt rekomandimi shkresa nr. 23324 Prot., datë 03.12.2020. Mos dakordësi shkresa nr.23324/2 Prot., datë 11.02.2021
- **A. P** Akt rekomandimi Nr. 23326 Prot., datë 03.12.2020, fillim i marrëdhënieve financiare, shkresa nr. 23326/2 Prot., datë 29.12.2020.
- **E. B** Akt rekomandimi Nr. 23323 Prot., datë 03.12.2020. Akt emërimi Dap shkresa nr. 6478/2 Prot., date 15.12.2020 protokolluar me tonën nr. 23323/1 Prot., datë 18.12.2020. Fillim i marrëdhënieve financiare shkresa nr. 23323/2 Prot., datë 29.12.2020. Akt rekomandimi Nr. 23325 Prot., datë 03.12.2020. Shkresa e DAP në përgjigje tones Nr. 6477/1 Prot., datë 16.12.2020, protokolluar me tonën nr. 23325/1 Prot., datë 18.12.2021. Shkresa nr.23325/2 Prot., datë 11.1.2021 kthim përgjigje Dap. Dap përgjigje shkresa nr. 6477/3 Prot., datë 25.01.2021 protokolluar me tonën nr. 23325/3 Prot., datë 28.01.2021.
- **Q. L** Akt rekomandimi Nr. 23325 Prot., datë 03.12.2020. Shkresa Dap në përgjigje të tonës Nr. 6477/1 Prot., datë 16.12.2020, protokolluar me tonën nr. 23325/1 Prot., datë 18.12.2021. Shkresa nr. 23325/2 Prot., datë 11.1.2021 përgjigje Dap. Dap ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6477/3 Prot., datë 25.01.2021 protokolluar me tonën nr. nr. 23325/3 Prot., datë 28.01.2021. Është përcjellë akt rekomandimi në DAP- pas rishqyrtimit nga Komisioni Posaçëm me shkresën nr. 23325/5 Prot., date 09.03.2021, dërguar serish akt-rekomandimi. Vendim emërimi nga DAP me nr. 2132/2 Prot., datë 01.04.2021. Fillimi i Marrëdhënieve financiare me shkresën nr. 23325/7 Prot., date 12.04.2021.

Koment i audituesit:*Referuar auditimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

<u>Rekomandimi 6</u>: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë të gjitha masat e nevojshme për nxjerrjen e përgjegjësive, dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës, me qëllim eliminimin dhe parandalimin e problematikave në lidhje me planifikimin buxhetor dhe inicimin e procedurave të prokurimit të pa mbështetura në fonde buxhetore të cilat kanë shkaktuar efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga auditimi aktual u konstatua se gjatë vitit 2020 janë likuiduar angazhimet buxhetore të marra gjatë këtij vit nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, por në rastin e investimit me objekt ñNgritja e Sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, me kod 18AV811 nuk është shlyer vlera e investimit Brenda afatit të përcaktuar (viti 2020), për mungesë fondesh.

Statusi:Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Rekomandimi 7: DPT me strukturat e saj përgjegjëse të urdhërojë menjëherë verifikimin e dy rasteve të detyrimeve të anuluara në sistemin *C@ts* në vlerë totale detyrimi të raportuar

35,433 mijë lekë, të kryera në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2017 dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse.

Afati: Menjëherë

Statusi i pa pranuar por ka lidhje me rekomandimin 8.1

Rekomandimi 8.1: Për të tre rastet e anulimit të detyrimeve tatimore të konstatuara me problematika kërkohet të verifikohen menjëherë nga strukturat përgjegjëse të kontrollit në DPT dhe DRT, vlefshmëria dhe rregullshmëria e procedurave të ndjekura për ekzekutimin e anulimit apo faljes së detyrimeve, të saktësohet situata e këtyre subjekteve në sistemin C@TS dhe të nxirren përgjegjësitë individuale përkatëse.

Afati: Menjëherë

Inspektori përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e këtij rekomandimi është z. A. Ç. dhe z. P.S.

Për zbatimin rekomandimit **7 dhe 8.*1***në zbatim të rekomandimeve të KLSH konstatohet se:

- Është dërguar shkresa nr. 7928, datë 30.04.2021 drejtuar DRT Sarandë në të cilën sqarohet rekomandimi i KLSH se konstatohen raste për të cilat anulimi i detyrimeve tatimore në sistemin *C@ts* është shpjeguar nga DRT se është kryer në referencë të ligjit të faljes së vitit 2017. Nga auditimi është konstatuar anulimi i detyrimeve tatimore për subjektin ñE. H.ò me vlerë 16.755 mijë lekë sipas ligjit të faljes kur subjekti ka qenë në proces gjyqësor. Për subjektin ñA. N.ò ku nga DRT Sarandë shpjegohet se falja/anulimi i gjobës është korrigjim i hedhjes gabim ne sistem të shumës 290 mijë lekë, por nuk sqarohet falja/anulimi i gjobës 3 vjet më vonë,
- Është dërguar shkresa nr. 7929, datë 30.04.2021 drejtuar Drejtorisë Tatimpaguesit të Mëdhenj në të cilën sqarohet rekomandimi i KLSH se konstatohen se subjekti ñO. Ph. G.ò anulim i detyrimit për tatim fitimin-detyrim principali në shumën 1,878 mijë lekë për pagesë të vonuar dalë pas periudhës së lidhjes së marrëveshjes me këste më datë 03.11.2017 anulim raste për të cilat anulimit të detyrimeve tatimore,
- Është dërguar shkresa nr. 7930, datë 30.04.2021 drejtuar DRT Vlorë në të cilën sqarohet rekomandimi i KLSH se konstatohen raste për të cilat anulimi i detyrimeve tatimore në sistemin *C@ts* është shpjeguar nga DRT se është kryer në referencë të ligjit të faljes së vitit 2017 . Nga auditimi është konstatuar anulimi i detyrimeve tatimore për subjektin ñMò me vlerë 35,433 mijë lekë sipas ligjit të faljes kur subjekti ka qenë në proces gjyqësor si dhe anulimi i tatim mbi fitimin-detyrim principali në shumën 3,153 mijë lekë pasi në vitin 2017 subjekti ka qenë pasiv.

Në të tre shkresat ne fund citohet për sa më sipër të shqyrtohen me përgjegjësi gjetjet e KLSH-së të nxirret përgjegjësia dhe të na dërgohet informacion i detajuar sa më shpejt për rastet e konstatuara.

Për sa më sipër konstatohet se në përgjigjen e dhënë nga inspektorët për rekomandimin 7 se ky i referohet ligjit të faljes së 2017 dhe nuk gjen zbatim në DKT të DPT, është kontradiktor me veprimet e ndërmarra me anë të shkresave sepse shprehen se pas shqyrtimit të informacioneve nga DRT Sarandë, DTM dhe DRT Vlorë do të gjykohet për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Është realizuar pjesërisht sepse janë hartuar shkresa për të sjellë informacion.

Statusi në proces zbatimi

Rekomandimi 8.2. DPT me strukturat përgjegjëse përfshirë AKSHI-n në cilësinë dhe përgjegjësinë e Drejtorisë IT të urdhërojë menjëherë inicimin e vlerësimit të sistemeve të kontrollit dhe të aplikacionit dhe procedurat shoqëruese të tyre, të miratuar nga Titullari, kjo në veçanti për veprimet të cilat ekzekutohen manualisht në C@TS nga inspektorët ne DRT dhe nga help desk.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria TIK në DPT Drejtoria e Proceseve të Biznesit
Përgjigja nga subjekti: Drejtoria për Proceset e Biznesit ka përfshirë këtë rekomandim tek planit operacional 2021, roli i Drejtorisë së Proceseve të Biznesit si pjesë e Strukturës së DPT, është në funksion të evidentimit, përmirësimit dhe implementimit të proceseve të automatizuara me qëllim rritjen e efektivitetit të punës, matjen e treguesve cilësorë dhe sasiorë, uljen e rasteve abuzive dhe unifikimin e procedurave, harmonizimin e të dhënave për raportim për kontroll sa më efikas. Sipas këtij rekomandimi janë përcaktuar aktivitetet dhe nënaktivitet për zbatim sa më të mirë të këtij rekomandimi.
Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi 8.3: Në kushtet kur shërbimi IT në lidhje me anën funksionale të sistemit C@TS menaxhohet nga AKSHI, një njësi kjo jo në varësi të DPT, dhe në kushtet ku njësia e auditit të brendshëm në DPT nuk disponon kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e auditimeve të teknologjisë dhe informacionit, DPT ti drejtohet MFE për të kërkuar kryerjen e një auditimi të sistemeve të kontrollit dhe sigurisë së sistemit C@TS.

Afati: Menjëherë

Personat përgjegjës për realizimin: Drejtoria e Auditit të Brendshëm
Përgjigjia nga subjekti:Me shkresën Nr. 21250/5, datë 24.02.2021, Drejtoria Auditit Brendshëm i është drejtuar MFE, duke i dërguar për njohje dhe kompetence rekomandimin e KLSH-së 8.3 "Në kushtet kur shërbimi IT në lidhje me anën funksionale të sistemit C@TS menaxhohet nga AKSHI një njësi kjo jo në varësi të DPT dhe në kushtet kur njësia e auditit të brendshëm në DPT nuk disponon kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e auditimeve të teknologjisë dhe informacionit, DPT tëi drejtohet MFE për të kërkuar kryerjen e një auditimi të sistemeve të kontrollit dhe sigurisë së sistemit C@TS."
Staturi: Në proces zbatimi

<u>Zbatimi i masave disiplinore</u>
Për zbatimin e masave disiplinore nga KLSH është dhënë rekomandimi si vijon:
Bazuar në Kreun X ñDisiplina në Shërbimin civilò, të ligjit nr. 153/2013 ñ Për nëpunësin civilò, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, i rekomandohet Titullarit të DPT marrja e masave për fillimin e ecurisë disiplinore dhe dhënien e masave disiplinore sipas përgjegjësive, për të gjithë nëpunësit që me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë sjellë situatën e konstatuar.
Përgjigja nga subjekti: Në proces shqyrtimi nga Titullari i Institucionit si dhe eprori direkt, sipas rastit për shkeljet e konstatuara. Për DBNJ, iniciuar fillimi për personin përgjegjës sipas përshkrimit të punës dhe është bërë propozim për punonjës të evidentuar qartazi të lidhur me DBNJ. Shkresa Nr. 25448/2 datë 09.03.2021.
Statusi:Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Pretendime nga subjekti i audituar*: Për rekomandimet me nr. 3, 5, 12, 19.3, 20, 23 dhe 30, lënë nga grupi i mëparshëm i auditimit të KLSH, është bërë observacion nga znj.M. S. me detyre Drejtore e Kontabilitetit dhe Statistiks, protokolluar në KLSH me nr.513/8, datë 23.08.2021, e cila thekson se këto observacione janë kundërshtuar dhe nuk janë pranuat nga DPT në auditimin e mëparshëm. Në planin e masave të hartuar nga DPT janë dhënë sqarime për këto kundërshtime.*
Qëndrim i grupit të auditimit*: Në analizën e përcaktimit të statusit të rekomandimit nga ana e grupit të auditimit është evidentuar çdo rekomandim i cili nuk është pranuar nga DPT dhe në vijim nga grupi janë bërë komentet e nevojshme.*

Konkluzion:Në përputhje me programin e auditimit të miratuar me nr.333/1 prot. Datë 15.04.2020, KLSH ka kryer auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përfundim të të cilit me shkresën nr. 333/16 prot., datë 30.10.2020,nga KLSH është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet. Zbatimi i rekomandimeve nuk është audituar më parë.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna, nga DPT është hartuar plani i masave në të cilin janë vendosur struktura përgjegjëse dhe afate për zbatim. Me shkresën nr. 21250/2, datë 20.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 333/17 prot, datë 20.01.2021, është njoftuar KLSH për hartimin e planit të masave. Si hartimi edhe njoftimi për planin e masave është bërë jashtë afatit 20 ditor nga data e marrjes së raportit përfundimtar, në kundërshtim me germën (j) të nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka raportuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 30.

Zbatimi nga DPT, i rekomandimeve të dhëna nga KLSH në raportin përfundimtar të auditimit me shkresën nr. 333/16 prot., datë 30.10.2020 paraqitet si vijon:

- Janë dhënë 46 masa organizative, nga të cilat 19 prej tyre janë në proces zbatimi, 13 nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar nga subjekti, 11 janë pranuar dhe janë zbatuar dhe 3 rekomandime janë pranuar, por nuk janë zbatuar.
- Janë dhënë 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 1,662,900 lekë, prej së cilës vlera 110,900 lekë për 6 raste për shërbimet e kryera jashtë qendrës së punës pa marrë më parë autorizim nga Titullari i Institucionit, ndërsa vlera 1,552,000 lekë për 14 raste, pgesa të kryera jo në përputhje me nivelin e diplomës për pagë grupi përpunonjës. Nuk janë kryer arkëtime për vlerën e mësipërme, por 5 punonjës kanë filluar procese gjyqësore, 5 punonjës nuk janë më në marrëdhënie pune më DPT, 4 punonjës kane rene dakort per kthimin e shumes me këste mujore.
- Janë dhënë 14 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat 9 prej tyre janë në proces zbatimi, 2 masa nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar, 2 masa janë zbatuar dhe 1 masë është pranuar, por nuk është zbatuar.

Të dhëna në formë tabele për zbatimin e rekomandimeve jepen në tabelën në vijim:

Masa organizative (numrat tregojnë nr e rekomandimit sipas raportit përfundimtar)				
Nr. R.	**Në proces zbatimi**	**Pa pranuar dhe pa zbatuar**	**Pranuar dhe zbatuar**	**Pranuar, pa zbatuar**
1	4.2	1	14	7.2
2	4.3	2	15	11
3	6	3	21	29
4	8.1	4.1	24	
5	8.2	5	25	
6	9	7.1	30	
7	10	12	31.1	
8	17	13	31.2	
9	18	16	32.2	
10	19.1	19.3	34.1	
11	19.2	20	34.2	
12	22	26.2		
13	23	29		
14	26.1			
15	27			
16	28.1			

17	28.2			
18	32.1			
19	33.1			
Total 46 masa	**19**	**13**	**11**	**3**

Masa në rubrikën e 3E (numrat tregojnë nr e rekomandimit sipas raportit përfundimtar)				
Nr. R.	**Në proces zbatimi**	**Pa pranuar dhe pa zbatuar**	**Pranuar dhe zbatuar**	**Pranuar, pa zbatuar**
1	3.1	3.2	1	5.2
2	4.1	7	2	
3	4.2			
4	4.3			
5	5.1			
6	5.3			
7	8.1			
8	8.2			
9	8.3			
Total 14 masa	**9**	**2**	**2**	**1**

Evidencë mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Dok. Standard 18)

Nr.	**Përshkrimi i rekomandimit**	**Statusi i zbatimit**
I.	**NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT**	
1	Shfuqizim akti	Nuk ka
2	Përmirësim akti	Nuk ka
II.	**MASA ORGANIZATIVE (Total 46)**	
	19 masa:	Në proces zbatimi
	13 masa:	Pa pranuar dhe pa zbatuar
	11 masa:	Pranuar dhe zbatuar
	3 masa:	Pranuar, pa zbatuar
III.	**MASA SHPERBLIM DEMI (Total 2)**	
	2 masa në vlerën totale 1,662,900 lekë	Në proces zbatimi (Nuk ka arkëtim, por fillim procedurash)
IV	**MASA PËR PËRDORIMIN E FONDEVE SIPAS 3E (Total 14, në të cilat nuk ka vlera financiare)**	
	9 masa:	Në proces zbatimi
	2 masa:	Pa pranuar, pa zbatuar
	2 masa:	Pranuar, zbatuar
	1 masë:	Pranuar, pa zbatuar
V.	**MASA DISIPLINORE**	
	Janë lënë në kompetencë të titullarit	Në proces zbatimi
VI.	MASA ADMINISTRATIVE	Nuk ka
VII	MASA TË TJERA (nëseka). -Heqje Licence,profesionale -Përjashtim nga pjesëmarrje në tendera, etj.	Nuk ka

Për sa më sipër DPT nuk ka marrë të gjitha masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit dhe për këtë ngarkohet me përgjegjësi titullari i Institucionit znj. D. I., si dhe personat e ngarkuar në planin e veprimit.

Pretendim i subjektit të audituar*: Për sa më sipër në fazën e përgatitjes së projektraportit, është bërë kundërshti nga znj. V. T., me detyrë Drejtore e Burimeve Njerëzore. Për arsye të ardhjes jashtë afatit, këtokundërshti nuk janë shqyrtuar në projektraport, por trajtohen në*

këtë raport auditimi. Thelbi i observacionit është pretendimi se burimet njerzoe kanë plotësuar detyrimet e tyre përsa i përket zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të KLSH. Në mënyrë të përmbledhur në observacion thuhet. Referuar emalit të datës 06.07.2021 dhe 16.07.2021 së bashku me dokumentacionin provues, vërtetojnë se zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH për pjesën që lidhet me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore është realizuar plotësisht. Edhe nga akt verifikimi konstatohet se të gjitha rekomandimet janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, për shkak të natyrës së tyre të të qenurit në vijimësi. Bashkëlidhur do të gjeni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Qëndrim i grupit të auditimit: *Grupii auditimit ka audituar dhe marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga ana Juaj në informacionin e dhënë dhe mbi bazën e tij ka përcaktuar edhe statusin e rekomandimit.*

IV. 8. Të tjera.

Në zbatim të VKM Nr. 143, datë 13.2.2020 ñ*Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimi*ò e ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 92/2014, ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar, ligjin nr. 97/2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH-ja, për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të përcaktuara, ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, duhet të jenë të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Në zbatim të këtyre përcaktimeve ligjore, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka nxjerrë urdhrat respektivë nr. 37, datë 22.5.2020, nr. 48, datë 9.7.2020 dhe nr. 90, datë 15.12.2020 për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të subjekteve të rindërtimit që aplikojnë për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Nga data 25.5.2020 periudhë kur është ngritur me urdhër ky grup pune deri me datë 31.12.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka lëshuar në total 477 autorizime, nga të cilat 250 janë lëshuar vetëm në 3 mujorin e fundit të vitit 2020.

DPT, në përputhje me përcaktimet ligjore të cituara më lart, ka patur detyrimin ligjor për lëshimin e autorizimeve, pasi vlerësimi i impaktit që ka sjellë zbatimi i këtyre akteve ligjore për buxhetin e shtetit nuk është objekt i grupit të punës për rindërtim.

Impakti nga lëshimi i këtyre autorizimeve duhet të reflektohet në buxhetin e shtetit gjatë vitit 2021, pasi numri më i madh i lëshimit të autorizimeve i përket periudhës së fund vitit 2020.

Lista e subjekteve të autorizuar për përjashtimin nga TVSH, në përputhje me VKM Nr. 143, datë 13.2.2020 e ndryshuar publikohet në faqen zyrtare të DPT-së së bashku me informacionin sqarues.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të rimbursimit të TVSH-së, u konstatua se në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë **88 kërkesa** për rimbursimin e TVSH-së të pranuara por **të pamiratuara** në vlerën totale për **1,992,004 mijë lekë** të cilat megjithëse kanë kaluar afatin ligjor të 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk

janë rimbursuar, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 75/1, pika 1, dhe VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatueseò të ligjit nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pikat 3 dhe 4 të nenit 10.Si rezultat **vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së,** në vlerësimin e audituesve të KLSH-së, është **11,789,313 mijë lekë** (9,797,309 mijë e paraqitur nga DPT plus 1,992,004 mijë lekë kërkesa të pranuara dhe në tejkalim të afatit të miratimit).

Gjithashtu kryerja automatike e pagesës nga ana e DPT-së brenda afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim në zbatim të pikës 3 të nenit 10[2], të VKM nr. 953, datë 29.12.2014, për personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% - 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet**pa miratimin e raportit të kontrollit të drejtorive rajonale** paraqet një risk të shtuar për DPT-në për kryerjen e pagesave për rimbursime në vlera të pa konfirmuara nga një raport kontrolli. Kjo e vlefshme për të gjithë ato raste kur vlera e kërkesës së pranuar për rimbursim mund të ishte më e lartë se vlera e miratuar nga raporti i kontrollit.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të ndërmarrë një iniciativë ligjore me qëllim ndryshimin e VKMNr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, dhe konkretisht pika 3, neni 10, duke hequr frazën *...Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.*

Brenda 6-mujorit të I-rë të 2022

2.1 Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në kuadër të auditimit të strukturës, kompetencave, mënyrës së emërimit dhe ndryshimeve të strukturës, hartimit të rregulloreve dhe detyrave funksionale së konstatohet se: legjislacioni i veprimtarisë së DHT nuk ka bashkëveprim të unifikuar midis tyre; Ligji i procedurave tatimore nuk ka përputhje në strukturën të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT; Udhëzimi i procedurave tatimore ka të përcaktuar organizimin Drejtoritë Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor të cilat tashmë janë shkrirë në bazë të riorganizimit të ri dhe ky udhëzim nuk ka ndryshuar; Drejtori i Hetimit vetëm emërohet nga Ministri i Financave dhe raporton tek ai por ai nuk ka pavarësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sepse në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñPër përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimorò, ai varet nga zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm, gjithashtu ai vetëm propozon punonjës për tu punësuar në strukturat e hetimit por nuk ka statusin e vendimmarrjes për ta si dhe nuk është vendimmarrës për gjithë veprimtarinë e kësaj drejtorie, sepse sipas ligjit të procedurave tatimore; Rregullorja e Brendshme ñPër Funksionimin e Administratës Tatimore Qendroreò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19 datë 22.02.2017 nuk është ndryshuar në funksion të ndryshimit të strukturës së Drejtorisë së Hetimit në DPT dhe shkrirjes së Drejtorive të Hetimit Tatimor

[2] *Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit,*

Rajoni Qendror, Verior dhe Jugor; *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të ndërmarrin iniciativën ligjore me qëllim përditësimin e Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 22.4.2009 ñ*Për përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimor*ò, në koherencë me ndryshimet strukturore të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, rritjen e pavarësisë së saj dhe harmonizimin e këtij akti nënligjor me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore.

Deri më 31.12.2021

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të rimbursimit të TVSH-së, u konstatua se, për vitin 2020 shpenzimet për rimbursimin e TVSH-në bazuar në Ligjin e Buxhetit të vitit 2020 dhe Aktit Normativ nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar, janë **programuar në vlerën për 21,000,000 mijë** lekë dhe janë **realizuar në vlerën16,511,532 mijë lekë** ose në masën 79% kundrejt planit të shpenzimeve. Konstatohet se, Drejtoritë Rajonale të Dibrës, Elbasanit dhe Korçës kanë paguar më tepër se fondet e planifikuara në vlerën 664,877 mijë lekë ose kanë tejkaluar fondet e parashikuara për rimbursim e TVSH-së, si në vijim :

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 453,942 mijë lekë ose në masën 267% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 121,247 mijë lekë ose në masën 34% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së.

-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, ka patur një tejkalim të planit të Rimbursimit të TVSH-së, në vlerën për 89,687 mijë lekë ose në masën 35% më shumë se parashikimit vjetor i Rimbursimit të TVSH-së. Veprime të tilla nga këto Drejtori Rajonale bien në kundërshtim me nenin 14 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, sipas të cilat DPT është autoriteti i vetëm qendror qe zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike sipas legjislacionit tatimor, Ligjin Nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar dhe shkresat e MFE mbi planin mujor dhe progresiv të rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së me qëllim parandalimin e pagesave përtej kufirit të lejuar të shpenzimeve. Për të gjitha rastet kur arsyetohet se, mund të procedohet me kryerjen e pagesave, të marrë masat e nevojshme me qëllim rishikimin e planit të shpenzimeve për Drejtoritë Rajonale të cilat prezantojnë situata të tilla.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin e **stokut të detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së,** u konstatua se,në evidencën e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së e cila dërgohet në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Kontabilitetit, për detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi pas miratimeve për rimbursimin e TVSh-së në bazë vjetore, gjendja e stokut te rimbursimit në 31.12.2020 është në shumën **9,797,309 mijë lekë për 9 subjekte tatimore, ku peshën më të madhe të këtij stoku e ka subjekti G. T A në vlerën për 7,117,301 mijë lekë ose 72% e stokut të detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së.** Në vitin 2020, në mbështetje te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008, "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe te VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "Për procedurat dhe kriteret e marrëveshjes për pagesën me këste te Tatimit mbi Vlerën e Shtuar,

te miratuar për rimbursim", DPT, ka lidhur në total **6 marrëveshjepër pagesën me këste** në vlerën totale për **3,932,236 mijë lekë .**
Konstatohet se, për të gjitha rastet e miratimit të kërkesës për rimbursim, vlera e kërkuar për rimbursim del jashtë sistemit C@TS, në pritje të lëshimit të Urdhër Pagesës për Rimbursim. Në vijim të gjithë të dhënat në lidhje subjektet të cilëve i është miratuar kërkesa për rimbursimin e TVSH-së mbahen nga jashtë në format excel nga Drejtori i Rimbursimit të TVSH-së dhe inspektorët përkatës. Nga auditimi u konstatua se, DRTVSH, në mbyllje të periudhës ushtrimore nuk mban akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me detyrimin e konstatuar për rimbursimin e TVSH-së me qëllim saktësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiare. Ky rakordim bëhet i nevojshëm sidomos për subjektet detyrimet ndaj të cilëve paguhen pjesërisht apo nëpërmjet marrëveshjeve me këste. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi e MFE, nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare të NJQPò pikës 3.1 ñ Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò,pika 30.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
2.1.Rekomandim: Drejtoria e Rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të marrë masat e nevojshme me qëllim që, në mbyllje të periudhës ushtrimore të mbajë akte rakordimi me tatimpaguesit në lidhje me **stokun e detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së** dhe, një kopje të këtij dokumenti ta paraqesë në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Kontabilitetit me qëllim dokumentimin e vërtetësinë e detyrimeve ndaj të tretëve para hartimit të pasqyrave financiare pasi kjo vlerë del jashtë sistemit C@TS.

Në mbyllje të periudhës ushtrimore

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të rimbursimit të TVSH-së, u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë **88 kërkesa** për rimbursimin e TVSH-së të pranuara por **të pa miratuara** në vlerën totale për **1,992,004 mijë lekë** të cilat megjithëse kanë kaluar 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19,05,2008 Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 75/1, pika1, dhe VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ñPër dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pikat 3 dhe 4 të nenit 10.Si rezultat **vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së,** në vlerësimin e audituesve të KLSH-së është **11,789,313 mijë lekë** (9,797,309 mijë e paraqitur nga DPT plus 1,992,004 mijë lekë kërkesa të pranuara dhe në tejkalim të afatit të miratimit).*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masat e nevojshme me qëllim respektimin e afateve ligjore në kryerjen e procesit të rimbursimit të TVSH-së nga ana e DRT-ve dhe DRTVSH-së dhe raportimin e saktë dhe të plotë të stokut të detyrimeve për tu paguar. ***Deri më 31.12.2021***

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin ushtrimor 2020, të **ardhurat tatimore bruto dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve** janë realizuar në masën **235,499 milion lekë ose** në masën 95,5%, nga246,480 milion lekë të planifikuara me Aktit Normativ nr. 28, datë 01.07.2020 ñPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar në vlerën 10,981 milion lekë më pak se planifikimi të ardhurave.
Megjithëse, peshën kryesore në realizimin e të ardhurave e zënë DR Tatimpaguesit e Mëdhenj me një vlerë për 88,708 milion lekë ose 38 % të të ardhurave bruto dhe të ardhurave nga kontributet, konstatohet se kjo drejtori paraqet një performancë jo të mirë duke rezultuar me një mosrealizim të planit të të ardhurave në masën për 8,3% ose në vlerën për 8,031 milion lekë. Gjithashtu me një performancë jo të mirë paraqitet edhe DRT Dibër e cila ka

realizuar planin e të ardhurave bruto në vlerën për 2,797 milion lekë duke reflektuar një mosrealizim të planit në masën 16,64% ose në vlerën për 558 milion lekë më pak se plani.
Nga auditimi i procedurave të mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u konstatua se, nuk kanë performancë të mirë në mbledhjen e të ardhurave Drejtoritë Rajonale Tatimore, Vlorë, Tiranë, Durrës ku konstatohet se, vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar për këtë zë në mbyllje të periudhës 2020, përfaqëson 25-27% të realizimit faktik të ardhurave, e ndjekur nga DRT Shkodër, dhe Lezhë. Ndërkohë që Drejtoritë Rajonale Tatimore, me përformancën më të mirë paraqitet Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ku vlera totale e detyrimeve për tu arkëtuar përfaqëson 1.1% të realizimit faktik të të ardhurave. **Mos arkëtimi i të ardhurave nga kontributet** nga ana e DPT-së, për **16,521 milion lekë** nga njëra anë përbën të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nga ana tjetër pas kësaj shume qëndrojnë një numër i konsiderueshëm punëmarrësish, të cilët në këto kushte nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin nr.16, datë 21.02.2020 i Komitetit të Përmbushjes, i cili ka miratuar planin e të ardhurave tatimore për vitin 2020 për çdo Drejtori Rajonale Tatimore.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
4.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave nga këto Drejtori Rajonale me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. ***Deri më 31.12.2021***

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, vlera e llogarisë 466 ñMjete në ruajtjeò, e cila përfaqëson arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemimin e tyre, e përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuara sipas natyrës dhe llojit të të ardhurave është në vlerën për **22,916 milion lekë**[3]. Konstatohet se, lëvizjet më të mëdha kjo llogari i ka në muajin dhjetor të vitit, duke ndikuar në të ardhurat tatimore gjithsej të raportuara nga DPT për periudhën ushtrimore si dhe në saktësinë e raportimit sipas zërave të të ardhurave në llogaritë e dedikuara sipas klasifikimit buxhetor në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, pika 2.3.
Gjithashtu, pjesë e vlerës prej 22,916 milion lekë është edhe vlera prej 240,641 mijë lekë e pa kontabilizuar në llogarinë përkatëse të ñtë ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò, e cila përfaqëson 0,26 % të të ardhurave totale vjetore nga kontributet e sigurimeve ka efekt në planifikimin jo të saktë të shpenzimeve nga ana e ISSH dhe FSDKSH-së pasi kontabilizimi i pagesave të tatimpaguesve në këtë llogari përfaqëson një të ardhur të munguar për këto dy institucione. Gjithashtu mos sistemimi i kësaj llogarie do të ndikonte në kontributet për pension të individëve pagesat e të cilëve nuk janë transferuar në llogarinë përkatëse në ISSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46, ñObjekti dhe detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimorò të ñRregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimoreò të miratuar me urdhrin 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
5.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve të marrin masat e nevojshme për mbikëqyrjen e punës së DRT-ve në drejtim të sistemimit të arkëtimeve të pa identifikuarame qëllim minimizimin e vlerës së paraqitur në llogarinë 466 ñMjete në ruajtjeò dhe klasifikimin e saktë të të ardhurave tatimore.

Në vijimësi

[3] *pa përfshirë llogarinë 4665511 Depozitime të përkohshme për Tatim Fitimin e Thjeshtuar, vlerë e cila nuk është përfshirë në realizimin faktik të të ardhurave të DPT-së pasi kjo e ardhur kalon tek njësitë vendore.*

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e mbledhjes dhe të raportimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat mblidhen nga DPT, u konstatua se referuar shkresave mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020 të dërguara nga DPT në ISSH dhe FSDKSH, konstatohet se realizimi i të ardhurave nga kontributet në vlerën totale për 93,730,110 mijë lekë është i ndarë në: të ardhura nga kontributet e sigurimet shëndetësore në vlerën për 12,943,486 mijë leke dhe të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën për 80,786,625 mijë lekë, ndërkohë që në Raportin Vjetor të vitit 2020, të ardhurat nga kontributet paraqiten në vlerën për 94,876,872 mijë lekë, pra me një diferencë për 386,762 mijë lekë më shumë se raportimi i bërë në ISSH dhe FSDKSH. Konstatohet se për efekte raportimi DPT përfshin si të ardhur nga kontributet edhe të ardhurat nga gjobat për deklarim të vonuar të kontributeve dhe TAP, gjoba për mos deklarim punonjësish dhe depozitime të përkohshme për liste pagesën e kontributeve dhe TAP në vlerën totale për 386,762 mijë lekë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, vlerë e cila nuk është e përfshirë në raportimet që bëhet në ISSH dhe FSDKSH referuar shkresave mbi treguesit e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2020, vlerë e cila nuk përfshihet si e ardhur nga këto dy institucione. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 të MFE datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetoreò. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese të Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e nevojshme me qëllim unifikimin e vlerës së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shprehur në raportimet e DPT-së me vlerën e raportuar si e ardhur nga kontributet për institucionet e ISSH-së dhe FSDKSH-së.

Në vijimësi

7.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të drejtorive funksionale në DPT konstatohet se:

- Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, për periudhën 01.01.2020-24.07.2020 ka funksionuar me **7** (shtatë) punonjës në strukturë organike, nga 8 gjithsej të miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 3.5.2019 të Kryeministrit (*përfshirë drejtor dhe përgjegjës sektori*) ndarë në 2 sektorë:

-Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve (*2 punonjës*), Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara (*1 përgjegjës dhe 4 punonjës*). Për këtë periudhë konstatohet një vend i pa plotësuar me punonjësnë pozicionin drejtor drejtorie, deri me hyrjen në fuqi të strukturës së re bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.2.2020. Me ndryshimet strukturore për periudhën 24 Korrik 2020-Dhjetor 2020, konstatohen katër vende të lira: Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese: me 2(dy) vende të lira/vakante, në pozicionin: P/Sektori 1(një) dhe inspektor 1 (një). Sektori Monitorimit & Analizës: me 2 (dy) vende të lira/vakante, në pozicionin P/Sektori 1(një) dhe inspektor 1(një).

- Implementimi i strukturës së re të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut ka filluar në korrik të vitit 2020, ose rreth 5 muaj e gjysmë me vonesë si dhe ka mungesa në personel për këtë drejtori.

- Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk është plotësuar me numër punonjësish e kryesisht Sektori i Kontrollit Tatimor ka mangësi në 50 %. Riorganizimi ka konsistuar në ndarjen e kësaj drejtorie në sektorë, pra në shtimin e sektorëve duke mbajtur të njëjtin numër punonjësish.

7.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Drejtorinë e Hetimit Tatimor konstatohet,mosplotësim i organikës me punonjës në pozicionin e përgjegjës sektori dhe inspektor hetimi kështu:nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës së bashku me 1 punonjës të këtij sektori, nuk është plotësuar pozicioni i punës së Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit së bashku me 4

punonjës të këtij sektori, kur gjithsej janë 9 punonjës ose 45% më pak punonjës së organika, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave. Gjithashtu për periudhën në vijim maj 2020 deri më 31.12.2020 konstatohet se: nuk është kryer ristrukturimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në afatet e përcaktuara po rreth 2 muaj me vonesë, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nuk është plotësuar pozicioni i punës i Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës, nuk është plotësuar Sektorit të Parandalimit dhe Pastrimit të parave me numrin e punonjësve ku konstatohet se nga 3 punonjës ai ka vetëm 1 punonjës;
Nga Drejtori i Hetimit nuk janë plotësuar kërkesat e udhëzimit për procedurat tatimore në të cilën shprehet se në zbatim të neneve 19 dhe 20 të ligjit për rekrutimin e punonjësve të hetimit tatimor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve kandidatura të mundshme për tu përzgjedhur për tâu punësuar në struktura të caktuara të drejtorisë së hetimit tatimor në qendër dhe rajone, në përputhje dhe në zbatim të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke sjellë që shumë vende pune të jenë të paplotësuara.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve të marrë masa për plotësimin e organikës në kuadër të ndryshimeve të strukturës së miratuar me VKM, kompetencave, mënyrës së emërimit, me punonjës të kësaj drejtorie sipas pozicioneve të miratuara.

Deri më 31.12.2021

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në zbatim të planit operacional për vitin 2020, nuk janë kryer inspektimet në 4 rajonet/Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM, me argumentin e shpalljes së gjendjes së karantinës për Covid 19. Në këtë kushte, përmes daljes së akteve ligjore e nënligjore nga qeveria për të përballuar situatën, janë krijuar përfitime për subjektet tatimpagues, me qëllim lehtësimin në afatet e vetë deklarimit dhe njëkohësisht përmbushjen e detyrimeve tatimore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Urdhrin nr.25 datë 11.03.2020 ka hartuar një plan masash ñPër zbatimin e planit të masave në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19ò. Në kuadër të planit të masave të miratuar me urdhrin e sipërcituar, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit Covid 19 dhe vijimësinë e punës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Administratës Tatimore, nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk janë kryer inspektimet nëpër Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe DTM me qëllim minimizimin e rrezikut të infektimit nga COVID-19 për nëpunësit /punonjësit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa që në të ardhmen inspektimet në rajone të intensifikohen, duke përmbushur edhe detyrat e parashikuara në planin operacional miratuar me Vendimin nr. 16, datë 06.02.2020.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, referuar informacionit të siguruar nga kjo drejtori, gjendja e detyrimeve të papaguara deri me datë 31.12.2020 është 122.4 miliard lekë. Gjatë vitit 2020, stoku i detyrimeve tatimore ka pësuar një rritje neto prej 5.4 miliard lekë krahasuar me fillim vitin 2020. Në vlerën e detyrimeve tatimore të papaguara deri më 31 Dhjetor 2020, prej 122.4 miliard lekë është përfshirë vlera prej 13.7 miliard lekë që përbën 11% të stokut të detyrimeve tatimore të papaguara dhe që përfaqëson detyrimet që rrjedhin nga proceset gjyqësore për 1462 subjekte, sipas të dhënave të raportuar nga 4 rajonet. Detyrimet tatimore

të papaguara në afat për periudhën nga gushti 2020 deri dhjetor 2020 janë rritur në vlerën 0,1 miliard lekë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandim: Të merren masa nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për minimizimin detyrimeve tatimore të papaguara përmes mbledhjes së tyre, duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore të parashikuar. ***Në vijimësi***

10.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut konstatohet se, moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja nga viti 2015, vit në të cilin është implementuar sepse ky modul shqyrton automatikisht aspekte të veçantë të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi. Ky azhornim bëhet i domosdoshëm për të qenë në koherence me gjithë ndryshimet që ka pësuar legjislacioni fiskal ndër vite, vetë administrata tatimore por edhe profili i tatimpaguesve. Kjo me qëllim identifikimin dhe verifikimin e tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial në harmoni me procedurat ligjore në fuqi dhe ndihmon administratën tatimore të zbulojë evazionin dhe mashtrimin tatimor. Konkretisht gjatë vitit 2020, një numër i madh tatimpaguesish reduktuan xhiron e deklaruar për të përfituar nga lehtësi tatimore, bazuar në ndryshimet ligjore VKM nr. 576 datë 22.07.2020 dhe me ligj nr. 106 datë 29.07.2020 lidhur me ndryshimin e pragjeve të qarkullimit për tu përfshirë në përgjegjësinë tatimore 10 milion lekë dhe për Tatim Fitimi 14 milion lekë; Gjithashtu, pavarësisht ekzistencës së modulit të riskut, nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe përpunimit të të dhënave bëhen manualisht, nëpërmjet programit Excel që kërkon kohë dhe punonjës të shumtë në numër. Kështu p.sh. vetëm një listë pagesë mujore e punonjësve të regjistruar në listëpagesat e administratës tatimore ka rreth 700 mijë pozicione pune.

10.2 Gjetje nga auditimi. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, në procesin e identifikimit dhe vlerësimit risqeve bazohet edhe në gjetjet e përgjithshme të raporteve të kontrollit të kryera nga DRT-të. Konstatohet se këto raporte kontrolli për vetë mënyrën si hartohen nga drejtoritë e kontrollit në DRT, e bëjnë të pamundur unifikimin e vlerësimeve të rrjedhura nga shkeljet ligjore të evidentuara rast pas rasti, kjo për faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është në proces pune për një standardizim dhe unifikim të tyre. Gjithashtu DRT nga ana e tyre nuk përgatisin raporte përmbledhëse për çka konstatohet dhe të raportojnë në mënyrë periodike kush janë problematikat më të shpeshta të hasura dhe mendime për përmirësimin e kritereve të risqeve në bashkëpunim me DMR. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar modulin e riskut, në koherencë me procedurat dhe ndryshimet ligjore në fuqi në ndihmë të administratës tatimore për të zbuluar evazionin dhe mashtrimin tatimor.

Deri më 31.12.2021

10.2.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa për standardizimin e raporteve të kontrollit të hartuara nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT, për të mundësuar unifikimin e vlerësimeve me qëllim përpunimin e informacionit mbi shkeljet e evidentuara. Në çdo rast të përgatiten raporte përgjithësuese në mënyrë periodike me problematikat më të shpeshta të hasura dhe me mendime për përmirësimin e kritereve të risqeve.

Deri më 31.12.2021

11. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, DPT nëpërmjet DMR ka firmosur memorandumit e bashkëpunimit me OSHEE (Operatori i Shpërndarjesh së Energjisë Elektrike), Bashkinë e Tiranës dhe është në proces firmosje me Shoqatën e Eksperteve Kontabël (IEKA) dhe UKT (Ujësjellës Kanalizime Tiranë). Do të ishte mirë që kjo iniciativë të shtrihej në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të këtij informacioni do të mundësohej përfshirja e të gjithë

tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave për të gjithë vendin me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta për shkëmbimin e të dhënave, të punojë që kjo iniciativë të shtrihej në rang kombëtar sepse nëpërmjet shkëmbimit të informacionit do të mundësohej përfshirja e të gjithë tatimpaguesve dhe kryqëzimi i shumë të dhënave me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe edukimin e tatimpaguesve.

Në vijimësi

12.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rezultateve të veprimtarisë së DHT në përputhje me përgjegjësitë ligjore, për vitet 2019 dhe 2020, nuk mund të arrijmë në konkluzione të plota nëse ishte i domosdoshëm dhe efektiv ky ndryshim në strukturat e hetimit sepse nuk jepen rezultatet konkretë të aktivitetit dhe se çfarë është arritur. Gjithashtu, në lidhje procedurat e ndjekura, Drejtoria e Hetimit Tatimornuk paraqiti të dhëna mbi korrespondencat me Drejtorin e Përgjithshëm, Drejtoritë e DPT si dhe Drejtoritë Rajonale si dhe të dhëna mbi ecurinë e realizimit të kontrolleve të propozuara. Kjo e argumentuar me pretendimet e legjislacionit të veprimtarisë së DHT se ñ*..për informacionin e mbledhur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për tatimpaguesit në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, dokumentimit të shkeljeve, konsiderohen konfidenciale, dhe mos respektimi i këtij detyrimi për administratën konsiderohet si cenim i së drejtës për tatimpaguesin si dhe dhënia e informacionit për tatimpaguesit në proces hetimi tatimor cenon këtë parim dhe dëmton emrin e mirë si një vlerësim i përgjithshëm i aktivitetit të biznesit...", etj.,* duke krijuar kështu një kufizim për realizimin e objektivave të auditimit për këtë çështje.

12.2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Hetimit Tatimor ka kryer propozime për vlerësim të situatës financiare dhe propozime për kontroll për vitin 2020 për 296 raste, nga të cilat 144 janë kanë përfunduar dhe kanë rezultuar me gjetje në vlerë prej 494,530 mijë lekë (detyrime+ gjoba) ndërsa për 152 rastet e tjera janë në proces ndjekje nga DRT, por nga ana e kësaj drejtorie nuk ka të dhëna se në çfarë faze janë çka tregon se nuk ka një bashkëpunim ndërmjet saj dhe DRT, gjë e cila ngarkon me përgjegjësi DRT dhe drejtorin e Drejtorisë së Hetimit. Konstatohet se në fund të vitit 2020 kanë mbetur pa u përfunduar rreth 50% e rasteve të denoncimeve nga të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

<u>12.1.Rekomandim</u>: Drejtori i Përgjithshëmtë marrë masa që Drejtoria e Hetimit Tatimor të përfundojë vlerësimin e situatës financiare të subjekteve të propozuara për kontroll gjatë vitit 2020 për 152 raste nga 296 raste gjithsej të cilat janë në proces ndjekje nga DRT *s*i dhe të përfundojnë analizimin e rreth 50 % të rasteve të denoncimeve të ardhura për vitin 2020 të cilat mund të rezultojnë me shkelje nga më të ndryshmet nga subjektet tatimpagues.

Deri më 31.12.2021

<u>12.2.Rekomandim</u>: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim më Drejtorinë Juridike të analizojë dhe të japë përgjigje të argumentuar për mos paraqitjen e të dhënave dhe për mos vënien në dispozicion të dosjeve të subjekteve, me qëllimin auditimin e përputhshmërisë ligjore dhe procedurale të ndjekur nga struktura e Hetimit Tatimor, në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të shmangieve fiskale.

Deri më 30.11.2021

13. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2020, konstatohen mangësi në drejtim të udhëheqjes metodologjike të

funksionit të kontrollit tatimor dhe monitorimit të punës së drejtorive rajonale tatimore lidhur me përgjegjësitë e tyre në zbatimin e legjislacionit tatimor. Konkretisht:
-Në zbatim të planit operacional për kontrollet monitoruese që Drejtoria e Kontrollit në DPT duhet të ushtrojë në drejtoritë rajonale, konstatohet se: nuk është realizuar për vitin 2020, asnjë program kontrolli në DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës. Qëllimi i këtyre kontrolleve është vlerësimi i punës në përmbushje të kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, mbulimin e periudhave të pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshme në të gjitha DRT; analizat dhe raportet e vizitave fiskale të zhvilluara duke mbajtur akt konstatime për inspektorët përgjegjës dhe propozuar masa konkrete për shkeljet e konstatuara
-Gjithashtu, Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit në këtë drejtori si pjesë e kontrollit nga zyra, i krijuar me objektiv monitorimin nga zyra të projektit të fiskalizimit, nuk ka qenë plotësisht në eficencë pasi ky projekt nuk është implementuar dhe nuk është shtrirë në të gjitha subjektet tatimpagues për faktin se hyri në fuqi më 1 korrik 2021 ose rreth dy vjet me vonesë nga parashikimi.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandim: Drejtoria e Kontrollit Tatimor të realizojë në vijim kontrollin e performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, në DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës në DRT, bazuar në kritere për vlerësim, me qëllim plotësimin e detyrave të parealizuar në objektivat e saj për vitin 2020 e në vijim.

Deri më 31.12.2021

13.2.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të marrë masa konkrete për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kontrollet e parealizuar dhe monitorimin e munguar nga Drejtoria Kontrollit Tatimor gjatë vitit 2020. Kjo me qëllim rritjen e udhëheqjes metodologjike të funksionit të kontrollit tatimor në qendër si dhe monitorimin periodik të punës të gjithë drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor. ***Deri më 31.12.2021***

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor e DPT në drejtoritë rajonale konstatohet se nuk është realizuar plani i kontrolleve nga DRT Lezhë, Tiranë, Berat. Gjithashtu konstatohen mangësi në drejtim të: mos përfundimit të analizave nga ana e DRT Korçë, Gjirokastër dhe Durrës për vitin 2019 si dhe nuk janë marrë masa nga ana e tyre për arkëtimin e detyrimeve përkatësisht: DRT Korçë 24,694 mijë lekë, DRT Gjirokastër 5,492 mijë lekë dhe DRT Durrës për vlerën prej 180,437 mijë lekë ndërkohë që ka kaluar viti 2020. Këto detyrime kanë të bëjnë me diferencat e konstatuara të TVSh-së të transmetuara nga pajisjet fiskale standarde krahasuar me situatën financiare të shfaqur në sistemin C@ts.
Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se ky kontroll i Drejtorisë së Kontrollit në DPT nuk është përfunduar. Grupi i kontrollit është tërhequr nga kryerja e këtij program monitorimi dhe kontrolli me urdhrin verbal të eprorëve, gjë e cila është konfirmuar në njoftimin me e-mail të datë 16.11.2020 drejtuar z.A. Ç. zv/Drejtor i Përgjithshëm dhe i Komanduar Drejtor i Drejtorisë Kontrollit si edhe në raportin paraprak të kontrollit. Gjithashtu me e-mail është njoftuar herë pas herë znj. O. U. në cilësinë e kryetarit të grupit që ndjek planin operacional korrik ï dhjetor 2020. Për projekt raportet paraprake të hartuara nga grupi dhe të nisura sipas shkresave të mësipërme i është nisur informacion me e-mail Përgjegjësitë e Sektorit të Kontrollit në vend në datën 29.01.2021 si dhe problematika për kohën e kufizuar dhe ndërprerje të këtij kontrolli në tre DRT dhe nga grupi i kontrollit nuk është marrë përgjigje. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të urdhërojë përfundimin e kontrollit të ndërprerë në DRT Lezhë, Tiranë, Berat, në bazë të autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020

dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020 për saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të vlerësuara si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për drejtuesit të cilët kanë anuluar pa shkak kontrollin në DRT Lezhë, Tiranë, Berat, në bazë të autorizimit nr. 20409, datë 20.10.2020 dhe program kontrolli nr. 20409/1, datë 20.10.2020.

Deri më 31.12.2021

15. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Kontrollit nuk ka praktikë verifikimin dhe kontrollin nga zyra të veprimtarisë kontrolluese të DRT-venëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts ku të verifikohet, kontrollohet dhe analizohen fenomene të cilat janë si bazë për arritjen e konkluzioneve në mirëfunksionimin e DK në DRT si: analizave të situatave kreditore debitor e tatimpaguesve për sigurimet; analiza e efektshmërisë së kontrollit të plotë apo nga zyra; analiza nëse janë efektive elementët e riskut që janë nxjerrë për kontroll si nga DMR apo dhe DRT pas kontrollit, apo është cilësia e kontrollit ajo që nuk shkon në realizimin e këtyre kontrolleve; analiza si bëhet hedhja në sistem në përputhje me manualin e kontrollit për aktet e kontrollit; analiza për kështet e tatimfitimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi; analiza për kontrollet nga zyra; analiza për vazhdimësinë pas njoftim vlerësimit që i është bërë tatimpaguesit; analiza sa arkëtohen detyrimet e njoftim vlerësimi kur s'ka apelime; analiza si zbatohet procesi i rimbursimit pas miratimit nga DPT; analiza e gjendjes kreditore të TVSh-së; analiza mbi situatat e parregullta sa janë dhe veprimet e ndërmarra nga inspektorët e kontrollit nga zyra; analiza se ku bazohen dhe si zgjidhen rastet për kontroll nga inspektorët e kontrollit në DRT.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

<u>15.1.Rekomandim</u>: Drejtoria e Kontrollit të hartojë praktika verifikimi nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts nëpërmjet analizave: të situatave kreditore- debitor të tatimpaguesve për sigurimet; të zbatimit të procesit të rimbursimit; të gjendjes kreditore të TVSh-së; analiza për kështet e tatimfitimit për rastet që është ndërhyrë pas kështit që vendos sistemi, kryqëzimin me të dhënat nga sistemi doganor, etj., me qëllim identifikimin fenomeneve dhe rritjes së zbulueshmërisë së shmangieve fiskale.

Deri më 31.12.2021

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se planifikimi i numrit të kontrolleve është objekt vendimmarrje i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, dhe që përbëjnë 70% të planit të kontrolleve ndërkohë që nga strukturat e Drejtorive Rajonale Tatimore propozohet një numër kontrollesh në nivelin e 30% të totalit të kontrolleve të planifikuara. Në të gjitha rastet, kontrollet e propozuara për tu kryer nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut janë rekomanduar për kontrolle të plota për shkak të riskut të lartë të evidentuar në vlerësimin e kritereve të paracaktuara për këtë përzgjedhje. Në vijim, realizimi dhe përmbushja e këtij cikli sipas argumentimit të bërë realizohet nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT.

Në këtë proces, konstatohet se nuk ka një bashkërendim të mirë dhe qartësisht të përcaktuar midis të tre strukturave: Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në qendër dhe në rajone, nëpërmjet një regjistri, programi, data baze në sistemin *C@ts*, ku të jenë rakorduar në mënyrë të saktë dhe automatike moduli 70%, moduli 30%, etj., nga momenti i nxjerrjes nga sistemi i DMR, miratimi për kontroll i regjistrimit të kontrollit e deri në përfundimin e tij në çdo fazë të kontrollit për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve. Kështu, konstatohet se nga të gjitha DRT nuk kanë planifikuar nga ana e tyre kontrolle për të gjithë muajt për vitin 2020, ndërsa DRT Lezhës dhe Sarandës nuk kanë planifikuar asnjë kontroll nga ana e tyre për gjithë vitin 2020.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandim: Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të ngrihet grup pune me përfaqësuesit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për të mundësuar një rakordim të saktë, automatik dhe të gjurmueshëm të kontrolleve të përzgjedhura sipas modulit 70%, dhe propozimeve në nivelin 30%, me qëllim monitorimin e realizimit të planit të kontrolleve deri në përfundimin dhe raportimin tyre, për të arritur në konkluzione të sakta mbi ecurinë e tyre dhe analizuar shkaqet e mos përfundimit apo vonesave në kryerjen e kontrolleve. ***Deri më 31.12.2021***

17. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me realizimin e numrit të kontrolleve për vitin 2020 konstatohet se nga 1540 kontrolle gjithsej të planifikuara janë realizuar 1432 kontrolle ose 93% e planit. Nga 108 kontrolle të parealizuara (nga të cilat 107 janë kontrolle të plota), me mosrealizime të mëdha të planit të kontrolleve janë: DRT Dibër me 7 kontrolle, Durrës me 10 kontrolle, Elbasan me 19 kontrolle, Fier me 21 kontrolle, Gjirokastër me 9 kontrolle, Korçë me 22 kontrolle, dhe VIP me 13 kontrolle të pa realizuara. Për sa i përket llojit të kontrolleve, numri i kontrolleve të plota në 2020 krahasuar me 2019 është 43 % më i ulët, gjithashtu dhe numri i vizitave fiskale është 20 % më i ulët.
Sa i përket rezultateve të kontrolleve, për 11 tatimpagues janë gjetur zbulimet në vlerën 7,986,537 mijë lekë ose 84% e vlerës totale të zbulimeve vjetore për 14 DRT-të që është 9,514,994 mijë lekë. Në kontrollet e planifikuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe që përfaqëson 70 % të planit të kontrolleve rezulton se janë kryer gjithsej 1136 kontrolle ose sa 79 % kundrejt e numrit gjithsej të kontrolleve të kryera gjatë vitit 2020, shkalla e zbulimeve është në masën më të ulët ose sa 20 % e zbulimeve gjithsej. Ndërkohë, kontrollet e kryera si përfaqësuese e 30 % e kontrolleve të propozuara nga DRT, niveli i zbulimit është me i lartë megjithëse janë në numër më të vogël kontrollesh (285 kontrolle) por zbulimet sa janë 79 % të zbulimit total.*(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
17.1.Rekomandim: Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të nxjerrë përgjegjësitë për kontrollet e planifikuara për vitin 2020 dhe të parealizuara ku mosrealizimet më të mëdha janë në DRT: Dibër , Durrës , Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, dhe DTM. ***Deri më 30.11.2021***

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nga Drejtoria e Kontrollit nuk janë përfunduar kontrolle nga viti 2015, sepse deri në fund të dhjetorit të vitit 2020 janë gjithsej 537 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose në proces, e konkretisht si më poshtë të ndara në:

- të pezulluara - 14 kontrolle;
- të pa filluara - 194 kontrolle;
- të dërguar projekt raporti i kontrollit - 233 kontrolle
- të mbajtura nga përgjegjësi i kontrollit - 2 kontrolle
- të mbajtura nga Drejtori i Kontrollit - 19 kontrolle
- të dërguara projekt/paraprak i kontrollit - 66 kontrolle
- kontrolle në pritje të observacionit nga subjektet - 6 kontrolle
- të dërguara raporti përfundimtar - 3 kontrolle

(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1.Rekomandim: Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të nxjerrë përgjegjësitë për gjithsej 537 kontrolle nga viti 2015, të pezulluara, të pafilluara ose në proces, të planifikuara në vite e të parealizuara.

Deri më 31.12.2021

19. Gjetje nga auditimi: Llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, e cila pasqyron shpenzimet që do të kryhen në periudhat pasardhëse, nuk pasqyron vlerën e plotë.

Kjo llogari përbëhet nga vlera 1,500,621 mijë lekë e pasqyruar në llogarinë 486 të pasqyrave financiare të Aparatit të DPT dhe vlera 66,250 nga DRT. Konstatohet se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës stokun e rimbursimit të TVSH-së prej 9.7 miliard lekë nuk e ka pasqyruar në llogarinë 486 -Shpenzime të periudhave të ardhshme, por në llogarinë 467. Mos përfshirja e stokun e rimbursimit të TVSH-së prej 9.7 miliard lekë në raportimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat të udhëzimit plotësues të MFE nr. 2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të viti 2020ò dhe shtojcën 4 ñDetyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-sëò. Mos kontabilizimi i plotë i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 -Shpenzime të periudhave të ardhshme, është në kundërshtim me pikës 42 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, ku përcaktohet se detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve duhet të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare në llogarinë 486 sipas llogarive specifike të kontabilitetit.

Në vlerën e detyrimeve të prapambetura të raportuara në MFE bënë pjesë edhe vlera e detyrimit për investime prej 569,127 mijë lekë, e cila ju përket dy projekteve të cilët bazuar në kontratat që administron DPT duhet të ishin likuiduar tërësisht. Këto projekte janë:

a- **"**Përmirësimi i modulit të Manaxhimit të Kontrollit të Faturimitò (Fiskalizimi), zhvilluar si procedurë në vitin 2018 nga AKSHI, lidhur kontrata nr. 6756 date 27/11/2018 vlere totale 1,727,792 mijë lekë), me kod projekti M100500, me afat përfundimi të likuidimit brenda vitit 2020. Detyrimi i pa likuiduar më 31.12.2020 është në vlerën 512,787 mijë lekë (detyrim jashtë afatit të kontratës). Që nga viti 2018 e në vijim nuk është respektuar likuidimi vjetor i parashikuar në kontratë, por është likuiduar më pak, gjë e cila ka sjellë edhe krijimin e detyrimit të prapambetur më 31.12.2020 në vlerën 512,787 mijë lekë.

b-ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, me kod produkti 18AV811, kontrata 3275 date 10/07/2020 vlere 80,040 mijë lekë, e cila është zhvilluar nga AKSHI në vitin 2020, me afat likuidimi brenda vitit 2020.Fillimi dhe miratimi i zhvillimit të kësaj procedure prokurimi nga DPT është bërë pa pasur fonde në dispozicion për këtë projekt, i cili nuk ka qenë i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe në planin fillestar vjetor. Ndryshimi i planit fillestar vjetor dhe futja e këtij projekti në listën e investimeve, është bërë me kërkesë të DPT, jo si rezultat i çeljes së fondeve të reja buxhetore, por si rezultat i transferimit të fondeve prej 23,700 mije lekë, nga projekti ekzistues ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò. Ky transferim ka qenë i gabuar, i pa argumentuar, pasi këto fonde nuk kanë qenë fonde ñtepërò për këtë projekt, por fonde të planifikuara dhe të nevojshme për tu shpenzuar për të. Si rezultat për projektin ñNgritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huajaò, më 31.12.2020 DPT ka krijuar një detyrim të ri të prapambetur në vlerën 56,340 mijë lekë, ose 58% të vlerës së investimit, si dhe ka lënë pa mbuluar me fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2020, investimin ñKrijimi i një mjedisi te ri dhomë serverësh (data center), sistem telefonik VOIP dhe monitorimi i qendërzuar për DPT/DRTò, për vlerën 23,700 mije lekë. Pra e gjithë vlera e investimit prej 80,040 mijë lekë, është angazhim i ri buxhetor pa pasur fonde në dispozicion, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, pika 153-162.

Mos shlyerja e detyrimeve për angazhimet e mara buxhetore, është në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis palëve, si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1.Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për raportimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore të detyrimeve për stokun e rimbursimit të TVSH-së në

Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH të informojë zyrtarisht Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës për vlerën e detyrimit.

19.2.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të ndërpresin praktikën e marrjes së angazhimeve buxhetor pa pasur më parë fonde në dispozicion. Në hartimin e buxhetit për vitin 2022, më parë të planifikohen fonde (dhe të zbatohen të pa ndryshuara gjatë vitit), fonde investimet e filluara dhe të pa likuiduara sipas parashikimit në kontratë.

Deri më 30.11.2020

20. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të konsoliduara të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò, e cila pasqyron gjendjen e debitorëve për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera brenda dhe jashtë sistemit C@TS, detyrimet e kontabilizuara por të mbajtura jashtë sistemit C@TS janë në vlerën 2,809,818 mijë lekë. Detyrimet jashtë sistemit C@TS janë në kontabilitetin e DR Tatimore dhe përbën detyrime të krijuara para vitit 2015, që i përkasin kohës kur jo te gjitha deklaratat tatimore ishin te informatizuara apo situatës për sigurime shoqërore e shëndetësore para se të kalonin ne ndjekje e administrim nga Administrata Tatimore.

Pjesën me te madhe në këto detyrime e zë akciza e cila i përket kohës para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohej dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky detyrim akcize prej 2,107,793 mijë lekë, i përket vetëm 2 tatimpaguesve, ñA.ò sha me Nipt J. në vlerën 2,106,993 mijë leke, subjekt i cili është në administrim te DRT Tirane dhe subjekti ñI.ò, me Nipt J., në vlerën 799,228 leke, subjekt i cili është në administrim të DR Tatimpaguesit e Mëdhenj.

Detyrimi për akcizën zë 75 % të totalit te detyrimeve jashtë sistemit C@TS, ndërsa 14 % te detyrimeve jashtë sistemit janë raportim nga Sektori i Shpenzimeve në DRT dhe DPT (aparati) te cilat nuk lidhen me te ardhurat tatimore, për rrjedhoje është normale të jenë jashtë sistemit C@TS. Vetëm 11% e detyrimeve jashtë sistemit C@TS, në vlerën 317,577 mijë lekëjanë për të ardhura tatimore për te cilat Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor me inspektoret e kontrollit nga zyra, do të duhet ti hedhin në sistemin C@TS, pasi për këto detyrime ka module përkatëse në sistem, si në vijim: Tatim mbi te ardhurat shuma 58,993,901 leke; Tatim fitimi shuma 2,772 mijë lekë; Taksa mbi biznesin e vogël shuma 63,750 lekë; Te tjera tatime (ne burim) shuma 17,556 mijë lekë; Tatim mbi vlerën e shtuar shuma 10,609 mijë lekë; Taksa e rrugës shuma 165 mijë lekë; Gjoba dhe kamate vonesa shuma 10,113 mijë lekë; Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore,shuma 217,302 mijë leke.

Mos hedhja në sistemin sistemin C@TS të vlerës 317,577 mijë lekë është në kundërshtim me kapitullin 6, ku përcaktohen detyrat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të ñRregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimoreò. *(Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20.1.Rekomandim: Drejtoria e Kontrollit Tatimor të marrë masa për hedhjen në sistemin C@TS të vlerën 317,577 mijë lekë, detyrime të subjekteve të pa përfshira në këtë sistem dhe për të cilat ka modul. ***Deri më 31.12.2021***

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, u konstatua se për 26 vendime gjyqësore për largimin e punonjësve nga puna, për disa prej tyre ka diferenca të konsiderueshme në kohë midis datës së zbardhjes së vendimit të formës së prerë nga Gjykata dhe datës së depozitimit të këtij vendimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Në disa prej tyre diferenca është me disa vjet, ndërkohë që institucioni angazhon juristë përkatës për ndjekjen e çdo procesi gjyqësor (Vendimi i Gjykatës nr. 10, date 27.12.2013, depozituar në DPT në vitin 2020, shtatë vjet me vonesë, Vendimi nr. 12, datë

22.01.2014, depozituar në DPT në vitin 2020, gjashtë vjet me vonesë, Vendim nr. 28 datë 19.01.2015, depozituar në DPT në vitin 2020, pesë vjet me vonesë, Vendim nr. 3850, datë 20.09.2017, depozituar në DPT në vitin 2020, tre vjet me vonesë). Gjithashtu gjatë vitit 2020 nuk u konstatuan zbatimi i asnjë vendimi gjyqësor në mënyrë vullnetare dhe shpenzimet përmbarimore për këtë vit kanë vlerën 21,959 mijë lekë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 5, 6 dhe 7 të nenit 101 ñ Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit të çështjeve ligjoreò; Pikën nr. 5 Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò; Neni 15 i ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 ñKodi i procedurës civile i Republikës se Shqipërisëò.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
21.1.Rekomandim: Drejtoria Teknike dhe Ligjore të marrë masa që me përfundimin e proceseve gjyqësore dhe daljen e vendimit të Gjykatës, të njihet menjëherë institucioni më këtë vendim për të programuar zbatimin e tij në kohë.Të mundësohet në çdo rast kryerja e pagesës së vendimit gjyqësor në mënyrë vullnetare, duke lidhur aktmarrëveshje me kreditorin, me qëllim shmangien e shpenzimeve përmbarimore.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në vlerën e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2020 prej 1,500,621 mijë lekë, përfshihet edhe detyrimi prej 82,645 mijë lekë që DPT ka për likuidimin e shtypshkrimeve të ndryshme. Ky detyrim vjen për shkak të stokut të këtyre shtypshkrimeve të blera prej DPT dhe të pa shitura ende, të cilat i përkasin jo vetëm vitit 2020, por edhe më parë. Në fund të vitit, Drejtoritë Rajonale Tatimore kthejnë pranë DPT të gjithë stokun e pa shitur të produkteve si bileta, pulla me të cilat furnizohet Ministria e Jashtme, blloqe tatimore, dëftesa tatimore, etj., të cilat ngelën mall stok i pa likuiduar. Ky stok likuidohet nga fondet e të ardhurave dytësore, të cilat sigurohen nga shitja e këtyre shtypshkrimeve.
Vlera prej 82,645 mijë lekë në fund të vitit 2020 është një vlerë e konsiderueshme, e cila duhet të përbëjë shkak për DPT, për rishikimin e sasive të furniturave me shtypshkrimeve në lidhje të ngushtë me nevojat reale, si dhe në ndarjen në disa furnitura gjatë vitit me sasi të ulët. Duke marrë në konsideratë dinamikën e ndryshimeve ligjore, një stok i konsiderueshëm shtypshkrimesh, mbart risk që një lloj i caktuar shtypshkrimi/dokumenti, të mos nevojitet më për përdorim, për arsye të humbjes së aktualitetit, situata të cilat shoqërohen me kosto financiare për buxhetin e shtetit, kur ka ende mall stok të pa shitur. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, 11 dhe 12 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
22.1.Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet strukturave përkatëse që programojnë blerjen e shtypshkrimeve, si dhe nëpunësit zbatues, të vlerësoj nivelin e lartë të stokut të shtypshkrimeve dhe të rishikojë sasinë e nevojave reale për çdo dokument në të ardhmen duke marrë në konsideratë shitjet që janë kryer gjatë vitit të mëparshëm buxhetor ashtu edhe pritshmëritë e nevojave të përdoruesve të shtypshkrimeve, si dhe duke shtuar shpeshtësinë e porosisë dhe duke ulur sasinë e artikujve, me qëllim që të të shmang mallin stok. ***Deri më 30.10.2021***

23. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e të ardhurave tatimore teprica e llogarisë 4665003, më datën 31.12.2019 paraqitet në vlerën 115.4 miliard lekë, ndërsa sipas sistemit C@TS teprica kreditore më datë 31.12.2020 është në vlerën 14.1 miliard. Për efekte të raportimit fiskal të ardhurat nga tatim fitimi raportohen në bazë cash-i, pra të ardhurat tatimore të realizuara janë të barabarta me arkëtimet gjatë vitit 2020, pa u kryqëzuar dhe sistemuar me deklarimet vjetore të 31 Marsit 2020 për rezultatin tatimor të vitit 2019. Deklaratat vjetore për tatim

fitimin, sistemojnë situatën reale të subjektit në sistemin C@TS, por ky veprim nuk gjen pasqyrim në kontabilitet dhe rrjedhimisht paraqitet si një shumë e akumuluar progresivisht vit pas viti, si një ñdetyrimò në pasivin e bilancit të DPT-së me kundër parti ñllog. 520 disponibilitete në thesarò. Në këto kushte, këto llogari paraqiten në pasqyrat financiare të DPT-së të mbivlerësuara krahasuar me situatën reale të tepricës kreditore të vlefshme në C@TS, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshmeò.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

23.1.Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë duhet të marrin masa për të përcaktuar skemën e kontabilizimit të veprime rregulluese për llogarinë 466 ó Kreditorë për mjete në ruajtjeô dhe llogarinë 520 ó Disponibilitete në thesarô, me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të mjeteve disponibël në Thesar dhe detyrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj tatimpaguesit kreditor për tatimin mbi fitimin e mbi paguar.

Deri më 31.12.2021

24. Gjetje nga auditimi:Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 për ñRiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, i ndryshuar, neni IV pika 18, është ngritur urdhri i përbashkët nr. 8778 prot, datë 02.05.2019, ndërmjet Drejtorisë se Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Në këtë urdhër është përcaktuar ngritja e grupeve të punës për të përgatitur listën e aktiveve për infrastrukturën hartdware dhe sistemet IT, si dhe të identifikojnë të drejtat dhe detyrimet e institucioneve në lidhje me aktivet. Ky urdhër është pasuar me urdhrin e brendshëm nr. 9379 prot., datë 09.05.2019 për krijimin e grupit të punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për kalimin e aktiveve në inventarin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i cili ka pasur si detyrë përcaktimin e listës së inventarit të aktiveve për infrastrukturën hardware dhe sistemet IT të DPT dhe kalimi i tyre në inventarin e AKSHI-it. Grupi i punës së DPT ka hartuar listën e aktiveve për transferim dhe e ka dërguar këtë pranë AKSHI-t në datën 31.07.2019, me shkresën nr. 14753 prot., ñKërkesë për konfirmim të listës së aktiveveò. Megjithatë, transferimi i aktiveve nga DPT te AKSHI vazhdon ende të mos jetë kryer, për arsye se AKSHI ka kërkuar që nga DPT të plotësohet kodi në burim për këto sisteme, por nga ana e DPT është vendosur ne dispozicion kodi në burim për sistemet M-tax dhe E-tax, ndërsa për sistemet Nexus (kasat), harta dixhitale dhe BI është komunikuar se mungon kodi në burim, i cili është edhe shkaku i mos transferimit të aktiveve. Pas hartimit të listës së aktiveve për transferim midis dy institucioneve, nga ana formale për këto aktive afatgjata jo materiale, nga magazina me kod DPT M263, është përgatitur fletëdalje për transferim te AKSHI i aktiveve në vlerën 225,334 mijë lekë, por transferimi nuk është kryer për arsye të pretendimeve të AKSHI-t. Për të bëre të mundur përfundimin e kësaj procedure, nga punonjësit e AKSHIT-t të cilët punojnë në DPT, nga ana formale është bërë dorëzimi në magazinën e DPT i aktiveve të cilat janë objekt kalimi kapital nga DPT te AKSHI në vlerën 225,334 mijë lekë, por në fakt aktivet janë në përdorim të punonjësve te AKSHI-t që janë pranë DPT. Mos përfundimi i procesit të transferimit të aktiveve është në kundërshtim me urdhrin e përbashkët DPT-AKSHI nr. 8778 prot, datë 02.05.2019, sipas të cilit transferimi duhet të ishte përfunduar në datën 09.05.2019 (7 ditë pas daljes së urdhrit).*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

24.1.Rekomandim: Grupi i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe grupi i punës i ngritur për transferimin e aktiveve nga DPT tek AKSHI, të bashkëpunojnë me grupin

e punës të AKSHI-t i ngritur për këtë qëllim, për të bërë të mundur zgjidhjen e pengesave të deritanishme dhe të realizojnë përfundimin e transferimit të aktiveve nga DPT te AKSHI.

Deri më 30.11.2021

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve nuk ka krijuar GMS të ri, pas emërimit të tij me vendimin nr. 495, datë 15.07.2019 të Këshillit të Ministrave, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe me ndryshimet strukturore me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, ñPër disa ndryshime në urdhrin nr. 126 datë 02.08.2016, *"Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"* të strukturës së re organike, përbërjen e anëtarëve të GMS, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 8 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e titullaritò të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; si dhe kreu II, pika 2.2.6 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

25.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve duhet menjëherë të urdhërojë ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), me pjesëmarrjen e nivelit drejtues ekzistues të njësisë, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të përkujdeset për performancën e Institucionit. ***Deri më 30.11.2021***

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) ka funksionuar me rreth 80% të strukturës së miratuar, si rezultat i ndryshimeve strukturore, si dhe transferimeve të shpeshta të inspektorëve të saj, për shkak të ristrukturimit të DPT. Nga auditimi u konstatua se, nga 8 auditime të planifikuara për vitin 2020, kanë përfunduar procesin vetëm 2 auditime dhe janë në proces 3 të tjerë.

-Nga auditimi u konstatua se, në dosjen e DRT Dibër dhe DRT Tiranë ka mungesë të dokumenteve të auditimit, si dhe Raporti Përfundimtar i auditimit në DRT Tiranë nga DAB, është dorëzuar jashtë afateve të caktuara, si pasojë e pritjes së observimeve nga subjekti. Veprime këto, në kundërshtim me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm, i miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë; i ndryshuar.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

26.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkëpunim me DAP-in të marrin masa, në plotësimin e strukturës së DAB.

26.2. Rekomandim: Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa në vijimësi që çdo dosje angazhimi auditimi, të plotësohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas formatit standard 1, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të zbatojë afatet e dorëzimit të raporteve, në angazhimet e tyre audituese.

Deri më 31.12.2021

27. Gjetje nga auditimi Në përputhje me programin e auditimit të miratuar me nr. 333/1 prot. Datë 15.04.2020, KLSH ka kryer auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përfundim të cilit me shkresën nr. 333/16 prot., datë 30.10.2020,nga KLSH është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet. Zbatimi i rekomandimeve nuk është audituar më parë.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna, nga DPT është hartuar plani i masave në të cilin janë vendosur struktura përgjegjëse dhe afate për zbatim. Me shkresën nr. 21250/2, datë 20.01.2021, protokolluar në KLSH me nr. 333/17 prot, datë 20.01.2021, është njoftuar KLSH për hartimin e planit të masave. Si hartimi edhe njoftimi për planin e masave është bërë jashtë afatit 20 ditor nga data e marrjes së raportit përfundimtar, në kundërshtim me germën (j) të nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka raportuar pranë

Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 30.
Zbatimi nga DPT, i rekomandimeve të dhëna nga KLSH në raportin përfundimtar të auditimit me shkresën nr. 333/16 prot., datë 30.10.2020 paraqitet si vijon:
- Janë dhënë 46 masa organizative, nga të cilat 19 prej tyre janë në proces zbatimi, 13 nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar nga subjekti, 11 janë pranuar dhe janë zbatuar dhe 3 rekomandime janë pranuar, por nuk janë zbatuar.
- Janë dhënë 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 1,662,900 lekë, prej së cilës vlera 110,900 lekë për 6 raste për shërbimet e kryera jashtë qendrës së punës pa marrë më parë autorizim nga Titullari i Institucionit, ndërsa vlera 1,552,000 lekë për 14 raste, pagesa të kryera jo në përputhje me nivelin e diplomës për pagë grupi përpunonjës. Nga auditimi konstatohet se, nuk janë kryer arkëtime për vlerën e mësipërme, por 5 punonjës kanë filluar procese gjyqësore, 5 punonjës nuk janë më në marrëdhënie pune më DPT, 4 punonjës kane rene dakord për kthimin e shumes me këste mujore.
- Janë dhënë 14 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat 9 prej tyre janë në proces zbatimi, 2 masa nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar, 2 masa janë zbatuar dhe 1 masë është pranuar, por nuk është zbatuar.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
27.1.Rekomandim:Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për strukturat e ngarkuara në planin e masave, të cilët nuk kanë realizuar zbatimin e rekomandimeve. Të vijojë prej DPT marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe të pa zbatuara.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2020 nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në mënyrë të pa drejtë, në vlerën **377,601 mijë lekë**, **për 198 punonjës, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.** Kjo vlerë është 2.7 herë më e lartë se vlera e shpenzuar për këtë qëllim gjatë vitit 2019 (140,101 mijë lekë). Detyrimi i ngelur për DPT më 31.12.2020 për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna është në vlerën 184,759 mijë lekë për 168 punonjës.
Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar proceset gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve nga puna ka qenë i pa rregullt dhe nga institucioni i DPT nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për këtë proces. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga DPT në proceset e largimit të punonjësve nga puna, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi nga DPT, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhetin e shtetit që sjell humbja e çdo vendimi gjyqësor.
Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.*Trajtuar më hollësisht në pikën IV.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna, duke ulur në këtë mënyre efektet financiare në buxhet për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

1.2. Rekomandim: Nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pas kryerjes së analizës së vendimeve gjyqësore, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësive administrative, në përputhje me pikën nr. 60, të Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Kreun X ñDisiplina në Shërbimin Civilò, të Ligjit nr. 153/2013 ñPër nëpunësin civilò, mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 ñPër nëpunësin civilò, i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënie masash disiplinore nga ñVërejtjeò deri ñLargim nga shërbimi civilò, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar për kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga ñVërejtjeò deri në ñLargim nga punaò për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

V. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i kundërt mbi auditimin e përputhshmërisë

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2020, bazuar në ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore mbi bazën e të cilave e ushtron veprimtarinë subjekti i audituar.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kundërt.

Baza për opinionin

Problematikat e konstatuara përfshijnë mangësi:

- Mangësi nga auditimi Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku referuar treguesve të raportuar nga kjo drejtori, gjendja e detyrimeve të papaguara deri me datën 31.12.2020 është 122.4 miliard lekë. Stoku i detyrimeve tatimore gjatë vitit 2020 ka pësuar një rritje neto prej 5.4 miliard lekë krahasuar me një vit më parë.

-Mangësi në lidhje me përputhshmërinë e procesit të rimbursimit të TVSH-së,konstatohet mos respektimi i afateve kohore në lidhje me procesin e rimbursimit, nga ana e DRTVSH-së dhe DRT-ve. Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2020, rezultojnë 88 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuara por të pa miratuara në vlerën totale prej 1,992,004 mijë lekë, në tejkalim të afatit ligjor 60-ditor, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar. Si rezultat vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së, në opinionin tonë është 11,789,313 mijë lekë nga 9,797,309 mijë e paraqitur nga DPT.
- Mangësi në mos arkëtimin e të ardhurave nga kontributet për vlerën 16,521,124 mijë lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor.
- Mangësi në përbërje të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuara sipas natyrës dhe llojit, janë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 ñMjete në ruajtjeò e cila përfaqëson arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemimin e tyre.
- Mangësi në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzorë, ku konstatohen parregullsi në plotësimin e vendeve vakante edhe pse institucioni ka kaluar një proces të gjatë ristrukturimi dhe nuk ka përfunduar plotësimi i të gjitha vendeve të punës sipas strukturës së miratuar.
- Mangësi nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për shpenzimet për investime për vitin 2020, ku konstatohet një investim në vlerën 80 milion lekë, i realizuar pa patur fonde në dispozicion, në kundërshtim me disiplinës financiare.
- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë Menaxhimit të Riskut të cilat konstatohen në përmirësimin e modulit të riskut, standardizim dhe unifikim të raporteve të kontrollit për ti analizuar në mënyrë të detajuar për të identifikuar risqe të reja dhe me qëllim studimin e treguesve në mënyrë periodike; mungesa të një koordinimi më të mirë ndërmjet DRT-ve dhe Drejtorive funksionale në DPT me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut (DMR) të cilat duhet të informojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe rast pas rasti DMR, për risqe potenciale si bazë në hartimin e strategjive dhe evidentimin e të gjitha problematikave që mund të konsiderohen risk për realizimin e objektivave të Administratës Tatimore.
- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e DRT të cilat konstatohen në unifikimin e organizimit dhe të strukturës në përputhje me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore, në rritjen e pavarësisë, në përfundimin e analizimin e rasteve të denoncimeve të ardhura.
- Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të cilat konstatohen në monitorimin periodik të punës së drejtorive rajonale tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor, në përfundimin e kontrolleve dhe arkëtimin e detyrimeve, në realizimin e kontrolleve nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts, në mos përfundimin e kontrolleve për disa vite.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, ndër të cilat përmenden: Ligji për procedurat tatimore Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, i ndryshuar, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimi Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë
Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i

lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm. Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të regjistrimit, ekzekutimit dhe raportimit në sistemin e thesarit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VI. ANEKSET

Aneksi nr.1. Pika nr.2 - Mbi organizimin, funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së: a. Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, trajtuar nga faqja 23 deri në faqen 53 të raportit të auditimit.

KRITERET/RREGULLAT E APLIKUARA

NR.	KRITERI	LLOJI TATIMIT	PËRSHKRIMI
1	DEBTVAT	TVSH	Rritje e borxhit të TVSH-së.
2	ALLBEDT	Të gjitha	Rritje e borxhit për të gjitha llojet e tatimeve.
3	PITPL	TFTH	Humbje e vazhdueshme e TFTH 2 vite
4	CITPL	TF	Humbje e vazhdueshme e Tatim Fitimit 2 vite
5	CITDP	TF	Rënie e pagesës së TF
6	VATDP	TVSH	Rënie e vazhdueshme e pagesës së TVSH-së përtej një kufiri të përcaktuar
7	PITINC	PIT	TVSH/Të ardhurat nga deklarata TFTH. (Krahason xhiron për efekt TVSH-je me të ardhurat bruto të biznesit për efekt të tatim-fitimit te thjeshtuar)
8	CITINC	TF	TVSH/Të ardhurat nga deklarata e TF. (Krahason xhiron për efekt TVSH-je me të ardhurat bruto të biznesit për efekt të tatim-fitimit)
9	PRDECB	TF	Marzhi i fitimit nga TF më i ulët krahasuar me sektorin.
10	PRDEC	TF	Marzhi i fitimit nga TF më i ulët krahasuar me kombëtaren.
11	TCSALA	TAP	Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga si dhe ñnën deklarimin për profesion të caktuarò nga mesatarja e sektorit ku operon tatimpaguesi
12	TCSAL	TAP	Mat devijim e fondit të shpenzim për paga krahasuar me mesataren e sektorit ku operon tatimpaguesi
13	TPLTOB	TVSH	Qarkullim i lartë pagesë e ulët-krahasuar me sektorin
14	TPLTOA	TVSH	Qarkull i lartë pagesë e ulët-Kombë(Shkalla efektive tatimo është e ulët në krahasim me pl e TVSH).
15	TPLTO	TVSH	Qarkullim i lartë pagesë e ulët e TVSH
16	EXRTC	TVSH	Vlera e eksporteve më e madhe se mesatarja e sektorit
